REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Tel/Fax: +355 4 369987, www.fhf.edu.al
Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

Disertacion
Në kërkim të gradës "Doktor i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare"

Autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë në marrëdhëniet shqiptaro-greke, 1918-1937

Kandidati

Ardit BIDO

Udhëheqësi shkencor

Prof. dr. Ferit DUKA

Tiranë, 2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Tel/Fax: +355 4 369987, www.fhf.edu.al
Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

Disertacion
Në kërkim të gradës "Doktor i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare"

Autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë në marrëdhëniet shqiptaro-greke, 1918-1937

Kandidati

Ardit BIDO

Udhëheqës shkencor

Prof. dr. Ferit DUKA

Mbrohet më datë ___.___.2015

1. _____(Kryetar)
2. _____(Anëtar-oponent)
3. _____(Anëtar-oponent)
4. _____(Anëtar)
5. _____(Anëtar)

Tiranë, 2015

PËRMBAJTJE

PARATHËNIE III

HYRJE XV

KREU I: ÇËSHTJA KISHTARE SHQIPTARE, 1918-1921 1

1.1. Krijimi i strukturave të para kishtare ortodokse shqiptare 1
1.2. Mitropolit Jakovi dhe beteja shqiptaro-greke për Korçën 5
1.3. Rrymat mbi çështjen kishtare ndër ortodoksët shqiptarë 23
1.4. Çështja e "Shën Gjergjit" dhe dëbimi i kryepriftit të fundit grek nga Shqipëria 27
1.5. Feja në baraspeshën diplomatike shqiptaro-greke, 1919-1921 38

KREU II: SHPALLJA E AUTOQEFALISË DHE ZHVILLIMET, 1921-1924 49

2.1. Përgatitjet për shpalljen e autoqefalisë 49
2.2. Kongresi i Beratit 57
2.3. Luhatja e Patriarkanës: Bekimi fillestar dhe mosnjohja zyrtare 64
2.4. Veprimi i njëanshëm për krijimin e Sinodhit, 1923-1924 71

KREU III: BISEDIMET PËR NJOHJEN E KOASH-it, 1924-1928 80

3.1. Marrëveshja e fshehtë e Beogradit mes Zogut dhe Greqisë 80
3.2. Plani i fshehtë i Hirësi Jerotheut 81
3.3. Dorëzimi Episkop i Visarion Xhuvanit 84
3.4. Trysnia greke ndaj Ahmet Zogut për zbatimin e zotimeve të Beogradit 89
3.5. Përafrimi i dytë shqiptaro-grek dhe Protokolli Kishtar i Tiranës 94
3.6. Rikthimi në pushtet i Venizelosit dhe zvarritja e zgjidhjes 106

KREU IV: KRIJIMI I SINODHIT DHE KONGRESI I KORÇËS, 1928-1929 121

4.1. Dështimet e përpjekjeve fillestare për krijimin e Sinodhit, 1928 121
4.2. Trupëzimi i Kishës dhe fronëzimi i episkopëve 132
4.3. Mbledhja e Sinodhit të Shenjtë dhe Kongresi i Dytë Kishtar 141
4.4. Qëndrimi jugosllav në kundërshtitë shqiptaro-greke për KOASH-in 152
4.5. Kundërveprimet e Patriarkanës, shtetit grek dhe mërgatës shqiptare 161

KREU V: FUQIZIMI I KOASH-it DHE NJOHJA ZYRTARE, 1929-1937 174

5.1. Bisedimet e reja me Patriarkanën Ekumenike, 1929-1931 174
5.2. Fuqizimi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë 183
5.3. Rikthimi i Kristofor Kisit dhe dorëheqja e Visarionit 201
5.4. Njohja e Autoqefalisë 211

PËRFUNDIME 220

BIBLIOGRAFIA 227

PARATHËNIE

Marrëdhëniet ndërkombëtare nuk mund të mos preken nga një fuqi aq e papërmbajtshme, sa feja. Ajo ka qenë shpeshherë vendimtare në baraspeshat ndërmjet shteteve. Kjo, sepse vetia fetare ka vepruar në disa raste si bashkëpunuese me varësinë shtetërore/kombëtare të njeriut e herë të tjera, pse vetia fetare ka tejkaluar kufijtë e një shteti të vetëm. Ndërthurja mes përkatësive të tjera të njeriut dhe vetisë fetare nuk mund të mos prekë thelbin e gjithsecilës.

Historiografia shqiptare e ka përçmuar ndikimin e fesë, edhe pse ai është më i gjerë, më i thellë dhe thuajse tërësisht i patrajtuar. Ngjyrimi ka qenë thuajse gjithnjë fyes në ato pak herë kur feja është shqyrtuar, në një kohë, kur ajo ka qenë shpeshherë pararojë e përkatësisë etnike e më pas kombëtare edhe për shqiptarët.

Shembulli më i dukshëm mund të cilësohet ai i Kishës Ortodokse në rastin shqiptar, teksa përmban disa veçanti në krahasim me bashkësitë e tjera fetare. Këto arsye, krahas përafrisë vetjake kundrejt ortodoksisë dhe shqiptarisë, më bënë të zgjedh temën "Autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë në marrëdhëniet shqiptaro-greke 1918-1937".

a) Teza dhe sfondi teorik

Kundërthëniet shkencore u ringjallën, kur Samuel Hantingtoni foli për përplasjen e qytetërimeve. Çështja nuk qëndronte vetëm si do të ishte bota pas Luftës së Ftohtë, por edhe se si ka qenë përpara. Hantingtoni arsyeton përplasjen mes nëntë qytetërimeve, që shërbejnë si grupime të mëdha, ku njerëzit vetëpërkiten në një njësi të përbashkët fetare-tokësore-gjuhësore a veçori të tjera përbërëse.[1]

Dijetarët morën hov dhe nxorën fenë nga errësira e trajtimit shkencor. Mirëpo, një ndër pyetjet më kryesore që lindi ishte si kishte ndikuar feja në periudhat ku ajo kishte shërbyer si përcaktues parësor i ngjizjes së bashkësive shoqërore, po ashtu si përplasja e qytetërimeve do të rikrijonte rendin botëror, sipas Hantingtonit?

Ndikimi i fesë ka qenë i pranishëm, por shpeshherë nënvlerësohej në trajtimin teorik. Në cilat trajta ka vepruar feja në marrëdhëniet ndërkombëtare?[2] *Pranohet se ajo ka qenë gjithmonë ndikuese në katër kuptime: ligjërimi i aktorëve politikë, krijimi i botëkuptimeve të reja, përplasjet fetare, që shndërroheshin në përplasje ndërkombëtare dhe dukuri ndërshtetërore fetare që kthehesh in në çështje ndërkombëtare.*[3]

Po në hapësirën shqiptare, në çfarë formash ka ndikuar feja në marrëdhëniet ndërkombëtare? Studimi nuk mund të ishte veçse i kufizuar në kohë, hapësirë dhe tematikë. Për këtë arsye, janë përzgjedhur Kisha Ortodokse, periudha e mesluftës dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke. Ky kufizim vjen, së paku, për katër arsye.

---

[1] *Samuel P. Huntington, Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror (Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos-A, 2009).*

[2] *Shih edhe: Fabio Petito; Pavlos Hatzopoulos, Religion in international relations: the return from exile [Feja në marrëdhëniet ndërkombëtare: Rikthimi nga ekzili] (Londër: Palgrave Macmillan, 2003)*

[3] *Për përqasjet kryesore teorike shih: Cecelia Lynch, "A neo-Weberian approach to religion in international politics [Një përqasje neo-Veberiane për fenë në politikën ndërkombëtare]", International Theory [Teoria ndërkombëtare] (Cambridge: Cambridge University Press: 2009), 381-408; Daniel Philpot, "The religious roots of modern international relations [Rrënjët fetare të marrëdhënieve moderne ndërkombëtare]", World Politics 1 (2000); si edhe Simon Polinder, International relations, religion, and the transcendent [Marrëdhëniet ndërkombëtare, feja, dhe trashedenti] (Leuven: Peeters, 2008)*

Së pari, ortodoksia është feja mbisunduese në Ballkan e rrjedhimisht roli që mund të luante në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë me fqinjët është më i lartë sesa bashkësitë e tjera fetare. Së dyti, ortodoksët shqiptarë kishin veçorinë e të qenit në një milet të madh mbietnik gjatë Perandorisë Osmane, të përbërë nga helenë, bullgarë, vllehë, e etni të tjera, që shkallë-shkallë u rrudh numerikisht dhe u shndërrua në kombin grek, duke krijuar një dyjëzim etniko-fetar.[4] *Së treti, bashkëveprimi mes shtetit dhe Kishës Ortodokse është pjesë e pandashme e vlerave të kësaj feje, përmbledhur në parimin "symphonia". Së katërti, periudha e mesluftës mundëson një trajtim të drejtpërdrejtë të marrëdhënieve shqiptaro-greke, teksa të dyja shtetet ishin të pavarura, në ndryshim nga më parë dhe të pandikuara nga ndarjet Lindje-Perëndim, të periudhës së mëvonshme.*

Punimi do të orvatet të pasqyrojë zhvillimin e përkatësisë fetare në Shqipëri dhe përplasjen diplomatike shqiptaro-greke. Pasqyrimi do të jetë në shërbim të tezës kryesore se njohja e autoqefalisë së Kishës Ortodokse në Shqipëri ka qenë një variabël i marrëdhënieve shqiptaro-greke dhe ka pësuar të njëjtat ulje-ngritje me to.

> *"Teoritë, mendimet dhe prirjet e mëdha të marrëdhënieve ndërkombëtare përfshijnë një paragjykim kundërfetar. Kjo nuk do të thotë se ato mohojnë prerazi rëndësinë e fesë, porse ato nuk e përfshijnë fenë në listën e çështjeve të rëndësishme".*[5]

Feja ka qenë ndikues dhe aktor në marrëdhëniet ndërkombëtare, përgjatë historisë. Prandaj, nuk mund të thuhet se ka diçka të re në teoritë bashkëkohore që i njohin fesë trajtën e "fuqisë së butë" në marrëdhëniet ndërkombëtare. Të vepruarit si "fuqi e butë" rrjedh ngaqë feja është një ngrehinë ndërshtetërore, që prek përkatësinë e mund t'i bëjë besimtarët të ndikojnë në paqëndrueshmërinë e shtetit, pjesë e të cilit janë. Mirëpo, kisha ndikon në marrëdhëniet ndërkombëtare edhe duke vepruar si aktor i mirëfilltë joshtetëror.[6]

Gjithsesi, ndikimi i fesë në marrëdhëniet ndërkombëtare është më i kufizuar, në sfondin e vendngjarjeve dhe periudhës kohore të shqyrtuar në këtë punim. Feja ka ndikuar në marrëdhëniet shqiptaro-greke të mesluftës si levë trysnie diplomatike. Bëhet fjalë për periudhën, kur marrëdhëniet ndërkombëtare bënë një përçapje të pasuksesshme të institucionalizimit liberal, të frymëzuara nga parimet uillsoniane. Ajo përbën një

---

[4] *Mileti rum u rrudh, gjatë periudhës së kombformimeve në Ballkan, me krijimin e Ekzarkatit Bullgar që u bë qendra e kombit bullgar, bashkësisë ortodokse vllehe që u orvat të krijonte kombin vlleh, apo kombit shqiptar që përthithi një pjesë të ortodoksëve shqiptarë. Nga ana tjetër, një pjesë e rëndësishme e bullgarëve (patriarkalistët), vllehëve, shqiptarëve (arbërorët, çamët ortodoksë), apo turqëve ortodoksë mbetën pjesë e miletit rum dhe u përfshinë në kombin grek. Ndërkaq, grekët etnikë myslimanë u "përjashtuan" nga kombi grek, pasi ai u bazua mbi miletin fetar rum. Për procesin e shndërrimit të "miletit rum" nga një ngrehinë fetare mbietnike, në bazën e themelimit të kombit grek shih: Victor Roudometof, "From Rum Millet to Greek Nation: Enlightenment, Secularization, and National Identity in Otoman Balkan Society, 1453-1821", Journal of Modern Greek Studies 16:1 (1998).*

[5] *Jonathan Fox: "The Multiple Impacts of Religion on International Relations: Perceptions and Reality [Impaktet e shumëfishta të fesë në Marrëdhëniet Ndërkombëtare: Perceptimi dhe realiteti]", International Studies Review [Rishikimi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare] (New York: Fall, 2001). Për më shumë rreth anashkalimit të fesë si faktor në marrëdhëniet ndërkombëtare, shih Jonathan Fox: "Religion as an Overlooked Element of International Relations [Feja si një element i anashkaluar i marrëdhënieve ndërkombëtare]", International Studies Review [Rishikimi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare] (New York: Fall, 2003)*

[6] *Po aty.*

periudhë kalimtare mes Koncertit të Vjenës, ku fuqitë e mëdha luanin me baraspeshën shumëpolëshe, dhe Luftës së Ftohtë, kur dy kampe botërore krijuan përplasje dypolëshe. Ndaj, meslufta është një sfond i veçantë.[7] Kjo e bën tezën e punimit të mund të trajtohet veçmas nga çështja kishtare përpara Luftës së Parë Botërore dhe nga ajo pas vitit 1937, pa pasur nevojën e rikthimit të vazhdueshëm për sqarimin e rrethanave historike. Çështja kishtare shqiptare mund të shihet po ashtu në këndvështrimin e marrëdhënieve shqiptaro-greke, përpara Luftës së Parë Botërore, si pjesë e çështjes lindore. Mirëpo, ajo ishte një përplasje e lëvizjes kombëtare shqiptare të pas-Lidhjes së Prizrenit, të painstitucionalizuar dhe shumëtrajtëshe me shtetin grek e Patriarkanën Ekumenike. Kjo përleshje zhvillohej në sfondin e mëtimeve tokësore të shpallura haptazi dhe të pafshehura, çka do të ndryshonte pas vitit 1919. Po ashtu, çështja kishtare shqiptare ndërron formë edhe pas vitit 1937, fillimisht si pjesë e Luftës së Dytë Botërore, për t'u vendosur në kornizën e betejës mes kampeve ideologjike pas vitit 1945. Rrjedhimisht, periudha e mesluftës u pa e nevojshme të trajtohej në tërësinë e vet, madje pak përpara fundit të Luftës së Parë Botërore. Kjo mundësoi nisjen e trajtimit nga shqiptarizimi i Kishës gjatë kësaj lufte, që përbën një çast kyç dhe shënon fillimin e një periudhe të re në trajtimin e çështjes kishtare.

Shqyrtimi lehtësohet nga një parim kyç i ortodoksisë: "symphonia". Ky parim bizantin nënkupton një "baraspeshë të përsosur" mes pushtetit laik dhe atij kishtar. Kështu, Kisha nuk do të ndërhynte në punët e shtetit dhe shteti nuk do të ndërhynte në punët e brendshme të Kishës. Kjo do të thotë bashkëveprim mes dy njësive, pra gjetja e një baraspeshe të vazhdueshme mes shtetit dhe kishës. Në të vërtetë, ajo nënkupton përshtatjen e Kishës në kushtet e natyrës shtetërore, pa u larguar assesi nga dogma, të cilën shteti duhet ta nderojë. Autoqefalia është vetëqeverisja kishtare e pandikuar nga kisha e një shteti tjetër, ku prijësi kishtar zgjidhet nga Sinodhi i Shenjtë i vetë kishës vendore dhe nuk i përgjigjet asnjë të huaji për çështje të qeverisjes kishtare. "Symphonia" nuk është e barasvlershme me autoqefalinë, edhe pse autoqefalia mund të shihet si një parakusht i "symphonisë", në kushtet e një shteti të pavarur me popullsi vendase ortodokse. "Symphonia" nënkupton veprimin e Kishës në bashkëjetesë me zyrtarët shtetërorë, që në kushtet e kombshtetit do të thotë veprimin edhe mbi themele atdhetare.[8]

Rrjedhimisht, "symphonia" në Shqipërinë e mesluftës nënkuptonte pikërisht një detyrim teologjik të drejtuesve kishtarë për të vepruar si një kishë kombëtare. Ky parim i rëndësishëm dogmatik ortodoks shpjegon se përse, siç do të shohim, të gjithë kryepriftërinjtë shqiptarë (me përjashtim vetëm të njërit) pranuan të përvijonin krijimin e një kishe kombëtare dhe punuan me përkushtim më të madh se shteti në këtë drejtim.

Fuqizimi i rrymës kombëtare të shtetit në të cilin Kisha vepron, është një domosdoshmëri fetare. Atdhetarizmi apo nacionalizmi humanist joshovinist përbëjnë një parim dogmatik të fesë. Ajo çfarë ortodoksia sheh si të palidhur me vetveten nuk është ideja kombëtare, por nënvlerësimi i kishës para saj. Mbitheksimi i kombit ndaj kishës është herezi, e përcaktuar që prej vitit 1872 si etnofiletizëm, teksa ajo do ta

---

[7] *Për trajtimin teorik të Koncertit të Vjenës dhe Luftës së Ftohtë shih edhe Henry Kissinger, Diplomacia, (Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999); Joshua S Goldstein, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, (Tiranë: Dituria, 2003).*

[8] *Lucian Leustean, edit., Eastern Christianity and the Cold War, 1945-91 [Krishtërimi Lindor dhe Lufta e Ftohtë, 1945-91] (Londër: Routledge, 2010), 1.*

pamundësonte natyrën e Përgjithshme (Katholike/Universale) të Kishës Ortodokse. Mirëpo, mosmbështetja e atdhetarisë dhe kombit nga Kisha është po aq kundërortodokse. Ky rol i Kishës është i pamohueshëm, për aq sa vetë besimtarët janë pjesë e një kombi.[9]

Rrjedhimisht, dëshira e shtetit dhe kombit grek për të pasur nën drejtim Kishën Shqiptare, si levë trysnie, apo trajtë ndikimi e sundimi të një pjese të popullsisë shqiptare vinte në përplasje me një parim dogmatik të vetë ortodoksisë, si "symphonia", duke përdorur edhe herezi si etnofiletizmi. Nga ana tjetër, shteti i sapokrijuar shqiptar kërkonte të krijonte "baraspeshën e re të përsosur" ose "symphoninë" e re mes shtetit dhe kishës, në parime kombëtare dhe në prirje për të fuqizuar kombshtetin. Këto parime dogmatike ortodokse përbëjnë sfondin fetar të çështjes kishtare shqiptare në marrëdhëniet shqiptaro-greke.

b) Struktura

Ndarja e punimit në pesë krerë e më tej në sythe të renditura sipas rrjedhës kohore u pa e nevojshme, nisur nga natyra e çështjes. Përmbajtja çelet me kreun e emërtuar "Çështja kishtare shqiptare, 1918-1921", që trajton periudhën nga fundi i Luftës së Parë Botërore deri në përmbylljen e çështjes së kufijve të Shqipërisë.

Kreu ndahet në pesë sythe, ku i pari përshkruan "Krijimin e strukturave të para kishtare ortodokse shqiptare", që kulmuan në vitin 1919: Kishën Shqiptare në SHBA e vetëshpalljen e Arkimandrit Theofan Nolit në episkop, dhe "Arqimandritinë Nasionale Shqiptare" nga Arkimandrit Visar Xhuvani në Shqipërinë e Mesme.

Sythi i dytë përqendrohet në qendrën e lëvizjes kishtare shqiptare, që ishte Korça. Ai përshkruan ndodhitë nga fundi i Luftës deri në vendimin e bashkimit të trevës me qeverinë e Tiranës, dy vite më vonë, dhe betejën diplomatike shqiptaro-greke mbi të. Njeriu kyç i Greqisë ishte një kryeprift: Jakov Ngjingjilias, ish-Mitropolit i Durrësit. Ai do të dërgohej me nismën e kryeministrit grek Venizelos dhe do të mundësonte rilindjen e rrymës greke në Korçë. Kjo u krye nëpërmjet rindalimit të meshimit në shqip, çeljes së shkollave greke dhe një rrjeti të frytshëm përgjimi. Përpjekja synonte përgatitjen e pushtimit të Korçës nga Greqia. Mospasja e trupave ushtarake të mjaftueshme e pamundësoi planin, çka solli Protokollin e Kapshticës. Protokolli pasqyrohet në trajtën e vërtetë për herë të parë, falë arkivave greke dhe shqiptare. Sythi trajton në fund përplasjen e lindur nga një përkujtesë kundërthënëse e hartuar nga atdhetarë shqiptarë që rrezikoi zgjedhjet e para në Korçë dhe fijet e lëvizura në prapaskenë nga Hirësi Jakovi. Po ashtu, shqyrton arsyet e mosdështimit të zgjedhjeve në Gjirokastër, edhe pse ai qark kishte një prani domethënëse të pakicës greke.

Sythi i tretë shtjellon rrymat e ortodoksëve shqiptarë për zgjidhjen e çështjes kishtare dhe madhësitë e tyre, nga zgjidhja e njëanshme e mbështetur nga Fan Noli dhe vatranët, te zgjidhja e kujdesshme që kërkonin atdhetarë liberalë si Sotir Peci apo

---

[9] *Shih edhe Joan Pelushi (Mitropolit), "Kisha Ortodokse dhe Konfliktet Etnike", Tempulli 9 (2004), 1-9. Raste të pastra etnofiletizmi mund të dallohen në Mitropolitët Jakov i Durrësit, Gjermanos i Korçës dhe Vasil i Gjirokastrës, të cilët u vunë në krye të fuqisë ushtarake për çlirimin e "Epirit të Veriut", në kundërshti me mësimet fetare. Po ashtu, mohimi që ata i bënë të drejtës së shqiptarëve për të meshuar në gjuhën amtare, për t'u shpallur si shqiptarë dhe për të marrë pjesë në jetën e kombit shqiptar, i përfshin pashmangshmërisht ndër etnofiletistë. Nga ana tjetër, ajka ortodokse shqiptare vështirë se mund të përfshihet në këtë bashkësi. Kryepriftërinjtë shqiptarë të kishës, duke nisur nga Hirësi Jerotheu, Kristofori, Theofani, Visarioni, Ambrozi e të gjithë me radhë nuk i hoqën në asnjë rast të drejtat etnike pakicës greke në Shqipëri, duke vepruar pikërisht sipas natyrës së Përgjithshme (Katolike/Universale) të Kishës.*

Visarion Xhuvani, te rryma konservatore, që kërkonte autoqefali me pranueshmëri nga Patriarkana, e deri te një pakicë e papërfillshme grekomane.

Sythi i katërt emërtohet "Çështja e "Shën Gjergjit" dhe dëbimi i kryepriftit të fundit grek nga Shqipëria". Ai trajton meshën e parë shqip nga Atë Vasil Marko, pas ndalimit njëvjeçar. Përmasat e vërteta të ngjarjes rindërtohen falë kujtimeve të nismëtarëve të meshës dhe arkivave të kohës. Greqia kërcënoi me luftë, për shkak të çështjes së Shën Gjergjit, çka solli përgatitjet dhe tërheqjen e palës shqiptare. Gjithashtu, sythi shqyrton zhvillimet nga ndalimi i përsëritur i meshimit në shqip, deri në dhënien në duart e korçarëve të çelësave të kishës, kur u dallua se Greqia nuk kishte fuqi ushtarake për të kërcënuar Shqipërinë. Ai përshkruan dëbimin e Jakovit, ditën kur çështja e kufijve u mbyll përfundimisht dhe Fuqitë e Mëdha e ripohuan Korçën si tokë shqiptare.

Sythi i pestë, "Feja në baraspeshën diplomatike shqiptaro-greke, 1919-1921" shqyrton përpjekjet diplomatike të Greqisë për të paraqitur praninë e shumë feve në Shqipëri si arsye e përçarjes së shoqërisë shqiptare. Po ashtu, trajton zhvillimet në Lidhjen e Kombeve, përfshi edhe përpjekjet greke për të ndërkombëtarizuar çështjen e Kishës së Shën Gjergjit. Sythi përmbyllet me kundërshtitë ndërkombëtare për dëbimin e Jakovit dhe përcaktimet e "Shpalljes për Mbrojtjen e Pakicave", që do të përvijonin marrëdhëniet shqiptaro-greke së paku për një dhjetëvjeçar.

Kreu i dytë trajton shpalljen e autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë dhe zhvillimet në çështjen kishtare përgjatë viteve 1921-1924. Ai ndahet në katër sythe. Sythi i parë nis me shpalljen e parë të autoqefalisë nga Arkimandrit Visari, në nëntëvjetorin e pavarësisë. Theofan Noli u përpoq të njihej si prijës i Kishës, po ato ditë, por u tërhoq pas kundërshtive të rrymës atdhetare liberale. Sythi përshkruan përgatitjet për Kongresin e Beratit, njerëzit që vepronin në prapaskenë dhe përkimin e ditënisjes së tij me humbjen greke në Luftën me Turqinë.

Sythi i dytë trajton mbledhjen dhe vendimet e Kongresit dhe fuqizimin e Kishës Autoqefale, nisur nga parimet e Statutit të Beratit, çka bëri të dukshme përplasjet Noli-Xhuvani.

Sythi i tretë "Luhatja e Patriarkanës: Bekimi fillestar dhe mosnjohja zyrtare" trajton kundërshtitë e para nga ish-mitropolitët grekë të Shqipërisë dhe njohjen e autoqefalisë nga i dërguari i Kishës Mëmë, Jerothe Jaho. Në fund, sythi shtjellon dështimin e bisedimeve kishtare në Stamboll. Ndryshimi i qëndrimit të Patriarkanës lidhej ngushtësisht me çështjen greko-turke dhe arritjen e marrëveshjes në Konferencën e Lozanës.

Sythi i katërt,"Veprimi i njëanshëm për zgjidhjen e çështjes kishtare, 1923-1924" trajton zhvillimet e brendshme. Ai shtjellon ardhjen e Hirësi Kristofor Kisit dhe veprimin sipas Statutit të Beratit, çka solli dorëzimin e rregullt si Mitropolit të Durrësit të Hirësi Theofan Nolit. Noli shihej si përshpejtues i zgjidhjes së çështjes kishtare. Mirëpo, ajo mbeti në vendnumëro kur mitropoliti u bë edhe kryeministër.

Kreu i tretë emërtohet "Bisedimet për njohjen e KOASH-it, 1924-1928" dhe ndahet në gjashtë sythe. Sythi i parë emërtohet "Marrëveshja e fshehtë e Beogradit mes Zogut dhe Greqisë" dhe trajton periudhën e vrullshme të rikthimit të Ahmet Zogut në pushtet. Ai kishte arritur marrëveshje me Serbinë dhe Greqinë për ndihmesë në orvatjen e rrëzimit të qeverisë së Nolit, që vjen në historiografinë shqiptare për herë të parë. Zotimet gojore përmbanin lëshime në çështjen kishtare, shkollore dhe gjuhësore.

Sythi i dytë emërtohet "Plani i fshehtë i Hirësi Jerotheut", që u dorëzua në Athinë në fillimvitin 1925.

Sythi i tretë trajton dorëzimin në Episkop të Visarion Xhuvanit, si një as nën mëngë për zgjidhjen e çështjes kishtare.

Sythi i katërt trajton "Trysninë greke ndaj Ahmet Zogut për zbatimin e Zotimeve së Beogradit" nga janari në shtator 1925 dhe mënyrën se si ia doli të shmangte zbatimin e marrëveshjes, edhe falë bashkëpunimit me Hirësi Jerotheun, Kisin, Xhuvanin, Atë Vasil Markon etj.

Sythi i pestë, "Përafrimi i dytë shqiptaro-grek dhe Protokolli Kishtar i Tiranës" trajton përmirësimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, gjatë qeverisjes së Greqisë nga gjenerali shqiptar Theodoros Pangalos. Përafrimi solli ndalimin e trysnisë për zbatimin e Marrëveshjes së Beogradit dhe pranimin nga Greqia se ortodoksët shqiptarë nuk ishin grekë. Drejtuesit kishtarë shqiptarë u bënë gati të krijonin Sinodhin në themele kombëtare. Kjo nuk u zbatua, për shkak se Patriarkana pranoi ta njihte autoqefalinë, me urdhër të Greqisë. Ajo dërgoi Ekzarkun Krisanthos në Tiranë, me të cilin u arrit nënshkrimi i Protokollit Kishtar, që përcaktonte mënyrën e njohjes së Kishës Shqiptare.

Sythi i gjashtë, "Rikthimi në pushtet i Venizelos dhe zvarritja e çështjes kishtare" sjell ndryshimin e ri të qëndrimit të palës greke dhe vendimin e Shqipërisë për zgjidhje të njëanshme. Lakorja e marrëdhënieve dypalëshe do të shoqërohej nga lakorja e zgjidhjes së çështjes kishtare. Rënia e gjeneral Pangalosit nga pushteti anoi baraspeshat kundër Shqipërisë. Hirësi Krisanthosi u dërgua sërish më 1927 me kundërsugjerime të Patriarkanës Ekumenike, të cilat u kundërshtuan nga pala shqiptare si përpjekje për krijimin e një shteti brenda shtetit. Patriarkana u tërhoq duke paralajmëruar njohjen e autoqefalisë, porse zvarriti zgjidhjen, duke nxjerrë arsyetime të njëpasnjëshme. Sythi arsyeton se përse Tirana zyrtare vendosi për "zgjidhje të njëanshme", kur Patriarkana i kaloi pa bujë gjysmën e mitropolive të saj Kishës së Greqisë.

Kreu i katërt, "Krijimi i Sinodhit dhe Kongresi i Dytë i KOASH, 1928-1929", ndahet në katër sythe. I pari emërtohet "Dështimet e njëpasnjëshme fillestare për krijimin e Sinodhit, 1928". Ai trajton ndërlidhjen mes shpalljes së Mbretërisë dhe zgjidhjes së çështjes kishtare dhe përshkruan katër përpjekjet e dështuara të krijimit të Sinodhit, pas tërheqjes së njëpasnjëshme të Vasil Joanidhit, Pandeli Kotokos, Hirësi Jerotheut, Hirësi Joakimit dhe Hirësi Kristoforit.

Sythi i dytë pështjellon ngritjen e Sinodhit të Shenjtë, nën drejtimin e Visarion Xhuvanit dhe fronëzimin e episkopëve.

Sythi i tretë trajton periudhën nga prilli në gusht 1929, duke nisur me mbledhjen dhe vendimet e para të Sinodhit, mbledhjen e Kongresit të Dytë Kishtar dhe përmbajtjen e statutit e rregullores së miratuar.

Sythi i katërt përshkruan arsyet pse Jugosllavia ndihmoi Kishën Shqiptare, por më pas nuk e njohu, nisur nga ndërhyrjet e shtetit grek. Sythi i katërt trajton mbarë kundërshtitë shqiptaro-greke në çështjen e trupëzimit të Sinodhit. Ajo nis me kundërpërgjigjet zyrtare të Patriarkanës Ekumenike dhe vijon me keqpërdorimin e emrit dhe syrgjynosjen e Hirësi Jerotheut nga shteti grek. Në fund, parashtron betejën në shtypin e dy vendeve dhe kundërshtimet e mërgatës shqiptare.

Kreu i pestë dhe i fundit emërtohet "Fuqizimi i KOASH-it dhe njohja zyrtare, 1929-1937". Sythi i parë trajton bisedimet me Patriarkanën, nga marrëveshja e 9 dhjetorit 1929, në mospranimin shqiptar.

Zhvillimet e jashtme kishin pasoja në zhvillimet e brendshme dhe anasjelltas, ndaj sythi i dytë trajton "Fuqizimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë". Ai përshkruan risitë në arsim, shtyp, përkthimin dhe botimin e dhjetëra librave kishtarë, heqjen e zakoneve të vjetra dëmtuese, afrimin e emrave më të njohur ortodoksë në strukturat drejtuese, rritjen e atdhetarizmit, fuqizimin ekonomik dhe qeverisës kishtar, krijimin e shoqërive bamirëse etj. Këto sollën rritjen e përqindjes së ortodoksëve në numërimin e vitit pasardhës. Sythi trajton përpjekjet e drejtuesve të rinj të Kishës për ndalimin e meshimit të huaj dhe veçanërisht betejën e ashpër të Fortlumturi Visarionit kundër Unitizmit. Ndërkaq, trajton edhe ndërkombëtarizimin e KOASH-it.

Sythi i tretë shtjellon rikthimin e Kristofor Kisit si Mitropolit i Korçës më 1933 dhe përplasjen me Kryepiskopin, çka e vendosi Visarionin edhe përballë qeverisë. Fortlumturia kuptoi se vullneti qeveritar ishte largimi i tij nga kryesia e KOASH-it dhe bëri përpjekjet e fundit për arritjen e njohjeve zyrtare, derisa u dorëhoq.

Sythi i fundit trajton njohjen e autoqefalisë. Ngjarjet ndodhin në kohën e përafrimit të tretë shqiptaro-grek, të arritur në vitet 1935-1937, kur çështjet mes dy vendeve u zgjidhën me vullnet të dyanshëm. Sythi paraqet marrëveshjen përfundimtare mes Shqipërisë dhe Greqisë e Patriarkanës Ekumenike të arritur në Athinë në fillimvitin 1937 dhe marrjen e Tomosit (aktit zyrtar të njohjes së autoqefalisë). Punimi përmbyllet me faljen e Visarion Xhuvanit nga Patriarkana, çka përbën hapin e fundit të çështjes kishtare shqiptare të kësaj periudhe.

c) Shqyrtim bibliografik

Punimi pikëniset nga arkivat e Shqipërisë dhe Greqisë, kryesisht Arkiva Qendrore e Shtetit (fondet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Fan Noli, Sotir Peci, Kryeministria, Zëvendësmitropolia Durrës, Mitropolia Korçë etj.), Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Arkiva Historike dhe Logoteknike Greke (Fondet Eleftherios Venizelos dhe Krisanthos) dhe Arkiva e Përgjithshme e Shtetit Grek. Hyrja në arkivat diplomatike greke u pamundësua për shkak të mospranimit nga Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë. Vështirësia u tejkalua nga gjetja dhe shfrytëzimi i arkivave të botuara në katër vëllimet e Vasilios Kondis, Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών [Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet greko-shqiptare: shkresa nga Arkiva Historike e Ministrisë së Jashtme]. Po ashtu, shtypi i kohës ka ndihmuar si burim parësor arkivor.

Disa botime kanë trajtuar çështjen kishtare shqiptare të kësaj periudhe. Dy të parat në rend kohor janë kaptina "Kisha Greke dhe Shqipëria", në librin Gerasimos Kondiaris, Η Ελληνική Εκκλησία ως Πολιτιστική Δύναμις εν τη Ιστορία της Χερσονήσου του Αίμου [Kisha Greke si Fuqi Qytetëruese në Historinë e Siujdhesës së Hemit], (Athinë: 1948), 188-250, si edhe Varnavas Xorxatos (Mitropolit), Η Αυτοκέφαλος Ορθόδοξος Εκκλησία της Αλβανίας και οι βασικοί θεσμοί διοικήσεως Αυτής [Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe ngrehinat themelore drejtuese të saj] (Athinë, 1975). Megjithatë, këto botime janë sipërfaqësore, me burime të pakta e tërësisht greke e rrjedhimisht pa risi të veçanta shkencore.

Apostolos Glavinas është studiuesi i parë që ka trajtuar çështjen kishtare shqiptare në pikëpamjen shkencore. Ai botoi fillimisht librin Το αυτοκέφαλον της εν Αλβανία Ορθοδόξου Εκκλησίας επί τη βάσει ανεκδότων εγγράφων [Autoqefalia e Kishës

Ortodokse në Shqipëri nisur nga shkresa të pabotuara], (Janinë: Fondacioni i Jonit, 1978), të cilin e pasuroi në vitin 1992, me: Ορθόδοξη Αυτοκέφαλη Εκκλησία της Αλβανίας. [Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë] (Selanik: Universiteti Aristoteli i Selanikut, 1992). Ky botim përmban përqasje të dobishme kryesisht arkivat e Patriarkanës Ekumenike dhe arkivat vetjake të Hirësi Jerothe Jahos dhe Hirësi Kristofor Kisit. Megjithatë, studimi çalon në tri drejtime kryesore: së pari, mungesa e arkivave shqiptare për një zhvillim që ndodhte në Shqipëri e bën atë së paku gjysmak. Së dyti, botimet e Glavinës kanë mungesë të arkivave diplomatike greke, duke mos trajtuar sfondin politik të çështjes kishtare shqiptare. Së treti, qasja e Glavinës është ajo e "studiuesit grek" në shërbim "të dobisë greke". Kjo dallohet sidomos në trajtimin e Xhuvanit, Nolit apo Kisit, të cilët "i qorton" se nuk i shërbyen "Epirit të Veriut".

Mihal Tritos është një tjetër autor grek që ka trajtuar çështjen kishtare shqiptare të kësaj periudhe. Ai ka botuar librin Η εκκλησία στο ανατολικό Ιλλυρικό και την Αλβανία [Kisha në Ilirikun Lindor dhe në Shqipëri] (Athinë: Qiriaqidhi Afi, 1999). Megjithatë, ky botim është më pak cilësor sesa Glavina, si në burime dhe në qasje.

Studimet e thelluara në historiografinë shqiptare janë të pakta. Historianët shqiptarë kanë zhvilluar tri konferenca, ku është rrekur të trajtohet çështja kishtare. Përpjekja e parë ka qenë në vitin 1992, me konferencën "70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare" (botuar në Tiranë: Instituti i Historisë, 1993). Mund të veçojmë disa kumtesa të rëndësishme mbi periudhën e trajtuar në këtë punim, si: Kaliopi Naska, "Kongresi themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat"; Koço Bihiku, "Themelimi i Kishës Ortodokse Kombëtare dhe roli i Nolit"; Valentina Duka, "Veprimtaria e Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës (1912-1920); Muin Çami, "Kleri i Lartë Ortodoks në Shqipëri dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1912-1921"; Aurela Anastasi, "Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe evoluimi i tij"; Fatmira Rama, "Sinodi i Parë Shqiptar dhe Kongresi i Dytë Panortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare"; Alqi Jani, "Papa Pano Gjirokastra - Figurë e shquar e Kishës Shqiptare" etj.

Përpjekja e dytë ka qenë në kapërcyell të mijëvjeçarit të ri, me konferencën "200 vjet Krishtërim dhe qytetërim shqiptar". Ndërkaq, përpjekja e tretë ka qenë konferenca "Shteti dhe feja në Shqipëri 1912-2000", organizuar në vitin 2010 nga departamenti i Historisë i Universitetit të Tiranës". Mund të veçojmë disa kumtesa të rëndësishme për këtë punim, si: Valentina Duka, "Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut: Një vështrim të legjislacionit të kohës (1928-1939)"; Fatmira Rama, "Shteti dhe njohja e Kishës Autoqefale Shqiptare (1922-1929) dhe Beqir Meta, "Autoqefalia e Kishës Ortodokse Shqiptare në procesin e formimit të institucioneve kombëtare në vitet 1920-1924". Të tria këto orvatje përbëjnë një trashëgimi të vyer në historiografinë shqiptare. Mirëpo, ato kanë qasje të cunguar në arkivat e kohës dhe në sfondin kishtar dhe rrjedhimisht arrijnë disa herë në përfundime të papërputhshme me të vërtetën historike.

Ndërkaq, ka pasur orvatje të autorëve të ndryshëm për t'u thelluar në këtë fushë. Andrea Llukani ka botuar librin "Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë" (nga vitet apostolike deri në vitet tona), (Tiranë: Botimet "Trifon Xhagjika", 2005). Ai është punim cilësor, porse ka mangësi në burimeve shqiptare dhe diplomatike greke për periudhën e trajtuar në këtë punim. Ndërkaq, teologu i mirënjohur Dhimitër Beduli ka një shqyrtim sipërfaqësor, pakfaqësh e të pathelluar në libërthin e paraçlirimit "Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944". Po ashtu, mund të veçojmë prof. dr. Dhori

Qiriazit me librin e thukët "Krishtërimi në Shqipëri" (Tiranë: Argeta-LMG, 2000) apo Koli Xoxi, Shkolla ortodokse në Shqipëri dhe rilindësit tanë (Tiranë, 2002). Roberto Moroco dela Roka ka sjellë për lexuesin shqiptar një këndvështrim përtej Adriatikut, nisur nga arkiva italiane, me librin "Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944" (Tiranë: Elena Gjika, 1994). Së fundmi, disa botime të tjera trajtojnë çështjen kishtare shqiptare, por ato çalojnë në shumë pikëpamje, si Nexhmedin Spahiu, National Awakening Process among Orthodox Albnians [Procesi i Rilindjes Kombëtare ndërmjet ortodoksëve shqiptarë] (Hamburg: 2006) apo Qani Nesimi, Ortodoksizmi te shqiptarët (Tetovë: 2005).

E përbashkëta për të gjitha këto botime është mungesa e shkresave arkivore shqiptare. Kjo bën të pamundur shqyrtimin e ngjarjeve në përmasat e vërteta dhe nxjerrjen e shkaqeve, pasojave dhe rrjedhojave të rrethanave historike. Historiografia shqiptare ka nënvlerësuar rolin që Kisha ka luajtur në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe anasjelltas, atdhetarinë e disa drejtuesve kishtarë shqiptarë si Jerotheu, Kisi, Kurilla etj., si dhe ka "fshehur" rolin e shtetit, duke ia faturuar lëvizjen kishtare pak meshtarëve atdhetarë dhe "popullsisë ortodokse" në përgjithësi.

Ndërkaq, historiografia greke e ka paraqitur çështjen kishtare shqiptare si çështje "shqiptaro-greke" dhe si një çështje që buron nga prania e pakicave të shumta në Shqipëri, në një kohë kur pakicat ndër ortodoksë kanë qenë të papërfillshme në Shqipëri. Prandaj, hyrja në një debat të pashtershëm është parë e panevojshme, pasi shumë qëndrime të autorëve për këtë periudhë vijnë si pasojë e mospasjes së burimeve të nevojshme arkivore. Në këtë kuptim, ky punim orvatet të rindërtojë plotësisht dhe me besnikëri ngjarjet dhe sfondin.

Një hapësirë e rëndësishme e këtij rindërtimi besnik është mundësuar nga jetëshkrimet apo arkivat vetjake. Kujtimet e Jakov Ngjingjilias na shpalosin rrethana të panjohura më parë. Po ashtu, arkiva vetjake e Hirësi Krisanthosit, ekzarkut të Patriarkanës për Shqipërinë nga viti 1926 deri më 1937 gjenden në arkivën ELIA dhe janë botuar në librin e Gjeorgjios Tasudhis, Βιογραφικαι αναμνήσεις του Αρχιεπισκοπου Χρυσανθου του απο Τραπεζουντος (1881-1949) [Kujtimet biografike të Kryepiskopit Krisanthos nga Trapezunda (1891-1949)] (Athinë: 1970). Ato përbëjnë një ndihmesë të rëndësishme të rindërtimit besnik të ngjarjeve. Botimet mbi Visarion Xhuvanin nga Nos Xhuvani apo dy vëllimet e "Jeta e Fan S. Nolit" nga Nasho Jorgaqi kanë ndihmuar në këtë punim. Ndërsa, Apostolos Glavinas ka mundësuar përmbledhjen e arkivave vetjake të Hirësi Jerotheut dhe Hirësi Kristoforit. Së fundmi, një sërë librash të botuar në atë kohë na ndihmojnë të kuptojmë zhvillimet. Ata janë tre libra të Visarion Xhuvanit, libërthat e botuar nga Koço Tasi dhe Vasil Novosela, botim i Sinodhit të Shenjtë për krijimin e KOASH-it etj.

Nga ana tjetër, rindërtimi i brendshëm historik është parë në shërbim të marrëdhënieve ndërkombëtare. Rrjedhimisht, trajtimi i sfondit të ngjarjeve kishtare shqiptare përbën domosdoshmëri. Sfondi i historisë së Shqipërisë është mundësuar me përdorimin e disa librave, ndër të tjerë: Joseph Swire, "Ngritja e një mbretërie" (Tiranë: Dituria, 2005), Arben Puto, "Shqipëria politike: 1912-1939" (Tiranë: Toena, 2009), Valentina Duka, "Histori e Shqipërisë: 1912-2000" (Tiranë: SHBLU, 2007), Akademia e Shkencave, "Historia e popullit shqiptar V. III" (Tiranë: Toena, 2007).

Ndërlidhja e çështjes kishtare me historinë e Greqisë është trajtuar, duke përdorur: Alkis Rigos, Η Β΄ Ελληνική Δημοκρατία 1924-1935 [Republika e Dytë Greke

1924-1935], (Athinë: Themelio, 1988), Ioanis Daskarolis, Στρατιωτικά κινήματα στην Ελλάδα του Μεσοπολέμου (1922-1935) [Lëvizje ushtarake në Greqinë e mesluftës (1922-1935)] (Athinë: Gnomon, 2012), Theodhoris Cironis, Εκκλησια Πολιτευομενη Ο Πολιτικός Λόγος και Ρόλος της Εκκλησίας της Ελλάδος (1913-1941) [Kisha në politizim: Fjala dhe Roli Politik i Kishës së Greqisë (1913-1941)] (Athinë: Epikendro, 2011).

Lëvizja unite është ndërfutur shpeshherë në thelbin e punimit. Prandaj, është përdorur botimi Inez Murzaku, "Returning home to Rome: the Basilian monks of Grotaferrata in Albania" [Duke u kthyer në Romë: murgjit bazilianë të Gotaferratës në Shqipëri], (Gotaferrata, Romë: Analekta Kryptoferris, 2009).

Çështjet kanonike dhe fetare janë sqaruar, nisur nga librat: Timothy Ware, "The Orthodox Church" (revised ed.), [Kisha Ortodokse (botim i përpunuar)] (New York: Penguin Books, 1980) dhe Andrea Llukani, "Kanonet dhe statutet e kishës ortodokse" (Tiranë: Botimet "Trifon Xhagjika", 2011).

Sfondi i marrëdhënieve greko-jugosllave është mundësuar nga punimi i Andonios Kulas, Οι ελληνογιουγκοσλαβικές σχέσεις από το 1923 έως το 1928 [Marrëdhëniet greko-jugosllave nga viti 1923 deri më 1928] (Disertacion, Universiteti i Selanikut, 2007).

Periudha e Luftës së Parë Botërore është trajtuar, nisur prej Charles Jelavich dhe Barbara Jelavich, "Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit: 1804-1920" (Tiranë: Dituria, 2004), kur nuk është përmendur ndryshe.

Cekja e pak çasteve të çështjeve kishtare rumune dhe bullgare është nevojitur. Për këtë, janë përdorur Hristo Matanov, et. al. "Historia e Bullgarisë" (Tiranë: Teuta, 2006) dhe Ioan-Aurel Pop dhe Ioan Bolovan, "History of Romania" [Historia e Rumanisë] (Bukuresht: Instituti i Kulturës Rumune, Qendra për Studime mbi Transilvaninë, 2006).

d) Marrëveshje fjalësh

Gjuha e përdorur në burimet shqip, parësore ose dytësore, është ruajtur me besnikëri, sa herë ato janë cituar. Është synuar të përdoren sa më pak shkurtime të panevojshme, me përjashtim të KOASH (Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë), KOSH (Kisha Ortodokse Shqiptare në SHBA), SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), MPJ (Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë), MPJG (Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë), MPJI (Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë), MD (Ministria e Drejtësisë), MPB (Ministria e Punëve të Brendshme), VKM (Vendim i Këshillit të Ministrave), LK (Lidhja e Kombeve) si edhe arkivat AQSH (Arkiva Qendrore e Shtetit në Shqipëri), AMPJ (Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri), ELIA (Arkiva Historike dhe Logoteknike Greke), GAK (Arkiva e Përgjithshme e Shtetit në Greqi), IDAYE (Arkiva Historike dhe Diplomatike e Ministrisë së Jashtme në Greqi).

Fjalët sinodh, episkop dhe kryepiskop janë shkruar në trajtën e vetë të qëmotshme në përzgjedhje vetjake të autorit. Fjalëpërzgjedhja vjen prej përdorimit të këtyre trajtave nga drejtuesit kishtarë ortodoksë shqiptarë: Noli, Xhuvani, Kisi, Jerotheu etj.; dhe në bashkëjetesë me emërtimet ipeshkëv dhe arqipeshkëv të përdorura në trajtën e vet të qëmotshme nga katolikët shqiptarë. Përjashtim përbëjnë rastet kur termat peshkop dhe kryepeshkop janë përdorur për denjësinë e krishterë në përgjithësi dhe jo atë ortodokse në veçanti. Ndërkaq, fjala orthodhoks është përdorur vetëm për arsye rrethanash dhe është përshtatur me ortodoks, në shumicën e punimit. Kjo vjen si rrjedhojë e mospasjes së

një trajte të njëjtë as në të kaluarën, duke u përdorur ortodoks, orthodoks apo orthodhoks nga shkrues të ndryshëm.

Së fundmi, ka qenë e domosdoshme të përdoren fjalët grekofil dhe grekoman, duke pasur ngjyrim krejt të ndryshëm nga njëra-tjetra. Emërtimi grekofil është përdorur për të gjithë ata që kishin një ndjesi afrie ndaj qytetarisë dhe së kaluarës greke, porse si atdhetarë shqiptarë ishin në radhë të parë të betejës për mbrojtjen e rrymës kombëtare shqiptare. Emërtimi grekoman është përdorur për shqiptarët e paktë, ortodoksë apo myslimanë, të cilët e shihnin veten pjesë të kombit grek dhe punonin kundër dobisë kombëtare shqiptare, si dr. Noçka, Havjer Hrushiti, Pandeli Kotoko etj.

e) Falënderime

Lista e atyre që më kanë ndihmuar për këtë punim është mjaft e gjatë, ndaj e kam të pamundur t'i përmend të gjithë. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen për udhëheqësin e këtij punimi prof. dr. Ferit Duka, i cili më ka mbajtur pa rënë në kurthe që gjendeshin rrugës, me këshillat, drejtimin dhe udhëzimet e tij. Gjithashtu, falënderoj prof. as. dr. Ilira Çaushin dhe prof. dr. Valentina Dukën, që u gjendën në krahun tim për të më mbështetur sa herë i kam kërkuar. Punimi do të ishte i paplotë pa ndihmën e miqve Kostandin Çobani, Andrea Llukani dhe studiuesit të talentuar, Niko Kotherja, i cili më mundësoi fotografi të çasteve kyçe kishtare.

Mirënjohja ime shkon për ata që më lehtësuan punën në arkiva, duke më mundësuar hyrje të pakufizuar, brenda kushteve ligjore, e në mënyrë të posaçme prof. dr. Pranvera Dibra, drejtore e Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, dr. Gjet Ndoji, drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit, si edhe koleget e vyera Gea Sulo dhe Sulbije Kurti, të cilat bënë që burokracia shtetërore të ishte e padukshme në sytë e mi. Dëshiroj të ndaj kënaqësinë e këtij punimi me bashkëpunëtorët e mi, ndër të tjerë, Shpëtimin, Arjanin, Evën, Arbën, Vjollcën, të cilët morën një barrë të shpërpjesëtuar gjatë mungesave të mia të herëpashershme.

Njerëzit cilësohen me fat, kur kanë rreth tyre familjarë mbështetës e të devotshëm. Shumë prej tyre më kanë përkrahur fuqimisht në këtë punim, secili në fushën e vet. Për këtë arsye, e kam të pamundur të mos shpreh përuljen vëllazërore për Enton Bidon, Besmira Çakon, Mirën e veçanërisht Roland, Vezire, Pamela dhe Aleksandra Bodinin.

Fjalët mungojnë për t'ia kushtuar punën time trevjeçare njerëzve më të dashur për mua, që m'u gjendën si gjithnjë pranë, duke më duruar, përkrahur dhe nxitur në mënyrën që vetëm ato dinë: mamasë dhe të fejuarës sime.

HYRJE

Pavarësia e Shqipërisë solli përplasjet e Kishës Ortodokse me shtetin shqiptar. Kisha Ortodokse në Shqipëri u kthye sërish në aktor të mirëfilltë në marrëdhëniet ndërkombëtare, teksa mitropolitët, Vasili i Drinupojës, Gjermanos i Korçës dhe Spiridhon i Velës dhe Konicës u bënë tre nga katër ministrat e një shteti të pavarur që u shpall në jug të shtetit të sapoformuar nga trupa ushtarake greke. Kisha luajti rolin e përfaqësuesit të shtetit grek në Shqipëri me nisjen e Luftës së Parë Botërore. Për më tepër, mitropolitët u shndërruan në drejtues të fuqive ushtarake, nëpërmjet Komisioneve të Mbrojtjes Kombëtare.[10]

Meshimi në gjuhë amtare dhe drejtimi i Kishës nga mitropolitë vendas ishte kërkuar nga shumë atdhetarë brenda Shqipërisë, përpara Luftës së Parë Botërore.[11] Po ashtu, zërat për një Kishë shqiptare u shtuan edhe në mërgatë, duke nisur nga viti 1900 në Bukuresht e më pas në Aleksandri, Odesë, Sofje dhe SHBA. Madje, Theofan Stilian Noli u dorëzua prift në SHBA, me synimin e themelimit të një kishe autoqefale.[12] Krijimi i shtetit shqiptar u pasua nga disa orvatje për nisjen e punës drejt pavarësisë së Kishës, sidomos nga qeveria e Princ Vidit, por vështirësitë politike dhe jetëgjatësia e saj e shkurtër ndaloi përpjekjet.[13]

Pala shqiptare do të ngadhënjente atëherë kur nuk pritej. Pushtimi i Shqipërisë gjatë Luftës do të krijonte parakushtet për drejtimin e Kishës në Shqipëri nga atdhetarë shqiptarë dhe meshimin vetëm në gjuhën amtare. Kjo vinte për arsye kundërthënëse, të lidhura ngushtësisht me baraspeshën e fuqive gjatë Luftës së Parë Botërore dhe mbështetjen që Greqia i dha Antantës. Përçarja e madhe në politikën greke luajti rol parësor, teksa Mbreti dhe Kryeministri Venizelos patën qëndrime të ndryshme mbi krahun që Athina duhet të mbante në luftë. Kështu, Korça dhe Gjirokastra, që ishin pushtuar dhe përvetësuar nga Greqia gjatë fillimit të Luftës, do të kalonin nën pushtimin francez dhe italian, në periudhën e dytë të saj.

Përfshirja e Bullgarisë në krah të fuqive të Boshtit kishte qenë përshpejtuese. Kryeministri Venizelos krijoi një qeveri paralele në Selanik, pasi qe shkarkuar nga Mbreti dhe u shpalli luftë forcave të Boshtit. Kjo solli që Italia të ndërhynte dhe të shtrinte pushtetin e vet përgjatë gjithë zonës jugore, përfshi Gjirokastrën, Sarandën dhe Delvinën, të cilat ishin nën pushtimin e fuqive mbretërore pro-Bosht të Athinës. Ndërkaq, Franca dërgoi trupa drejt Korçës, me frikën se trupat greke do të dorëzoheshin tek ato bullgare ose te çetat shqiptare.[14] Njësitë e Sali Butkës dhe Themistokli Gërmenjit e kishin

---

[10] Valentina Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, (Tiranë: SHBLU, 2007), 64.

[11] Korça printe në këtë drejtim, sidomos me anë të Lidhjes Ortodokse të drejtuar nga Mihal Grameno. Shih kolanën e gazetës "Lidhja Ortodokse".

[12] Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit,Vëllimi I,* (Tiranë: Ombra OVG, 2005).

[13] Mundësia e një Kishe Autoqefale ishte lënë e hapur edhe në Statutin Organik të Principatës. Neni 176 përcaktonte se "rregullimi i marrëdhënieve midis kishave në Shqipëri dhe kryetarëve të tyre shpirtërorë më të lartë do të jetë objekt i marrëveshjeve të posaçme që do të lidhen midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve". Romeo Gurakuqi, *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë 1913-1914* (Tiranë: UET Press, 2012), f. 114.

[14] Muin Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë 1912-1924* (Tiranë: Onufri, 2007), 127-129. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Edit Durham (Edit Durham, *Njëzetë vjet ngatërresa ballkanike* (Tiranë: Argeta-LMG, 2001). Mirëpo, telegrami i mëposhtëm tregon se çetat shqiptare kishin më shumë mundësi ta pushtonin. Nuk mund të përjashtohet që pushtimi i Korçës të ketë qenë kërkesë e Venizelosit për të rivendosur nën zotërim gjendjen, që i kishte ikur nga duart.

rrethuar ushtrinë greke brenda në qytet dhe kishin kërkuar dorëzimin e menjëhershëm. Zyrtarët grekë lajmëronin Venizelosin më 24 tetor se trupat e përbëra kryesisht nga kosturiotë kishin humbur tërësisht guximin dhe dëshironin të ktheheshin në Kostur. Njëherazi, asnjë korçar nuk shkonte për ushtar. Ndërkaq, ata pohonin se lëvizja kombëtare shqiptare ishte shtuar shumë, sidomos në radhët e ortodoksëve.[15]

Korça u pushtua nga trupat franceze të drejtuara nga koloneli Deskua, më 28 nëntor. Njëkohësisht, Britania e Madhe dhe Franca i kërkuan Mbretit Aleksandër të bashkohej me Antantën. Mospranimi bëri që ato të njihnin zyrtarisht qeverinë e Venizelosit më 2 dhjetor. Qeveria e Selanikut u shpalli luftë Fuqive të Qendrës, pesë ditë më vonë. Bullgaria do të bëhej pa dashur përshpejtuese që: Greqia të përçahej; trupat franceze të dëbonin ato greke nga Korça dhe Italia të shtrinte pushtetin në Gjirokastër, Sarandë e Delvinë.

Qëndrimi i Francës erdhi në mbështetje të popullsisë vendore. Zyrtarët ushtarakë francezë mendonin se zhvillimi i luftës ishte më e rëndësishmja dhe gjithçka tjetër duhet të lihej për më pas. Të dërguarit francezë në Korçë u takuan me përfaqësuesit e popullsisë dhe arritën në përfundimin se korçarët nuk dëshironin pushtim grek në asnjë mënyrë. Ata theksonin se si myslimanët, edhe të krishterët, kishin nisur një fushatë të gjallë kombëtare shqiptare e, madje, ishin përgatitur për luftë. Komandanti i Ushtrisë Franceze, gjeneral Sarrail, theksonte se nevojitej marrëveshje me popullsinë, në mënyrë që të mos kishte kryengritje në prapavijë dhe e gjithë lufta të përqendrohej ndaj forcave bullgare dhe austro-hungareze. Qëllimet e Greqisë, Italisë apo Esad Pashës duhet të prisnin.[16]

Kështu, përfaqësues të popullsisë zhvilluan bisedime me kolonelin Dekua, që u kurorëzuan me Protokollin e Korçës, të nënshkruar më 10 dhjetor 1916. Protokolli përcaktonte që Korça dhe zonat e Oparit, Gorës, Bilishtit dhe Kolonjës do të njiheshin si krahinë vetëqeverisëse, e drejtuar nga nëpunës shqiptarë në mbrojtje ushtarake franceze. Ajo do të drejtohej nga një këshill prej 14 anëtarësh, gjysma e të cilëve myslimanë e gjysma të krishterë, ku majori Lespina do të merrte pjesë si përfaqësues i francezëve. Gjithashtu, u ngritën dy xhandarmëri për të ruajtur rendin dhe qetësinë në qytet dhe në qark, nën drejtimin e Themistokli Gërmenjit, që *de facto* u bë drejtuesi i kësaj krahine vetëqeverisëse. Shqipja u përcaktua gjuhë zyrtare, ndërsa flamuri do të ishte ai shqiptar me një shirit trengjyrësh të flamurit francez. Kjo vetëqeverisje do të mbetej në histori si "Republika Shqiptare e Korçës". Shqiptaria e Korçës u vërtetua më së miri ngase bashkëluftuesit e grekëve mbështetën dëshirën e korçarëve për qeverisje shqiptare. Vlen të theksohet se të gjithë anëtarët e këshillit ishin atdhetarë shqiptarë dhe grekomanët e pakët rreth mitropolitit nuk arritën të përfaqësoheshin. Atdhetari Koço Kota fitoi në zgjedhjet bashkiake të zhvilluara. Francezët u kënaqën nga qetësia që mbisundonte dhe shpërblyen Themistokli Gërmenjin me "Kryqin e Luftës" dhe shumë të tjerë me "Legjionin e Nderit".[17]

Mitropoliti Gjermanos ishte larguar përpara trupave greke nga Korça dhe u gjend në Athinë, më 1 dhjetor. Ai ishte në vështirësi, pas një veprimi të kryer gjatë ditëve të

[15] Vasilios Kondis, *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 1, 1879-1918. [Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet greko-shqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 1, 1879-1918]* (Athinë: Estia, 1995), 380-381: Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Greqisë (IDAYE), D. a/5/VII, pa nr., Argjiropulos drejtuar Venizelosit, 24 tetor 1916.
[16] Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë*, 127-151.
[17] Po aty.

fundit të pushtimit grek. Hirësia kishte zhvilluar një shërbesë në kishë, ku kishte përmendur edhe Mbretin, edhe Venizelosin. Ajo ishte pjesë e një skenari më të gjerë për ta bashkuar Korçën me qeverinë e Selanikut. Ndaj, ushtria e detyroi të shkonte në Athinë, ku kërkoi ndjesë për këtë gabim dhe u bashkua me qeverinë e Mbretit Konstandin. Ai la Atë Petron si zëvendësmitropolit dhe kryetar të Pleqësisë Kishtare të Korçës, me udhëzim që të vijonte të ishte me përbërje grekomane.[18]

Mirëpo, Pleqësia nuk kishte më mbështetjen e ushtrisë pushtuese e as të besimtarëve ortodoksë.[19] Ajo do të detyrohej shumë shpejt t'u bindej kërkesave të korçarëve. Këshilli që drejtonte krahinën kishte nisur përpjekjet për ngritjen e ngrehinave kombëtare. Ajo nisi çeljen e shkollave shqipe, përfshi edhe të Liceut Shqiptaro-Francez, të parës shkollë të mesme në Korçë. Njëkohësisht, i kërkoi Pleqësisë të rivendoste shqipen si gjuhë zyrtare në Kishën Ortodokse, përfshi edhe në meshim. Zëvendësmitropoliti nuk pranoi fillimisht, duke u arsyetuar se i duhej miratimi i Patriarkut, por u detyrua, duke nisur nga bekimi i çeljes së shkollave shqipe për vitin shkollor 1917-1918.[20] Të gjitha shkresat do të shkruheshin në gjuhën amtare prej majit 1917 e deri në përfundim të Republikës së Korçës, madje të nënshkruara edhe nga vetë Atë Petroja.[21]

Kisha në Korçë ishte kthyer në duart e përkrahësve të lëvizjes kombëtare shqiptare për herë të dytë, pas një periudhe gjashtëmujore në vitin 1914, kur çdo meshë kryhej në gjuhën amtare, nën drejtimin e Atë Josif Qiricit. Gjermanosi dhe deputeti i Korçës, voskopojari Konstandin Skënderi, kundërshtuan, duke fajësuar Themistokli Gërmenjin dhe Sali Butkën. Sipas tyre, gjendja nuk kishte zgjidhje, nëse Korça nuk vendosej nën pushtimin grek. Ata shkruanin se shqiptarizimi do të ndodhte, edhe nëse italianët shkonin në vend të francezëve. Gjermanos dhe Skënderi merrnin për shembull Përmetin e pushtuar nga italianët, që nga pikëpamja kishtare ishte nën varësinë e Mitropolisë së Korçës. Edhe zëvendësmitropoliti i atyshëm ishte nën trysni të fuste shqipen në kishë.[22]

Ata kishin të drejtë. Përdorimi i shqipes në kishë dhe predikimi për lëvizjen kombëtare do të ishte i plotë në Gjirokastër. Trupat italiane gjetën një qytet që drejtohej nga fuqitë e Mbretit Konstandin, ku Mitropoliti Vasili e kishte mbështetur Mbretin në betejën e tij me Venizelosin. Nga ana tjetër, italianëve u nevojitej të fitonin përkrahjen e popullsisë vendase. Ndaj, ata shpallën menjëherë se do të njihnin pavarësinë shqiptare, pa ndryshime tokësore. Kjo qetësoi popullsinë dhe e bëri pushtimin italian më të pranueshëm. Zyrtarët grekë në ikje i kishin kërkuar Vasilit t'i shoqëronte, por Mitropoliti kishte thënë se do të qëndronte në qytet. Ushtria italiane u prit si çlirimtare nga popullsia,

[18] "Οι αποστάντες ιεράρχαι ζητούν να εκσηλεοθούν απέναντη του κράτους [Kryepriftët kundërshtarë dëshirojnë të shfajësohen përballë shtetit]", *Skrip*, 16.11.1916, 2.

[19] Tregues për këtë mund të cilësohet frika e treguar nga anëtarët e Pleqësisë përballë besimtarëve: Korça kishte dërguar deputetë në zgjedhjet greke të dhjetorit 1915. Ata ishin shtatë ortodoksë (ndonëse popullsia ishte pak më shumë se gjysma myslimane), katër prej të cilëve korçarë e tre grekë që punonin në Korçë, të gjithë pjesë e rrethit të ngushtë të Mitropolisë. Deputetët ishin zgjedhur nga Pleqësia Kishtare, në vend të zgjidheshin nga populli. Atë Petroja i kërkoi Ministrisë së Punëve të Brendshme Greke që të shtirej se nuk kishte lidhje me këto zgjedhje. Ai theksonte se nuk do të zhvillonte dhoksologji për deputetët korçarë, pasi kjo do të sillte përplasje me popullsinë, tashmë që francezët drejtonin qytetin (Arkiva Qendrore e Shtetit (AQSH), f. 141 "Mitropolia e Korçës", D. 404, f. 11, Pleqësia Kishtare drejtuar MPB Greke, pa datë.).

[20] Kondis, *Elinizmos I*, 394-395: IDAYE, D. B/33, nr. 26, Rrethi i Follorinës drejtuar MPJ, 5 shtator 1917.

[21] Shih dosjen me testamente dhe marrëveshje paje: AQSH, Fondi 141 "Mitropolia e Korçës", d. 393.

[22] Kondis, *Elinizmos I*, 384-386: IDAYE, D. /5/VIII, pa nr., Skënderi drejtuar MPJ, 14 maj 1917.

e cila shihte tek ajo një rrezik më të vogël, sesa rreziku grek. Të krishterët e Gjirokastrës i kërkuan Vasilit të dilte në pritjen e ushtrisë, por ai nuk pranoi. Dëbimi i Mitropolitit ishte ndër veprimet e para të qeveritarëve të rinj, më 22 shtator 1916. Arsyetimi i tyre ishte se urrejtja që Vasili kishte krijuar në qytet, për shkak të mbështetjes së Republikës së Epirit të Veriut dhe masakrave të kryera e kishin bërë të shihej si cenues i sigurisë së Gjirokastrës.[23] Ai u shoqërua nga 14 ushtarë për të dalë jashtë Shqipërisë. Popullsia brohoriste kundër Mitropolitit dhe Greqisë dhe pro Shqipërisë e Italisë. Vasili u shqetësua, jo për thëniet kundër tij, por për fyerjet ndaj Greqisë. Vepra e fundit e Mitropolitit të Drinupojës, përpara se të largohej njëherë e përgjithmonë nga Shqipëria, ishte të qortonte ashpër zyrtarët italianë që lejuan fyerjen e një shteti mik.[24]

Vasili zhvendosi qendrën e Mitropolisë në Delvinaq, që ishte pjesë e Mitropolisë së Drinupojës, por kishte mbetur pjesë e shtetit grek me Protokollin e Firences. Ai udhëhiqte Mitropolinë, duke qenë se vijonte të ishte zyrtarisht në krye dhe brenda kufijve të saj. Zëvendësitë episkopale drejtonin punët fetare, ndërsa rrjeti i ngritur nga Vasili përgjonte trupat ushtarake.[25] Italianët nuk u mjaftuan me Vasilin. Ata fajësuan priftin e Lefterohorit, se ishte kishte bërë marrëveshje me nëndetëset gjermane. Fshati gjendej në malin mbi Delvinë, katër orë me këmbë larg detit. Urata u vendos përpara gjykatës ushtarake. Deputeti i Gjirokastrës në Parlamentin Grek, delvinjoti Themistokli Bamiha, parashtronte se priftërinjtë ishin detyruar të përmendin në meshë Mbretin e Italisë dhe ishin ndaluar të përmendnin Mbretin e grekëve siç ndodhte edhe gjatë regjimit turk.[26] Mesha në kishat ortodokse zhvillohej në gjuhën shqipe prej vitit 1917,[27] kur Arkimandriti Taras Koroni u bë zëvendësmitropolit i Gjirokastrës, pasi ishte bashkëpunëtor i italianëve. Prifti i sprovuar kombëtar, Atë Pano Çuçi (i njohur edhe si Atë Pano Gjirokastra ose Papa Pano Gjirokastra), mbajti meshën e parë në gjuhën amtare në qytetin e Gjirokastrës, prej më shumë se gjysmë qindvjeçari.[28]

Përmeti përbënte veçanti. Ai ishte nën pushtimin italian, por pjesë e Mitropolisë së Korçës. Veprimtaria e Atë Stathi Melanit do të ishte mjaft e gjerë. Ai qe dorëzuar prift në Shqipëri, në fund të qindvjeçarit XIX dhe kishte shërbyer për pak vite pas pavarësisë për shqiptarët e Amerikës. Atë Stathi ishte kthyer në Shqipëri në mes të Luftës së Parë Botërore për të vijuar veprimtarinë e parapavarësisë. Atdhetarët ortodoksë shqiptarë nisën përpjekjet për largimin e grekomanëve nga drejtimi i Kishës dhe vendosjen e saj nën udhëheqjen e mbështetësve të lëvizjes kombëtare, pas dëbimit të trupave greke. Kupa u mbush më 17 mars 1917, kur një festë zyrtare u mbajt në Përmet, me rastin e përvjetorit të bashkimit të Italisë. Zyrtarët italianë kishin thirrur përfaqësi të ndryshme, ndër të cilët edhe drejtorin e shkollës së Mitropolisë, Vasil Dhaskalin. Ai e nisi fjalën në greqisht, duke folur për dy gjuhët motra "italishten dhe greqishten". Atë Stathi ngriti krye dhe u largua në shenjë neverie, së bashku me Spiro Kosovën, Koço Tasin, Dhimitër Kacimbrën dhe Viktor Plumbin. Ata vendosën ta zëvendësonin zëvendësmitropolitin, Atë Stavron,

[23] Kondis, *Elinizmos I*, 410-421: IDAYE, D. A/5, pa nr., Bamiha drejtuar MPJ, 28 shkurt 1918.
[24] Apostolos Katopodhis. "*Ο Μητροπολίτης Δρυινουπόλεως Βασίλειος Παπαχρήστου στο Βοριοηπειρώτικο Αγώνα, [Mitropoliti i Drinupojës Vasil Papakristu në Betejën Vorioepirotase]"* (Disertacion, Universiteti Aristotel i Selanikut, 2001), 122.
[25] Kondis, *Elinizmos I*, 378: IDAYE, F. A/5/VII, pa nr., Prefektura Gjirokastër drejt. MPJ, 6 shtator 1915.
[26] Kondis, *Elinizmos I*, 410-421: IDAYE, Bamiha drejtuar MPJ, cit.
[27] Kondis, *Elinizmos I*, 173: IDAYE, D. A/5, nr. 4457, Qeveritari i Epirit drejtuar MPJ, 28 mars 1920.
[28] "Personalitet i dyfishtë, Ikonom Papapano atdhetar shqiptar dhe prift shqiptar", *Autoqefalia Ortodokse Shqiptare*, nr. 10, shtator 1994, 3.

me Atë Stathin. Katër bashkëpunëtorët, pa Melanin, shkuan në Mitropoli të nesërmen. Koço Tasi e kishte Atë Stavron kushëri. Ai i pohoi se kishin shkuar ta nxirrnin jashtë nga Mitropolia, pasi dikush që mohon gjuhën dhe atdheun nuk meritonte të ishte në krye të ortodoksëve të Përmetit. Katër atdhetarët shkëmbyen fjalë të rënda me Atë Stavron dhe e nxorën jashtë me dhunë.[29]

Zyrtarët italianë hynë në shtëpinë e zëvendësmitropolitit, ku gjetën 500 pllakata të shtypura në Janinë, ku shkruhej: "Bashkim ose vdekje me nënën Greqi". Gjithashtu, u zbulua një letër e dërguar nga Gjermanosi, ku i thuhej të mos e humbiste besimin, pasi bashkimi me Greqinë do të ndodhte. Ai u arrestua dhe u burgos në Gjirokastër, ku u dënua me pesë vjet.[30] Mirëpo, vdiq në burg pas pak, si pasojë e dhunës së trupave italiane.[31]

Atë Stath Melani u vendos së krye të zëvendësisë episkopale. Të gjithë priftërinjtë e Përmetit meshuan në shqip, prej asaj dite. Atë Stathi filloi të mbante shërbesa edhe jashtë zëvendësisë, duke shkuar në fshatra të Tepelenës apo edhe të Kolonjës. Vasili e qortoi për rikthimin e gjuhës amtare në Kishën e Përmetit. Melani iu përgjigj se shqiptarët merreshin vesh me Perëndinë më mirë dhe më shpejt me shqipen, sesa me greqishten. Kjo përgjigje nxiti mallkimin e priftit nga ana e Vasilit, por Atë Stathi nuk u tut. Ai iu kundërpërgjigj me nënqeshje se do t'i ishte mirënjohës, nëse e dërgonte në skëterrë, ku Hirësia do ta linte të qetë.[32]

Atë Stathi do të vritej nga trupat e bandës greke të Josif Suropullit, ditën e Krishtlindjeve 1917. "Albania" vajtonte një vit më vonë se nuk kishte zemër shqiptari të mos pikëllohej e sy shqiptari të mos lotonte për dëshmorin e madh të Shqipërisë.[33]

Gjendja do të ndryshonte në dëm të grekëve edhe në Durrës. Mirëpo, rrethanat ishin krejt të kundërta këtë herë. Trupat e Fuqive të Qendrës kishin gjetur një mitropolit bashkëpunëtorë të Antantës, kur pushtuan qytetin. Esad Pasha i kishte kërkuar Jakovit ta shoqëronte së bashku me trupat serbe për në Korfuz dhe Selanik, pak përpara se Austro-Hungaria të hynte në qytet. Kryeprifti nuk pranoi. Tre muajt e parë të pushtimit austro-hungarez do të kalonin pa kundërshti.[34] Jakovi ishte ndër mitropolitët e paktë grekë që e kishin mbështetur Venizelosin. Shumica e kryepriftërinjve e kishin dënuar veprimtarinë e Kryeministrit grek, madje e kishin shkishëruar, për shkak të përçarjes me Mbretin Konstandin.[35] Si pasojë, ngritja e qeverisë së Selanikut solli edhe ringjalljen politike të Jakovit, i cili mori menjëherë anën e Antantës, duke penguar në forma të ndryshme pushtetin e ri në Durrës.

Zyrtarët austro-hungarezë nuk mund ta pranonin diçka të tillë. Ata e fajësuan Jakovin se po i përgjonte në shërbim të Antantës, nëpërmjet rrjetit që kishte ngritur prej

---

[29] Përshkrimi i detajuar i kësaj ngjarjeje është mundësuar nga Spiro Kosova, në kujtimet e tij: Mareglen Verli (përg), *Shqipëria e viteve 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës Vëllimi 1* (Tiranë: Klean 2008), 152-153.

[30] Verli, *Spiro Kosova I*, 154-155.

[31] Kondis, *Elinizmos I*, 410-421: IDAYE, Bamiha drejtuar MPJ, cit.

[32] Nos Xhuvani, *Na flet Visarion Xhuvani* (Tiranë: 2008), 250.

[33] "Vrasja e Atë Stath Melanit", *Albania*, 16 mars 1918, 4.

[34] Ioanis Em. Stratigaqis, *Ο Μητροπολίτης Μυτιλήνης Ίακωβος: ο άνθρωπος και η δράση του [Mitropoliti i Mitilinit Jakovi: njeriu dhe vepra e tij]* (Athinë: 1956), 93-94.

[35] Vasili dhe Gjermanosi ishin ndër ta. Theodhoris Cironis, *Εκκλησια Πολιτευομενη Ο Πολιτικός Λόγος και Ρόλος της Εκκλησίας της Ελλάδος (1913-1941) [Kisha në politizim: Fjala dhe roli politik i Kishës së Greqisë (1913-1941)]* (Athinë: Epikendro, 2011), 82.

vitesh. Për më shumë, ata frikësoheshin se Mitropoliti përgatiste lëvizje të armatosur kundëraustriake në kufi me trevat e pushtuara nga Antanta, që ishin në varësi të Mitropolisë, si Pogradeci.

Goditja e parë ndaj Jakovit erdhi në zemër të pushtetit të tij: në kishë. Austro-hungarezët lejuan durrsakët të psalnin në gjuhën amtare. Ngjarja ndodhi në prill 1916, kur një prift shqiptar nisi të fliste në shqip, në prani të Mitropolitit. Për më tepër, një kor i përbërë nga fëmijë filluan të këndonin në gjuhën amtare, duke gjetur mbështetjen e besimtarëve.[36] Jakovi u dëbua nga qyteti për të përfunduar në Kostandinopojë, në prill 1917.[37] Gjykata Ushtarake Austriake e Tiranës e dënoi në mungesë me shtatë vjet burg, si bashkëpunëtor i Antantës dhe mik i Venizelosit.[38]

Gjendja në Berat paraqitej krejt ndryshe. Mitropoliti i Velegradit, shqiptari Joakim Martishti, kishte mbajtur një qëndrim asnjanës dhe të pavarur nga qeveria e Athinës, prej sigurimit të pavarësisë shqiptare. Ai hoqi dorë nga qëndrimet e para kundër bashkëkombësve, pasi pa se Shqipëria do të mbetej shtet, i mbështetur nga fuqitë e mëdha. Madje, kryengritësit e Shqipërisë së Mesme, që kishin mbështetur të gjithë mitropolitët grekë, nuk u sollën me dashamirësi me Joakimin. Ata vodhën Mitropolinë dhe e detyruan Hirësinë të shkonte në Vlorë, kur pushtuan Beratin.[39]

Kjo sjellje ishte hakmarrje ndaj Joakimit, i cili kishte pranuar kërkesat kombëtare shqiptare, krejt ndryshe nga ajo që synonin kryengritjet otomaniste në Shqipëri: ajo e Shqipërisë së Mesme dhe ajo vorioepirote. Joakimi u afrua më së shumti me zyrtarët e rinj ushtarakë, gjatë pushtimit austro-hungarez. Gjuha shqipe u përdor edhe në kishat e kësaj Mitropolie. Joakimi u dëbua si bashkëpunëtor i Fuqive të Qendrës, kur Mitropolia e tij u pushtua nga Italia. Rrjedhimisht, të gjithë mitropolitët ishin larguar nga vendi: disa u dëbuan nga Fuqitë e Qendrës, pse kishin bashkëpunuar me Antantën e të tjerë për arsyen e anasjelltë. Shqipja ishte futur në kishë pa dhunë e papandehur, falë rrethanave të papritura të Luftës së Parë Botërore...

[36] Petrit Bidoshi, "Një ngjarje e paharrueshme e vitit 1916 në Durrës", *Autoqefalia Ortodokse Shqiptare* nr. 7, qershor 1994, 5.

[37] Apostolos Glavinas, *Ορθόδοξη Αυτοκέφαλη Εκκλησία της Αλβανίας [Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë]* (Selanik: Fondacioni i Hapësirave të Adriatikut dhe Jonit, 1992), 28; Andrea Llukani, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë: (nga vitet apostolike deri në vitet tona).* (Tiranë: Botimet "Trifon Xhagjika", 2005), 49; Mihail Tritu, *Η εκκλησία στο ανατολικό Ιλλυρικό και την Αλβανία [Kisha në Ilirikun Lindor dhe në Shqipëri]* (Athinë: Qiriaqidhi Afi, 1999).

[38] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*., f.95-97.

[39] AQSH, f. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 116, Shkresa e Mitropolitit Joakim, 21 nëntor 1928.

KREU I:
ÇËSHTJA KISHTARE SHQIPTARE, 1918-1921

1.1. Krijimi i strukturave të para kishtare ortodokse shqiptare

Kisha në Shqipëri ishte vendosur nën drejtimin e atdhetarëve, por zhvillimi më i rëndësishëm nuk kishte ardhur ende. Përpjekjet për krijimin e një strukture kishtare shqiptare nuk mund të ndodhnin në mes të përleshjes së armatosur në Ballkan. Ndaj, nisma u përmbush në SHBA. Flamurtari i lëvizjes, Atë Theofan Noli, ishte kthyer në Boston prej fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe kishte shndërruar në qeveri të pashpallur në mërgim shoqatën që kryesonte, "Vatra". Ai pati arritje diplomatike përgjatë Luftës, duke i parashtruar kërkesat shqiptare Presidentit amerikan, Udrou Uillson. Të gjithë priftërinjtë nën drejtimin e Nolit dërguan një përkujtesë, me anë të së cilës kërkonin përkrahjen e Uillsonit dhe kundërshtonin pandehjet se ortodoksët shqiptarë ishin grekë. Meshtarët nënshkrues ishin Atë Naum Çere, Atë Marko Kondili, Atë Damian Angjeli, Atë Pando Sinica dhe Atë Vangjel Çamçe.[40]

Prifti kombëtar ishte zotuar se do të shpinte fronin e Kryepiskopit në atdhe. Mirëpo, froni duhet të krijohej përpara se të zhvendosej. Ndaj, Atë Theofani dhe Atë Vangjel Çamçe morën pjesë në Kongresin Ortodoks të mbajtur në Klivelend të Ohajos, në mars 1918, ku kishte përfaqësues nga të gjitha kishat e Mitropolisë Ruse në SHBA.[41] Shqiptarët dhe rumunët kishin gjetur strehë në Patriarkanën e Moskës, të përndjekur nga strukturat e tjera kishtare. Ata kërkuan zyrtarisht krijimin e episkopatave përkatëse. Lutja u pranua në parim, por u shty në kohë për dy arsye. Së pari, u vlerësua se duhej parë nëse kërkesa përqafohej nga besimtarët. Së dyti, dorëzimi i episkopëve kishte si parakusht marrjen e lejes nga Patriarku i Moskës. Ai vijonte të ishte prijës i Kishës, edhe pse lidhja me Mitropolinë ishte zvenitur prej kohës kur bolshevikët kishin marrë pushtetin në Rusi. Gjithsesi, Kongresi mori një vendim të rëndësishëm. Ai themeloi Misionin Ortodoks Shqiptar në Amerikë, nën drejtimin e Atë Theofan Nolit, më 24 mars 1918. Kjo ishte struktura e parë kishtare shqiptare e krijuar ndonjëherë.[42]

Drejtuesi i Mitropolisë Ruse, Kryepiskopi i Nju Jorkut, Aleksandër, e ngriti Nolin në shkallën murgjërore të arkimandritit në tetor, çka i paraprinte dorëzimit episkop. Kuvendi i Misionit Shqiptar u mblodh në Boston, më 25 mars 1919, me pjesëmarrjen e kryepriftërinjve të Mitropolisë dhe kishave të tjera, përveç grekes. Grigja zgjodhi zyrtarisht Atë Theofanin për episkop. Noli tha se nuk e gjente arsyen e nderit që i bëhej dhe shpalli synimin përfundimtar: zhvendosjen e fronit në Shqipëri.[43] Besimtarët thirrën

[40] Avni Spahiu, *Noli: Jeta në Amerikë* (Tiranë: Toena, 2007), 41.

[41] Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit I* (Tiranë: Ombra GVG, 2006), 186; Për një këndvështrim qortues ndaj veprimtarisë së Hirësi Theofan Nolit dhe ndaj përkatësisë kombëtare shqiptare, shih disertacionin e Gjergji Simakut, prift në Selanik, me emrin Atë Dhaniil: Gjergji Simaku, "Theofan Mavromati (Fan Noli): Pasoja të prirjeve nacionaliste në ndryshimin e përkatësisë dhe besimit kombëtar" (Disertacion, Universiteti i Selanikut, 2011).

[42] Krijimi i një strukture/juridiksioni është krijimi i një episkopate, misioni, vikariati apo bashkësie tjetër kishash, të cilat kanë kryepriftërinj të varur nga drejtuesi i kishës përkatëse. Kjo është pa dyshim data më e rëndësishme përpara shpalljes së autoqefalisë, teksa përcaktonte se edhe shqiptarët kishin strukturën e tyre, edhe pse ajo ishte thjesht një mision nën varësinë e Mitropolisë Ruse në Amerikë.

[43] Jorgaqi, *Fan Noli*,187.

njëzëri: "I merituar". Ata e kishin përkthyer emërtimin e qëmotshëm "Aksios", të dëgjuar 11 vjet më parë, kur Theofani kishte mbajtur meshën e tij të parë. Episkopi i zgjedhur priste të dorëzohej për të nisur "betejën e parë ballore me priftërinjtë grekë në Shqipëri", siç kishte paralajmëruar në kapërcyell të qindvjeçarit. Mirëpo, plani nuk shkoi sipas paramendimit, kur diplomacia hyri në mes. Hirësi Aleksandri i kishte kërkuar Patriarkut Tikhon lejen për kthimin e Misionit Ortodoks Shqiptar në Episkopatë dhe dorëzimin e fronëzimin e Theofanit në kryeprift. Përgjigjja vonoi pambarimisht në rrethanat e vështira. Dorëzimi i Nolit u la dy herë, por në të dyja rastet nuk u mundësua prej mosparaqitjes së kryepriftërinjve rusë.[44]

Qeveria e Athinës udhëzoi Episkopin grek të Rodostolit, Aleksandër, të vepronte.[45] Ai kërkoi mosdorëzimin e Theofanit, duke e përgojuar si mosbesimtar dhe tallës të Ortodoksisë. Kryepiskopi rus e pranoi lutjen greke.[46] Prapaskenat e takimit mes dy burrave nuk dihen e nuk është vërtetuar ndonjë përfitim që Mitropolia pati nga Kisha Greke në SHBA, që asokohe ishte në varësinë e Kishës Ortodokse të Greqisë dhe jo të Patriarkanës Ekumenike. Episkopët rusë nuk u paraqitën sërish në mbledhje më 26 korrik 1919. Drejtuesit e Misionit mblodhën një kuvend të posaçëm, ku grigja do të shpallte Nolin kryeprift dhe misioni do të shndërrohej në Kishë Autoqefale. Noli kreu kryengritjen, në shkelje të rregullave kishtare, që pamundësonin dorëzimin pa praninë e dy kryepriftërinjve.[47] Grigja e emëroi Episkop dhe ai shpalli mëvetësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Mbështetësit brohoritën zhvillimin. Mihal Grameno shkruante te "Koha" se kombi shqiptar ishte mëshiruar nga Perëndia dhe episkopata shqiptare dilte si nuse e veshur me roba të reja e të paqme për të udhëhequr besimtarët në udhën e drejtë dhe të vërtetë të lëvdimit të Zotit në gjuhën amtare.[48]

Kisha Ortodokse Shqiptare përbëhej nga më shumë se dhjetë priftërinj të ndarë në shtatë meshtari. Katedralja e Shën Gjergjit në Boston të Masaçusetsit ishte më e madhja. Ajo ishte themeluar më 22 mars 1908, kur Noli kishte zhvilluar mbledhjen e parë.[49]

Vetëshpallja Episkop zemëroi një pjesë domethënëse të priftërinjve ortodoksë shqiptarë. Noli ishte zgjedhur ligjërisht nga Misioni, por kjo nuk ishte e mjaftueshme. Ai duhet të dorëzohej rregullisht nga dy ose tre kryepriftërinj. Katër atdhetarë nuk morën pjesë në kremtim. Ata ishin Atë Naum Çere, Atë Damian Angjeli dhe Atë Kol (Nikollë) Kristofori, të tre firmëtarë të përkujtesës për Shqipërinë dhe veprimtarë kombëtarë në SHBA. I katërti ishte Atë Vasil Marko, i cili më vonë do të printe shpalljen e autoqefalisë në Shqipëri.[50] Tre të parët paditën Nolin te Kryepiskopi Aleksandër, ndërsa Marku e rigjeti gjuhën pas pak kohësh. Veprimi i parregullt i Nolit u prit me mëdyshje edhe nga një pjesë e atdhetarëve. Bashkëluftëtari në betejën kishtare, Pandeli Evangjeli, e cilësoi "jo në shërbim të dobisë kombëtare". Evangjeli i shkruante sekretarit të mërgatës së Bukureshtit, Asdrenit, më 14 gusht 1919, se nuk ishte në dijeni të rrethanave që çuan në një veprim të tillë pa pyetur njeri. Ai vlerësonte se hapi i Nolit u jepte një armë të re në

[44]Jorgaqi, *Fan Noli*¸188; Valentina Duka, "Veprimtaria e Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës (1912-1920)". *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, (Tiranë: Instituti i Historisë, 1993), 36-40.
[45] Më pas do të bëhej Kryepiskop i Amerikës.
[46] Glavinas, *Kisha Ortodokse*, 44.
[47] Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e kishës ortodokse* (Tiranë: Trifon Xhagjika, 2011), 18.
[48] Mihal Grameno: "Pishkopata Autoqefale Orthodhokse Kombëtare", *Koha* nr. 135, 11 shtator 1919, 1.
[49] Mitropolit Fan Noli, *Pesëdhjetëvjetori i Kishës Ortodokse Shqiptare 1908-1958*, (Boston: KOSH, 1959).
[50] Xhuvani, *Na flet*, 139.

duar armiqve dhe kundërshtarëve të Shqipërisë. Luigj Gurakuqi ngriti po ashtu pikëpyetje, duke kërkuar sqarime nga Mihal Gramenoja.[51]

Krijuesi i Kishës Shqiptare, Kryepiskopi Aleksandër i Mitropolisë, shpërndau një qarkore "drejtuar priftërinjve dhe laikëve, të dashurve më Krisht të Kishës Ortodokse Shqiptare", më 3 prill 1920. Ai e quajti vetëshpalljen e rreme "djallëzore dhe krenari të pamatshme". Aleksandri theksonte se Noli kaloi në fepërdhosje duke meshuar si episkop, por mbi të gjitha duke guxuar të dorëzojë dhjak e priftërinj. Ai e kishte uruar Arkimandritin për zgjedhjen kryeprift, por mohonte ta kishte dorëzuar. Aleksandri kishte qenë i vetëm në mbledhjen e kuvendit kishtar, pa praninë e ndonjë kryeprifti tjetër që do t'i mundësonte të vijonte me dorëzimin e rregullt. Kryepiskopi rus theksonte se Noli ishte Arkimandrit, duke u shtirur rrejshëm si kryeprift, dhe si pasojë priftërinjtë dhe dhjakët, të cilët kishte dorëzuar nuk kishin marrë misterin hyjnor. Priftërinjtë dhe besimtarët kryenin mëkat të vdekshëm dhe shkishëroheshin, nëse vijonin ta njihnin si Episkop, pasi të kishin lexuar qarkoren. Aleksandri i lutej Zotit ta sillte Nolin në njohje të veprimeve të tij të rënda dhe shpallte se ishte Episkopi i të gjithë shqiptarëve në Amerikë.[52]

Krijimi i strukturës shqiptare në SHBA do të pasohej nga përpjekje të ngjashme në Shqipëri. Kufijtë shtetërorë kishin përfshirë katër qarqe kishtare: Mitropolinë e Durrësit, me shtrirje në Tiranë, Krujë, Elbasan, Pogradec etj; Mitropolinë e Velegradit, me qendër në Berat e shtrirje në Myzeqe, Vlorë, Skrapar etj; Mitropolinë e Korçës, me shtrirje në një pjesë të Kolonjës dhe Devollit, Përmet etj. dhe Mitropolinë e Drinupojës, me qendër në Gjirokastër e shtrirje në Tepelenë, Delvinë, Himarë etj. Lufta e Parë Botërore kishte shkaktuar largimin e mitropolitëve. Ndërkohë, pushtuesit italianë, francezë dhe austro-hungarezë kishin lejuar dhe nxitur përdorimin e shqipes dhe vendosjen e mitropolive nën drejtimin e atdhetarëve shqiptarë. Kryeministri i dikurshëm i Princ Vidit, Turhan Pashë Përmeti, drejtonte prej dhjetorit 1918 një qeveri të përkohshme. Qeveria shtriu drejtimin në pjesën e Shqipërisë së Mesme, ku vepronte krahas trupave ushtarake italiane. Ish-Mitropoliti i Durrësit, Jakovi, nuk mund të rikthehej, pasi italianët nuk e lejonin të zbarkonte në qytet, duke e lënë për disa muaj në pritje në Korfuz.[53]

Një arkimandrit i lindur në Elbasan dhe i doktoruar për teologji në Athinë mbërriti në Shqipëri, në mesvitin 1919.[54] Visar Xhuvani ishte dorëzuar prift e arkimandrit gjatë qëndrimit në kryeqytetin grek, me qëllim të shkonte e shërbente në Tepelenë. Dorëzimi ishte kryer me lejen e domosdoshme të Jakovit, nga kush varej vendlindja e Visarit. Xhuvani kishte shërbyer pak muaj në Kishën e Sofjes, ku ishte përpjekur të krijonte një Kishë Shqiptare dhe të dorëzohej episkop në bashkëpunim me mërgatën e Bullgarisë, por pa ia dalë. Visari plotësonte të gjitha kushtet për të drejtuar lëvizjen kishtare: doktor shkencash, me arsim të thelluar në teologji, arkimandrit, i zellshëm, besimtar dhe gojëtar. Ai do ta zhgënjente shumë shpejt Mitropolitin e Durrësit, me lejen e të cilit ishte dorëzuar

[51] Muin Çami (red), *Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirimin Kombëtar 1918-1920 (përmbledhje dokumentesh) Vëllimi I*, (Tiranë: Shtypshkronja "Mihal Duri", 1975), 300-306.
[52] Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë (AMPJ), V. 1920, D. 1, f. 1, Qarkore drejtuar besimtarëve shqiptarë, 21 mars/3 prill 1920.
[53] Stratigakis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 96.
[54] Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani: Apostull i Atdhetarizmit dhe i Ortodoksisë Shqiptare* (Tiranë, 2003), 14.

prift. Xhuvani udhëtoi në Shqipërinë e Mesme, ku meshoi shqip dhe mori mbështetjen e ortodoksëve, përfshi të zëvendësmitropolitit të Elbasanit, Atë Dhimitër Dhimitrukës.[55]

Shtatëvjetori i pavarësisë u kremtua në gjithë vendin, si një periudhë e re. Flamujt dykrenorë zbukuruan sheshet e qyteteve kryesore dhe banorët shpallën dëshirën për një Shqipëri të pavarur në kufijtë etnikë. Një plan i mëtejshëm po thurej në Elbasan. Atë Dhimitër Dhimitruka dhe ajka e Lagjes Kala i ngarkuan Xhuvanit drejtimin e Kishës. Jakovi u shpall i rrëzuar dhe u vendos t'i hiqej emërtimi "Mitropolit i Durrësit", me arsyetimin se kishte vepruar kundër dobisë së ortodoksëve të qarkut dhe mbarë vendit. Ata zgjodhën Visarin drejtues të Mitropolisë, me emërtimin "Arqimandrit i përgjithshëm dhe predikonjës i Elbasanit dhe i Shpatit".[56] Vendimet iu bënë të ditura qeverisë, pleqësive të Elbasanit e Durrësit dhe vetë Xhuvanit, i cili shtirej se nuk ishte lajmëruar, ndonëse e kishte drejtuar vetë në prapaskenë. Arkimandriti mori mbështetjen e pogradecarëve, kavajasve, tiranasve dhe durrsakëve, të cilët i dërguan lutjet përkatëse qeverisë, që ta njihte Xhuvanin si drejtues të qarkut kishtar të Durrësit, Shpatit dhe Gora-Mokrës.[57] Treva e fundit që do të rrëzonte Jakovin ishte Starova e Pogradecit, në dhjetor 1919.[58] Rrjedhimisht, qeveria e Durrësit vendosi ta njihte Visarin si "Arkimandrit të Ortodoksëve Shqiptarë", në janar 1920.[59] Emërtimi ishte i pakuptimtë në pikëpamjen kishtare, por me vlerën e njëjtë të drejtuesit të një strukture kishtare kombëtare, që sapo ishte shpallur nga të gjitha pleqësitë e Mitropolisë së Durrësit.

Visari synonte të kryesonte betejën kishtare shqiptare, si drejtues i Mitropolisë së qendrës. Mirëpo, ai kishte një mangësi: nuk ishte dorëzuar episkop. Kjo orvatje pritej e vështirë. Kisha Greke nuk do ta kryente kurrë. Shpresa mbetej vetëm te kishat kombëtare të Ballkanit, me gjasë te ato që kishin pasur përplasje me simotrën Greke: Kisha Bullgare, Rumune dhe Serbe. Arkimandriti u përpoq të dorëzohej episkop në Rumani. Ai vizitoi Bukureshtin në muajt e para të vitit 1920. Shkruesi i himnit kombëtar, Aleksandër Stavre Drenova, sekretar i Mërgatës Shqiptare, e shoqëroi në një takim në Ministrinë e Jashtme, ku u prit fillimisht nga zyrtarë të lartë të diplomacisë rumune. Visari i njoftoi se ishte zgjedhur "Kryefetar" në Shqipëri dhe qëllimi përfundimtar ishte krijimi i një kishe autoqefale. Ai iu lut qeverisë rumune të ndihmonte çështjen shqiptare. Ministri i Jashtëm u zotua se do ta shqyrtonte kërkesën.[60] Visari u takua edhe me përfaqësues të Patriarkanës Rumune, të cilët shprehën mirëdashje për qëllimin e lartë të shqiptarëve, pasi edhe ata kishin pasur të njëjtin fat në të kaluarën. Mirëpo, Visari nuk u dorëzua episkop, teksa javët kalonin. Ministria e Punëve të Jashtme u përgjigj përfundimisht se Rumania ishte e gatshme ta rivlerësonte lutjen, duke dorëzuar episkopë për në Shqipëri, vetëm kur të

[55] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. VIII-175, f. 1-10, KOASH drejtuar MD "Mbi Pikëpamjen Kanonike të gjendjes së sotshme të KOASH", 14 dhjetor 1931.

[56] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1919, D. 286, f. 1, Dhimitruka drejtuar Delegacisë së PB, 30 tetor 1919.

[57] Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjoze Konstandinopoli-Tiranë (Botohet me rastin e bisedimeve përkatëse që janë tyke u bamë kto dit në Tiranë)* (Tiranë, Shtypshkronja Tirana, 1926), 18; Vendimet përkatëse ndodhen të gjitha në AQSH, Fondi 152 "MPB", V. 1921, D. 1011.

[58] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 3, Prefektura Korçë drejtuar MPB, pa datë.

[59] Vendim i Këshillit të Ministrave, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 1011, f. 7; "Tue marrë parasysh atdhetarinë e tregueme të Z. Arkimandrit Visarion Xhuvani u vendos që zotnia e tij, sipas kërkesave të popullit të Elbasanit, Durrësit, Kavajës etj, të emnohet Arkimandrit i Ortodoksëve", - përcaktonte vendimi. Ndërkaq rroga paguhej nga qeveria. 230 franga ari në muaj (Po aty, f. 8). Pas lutjes së Visarit u rrit në 300 franga ari me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 681, më 9 gusht 1921.

[60] AQSH, f. 2 "ASDRENI", D. 75, f. 77-78, Asdreni drejtuar Sotir Gjikës, 28 shtator 1920.

zgjidhej çështja e shtetit shqiptar.[61] Veprimtari Sotir Gjika i shkruante Asdrenit i mërzitur pse qeveria rumune nuk bënte as lëvizjen më të vogël për t'u ardhur në ndihmë ortodoksëve shqiptarë.[62]

Përpjekja e parë për plotësimin e episkopatave shqiptare dështoi dhe Visari u kthye në Durrës, ku u orvat të mirëdrejtonte Mitropolinë. Ai vepronte me fuqitë e ngarkuara nga vendimi qeveritar dhe pleqësitë kishtare, duke e quajtur strukturën "Aqimandritia e Orthodhoksisë. Kisha Nasionale Shqipe".[63] Visari kishte të drejtë dhe disa herë i ushtroi të emëronte dhe zhvendoste priftërinjtë e qarkut kishtar së Durrësit, si edhe të mbikëqyrte veprimtarinë e përditshme të tyre. Ai u tregua i kujdesshëm me ish-bashkëpunëtorët e Jakovit, duke i kufizuar në detyrat fetare.[64] Arkimandriti nisi të meshonte shqip në të gjithë Mitropolinë. Ai rifuti shqipen në kishat e Kavajës, Elbasanit e së fundmi, me rastin e Krishtlindjeve të vitit 1920, edhe në Pogradec, në praninë e qindra ortodoksëve të qytetit dhe qarkut.[65] Veprimet e Visarionit gjetën mbështetjen e atdhetarëve shqiptarë. Noli e përshëndeste me anë të një letre më 7 mars 1920:

> "Një zonjë Amerikane e kryqit kuq e cila arriu këto dit në Boston, më dha lajmën gazmore që jini vendosur në Elbasan, që meshoni shqip, që përpiqeni t'a çlironi kishën tonë nga zgjedha e huaj, që kini fituar simpathinë dhe përkrahjen e popullit për veprën tuaj fisnike, dhe shum gjëra të tjera të mira, të cilat e ngrenë nderin tuaj dhe të Elbasanit shumë lart", – shkruante Noli. [66]

1.2.Mitropolit Jakovi dhe beteja shqiptaro-greke për Korçën

Shqipëria u gjend e papërgatitur për rrjedhën e re të zhvillimeve më 11 nëntor 1918, kur Matias Erzberger nënshkruante dorëzimin pa kushte të Gjermanisë, çka shënonte fundin e Luftës së Parë Botërore. Shqiptarët i kishin sytë në Paris, ku fituesit e Luftës ishin mbledhur duarlirë prej janarit 1919 për të përcaktuar fatet e Botës. Konferenca ishte vendimtare për vendin. Greqia, Italia dhe fuqitë bashkëluftuese kishin nënshkruar Marrëveshjen e Fshehtë të Londrës, që i kalonte Shqipërinë e Jugut Greqisë, Vlorën dhe rrethinat Italisë, Veriun Serbisë; ndërsa shteti i vogël i mbetur parashihej si nënzotërim italian.[67] Shqiptarët u gjendën të pamundur, kur marrëveshja u botua nga bolshevikët e ardhur rishtazi në pushtet në Rusi. Shteti i ri ishte plagosur që në lindje, ndaj nuk kishte qeverisje përgjatë Luftës. Diplomacia mbetej e vetmja rrugëzgjidhje, në pamundësi për të ruajtur kufijtë prej armiqve të mirarmatosur.

Mirëpo, Shqipëria çalonte edhe këtu. Përfaqësuesi zyrtar, Turhan Pasha, nuk mund të sfidonte hijeshinë që rrezatonte Kryeministri grek Venizelos në Paris. Shpresa mbetej te mëshira ose te mbijetesa e 14 pikave që Presidenti amerikan Udrou Uillson kishte parashtruar.[68] Arsyetimet e palës greke në Konferencën e Paqes u shkuan për shtat

[61] AQSH, F. 99 "Kolonia shqiptare në Rumani", D. 267, f. 1, Pa autor, pa datë.
[62] AQSH, f. 2 "ASDRENI", D. 74/2, f. 841, Sotir Gjika drejtuar Asdrenit, 28 prill 1920.
[63] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 1011 f. 16, Arqimandritia drejtuar MPB, pa datë.
[64] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 104, f. 1, Xhuvani drejtuar MPB, 15 shtator 1921.
[65] Shërbesat në Durrës zhvilloheshin në gjuhën amtare prej vitit 1916. AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 2, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 16 janar 1921.
[66] Vissarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige* (Tiranë: "Tirana", 1926), *4.*
[67] Arben Puto, *Shqipëria politike: 1912-1939* (Tiranë: Toena, 2009), 160.
[68] Po aty.

bashkëluftueseve të saj, Britanisë dhe Francës. Italianët ishin të fundit që mund ta pengonin Greqinë në mëtimet tokësore. Ata nuk dëshironin fuqizimin as të Athinës e as të Beogradit, që në të ardhmen mund të zëvendësonin Austro-Hungarinë në baraspeshat e Adriatikut. Ndaj, Italia e kishte mbështetur lëvizjen kombëtare në trevat e pushtuara shqiptare, duke minuar përpjekjet greke të periudhës së autonomisë. Mirëpo, dy shtetet arritën ta gjenin gjuhën e përbashkët, bazuar në Marrëveshjen e Fshehtë të Londrës. Kryeministrat nënshkruan ujdinë që do të njihej me emrat tyre, Venizelos-Titoni, më 29 qershor 1919. Sipas saj, Greqia do të mund të përvetësonte viset e Gjirokastrës dhe Korçës, ndërsa Italia do të pushtonte Vlorën dhe do të përfitonte mbizotërim mbi Shqipërinë. Italia zotohej të lëshonte ujdhesat e Dodekanezit të banuara nga grekë, në të ardhmen, teksa i kishte pushtuar nga Perandoria Osmane, më 1912.[69]

Qendra e kundërshtive shqiptaro-greke ishte Korça. Fuqitë e Mëdha nuk ishin bindur t'ia dorëzonin trevën Greqisë. Mirëpo, francezët u prirën drejt Athinës dhe e zhbaraspeshuan gjendjen në dobi të grekëve. Vetëdrejtimi i Korçës u shpërbë dhe drejtuesi Themistokli Gërmenji u vra, si tradhtar.[70]

Gjithsesi, Greqia shihte nevojën e pranisë vetjake në Korçë për të mos u mbështetur vetëm te francezët. Treva nuk përmbante greqishtfolës dhe lëvizja kombëtare shqiptare ishte mjaft e përhapur. Elbasanasi Efrem Gjini ishte emëruar mbikëqyrës i shkollave të Mitropolisë. Ai këmbëngulte më 14 shkurt 1918 se ndalimi i shqipes në shkollat e Korçës dhe në trevat me gjendje të përafërt kombëtare ishte një masë e gabuar, që mund të shkaktonte vetëm vështirësi. Gjini e dinte se atdhetaria e korçarëve do të vendoste në vështirësi Greqinë, ndaj kërkonte që shteti grek të shfaqej përpara shqiptarëve si komb vëlla dhe jo si pushtues. Vëllazëria rrëfehej me lejimin e shqipes, duke qenë se ajo flitej nga mijëra njerëz akoma edhe në kufijtë e Athinës.[71]

Ndryshimi do të vinte më 3 nëntor 1918, dy vite pasi shqipja ishte e vetmja gjuhë në shkolla dhe kisha. Një meshë me rastin e armëpushimit u zhvillua në greqisht në Kishën e Shën Gjergjit. Drejtori i Shkollës Qytetase Greke, Krois, ishte përpjekur të vendoste nxënësit në rresht në oborrin e kishës. Shqiptari stërfalë Thanas Mano iu sul dhe e grushtoi në kokë, duke e hedhur në tokë. Kjo ishte si parullë, pasi atdhetarët e tjerë u sulën menjëherë ndaj mësuesve grekë.[72] Meshimi në greqisht nuk u guxua të rikthehej, prej kësaj përplasjeje deri në dërgimin e Jakovit.[73]

Venizelosi gjykonte se Korça do të pushtohej herët a vonë. Çështja qëndronte gjetkë; Azia e Vogël dhe Stambolli ishin pikësynimi i politikës së jashtme greke.

---

[69] Nënshkrimi i marrëveshjes së korrikut 1919 dhe prapaskenat detajohen në: Thanos Veremis, *Zgjerimi ballkanik i Greqisë* (Athinë: Fondacioni Helenik për Politikë të Jashmte dhe Evropiane, 1995), 14-33.

[70] Republika Shqiptare e Korçës shqyrtohet gjerësisht në: Muin Çami, "Ushtarakët francezë në Korçë, mbështetës të aspiratave kombëtare të popullsisë (1916-1920)", *Studime Historike,* (Tiranë: Instituti i Historisë, 2002).

[71] Arkiva e Përgjithshme e Shtetit të Greqisë (GAK), F. "Zyra Politike e Kryeministrit", D. 229, f. 3, Efrem Gjini drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 14 shkurt 1918.

[72]Vasilios Kondis. *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 2, 1919-1921*. [*Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet greko-shqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 2, 1919-1921]* (Athinë: Estia, 1995), 55: IDAYE, D. A/5, pa numër, Prefekti i Follorinës drejtuar MPJ, 3 nëntor 1918.

[73] Gjendja vijonte të ishte e nderë gjithsesi. Frika kishte bërë shumë korçarë të kërkonin largimin në turmë në rast pushtimi nga Greqia. Lutja e arsyetuar me dhunën e pritshme greke iu drejtua SHBA-së (Arkiva Historike dhe Logoteknike Greke (ELIA), F. "Eleftherios Venizelos", D. 7/1, f. 3, Parasqevopulos drejtuar Venizelos, 28 shtator 1919).

Venizelos ia doli qëllimit, gjatë qëndrimit në Paris. Fuqitë e Mëdha ngarkuan Greqinë të dërgonte trupat ushtarake për të mbikëqyrur rrethinat e Izmirit dhe gjithë Trakën, me përjashtim të qytetit të Stambollit. Venizelos dëshironte të arrinte vendim të ngjashëm edhe për Korçën dhe Gjirokastrën. Ai kishte lënë mëkëmbës në Athinë zëvendëskryeministrin Repuli. Kryeministri i parashtroi më 11 gusht 1919 si duheshin kryer përgatitjet:

> "Drejt Konstandinopojës po dërgoj telegram ku i kërkohet Patriarkut... të dërgojë ekzark në Korçë, [Mitropolitin e] Durrësit që është zgjedhje më e mirë. Do ta telegrafoni menjëherë në Athinë nga Korfuzi ku ndodhet të shkojë sa më shpejt në Korçë, gjithsesi përpara arritjes së ushtrisë sonë. Drejtuesit ushtarak do t'i jepen udhëzime që të jetë në lidhje të ngushtë me Mitropolitin në fjalë, i cili ka mundësi të japë shërbime të mëdha".[74]

Patriarkana Ekumenike e Kostandinopojës njihej prej vitesh në skenën diplomatike si zgjatim i shtetit grek në Perandorinë Osmane. Ajo kishte emëruar ish-episkopin e Ardhameriut, Joakim Strumbis, si ekzark në Korçë.[75] Mirëpo, kërkesa e Venizelosit ndryshoi menjëherë vendimin. Patriarkana u dërgoi telegram trupave bashkëluftuese nën drejtimin francez në Selanik, ku njoftonte shfuqizimin e vendimit të parë dhe emërimin e Jakovit.[76] Mitropoliti i Durrësit u njoftua ngutshëm të paraqitej sa më shpejt në Ministrinë e Jashtme Greke për të marrë udhëzimet për detyrën e re.[77]

Venizelos e pati takuar Jakovin gjatë rrugës për në Paris, teksa Mitropoliti ndodhej në Korfuz. Vendtakimi qe caktuar një anije e ndaluar në skelën e Sarandës. Kryeministri i kishte shprehur mirënjohjen e kombit e shtetit grek dhe i kishte dhënë një qese me napolona, vetëm për përdorim vetjak.[78]

Jakovi nuk e fsheh politizimin në jetëshkrimin e botuar vite më vonë. Kahkundërt, ai pohon haptazi se qëllimi i dërgimit në Korçë ishte tërësisht politik, në thyerje të rregullave të Kishës Ortodokse Lindore. Jetëshkruesi shënon se qeveria greke do të urdhëronte nisjen e ushtrisë drejt pushtimit të Korçës dhe ishte e domosdoshme të gjendej aty një përfaqësues i aftë, që i njihte çështjet shqiptare. Prandaj, Venizelos përzgjodhi Jakovin. Kalevras ishte emëruar qeveritar, me udhëzimin të vepronte në marrëveshje me kryepriftin. Jetëshkruesi i Mitropolitit shënon se Kalevras dërgohej në Korçë për të mbuluar detyrën e vërtetë të Hirësisë.[79]

---

[74] Kondis, *Elinizmos II, 98-99:* IDAYE, D. A/5/VII(1), nr. 7944, Venizelos drejtuar Repulis, 11 gusht 1919.

[75] Fotios G. Ikonomu, *Η Ορθόδοξος Εκκλησία της Αλβανίας και η συμβολή της εις την διατήρησιν του ελληνισμού της Βορείου Ηπείρου [Kisha Ortodokse në Shqipëri dhe kontributi i saj në ruajtjen e helenizmit të Epirit të Veriut]* (Athinë: Nees Theseis, 1988), 17.

[76] Apostolos Glavinas, "Ο Μητροπολίτης Δυρραχίου Ιάκοβως και οι δραστηριότητες του για το εκκλησιαστικό ζήτημα της Αλβανίας. [Mitropoliti i Durrësit Jakovi dhe veprimtaria e tij në çështjen kishtare të Shqipërisë]" *Ηπειρότηκο Ημερολόγιο,* 2 (Janinë: IES, 1986): 56-58; Shih edhe: Ardit Bido, "The role of Metropolitan Iakovos in Albanian-Greek relations (1919-1921)", *International Journal of Scientific and Research Publications (IJSRP)* ["Roli i Mitropolit Jakovit në Marrëdhëniet Shqiptaro-Greke (1919-1921)" *Revista Ndërkombëtare e Botimeve Kërkimore dhe Shkencore (IJSRP)*] 4:9 (2014).

[77] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 100 .

[78] Jakovi ia kishte thënë këtë ngjarje gazetarit grek Gjeorgjios Anastasiadhis. Mitropoliti i kishte bërë napolonat lugë dhe pirunj të argjendtë, që sipas Anastasiadhisit ishte e vetmja gjë me vlerë monetare që ai kishte. Enosis Smyrneon. Ο Μητροπολίτης Μυτηλήνης Ιάκωβος, , ο άπο Δυρραχίου, *[Mitropoliti i Mitilinit Jakovi, prej Durrësi]* (Athinë: Enosis Smyrneon, 1965), 29.

[79] Stratigaqis: *Mitropoliti i Mitilinit*, 101.

Dy burrat i kërkuan qeverisë greke në fundgusht të urdhëronte hyrjen e trupave në Korçë për të rivendosur rendin dhe për të ndaluar veprimet kundër dobisë së tyre kombëtare. Udhëzimi u mor parasysh dhe Jakovi e Kalevras u nisën për në Korçë, duke prirë batalionet e ushtrisë greke, më 1 shtator 1919. Çasti vendimtar për ëndrrat e Greqisë kishte ardhur. Raste kur mitropolitë gjendeshin në krye të një ushtrie apo që zgjeronin perandori e shtete kishin qenë të pakta në të kaluarën. Aq më tepër, drejtimi i veprimtarive luftarake nga një mitropolit ishte e pashoqe. Jakovi dhe Kalevras u zhgënjyen vetëm pak kilometra larg kufirit. Nënprefekti i Follorinës, Stilianos Grigoriu, i lajmëroi se ushtria greke e kishte shtyrë hyrjen në Korçë në çastin e fundit. Gjendja nuk kishte ndryshuar rrënjësisht, por kundërshtitë e shqiptarëve kishin frikësuar francezët, të cilët dëshironin të krijoheshin kushtet përpara pushtimit grek. Francezët e drejtuar nga koloneli Lespina kishin thyer të drejtat e fituara nga "Republika e Korçës". Mirëpo, ata nuk ia dilnin të bindnin popullin se ushtria greke do të hynte në emër të bashkëluftuesve deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes në Konferencën e Paqes të Parisit.[80]

Venizelos ishte i ndërgjegjshëm se kishte të bënte me një qendër të lëvizjes kombëtare shqiptare, të përbërë në veçanti nga shumica e ortodoksëve korçarë. Ai udhëzoi Kalevrasin të merrte një sërë masash për t'i bindur shqiptarët. Kryeministri grek sugjeronte rritjen e rrogave të xhandarëve shqiptarë, t'u shpjegohej korçarëve vendi që zotëronin shqiptarët e Greqisë, t'u shpallej se mësimi i shqipes do të përfshihej në shkolla dhe se qeveria greke ishte e gatshme të jepte një vetëdrejtim të madh për Epirin e Veriut.[81]

Ortodoksët korçarë ishin në krye të betejës për shqiptarizimin e kishës. Jakovi ishte përballur me ta jo pak herë, kur drejtonte Mitropolinë e Durrësit. Ata kishin nisur turbullira, kur u njoftua marrëveshja e forcave bashkëluftuese. Prandaj, Lespina kishte kërkuar shtyrjen e përkohshme të hyrjes së trupave greke pas tubimeve, përkujtesave dhe kundërshtive shqiptare. Kalevras nuk mund të hynte si drejtues zyrtar i trupave, ndaj qëndroi në Bilishtin e pushtuar prej kohësh nga Greqia. Ai u emërua Qeveritar i Përgjithshëm i Epirit. Mitropoliti i Durrësit ishte i vetmi nga ushtria që mund të mbërrinte në Korçë. Dërgimi i Jakovit ishte i thjeshtë, pasi ai *de jure* përfaqësonte Patriarkanën Ekumenike dhe jo Athinën zyrtare.[82] Detyra i qe paracaktuar: krijimi i kushteve për pushtimin e Korçës me sa më pak humbje për ushtrinë greke.[83]

Mitropoliti mbërriti në qytetin e nderë dhe takoi menjëherë kolonelin francez Lespina.[84] Ai dëshironte të dinte nëse thashethemi mbi kryengritje shqiptare ndaj ushtrisë pushtuese ishte i vërtetë. Lespina u shpreh se nuk do të ishte nevoja e një ushtrie aq të

[80] Kondis: *Elinizmos II*, 109-110: IDAYE, D. A/5/II, pa numër, Kalevras drejtuar MPJG, 17 gusht 1919.
[81] Kondis, *Elinizmos II*, 123: IDAYE, D. a/5/VII(1), nr. 8493, Venizelos drejtuar Kalevras, 26 gusht 1919.
[82] Kondis, *Elinizmos II*, 128: IDAYE, D. a/5/VII(1), nr. 8807, Dhiomidhis drejt. Venizelosit, 30 gusht 1919.
[83] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 101.
[84] Jakovi na jep hollësi të gjendjes së nderë, kur përshkruan mbërritjen në Korçë. Francezët nuk kishin makinë në Bilisht, atë ditë fillimshtatori. Ndërkaq, makinat e shoferët grekë nuk pranoheshin të hynin në Korçë. Zgjidhjen e dha Jakovi me anë të rrengës: mbulimin e targave greke dhe veshjen e një fesi nga shoferët për t'u pandehur si ushtarë afrikanë të ushtrisë franceze. "Kur arritëm në sheshin e Korçës u ça goma e makinës që sillte plaçkat e mia. U gjendëm, si pasojë, në nevojën për të ndaluar dhe për të parë se çfarë do të ndodhte. Në krahun tim, qëndronte bashkudhëtari im, toger francez, i cili nuk mbante dot të qeshurën, duke parë "shoferët afrikanë" të flisnin kaq mirë greqisht. Shumë shqiptarë u afruan në makina dhe kur dëgjuan shoferët me fesët që flisnin greqisht, të habitur thoshin me njëri-tjetrin "More dreq, kur mësuan greqisht?" Disa prej tyre madje e njohën edhe Jakovin. Ngjarja rrëfente se akoma edhe një makinë me targa dhe ushtarë grekë shihej si keqdashëse nga korçarët. (Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 102).

madhe greke për aq sa gjendej në Korçë. Përndryshe, u shpreh i sigurt se shqiptarët do të kundërshtonin.[85]

Përgjigjja u shndërrua në pikënisjen e përplasjeve të vazhdueshme me Mitropolitin grek. Jakovi nisi punën, duke takuar njerëzit kyç të qytetit. Mitropoliti bisedoi me konsullin e Serbisë, disa grekomanë të paragjetur prej pushtimit të parë grek, zyrtarët shqiptarë që drejtonin Këshillin dhe Bashkinë e Korçës thjesht për emër, por pa fuqi zbatuese, dhe drejtuesit e përfaqësisë protestante amerikane.[86] Ai njoftoi menjëherë eprorët pas takimeve: jo Patriarkanën Ekumenike, por qeverinë greke. Jakovi përshkruante gjendjen e njësive shqiptare, duke i cilësuar të zmadhuara të dhënat për çetën e Ali Butkës, ku ishin përfshirë edhe pjesëtarët e trupave të dikurshme të Themistokli Gërmenjit, nën drejtimin e Leonidha Frashërit. Ai parashtronte se shkolla protestante kishte përfshirë greqishten si gjuhë të huaj në pritje të pushtimit grek.[87]

Gjithsesi, Jakovi korri fitoren e parë të madhe në fushën e vet. Ai bindi zyrtarët francezë se gjuha e Mitropolisë së Korçës nuk mund të ishte shqipja. Korçarët kishin arritur meshimin në gjuhën amtare prej vitit 1914. Mirëpo, gjendja ndryshoi me vajtjen e Jakovit. Greqishtja në kishë e më pas në shkolla u kthye sikurse përgjatë pushtimit otoman.[88] Mitropoliti meshoi në gjuhën e tij dhe ligjëroi në greqisht e shqip gjatë shërbesës së parë në Kishën e Mitropolisë. Jakovi foli për vëllazëri dhe kërkoi që dashuria dhe çiltërsia të mbretërojë ndërmjet grekëve dhe shqiptarëve. Mirëpo, ai pranon në kujtime se kjo ishte shtirje. Gojëtaria shërbente si mjet për të bindur popullsinë, se të qëndruarit në Korçë kishte natyrë thjesht fetare dhe jo kundërshqiptare.[89]

Mitropoliti shkonte shpesh në Bilisht, ku merrte udhëzimet e Venizelosit nëpërmjet Kalevrasit. Korça ishte trevë e frytshme politikisht për dy burrat, edhe pse pa prani grekësh, teksa zyrtarët francezë lehtësonin veprimtarinë e tyre. Fushëgropa e Korçës shtrihet në pjesën lindore të Maqedonisë. Treva e gjerë kishte pakicë greke akoma edhe në pjesën e përvetësuar nga Greqia. Prefekti i Kozani-Follorinës, Iliaqis, lajmëronte më 17 shtator 1919 se shumica e banorëve në Follorinë dhe Kostur ishin jogrekë,[90] e jo më në Korçë e Bilisht, ku jetonin vetëm shqiptarë. Zyrtarët shtetërorë ishin ata që e mbanin në këmbë rrymën kombëtare greke. Qeveritarët vendorë në pjesën greke të Maqedonisë pohonin se punonin për përshtatjen e popullsisë me kombin grek. Ndërkaq, zyrtarët francezë ndihmonin në plotësimin e detyrave të Mitropolit Jakovit në anën shqiptare.

Fushata greke u fuqizua pas ikjes së kolonel Lespinës nga Korça. Ai kishte arritur të mundësonte bindje të popullsisë, si drejtues i regjimentit "Kufijtë Shqiptarë". Mirëpo, Franca mendonte seriozisht kalimin e Korçës nën sundimin e përkohshëm grek, deri në

[85] Kondis, *Elinizmos II*, 111: IDAYE, D. a/5/II, nr. 8255, Kalevras drejtuar MPJ, 21 gusht/3 shtator 1919.
[86] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 102.
[87] Kondis, *Elinizmos II*, 135: IDAYE, D. a/5/VII(1), nr. 8985, Parasqevopulos drejtuar Venizelosit, 9 shtator 1919.
[88] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 105.
[89] Kondis, *Elinizmos II*, 135: Parasqevopulos drejtuar Venizelosit, cit.
[90] Iliaqis përpiqej t'i përfshinte në kombin grek me anë të fesë. Ai thoshte në takimet me popullsinë se "do ta sigurojmë dhe në të ardhmen që të bëhen Grekë të mirë dhe të Krishterë të mirë, sepse një i Krishterë i mirë duhet të jetë dhe Grek i mirë, për aq sa Ungjilli është i shkruar në Greqisht". GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", D. 228, f. 1, Prefekti i Follorinës drejtuar MPJG, 17 shtator 1919.

vendimin përfundimtar të Konferencës së Paqes në Paris.[91] Lespina nuk përbënte një gur të mirë në shahun e Ballkanit. Ai kishte krijuar lidhje shpirtërore me çështjen e korçarëve, çka do ta vështirësonte, në mos pamundësonte, animin në dobi të Greqisë. Jakovi i vesh vetes merita në dëbimin e kolonelit. Ai kujton se këmbëngulja te Venizelosi dhe ndërhyrja e këtij të fundit te zyrtarët francezë mundësoi zëvendësimin e Lespinës me një nënkolonel francez progrek, të quajtur Kreten.[92] Lespina u largua në fillimtetor 1919. Jakovi e ndiqte nga Mitropolia shprehjen e fundit të mirënjohjes së shqiptarëve. Kryeprifti parashtronte se shqiptarët e përcollën duke qarë, i dhanë drekë në Bashki, emërtuan rrugë Lespina dhe i dhanë dëshminë e shërbimeve të veçanta. Jakovi nuk mori pjesë. Ai kishte shkëmbyer vizita një ditë më parë dhe i kishte uruar rrugë të mbarë drejt Gymylcines,[93] ku do të drejtonte ushtrinë franceze. Mitropoliti mendonte se qëndrimi pro kërkesave të korçarëve ishte njollë e keqe mbi Lespinën. Ai iu lut që të mbronte grekët në Gymylcines, të cilët kishin pësuar shumë nga bullgarët dhe turqit. Jakovi rrëfente se Lespina iu zotua, çka për kryepriftin grek ishte mënyra e vetme e heqjes së "njollës së këtushme."[94]

Gjendja ndryshoi katërcipërisht pas mbërritjes së nënkolonel Kretenit në Korçë. Ai kishte marrë udhëzime të qarta nga Parisi për të mbështetur synimet greke dhe për të dëgjuar me kujdes Jakovin. Kryeprifti grek do ta tepronte me kërkesa, duke u kthyer në pengesë edhe për drejtuesit e rinj francezë. Nënkoloneli Kreten parashtronte fillimnëntorin 1919 se kishte çelur katër shkolla greke në Ziçisht, Qytezë, Tërovë dhe Boboshticë. Ai shkruante se vendimi kishte shkaktuar shqetësim në qarqet shqiptare, që nuk kishte si të mos shihnin fuqizim të fushatave greke.[95] Jakovi iu përvesh punës për shtimin e ndikimit. Ai lejoi mësim shqip dy orë në javë, duke qenë se të gjithë nxënësit ishin shqiptarë dhe vetëm një pjesë e vogël vllehë. Arsyetimi ishte i thjeshtë: pasi shqipen e dinin.[96] Veprimtaria e Mitropolitit ishte dyzuese për grigjën, por e madhërishme për shtetin nga paguhej. Komandanti ushtarak i Kozanit dhe Follorinës, Kaklamanis, parashtronte më 5 nëntor 1919 se përmirësimi i gjendjes në Korçë në dobi të Greqisë u krye falë bashkëpunimit të komandantit Kreten me Hirësinë.[97]

Jakovi printe fushatat progreke, ndaj ishte në shënjestrën e atdhetarëve shqiptarë, duke ndier rrezik për jetën. Kreteni rrëfente se Mitropoliti i Durrësit u frikësohej orvatjeje për ta vrarë. Koloneli nuk besonte se diçka e tillë do të ndodhte, por vlerësonte se çështja e shkollave greke kishte tërhequr vëmendjen e njerëzve që shihnin te kryeprifti një vegël të Greqisë.[98] Kreteni kishte vendosur për sigurinë e Jakovit tre roja dhe shumë xhandarë të fshehtë nga grekët që ishin në shërbim të tij.[99]

---

[91] Kacafytja diplomatike e Francës me Italinë ishte bërë shkak shtesë për të ndihmuar Greqinë. Muin Çami, "Kleri i Lartë Ortodoks në Shqipëri dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1912-1921", *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare,* (Tiranë: Instituti i Historisë, 1993),47-48.

[92] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit,* 103.

[93] Gymylcine ishte asokohe pjesë e Bullgarisë, afër kufirit turk. Qyteti është pjesë e Greqisë sot, me emrin Komotini.

[94] ELIA, F. "Eleftherios Venizelos", D. 5/4, f. 9, Jakovi drejtuar Parasqevopulos, 12 tetor 1919.

[95] Çami, *Lufta e popullit shqiptar I,* 379.

[96] Kondis, *Elinizmos II,* 148-149: IDAYE, D. a/5/II(9), nr. 15681, Shtabi i Përgjithshëm drejtuar MPJ, 3 nëntor 1919.

[97] GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", D. 228, f. 44, nr. 1060, Komanda e Kozani-Follorinës drejtuar Ministrisë së Luftës, 16 nëntor 1919.

[98] Çami, *Lufta e popullit shqiptar I,* 380.

[99] Kondis, *Elinizmos II,* 148-149: Shtabi i Përgjithshëm drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, cit.

Drejtuesi francez ia vishte fajin Jakovit, teksa diçka e tillë nuk do të ndodhte, në rast se ai mbante qëndrimin e paanshëm që i takonte. Mërzia e popullsisë vendase vlerësohej e natyrshme dhe e pritshme. Mitropoliti kishte shkuar në Korçë në çastin kur pushtimi nga ushtria greke dukej shumë i afërt dhe familje të shumta të lemerisura braktisnin trevat amtare. Kreteni rrëfente se prania e Kryepiskopit në Korçë dukej e përligjur asokohe nga detyra e paqtimit dhe sigurimit të popullsisë mbi qëllimet e qeverisë greke. Mirëpo, kalimi i kohës kishte bërë që Jakovi të kthehej në pengesë serioze akoma edhe në zbatimin e politikës progreke, që Kreteni zbatonte sipas udhëzimit të eprorëve. Kreteni parashtronte më 1 dhjetor se popullata prekej shumë lehtë për fatin që do t'i caktonte Konferenca e Paqes. Ai vlerësonte se politika e atdhetarëve nuk kishte ndryshuar dhe masa do ta kundërshtonte me dhunë hyrjen e grekëve. Nga ana tjetër, ai dallonte se partia grekomane lëvizte, edhe pse ishte shumë më e vogël në numër. Kreteni tregonte se udhëzimet vinin nga Mitropolia dhe Jakovi ishte bërë kreu i gjithë organizimit të propagandës; mjeti kryesor i të cilave ishin shkollat greke, që kërkoheshin gjoja për qëllime humanitare, por në të vërtetë për qëllime politike.[100]

Jakovi kishte arritur të ngrinte kudo shkolla greke dhe të përthithe shumë nxënës, të cilët gjendeshin në pamundësi për të vijuar dy shkollat e vetme shqiptare, deri në fund të pushtimit francez. Ai ia doli të ngrinte gjimnazin me 8 mësues dhe 50 nxënës; shkolla qytetëse gjashtëvjeçare kishte 18 mësues dhe 700 nxënës; shkolla e vajzave kishte 15 mësues dhe 515 nxënëse; dy çerdhe me 12 mësues dhe 950 fëmijë dhe 30 shkolla djemsh dhe vajzash, me 37 mësues dhe 1800 nxënës në 22 fshatra.[101]

Ushtria greke pritej të vinte nga çasti në çast. Jakovi kishte përfunduar përgatitjet: shkollat ishin hapur, meshat mbaheshin në greqisht, një pjesë e korçarëve, ndonëse shumë e vogël, ishin përfshirë në oborrin e tij dhe në përgjithësi, ushtria nuk do të haste pengesa me gjithë kundërshtitë. Mirëpo, gjendja nuk ishte siç dukej fillimvitin 1920. Ushtria e lavdishme që ai priste ndodhej gjetkë; Azia e Vogël dhe Traka kishin mbërthyer fuqinë luftarake, me të vërtetë të madhe për Siujdhesën Ballkanike. Gjendja ndryshonte afër Korçës. Greqia kishte asokohe vetëm një divizion në mbarë hapësirën e Epirit dhe Maqedonisë Perëndimore. Njësia krekosej vetëm prej emrit, teksa në të vërtetë përfshinte pak njerëz dhe armatime, për shkak të dërgimit në masë të trupave në Lindje. Divizioni VIII kryesohej nga gjeneral Orfanidhis. Ai njoftoi Ministrinë e Luftës së Greqisë për të vërtetën e hidhur për të, më 7 mars 1920. Orfanidhis shkruante se divizioni e kishte të pamundur të përballej me një kryengritje shqiptare. Trazirat mund të quheshin të mirëqena në rast ndërhyrjeje, teksa paria po përgatitej për luftë si në Korçë edhe në Gjirokastër. Ndërkaq, njoftohej se edhe në Çamëri po ziente një kryengritje. Orfanidhis shihte me paanshmëri: "Shpëtimi i helenizmit" të Korçës mund të kryhej nëse ai lejohej të mësynte "Epirin e Veriut". Mirëpo, kjo mundësohej vetëm me "plotësimin e nevojave të divizionit" përpara urdhrit për ndërhyrje ushtarake.[102]

Ministria Greke e Luftës i dha rëndësi kërcënimit nga Shqipëria. Parashtresa e Orfanidhisit përputhej me njoftime që vinin prej dhjetorit të vitit të kaluar. Mund të quhej e sigurtë se shqiptarët kishin mundësi të shkaktonin humbje të trupave të mirëradhitura greke. Mirëpo, zgjidhja duhet të ishte më shumë e zgjuar sesa e vrullshme, në kushtet kur

[100] Çami, *Lufta e popullit shqiptar I*, 381-388.
[101] Kondis, *Elinizmos II*, 282-284: IDAYE, D. a/5, nr. 148691, Jakovi drejtuar MPJ, 4 shtator 1920.
[102] Kondis, *Elinizmos II*, 165-167: IDAYE, D. a/5, nr. 5415, Orfanidhis drejtuar Ministrisë së Luftës, 7 mars 1920.

Traka dhe Azia e Vogël përthithnin pjesën e luanit të ushtrisë. Ministria e Luftës shpalli risinë më 19 mars: ajo do të dërgonte në Korçë ushtarë nënshtetas grekë me prejardhje shqiptare. Pasja e ushtarëve shqiptarë besnikë ndaj Athinës vlerësohej se do t'i jepte ushtrisë greke përparësi. Parashtresa e Ministrisë së Luftës përcaktonte domosdoshmërinë që të çoheshin ushtarë shqiptarë në Divizionin VIII për të mundësuar arritjen e një kënaqësie në popullsi, duke nënkuptuar shqiptarët arbërorë të Atikës, Viotisë, Eubesë, Peloponezit e ishujve, që vetëm më vonë do të merrnin emërtimin "arvanitas".[103] Plani nuk u zbatua për dy arsye. Lëvizjet e ushtarëve grekë nga Traka dhe Azia e Vogël ishin thuajse të pamundura, ndërkaq frika se një divizion vetëm me shqiptarë nga ata të Greqisë mund të kthehej në dobi të shqiptarëve të Shqipërisë e bëri Ministrinë të tërhiqej.

Në të vërtetë, Greqia luante blofin muajt e parë të vitit 1920. Ajo lëshonte kushtrimin në Korçë se ushtria do të hynte sapo të iknin francezët, ndërkaq u kërkonte francezëve ta shtynin largimin. Kjo lutje nuk vinte hapur. Kështu, data për zëvendësimin e trupave të Kretenit u caktua dy herë dhe të dyja herët u shty. Jakovi pasqyronte gjendjen në qytet në një nga rastet më 2 maj. Ai shprehej se shqiptarët ishin ngazëllyer me zhvillimet, ndërsa grekomanët u mërzitën prej shtyrjes së hyrjes së ushtrisë. Mitropoliti njoftonte se Pandeli Cale ishte vendosur në krye të shqiptarëve në Korçë dhe atdhetarët shqiptarë shtoheshin gjithnjë e më shumë.[104]

Hera e tretë dukej vendimtare për ata që nuk e dinin se çfarë ndodhte në ushtrinë greke. Ushtria franceze nuk dukej e gatshme të vononte largimin. Prandaj, Greqia vuri në veprim dredhinë ushtarake. Jakovi priti një lajmëtar nga Follorina më 21 maj 1920. Ai i dha lajmin se marrëveshja me francezët u arrit dhe trupat greke do të pushtonin Korçën. Jakovi takoi Kretenin dhe i tha se pushtuesit grekë do të bënin çmos për të mos zemëruar popullsinë dhe kishin për qëllim të pranonin gjendjen e krijuar dhe të linin të hapura shkollat shqiptare që vepronin. Nënkoloneli e udhëzoi të mos e përhapte lajmin dhe Jakovi u largua nga zyra. Menjëherë shkoi në Mitropoli, thirri mbështetësit dhe u kërkoi të njoftonin popullin për pushtimin.[105] Moszbatimi i udhëzimit të Kretenit për shmangien e rrëmujës vinte pikërisht prej rrengut që po luhej. Nevoja greke ishte e kundërta: shqiptarët të mendonin se pushtimi ishte i pashmangshëm dhe të dëshpëroheshin. Nga ana tjetër, fushata e Jakovit u kujdes të përhapte se zëvendësimi i francezëve do të zgjaste deri në vendimin përfundimtar të Konferencës së Paqes në Paris. Ndërthurja e dy arsyetimeve mund të sillte moskryengritjen e korçarëve.

Paria e Korçës u zemërua kur mësoi lajmin. Jorgji Raçi, kryetar i Këshillit të Parësisë, dhe kryebashkiaku Koço Kota i dorëzuan Kretenit një lutje për dëbimin e Mitropolitit, që përmbante kërcënime jo shumë të fshehura. Ndërkaq, nënkoloneli parashtronte se përgatiteshin mbledhje për t'u bërë ballë zhvillimeve.[106] Paria vendosi t'i dorëzonte qytetin qeverisë së Tiranës, të dalë nga Kongresi i Lushnjës. Njëkohësisht, nisi përgatitjet ushtarake.[107] Zyrtarët francezë pohonin se ushtarë nga të gjitha anët po grumbulloheshin për t'i bërë ballë pushtimit grek. Ata vlerësonin se ishin mbledhur shtatë

[103] Kondis, *Elinizmos II*, 170-173: IDAYE, D. A/5, nr. 3753, Raport i Ministrisë së Luftës, 19 mars 1920.
[104] Kondis, *Elinizmos II*, 196-197: IDAYE, D. A/5, nr. 6742, Spilianaqis drejtuar MPJ, 20/2 maj 1920.
[105] Muin Çami (red), *Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirimin Kombëtar 1918-1920 (përmbledhje dokumentesh) Vëllimi II*, (Tiranë: Akademia e Shkencave; Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 1976), f. 177-192
[106] Po aty.
[107] Duka, *Histori e Shqipërisë*, 155.

mijë luftëtarë deri në atë çast.[108] Venizelos e peshoi gjendjen. Ai mundohej të shmangte përplasjen e armatosur, por bëri përpjekjen e fundit për përgatitje ushtarake. Kryeministri grek kërkoi nisjen e një divizioni nga Izmiri më 22 maj. Ai arsyetoi se Greqia rrezikonte të humbiste përfundimisht Korçën, nëse ushtria greke nuk hynte pas ikjes së francezëve.[109] Ndërkaq, udhëzoi Jakovin të lajmëronte popullsinë se ushtria greke nuk ishte pushtuese, por zëvendësuese e francezëve deri në vendimet e Konferencës së Parisit.[110] Mirëpo, ushtria nga Izmiri nuk vinte dot në aq kohë të shkurtër. Francezët kishin përcaktuar 26 majin si ditë largimi dhe nuk pranonin ta shtynin përsëri. Prefekti i Kozani-Follorinës, Iliaqis, vlerësonte ato ditë se ushtria greke do t'ia kishte dalë të pushtonte Korçën, nëse ikja e francezëve do të shtyhej me një ditë të vetme.[111]

Venizelosi e përligji pamundësinë ushtarake greke si lojë politike. Ai i tha Qeveritarit të Përgjithshëm të Epirit se pushtimi i Korçës ishte vendosur me njëmendësinë e italianëve e francezëve, por anglezët këshilluan të kundërtën për të shmangur kundërveprimin shqiptar.[112] Përligjja ngjan si arsyetimi që Venizelos dëshironte t'i përcillej popullsisë, pasi Kryeministri grek i shprehej Ministrisë së Punëve të Jashtme se asnjë mendim për pushtimin e Epirit të Veriut nuk mund të bëhej në atë çast, për shkak të mungesave që kishin prej pushtimit të Trakës Lindore.[113]

Lëvizja ishte e mirëmenduar. Traka Perëndimore dhe Azia e Vogël duheshin pushtuar sa më shpejt, përpara se një shtet i ri të ngrihej nga hiri i Perandorisë Osmane. Korça dhe Gjirokastra le të prisnin; Shqipëria e dobët mund të mposhtej në një çast të dytë. Mirëmendimi i Venizelosit lypte/kërkonte një ndryshim të vetëm. Edhe pushtimi i Korçës, edhe qëndrimi i mëtejshëm i trupave franceze ishin të pamundura për arsye të dukshme. Po ashtu, Korça nuk mbarte mjaftueshëm grekomanë që të nxisnin "kryengritje ushtarake", qoftë edhe me mbështetjen e plotë të Divizionit VIII. Parashtresat e shqiptarëve, grekëve dhe francezëve ishin njëmendëse se Korça numëronte fare pak grekomanë. Rrjedhimisht, treva kishte mbetur në vullnetin e banorëve, të cilët ishin shprehur qartë për varësi nga Tirana. Ajo çka i mbetej Venizelosit ishte të krijonte parakushtet e pushtimit në një të ardhme, pasi të kishte mbyllur përfundimisht çështjen turke. Kjo kërkonte vazhdimësinë e rrjetit të përgjuesve të ngritur pranë Jakovit. Po ashtu, shkollat dhe kishat duhet të ruanin grekësinë, qoftë edhe vetëm për shfaqje epërsie. Ndërlidhësi mes Jakovit dhe Venizelosit, prefekti Iliaqis, rrëfente se kalimi i Korçës nën varësinë e qeverisë së Tiranës detyronte qeverinë greke të lidhej me palën shqiptare, pasi ndalimi i marshimit të ushtrisë do të shihej si frikë dhe do të krijonte një gjendje të frikshme për grekomanët dhe Mitropolitin.[114]

Njëzetegjashtë maji 1920 ishte mbyllur me dy vendime. Korça iu dorëzua qeverisë së Tiranës. Drejtori i Punëve të Përgjithshme, Eshref Frashëri, dhe prefekti i Korçës, Pandeli Cale, morën drejtimin e qytetit nga paria e zgjedhur, të përfaqësuar nga kryekëshilltari Jorgji Raçi dhe kryebashkiaku Koço Kota. Kreteni ishte ende në Korçë, edhe pse tashmë pa detyrë. Ai priste për ndonjë urdhër të çastit të fundit që nuk erdhi

[108] Çami, *Shqipëria në rrjedhat*, 205-206.
[109] Kondis, *Elinizmos II*, 208: IDAYE, D. A/5, nr. 6095, Venizelos drejt. Ministrisë së Luftës, 9 maj 1920.
[110] Kondis, *Elinizmos II*, 209: IDAYE, D. a/5, nr. 6310, Venizelos drejtuar Iliaqisit, 10/23 maj 1920.
[111] Kondis, *Elinizmos II*, 232-235: IDAYE, D. a/5, nr. 7261, Iliaqis drejtuar MPJ, 30 maj/12 qershor 1920.
[112] Kondis, *Elinizmos II*, 216: IDAYE, D. A/5, nr. 6446, Venizelos drejtuar Kalevrasit, 15/28 maj 1920.
[113] Kondis, *Elinizmos II*, 248: IDAYE, D. a/5, nr. 7535, Venizelos drejtuar MPJ, 6/19 qershor 1920.
[114] Kondis, *Elinizmos II*, 232-235: Prefekti i Kozani-Follorinës drejtuar MPJ, cit.

kurrë. Padija e korçarëve dhe qeverisë së Tiranës për pamundësinë ushtarake greke solli zbatimin e rrengut të emërtuar "Protokolli i Kapshticës".[115]

Rrengu përmblidhet më së miri në shkresën pikënisëse: Venizelosi i kërkoi nënprefektit të Follorinës të lidhej me Mitropolitin e Durrësit dhe t'i përcillte një tjetër udhëzim, menjëherë pasi kishte urdhëruar mospushtimin e Korçës. Sipas tij, Jakovi duhet të merrte përsipër përpara shqiptarëve të bindte qeverinë greke të mos vijonte me marshimin e trupave ushtarake, me kusht që shqiptarët të ruanin grekomanët dhe ngrehinat e tyre në Korçë.[116]

Jakovi takoi përfaqësuesit e qeverisë shqiptare dhe u tha troç se gjithçka kishte marrë fund dhe Korça do të pushtohej nga ushtria greke. Mitropoliti tha se e tëhuante gjakderdhjen si prift, ndaj mund të ndërmjetësonte për ta parandaluar. Përfaqësuesit shqiptarë pranuan, të sigurtë se ushtria greke ishte duke marshuar drejt qytetit.

---

[115] "Protokolli i Kapshticës" është cilësuar si "arritje e madhe" në historiografinë shqiptare dhe rrenga greke nuk ka zënë fare hapësirë. "Peshkop Jakovit nuk i mbeti gjë tjetër veçse të pranonte realitetin e hidhur për të, të merrte pjesë dhe të firmoste si i tillë Protokollin e Kapshticës", - shkruan historiani i njohur Muin Çami (Çami, "Kleri i lartë...", 51). Arben Puto e cilëson arritje "Protokollin e Kapshticës", duke thënë se ishte Greqia ajo që u tërhoq nga pushtimi (Puto, *Shqipëria politike*, 68). Dokumentet që botojmë, të marra nga arkivat zyrtare greke e thyejnë këtë ide, duke treguar krejt të kundërtën, se Greqia e pamundur për të bërë asgjë tjetër, luajti një rrengë, në të cilën qeveria shqiptare ra, pasi nuk kishte dijeninë e nevojshme për sasinë e trupave greke. Vlen të theksohet se edhe historiografia zyrtare shqiptare është kundërthënëse, në përpjekje për të vërtetuar këtë "arritje". Prof. Muin Çami është studiuesi më i njohur i kësaj periudhe. Ai shkruan se trupat greke ishin përgatitur në dhjetëditëshin e fundit përpara pushtimit, nën drejtimin e gjeneral Trikupit. "Ky raport i pabarabartë forcash ishte njëri ndër faktorët që e trimëronte komandën greke", – arsyeton Çami. I njëjti autor, në të njëjtin studim, shkruan se trupat greke kishin formuar një brigadë, e përbërë nga dy regjimente (Çami, *Shqipëria në rrjedhat*, 206-207). Kjo njësi në madhësi ushtarake nuk do të thoshte më shumë se 4 mijë ushtarë, shifër që Çami nuk e përfshin në studim, duke lënë të kuptohet një "raport të pabarabartë" në favor të ushtrisë greke, çka rezulton tërësisht i pavërtetë. Për më tepër, ai përmend forcat e ardhura nga Izmiri, që sipas dokumenteve greke nuk arritën të vinin në kohë dhe ishin shkaku kryesor i mospushtimit të Korçës. Prefekti Iliaqis thekson nisur nga kjo se vonesa me një ditë të vetme e ikjes së francezëve do të ishte e mjaftueshme të pushtohej Korça (Kondis, *Elinizmos II*, 232-235). Muin Çami shqyrton gjatë arsyet përse Greqia nuk e pushtoi Korçën (Çami, *Shqipëria në rrjedhat*, 211-220). Këto qëndrime variojnë nga "zbatimi në verbëri" i udhëzimeve të bashkëluftuesve, që nuk merrte parasysh aspak qëndresën shqiptare, deri në frikën nga qëndresa e madhe shqiptare. Ai arrin në përfundimin se nxitësi i mosndërhyrjes ishte pikërisht kjo qëndresë e madhe e popullit shqiptar, që bëri që Venizelosi të përdorte *alibinë* e qeverisë britanike, që në të vërtetë e kështilloi të mos ndërhynte. Kjo teori duket e tepruar. Arsyeja e mospushtimit nuk duhet parë te qëndresa shqiptare në vetvete. Ajo çka historiografitë në linja etnike, si shqiptare dhe greke, nuk kanë pranuar të trajtojnë është mundësia e këtij pushtimi. Korça është pushtuar dy herë deri në atë kohë; në të dyja rastet ajo është pushtuar me së paku një divizion, që e ka vendosur trevën nën ushtrinë greke. Një brigadë e drejtuar nga Trikupi e kishte humbjen të sigurtë në çfarëdolloj beteje që do të kryente. Është e domosdoshme të kuptojmë madhësitë: Greqia kishte rreshtuar rreth Izmirit 220 mijë ushtarë në të njëjtën periudhë dhe ishin dërguar pak më shumë se tre mijë trupa në Korçë. Mospasja e mundësisë ushtarake nga Greqia nuk është vlerësuar dobiprurëse nga historiografitë në linja etnike. Ajo shqiptare përpiqej të shihte frikën nga "qëndresa e madhe shqiptare", ndërsa ajo greke përpiqej të shihte arsye të jashtme dhe jo "turpërim ushtarak". Greqia në asnjë mënyrë nuk do të jepte urdhrin e vërtetë të pushtohej Korça me tre mijë ushtarë që arriti të grumbullonte. Pala shqiptare nuk kishte si ta dinte këtë. Ndaj, Venizelos rrëfen në atë kohë se pushtimi i "Epirit të Veriut" përjashtohej, për aq sa trupat greke po zëvendësonin ato franceze në Trakë. (Kondis, *Elinizmos II*, 248).

[116] Kondis, *Elinizmos II*, 216: IDAYE, D. a/5, pa numër, Venizelos drejtuar Nënprefektit të Follorinës, 28 maj 1920.

> "Pa pandehur, luani i frikshëm shfaqet përpara shqiptarëve si qëngj i urtë, duke mbajtur në duar degë ulliri! Nëpërmjet Riza beut, të cilin arriti ta çonte në qëllimet e tij me shpirt e trup, udhëzon paqe politike ndërmjet "dy popujve miq"! Merr përsipër, u thotë, që të ndalojë pushtimin e Korçës nga ushtria greke, me kushtin që të njohin "vëllezërit" shqiptarë "të drejtat e ndaluara kishtare dhe shkollore të të krishterëve shqipfolës", – përshkruan jetëshkruesi i kryepriftit.[117]

Jakovi i dërgoi te gjeneral Trikupi, udhëheqës i njësisë së ngarkuar me pushtimin e Korçës. Njëherazi, Mitropoliti i shkroi drejtuesit ushtarak se Pandeli Cale, Qani Dishnica dhe Nikollaq Zoi po shkonin si përfaqësues të Këshillit Shqiptar për të biseduar me palën greke. Ai lutej të shmangej çdo gjakderdhje për të shkëmbyer mendime. Mitropolia vërtetonte se kishte dijeni për takimin, duke i përcjellë tre përfaqësuesit shqiptarë oficeri francez, Vo, edhe Ikonomi Atë Petro.[118]

Takimi me Trikupin u bë në fshatin Smardës.[119] Dërgata shqiptare i kërkoi gjeneralit grek të ndalonte ndërhyrjen ushtarake, sepse banorët e Korçës kishin vendosur të kundërshtonin me armë dhe do të derdhej shumë gjak. Ata u shprehën të gatshëm për marrëveshje. Trikupi u përgjigj se kishte urdhër të prerë të pushtonte Korçën dhe duhej të zbatonte. Prandaj, e përcolli dërgatën për në Follorinë, ku e priste prefekti Iliaqis për bisedime të mëtejshme.[120]

Iliaqis i njohu përfaqësuesit shqiptarë me vendimin për pushtim, por tha se do të merrte përsipër detyrën t'i kërkonte Kryeministrit ta ndalonte, meqenëse Mitropoliti i Durrësit lutej kaq shumë nëpërmjet përfaqësuesit të tij.[121] Dërgata shihte ndarjen mes luftës dhe paqes në shfaqjen skenike të zyrtarëve grekë. Ata ishin nisur të pashpresë, thjesht për të mos e çuar dëm një përpjekje të fundit. Asnjëri prej përfaqësuesve shqiptarë nuk besonte se ndërhyrja e një prifti, qoftë edhe e natyrës së Jakovit, mund të ndryshonte të paracaktuarën. Ndaj, përgjigjja e Venizelosit i kapi në befasi. Dëshmitari Atë Petro vërente shtangien e Pandeli Cales, kur Iliaqis shqiptoi se pushtimi nuk do të kryhej.[122] Palët vendosën zhvillimin e një takimi në Kapshticë të nesërmen, ku duhet të shkonte një përfaqësi dyanëtarëshe me Mitropolitin e Durrësit. Iliaqis theksoi se marrëveshja u bë e mundur prej Jakovit dhe palët duhet t'i ishin mirënjohës Hirësisë.[123]

Mitropoliti hartoi protokollin dhe dy dërgatat u takuan në Kapshticë për ta nënshkruar. Pala shqiptare u përfaqësua nga Eshref Frashëri, Jorgji Raci, Pandeli Cale, Nikollaq Zoi dhe Selaudin Blloshmi, ndërsa pala greke nga gjenerali Trikupi dhe prefekti Iliaqis. Jakovi dhe grekomani Riza Hrushiti ishin dëshmitarë nënshkrues të marrëveshjes.

---

[117] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 113. Grekomanët në Korçë nuk ishin doemos ortodoksë, por vinin nga të gjitha fetë. Riza Hrushit Beu ishte një be mysliman, grekoman, që përbënte rrethin kryesor të Jakovit, krahas Papa Petros, Doktor Noçkës dhe drejtorit të gjimnazit, Anagnostopullos. Edhe Pandelejmon Kotoko, Sotir Papahristo e mësues të tjerë të gjimnazit bënin pjesë në partinë grekomane. Parashtresat franceze dhe greke njëmendësohen se grekomanët ishin shumë të pakët, jo më shumë se 50 veta dhe kishin përballë një pari atdhetare shqiptare shumë të madhe dhe të mirëpërhapur, që drejtonte Bashkinë apo Parësinë e Qytetit.

[118] Kondis, *Elinizmos II*, 212: IDAYE, D. a/5, pa numër, Jakovi drejtuar Trikupit, 14/27 maj 1920.

[119] Sot fshati ndodhet në Greqi me emrin Kristalopigi. Është fshati i parë në kufirin shqiptaro-grek, menjëherë sapo kalon Kapshticën.

[120] Kondis, *Elinizmos II*, 225: IDAYE, D. a/5, nr. 938, Komanda Ushtarake e Selanikut drejtuar MPJ, 10 qershor 1920.

[121] Kondis, *Elinizmos II*, 232-235: Prefekti i Kozani-Follorinës drejtuar MPJ, cit.

[122] Kondis, *Elinizmos II*, 225: Komanda Ushtarake e Selanikut drejtuar MPJ, cit.

[123] Kondis, *Elinizmos II*, 232-235: Prefekti i Kozani-Follorinës drejtuar MPJ, 30 maj/ 12 qershor 1920, cit.

Ajo caktonte se ushtria greke nuk do të hynte në Korçë. Pala shqiptare merrte përsipër mbrojtjen e grekëve të atyshëm.[124] Shkollat dhe kishat greke nuk do të cenoheshin, ndërsa xhandarmëria shqiptare nuk do të tejkalonte kufijtë e përcaktuar, derisa kufiri shqiptaro-grek të vendosej në Konferencën e Paqes. Disa fshatra shqiptare rreth Bilishtit mbetën nën sundimin e përkohshëm grek. Marrëveshja vlerësonte Mitropolit Jakovin dhe Riza Hrushit Beun si frymëzues dhe dëshmitarë të vëllazërisë mes dy popujve.[125]

Kthimi i dërgatës shqiptare u shoqërua me festë. Korçarët i bënë pritje falënderimi edhe Jakovit.[126] Mitropoliti u tha të nesërmen grekomanëve që kishte përreth se Greqia vendosi të mos derdhej gjak e të mos vdisnin padrejtësisht njerëz dhe të priste zgjidhjen e çështjes së Epirit të Veriut.[127] Rrengu politik me kyç Jakovin përbën një çast të rëndësishëm të marrëdhënieve shqiptaro-greke. Jetëshkruesi i Jakovit e vlerëson si vijon:

> "Marrëveshja e Kapshticës ndodhet në arkivat kombëtare të Ministrisë Greke të Jashtme, prej nga cilësohet si një shkresë e rëndësishme dhe "dëshmi e fuqishme diplomatike" për të treguar të drejtën greke mbi Epirin e Veriut dhe mbi Korçën, sikurse është edhe në protokollet ndërkombëtare ku ka numrin 27. Nëpërmjet këtij protokolli u njoh prej Shqipëtarizuesve[128] grekësia e Epirit të Veriut dhe Korçës, dhe prej atëherë ky protokoll përdoret prej Greqisë ndërkombëtarisht për të vërtetuar të drejtat greke".[129]

Athina kishte korrur një fitore, në kushtet kur nuk mund të ndërhynte ushtarakisht në Korçë. Pala shqiptare kishte shpejtuar ta pranonte Protokollin e Kapshticës, në padijeni të pamundësisë pushtuese greke. Gjithsesi, edhe pala shqiptare përfitoi, teksa Protokolli i Kapshticës i mundësoi qeverisë së Tiranës të përqendrohej në çështjen e Vlorës. Dy shkaqe e zhvlerësuan rrengën. Së pari, Greqia do të pësonte shpartallimin më të madh ushtarak bashkëkohor, pas ringjalljes së Turqisë përmes Ataturkut, vetëm pak muaj më vonë. Së dyti, Italia do të rrëzonte marrëveshjen "Venizelos-Titoni" pas humbjes ushtarake në Shqipëri. Ndihma e Protokollit të Kapshticës në fitoren shqiptare të Luftës së Vlorës u vlerësua nxitëse e vendimit italian.[130]

Korça u bashkua me qeverinë e Tiranës dhe u vendos nën drejtimin e prefektit Nikollaq Zoi. Ai e shihte Jakovin kundërshtar të rreptë të qeverisjes në trevë. Zoi vlerësonte se Jakovi nuk mund të kishte të drejta sikurse gjatë qeverisjes franceze dhe i ndaloi të gjitha detyrat politike, duke e kufizuar në sferën fetare.[131]

---

[124] Natyrisht, Protokolli nuk nënkuptoheshin vetëm ata pak shtetas grekë që kishte Korça, që ishte një numër i papërfillshëm. Qëllimi ishte të mbroheshin të gjithë ortodoksët e Korçës. Kjo nuk kishte vlerë nën qeverisjen shqiptare, teksa si shqiptarë, të gjithë korçarët, ortodoksë e myslimanë u bashkuan si bashkëkombës me qeverisjen e re. Qëllimi parësor ishte që Shqipëria të pranonte se në Korçë ka grekë, çka përbën dhe arritjen e Greqisë në Protokollin e Kapshticës.

[125] Stratigaqis, vep. cit., 113-114.

[126] "Kur pashë mikpritjen… me shumë vështirësi mbajta të qeshurën dhe thashë me vete: "Ku ta dinit çfarë ju bëra!", – kujtonte vite më vonë mitropoliti grek (Stratigaqis, 114).

[127] Komanda Ushtarake e Përgjithshme e Selanikut drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, cit.

[128] Shqiptarët etnikë të fesë ortodokse që luftonin për idenë kombëtare shqiptare, cilësoheshin "alvanizondes", pra "shqiptarizues", në shkresat e kohës dhe në librat me natyrë nacionaliste greke të mëvonshme. Ndërkaq, grekomanët cilësoheshin thjesht "tanët".

[129] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit,* 110.

[130] Athina u njoftua më 28 qershor 1920 se Italia mbështeste tërësinë tokësore të Shqipërisë. Kondis, *Elinizmos II*, 255: IDAYE, D. a/4, nr. 8519, Ambasada e Romës drejtuar MPJ, 28 qershor 1920.

[131] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit,* 116.

Mirëpo, të qenit Mitropolit ishte vetëm një pjesë e punës për Jakovin. Ai kishte një mjet shumë të fortë: rrjetin e përgjuesve që kishte ngritur përreth mitropolisë. Rrjeti ishte i frytshëm edhe pse i vogël. Ai përbëhej nga mësuesit e shkollave greke dhe një pjesë e vogël e priftërinjve. Mitropoliti njoftonte eprorët politikë në Athinë si konsull i vërtetë, edhe pse i qenë ndaluar detyrat politike. Shkresat e dërguara ose të siguruara nga zyrtarët vendorë shumëfishoheshin. Një shkresë e njëjtë i dërgohej marrësit dhe tjetra Ministrisë së Punëve të Jashtme Greke.[132] Ndërkaq, njoftimet i dërgoheshin shtetit grek me gjuhë diplomatike.[133] Rrjeti vepronte si njësi e pandashme. Ai përgjonte hap pas hapi njerëz të veçantë me kërkesë të shtetit grek.[134]

Mitropoliti nuk i fshihte mendimet në takimet e pakta me drejtues të lartë të qeverisë së Tiranës. Ai i tha troç një ministri shqiptar në mars 1921 se do të kishte keqkuptime të vazhdueshme mes dy vendeve pa u zgjidhur çështja e "Epirit të Veriut". Ministri iu përgjigj se nuk kishte çështje të tillë, pasi Shqipëria ishte njohur me kufijtë e vitit 1913 dhe Greqia ishte tërhequr në Lidhjen e Kombeve nga kërkesat e mëparshme.

Jakovi e quajti të pamundur dhe tha se qeveria greke kishte përgënjeshtruar tërheqjen. Ai u shkruante eprorëve në Athinë se nuk mund të zgjatej më tej, për shkak të detyrës që kishte si Mitropolit. Ministri shqiptar i kujtoi kryepriftit se ishte Mitropolit i Durrësit dhe e pyeti kur do të shkonte në qendrën e qarkut të tij kishtar. Natyrisht, Jakovi dhe Patriarkana Ekumenike e shihnin të pavlerë zhvendosjen, teksa Hirësia duhet të qëndronte në Korçë, ku zhvillohej beteja shqiptaro-greke. Jakovi parashtronte se qarqet qeveritare po shqyrtonin dërgimin e tij në Durrës për të shpëtuar prej pranisë së tij në Korçë. Ai rrëfente se prefekti i kishte matur pulsin grekomanit Evklidhi Shomo, por zyrtarët shqiptarë nuk kalonin në kërkesë zyrtare, sepse kishin frikë pasojat e kundërshtimit të Jakovit. Ministri shprehu frikën e humbjes greke në Azinë e Vogël, por Jakovi i tha se frika nuk ka vend kur flasin armët dhe grekët ishin do të shkatërronin tërësisht Ataturkun.[135]

Jakovi lëvizi të gjithë gurët edhe në Korçë. Ai ligjëroi sërish Kishën Rumune, ndonëse Athina shpallte se vllehët ishin grekë dhe jo rumunë.[136] Megjithatë, marrëdhëniet nuk u përmirësuan me bashkësinë që kishte kundërshtuar për dhjetëvjeçarë sundimin grek. Ndërkaq, Jakovi kishte emëruar edhe zëvendësmitropolitin e Përmetit pas përafrimit fillestar italo-grek, duke ndaluar edhe aty gjuhën shqipe. Ndryshimi shkaktoi një ngjarje në Pashkët e vitit 1920. Njëra palë këndonte "Krishti u Ngjall së Vdekurësh", pala tjetër "Kristos Anesti ek Nekron".[137] Kundërshtarët e ndërprenë dy herë këndimin shqip, duke e

[132] Shkresat janë të përmbledhura në dosjen e veçantë për Kishën Shqiptare nr. B/35, të vitit 1925 të Ministrisë së Jashtme Greke dhe një pjesë e tyre janë botuar edhe në Glavinas, "Mitropoliti i Durrësit", 56-58.

[133] Shembull është telegrami i 17 qershorit 1920: "Vijon qetësi absolute. Pardje u dërguan nga Tirana në emër të partisë popullore shqiptaromëdhenjtë e skajshëm Harallamb Bimbli dhe [Kol] Tromara për çështjen e prefektit... nga lajmet nga Tirana vijojnë pushtimi i lartësive rreth Vlorës. Qeveria dërgoi në Berat nga Tirana të burgosurit esadistë dhe varën një hoxhë..." Kondis, *Elinizmos II*, 246: IDAYE, D. A/5, nr. 8045, Nënprefektura Follorinë drejtuar MPJ, 17 qershor 1920.

[134] Një rast i tillë ndodhi në prill 1921, kur koloneli turk, Qamili nga Ohri, u shfaq në Korçë. Kondis, *Elinizmos II*, 336: IDAYE, D. a/5/10, nr. 5446, Nënprefekti i Follorinës drejtuar MPJ, 12/25 maj 1920.

[135] Kondis, *Elinizmos II*, 318-319: IDAYE, D. a/5, nr. 3611, Mitropolit Jakovi drejtuar MPJ, 22 mars 1921.

[136] "Andej-Këndej", *Koha*, nr. 41, 20 prill 1921, f. 3.

[137] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1920, D. 68, f. 3, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 18 prill 1920.

kthyer në greqisht, me nxitjen e Mandi Adhamidhit. Palët u përleshën me dhunë, pasi dështuan në betejën me këngë.[138]

Marrëdhëniet shqiptaro-greke nisën të ndryshonin fundnëntorin 1920. Zgjedhjet e reja në Greqi rrëzuan liberalët e Venizelosit, i cili nuk arriti të zgjidhej as deputet. Qeveria e re e kryesuar nga Dhimitrios Gunaris mori frenat e shtetit. Pakicat kombëtare, përfshi edhe shqiptarët, kishin votuar në masë pro tij. Zotimi kryesor i Gunarisit ishte fundi i luftës me Turqinë dhe kthimi i ushtarëve në shtëpi. Mitropolit Jakovi kishte humbur udhërrëfyesin politik dhe mikun vetjak nga kryesimi i qeverisë greke. Njëherazi, shenjat e dërguara nga fitorja e Gunarisit u dhanë hov lëvizjeve kombëtare jogreke në trojet të pushtuara ose nën kanosjen e pushtimit grek.[139]

Jakovi nuk kishte ndaluar të vepronte politikisht. Qeveria nuk guxonte të ndërmerrte masa kundër tij, deri në zgjidhjen e çështjes së kufijve, për të mos shkaktuar kundërveprimin grek. Zgjedhjet e para kuvendore në Shqipëri zhvilloheshin në këtë sfond. Jakovi i ndiqte gjallërisht dhe siguronte Ministrisë e Jashtme Greke se do të punonte për mospjesëmarrjen e grekomanëve në zgjedhje, nëse ajo dëmtonte mendimin ndërkombëtar për çështjen e Korçës dhe "Epirit të Veriut". Mirëpo, ai çmonte se përkrahësit e tij duhet të merrnin pjesë në zgjedhje. Dy palët kryesore në Shqipëri ishin nacionalistët dhe bejlerët. Sipas Jakovit, të parët kërkonin një pavarësi të vërtetë dhe me trajtë të krishterë dhe shqiptarizimin e plotë të "Epirit të Veriut". Ndërsa, bejlerët kërkonin turqizimin dhe italianizimin e Shqipërisë. Ai vlerësonte se zgjidhja e çështjes së Korçës nuk varej nga çështjet e brendshme, por prej zgjidhjes së çështjeve ndërkombëtare. Prandaj, ai gjykonte se Greqia do të përfitonte nëse ndiqte nacionalistët, pasi ata do të luftonin turqizimin, ndërsa grekomanët do të siguronin qetësi me vazhdimin e kohërave.[140]

Kjo zgjedhje nuk u vlerësua si veprimi më i zgjuar politik. Shumica dërrmuese e ortodoksëve ishin rreshtuar në radhët e nacionalistëve, por një qeveri e tyre do të ishte e pamundur t'i shërbente dobisë greke, edhe nëse grekomanët votonin për ta. Lufta më e madhe për shumicën e ortodoksëve korçarë ishte kundër Greqisë. Ndërkaq, Athina kishte frikë se pjesëmarrja në zgjedhje e korçarëve, gjirokastritëve dhe anëtarëve të pakicës greke të fshatrave të Gjirokastrës, Delvinës e Çamërisë do të sillte fundin e ëndrrës për "Epirin e Veriut". Nisur nga këto, Ministria Greke e Punëve të Jashtme kërkoi moszhvillimin e zgjedhjeve në Gjirokastër dhe në Korçë. Ajo urdhëroi Qeveritarin e Përgjithshëm të Epirit të takonte prefektin e Gjirokastrës. Ministri grek kërkonte t'i thuhej palës shqiptare "jozyrtarisht" se Epiri i Veriut nuk ishte pjesë e Shqipërisë pasi fati i trevës nuk ishte caktuar nga Konferenca, ndaj nuk duhet të zhvilloheshin zgjedhje. Kjo duhet të paraqitej si dëshira e popullit të Epirit të Veriut dhe Qeverisë Greke dhe si e përputhshme me Protokollin e Kapshticës. Mosbindja e palës shqiptare do të sillte mospjesëmarrjen e grekëve në zgjedhje.[141]

Qeveritari i përcolli prefektit shqiptar qëndrimin e qeverisë greke. Ai u përpoq të fshihte ndërhyrjen në punët e brendshme të Shqipërisë. Prefekti shqiptar u parashtronte eprorëve se Qeveritari grek nuk ia paraqiti kërkesën si të qeverisë greke, porse i tha se vetë ai pandehte se kështu ishte më mirë. Ndërhyrja ishte e papranueshme për palën

[138] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1920, D. 68, f. 7, Nënprefektura Përmet drejtuar Prefekturës Gjirokastër.
[139] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit,* 107-108.
[140] Kondis, *Elinizmos II,* 286, IDAYE, D. a/5, nr. 496, Mitropoliti Jakovi drejtuar MPJ, 20 nëntor 1920.
[141] Kondis, *Elinizmos II,* 293: IDAYE, D. A/5, nr. 61/115, MPJ drejtuar Qeveritarit të Epirit, 3 janar 1921.

shqiptare, por mjaftoi për të shkaktuar frikë. Të pasurit e një ushtrie të madhe greke i frikësonte shqiptarët, edhe pse shumica e trupave vijonte të ishte përqendruar larg. Njoftimet e kohës flasin për çeta të krijuara në kufi për të hyrë në Shqipëri dhe për t'u dhënë ngjyrë greke Gjirokastrës dhe Korçës.[142]

Rrethanat sollën fitoren e pamenduar të politikës greke, që Jakovi e shfrytëzoi më së miri. Ai nuk ishte nismëtar. Mitropoliti nuk kishte mjete të tjera, përveç fjalëve të përhapura për hyrjen e pritshme të ushtrisë greke. Mirëpo, këto fjalë duket se mjaftuan. Disa korçarë hartuan një përkujtesë më 13 shkurt 1921.[143] Shumica e tyre ishin atdhetarë, të cilët nënshkruanin në emër të të krishterëve shqiptarë të Korçës e qarkut të saj. Përkujtesa arsyetonte se Shqipëria nuk ishte larguar nga qeverisja lindore e Turqisë, që rrezikoi kombin dhe shtetin shqiptar. Përkujtesëshkruesit paralajmëronin se nuk do të merrnin pjesë në zgjedhjet kuvendore që vlerësoheshin të jashtëligjshme, nëse nuk zbatoheshin kërkesat e tyre. Ata përdornin si pikënisje vlerësime të përgjithshme mbi mënyrën si duhet të qeverisej vendi. Nismëtarët shënonin se ishin kundërshtarë të qendërzimit të pushtetit, si një trajtë e dështuar e qeverisjes së shteteve. Së dyti, ata theksonin se kombi shqiptar ishte komb i njëtrajtshëm. Mirëpo, ndryshimi i arsimit dhe kulturës e kishte ndarë në dy bashkësi qytetërimi, prandaj përparimi dhe bashkimi i kombit nuk do të ishte i mundur, nëse sundimi i Shqipërisë Jugore do të ishte në dorë të myslimanëve. Kjo pamundësi vinte prej vlerësimit të tyre se myslimanët do ta përqafonin me vështirësi qytetërimin perëndimor, për shkak të kulturës dhe arsimimit të mëparshëm lindor. Së treti, qeverisja e veçantë e Jugut të Shqipërisë çmohej e domosdoshme, për të shmangur qëllimet politike të Greqisë. Përkujtesëshkruesit shpallnin se do të merrnin pjesë në zgjedhje, nëse pranoheshin kushtet për shpëtimin e jetës politike të kombit. Përndryshe, hiqnin dorë duke i lënë përgjegjësinë qeverisë dhe bashkatdhetarëve myslimanë.[144]

Kushtet ishin që Shqipëria Jugore të qeverisej veçmas me qendër Korçën, me qeveritar dhe këshilla degësh. Qeveritari do të zgjidhej me shumicë votash prej degëve e do të miratohej prej qeverisë qendrore. Këshilla e degëve do të përbëhet nga këshilltarë, ku 2/3 do të ishin të krishterë dhe 1/3 myslimanë, ndonëse përbërja e popullsisë nuk ishte e tillë. Arsimi, ekonomia dhe qeverisja do të ishin nën drejtimin e këshillit, ndërsa të ardhurat do të prisheshin brenda trevës, me përjashtim të shpenzimeve të shtetit që do të dorëzoheshin në përpjesëtim me krahinat e tjera. Monedha, taksat dhe pagesat qeveritare i përkisnin fuqisë ligjore të qeverisë qendrore. Shqipëria duhet të ishte asnjanëse dhe e çarmatosur, ndërsa Jugu do të mbante një xhandarmëri të vogël për të ruajtur qetësinë, në të cilën 75% do të ishin të krishterë dhe 25% myslimanë, derisa të largohej mendësia lindore nga kombi.[145]

Hartuesit e përkujtesës ishin të larmishëm. Emrat e atdhetarëve Koço Kota, Thoma Orolloga, Llambi Bimbli, Llambro Mborja, Milto Gura, Kol Rodhe përbënin shumicën dërrmuese. Mirëpo, emrat e grekomanëve Efdhoksi Shomo e Ilia Llukeri nuk mungonin.[146] Nisma për përkujtesën i përkiste atdhetarit Koço Kota.[147]

---

[142] AMPJ, D. 41, f. 268, S. M. T. drejtuar Imzot Fan Nolit, shkurt 1921.
[143] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 5, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 13 shkurt 1921.
[144] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 3, Përkujtesa e Korçës, 13 shkurt 1921.
[145] Po aty.
[146] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 6, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 15 shkurt 1921.
[147] Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri* (Tiranë: Vllamasi, 2012), 239.

Beteja kishte natyrë kombëtariste. Atdhetarët shqiptarë mendonin se përkujtesa do të mbyllte çështjet me Greqinë. Askush nuk do të mund të thoshte se Shqipëria po nëpërkëmb "grekët" e Korçës, nëse kushtet pranoheshin përkohësisht. Qeverisja ortodokse shqiptare nuk do të mund të përgojohej si "islamike otomane", sulm grek i përsëritur dendur ndaj shtetit shqiptar. Prandaj, përkujtesa afroi atdhetarë të shquar.[148] Ata arsyetuan se grekomanët më mirë të ishin shqiptarë kundërshtarë sesa grekë me mitropolinë. Mirëpo, kjo ishte edhe një fitore e pamenduar për Jakovin, i cili gjeti rastin të rihynte në lojën politike. Prefekti zëvendësues Lutfiu parashtronte se Mitropolia e mbështeste përkujtesën dhe ajo nënshkruhej masivisht nga grekomanët.[149]

Tubimet dhe kundërshtitë nisën në mbarë vendin. Zëvendëskryebashkiaku i Beratit Haxhi Stasa kundërshtonte në emër të popullit më 24 shkurt dhe lutej të merreshin masa ndaj përçarësve.[150] Tubime me pjesëmarrje qindra e mijëra frymësh u zhvilluan në Elbasan, Lushnjë, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Mallakastër e gjetkë.[151] Ndërkaq, korçarë me peshë si Mihal Grameno, Pandeli Cale, Eshref Frashëri etj. kundërshtuan ashpër në shtyp.[152]

Qeveria kundërveproi menjëherë, duke rrëzuar përkujtesën. Ajo u përgjigj se nuk mund të trajtonte çështjen, pasi ajo i përkiste fuqisë së Kuvendit. Ndërkaq, zyrtarët vendorë u udhëzuan të merrnin masa.[153] Mirëpo, zbatimi i udhëzimit ishte i vështirë, teksa përballë gjendeshin atdhetarët shqiptarë dhe jo grekomanët. Prefekti i Korçës punonte për të përçarë nismëtarët.[154] Nikollaq Zoi njoftoi më 21 mars se mirëkuptimi me përkujtesëshkruesit dukej i pamundur, por kjo ishte e parëndësishme. Sipas tij, nismëtarët kishin mbetur pakicë dhe korçarët i quanin vegla të të huajve.[155] Qeveria kërkoi

[148] Mjaft historianë shqiptarë e kanë vlerësuar përkujtesën si një shfaqje të një rryme kundërshqiptare. Akademik Beqir Meta e vlerëson kështu: "Ekzistencën e një rryme me mentalitet jo të drejtë kombëtar dhe me një tendencë të dukshme separatiste e grekomane e dëshmonte edhe memorandumi i të krishterëve të Korçës. Memorandumi i deformonte shkaqet e vështirësive të konsolidimit të shtetit shqiptar..." (Meta, "Autoqefalia e Kishës Ortodokse Shqiptare në procesin...", 87.). Shpërfytyrimi i shkaqeve të vërteta të vështirësisë së fuqizimit të shtetit është i dukshëm. Mirëpo, ngjarjet e mëvonshme rrëfejnë se qëllimi i përkujtesës ishte atdhetar. Kjo mbështetet në disa arsye syresh: nismëtarët e përkujtesës vinin nga radhët e atdhetarëve. Koço Kota ishte ai që kishte bashkuar Korçën me qeverinë e Tiranës, duke tëhuajtur kërkesat greke për bashkim, përpara vetëm një viti. Së dyti, përkujtesëshkruesit rendën të kundërshtonin orvatjen greke për ta paraqitur përkujtesën si vërtetim të grekësisë së "Epirit të Veriut" (shih sythin 1.5). Së fundmi, edhe qeveria shqiptare e pranonte se përkujtesa ishte veçse një peshim i gabuar i baraspeshave të kohës. Këto arsye e bëjnë fare të qartë se arsyetimi i përkujtesëshkruesve që orvatja e tyre ishte atdhetare është e besueshme, sidomos për aq sa ata ishin në masë kombëtaristë të orëve të para. Paragjykimi i historiografisë shqiptare, kryesisht nisur prej mosshqyrtimit të të gjitha burimeve të kohës, del të jetë i pathemeltë.

[149] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 3, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 16 shkurt 1921.

[150] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 9, Prefektura e Beratit drejtuar MPB, 24 shkurt 1921.

[151] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 31, Prefektura e Elbasanit drejtuar MPB, 26 shkurt 1921.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 36, Nënprefektura e Lushnjes drejtuar MPB, 26 shkurt 1921; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 37, Bashkia e Tiranës drejtuar MPB, 26 shkurt 1921.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 38, Prefektura e Durrësit drejtuar MPB, 26 shkurt 1921.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 44, Nënprefektura e Fierit drejtuar MPB, 26 shkurt 1921.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 47, Prefektura e Vlorës drejtuar MPB, 26 shkurt 1921.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 22, Nënprefektura e Mallakastrës drejtuar MPB, 26 shkurt 1921.

[152] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 55, MPB drejtuar Mihal Gramenos, 5 mars 1921.

[153] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 33, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 17 shkurt 1921.

[154] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 74, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 20 mars 1921.

[155] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 15, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 21 mars 1921.

arrestimin e Rodhes, Kotës, Bimblit dhe Milto Gurës më 24 mars.[156] Zoi kundërshtoi duke thënë se do të kërkonte ndërhyrjen e Atë Vasil Markos dhe Fan Nolit për t'i tërhequr nga veprimet kundër qeverisë.[157]

Zgjedhjet u kryen në dy faza, më 5 dhe 29 mars. Fushata e Jakovit dhe lëvizja e përkujtesëshkruesve pati pasoja. Një pjesë domethënëse e ortodoksëve në qytetin e Korçës nuk morën pjesë. Mirëpo, në fshatrat ortodokse, ku jetonte shumica e të krishterëve, fushata nuk dha fryte. Mihal Turtulli arsyetonte se votat e pakta të ortodoksëve të qytetit vinin prej dredhive të Mitropolitit, më pas konsullit serb e në fund disa të meta të qeverisë.[158]

Eshref Frashëri i shkruante Mid'hat Frashërit se Jakovi bleu disa nga atdhetarët e krishterë, të cilët bënë përçarje nën frymën e atdhetarizmit. Ai rrëfente se shumica e të krishterëve të qytetit dhe të gjithë ortodoksët e fshatrave morën pjesë në zgjedhje. Eshrefi ia vishte shkakun frymëzimit të Jakovit, parave të Greqisë dhe ndërhyrjes së Italisë. Ai gjykonte se sjellja e ushtrisë greke gjatë Luftës së Parë Botërore u bë nxitësja kryesore e ngjarjes. Në fund, thoshte se mbarë popullsia donte më tepër Shqipërinë, por nuk guxonin ta thoshin, pasi nuk u kishte dalë frika nga ardhja e Greqisë.[159]

Votat e ortodoksëve të fshatrave dhe të pakicës së qytetit mjaftuan që Korça të zgjidhte deputetë atdhetarë. Pandeli Evangjeli, Loni Kristo, Pandeli Cale, Sotir Peci dhe Kristo Kirka u zgjodhën nga radhët e ortodoksëve. Ndërsa bashkësia myslimane zgjodhi Banush Hamdiun, Eshref Frashërin, Sejfi Vllamasin, Tefik Mborjan dhe Tefik Panaritib.[160]

Çështja e zgjedhjeve ktheu për herë të parë qeverinë kundër Jakovit. Prefekti Zoi u udhëzua më 26 prill të hetonte sjelljen e Mitropolitit.[161] Drejtori i Policisë, Nik Dishnica, parashtroi se Jakovi vizitohej vazhdimisht nga kundërshtarët e shtetit shqiptar dhe mori pjesë jodrejtpërdrejt në zgjedhjet e Korçës, duke i këshilluar pasuesit e tij të mos votonin. Dishnica mendonte se përkujtesa ishte rrjedhim i sugjerimit të Jakovit. Ndërkaq, Greqia njoftohej mbi çdo zhvillim, falë përgjuesve të Mitropolitit. Dishnica përfundonte se ndenja e Jakovit në Korçë ishte kundër dobisë shtetërore.[162]

Kjo ishte kërkesa e parë e një zyrtari për dëbimin e Jakovit. Ai kishte qenë dytësor në çështjen e përkujtesës, por doemos pati ndikim. Pasuesi i Jakovit, Pandeli Kotoko, asokohe mësues në shkollat greke të Korçës, vlerësonte se merita e kryepriftit grek ishte që ia doli të krijonte përçarje në lëvizjen atdhetare shqiptare dhe krijoi klimë dyshimi dhe pakënaqësi mes të krishterëve dhe myslimanëve shqiptarë, me përfundim fitoren politike të myslimanëve.[163]

Greqia u përpoq të minonte zgjedhjet edhe në Gjirokastër. Athina nuk kishte mundur të zëvendësonte fillimisht Arkimandrit Taras Koronin, i cili kishte lejuar shqipen në Kishë. Qeveritari i Epirit parashtronte në mars 1918 se zëvendësmitropoliti ishte i pranueshëm prej italianëve dhe Greqia nuk mund të ndërhynte dukshëm. Gjithsesi,

---

[156] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 80, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 24 mars 1921.
[157] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 81, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 25 mars 1921.
[158] AMPJ, V. 1920, D. 3, f. 10, Dr. Turtulli drejtuar Mid'hat Frashërit, pa datë.
[159] AMPJ, V. 1920, D. 3, f. 20, Eshref Frashëri drejtuar Mid'hat Frashërit, pa datë.
[160] Këto ishin zgjedhjet e pra dhe të fundit ku të krishterët dhe myslimanët votuan ndarazi. Kastriot Dervishi. *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005* (Tiranë: "55", 2006), 128.
[161] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 10, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 26 prill 1921.
[162] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1921, D. VI-61, f. 2, Policia Korçë drejtuar Prefektit, 28 prill 1921.
[163] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit,* 107-108.

Qeveritari Stergjiadhi përmirësoi marrëdhëniet me zyrtarët italianë dhe me Tarasin. Ai kërkoi që Koroni të emërohej zëvendësmitropolit i Gjirokastrës, nga Kisha e Greqisë, si kisha më e afërt ortodokse, me synim mbikëqyrjen më të lehtë të arkimandritit.[164]

Italianët u dhanë hapësirë kërkesave greke vetëm pas marrëveshjes "Venizelos-Titoni". Ata lejuan emërimin e një zëvendësmitropoliti të ri. Ikonom Thanas Duka ishte nën urdhrat e drejtpërdrejtë të Mitropolit Vasilit dhe mbante lidhje me Qeveritarin e Epirit. Duka ishte zgjedhje vetjake e Hirësisë, si bashkëfshatar nga Labova e Kryqit.[165] Megjithatë, ai nuk kishte punë të lehtë. Sipas zyrtarëve grekë, lëvizja shqiptare u pasurua në periudhën e pushtimit italian nga gjirokastritë të zëshëm, si Vasil Dilo, Apostol Dhima e Athanas Noti. Shqiptarët përbënin rreth 2/3 e ortodoksëve të qarkut të Gjirokastrës dhe Delvinës. Grekomanët ishin të paktë ndër ta, teksa shumica po mbështeste lëvizjen kombëtare.[166]

Shteti grek i mbajti shpresat te Atë Thanasi për minimin e zgjedhjeve. Ai vlerësohej si "drejtues i rëndësishëm grek" në qytet. Qeveritari i kishte premtuar ndihmë ekonomike për shërbimin, vonesa e së cilës për pak sa nuk shkaktoi dorëheqjen e zëvendësmitropolitit.[167]

Atë Thanasi ishte përpjekur të bindte ortodoksët të mos votonin, por nuk ia kishte arritur. Përkujtesa e Korçës nuk gjeti përkrahje në Gjirokastër. Ortodoksët e qytetit, përfshi edhe grekomanët, nuk besonin te zëvendësmitropoliti, për shkak të qëndrimit të tij kryeneç.[168] Mbledhjet e organizuara në Mitropoli kishin pjesëmarrje shumë të ulët. Sidoqoftë, mospërsëritja e zhvillimeve të Korçës erdhi kryesisht falë ndërhyrjes së gjallë të prefektit të Gjirokastrës, Kol Tromara. Ai kishte urdhëruar arrestimin e kujtdo që nuk merrte pjesë në zgjedhje.[169]

Prefektura e Gjirokastrës ndiqte hap pas hapi veprimtarinë e Kishës. Tromara kanosi me përndjekje, kur mësoi se mitropolia zhvillonte mbledhje politike.[170] Atë Thanasi u kundërpërgjigj po atë ditë se mbledhjet e të krishterëve për çështje kishtare janë e drejtë e Mitropolisë dhe do të ndodhin sa herë shihej e nevojshme. Ai pohonte se ndalimi i mbledhjeve do të bëhej vetëm kur të ndalohej edhe meshimi për shkak të mundimeve që kisha haste nga Prefektura. Thanas Duka arsyetonte se Kisha nuk merrte pjesë akoma edhe në mbledhje shtetërore, pasi i vlerësonte politike.[171]

Mirëpo, kjo nuk e ndalonte të ishte në lidhje të vazhdueshme me Qeveritarin e Epirit dhe të zhvillonte mbledhje sa herë i kërkohej prej tij. Thanasi njoftonte përfaqësuesit grekë në fundjanar se do të thërriste një mbledhje për të vendosur mbi zgjedhjet. Gjithashtu, ai i qahej qeverisë greke për ndërhyrje të xhandarëve shqiptarë në kisha,[172] si edhe për gjykimin e trashëgimive nga Gjykata Civile dhe jo ajo Fetare, sipas

[164] Kondis, *Elinizmos II*, 423: IDAYE, A/5II3, nr. 2360, Qeveritari i Epirit drejtuar MPJ, 9 mars 1918.
[165] AQSH, F. 156 "Gjykata e Diktimit", V. 1923, D. 4, f. 143, Raport mbi Thanas Dukën, pa datë.
[166] Kondis, *Eliniizmos II*, 150-153: IDAYE, D. A/5/II(9), nr. 12431, Orfanidhis drejtuar Ministrisë së Luftës, 27 nëntor 1919.
[167] Kondis, *Elinizmos II*, 295: IDAYE, D. A/5, nr 1147, Qeveritari i Epirit drejtuar MPJ, 21/3 janar 1921.
[168] Vasil Dilo, "Psikoza e "Vorio Epirit"dhe marrëveshjet mbi protokollin e Korfuzit", *Ndryshe* nr. 289, 26 prill 2007, 16-17.
[169] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 14, Letër e Unionit-Panepirotik të Amerikës, 18 prill 1921.
[170] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 96, f. 15, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 21 shkurt 1921.
[171] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 96, f. 7, Mitropolia drejtuar Prefekturës, 14/27 janar 1921.
[172] Ngjarja duket se ishte një keqkuptim. Ajo kishte ndodhur në fshatin Goricë në Ditën e Ujërave të Bekuara dhe kishte nxitur gjakrat. Disa xhandarë kishin parë një flamur në oborr të kishës dhe menduan se ishte grek. Ata hynë në kishë dhe madje u futën në Ajovimë, dhomën në të cilën lejohet të hynë vetëm

ligjit të ri shqiptar. Duka kërkoi nga qeveria greke të bindte "vorioepirotët" që jetonin në Athinë të kundërshtonin botërisht trysninë e prefektit Tromara.[173]

Megjithatë, zëvendësmitropoliti nuk ia doli. Treva e vetme, ku jetonte pakica greke, nuk pati mospjesëmarrje. Deputetët e zgjedhur ishin atdhetarë shqiptarë. Lëvizja kishtare në Gjirokastër vijonte të fuqizohej edhe nën drejtimin e Atë Thanas Dukës. Ajo kryesohej nga Atë Pano Gjirokastra, i cili meshonte vazhdimisht në shqip nga njëri fshat në tjetrin. Ai sulmonte hapur Thanas Dukën, duke theksuar se sëmurej sa herë vinin festat kombëtare për të mos meshuar për to. Ai bënte të ditur se po zhvillohej veprimtari kundërkombëtare në Mitropolinë e Drinupojës dhe arka e Kishës po shpërdorohej prej pleqësisë grekomane. Populli i Gjirokastrës mori pjesë në një shërbesë shqip të drejtuar nga Atë Pano, më 8 qershor.[174] Ai meshoi në Tërbuq më 11 tetor,[175] ndërsa dëshmorët e Atdheut u nderuan në Kishën e Shën Mëhillit, më 26 nëntor. Shërbesa u ndoq edhe nga Atë Thanas Duka, i cili nuk bashkëmeshoi.[176]

1.3. Rrymat mbi çështjen kishtare ndër ortodoksët shqiptarë

Nismëtarët e Kishës Kombëtare në SHBA kishin ardhur në Shqipëri, duke thyer vetminë e përpjekjeve të Visarion Xhuvanit në Durrës. Mirëpo, hyrja e Fan Nolit në Atdhe nuk kishte qenë e lehtë. Kisha Autoqefale Shqiptare e Amerikës kishte vendosur të niste në Shqipëri tre priftërinjtë kryesorë, Atë Vasil Markon dhe Atë Vangjel Çamçen, nën kryesimin e Episkopit të zgjedhur Theofan. Vetëshpallja e Nolit episkop kishte sjellë mjaft kundërshtime, sidomos pasi Mitropoliti i Beratit, Joakimi, kishte përhapur në Shqipëri qarkoren e episkopit rus, Aleksandrit.[177]

Një pjesë e madhe e atdhetarëve shqiptarë i ishin kundërvënë veprimit të parregullt të Theofanit. Ish-udhërrëfyesi Sotir Peci do të bëhej kundërshtari më i ashpër. Ai e këshilloi që ta vononte mbërritjen në Atdhe, për të mos ngjallur përplasje.[178] Noli nuk e dëgjoi. Komisioni i ngritur nga qeveria për të dhënë udhëzime mbi përmirësimin e gjendjes në Jug të vendit, përbërë nga Koço Kota, Sotir Peci, Kiço Koçi, Sejfi Vllamasi, Fazlli Frashëri dhe Dhimitër Kacimbra, udhëzoi që Noli të mos lejohej të hynte në Shqipëri.[179] Po ashtu, Mitropolit Jakovi i kërkoi Kryeministrit Delvina moslejimin e ardhjes së "shkelësit të fesë". Ai mund të citonte lirshëm edhe atdhetarë shqiptarë, si priftërinjtë që kishin kundërshtuar veprimin e parregullt të Theofanit. Jakovi dërgoi shkresën që Atë Naum Çere, Atë Damian Angjeli dhe Atë Nikollë Kristofori i kishin drejtuar episkopit rus kundër Nolit. Jakovi theksonte se shkresa tregonte qartazi jetën dhe

---

priftërinjtë. Ata arrestuan priftin, duke i marrë edhe Kupën e Shenjtë. E vërteta doli shumë shpejtë: flamuri nuk ishte grek, por i Patriarkanës. Prifti u la i lirë menjëherë, ndërsa xhandarët u dënuan (Prefektura Gjir. drejtuar MPB, cit). Thanasi protestoi ashpër ndaj prefekturës (Mitropolia drejtuar Prefekturës, cit).

[173] Kondis, *Elinizmos II*, 295: IDAYE, D. a/5, nr. 1331, Bajra drejtuar Ministrisë së Luftës, 27 janar 1921.

[174] Alqi Jani, "Papapano Gjirokastra – Figurë e shquar e Kishës Shqiptare", *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare"* (Tiranë: Instituti i Historisë, 1993), 88-92.

[175] *Posta e Korçës*, 11 tetor 1921, nr. 55, 2.

[176] *Posta e Korçës*, 26 nëntor 1921, nr. 70, 1.

[177] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1920, D. 69, f. 1, Prefektura Berat drejtuar MPB, 27 gusht 1920.

[178] Vllamasi, *Ballafaqime politike*, 235-236.

[179] Beqir Meta, "Vështrim rreth kombëtarizimit dhe pavarësimit të kishës ortodokse", *Studime Historike* 1-2 (2006): 74.

sjelljen e priftit kombëtar. Ai shënonte se ky njeri nuk i sillte nder kombit shqiptar dhe nuk duhet të lejohej të hynte në Shqipëri.[180]

Priftërinjtë shqiptarë kishin zbritur në Vlorë, më 28 shtator. Pritja e popullsisë kishte qenë krejt ndryshe nga viti 1913: qindra mbështetës brohoritën në nder të dërgatës së Kishës Shqiptare. Tre burrat u nisën të nesërmen për në Durrës. Mirëpo, prefekti njoftoi Nolin se nuk mund të hynte. Vendimi ishte një zhgënjim i madh për një veprimtar si ish-kreu i "Vatrës". Theofani u detyrua të kthehej në Itali. Çështja "Noli" solli për pak paqëndrueshmëri të qeverisë. Ministrat e Brendshëm dhe të Jashtëm, Ahmet Zogu dhe Mehmet Konica, kërcënuan se do të jepnin dorëheqjen, nëse Noli nuk lejohej të kthehej.[181] Sulejman Delvina u detyrua të ndryshonte kurs përballë kësaj trysnie. Rrjedhimisht, Konica lajmëroi Nolin të rinisej për në Atdhe. Ministri Zogu urdhëroi prefektin e Durrësit, më 29 tetor, të lejonte Fan Nolin të dilte në Shqipëri.[182] Mirëpo, episkopi i vetëshpallur nuk kishte ardhur më 1 nëntor, kur pritej të zbriste në Durrës.[183] Pengesa u shndërrua në lajm të mirë, teksa qeveria e emëroi priftin në krye të dërgatës që do të përpiqej të anëtarësonte Shqipërinë në Lidhjen e Kombeve. Noli do të kthehej ngadhënjimtar, pas pak muajsh.

Ngjarjet kishin sjellë përçarje ndër ortodoksët shqiptarë. Shumica dërrmuese e ajkës ortodokse ishte qartësisht pro autoqefalisë, përveç një rryme të papërfillshme grekomane. Kjo e fundit përfaqësohej nga ajka e pakicës greke, si familja Bamiha, dhe nga një numër i pakët e gjithnjë e në rënie shqiptarësh ortodoksë, kryesisht bashkëpunëtorë të ngushtë të mitropolitëve grekë në Shqipëri. Ajo kundërshtonte autoqefalinë, kërkonte meshim në greqisht dhe varësi nga Patriarkana, së paku në trajtën e vetëdrejtimit. Mirëpo, përkrahësit e kësaj rryme përbënin një pakicë të papërfillshme që nuk mund të përcaktonte vendime. Historiani Xhozef Suajër thekson se shumica e shqiptarëve të Jugut ishin helenofilë, në kuptimin se ndiheshin të afërt me kulturën greke, porse vetëm një pakicë e vogël ishte grekomane, pra që kërkonte dobinë politike greke në kurriz të Shqipërisë. Kahkundërt, grekofilët në Shqipëri ishin nacionalistë shqiptarë, të cilëve u ngjallej armiqësi ndaj Greqisë nga çdo mëtim tokësor apo përpjekje për të penguar lirinë politike shqiptare.[184]

Shqipëria ishte ndër vendet me popullsi ortodokse më të njëtrajtshme, teksa thuajse 90 për qind e ortodoksëve ishin shqiptarë. Rumania dhe Bullgaria kishin asokohe pakica të mëdha të njërit vend në tjetrin, deri në shkëmbimin e popullsisë. Kisha Serbe përfshinte një popullsi shumë të madhe bullgarishtfolëse në Maqedoni dhe disa mijëra ortodoksë rumunë e më pak grekë dhe shqiptarë.[185] Greqia kishte më shumë se tridhjetë për qind popullsi shqiptare, vllahe, bullgare, si edhe turqishtfolës, pas shkëmbimit të ardhshëm të popullsisë. Megjithatë, Shqipëria mbetej vendi i vetëm, ku meshimi në gjuhë të huaj nuk ishte zhdukur.

Shumica dërrmuese e ajkës ortodokse shqiptare ishte e bindur për autoqefali. Së pari, veprimtaria e Jakovit, Vasilit dhe Gjermanosit e kishin nxjerrë në pah qëllimin

[180] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1920, D. 130, f. 1, Mitropolit Jakovi drejtuar Kryeministrit, 22 korrik 1920.
[181] Jorgaqi, *Fan Noli I*, 391.
[182] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1920, D. 69, f. 3, MPB drejtuar Prefekturës Durrës, 29 tetor 1920.
[183] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1920, D. 69, f. 4, Prefektura Durrës drejtuar MPB, 29 tetor 1920.
[184] Swire, *Shqipëria*, 23.
[185] Shqiptarët ortodoks ishin të përqendruar në zonën e Rekës, si edhe të Manastirit, ku jetonte edhe një bashkësi e vogël greke.

kundërshqiptar të Patriarkanës në dhjetëvjeçarin e parë të pavarësisë. Së dyti, rregullat kishtare përcaktonin se një shtet i pavarur si Shqipëria, me popullsi ortodokse vendase, kishte të drejtën e një kishe autoqefale. Së treti, drejtimi i kishës nga jashtë vendit mund të çonte në përçarje. Prandaj, të gjitha rrymat e ajkës ortodokse, nga më liberalët te më konservatorët, e shihnin autoqefalinë si rrugëzgjidhje të vetme. Përçarja lindte për dy arsye të tjera: kush do ta drejtonte dhe kush do ta mbikëqyrte lëvizjen kishtare. Kështu, ndër ortodoksët shqiptarë lindën tri rryma, që shkonin në katër së bashku me grekomanët. Këto rryma ishin: nacionalistët liberalë, fanolistët dhe së fundmi një rrymë ortodoksësh shqiptarë konservatorë.[186]

Rryma më e madhe ishin nacionalistët liberalë, të cilët kërkonin doemos një kishë autoqefale, të arritur nëpërmjet njohjes nga ana e kishave të tjera ortodokse dhe meshim në shqip në të gjitha kishat. Ata kundërshtonin ashpër vetëshpalljen e parregullt episkop të Fan Nolit, çka e vlerësonin të rrezikshme për dobinë kombëtare. Ky grupim do ta mbështeste Nolin për drejtimin e kishës, nëse ai do të dorëzohej rregullisht në të ardhmen. Ata e vlerësonin ndihmesën e Nolit dhe kundërshtonin vetëm veprimin e parregullt. Rryma përfaqësohej fetarisht nga Arkimandrit Visari, i cili kishte vepruar tërësisht në përputhje me rregullat kishtare dhe dobinë kombëtare. Ajo mbështetej politikisht nga shumica e ajkës ortodokse shqiptare, si: Sotir Peci, Agathokli Xhitomi, Leonidha Frashëri, Pandeli Evangjeli, Koço Kota etj. dhe kishte mbështetjen e shumicës dërrmuese të korçarëve, krahas një ndikimi të fortë në qarqe të tjera. Ndërkaq, qeveritë shqiptare e mbështetën planin kishtar të liberalëve deri në fund.[187]

Rryma e dytë përbëhej kryesisht nga vatranët dhe mbështetësit e flaktë të Fan Nolit. Fanolistët kërkonin zgjidhje rrënjësore, ashtu sikurse Noli kishte vepruar duke u vetëshpallur episkop. Ata e shihnin Kishën Autoqefale të krijuar që në vitin 1919 në Amerikë dhe që veçse priste të ndryshonte qendrën, nga Bostoni në kryeqytetin shqiptar. "Shpallja" e autoqefalisë shihej si e pavlerë dhe bisedimet me Patriarkanën, pa arsye. Udhëheqës politik e fetar ishte Theofan Noli. Priftërinjtë Vasil Marko dhe Vangjel Çamçe ishin mbështetësit kryesorë. Vatranë të njohur, si Mihal Grameno, e përkrahnin vazhdimisht.[188] Mirëpo, rryma pati mbështetje të rrudhur në politikë. Fillimisht, bashkëpartiakët e Nolit, Ahmet Zogu, Mehmet Konica, Terenc Toçi e të tjerë, i dolën në krah, por shumë shpejt ata do të përqafonin qëndrimin e liberalëve. Rrjedhimisht, Noli do të pranonte të qëndronte përkohësisht në hije.

Rryma e tretë përbëhej nga atdhetarë konservatorë. Ajo ishte e larmishme dhe përfshinte ata ortodoksë shqiptarë, kryesisht nga Gjirokastra, të cilët kishin pikënisje kryesore përkatësinë fetare. Ata kishin frikë se autoqefalia do të kishte qëllim sundimin ndaj ortodoksëve shqiptarë, nëse do të kryhej me ndërhyrjen e myslimanëve dhe katolikëve. Konservatorët kundërshtonin ashpër çdo përpjekje të vatranëve. Njëkohësisht, dëshironin mosndërhyrje qeveritare dhe bisedime mes pleqësive kishtare shqiptare me

[186] Emërtimet për këtë ndarje janë të autorit. Këto rryma nuk ishin të organizuara e si pasojë ishin shumëplanëshe, shumëpolare e pa udhëheqës. Por, ato dallohen qartë në planin kishtar, përgjatë gjithë përpjekjes për shpalljen e autoqefalisë.

[187] Veprimtaria e kësaj rryme del e qartë në trajtimet që Sotir Peci bën mbi çështjen kishtare. Shih AQSH, F. 55 "Sotir Peci", D. 77.

[188] Mbështetësit e Nolit janë trajtuar gjerësisht edhe nga jetëshkruesi i tij Nasho Jorgaqi, sidomos gjatë periudhës së parë të ardhjes në Shqipëri. Ndalimi i zbritjes në Durrës dhe kundërshtitë rreth kësaj çështjeje përbëjnë çastin e parë të daljes në skenë të këtyre përplasjeve, që do të kulmonin me meshimin e parë të Nolit në Korçë (shih sythin 2.1).

Patriarkanën. Rryma kërkonte marrëdhënie shumë të mira me Greqinë, por pa prekur pavarësinë shqiptare. Ajo luftonte që gjuha e meshimit të lihej në dorë të popullsisë, që greqishtja të mund të bashkëjetonte me shqipen dhe të ruheshin disa të drejta të posaçme të Kishës ndaj shtetit. Sipas tyre, vetëm kjo do të mund të siguronte se myslimanët nuk do të mbisundonin ndaj ortodoksëve shqiptarë. Rryma përmbante njerëz që do të cilësoheshin të dyzuar, si Vasil Dilo dhe Koço Tasi. Dilo kishte qenë pjesë e Kongresit Vorioepirot që miratoi Protokollin e Korfuzit, krahas Petro Haritos. Ai mbante një fletore greko-italiane gjatë pushtimit italian, por këto qëndrime nuk e bënin doemos grekoman, teksa ishte mbështetës i një Shqipërie të pavarur dhe një kishe autoqefale. Tasi kishte vendosur Atë Stathi Melanin si zëvendësmitropolit në Përmet (më vonë do të dilte kundër trupëzimit të Sinodhit të Kishës Shqiptare, kur u arratis si mbështetës i Fan Nolit). Kjo rrymë mund të thuhet se ishin atdhetarë shqiptarë, ortodoksë konservatorë, grekofilë, kundërshtarë të rreptë të vatranëve, por qartësisht pro pavarësisë shqiptare, autoqefalisë dhe kundër pranimit të kryepriftërinjve të huaj në Shqipëri.[189]

Grekomanët ishin të përqendruar në hapësirën Gjirokastër-Delvinë, ku jetonte pakica greke. Rrjedhimisht, edhe dyshimi ndaj ortodoksëve si me gjasë "më pak atdhetarë", si një përgjithësim i padrejtë, ishte më i theksuar te myslimanët shqiptarë të Gjirokastrës. Ndaj nuk është rastësore që ortodoksët shqiptarë në Gjirokastër ishin më të frikësuar ndaj një sundimi mysliman, në përsiatjen për përkatësi dhe dobi kombëtare. Aty kishte mjaft kombëtaristë shqiptarë, myslimanë dhe ortodoksë, që nuk shihnin ndarje fetare te kombi shqiptar, por një pjesë si Tasi, Dilo e të tjerë e shihnin këtë rrezik dhe përpiqeshin të vendosnin kufijtë e tyre të mospërçarjes. Krejt ndryshe, shumica e korçarëve dhe ortodoksëve në trevat e tjera nuk shihnin një kanosje të ngjashme, në mungesë të një rreziku grek. Ortodoksët e atyshëm ishin në pararojë të lëvizjes kombëtare, si lëvizje mbifetare, që do të mundësonte barazi përtej fesë. Lëvizja kishtare në këto treva bëhet vatra e shqiptarizimit të plotë të Kishës; për autoqefali pa lëshime.

Atdhetarët e rrymave të tjera i bënë të qartë Nolit se nuk duhej të merrej me çështjen kishtare, pasi u rikthye nga Lidhja e Kombeve në Shqipëri. Episkopi i vetëshpallur ruante lidhje të vazhdueshme me dy priftërinjtë që ishin dërguar në Korçë, por nuk vepronte si kryeprift, duke u kufizuar në jetën politike. Ai u zgjodh deputet nga Federata *Vatra* në mars 1921.[190] Sotir Peci e paralajmëroi Nolin, kur u mblodh kuvendi. Ai i tha se çdo veprim fetar si episkop do të përbënte rrezik kombëtar, për aq sa Protokolli i Kapshticës ishte në fuqi. Peci rreshtoi pesë arsye, pse Noli nuk duhej të përfshihej në jetën fetare, nisur nga qarkorja që e dënonte. Sipas tij, gjendja e ortodoksëve në Shqipëri ishte e brishtë. Patriarkana ishte duke kërkuar me qiri një arsye

[189] Vasil Dilo e arsyeton në këtë mënyrë qëndrimin ndaj çështjes kishtare në kujtimet e tij: "Sapo u bë shtet më vete Shqipëria nga një anë nacionalistat ekstremë dhe nga një anë Dullkaukerit që për oportunitet politik dhe nga ana tjetër fanatizma e vëllazërvet musullimanë, së cilës i ishte shoqërue edhe Qeveria Kombëtare sigurimin e shtetit nga dekllarimi i autoqefalisë të Qishës Orthodokse të Shqipërisë. Preteksti ishte që duhesh prerë korenti i influencës të elenizmit i cili bënesh me anë të Qishës; por qëllimi i vërtetë ishte që Qisha të mos përdoresh edhe ma prej të krishterëvet si një qëndrë e bashkimit të tyre dhe tue i prerë çdo rellasion me Patriarkanën ta thanin që në djep. " Ai arsyetonte se autoqefalia ishte e domosdoshme, por se çështja u përkiste të krishterëve dhe myslimanët nuk duhet të merrnin pjesë në të. Gjithashtu, ai thotë se vatranët ishin "shumicë myslimane" (Dilo, "Psikoza e 'Vorio Epirit'", cit.).

[190] Federata "Vatra" kishte të drejtën e të zgjedhurit një deputet në Kuvendin e parë Shqiptar, si shpërblim për punën atdhetare të kryer. Kështu, "Vatra" zgjodhi Nolin. Plotfuqia e Episkopit të zgjedhur Theofan u njoh me vendim qeverie, më 1 shkurtit 1921. AQSH, F. 152 "MPB", V. 1920, D. 3, f. 6, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 109, 1 shkurt 1921.

pse të mohonte autoqefalinë, sidomos në një vend me shumicë myslimane. Dalja e Nolit në krye të betejës pa qenë episkop i rregullt mund të çonte në përçarje. Peci mendonte se shumica do të trembej nga kundërshtimi i Patriarkanës dhe vetëm 10 për qind do të bashkoheshin me Nolin. Ai mendonte se, si atdhetarët liberalë, ashtu edhe ata konservatorë do të bashkoheshin kundër vatranëve. Peci vlerësonte se duhet të pritej shpallja e Kishës Autoqefale, arritja e marrëveshjes me Patriarkanën, dorëzimi i rregullt i Nolit nga dy episkopë të tjerë dhe pastaj vendosja e tij në krye të lëvizjes kishtare.[191]

1.4. Çështja e "Shën Gjergjit" dhe dëbimi i kryepriftit të fundit grek nga Shqipëria

Meshimi në gjuhën amtare bashkonte të gjithë shqiptarët. Pashkët e vitit 1921 nuk do të ishin si ato të vitit të kaluar. Jakovi ia kishte dalë të kthente greqishten në meshim, falë urdhrit të dhënë nga trupat franceze. Për më tepër, kishte mundësuar vijimin e status quo-së edhe nën qeverisjen shqiptare me anë të Protokollit të Kapshticës.

Atë Vangjel Çamçe dhe Atë Vasil Marko kishin mbërritur në Korçë, prej 26 nëntorit 1920, dy ditë përpara tetëvjetorit të pavarësisë. Synimi i tyre ishte ngritja e Kishës Autoqefale nga themeli.[192] Noli nuk i shoqëroi, për të mos krijuar përplasje deri në mbylljen përfundimtare të çështjes së kufijve. Çamçja shkoi dhe u takua me episkopin e vetëshpallur, kur ai u kthye nga Gjeneva në Tiranë.[193] Frymëzimi për korçarët do të vinte pikërisht nga ky takim. Priftërinjtë vatranë zhvilluan një meshë në shqip në Kishën e Tiranës, më 3 prill 1921. Meshtarë ishin Atë Vasil Marko, Atë Vangjel Çamçe dhe Atë Gjergji i Kishës së Tiranës.[194] Noli ishte në Kishë, por nuk bashkëmeshoi. Marko dhe Çamçe zhvilluan një tjetër meshë në Pogradec, më 16 prill. Ata bashkëmeshuan me priftërinjtë e qytetit, Atë Thanasi dhe Atë Nastasi, duke vijuar udhën e nisur nga Arkimandrit Visari.[195]

Korça kishte qenë në ballë të shqiptarizimit të kishës, por kishte mbetur befas ndër të fundit ku mesha zhvillohej në greqisht. Për këtë, paria e ortodoksëve korçarë u mblodh më 24 prill dhe vendosi të përmbushte dëshirën për të meshuar shqip në Kishën e Shën Gjergjit, përgjatë Pashkëve. Ata i dërguan kërkesën Sotir Pecit dhe deputetëve të tjerë të Korçës. Të nënshkruarit e quanin turp të madh meshimin në gjuhë të huaj, teksa akoma dhe në Amerikë e Vllahi shqiptarët meshonin shqip. Ata ishin përpjekur pranë prefektit Zoi, por ai i kërcënoi se do t'i burgoste, nëse do të hynin në kishë. Nënshkruesit shpreheshin gati të flijoheshin, por kundërshtonin fuqimisht burgosjen e priftit, çka do të ishte çnderim përpara grekomanëve. Zoi u kishte thënë se kjo do të vendosej nga qeveria qendrore, bashkë me Nolin dhe me deputetët e Korçës, por arsyetimi nuk i bindi. Ata shpreheshin se nuk kishin pasur frikë nga bajonetat greke dhe franceze, ndaj nuk mund të

[191] AQSH, F. 55 "Sotir Peci", D. 77, f. 14, Letër e Sotir Pecit, pa datë.
[192] "Andej-Këndej", *Koha* nr. 21, 27 nëntor 1920, 3.
[193] "Andej-Këndej", *Koha* nr. 34, 5 mars 1921, 3.
[194] Rako Katundi përshkruante për "Koha": "Kisha ishte mbushurë si edhe një shumicë e madhe qëndronte përjashta duke pritur me pa durim që të hapeshe nonjë vënt për të dëgjuar meshën shqipe. Që të gjithë kishin hedhur vërejtjen në të meshuarit shqip, të cilët për herë të parë e vështronin edhe dëgjonin". "Nga Tirana: Meshë shqipe", *Koha* nr. 41, 23 prill 1921, 1.
[195] "E para meshë në gjuhën amtare në Kishën e Pogradecit!", *Koha* nr. 42, 30 prill 1921, 1.; Shkrimi pranon se nuk ishte mesha e parë në shqip, por arsyetohej se Visari nuk i përkiste Kishës Autoqefale Shqiptare, të drejtuar nga Fan Noli.

frikësoheshin nga bajonetat shqiptare. Paria kanoste se do të bënte meshë shqip ose do të vrisnin shkaktarët dhe do të vriteshin edhe vetë. Po ashtu, kërkonin largimin e Jakovit në Durrës dhe kërcënonin se Atë Petro dhe Hirësia ishin në rrezik, nëse kërkesat nuk plotësoheshin.[196]

Gjendja ishte e nderë në Korçë. Mitropoliti dhe priftërinjtë meshonin greqisht, edhe pse një pjesë e tyre radhiteshin në lëvizjen kombëtare shqiptare. Nga ana tjetër, Atë Vasil Marko dhe Atë Vangjel Çamçja prisnin udhërrëfimin nga Noli. Qeveria kishte urdhëruar mosdaljen nga shtëpia të dy priftërinjve, për të shmangur përplasjet. Ngacmimi që do të ndryshonte gjithçka do të vinte andej nga nuk pritej: qeveria e Tiranës ishte kundër ndryshimit të status quo-së. Ky qëndrim ishte i qartë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, por ushtria ngriti krye. Kërcënimi i ortodoksëve korçarë u vendos në zbatim, nëpërmjet lëvizjes së një pjesëtari të mbledhjes së 24 prillit. Kanosja solli përleshjen më të madhe të vitit, që për pak shkaktoi luftë shqiptaro-greke.

Nismëtari ishte Spiro Kosova, një ortodoks vatran nga fshati Kosovë i Përmetit. Ai ishte kthyer për të ndihmuar pavarësinë shqiptare në vitin 1914 dhe ishte rreshtuar në ushtri si toger. Kosova drejtonte Kompaninë III të Batalionit të Parë të Ushtrisë, që qëndronte në Korçë. Kompania kishte shumë ortodoksë dhe u bë vatra e lëvizjes për meshim në shqip. Kosova kërkoi një mjedis për shërbesë fetare në gjuhën amtare nga drejtuesi i Batalionit, Mustafa Aranitasi, të Enjten e Madhe, 28 prill 1921. Togeri u lut që mesha të zhvillohej në një mjedis tjetër të shenjtë, në pamundësi për një kishë. Mirëpo, Kosova kërkoi një xhami për meshën ortodokse, për të ngacmuar përgjigjen e kolonelit. Aranitasi iu kthye ashpër se ka mjaft myslimanë për të shkuar në xhami, ndaj ortodoksët mund të shkonin në cilëndo kishë të donin, sepse gjuha shqipe nuk mund të ndalohej.[197]

Leja i mjaftonte Spiro Kosovës. Ai e dinte se kolonel Aranitasi nuk e kishte peshuar gjatë mendimin. Mirëpo, kjo ishte dytësore. Bashkë me nëntoger Kol Gjonin shkuan menjëherë në Kishën e Shën Gjergjit. Ajo ishte faltorja më e njohur e Korçës, krahas asaj të Mitropolisë. Dy ushtarakët pritën ardhjen e shërbëtorit që hapi derën dhe i morën çelësat. Shërbëtori kundërshtoi, por Kosova i thirri atdhetarizmit të korçarit të ri. Kol Gjoni kërcënoi me armë edhe dhjakun, që mbërriti pas pak.[198]

Spiro Kosova la Kol Gjonin në Kishë dhe iu drejtua shtëpisë së Atë Vasil Markos, i cili qëndronte si i burgosur, në pritje të ditës që Jakovi do të ikte nga Korça. Atë Vasili ishte korçar, i lindur në vitin 1886, i biri i Grigor Markos.[199] Kosova iu paraqit me detyrën që kishte te "Vatra" dhe i tha se kishte shkuar që ta çonte në Kishën e Shën Gjergjit për të meshuar. Atë Vasili as e priste këtë zhvillim. Ai i kërkoi Kosovës siguri se do të hynte në kishë, pasi prej atij çasti nuk mund ta nxirrte më njeri.[200]

---

[196] AQSH, F. 55 "Sotir Peci", D. 72, f. 12, Parashtresë drejtuar deputetëve korçarë, 24 prill 1921.

[197] Ngjarjet detajohen në kujtimet e Spiro Kosovës: Verli, *Spiro Kosova I*, 188-202. "Zoti kolonel, sot është një ditë e shënuar për neve të krishterët dhe duhet të vemi në faltore, mbasi unë në kompaninë time kam ushtarë të krishterë. Ju lutem fort kini mirësinë të ndërmjetësoni ku duhet që të më caktohet një xhami dhe t'i falemi Zotit në gjuhën tonë shqip", – i tha Spiro Kosova. Vende të tjera adhurimi janë përdorur shpesh, në mungesë të një mjedisi të fesë përkatëse. Katolikët në Elbasan meshonin në kisha ortodokse, ortodoksët në Shkodër, në kisha Katolike, deri sa kishat përkatëse u ndërtuan. Gjithsesi, kërkesa e Kosovës ka karakterin e një provokimi për të sjellë atë që rrodhi.

[198] Po aty.

[199] AQSH, F. 155 "MD", D. 169, f. 1, Biografi e Atë Vasil Markos, pa datë.

[200] Verli, *Spiro Kosova I*, 188-202.

Kosova e siguroi dhe të dy u nisën për në Shën Gjergj. Çasti i shumëpritur po vinte për Atë Vasilin. U fut në Kishë, u vesh dhe kambanat nisën të binin. Njerëzit rendën për në meshë. Drejtori i policisë, Nik Dishnica, dhe të gjithë vartësit e tij i prisnin përpara Kishës. Ata ndaluan besimtarët, sipas urdhrit qeveritar. Vetëm Atë Vasil Marko, Spiro Kosova dhe Kol Gjoni qëndronin brenda faltores. Kompania e parë, e thirrur prej Spiro Kosovës për të ruajtur rendin, ishte rreshtuar përpara saj. Kështu, përplasja ishte shndërruar mes policisë dhe ushtrisë. Spiro Kosova doli dhe iu drejtua Dishnicës të mos bënte fjalë me ushtarakët. Dishnica i kërkoi ta shoqëronte për të takuar prefektin. Me të shkuar në zyrën e tij, Zoi e cilësoi "kryengritje" veprimin. Kjo ishte fyerje për Kosovën. Ai u përgjigj se ishte i detyruar ta shuante çdo kryengritje kundër atdheut e qeverisë, prandaj nuk e pranoi pandehjen. Njëherazi, tha se dëshironte t'i lutej Zotit në shqip si oficer ortodoks shqiptar që nuk dinte greqisht. Grindja u ashpërsua. Zoi ishte atdhetar i sprovuar, por kundërshtar i veprimit të Nolit. Ai nënqeshi Atë Vasil Markon dhe Atë Vangjel Çamçen, çka nxehu gjakrat. Gjithçka mund të përfundonte në gjakderdhje, nëse në zyrë nuk do të gjendej toger Sami Koka. Çështja nuk ishte Kosova, por Aranitasi. Koloneli i tha prefektit se ai nuk mund të ndërhynte në çështje fetare. Zoi i sqaroi vendimin qeveritar për ruajtjen e status quo-së. Mirëpo, Aranitasi nuk pranoi të ndryshonte qëndrim.[201]

Prefekti telefonoi menjëherë ministrin e Punëve të Brendshme. Ai i shpjegoi gjendjen dhe i tha se Ministria e Mbrojtjes duhet të ndërhynte. Eprori e qortoi pse nuk e kishte parandaluar rrjedhën e ngjarjeve, edhe pse kryengritja nisi prej ushtrisë, ku Zoi nuk kishte fuqi. Teksa prefekti fliste me ministrin, Nik Dishnica nuk e ndalonte dot më meshën në Kishën e Shën Gjergjit. Edhe Atë Vangjel Çamçja kishte mbërritur dhe më se një mijë besimtarë mbushën mjediset e brendshme dhe oborrin për të dëgjuar meshën e parë shqipe në Korçë pas më shumë se një viti.[202]

"Koha" njoftonte me ngazëllim se një tepri populli kishte hyrë në Shën Gjergj dhe kishte kërkuar të meshohej shqip. Sipas saj, kundërshtia e prefektit u zbeh nga vendosmëria e popullit. Kori shoqërohej nga trupa muzikore e "Vatrës". Grameno përshkruante mallëngjimin e besimtarëve dhe lëvdonte drejtuesit ushtarakë që plotësuan detyrën fetare dhe kombëtare.[203]

Mosbindja e ushtrisë ishte e dukshme. Kolonel Aranitasi nuk pranoi të lëshonte Kishën, pavarësisht urdhrave nga Tirana. Madje, Spiro Kosova dhe Kol Gjoni u kërkuan në Tiranë për t'u dënuar, por Aranitasi u përgjigj se do të niste të gjithë kompaninë III.[204] Nikollaq Zoi nuk mund t'i zbatonte urdhrat për të marrë dhunshëm Kishën. Ai shënonte se asnjë përçapje nuk mund të bëhej për aq sa ushtria vijonte të përzihej në çështje, teksa oficerët kishin çelësat dhe quanin grekoman këdo që orvatej të mbyllte faltoren.[205] Zoi shfajësohej se populli qe këshilluar të mos e ngacmonte çështjen para zhvillimit të meshës. Mirëpo, kthimi në gjendjen e mëparshme ishte i pamundur pa turbullime pas shërbesës shqip.[206]

[201] Po aty.
[202] AQSH, f. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 12, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 28 prill 1921.
[203] "Kisha Shqipe në Korçë". *Koha* nr. 42, 30 prill 1921, 3.
[204] Verli, *Spiro Kosova I*, f. 188-202.
[205] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 20, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 1 maj 1921.
[206] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 12, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 28 prill 1921.

Zoi i kërkoi ndjesë Jakovit më 30 prill. Ai shprehu keqardhjen për mosparandalimin e puçit dhe për pjesëmarrjen e ushtrisë. Prefekti siguroi se Kisha do të rikthehej pas Pashkëve.[207] Ndërkaq, lajmet mbërritën të fryra në Athinë.[208] Katër të vdekur, nëntë të plagosur dhe paqartësi mbi jetën e Jakovit ishte pasqyra që kishte Ministria e Jashtme Greke më 3 maj 1921. Senatori Godard, që ato ditë kishte vizituar Korçën, u cilësua si shtysë për marrjen e Kishës. Ai kishte bërë thirrje për ringritje kombëtare, çka, sipas Athinës, solli çështjen e "Shën Gjergjit". Për më tepër, fshatrat e pushtuara nga Greqia në Devoll dhe Prespë ishin nën kërcënimin ushtarak shqiptar pas atij çasti.[209]

Pasqyrimi i zmadhuar për pak solli luftë. Kundërveprimi i parë i Greqisë ishte i dukshëm: asnjë shqiptar nuk mund të lejohej të hynte në Greqi. Prefekti i Kozanit thirri Nikollaq Zoin në Kapshticë më 6 maj 1921. Prefekti grek i pranoi Zoit se arsyeja e mbylljes së kufirit ishte çështja e Shën Gjergjit. Ai paraqiti gjashtë kërkesa. Dorëzimi i menjëhershëm i Kishës në duart e Mitropolitit të Durrësit ishte kushti kryesor i Greqisë. Pala shqiptare duhet të zotohej se nuk do të kërkonte letërnjoftime për grekët që donin të hynin në Shqipëri. Ndërsa, të krishterët e Korçës duhet të përjashtoheshin nga ushtria, pasi "ishin grekë".[210] Natyrisht, pala greke ishte lajmëruar se ushtarët ortodoksë ishin nismëtarë të çështjes së "Shën Gjergjit". Rrjedhimisht, ata synonin arritje të dyfishtë me këtë kërkesë. Së pari, mundësonin përçarjen brenda shoqërisë shqiptare në vija fetare, që të nesërmen mund ta shfrytëzonin në dobi të tyre. Së dyti, parandalonin zotërimin e mjeteve të forcës nga të krishterët shqiptarë, në masë atdhetarë. Shteti shqiptar kishte bërë disa përjashtime në thirrjen e ortodoksëve në ushtri prej vitit 1920, me qëllim që të pamundësonte kanosjen greke. Ajo masë kishte hasur në mjaft kundërshti, teksa ortodoksët kishin zhvilluar tubime për të kërkuar thirrjen e detyrueshme të mbarë bashkëfetarëve të tyre.[211]

Nikollaq Zoi u shfajësua se kisha u pushtua pa dëshirën e qeverisë dhe se zyrtarët qeveritarë u gjendën të papërgatitur për ndalimin e gjakderdhjes. Iliaqis u tregua i ashpër, duke kujtuar Protokollin e Kapshticës, që i jepte të drejtë të ndërhynte në çështjen kishtare shqiptare. Ai mendonte se nuk mund të falej moskthimi i menjëhershëm i Kishës, edhe nëse ngjarja ishte pasojë e çoroditjes së zyrtarëve shqiptarë. Ai tha se kjo dëshmonte bashkëfajësinë e qeverisë. Zoi ishte njëmendësuar me Jakovin që Kisha të kthehej më vonë, por prefekti i Kozanit nuk pranoi. Sipas tij, kombi grek nuk ishte i gatshëm të përulte rrezikshëm denjësinë e vet. Iliaqis i rrëfeu ortodoksit shqiptar Zoi se kombi grek mbajti kishat ndaj Perandorisë Osmane për 550 vjet dhe falë tyre u ringjall kombëtarisht. Ndaj, ai e shihte të pamundur një marrëveshje përulëse me Shqipërinë. Fundi i takimit fshihte një kanosje jo fort të fshehur. Iliaqis kërcënoi haptazi me luftë,

[207] Kondis, *Elinizmos II*, 333: IDAYE, D. A/5/10, nr. 4640, Nënprefektura e Follorinës drejtuar MPJ, 24/7 maj 1921.

[208] Edhe burime të huaja kishin një pasqyrë të zmadhuar të ndodhive. Ministri britanik lajmëronte se ishin 11 të vrarë, ndërkohë që nuk pati humbje njerëzore. Meta, "Vështrim rreth kombëtarizimit", f. 74.

[209] Kondis, *Elinizmos II*, 324-325: IDAYE, D. A/5/10, nr. 4538, Ministria e Luftës drejtuar MPJ, 21 prill 1921.

[210] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 60, f. 4, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 6 maj 1921.

[211] Përjashtimet u zhbënë në fillimvitin 1922, pasi çështja e kufijve shqiptarë ishte përfunduar. Beqir Meta, "Autoqefalia e Kishës Ortodokse Shqiptare në procesin e formimit të institucioneve kombëtare në vitet 1920-1924", *Studime Albanologjike* 11:1 (2008), 82-83.

duke thënë se Greqia ishte e gatshme me të gjitha fuqitë të bënte atë që qeveria shqiptare nuk mundej. Kjo u vlerësua madje si detyrë për mbrojtjen e denjësisë kombëtare.[212]

Çështja e Kishës së Shën Gjergjit u kthye në *casus belli*, siç frikësohej Tirana. Shumë shqiptarë ishin burgosur në Janinë si hakmarrje, ndër të cilët prefekti i Elbasanit dhe deputeti Hysni Vrioni. Të burgosurit u mbajtën për gjashtë javë, ndërkohë që Greqia shpallte se Shqipëria po lemeriste grekët në vend.[213]

Qeveria shqiptare pranoi pjesërisht kërkesat greke dhe vendosi që të ruhej status quo-ja kishtare derisa ortodoksët shqiptarë të vendosnin marrëdhëniet me Patriarkanën. Zoi u urdhërua të merrte çelësat e Kishës me ose pahir. Ndërkaq, kërkesat e tjera niseshin nga premisa se "Shqipëria nuk njihej si shtet sovran", ndonëse ishte anëtarësuar në Lidhjen e Kombeve dhe kishte shpallur pavarësinë prej një dhjetëvjeçari. Qeveria shqiptare iu përgjigj Athinës se çështjet e tjera të ngritura ishin të brendshme.[214]

Njëkohësisht, Shqipëria po bëhej gati për luftë. Kërcënimi i marrë në Kapshticë trembi qeveritarët në Tiranë dhe Korçë. Jakovi njoftonte se një mbledhje e parisë u thirr vetëm një ditë pas takimit të Kapshticës, për të biseduar rreth mbrojtjes, në rast sulmi grek. Ai shkruante se shumica ishin kundër luftës, duke mos dashur shkatërrimin e ri të vendit. Ushtria e vogël prej 200 njerëzish që qëndronte në Korçë u dërgua në Bilisht, ndërsa italianët kishin dhënë 20.000 armë. Kërkesat e Kapshticës ishin të rënda dhe zyrtarët e popullsia e kishin të pamundur t'i pranonin. Mitropoliti i Durrësit nënqeshte me kërkesën e një pjese të korçarëve që t'ia kthenin Kishën e Shën Gjergjit Jakovit, për të shmangur luftën. Ai shkruante se shqiptarët ishin për të ardhur keq, teksa të ndarë shanin njëri-tjetrin.[215] Zyrtarët shpërndanë një shpallje për popullin e Korçës më 14 maj. Ajo shkruante se qeveria nuk kishte qëllim të godiste fqinjët, përkundrazi kërkonte miqësi. Mirëpo, qeveria zotohej të përmbushte detyrën e saj së bashku me popullin, nëse ndonjë fqinj do të kalonte kufirin. Thirrja përfundonte me kërkesë për gjakftohtësi.[216]

Kisha mbetej e mbyllur, prej të Dielës së Pashkëve, kur kremtimi madhështor kishte ngritur pritshmërinë e korçarëve. Çelësat i kishin marrë gratë që shkonin në kishë, ndaj të cilave dhuna do të ishte më e vështirë. Atë Vasil Marko dhe Atë Vangjel Çamçe u kthyen në veçim shtëpie, edhe pse pa shpallje zyrtare. Qeveria kishte urdhëruar dërgimin e priftërinjve në Berat dhe marrjen me dhunë të çelësave ndaj grave, pasi ligji nuk bënte dallime mes gjinive.[217]

Mirëpo, zyrtarët vendorë u stepën nga zbatimi i urdhrit, nga frika e kundërveprimit të popullit. Mihal Grameno shkruante te "Koha" se përndjekja e kryengritësve të "Shën Gjergjit" ngjante me dorëzimin e Ulqinit malazezëve, kur gjenerali turk dërgoi telegram që "ushtria e padishahut dërmoi armikun", domethënë shqiptarët, duke bërë që atdhetarë si Abdyl Frashëri të qanin si fëmijë. Grameno

[212] Kondis, *Elinizmos II*, 327: IDAYE, D. A/5/10, pa nr., Prefektura Kozani drejtuar MPJ, 23 prill 1921.
[213] Meta, "Vështrim rreth kombëtarizimit", 79-80.
[214] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 60, f. 9, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 6 maj 1921.
[215] Kondis, *Elinizmos II*, 336: IDAYE, D. A/5/10, nr. 5446, Nënprefektura e Follorinës drejtuar MPJ, 12/25 maj 1921. Gjendja e pragluftës i dhuroi Jakovit një nderim. Ai u pajis me dekoratë ushtarake, atë të Kryqit Ushtarak të Rendit të Parë. Vendimi parashihte se udhëheqësit e ushtrisë greke do t'ia vendosnin në gjoks, sapo të hynin në Korçë. Dy dekoratat e tjera i kishte marrë në vitet 1914 dhe 1920 për veprimtarinë në Shqipëri. Jakovi mbetet ndër të paktët fetarë që kanë dekoratë ushtarake (Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 119-121.).
[216] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 60, f. 12, Shpallje e MPB, 14 maj 1921.
[217] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 27, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 11 maj 1921.

shkruante se Kisha ishte e ortodoksëve korçarë dhe vetëm ata do të merreshin vesh me Patriarkanën nëse dëshironin dhe jo me shtetin grek. Ai qortonte qeverinë se po u jepte armiqve të drejtë dhe shtrëngonte shqiptarët të jetonin me frikën e Greqisë: një shuplakë e idhët që nuk e meritonin.[218]

Qeverisë iu deshën dy javë të bindte gratë të jepnin çelësat, me premtimin se nuk do t'ia dorëzonte Jakovit. "Koha" nënqeshte se ky mësim u kishte ngrohur zemrat kombëtarëve dhe tani prisnin të shihnin cili trim do ta rrëzonte flamurin kombëtar nga Shën Gjergji.[219]

Qeveria shqiptare ndodhej mes dy zjarreve, ndaj zgjodhi t'i mbante çelësat për vete. Korça do të ngrihej në kryengritje, nëse kyçet i ktheheshin Jakovit. Ndërkaq, lufta me Greqinë vlerësohej në prag të portës, nëse lejonte rihapjen e Kishës. Kështu, mbyllja e Shën Gjergjit deri në një çast të dytë u vlerësua si zgjidhja më e mirë. *Status quo*-ja e re linte të pakënaqur korçarët, pasi shqipja u përjashtua sërish nga Kisha Ortodokse. Ajo ishte e pranueshme për Greqinë, teksa mbyllja e Kishës nuk ndikonte në asgjë.

Mirëpo kanosja greke nuk ishte e themeltë. Përfshirja e madhe ushtarake në Azinë e Vogël e bënte Athinën të mos e zbatonte kërcënimin për luftë. Ambasadori në Durrës i kishte pohuar atij britanik se masat e ashpra ndaj Shqipërisë do të merreshin vetëm pas përfundimit të çështjes së Azisë së Vogël. Greqia vetëm sa kishte rritur praninë ushtarake në bregun shqiptar me anijen shkatërruese "Aetos", si një trysni ndaj Tiranës.[220]

Ministri i Brendshëm, Fuat Dibra, udhëzoi Prefekturën e Korçës më 15 qershor, të përpilonte një kërkesë të nënshkruar nga shumë ortodoksë shqiptarë për të lejuar meshimin shqip në kisha.[221] Shkresa do të zbuste ndjenjat e popullit, teksa do të zyrtarizonte kërkesën. Njëherazi, do t'i shërbente Shqipërisë për ta paraqitur në Lidhjen e Kombeve. Përkujtesa shkruante se populli paqedashës që shijonte lirinë nën hijen madhështore të flamurit kombëtar kërkonte predikimin e fesë ortodokse në gjuhën amtare. Ajo vlerësonte mosfaljen në shqip si padrejtësi për nënat, gratë, motrat dhe fëmijët, teksa në kishat e stërgjyshërve predikohej gjuha e huaj greqishte. Përkujtesa shënonte rastin e pashoq shqiptar, ku kombi shijonte lirinë, por ishte i ndaluar në predikimin e fesë në gjuhën e vet, njëherazi gjuhë zyrtare e shtetit. Ajo arsyetonte se librat dhe priftërinjtë ishin tashmë, ndërkaq shqipja lejohej në shtete të huaja. Prandaj, ndalimi në Shqipëri ishte i pakuptimtë. Kërkesa i thërriste shprehjes "zëri i popullit është zëri i Perëndisë" dhe i drejtohej qeverisë të kujdesej për ta zgjidhur çështjen jetësore të ortodoksëve shqiptarë. Përkujtesa mori mbështetjen nga një numër i pashoq, më shumë se 7000 nënshkrime; ndër të cilët të gjithë njerëzit e njohur të qytetit dhe rrethinave të Korçës.[222]

Shtypi jehoi në faqet e para. "Posta e Korçës" shkruante se populli vërtetonte me padurim dhe zell dëshirën e natyrshme dhe qeveria duhet të bënte hapat e duhur pa asnjë drojë.[223] Për më tepër, shtypi mori shkas për të kërkuar largimin e Jakovit. "Posta" theksonte se ortodoksët kërkonin dëbimin e agjentëve të huaj që drejtonin kishat.[224]

---

[218] Mihal Grameno, "Armiku u dërrmua", *Koha* nr. 44, 21 maj 1921, 1.
[219] *Koha* nr. 44, 21 maj 1921, 2.
[220] Meta, "Vështrim rreth kombëtarizimit", f. 75.
[221] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 28, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 12 qershor 1921.
[222] Telegrami bashkë me nënshkrimet ndodhet në Arkivën Qendrore të Shtetit: AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 29, Kërkesë e qytetarëve drejtuar MPB, 16 qershor 1921.
[223] *Posta e Korçës* nr. 10, 18 qershor 1921, 2.
[224] *Posta e Korçës* nr. 11, 21 qershor 1921, 2.

Kryetari i Kuvendit, korçari Pandeli Evangjeli, dhe ministri Xhaferr Ypi premtuan më 8 qershor se Kisha do të kthehej brenda 15 ditëve. Përfaqësia kishtare shkoi në zyrën e Nikollaq Zoit dhe kërkoi çelësat më 23 qershor, kur mbaroi afati gjysmëmujor.[225] Kryeministri Ilias Vrioni e shtyu sërish vendimin, duke përligjur se gjendja politike detyronte që çelësat e Kishës të mbeteshin në dorë të qeverisë edhe për pak kohë.[226]

Gjendja ndryshoi tërësisht në gusht, pa vullnetin e qeverisë. Lajmet që vinin nga jashtë duket se ndikuan. Korçarët e dinin se pengimi i hapjes së kishave në shqip vinte prej kërcënimit ushtarak të Greqisë. Mirëpo, tri zhvillime të ndryshme përbënin lajmet kryesore në gusht. Qeveria e re greke kishte rikthyer në pushtet mbretin e dëbuar nga Venizelosi, duke krijuar një çarje sado të vogël me bashkëluftuesit e mëdhenj, sidomos me francezët. Ndaj, ata pakësuan ndihmën ekonomike dhe ushtarake. Së dyti, Greqia nisi mësymjen përfundimtare në betejën me Turqinë dhe arriti 40 kilometra larg Ankarasë. Zgjerimi kaq i madh i territorit grek kishte rritur jashtë mase nevojat ushtarake dhe ekonomike. Llogaritet se 200 mijë ushtarë grekë ishin në Azinë e Vogël në mes të muajit. Ndërkohë, edhe politika greke ishte përqendruar tërësisht në goditjen e fundit ndaj Turqisë.[227] Së treti, u mësua jozyrtarisht se Britania e Madhe mbështeti kufijtë shqiptarë, sipas Protokollit të Firences.

Nuk e dimë nëse këto rrethana kanë ndikuar në lëvizjen e fundit në çështjen e Kishës së Shën Gjergjit. Gjithsesi, ishte e qartë se Greqia nuk përbënte rrezik për Shqipërinë. Prefekti Nikollaq Zoi kërkoi lejen për t'i dhënë çelësat popullit më 22 gusht.[228] Ministri Sulejman Delvina e urdhëroi të mos i dorëzonte.[229] Mirëpo, Zoi njoftoi se populli hapi Kishën e Shën Gjergjit dhe ai nuk kishte mundur t'i ndalonte. Në fund, ai qe detyruar të jepte çelësat.[230] Gjendja i kishte dalë duarsh qeverisë. Këshilli i Ministrave vendosi shkarkimin e Nikollaq Zoit dhe drejtuesit të xhandarmërisë për mosveprim në përputhje me urdhrat qeveritarë. Vendimi u përmbajt derisa të gjendej zëvendësuesi, pasi nuk kishte vend për zbrazëti në qeverisjen e trevës.[231]

Arsyet pse Zoi nuk ndoqi urdhrat nuk dihen. Natyrisht, ai e kishte kuptuar se Shqipëria nuk rrezikonte të pushtohej. Në të kundërt, një atdhetar i sprovuar nuk do të rrezikonte. Arsyeja që e shtyu t'u kundërvihej eprorëve mund të jetë e shumëfishtë. Së pari, një sërë shkrimesh kishin parë dritën e botimit në shtypin vendor gjatë muajve të fundit. *Posta e Korçës*, *Gazeta e Korçës* dhe *Koha* e sulmonin pa të drejtë se kishte mbajtur qëndrim progrek në çështjen kishtare. Së dyti, Zoi nisi të kishte fërkime me qeverinë, për shkak të grekomanëve të qytetit. Letërkëmbimet e gushtit tregojnë se të mbështeturit e Jakovit nënshkruanin kërkesa për shkarkimin e tij. Prefekti i paraqiste Kryeministrit Vrioni se lëvizja kishte për kryetar Mitropolitin, me qëllim t'i sillte ngatërrime qeverisë shqiptare. Ai njoftonte se Jakovi kishte ngritur një komision katëranëtarësh për të shkuar në Tiranë, për të kërkuar prej qeverisë pushimin e nëpunësve, ndër të cilët edhe të vetë Zoit.[232] Vrioni nuk e mbështeti dhe priti e dëgjoi

[225] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 43, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 23 qershor 1921.
[226] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 44, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 4 korrik 1921.
[227] Ioanis Daskarolis, *Στρατιωτικά κινήματα στην Ελλάδα του Μεσοπολέμου (1922-1935) [Lëvizje ushtarake në Greqinë e mesluftës (1922-1935)]* (Athinë: Gnomon, 2012), 15.
[228] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 57, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 22 gusht 1921.
[229] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 58, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 22 gusht 1921.
[230] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 63, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 22 gusht 1921.
[231] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 97, f. 1, Vendim nr. 709 i Këshillit të Ministrave, 23 gusht 1921.
[232] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 136, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 10 gusht 1921.

grekomanët, duke e përligjur si diçka të natyrshme.[233] Të gjitha këto arsye duhet të kenë qenë shkaku i dorëzimit të Kishës së Shën Gjergjit.

Posta e Korçës botoi kryeshkrimin "Kishrat i kanë bërë gjyshrit tanë dhe janë tonat: Populli", duke përligjur marrjen e faltores. Ajo shkruante se populli mori lajmin gazmor të sigurimit të kufijve dhe nuk duronte më të lëvdonte Zotin në gjuhë të huaj. Prandaj, hapi Kishën dhe bëri ujë-bekimin, duke rifilluar meshimin në gjuhën amtare, me priftërinjtë kombëtarë në krye.[234] Menjëherë, Atë Vasil Marko dhe Atë Vangjel Çamçe zhvilluan një shërbesë në Kishën e Shën Gjergjit, me pjesëmarrjen e kryebashkiakut dhe mbarë Këshillës së Bashkisë.[235]

Moskundërveprimi prej pamundësisë ushtarake greke qartësoi përparësinë e palës shqiptare. Jakovi i kishte ditët të numëruara. Botimi i vendimit përfundimtar për kufijtë shqiptarë ishte ajo çka pritej që kryeprifti grek të mos përbënte kërcënim. Disa zyrtarë të shtetit mendonin se kishte ardhur koha, pasi veprimtaria e Mitropolitit të Durrësit ishte kthyer në rrezik kombëtar. Prefekti i Gjirokastrës, Kol Tromara, parashtronte më 18 gusht se qëndrimi i Jakovit në Korçë shkaktonte dëm dhe dobësonte fuqinë shpirtërore të qeverisë e popullit. Ndaj, ai udhëzonte dëbimin e shpejtë të kryepriftit.[236]

Nikollaq Zoi ishte më i bindur se kurrë. Ai sugjeroi zgjidhjen përfundimtare, pasi dorëzoi Kishën e Shën Gjergjit me nismë vetjake e në përplasje me qeverinë. Prefekti i arsyetonte ministrit më 29 gusht se atdhetaria kërkonte që kishat të ishin vetëm shqip dhe kjo mund të bëhej kur të dëbohej Mitropoliti.[237] Mirëpo, qeveria vendosi të mos rrezikonte. Ajo urdhëroi më 30 gusht që të ruhej status quo-ja kishtare deri në zgjidhjen përfundimtare të kufijve.[238]

Jakovi mbeti pa asnjë mbështetje, teksa Korça ishte larg vëmendjes së Athinës. Konsulli serb Çoloviç dhe gruaja e tij franceze ishin të vetmit që e vizitonin.[239] Bashkëpunëtorët e ngushtë, Doktor Noçka dhe Atë Petro, ishin dëbuar në Vlorë, për shkak të një ndodhie kundërshqiptare të atyre ditëve.[240] Jakovi theksoi se dëbimi nuk nderonte vendimmarrësit, ankesë që u mor parasysh me lirimin e dy burrave në mestetor 1921.[241]

Gjendja u rëndua pas vërtetimit se Hirësia kryente punë konsullore. Lajmi u bë i ditur fillimisht nga "Posta e Korçës". Ajo pyeste me nënkuptim pse prefekti nuk i kishte kërkuar Jakovit dëshmitë për të parë në ishte mitropolit apo konsull. Fletorja qortonte Nikollaq Zoin se nuk u kishte vënë veshin parashtresave të vartësve, që vërtetonin pjesën konsullore të punës së Jakovit. "Posta" e uronte Mitropolitin për punën si atdhetar i vërtetë i atdheut të tij.[242] Sulmi ndaj prefektit ishte i padrejtë. Zoi e kishte njoftuar ngjarjen dhe kishte kërkuar edhe dëbimin e Jakovit.[243] Ai u takua me Mitropolitin dhe e

[233] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 45, f. 137, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 10 gusht 1921.
[234] "Kishrat i kanë bërë gjyshrit tanë dhe janë tonat: Populli", *Posta e Korçës* nr. 36, 23 gusht 1921, 1.
[235] *Posta e Korçës* nr. 36, 23 gusht 1921, 2.
[236] AQSH, F.149 "Kryeministria", V.1921, D.VI-66, f. 2, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 18 gusht 1921.
[237] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 66, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 29 gusht 1921.
[238] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 68, Vendim nr. 726 i Këshillit të Ministrave, 30 gusht 1921.
[239] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 118.
[240] *Posta e Korçës* nr. 60, 25 tetor 1921, 2.
[241] Glavina, "Mitropoliti i Durrësit", 60-61.
[242] *Posta e Korçës* nr. 33, 10 gusht 1921, 1.
[243] AMPJ, V. 1921, D. 159, f. 26, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 27 gusht 1921.

ballafaqoi me shkresat e kapura. Kryeprifti grek u përgjigj se letrat i jepte për të lehtësuar popullin, por do ta ndërpriste lëshimin e dëshmive, nëse qeveria e urdhëronte.[244]

Fushëveprimi i fundit i mbetur i Jakovit ishin shkollat. Korçarët kishin rendur të kyçeshin në shkollat greke vitin e kaluar, pasi pritej pushtimi i Korçës. Mirëpo, viti i ri sillte një pasqyrë tjetër. Atdhetarët nisën përpjekjet për fuqizimin e mësonjëtoreve të çelura shqiptare. "Posta e Korçës" nisi betejën kundër Mitropolisë. Ajo shkruante më 19 korrik se nxënësit e paktë që vazhdonin mësimin në "shkollat e poshtra" përfshinin edhe fëmijë të atdhetarëve të njohur, të cilët prefekti i këshillonte shpesh.[245]

Kryeshkrimi "Dërgoni fëmijët në shkollat e shtetit" thërriste në ditënisjen e vitit shkollor, që korçarët t'ia jepnin fëmijën Atdheut. "Posta" kërkonte të liheshin mënjanë thashethemet dhe të përkrahej Shqipëria e përbashkët, duke vrapuar drejt shkollave shtetërore e duke i shtypur kokën gjarprit që mundohej të helmonte trupin e të linte kombin në gjysmëvdekje.[246] Po ashtu, fajësonte Jakovin për përzierje me politikë, teksa kryeprifti kishte kërkuar dërgimin e fëmijëve në shkollat greke.[247]

Kyçjet në shkollat e Mitropolisë ishin të pakta. Jakovi përligjej në parashtresën drejtuar qeverisë greke se trupat e rendit kishin ndaluar çeljen e shkollës më 13 shtator me urdhër të prefektit. Kryeprifti kërkonte ndërhyrjen e qeverisë greke, ndërkohë që iu ankua edhe Kryeministrit Iljaz Vrioni.[248] Goditja përfundimtare ishte ndalimi i drejtorit të gjimnazit grek të Korçës, Anagnostopullos, të hynte në vend, pas një vizite në Greqi. Ankesa e Jakovit nuk u mor parasysh.[249] Çështja u cilësua politike dhe e palidhur me kryepriftin. Qeveria arsyetonte se Anagnostopullos merrte pjesë në klubet vorioepirote në Athinë prej dy muajsh.[250]

Në këto rrethana, qeveria shqiptare i frikësohej vetëm ndonjë kryengritjeje, si kundërveprim i fundit ndaj humbjes greke të Korçës. Kol Tromara kishte theksuar në parashtresën kundër Jakovit se nuk ishte çudi të përsëriteshin ngjarjet e 1914-ës, duke kujtuar kryengritjen e drejtuar asokohe nga Gjermanosi.[251] Prefekti Zoi ndërmori veprim. Ai kërkoi të sheshonte pak ushtarë në oborrin e Mitropolisë, por Jakovi nuk pranoi të dorëzonte çelësat. Zoi ndërhyri i frikësuar se mos po përsëritej plani i vitit 1914.[252] Bastisja e 5 shtatorit nuk gjeti gjë.[253] Jakovi iu ankua Kryeministrit Vrioni dhe ministrit të Brendshëm, Sulejman Delvina, dy ditë më vonë. Po ashtu, ai iu qa zyrtarëve të lartë se Zoi thurte kërkesa nga kryekatundarët e Korçës për dëbimin e hirësisë.[254] Edhe ministri britanik në Tiranë kishte të dhëna se marrja e nënshkrimeve ishte pasojë trysnish.[255]

Kryeministri Vrioni ishte kundër këtyre veprimeve në pritje të vendimit përfundimtar për kufijtë. Ai i kërkoi Zoit të mos u jepte shkak paudhësive. Mirëpo, gjendja nuk ishte më në duart e prefektit. Zoi iu përgjigj se populli kërkonte masa ndaj

[244] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 56, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 21 gusht 1921.
[245] *Posta e Korçës* nr. 21, 19 korrik 1921, 2.
[246] "Një këshillë vëllazërore popullit të Korçës" *Posta e Korçës* nr. 44, 13 shtator 1921, 1.
[247] *Posta e Korçës* nr. 44, 13 shtator 1921, 2.
[248] Glavina, "Mitropoliti i Durrësit", 59-60.
[249] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 84, Mitropoliti Jakovi drejtuar MPB, 3 tetor 1921.
[250] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 88, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 11 tetor 1921.
[251] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1921, D. VI-66, f. 2, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 18 gusht 1921.
[252] AMPJ, V. 1921, D. 42, f. 119, Prefektura Korçë drejtuar Dërgatës shqiptare në Paris, 10 nëntor 1921.
[253] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 70, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 5 shtator 1921.
[254] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 71, Jakovi drejtuar MPB dhe Kryeministrisë, 7 shtator 1921.
[255] Meta, "Vështrim rreth kombëtarizimit", 84.

Mitropolitit, edhe pse ai po përpiqej t'i ndalonte.[256] Kërkesa kundër Jakovit gjeti hapësirë në radhët e "Postës", që arsyetoi se masat ishin të domosdoshme për të shpëtuar nga dredhitë.[257]

Ortodoksët e Oparit pasuan më 10 shtator, duke kërkuar dëbimin e kryepriftit.[258] Gjithë përpjekja fetare rrezikoi befas, kur Koço Tasi u emërua nënministër i Brendshëm. Ai ishte kundërshtar i flaktë i lëvizjes së parregullt të Nolit, e si pasojë edhe i vatranëve. Nënministri i tërhoqi vëmendje Zoit më 11 shtator. Ai paditi prefektin si frymëzues të kërkesës së Oparit.[259] Mirëpo, Tasi nuk qëndroi me kaq. Ai i kërkoi Prefekturës kthimin e Kishës së Shën Gjergjit në duart e Mitropolisë.[260] Zoi e tëhuajti. Ai tha se lirimi i Kishës do të quhej çnderim prej të gjithë shqiptarëve dhe do të shkaktonte turbullime.[261] Sulejman Delvina e shfuqizoi menjëherë urdhrin e nënministrit.[262]

Përpjekjet e Tasit nuk e shpëtuan Jakovin. Komandanti i Qarkut të Korçës, Ferid Frashëri, parashtronte më 27 tetor se një grup shqiptarësh do ta dëbonin me pahir jashtë kufijve.[263] Prandaj, Prefektura rriti numrin e rojeve që mbronin jetën e Mitropolitit.[264]

Korçarët e kthyen qytetin në vatër atdhetarizmi dhe fetarie ende pa ikur kryeprifti grek. Meshtarë atdhetarë mbërrinin nga të gjitha anët e Shqipërisë. Atë Isaia nga Vlora u bashkua me Kishën Autoqefale, më 5 nëntor. Ndërkaq, shumë priftërinj korçarë bëheshin gati të braktisnin Jakovin për t'u bashkuar shpirtërisht me autoqefalistët.[265] Atdhetarë dhe dëshmorë të kombit nisën të përkujtoheshin. Atë Vasil Marko drejtoi përshpirtjen për katërvjetorin e vdekjes së Themistokli Gërmenjit, pas pesë ditësh.[266]

Kërkesa zyrtare për dëbimin e Jakovit u hartua nga Ministria e Brendshme më 29 tetor 1921. MPB njoftoi Kryeministrinë se politika e brendshme kërkonte që Mitropoliti të largohej nga Korça. Prandaj, Kryeministria sugjerohej të peshonte pasojat e dëbimit në pjesët e tjera të politikës shtetërore.[267]

Qeveria do të priste, deri kur Shqipëria siguroi kufijtë me Greqinë, më 9 nëntor 1921. Konferenca e Paqes e Parisit njohu Protokollin e Firences. Ky vendim solli fundin e Jakovit në Korçë. Agimi i 19 nëntorit çeli "Postën" me mbishkrimin "Kupa u mbush – Dhespot Jakovi duhet dëbuar medoemos".[268] Drejtuesit e fletores ishin në dijeni të zhvillimeve. Ministri i Punëve të Brendshme dorëzoi arsyetimin e vendimit në mbledhje të Këshillit të Ministrave pak orë më vonë. Ai bazohej në ligjin otoman që ishte ende në fuqi në Shqipëri, sipas të cilit Mitropoliti duhet të ishte nënshtetas i vendit. Jakovi nuk

[256] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 77, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 9 shtator 1921.
[257] "Të dëbohet dhespoti", *Posta e Korçës* nr. 42, 8 shtator 1921, 2.
[258] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 90, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 10 shtator 1921. Opari është zona malore në perëndim të Korçës. Kjo krahinë përbën gjeografikisht pjesën më të madhe të krahinës së Korçës dhe është e banuar tërësisht nga shqiptarë, kryesisht nga ortodoksë.
[259] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 91, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 11 shtator 1921.
[260] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 92, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 12 shtator 1921.
[261] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 98, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 14 shtator 1921.
[262] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 97, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 14 shtator 1921.
[263] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 105, Qarku Korçë drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 27 tetor 1921.
[264] *Posta e Korçës* nr. 61, 27 tetor 1921, 2.
[265] *Posta e Korçës* nr. 64, 5 nëntor 1921, 2.
[266] *Posta e Korçës* nr. 65, 10 nëntor 1921, 2.
[267] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1921, D. VI-66, f. 3, MPB drejtuar Kryeministrisë, 29 tetor 1921.
[268] "Kupa u mbush – Dhespot Jakovi duhet dëbuar medoemos", *Posta e Korçës* nr. 68, 19 nëntor 1921, 2.

kishte lindur në tokë shqiptare e as ishte prej gjaku apo gjuhe shqiptar, çka bënte që të mos plotësonte cilësitë ligjore për të qenë Mitropolit vendor.[269]

Qeveria miratoi njëzëri dëbimin e Jakovit.[270] Ministria e Brendshme lajmëroi Prefekturën e Vlorës të priste biletë të klasit të parë për Itali ose Greqi, për të shmangur ankesat e Mitropolitit. Shtypi u udhëzua të mos shkruante kundër cilësisë fetare, por të lajmëronte se dëbimi vinte pasi hirësia kishte vepruar si vegël e huaj.[271] Drejtori i Policisë së Korçës, Nik Dishnica, shkoi në Mitropoli, ku e gjeti Jakovin në gjumë.[272] Qeveria i kishte lënë vetëm dy ose tri orë kohë. Dishnica shoqërohej nga një mjek, për t'u siguruar se nuk do të kishte ndonjë rreng. Jakovi duhej të këqyrej në vend, nëse shtirej i sëmurë. Ai duhet të hipej me zor në makinë dhe të nisej për në Vlorë, nëse nuk do të kishte ndalim mjekësor. Dishnica ishte urdhëruar të kujdesej veçanërisht për mosprekjen e denjësisë fetare të kryepriftit.[273] Jakovi kundërshtoi, por pa vlerë. Ai kërkoi të shkonte në Kishë për herë të fundit dhe të dilte nga Kapshtica, por nuk u lejua.[274] Makina e Jakovit dhe ajo e plaçkave morën rrugën e Kolonjës për të dalë në Vlorë. Ai shoqërohej nga një oficer i krishterë dhe 10 xhandarë.[275] Siç ishte planifikuar, Mitropoliti i Durrësit la Shqipërinë të nesërmen; këtë herë pa kthim.

Përfaqësia e Lidhjes së Kombeve që vizitoi vendin pak muaj më vonë do të vërente se dëbimi ishte rrjedhojë e natyrshme e veprimtarisë së Jakovit. Ata shënonin se pakica që dëshironte të ishte nën sundimin grek ishte jashtëzakonisht e vogël, ndërkaq fushata e hapur kundërshqiptare e mitropolitit kishte bërë që pjesa atdhetare ta hiqte qafe këtë prift të huaj që e shihte si mik të paftuar.[276]

Kishat u mbushën si asnjëherë më parë, ditën e ikjes së Jakovit. Priftërinjtë e Mitropolisë drejtuan një përshpirtje për dëshmorët e rënë në fushën e lëvizjes kombëtare, ku morën pjesë të gjithë zyrtarët vendorë dhe ushtarakë, krahas një teprie populli.[277] Përshpirtja rrëfente veprimtarinë që Kisha duhet të kishte në shoqëri. Shërbesa përkatëse u mbajtën në kishat katolike dhe xhami, pas një qarkoreje bashkërenduese të Ministrisë së Punëve të Brendshme.[278]

Priftërinjtë e Korçës zgjodhën një pleqësi të re kishtare me kryetar Llambro Mbrojën dhe sekretar Foqion Postolin. Anëtarë ishin atdhetarët korçarë: Llambi Bimbli, Sotir Kota, Thanas Mano, Vangjel Turtuli, Kristaq Marko dhe Vani Kirka. Meshtarët shpallën bindje dhe pranuan të lexonin shërbesat në shqip që të nesërmen.[279] Pleqësia paditi Jakovin se kishte marrë të holla të qarkut kishtar për fushatën kundërshqiptare. Gjithashtu, kryeprifti u fajësua se kishte marrë plaçka të Mitropolisë, përfshi dhe një veshje me vlerë 3.000 franga.[280] Jakovi la zëvendës Atë Josifin, priftin, që kishte

---

[269] AQSH, F. nr. 159 "Kryeministria", V. 1921, D. VI-66, f. 9, MPB drejtuar Kryeministrisë, 19 nëntor 1921.
[270] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 196, Vendim nr. 910 i Këshillit të Ministrave, 19 nëntor 1921.
[271] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 59, MPB drejtuar Prefekturës së Vlorës, 20 nëntor 1921.
[272] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit,* 199.
[273] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 60, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 20 nëntor 1921.
[274] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit,* 201.
[275] "Qeveria largoj nga Korça Dhes. Jakovë", *Posta e Korçës* nr. 69, 22 nëntor 1921, 1.
[276] Joseph Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie* (Tiranë: Dituria, 2005), 304.
[277] *Posta e Korçës* nr. 69, 22 nëntor 1921, 4.
[278] AMPJ, V. 1921, D. 172, f. 9, Qarkore e MPB, 19 nëntor 1921.
[279] *Posta e Korçës* nr. 70, 26 nëntor 1921, 2.
[280] *Posta e Korçës* nr. 72, 3 dhjetor 1921, 2.

shqiptarizuar përsëpari Kishën në Korçë në vitin 1914. Atë Josifi ishte zgjidhja më e mirë, teksa nuk do të paragjykohej nga askush.[281] Vendimi i parë i drejtuesve të rinj ishte ndryshimi i gjuhës më 22 nëntor. Pleqësia vendosi që gjithçka të kryhej në shqip. Po ashtu, meshimet do të përmendnin qeverinë shqiptare dhe përkohësisht Sinodhin e Patriarkanës derisa të përfundonte çështja e Kishës Autoqefale.[282]

Ikja e Mitropolitit solli fundin zyrtar të arsimit grek në Korçë. Pandeli Kotoko shënonte vite më vonë se shkollat dhe kishat greke pushuan së vepruari prej ikjes së Jakovit në vitin 1921.[283] Shtypi grek kundërveproi siç pritej. Ai citonte konsullin serb se kryeprifti ishte larguar me dhunë. "To Fos" përshkruante më 23 nëntor se grekët e Korçës kishin qarkuar makinën e Mitropolitit, duke qarë dhe duke kërkuar të mos dëbohej. Ndërsa, shkollat dhe kishat ishin zaptuar prej shqiptarëve. "Posta" përgjigjej se nuk kishte kush tjetër t'i merrte kishat, për aq sa nuk kishte grekë në Korçë.[284] Ministria e Punëve të Jashtme nuk e pa të arsyeshme t'i përgjigjej ankesës së konsullit serb.[285] Dëbimi i Jakovit përbënte ditën e fundit të Nikollaq Zoit në krye të prefekturës së Korçës.[286] Ai dha dorëheqjen, duke jetësuar vendimin e ngrirë të shkarkimit. Zoi do të rikthehej në çështjet botore vetëm pas dhjetë vjetësh.

Miratimi i kufijve shqiptarë kishte mbyllur periudhën e Jakovit në Korçë. Përgojimet e kryepriftit grek se po përndiqej nga një shtet "mysliman" dolën të pavërteta. Dëbimi ishte nxitur nga pranimi i kufijve shqiptarë, çka u krye falë veprimtarisë së episkopit të zgjedhur Theofan Noli. Qeveria që vendosi ta largonte, drejtohej nga një tjetër ortodoks, e madje korçar, Pandeli Evangjeli. Prefekti që këmbënguli me çdo mjet ta dëbonte dhe drejtori i policisë që plotësoi këtë detyrë, ishin të krishterë vendas: Nikollaq Zoi dhe Nik Dishnica. Korça, në duar të korçarëve, ishte gati të priste Theofan Stilian Nolin.[287]

1.5. Feja në baraspeshën diplomatike shqiptaro-greke, 1919-1921

Konferenca e Paqes në Paris ishte vendi më i mirë që Athina të krijonte përshtypjen se ortodoksët shqiptarë ishin grekë. Greqia shkonte si fitimtare, me joshjen dhe lavdinë e Kryeministrit Venizelos, i cili kishte ngadhënjyer në betejën e brendshme me Mbretin Aleksandër. Së dyti, krijimi i Shqipërisë ishte marrëveshja e fundit të madhe e Koncertit të Vjenës. Konferenca e Paqes ishte mbledhur pikërisht për të krijuar rendin e ri botëror pas Koncertit. Ndaj, mund të ishte e gatshme të ndryshonte marrëveshjen e fundit të tij. Së fundmi, shembulli i Perandorisë Osmane rrëfente se feja ishte pararendës

[281] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1921, D. 111, f. 124, Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 22 nëntor 1921.
[282] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1921, D. VI-66, f. 7, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 24 nëntor 1921
[283] Stratigaqis, *Mitropoliti i Mitilinit*, 107-108. As Jakovi e as Kotoko nuk do të shihnin shkolla greke përreth Korçës sa të ishin gjallë. Shkollat greke nuk u kërkuan zyrtarisht nga popullsia as gjatë periudhës së demokracisë liberale 1920-1924, as gjatë Mbretërisë dhe as gjatë periudhës së komunizmit. U nevojitën 80 vjet që Shqipëria të bënte një lëshim të tillë, vetëm në vitet 2000, kur shkolla greke do të çelej sërish në rrethinat e Korçës; një arritje e pamenduar as për vetë Kotokon, që e quante hapjen e shkollave greke në Korçë, betejë të humbur prej kohës së Jakovit...
[284] "Shpifjet e gazetave greke mbi dëbuarjen e Dhespot Jakovit", *Posta e Korçës* nr. 72, 3 dhjetor 1921, 1.
[285] AMPJ, V. 1921, D. 59, f. 52, Protesta e konsullit grek në Korçë, pa datë.
[286] "Përgjigje Z-Tij N. Zoit, ish-prefektit të Korçës" *Posta e Korçë*s nr. 70, 26 nëntor 1921, 2.
[287] *Posta e Korçës*, nr. 72, 3 dhjetor 1921, 2.

kombëtar në Ballkan. Kombformimi në këtë hapësirë u shfaq kryesisht si shndërrim i miletit fetar në kombet e reja.[288] Vijat ndarëse vendoseshin ndër bullgarishtfolësit mbi "patriarkanistët grekë" dhe "ekzarkistët bullgarë"; turqit ortodoksë të Kapadokisë vetëshpalleshin grekë dhe grekët myslimanë të Kretës pandeheshin turq; ndërsa malazezët, serbët dhe kroatët kishin krijuar përkatësi kombëtare në bazë fetare.

Venizelos dallonte në Paris. Dërgata e Kryeministrit grek përfshinte edhe ministrin e Jashtëm të Republikës së Epirit të Veriut, Karapanosin. Qëllimi ishte jetësimi i Idesë së Madhe të Greqisë së pesë deteve. Ndihmësit mbanin dosje ku ndërthureshin harta dhe të dhëna që, sipas palës greke, vërtetonin se "Epiri i Veriut" i takonte Greqisë. Venizelos i parashtroi Konferencës se gjuha nuk ishte matëse për kombin e tij fqinj. Ai mori për shembull shqiptarët e Atikës dhe Eubesë, të cilët kryesonin flotën greke prej pavarësisë, duke thënë se admiralët e tij flisnin vetëm shqip.[289]

Gjysma e qeverisë fliste po shqip, çka përbënte asin nën mëngë të Venizelosit. Ai paraqiti si "të vërtetë të madhe", të fshehur gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër, se kombi në Shqipëri ndahet me pikënisje fenë. Të dhënat e paraqitura nga Karapanosi mbronin arsyetimin, duke shënuar se ortodoksët përbënin shumicën në Shqipërinë e Jugut.[290] Natyrisht, hartat nuk shënonin se ata ishin në masë dërrmuese ortodoksë shqiptarë, që në ndërthurje me myslimanët, e zhvleftësonin përqindjen e grekëve në kazatë otomane të Gjirokastrës dhe Korçës. Komisioni i Fuqive të Mëdha nënvizonte se dërgatat franceze dhe britanike ishin të mendimit se të dhënat fetare nuk mbështesnin palën shqiptare, ndërsa të dhënat gjuhësore nuk përfaqësonin kriter të drejtë për grekët. Kryeministri francez, Klemanso, kishte kundërshtuar përdorimin e gjuhës për përcaktimin e kombësisë prej vitit 1913. Ai merrte si shembull pikërisht bëmat e epirotëve shqipfolës në luftën për pavarësinë e Greqisë.[291]

Dërgata amerikane u njëmendësua me lëshimin e Gjirokastrës, por jo të Korçës. Ndërkaq, italianët kërkonin ripohimin e kufijve të vitit 1913. Dërgata shqiptare nuk mund t'i bënte ballë joshjes së Venizelosit. Ajo thjesht sa paraqiti kërkesat, teksa askush nuk i përqafoi. Përjashtim përbënte dëshmia e dr. Mihal Turtullit. Të qenit mjek korçar ortodoks e bënin shëmbëlltyrë të padrejtësisë së arsyetimit grek. Ai dëshmoi se Korça nuk kishte asnjë grek dhe ngatërresa e fesë me kombësisë ishte sajesë e palës tjetër. Turtulli kishte qenë nxënës e më vonë drejtor i një shkolle greke. Ai pohoi se këto shkolla nuk ishin provë greqizmi. Dëshmia e tij frenoi në masë qëndrimin grek dhe zgjoi bisedat në komision. Protokolli i Korfuzit u cilësua nga Venizelosi si shembull i greqizmit të "Epirit të Veriut". Mirëpo, dërgata shqiptare parashtronte se Protokolli u bë pa vullnetin e qytetarëve dhe nën armët e ushtrive të huaja. Ajo vendosi përballë Protokollin e Korçës me francezët, të nënshkruar nga përfaqësues të zgjedhur të korçarëve pa frikën as të armëve shqiptare e as të armëve greke. Komisioni dëgjoi edhe qeverinë "vorioepirote",

[288] Hannes Grandits, Nathalie Clayer, dhe Robert Pichler, *Conflicting Loyalties in the Balkans: The Great Powers, the Otoman Empire and Nation-Building*, (London: I.B. Tauris, 2011), 89-90.
[289] Për punimet në Konferencën e Paqes në Paris, shih: Margaret Makmillan, *Paris 1919: gjashtë muajt që ndryshuan Botën*, (Tiranë: Plejad, 2006).
[290] Po aty. Edhe pala shqiptare paraqiti të dhënat e saj mbi përbërjen kombëtare të vendit. Ato gjenden të përmbledhura në kujtimet e kryeministrit të kohës: Turhan Pashë Përmeti, *Shqipëria përballë Konferencës së Paqes Paris 1919*, (Tiranë: Eugen, 2007).
[291] Puto, *Shqipëria Politike*, 229.

që theksoi se shqiptarët kërkonin krijimin e një shteti mysliman nën urdhrat e Stambollit.[292]

Një lumë kërkesash për bashkimin e Korçës dhe Gjirokastrës me Shqipërinë apo Greqinë u ishin drejtuar Fuqive të Mëdha. Unioni Pan-Epirotik i Amerikës dërgoi një përkujtesë në mars 1919. Një përfaqësi ortodoksësh shqiptarë u përgjigj nëpërmjet *Vatrës* në maj. Ata kishin prejardhjen nga rrethet e Korçës dhe Kolonjës. Katër kryearadhët e parë të përkujtesës shqiptare rrëfenin mosndarjen fetare të kombit shqiptar. Nënshkruesit shprehnin keqardhjen që u nevojitej të flisnin ndarazi nga vëllezërit e tyre myslimanë, të cilët kishin të drejta të njëjta me ta për të paraqitur qëllimet kombëtare përpara Konferencës së Paqes. Korçarët e Amerikës sqaronin se qëndrimin tyre e qartësonin veçmas për të hequr çdo lloj dyshimi mbi vërtetësinë e ndjenjave të popullsisë së krishterë dhe numrin e ortodoksëve. Numri i pashoq prej dy mijë e pesëqind nënshkruesish kundërshtonte qëndrimin e Unionit Pan-Epirotik dhe të Greqisë në tërësi, se kinse, Shqipëria ishte "vend mysliman" dhe ortodoksët ishin grekë.[293]

Fundi zyrtar i Konferencës së Paqes në Paris u shënua më 16 janar 1920. Ajo u pasua nga ngrehina e parë ndërkombëtare paqsjellëse në botë. Lidhja e Kombeve u themelua nga Traktati i Versajës në qershor 1919 dhe mori fuqi ligjore në krye të vitit pasardhës. Anëtarët fillestarë ishin nënshkruesit e traktatit, çka nuk përfshinte Shqipërinë.[294]

Shqipëria kishte tashmë një qeveri qendrore dhe një rrymë të re politike me pikënisje Kongresin e Lushnjës. Qeveria e re ishte gati të siguronte anëtarësimin. Kërkesa zyrtare u dorëzua nga i dërguari i Shqipërisë në Konferencën e Paqes, Pandeli Evangjeli, më 12 tetor. Qeveria e Tiranës nisi një dërgatë në Gjenevë me Fan Nolin në krye. Ai ndodhej në Romë, pasi nuk ishte lejuar të hynte në Shqipëri. Drejtimi i një dërgate kishtare ishte e papranueshme për qeverinë, por jo edhe veprimtaria diplomatike. Përshtypja e krijuar nga Mihal Turtulli në Paris ndikoi në këtë vendim. Përçarja fetare, që Greqia orvatej të përfshinte në betejën diplomatike ndaj Shqipërisë, luftohej më së miri nga prania e shqiptarëve ortodoksë. Dërgata drejtohej nga një prift dhe përmbante tre të krishterë: Pandeli Cale, Hil Mosi dhe Gaqo Adhamidhi. Ajo mbërriti në Gjenevë më 12 nëntor, tri ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Lidhjes së Kombeve. Sekretariati i Përhershëm mori në dorëzim njëjtëshkresat e vendimeve të njohjes së pavarësisë nga Konferenca e Londrës, Statutit Organik të Shqipërisë dhe një përkujtesë të gjatë, që përmendte, krahas të tjerash, protokollet e Kapshticës me grekët dhe të Tiranës me italianët si dëshmi të njohjes *de facto* dhe *de jure* të pavarësisë shqiptare nga fqinjët. Shqipëria u pranua anëtare me të drejta të plota më 17 dhjetor 1920, me 35 vota pro, 7 abstenime dhe asnjë votë kundër. Arsyet e pranimit ishin disa, por ajo që veçonte ishte se Shqipëria nuk u shënjestrua si "Turqi e Vogël" apo "vend mysliman" me pakicat të krishtera të kërcënuara.[295] Kahkundërt, ajo u lëvdua si vend shumëfetar. Përfaqësuesi i Indisë Britanike pohoi se Asambleja do të shpallte qenien e një vendi ku kombësia ishte

[292] Po aty, 234-239.

[293] The Pan Albanian Federation of America Vatra, *Statement of the Christian Orthodox Albanians Natives of the Districts of Koritza and Kolonia in Reply To the Declaration of the Pan-Epirotic Union in America, of May, 1919,* (Boston: Vatra, 1919).

[294] Puto, *Shqipëria Politike*, 241.

[295] Prof. Arben Puto vlerëson se arsyeja kryesore që çoi në pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ishte se Britania e Madhe shfaqte lakminë për pasurinë nëntokësore të Shqipërisë. Puto, *Shqipëria Politike*, 288-289.

më e rëndësishme, sesa mosmarrëveshjet dhe grindjet fetare, duke kërkuar nga Asambleja të mbështeste fuqimisht shembullin e rrallë të bashkimit të Kryqit dhe Gjysmëhënës.[296]

Një prift ortodoks, gojëtar dhe plot gjallëri qëndronte përballë përfaqësive në Gjenevë. Noli priu betejën e kombit shqiptar për t'u njohur si i pandashëm. Veç kjo pamje mjaftonte për të hedhur poshtë pandehmat me natyrë përçarëse fetare, për të cilat Turhan Pasha u kryqëzua në Paris, apo Protokolli i Korfuzit u duk i arsyeshëm vetëm pak vite më parë. Kreu i dërgatës shqiptare rrëfeu në fjalimin e parë përpara Asamblesë mallëngjimin e tij kur pa fqinjët të votonin bujarisht për kërkesën shqiptare. Ai tha se pranimi i Shqipërisë e nderoi shumë Lidhjen.[297]

Shqipëria kishte hasur ankesa me natyrë fetare, ende pa u anëtarësuar në Lidhjen e Kombeve. E para nënshkruhej nga kryetari i Unionit Pan-Epirotik të SHBA-së, Joan Kasavetis, më 25 nëntor 1920. Ajo u qarkullua nga përfaqësuesi grek pak ditë pasi Shqipëria zuri vend mes të barabartësh në Asamblenë e Përgjithshme. Përkujtesa shënonte se vullneti i vërtetë i banorëve të "Epirit të Veriut" ishte bashkimi me Greqinë. Unioni shprehej i detyruar të paraqiste shkresën, pasi tërheqja zyrtare e shtetit grek nga mëtimet tokësore mbi Korçën dhe Gjirokastrën e detyronte atë të mos vepronte. Unioni shkruante se Konferenca e Paqes i kishte pranuar shpalljet se të krishterët, me përjashtime të pakta, dëshironin bashkimin me Greqinë dhe shumica e myslimanëve parapëlqente bashkimin me Shqipërinë myslimane, duke nënvizuar se edhe Senati Amerikan kishte njohur grekësinë e trevës. Sipas Kasavetisit, miqtë e Shqipërisë përpiqeshin të shmangnin dëshmimin e kombësisë sipas vullnetit të popullit, duke këmbëngulur te gjuha. Unioni parashtronte rastet botërore ku gjuha nuk ishte e ndërlidhur me kombësinë, si Belgjika dhe Franca me frëngjishten apo SHBA dhe Anglia me anglishten. Përkujtesa përfundonte se "vorioepirotët" nuk kërkonin asgjë më shumë, sesa zbatimi i njëjtë i kushteve.[298]

Arsyetimi u plotësua pas pak muajsh, me anë të një tjetër përkujtese. Unioni mohonte qenien e gjuhës shqipe. Përkujtesa shënonte se të krishterët flisnin *të folmen* shqipe, krahas greqishtes në shtëpi, por shkruanin e lexonin vetëm greqisht. Ndërkaq, fëmijët i dërgonin në shkolla greke, të krijuara dhe të mbajtura nga Bashkësitë e Krishtera Epirotike, pa asnjë ndihmë nga jashtë. Unioni shënonte se edhe myslimanët flisnin greqisht përveç *të folmes* shqipe. Përkujtesa përfundonte se "qeverisja myslimane" përndiqte "vorioepirotët", duke mbyllur shkollat dhe duke dëbuar priftërinjtë grekë.[299]

Themistokli Bamiha parashtroi të njëjtat mendime në fillimvitin 1921. Ai shprehej se Brigada Shqiptare Myslimane vijonin të lemerisin Rrethin e Krishterë të Delvinës.[300] Ndërkaq, disa ortodoksë shqiptarë nga Stambolli kërkuan ndarjen e Shqipërisë në kantone fetare. Nënshkrimet i kryesonte Mitropoliti i Gjirokastrës, Vasili.[301]

Pandehjet e Unionit morën përgjigje të tërthortë vetëm pak ditë më vonë, më 9 shkurt. Kryeministri Iljaz Vrioni paraqiti një përmbledhje të gjendjes së pakicave kombëtare dhe të feve në Shqipëri, pas kërkesës përkatëse nga Sekretari i Lidhjes së Kombeve, Drumond. Vrioni sqaronte ndarjen e Shqipërisë në katër bashkësi fetare. Ai

[296] Puto, *Shqipëria Politike*, 290.
[297] Po aty.
[298] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 1, Letra e Unionit Pan-Epirotik të Amerikës, 27 janar 1921.
[299] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 30, Letra e Unionit Pan-Epirotik të Amerikës, 19 prill 1921.
[300] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 6, Bamiha drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë.
[301] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 111, Vasili etj. drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë.

parashtroi se numri i gjithsecilës prej feve ishte i ndarë në mënyrë të atillë, sa asnjë nuk arrinte të bënte shumicën më vete. Kryeministri shpalli se liria e ndërgjegjes dhe besimit mbizotëronte dhe të gjithë qytetarët shqiptarë gëzonin lirisht të njëjtat të drejta politike dhe shoqërore, pavarësisht nga feja. Kreu i qeverisë trajtonte përbërjen e ngrehinave kryesore të shtetit. Këshilli i Lartë përbëhej nga një peshkop katolik, një ortodoks dhe dy myslimanë. Kuvendi i parë ishte gjysmë myslimanë dhe gjysmë i krishterë. Ushtria, xhandarmëria, policia, administrata dhe këshillat vendore ishin të formuara në të njëjtën trajtë, duke vërtetuar se nuk kishte qeverisje njëfetare.[302]

Përplasjet në Lidhjen e Kombeve ndiqnin rrjedhën e zhvillimeve të brendshme në Shqipëri. Çështja e zgjedhjeve në Korçë çeli siparin e kundërshtive të ashpra shqiptaro-greke. Zërat se Greqia po përgatitej të ndërhynte ushtarakisht iu përcollën menjëherë dërgatës shqiptare.[303] Fan Noli fajësoi zyrtarisht Greqinë më 1 mars për grumbullimin e trupave të rregullta dhe komitaxhinjve grekë në kufirin shqiptar. Përfaqësuesi grek, Vasilios Dendramis, përgënjeshtroi dhjetë ditë më vonë. Ai kundërsulmoi qeverinë shqiptare si të vrazhdë kundrejt Greqisë. Athina cilësonte zhvillimin e zgjedhjeve "thyerje e *status quo*-së", që ishte përcaktuar në Protokollin e Kapshticës. Dendramis përmendte burgosjen e grekëve që nuk pranuan të merrnin pjesë në zgjedhje, sulmin ndaj të drejtave kishtare në Korçë dhe Gjirokastër, trysninë ndaj qytetarëve për të kundërshtuar qëndrimet greke dhe përfoljen se Greqia kishte braktisur mëtimet në Korçë dhe "Epirin e Veriut".[304]

Unioni Pan-Epirotik i Amerikës e fuqizoi qëndrimin e Dendramisit pak kohë më vonë, me dy përkujtesa të 18 dhe 22 prillit. Unioni shfaqi përkujtesën e Korçës, si një vërtetim se Krishterët e Epirit të Veriut ishin kundër Shqipërisë. Kasavetis shkruante se ortodoksët e Korçës përbënin shumicën e popullsisë dhe pjesën intelektuale e tregtare të saj. Ai theksonte se ata kërkuan pavarësi të plotë nga Shqipëria, qeveria e së cilës qortohej se kërkonte krijimin e një Turqie të Vogël në anën tjetër të Ballkanit. Unioni e përdori rastin për të sulmuar shëmbëlltyrën e gjallë të shqiptarësisë ortodokse, Fan Nolin. Kasavetis theksonte se përkujtesa e të krishterëve të Korçës kundërshtonte pandehjet e Episkop Nolit se të Krishterët e Epirit të Veriut dëshironin bashkimin me Shqipërinë. Ai dilte në përfundimin se korçarët do të shprehnin dëshirën për t'u bashkuar me Greqinë, nëse do të flisnin lirisht. Unioni u rrek të lëshonte kushtrimin se qeveria shqiptare kishte urdhëruar vrasjen e kujtdo që nuk merrte pjesë në zgjedhje. Po ashtu, një ligj "i vjetër turk" ishte miratuar, që dënonte këdo të krishterë që vlerësohej i rrezikshëm nga qeveria.[305]

Kushtrimi ishte i rremë. Asnjë vendim apo ligj nuk ishte miratuar. Unioni nuk kishte lexuar saktë zhvillimet, as në çështjen e Përkujtesës së Korçës. Përkujtesëshkruesit ishin në masën dërrmuese atdhetarë shqiptarë. Ata kërkonin krijimin e një gjendjeje në dobi të Shqipërisë dhe jo anasjelltas. Ndaj, u kundërpërgjigjën menjëherë kur vërejtën pasojat e veprimit të tyre. Sotir Bimbli, Milto Gura, Koço Kota, Kol Rodhea, Llambro Mbroja dhe L. Mihalli, nismëtarët dhe nxitësit e përkujtesës i hodhën poshtë pandehjet greke. Ata theksonin se përkujtesa i "drejtohej qeverisë sonë kombëtare në Tiranë" dhe fajësonin Kasavetisin se dëshironte të shfaqte "në mënyrë djallëzore" që ata ishin

[302] AMPJ, V. 1921, D. 87, f. 12-14, Vrioni drejtuar Lidhjes së Kombeve, 9 shkurt 1921.
[303] AMPJ, S. M. T. drejtuar Imzot Nolit, cit.
[304] AMPJ, V. 1921, D. 41, f. 285-286, Dendramis drejtuar Lidhjes së Kombeve, 11 mars 1921.
[305] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 4, Letër e Unionit Pan-Epirotik të Amerikës, 19 maj 1921.

partizanë të bashkimit me Greqinë. Nismëtarët i sqaruan Lidhjes së Kombeve se përkujtesa kishte natyrë të brendshme, në përputhje me Kushtetutën shqiptare dhe në përpjekje për të shndërruar Shqipërinë Jugore në bashkëkohore. Prandaj, nismëtarët përgënjeshtronin prerazi "dredhitë djallëzore" të Kasavetisit.[306]

Të gjithë deputetët e sapozgjedhur ortodoksë kundërshtuan zyrtarisht pandehjet greke. Pandeli Evangjeli, Dhimitër Kacimbra, Agathokli Xhitomi, Koço Tasi, Leonidha Frashëri, Stavro Vinjau, Loni Kristo, Kristo Kirka dhe Pandeli Cale dërguan një ankesë të përbashkët. Ata flisnin në emër të popullsisë së krishterë të Korçës dhe Gjirokastrës dhe përgënjeshtronin me neveri të madhe shtrembërimet dhe shpifjet e Unionit, sipas të cilave qeveria ushtronte dhunë për të detyruar ortodoksët të merrnin pjesë në zgjedhje. Deputetët shpallnin se popullsia e krishterë shqiptare kishte votuar vetvetishëm dhe lirisht, e pandikuar nga fushatat dhe ndërhyrjet e huaja.[307]

Qeveria shqiptare i parashtroi Lidhjes rrjedhën e ngjarjeve nga veprimet e Patriarkanës para pavarësisë, në periudhën e Princ Vidit dhe Protokollit të Korfuzit e deri rishtazi. Kryeministri Vrioni shkruante më 21 qershor se përkujtesa ishte punë e disa stërfalëve: porse ata ishin atdhetarë të vërtetë, që kishin zhvilluar betejë të përkushtuar kundër pushtimit të përkohshëm të Korçës nga Greqia.[308]

Çështja e Kishës së Shën Gjergjit solli sulmet më të ashpra në Lidhjen e Kombeve. Ato tejkaluan shpeshherë kufijtë e gjuhës diplomatike, deri në fyerje kombëtare. Fushata nuk do të çelej nga qeveria greke. Këshilli Qeverisës i Lidhjes Vorioepirote të Athinës dhe Pireut u ankua për çështjen e Kishës së Shën Gjergjit më 10 maj. Lidhja i pagëzoi ushtarakët ortodoksë të drejtuar nga Spiro Kosova, si ushtarë myslimanë të shoqëruar nga disa stërfalë. Ajo shfaqte zemëratën për 12 viktimat dhe sigurinë se sulmet do të rinisnin. Në fund, i kërkonte Lidhjes së Kombeve të tregonte mëshirë për popullsinë e qytetëruar ortodokse dhe t'i jepte fund therorizimit të gjatë.[309]

Dërgata shqiptare përgënjeshtroi më 18 maj, nëpërmjet kryetarit Mit'hat Frashëri. Ai tha se nuk kishte asnjë viktimë dhe asnjë joortodoks nuk kishte marrë pjesë në ndodhitë e Korçës. Frashëri shënonte se qetësia më e përsosur mbretëronte në qytet. Ndryshimi i vetëm ishte se ortodoksët mbajtën shërbesat në shqip, përtej dëshirave të Mitropolitit grek. Shqipëria njoftoi se nuk po mblidhte trupa ushtarake në kufi. Nga ana tjetër, ajo kallëzoi Greqinë se kishte mbledhur ushtrinë afër Shqipërisë dhe se ata vrisnin dhe dhunonin qytetarë të pafajshëm në Çamëri. Qeveria shqiptare kërkonte paqe dhe nuk kishte plan për luftë, por ajo do të përgjigjej, nëse Greqia do të kryente hapin e parë.[310] Frashëri shtoi pas pak ditësh se nuk kishte as turbullim, as kundërshtim dhe as qëndresë e si pasojë asnjë viktimë.[311] Ndërkaq, edhe mërgata shqiptare u kundërpërgjigj.[312]

Greqia kishte dorëzuar ankesën në Sekretariatin e Lidhjes së Kombeve, dy ditë përpara se letra shqiptare të botohej. Greqia u orvat t'i jepte Shqipërisë ngjyrë fetare, duke përdorur çështjen e pakicave, të cilat Lidhja zotohej të mbronte. Ankesa e Dendramisit niste me një citim të mbledhjes së 15 dhjetorit 1920, kur u bisedua për anëtarësimin e Shqipërisë. Atëherë ishte përcaktuar se Shqipëria duhej të zbatonte me

[306] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 63, Bimbli etj., drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë.
[307] AMPJ, V. 1921, D. 88, F. 27, Evangjeli etj. Drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë.
[308] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 16, Letër e Kryetarit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, 4 korrik 1921.
[309] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 3, Lidhja Vorioepirote e Athinës dhe Pireut drejtuar Lidhjes së Kombeve.
[310] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 39, Letër e dërgatës shqiptare, 23 maj 1921.
[311] AMPJ, V. 1921D. 88, f. 17, Frashëri drejtuar Lidhjes së Kombeve.
[312] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 12, Kolonia Shqiptare në Bukuresht drejtuar Lidhjes së Kombeve.

përpikmëri përcaktimet e Traktatit të Pakicave. Ky detyrim ishte për të gjitha shtetet e tjera të anëtarësuara rishtazi. Dendramis vendoste në pikëpyetje nëse Shqipëria duhej të zbatonte vetëm pjesët e përgjithshme të traktatit. Ai kërkonte më shumë, duke e arsyetuar në kornizën e mileteve: përfaqësuesi grek shkruante se natyra myslimane e shtetit shqiptar ishte e qartë te çdokush që kishte vizituar vendin dhe rrëfehej nga përbërja e Këshillit të Mëkëmbësisë, ku myslimanët kishin dy përfaqësues, po aq sa katolikët dhe ortodoksët së bashku, sikurse i ndarë përgjysmë ishte edhe Kuvendi. Dendramis e themelonte vërejtjen me letrën e Kryeministrit Vrioni, që thoshte se Shqipëria ishte e ndarë në tri pjesë: katolikë, ortodoksë dhe myslimanët, asnjë prej të cilëve nuk përbënte shumicë.[313] Arsyetimi nisej prej fjalëpërzgjedhjes së Kryeministrit shqiptar se myslimanët ishin të ndarë në dy sekte; porse të krishterët në dy fe. Dendramis përzgjodhi të merrte vetëm *fetë* në kuptimin e ngushtë, ndonëse Vrioni kishte sqaruar se të katërta ishin bashkësi. Përfaqësuesin *mysliman suni* dhe atë *bektashi* i quajti "myslimanë", duke i barazuar me të krishterët në Këshillin e Mëkëmbësisë. E njëjta edhe për kuvendin.

Dendramis kërkoi që në rastin shqiptar të kishte "kërkesa të veçanta". Ai e quajti "qeveria e turko-shqiptarëve", duke tejkaluar kufijtë e gjuhës së pranueshme diplomatike. Sipas tij, kjo qeveri kishte një urrejtje të pandryshueshme përndjekëse ndaj të krishterëve. Prandaj, kujdesi më themelor do të udhëzonte që përcaktimet mbi pakicat të fuqizoheshin. Së pari, ai kërkoi që Kushtetuta të përcaktonte përfaqësimin e përpjesëtueshëm të pakicave në Kuvend, qeverisje dhe shërbimin civil, si dhe grumbullimi i ortodoksëve në ndarje tokësore të njëtrajtshme. Së dyti, ata që dëshironin duhet të lejoheshin të ktheheshin në Krishtërim pa dënime ose përndjekje. Kërkesa e tretë dhe e katërt ishte njohja e veçanësisë ligjore të bashkësive fetare, kishave, shkollave, marrja e masave për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faltoreve, ndërtesave arsimore dhe të bamirësisë. Pika e pestë kërkonte krijimin e organizatave dhe shkollave në gjuhën e pakicave fetare, etnike dhe gjuhësore, pa ndërhyrje shtetërore. Dendramis kërkoi ripohimin nga qeveria shqiptare të të drejtave që Sulltani u njihte nënshtetasve jomyslimanë të Turqisë. Së fundmi, çdo shtet duhet të kishte të drejtë të këqyrte zbatimin e pikave dhe të lajmëronte Lidhjen e Kombeve për shkelje të tyre.[314]

Përcaktimet mbi shkollat dhe bashkësitë fetare i ngjasonin së tepërmi Protokollit të Korfuzit. Çështja e Shën Gjergjit kishte bërë Greqinë të shihte se nuk i mbetej rrugë tjetër veçse të krijonte përçarje mbi baza fetare. Përndryshe, mundësia e ndërhyrjes do të ishte e papërfillshme në të ardhmen.[315]

Qeveria shqiptare u kundërpërgjigj më 21 qershor. Kryeministri Vrioni theksonte se nuk kishte përndjekje të ortodoksëve dhe as të pakicës greke. Ai kundërshtoi parakushtin prej nga nisej Dendramis, që myslimanët kishin më shumë përfaqësim sesa ortodoksët dhe katolikët. Vrioni sqaroi se të krishterët dhe myslimanët ishin të ndarë në dy trajta, ndaj arsyetimi i Dendramisit kundërshtohej nga matematika e thjeshtë. Kryeministri tëhuajti përdorimin e termit "turko-shqiptar". Ai citoi fjalorin se turk ishte një popullsi "turaniane", ndërsa shqiptar, një popullsi "ariane" ose "indoevropiane". Vrioni pohoi se shteti shqiptar nuk kishte fe zyrtare, as të pushtuar e as pushtues si në Turqi. Ndryshe ndodhte në Greqi. Ai fajësoi Dendramisin për tejkalim pesëqindvjeçar,

[313] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 5, Letër e dërgatës greke, 21 maj 1921.
[314] Po aty.
[315] Ledia Dushku, "Debatet shqiptaro-greke dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922)", *Studime Historike* 3-4 (2006), 79.

duke arsyetuar se ndërrimi në masë i fesë kishte ndodhur si pasojë e pushtimit. Vrioni shënonte se Dendramisi ngatërronte armikun e urryer me pjesën e përndjekur. Kryeministri shqiptar kundërsulmoi se grekët ishin ortodoksë stërfalë dhe trajtonin pjesët joortodokse bazuar në mendësinë e tyre. Mirëpo, fushatat e dhunshme të zhvilluara nga priftërinjtë grekë në Shqipërinë e Jugut gjatë sundimit turk kishin dështuar të përçanin myslimanët dhe ortodoksët shqiptarë. Vrioni theksonte se anëtarët e dy feve ishin vëllezër të një gjuhe dhe të bashkuar përjetë nga dashuria për atdheun.[316]

Ai paraqiti përfaqësimin e ortodoksëve në Kuvend. Korça e 82 mijë myslimanëve dhe 40 mijë ortodoksëve kishte pesë deputetë myslimanë dhe pesë ortodoksë. Berati zgjodhi tre deputetë, pavarësisht pse kishte 27 mijë ortodoksë, që do të përkthehej në dy ndenjëse në Kuvend. Po ashtu, ortodoksët ishin të paktë në Vlorë, por zgjodhën një deputet. Shtatë mijë ortodoksët e Elbasanit dhe Drini pa asnjë të krishterë zgjodhën nga dy deputetë ortodoksë. Kryeministri njoftoi Lidhjen e Kombeve se shumica e kërkesave të Dendramisit ishin në zbatim vetvetiu, pikërisht pse as shteti, as kombi shqiptar nuk kishin natyrë fetare. Përfaqësimi në qeverisje, mosdënimi i ndërrimit të fesë dhe të drejtat e pakicës greke, që nuk përbënte më shumë se 16 mijë, ishin të siguruara. Vrioni përfundonte se Shqipëria do të ndiqte parim të njëjtë me vendet e tjera të Ballkanit se çdo shtet i pavarur kishte të drejtën e një kishe autoqefale.[317]

Përplasja kulmoi me vendosjen e Jakovit nën vërejtje policore në Korçë. Dendramisi fajësoi qeverinë shqiptare më 1 shtator se po myslimanizonte "Epirin e Veriut" dhe po nxiste mërgimin e pakicës greke.[318] Noli sugjeroi dërgimin e përkujtesave nga priftërinjtë katolikë dhe ortodoksë, si lëvizja më e zgjuar për të mbrojtur pikëpamjen shqiptare.[319] Njëherazi, njoftoi se shtypi francez lajmëronte ndarjen e Kishës Shqiptare nga Patriarkana e Kostandinopojës.[320] Qeveria i përgënjeshtroi lajmet për autoqefalinë e Kishës, si të pathemelta.[321] Ndryshimi i vetëm ishte se çelësat e Kishës së Shën Gjergjit u ishin dorëzuar "partizanëve të kishës kombëtare". Dërgata lajmërohej për dëbimin e Atë Petros dhe Dr. Noçkës për sjellje të dyshimtë.[322]

Arkimandrit Visar Xhuvani dërgoi një telegram drejtuar Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve, duke ndjekur udhëzimin e Nolit. Ai foli në emër të të gjithë priftërinjve dhe popullsisë ortodokse shqiptare. Xhuvani i parashtroi Lidhjes vëllazërinë e ortodoksëve me bashkëkombësit katolikë e myslimanë për mbrojtjen e Atdheut kundër kahjeve që dëmtonin pavarësinë dhe tërësinë e vendit. Në fund, ai nënshkruante si "shef i fesë ortodokse në Shqipëri". Vasili i Drinupojës u kundërpërgjigj. Ai shkruante se priftëria ortodokse shqiptare nuk ishte e qenë dhe priftërinjtë në Shqipëri e sidomos në "Epirin e Veriut" ishin ende grekë. Ai theksonte se Xhuvani fliste në emër vetjak, pasi përfaqësuesit e vërtetë të ortodoksëve ishin ende katër episkopët, prej të cilëve vetëm Jakovi gjendej në Shqipëri. Vasili quante Visarin mosmirënjohës ndaj Kishës Mëmë, duke e braktisur për kishën përçarëse të Bullgarisë e më pas duke shkuar në Shqipëri ku një "qeveri myslimane" shtrëngoi grigjën ortodokse ta pranonte.[323]

---

[316] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 20, Vrioni drejtuar Lidhjes së Kombeve, 21 qershor 1921.
[317] Po aty.
[318] Dushku, "Debatet shqiptaro-greke", 79.
[319] AMPJ, V. 1921, D. 159, f. 27, Noli drejtuar MPJ, 3 shtator 1921.
[320] AMPJ, V. 1921, D. 171, f. 6, Noli drejtuar MPJ, 5 shtator 1921.
[321] AMPJ, V. 1921, D. 159, f. 28, MPJ drejtuar Dërgatës shqiptare, 7 shtator 1921.
[322] AMPJ, V. 1921, D. 159, f. 29, MPJ drejtuar Dërgatës shqiptare, 9 shtator 1921.
[323] AMPJ, V. 1921, D. 171, f. 8, Xhuvani drejtuar Dërgatës shqiptare, 8 shtator 1921.

Qeveria shqiptare e hodhi poshtë padinë e Vasilit. Ministri Pandeli Evangjeli njoftoi se Arkimandrit Visari ishte ngarkuar të fliste nga priftërinjtë ortodoksë. Njëkohësisht, qeveria po shihte mundësinë e zhvendosjes të Jakovit në Durrës, për ta shmangur nga Korça.[324] Dërgata u njëmendësua me mendimin qeveritar. Çdo veprim u la pas nënshkrimit të Traktatit të Pakicave, ndërkaq nuk u përjashtua dëbimi përfundimtar.[325]

Dendramisi fajësoi qeverinë shqiptare se kishte urdhëruar mbylljen e shkollave dhe dëbimin e familjeve të të krishterëve korçarë, që jetonin jashtë Shqipërisë.[326] Dy ministrat e qeverisë "vorioepirote", Mitropolit Vasili dhe Dhimitër Dhuli, u shfaqën më 4 tetor si "fuqiplotë të popullsisë greke të Epirit të Veriut" për të rrëfyer padrejtësinë e mbetjes nën sundimin shqiptar.[327] Një përfaqësi e Komitetit të Bashkuar të Shqiptarëve Irredentë kundërvuri para Lidhjes gjendjen kombëtare në Çamëri, duke kërkuar bashkimin e trevave me shumicë shqiptare me vendin amë.[328]

Shpallja për Mbrojtjen e Pakicave ishte një detyrim shtesë ndaj vendeve jonismëtare të Lidhjes së Kombeve. Disa prej tyre u detyruan të nënshkruanin marrëveshje dypalëshe për pakicat. Një pjesë e vogël u lejuan të nënshkruanin një shpallje të njëanshme, me anë të së cilës merrnin përsipër detyrime të caktuara. Shqipëria u përfshi në bashkësinë e dytë. Shpallja u dorëzua në emër të Shqipërisë nga Fan Noli më 21 tetor 1921. Ajo përmbante 7 pika. Shpallja siguronte mbivlefshmërinë e saj ndaj ligjit të brendshëm shqiptar. Pika dy përcaktonte mbrojtjen e plotë të lirisë dhe jetës ndaj të gjithë banorëve të Shqipërisë, pa dallim lindjeje, kombësie, gjuhe, race ose feje. Gjithashtu, caktonte se çdo banor kishte të drejtë të ushtronte lirisht, veçmas ose botërisht, si edhe ta ndryshonte fenë dhe besimin e tij. Pika e tretë siguronte të drejtën e shtetësisë ndaj kujtdo që kishte lindur ose jetonte në Shqipëri përpara Luftës. Po ashtu, parashihte mundësinë që Lidhja e Kombeve të këshillonte mërgimin e dyanshëm vullnetar të pakicave kombëtare.[329]

Shqipëria merrte përsipër barazinë e të gjithë banorëve përpara ligjit me anë të pikës 4. Zgjedhjet do të zhvilloheshin duke pasur parasysh pakicat racore, fetare dhe gjuhësore. Dallimet fetare nuk mund të pengonin askënd të punësohej në zyrat shtetërore. Shpallja përcaktonte se nuk do të kishte ndalesa për përdorimin e lirë të secilës gjuhë në bashkëbisedimin vetjak, tregti, fe, shtyp ose në mbledhje botore. Shtetasit shqiptarë që u përkisnin pakicave racore, fetare ose gjuhësore kishin të drejtë të krijonin dhe mbanin ngrehina bamirëse, fetare, shoqërore, shkollore etj. dhe kishin të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe ushtrimin e fesë, sipas pikës 5. Pika 6 caktonte se shkollat fillore të pakicës do të zhvillonin mësimin në gjuhën amtare, krahas asaj shqipe. Pakicat fetare, gjuhësore dhe racore do të kishin një përfaqësim të barasvlershëm në punësim dhe në shpërndarjen e buxhetit. Pika e shtatë dhe e fundit i njihte të drejtën çdo shteti anëtar të njoftonte Lidhjen mbi shkeljen e përcaktimeve të shpalljes.[330]

---

[324] AMPJ, V. 1921, D. 171, f. 9, Evangjeli drejtuar Dërgatës shqiptare, 25 shtator 1921.
[325] AMPJ, V. 1921, D. 159, f. 34, Frashëri drejtuar Lidhjes së Kombeve, 26 shtator 1921.
[326] AMPJ, V. 1921, D. 42, f. 94, Dendramis drejtuar Lidhjes së Kombeve, 27 shtator 1921.
[327] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 98-101, Vasili, Duli drejtuar Lidhjes së Kombeve, 4 tetor 1921.
[328] AMPJ, V. 1921, D. 88, f. 162-165, Komiteti i Bashkuar i Shqiptarëve Irredentë drejtuar LK.
[329] Fan Noli. "Declaration concerning the Protection of Minorities in Albania [Shpallje mbi Mbrojtjen e Pakicave në Shqipëri]", *League of Nations Treaty Series 51* (Gjenevë: Lidhja e Kombeve, 1922).
[330] Po aty.

Kërkesat e Dendramisit nuk u përfshinë në shumicën e pikave, por dy parime të rëndësishme u pranuan. Shteti shqiptar njihte "pakicat fetare", ndonëse asnjë bashkësi nuk kishte shumicën, siç shprehej Vrioni vetëm pak javë më parë. Shpallja u njihte pakicave të drejtën e përzgjedhjes së cilësdo gjuhë që dëshironin në çdo fushë, përfshi edhe në meshim. Së fundmi, ajo i njihte Greqisë të drejtën të njoftonte Lidhjen mbi shkelje të përcaktimeve, sikurse Dendramisi kishte kërkuar. Shpallja e Mbrojtjes së Pakicave do të përbënte pikënisjen e përplasjes së ardhshme diplomatike shqiptaro-greke mbi çështjen kishtare. Greqia do të këmbëngulte se Shqipëria kishte pranuar që çdo bashkësi ortodokse, qoftë edhe shqiptare, që dëshironte të meshonte dhe krijonte shkolla në greqisht kishte të drejta të siguruara. Trajtimi i bashkësive fetare nën përcaktimin e "pakicave", të cilat mbronte Shpallja u krye fillimisht edhe nga shteti shqiptar. Qeveria propozoi vendosjen e përpjesëtimeve fetare në zgjedhjen e deputetëve në vitin 1923. Ministri Milto Tutulani theksoi se propozimi ishte bërë pikërisht prej përcaktimeve të Shpalljes për Mbrojtjen e Pakicave. Deputetët kundërshtuan ashpërsisht. Qazim Koculi e quajti Shpalljen "një gabim trashanik" dhe kërkoi që ajo të mos zbatohej. Ky përcaktim u pranua fillimisht, por përpjesëtimi fetar dhe përfshirja e bashkësive fetare nën mbrojtjen e "Shpalljes" u zhbënë shumë shpejt.[331]

Sidoqoftë, Shpallja ishte një parakusht për vendimin më të rëndësishëm që u mor më 9 nëntor 1921: njohja e Protokollit të Firences nga Konferencës e Ambasadorëve. Kufijtë e Shqipërisë tashmë ishin përcaktuar. Një dërgatë e posaçme do të shqyrtonte një numër shumë të vogël (26) fshatrash ende të pandara. Asnjë ndryshim thelbësor nuk mund të bëhej.[332] Greqia ishte e pafuqishme përballë këtij vendimi. Ajo u përpoq të ringjallte Protokollin e Korfuzit, duke kujtuar miratimin zyrtar prej qeverisë së Vidit. Pala shqiptare çmonte se Protokolli ishte nënshkruar me "lakun në fyt" dhe rigjallërimi i tij do të minonte pavarësinë e ripohuar të shtetit shqiptar. Ndaj, Konferenca e shfuqizoi zyrtarisht Protokollin në fundvitin 1921.[333]

Sigurimi përfundimtar i kufijve solli dëbimin e Jakovit më 19 nëntor. Greqia dënoi futjen e shqipes në shkolla dhe dëbimin e Mitropolitit më 25 dhe 28 nëntor 1921.[334] Jakovi quhej "drejtuesi shpirtëror i grekëve të Korçës".[335] Kryeministri Xhaferr Ypi u përgjigj se episkopi grek dredhonte në kurriz të shtetit dhe kombit shqiptar. Ndaj, të krishterët kishin zgjedhur lirisht pleqësitë kishtare të bashkësisë ortodokse në Korçë. Ypi sqaronte se shkolla greke u mbyll me vendim të pleqësisë, për shkak të vështirësive ekonomike, ndaj të cilave qeveria nuk mund të ndërhynte. Kryeministri përfundonte se Jakovi kishte kaluar në bankat greke 2 milionë franga ari pasuri të Mitropolisë së Korçës, përpara se të ikte. Banka e Athinës nuk pranoi t'i kthente të hollat.[336]

I dërguari shqiptar pranë Sekretariatit, Benedikt Blinishti, arsyetoi dëbimin më 6 dhjetor. Ai shkruante se Episkop Jakovi ishte grek ortodoks nga Azia e Vogël dhe la qarkun kishtar të Durrësit me vetëdashje, pa marrë asnjë emërim tjetër. Ai kishte shkuar në Korçë ku dredhoi kundër sigurisë dhe tërësisë së shtetit shqiptar. Sipas Blinishtit, kjo bëri që populli ta shihte si ngatërrestar dhe të mos e duronte dot. Qeveria u detyrua të

[331] Meta, "Autoqefalia e Kishës Ortodokse në procesin…", 84-85.
[332] Puto, *Shqipëria Politike*, 298-302.
[333] Debati mbi shfuqizimin e Protokollit të Korfuzit është përmbledhur në AMPJ, Dosja 86, Viti 1922.
[334] Dushku, "Debatet shqiptaro-greke", 79.
[335] AMPJ, V. 1921, D. 159, f. 3-4, Dendramis drejtuar Lidhjes së Kombeve, 25 nëntor 1921.
[336] AMPJ, V. 1921, D. 87, f. 88, Ypi drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë.

merrte masa për ta larguar, duke e shpëtuar nga dhuna. Rrjedhimisht, bashkësia ortodokse mori drejtimin e plotë të fateve të saj.[337] Ndërsa, Kryeministri Hasan Prishtina siguroi liri të plotë feje dhe besimi, pa ndërhyrje shtetërore.[338]

[337] AMPJ, V. 1921, D. 87, f. 104, Blinishti drejtuar Lidhjes së Kombeve, 6 dhjetor 1921.
[338] AMPJ, V. 1921, D. 159, f. 16, Prishtina drejtuar Lidhjes së Kombeve, 12 dhjetor 1921.

KREU II:
SHPALLJA E AUTOQEFALISË DHE ZHVILLIMET, 1921-1924

2.1. Përgatitjet për shpalljen e autoqefalisë

Drejtuesit e lëvizjes kishtare shquheshin në jetën shoqërore. Kreu i Mitropolisë së Durrësit, Arkimandrit Visari, u ul në radhët e Kuvendit të parë Kombëtar. Episkopi i zgjedhur Theofan Noli do ta shoqëronte një vit më vonë, si deputet i "Vatrës".[339]

Arkimandrit Visari thirrej Hirësia e Tij nga ortodoksët që kishte nën drejtim, një thirrje që përdoret për episkopët. Ai hodhi gurin e themelit të autoqefalisë së Kishës Shqiptare, në Tiranë, më 28 nëntor.[340] Mesha e zhvilluar me rastin e përvjetorit të pavarësisë mblodhi zyrtarët më të lartë të vendit. Kisha e Tiranës u përmbush me besimtarë, krahas anëtarit të Këshillit të Lartë, Abdi bej Toptanit, Këshillit të Ministrave dhe drejtues ushtarakë e civilë. Në fund, Arkimandrit Visari shpalli krijimin e Kishës Vetëqeverimtare Orthodhokse Kombëtare.[341]

Vendimi ishte përpiluar gjatë një mbledhjeje me priftërinjtë dhe anëtarët e pleqësisë Kishtare të kryeqytetit, nën drejtimin e Arkimandritit. Ai niste me një parathënie, ku theksohej nevoja e bashkimit dhe përparimit të ortodoksëve, fuqizimit dhe përkrahjes së shtetit e kombit shqiptar dhe ruajtjes së rregullave të ortodoksisë. Shpallja vijonte me arsyetimin e autoqefalisë sipas së drejtës kishtare. Tri parimet përligjëse ishin: "Një kishë e një shteti tjetër të mos japi urdhër një kishe të shtetit tjetër", "Një kishë e lirë me një shtet të lirë" dhe "ndryshimet politike të pasohen nga ndryshimet Kishtare."[342]

Vendimi ndahej në tetë pika. Së pari, shpallej vetëqeverimi, pra Autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shtetit Shqiptar. Pika e dytë kërkonte një mbledhje sa më të shpejtë mbarortodokse në qytetin që do të caktonte Ministria e Brendshme. Pikat tre, katër dhe pesë trajtonin planveprimin e mbledhjes. Priftërinjtë dhe pleqësitë e prefekturave dhe nënprefekturave do të dërgonin një deri në tre përfaqësues fuqiplotë. Ata do të ngarkoheshin të merrnin vendime përfundimtare të detyrueshme. Gjithsesi, vendimi kryesor ishte paracaktuar: Kongresi do të krijonte një këshillë që do të drejtonte përkohësisht Kishën dhe do të mbante bashkim të plotë dogmatik me të gjitha simotrat. Pikat gjashtë dhe shtatë parashihnin detyrat e ngrehinës së re kishtare. Kryekëshilla e Lartë e Përgjithshme Orthodhokse dhe Kombëtare do të zgjidhte çështjet me patriarkanat e tjera, duke ruajtur ortodoksinë. Të gjithë priftërinjtë në Shqipëri do të luteshin për "Çdo Episkop Orthodhoks", në vend të Jakovit, deri sa të zgjidhej një Kryepiskop i rregullt. Pika e fundit ngarkonte Arkimandrit Visarin me zbatimin e vendimit, duke kërkuar mbështetje qeveritare dhe bindje të priftërinjve dhe pleqësive. Vendimi nënshkruhej nga zëvendësmitropoliti Stefan Tirana (Mima) dhe parësia kishtare.[343] Vendimi u mbështet

[339] Për deputetët dhe senatorët shqiptarë, përveç Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar;* dhe *Akademia, Historia e Shqipërisë III;* ku listohen në tabela, një vepër më e thukët është ajo e Diana Estrefi. *Ligjvënësit shqiptarë 1920-2005*, (Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë, 2005).
[340] Xhuvani, *Kujtim Vepre dhe Intrige*, 26.
[341] AQSH, F. 152 "MPB", pa vit, D. 839, f. 1, Telegram Qarkore e Drejtorisë së Shtypit, 29 nëntor 1921.
[342] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 27-29.
[343] Pleqësia përbëhej nga Kozma Lasku, Stefan Koja, Spiro Zhava, Spiro Janko, Leonidha Nishku, Pavllo Koja dhe Stefan Buçani. Arkimandriti dr. Visar Xhuvani, Papa Jorgji Rusi dhe Papa Simon Athanasi nënshkruan në emër të meshtarëve.

nga mbarë besimtarët që merrnin pjesë në meshë. Qeveria rendi ta botojë shpalljen e autoqefalisë që të nesërmen, me anë të një qarkoreje të shpërndarë nga drejtori i Shtypit, Vasil Kalluci.[344]

Episkopi i zgjedhur Theofan Noli nuk ishte i pranishëm në Kishën e Tiranës. Ai po festonte nëntëvjetorin e pavarësisë në Vlorë. Shpallja e autoqefalisë shënjonte mënjanimin e Nolit. Qeveria ishte bindur se zgjidhja në shkelje të rregullave kishtare, e përfaqësuar nga vatranët, përbënte kërcënim. Gjithsesi, Arkimandrit Theofani nuk ishte i gatshëm të hiqte dorë nga beteja e nisur prej vitesh në SHBA. Zhvillimet e ndihmonin. Atë Vangjel Çamçe dhe Atë Vasil Marko kishin arritur të merrnin kryesinë e Pleqësisë Kishtare të Korçës. Vatrani Koço Grameno ishte zgjedhur kryetari i ri i Bashkisë. Ndaj, rrethanat ishin përgatitur më së miri për të plotësuar qëllimin e ardhjes në Shqipëri. Theofan Noli udhëtoi nga rruga e Jugut për të shkuar në Korçë.[345]

Ai mbërriti më 9 dhjetor në qytetin e zbukuruar me flamuj kombëtarë. Shpallje që thërrisnin popullin gjendeshin kudo, ndërsa tregu ishte mbyllur që në orën 12. Trupa muzikore "Vatra" drejtonte përfaqësinë, të përbërë nga Pleqësia Kishtare, të gjithë priftërinjtë, Këshilli Bashkiak dhe kleri mysliman. Shoqëritë "Përlindja", "Çvillimi" dhe "Vatra", shkollat e qytetit, zyrtarët dhe thuajse mbarë populli ishin rreshtuar me kujdes në dalje të rrugës.[346] Radha e makinave arriti në orën 2. Noli zbriti i pari, i shoqëruar nga deputetët Leonidha Frashëri dhe Agathokli Xhitoni.[347] Populli e brohoriti, ndërsa Koço Grameno dhe priftërinjtë rendën ta përshëndesnin. Atë Vangjel Çamçe mbajti fjalën e parë. Ai përmendi arritjet e pamatshme të Theofanit në lëvizjen kishtare, në krye të "Vatrës" dhe në Lidhjen e Kombeve. Çamçe tha se priftërinjtë dhe populli ortodoks prisnin me padurim hedhjen e themeleve kombëtare të Kishës. Theofani uroi grigjën dhe shpalli se do të vijonte rrugën për fuqizimin e Kishës së Krishtit me prindërit e djemve korçarë, me të cilët kishte themeluar Kishën Ortodokse Shqiptare në SHBA. Noli vajtoi për humbjen e heroit Themistokli Gërmenji dhe thirri "Rroftë Korça!" Një nxënëse i dhuroi buqetë me lule, teksa trupa muzikore printe besimtarët përgjatë rrugës së Postës dhe shëtitores "Shën Gjergji", me vendmbërritje Mitropolinë. Noli bëri thirrje nga ballkoni që populli të bashkohej e të harronte të kaluarat. Vatranët e pritën me ngazëllim. Mihal Grameno shkruante në "Koha":

> "Kurrë edhe kurrë të kurrës do të mos haronet dita e 9 dhjetorit 1921. Që kur se është themeluarë qyteti, Korça ka patur raste të kremtonjë edhe festonjë po kurrë të kurrës nuku munt që të kapërxenjë ditën të 9 Dhjetorit! Ishte, është dhe ka për të mbetur e pa haruarë këjo ditë, në histori të Shqipërisë! Në këtë ditë shkeli për të parën herë në tokë të plakës Korçë Shënjtëria e Tij Pishkopi Theofan, themelonjësi i kishës Orthodhokse Autoqefale Shqipe, Pishkopi i Bostonit, Dhespot i Krujës edhe Eksarku i gjithë Ilirisë".[348]

Theofani drejtoi të nesërmen mbledhjen e Pleqësisë Kishtare. Ajo vendosi ndryshimin e emrit nga "Bashkësia Orthodhokse Greke e Korçës", në "Bashkësia

[344] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 27-29.
[345] Pleqësia Kishtare ngriti menjëherë një përfaqësi të përbërë nga Rodhe, Nasi Aristidhi, Nuçi Mbroja, Milto Gurra, Mina Grameno, Theodhoraq Mano dhe Mihal Bellkameni. Llambi Bimbli u dërgua deri në Vlorë për ta shoqëruar gjatë gjithë rrugës. *Posta e Korçës* nr. 72, 3 dhjetor 1921, 2.
[346] "Episkop Theofani në Korçë" *Posta e Korçës*, 10 dhjetor 1921, nr. 73, 1.
[347] *Koha*, pa datë, pa nr. 2.
[348] "Mihal Grameno"Ardhja edhe pritja e Shen. Tij Pishkopit Theofan në Korçë", *Koha*, pa datë, 1.

Orthodhokse Shqiptare e Korçës". Pleqësia vendosi që çdo shkresë, përfshi edhe pajëmarrëveshjet dhe paditë, të ishte në shqip. Përndryshe, nuk do të merreshin parasysh.[349]

Milto Gurra sqaronte të mirat e vendimeve, nëpërmjet "Kohës". Ai shkruante se fjala e Zotit e bashkuar me atdhetarinë shqiptare do të trumbetonte nga froni kryepriftëror, ku deri atëherë mbaheshin predikimet fetare të përziera me qëllimet kombëtare greke. Gurra shtonte se Kisha Kombëtare shkonte bashkërisht me shtetin, si bashkëpunëtor dhe vetëm ajo do të thyente kalanë e grekomanisë, duke nxjerrë helmin me të cilin mitropolitët grekë kishin vaditur popullin. Ai theksonte rëndësinë e drejtimit të lëvizjes nga Theofan Noli, ngadhënjimtari i anëtarësimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve.[350]

Qëndrimi në Korçë e bindi Episkopin e zgjedhur se duhet të ndërmerrte veprimin përfundimtar: të meshonte si kryeprift, në kundërshti me zotimet e marra para qeverisë. Noli meshoi në mitropoli përpara mijëra besimtarëve, më 21 dhjetor. Ai mori urime nga mbështetësit anembanë Shqipërisë, të cilët kërkuan të kryente shërbesa edhe në qytetet e tyre. Mirëpo, veprimi vendoste në rrezik përpjekjen për autoqefali, që atdhetarë dhe qeveria e kishte nisur në Tiranë, më 28 nëntor. Veprimtaria e Nolit mund të sillte përçarje. Shumica e priftërinjve kishin pranuar drejtimin kryepriftëror, por dy meshtarë nuk pranuan të merrnin pjesë në meshën që drejtoi si Episkop dhe jo si Arkimandrit.[351]

Deputetët ortodoksë Agathokli Xhitoni, Koço Tasi dhe Sotir Peci kundërshtuan ashpër më 22 dhjetor 1921. Ata tëhuajtën veprat e Nolit kundër ngrehinave fetare të krishtera. Xhitoni e kishte shoqëruar në Korçë, me qëllim drejtimin e lëvizjes kishtare në prapaskenë dhe jo të meshonte si episkop. Deputetët cilësonin veprimet e Nolit fepërdhosje në pikëpamjen fetare, tradhti të pandërgjegjshme në pikëpamjen politike dhe shkelje të lirisë fetare në pikëpamjen ligjore. Ata paralajmëruan se do të shtronin pyetje të ashpra në kuvend. Sotir Peci kishte qenë ndër nxitësit dhe mbështetësit e parë të Nolit për t'u bërë prift e në një të ardhme episkop. Ai ishte i nxehur më shumë se kurrë. Peci arsyetonte pakënaqësinë dhe shqetësimin që e kishte kapluar në një letër të atyre ditëve. Ai habitej se si nënshkruesi i Shpalljes së Mbrojtjes së Pakicave e shkelte vetë, duke u shfaqur si kryefetar, kur nuk ishte episkop, nuk njihej nga askush e nuk kishte lidhje fetare me kurrkënd. Ai gjykonte se rruga që duhej ndjekur ishte tjetër. Noli duhet të priste të merrej vesh me deputetët ortodoksë, si përfaqësues ligjorë të bashkësisë, të bëhej kongresi, të nisej një dërgatë në Stamboll dhe të thirreshin dy kryepriftërinj shqiptarë. Këta të fundit do ta dorëzonin rregullisht, duke i çelur rrugën për fronin e Kryepiskopit. [352]

Ndërkaq, zhvillimet ishin të vrullshme në Tiranë. Muaji dhjetor kishte parë pesë qeveri. Noli kishte edhe cilësinë e ministrit të Punëve të Jashtme, ditën që kishte arritur në Korçë. Ai do ta mbante detyrën nga data 6 deri më 12 dhjetor, në dy qeveri të ndryshme. Noli ishte emëruar ministër pas rënies së qeverisë së Pandeli Evangjelit, në qeveritë njëditore të Qazim Koculit dhe pesëditore të Hasan Prishtinës. Turbullira solli një qeveri kalimtare nën drejtimin e Idhomeno Kosturit. Përfundimisht, vendi gjeti qëndrueshmërinë nën udhëheqjen e Xhaferr Ypit. Ministër i Brendshëm ishte emëruar miku dhe bashkëpunëtori i Theofanit, Ahmet Zogu.

---

[349] "Buletin Zyrtar nga e Sh. Mitropoli e Korçës", *Posta e Korçës* nr. 74, 13 dhjetor 1921, 2.
[350] Milto Gurra. "Kisha Autoqefale dhe Shteti Shqiptar". *Posta e Korçës* nr. 76, 31 dhjetor 1921, 1.
[351] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1921, D. VI-56, f. 1, Prefektura Korçë drejt. MPB, 21 dhjetor 1921.
[352] AQSH, F. 14 "Fan Noli", V. 1921, D. 130, f. 1, Protestë e deputetëve.

Ministri i ri e lajmëroi Nolin për zhvillimet në Tiranë dhe kundërshtitë e ashpra të tre deputetëve Xhitoni, Peci dhe Tasi. Ai sugjeroi kthimin e menjëhershëm në kryeqytet më 24 dhjetor. Noli u tregua i gatshëm ta linte Korçën, por me një kusht. Ai i kërkoi Zogut të emëronte përfundimisht prefekt Terenc Toçin dhe t'i jepte atij plotfuqi të largonte kundërshtarët e pakët të Kishës Kombëtare. Kjo ishte e nevojshme që ndryshimi i qëndrimit të mos lexohej si çnderim, çka mund të shkaktonte turbullime të mëtejshme. Noli shkruante se miqtë dhe trimat besnikë si Zogu dalloheshin në raste të tilla.[353]

Frika e Nolit kishte të bënte me betejën e brendshme të pashpallur kishtare. Mundësi që Kisha në Korçë të rigreqizohej nuk kishte. Grekomanët numëroheshin në gishtat e duarve dhe kishin vërtetuar në të kaluarën se nuk mund të bënin asgjë, pa drejtimin e pleqësisë kishtare e pa mbështetjen ushtarake greke. Ndaj, me gjasë, Noli kishte frikë se Visar Xhuvani do të shihte stepje dhe do të merrte përparësi me ndihmën e korçarëve ndikues si Sotir Peci, Pandeli Evangjeli, Koço Kota etj. Një skenar i tillë ulte shanset e Theofanit për të marrë kryesimin e Kishës në të ardhmen.

Zogu emëroi prefekt të përhershëm zëvendësprefektin Terenc Toçi. Rrjedhimisht, Theofani u nis për në Tiranë më 29 dhjetor 1921. Ai u shoqërua nga Atë Vasil Marko dhe Atë Isaia dhe meshoi edhe në Pogradec. Aty pagëzoi dy fëmijë me emrat Piro dhe Gjergj, në kujtim të Piros së Epirit dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Noli foli në Kishë mbi: "Kush do ta rokullisë gurin nga vari i Krishtit", duke e lidhur me betejën për shpëtimin e Atdheut dhe gurin që shqiptarët arritën të rokullisnin. Ai premtoi se do të meshonte në Elbasan, Tiranë, qytetet e tjera e më pas do të kthehej sërish në Korçë.[354]

Meshat e paralajmëruara nuk u kryen. Qeveria dhe deputetët ortodoksë arritën ta bindnin episkopin e vetëshpallur të mos shfaqej haptazi në çështjen kishtare. Gjykimi i Nolit se Kisha ishte autoqefale prej Bostonit ishte hedhur poshtë akoma edhe në fortesën e re: Korçë. Zëvendësmitropolit Atë Josifi thoshte haptazi në fillimvitin 1922 se kishat e Korçës nuk ishin autoqefale. Ai arsyetonte se kishte ndryshuar vetëm gjuha, ndërsa gjendja kishtare mbetej të caktohej në një çast të dytë.[355]

Pikënisja e planveprimit të autoqefalisë nuk mund të thuhet me saktësi. Mirëpo, ajo që dihet është se gjithçka përvijoi sipas planit të parashtruar nga Visarion Xhuvani më 28 nëntor 1921. Sotir Peci shkruante prej kohësh për mbledhjen e një kuvendi mbarortodoks, që do të krijonte një këshillë kishtare, do të mundësonte njohjen e autoqefalisë, do të thërriste dy episkopë, të cilët do të dorëzonin edhe Nolin.[356]

Sidoqoftë, nevojitej ndërhyrja qeveritare për të mundësuar njëmendësi të plotë. Autoqefalia ishte një veprim i ndërmarrë nga qeveritë në të gjitha vendet e Ballkanit. Greqia ishte mjaftuar me një vendim mbretëror për të shkëputur lidhjet me Patriarkanën Ekumenike, të pasunduar asokohe nga shteti grek. Qeveria kishte rol vendimtar edhe në Shqipëri, ndonëse me tjetër planveprim, për të shmangur keqkuptimet, pasi ortodoksët nuk përbënin shumicën.

Dy zhvillime të njëkohshme do ta ndalonin shtetin shqiptar të vepronte me shpejtësi. Komisioni i Hetimit, i ngritur nga Konferenca e Ambasadorëve, po shqyrtonte çështjen e 26 fshatrave në Jug dhe ndarjen përfundimtare të kufirit në Veri. Qeveria nuk dëshironte t'i mundësonte Greqisë të ankohej në këto rrethana se Tirana po ndërhynte në

[353] AWSH, F. 152 "MPB", pa vit, D. 247, f. 1, Fan Noli drejtuar MPB, pa datë.
[354] *Posta e Korçës* nr. 76, 31 dhjetor 1921, 2.
[355] AQSH, 30 maj 1922, F. 152 "MPB", D. 52, f. 7, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB.
[356] AQSH, Letër e Sotir Pecit, cit.

çështje fetare. Komisioni Hetimor kishte thirrur Mitropolit Jakovin për të shpalosur qëndrimet e tij më 6 dhe 26 janar 1922.[357] Gjithsesi, kjo nuk duket arsyeja kryesore, teksa kufijtë nuk ishin të caktuar as kur Visarioni kishte hedhur hapin e parë më 28 nëntor.

Ajo çka përbënte vështirësi për Tiranën ishin zhvillimet e brendshme. Qeveria ishte shqetësuar nga kryengritje që vendosnin në pikëpyetje qëndrueshmërinë e shtetit shqiptar. Fuqi të drejtuara nga ministri Ahmet Zogu arritën të zaptonin me vështirësi Mirditën në vitin 1921. Viti pasardhës e gjeti Tiranën me një përballje të re. Bajram Curri ishte përqendruar në Malësinë e Gjakovës dhe përgatitej të çlironte Kosovën prej nga vinte. Elez Isufi ndodhej në fshatrat e Dibrës në kufirin shqiptaro-jugosllav dhe dëshironte të çlironte kryeqendrën e trevës. Kjo ishte arsyeja e rrëmujës politike të shkaktuar me pesë qeveri brenda muajit dhjetor 1921. Mosqetësimi politik i gjendjes bëri që trupat e Elez Isufit të marshonin drejt Tiranës në mars 1922. Bajram Curri u përpoq po ashtu, por nuk ia doli. Trupat e Isufit u shpërndanë, falë ndërhyrjes së ambasadorit britanik. Ahmet Zogu ishte i vetmi ministër i mbetur në kryeqytet për t'i bërë ballë kryengritjes. Ai doli ngadhënjimtar.[358]

Qëndrueshmëria politike u rikthye në fundprill. Ndërkaq, zhvillimet ishin të shumta: Mitropolit Jakovi ishte nisur ato ditë nga Korfuzi për në Kostandinopojë, i sapoemëruar Protosingjel i Patriarkut; një murg shqiptar në Malin e Shenjtë dhe rreth 40 bashkatdhetarë ortodoksë ishin ndaluar në Selanik, si përgjues të Shqipërisë;[359] Ndërsa, në Jug përflitej se Patriarkana po përgatitej të emëronte dy mitropolitë të rinj për Beratin dhe Durrësin.[360] Thashethemet trembën zyrtarët shqiptarë. Stavro Vinjau, Koço Tasi dhe Dhimitër Kacimbra u shqetësuan, edhe pse kishin qasje të ndryshme mbi mënyrën e shpalljes së autoqefalisë. Ata i kërkuan qeverisë të ndalonte me çdo mënyrë hyrjen e mitropolitëve.[361] Ministri i Brendshëm urdhëroi më 5 maj ruajtjen e gjendjes së deriatëhershme fetare deri në mbledhjen mbarortodokse të Shqipërisë. Ai udhëzoi marrjen e masave për parandalimin e ngatërrimeve të kota.[362]

Data e mbajtjes së kongresit do të vendosej vetëm në mesgusht. Përshpejtues u bë një takim ndërmjet përfaqësuesit grek në Komisionin e Caktimit të Kufijve, Kalamaras, me Kryeministrin shqiptar, Xhafer Ypi. Kalamaras shprehu shqetësimin për moslejimin e gjuhës greke në kisha. Ypi u përgjigj se qeveria shqiptare nuk kishte trajtë fetare dhe këtë çështje ua kishte lënë në dorë besimtarëve.[363] Kryeministri tha se qeveria do të zbatonte vendimet e një kuvendi mbarortodoks, që parashihej të mblidhej në fillim të shtatorit.[364] Ypi i shprehu përfaqësuesit grek mendimin vetjak se kishat duhet të ishin të ndara veçmas për shqip e greqisht.[365] Mirëpo, ai paralajmëroi se për këtë duhej kohë, teksa ortodoksët do ta quanin si dorëzim para Greqisë. Kryeministri kuptoi se Athina zyrtare ishte e gatshme ta përfshinte çështjen kishtare në kornizën e Komisionit Hetimor. Ypi

[357] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 64, f. 3, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 6 janar 1922.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 64, f. 8, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 26 janar 1922.
[358] Puto, *Shqipëria Politike*, 295.
[359] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 71, f. 1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 11 prill 1922.
[360] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 87, f. 2, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 27 prill 1922.
[361] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 53, f. 2, Vinjau etj. drejtuar MPB, prill 1922.
[362] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 186, f. 3, Qarkore e MPB, 5 maj 1922.
[363] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 52, f. 9, Ypi drejtuar MPB, 8 gusht 1922.
[364] GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", Dosja 702, f. 1, Kalamaras drejtuar Ministrisë së Luftës, 25 korrik/8 gusht 1922.
[365] GAK, Kalamaras drejtuar Ministrisë së Luftës, cit.

frikësohej se meshimi vetëm në shqip do të krijonte përshtypje të gabuar, si të ishte i detyruar prej qeverisë. Prandaj, përcaktimi i messhtatorit si data e mbajtjes së kongresit duket vendim i çastit. Ai rendi t'i kërkojë Ahmet Zogun, me të përfunduar takimin, që mbledhja e shpejtë e kongresi të caktohej në takimin e radhë së Këshillit të Ministrave.[366]

Kryeministri e ndau shqetësimin edhe me zëvendësprefektin e Korçës, Rasim, i cili thirri Pleqësinë Kishtare të qytetit. Prefektura e Korçës i parashtronte Zogut se po punonte që kërkesa për mbajtjen e ngutshme të kongresit të mos dukej detyrim qeveritar, por sugjerim nga poshtë.[367] Mirëpo, qeveria vendosi që Korça të mos ishte vendmbledhja. U mendua fillimisht të thirrej një mbledhje, prej ortodoksëve durrsakë, përfaqësuar nga kryebashkiaku Kostë Paftali. Gjithçka u ndryshua në çastet e fundit dhe u vendos që mbledhja të quhej kongres dhe vendtakimi të ishte Berati.[368]

Arsyet e ndryshimeve të njëpasnjëshme janë të paqarta. Të thirrurit në Durrës nga Kostë Paftali ishte kuptimplotë. Durrësi ishte qendra e Mitropolisë që përfshinte kryeqytetin. Për më tepër, qyteti drejtohej nga një kryebashkiak ortodoks, i cili nuk ishte përfshirë në përplasjet mes rrymave të krijuara. Ndryshimi i çastit të fundit ngjan me një pajtim të brendshëm për të zhvilluar mbledhjen në një "tokë të paanshme". Noli kishte nën drejtim të pakundërshtueshëm Korçën dhe kjo është arsyeja e vetme se përse ky qytet u shmang nga Zogu. Nga ana tjetër, Visar Xhuvani ishte zëvendësmitropolit në Durrës, çka do të krijonte një frymë dyshimi te fanolistët. Berati dukej zgjedhja më e mirë e mundshme.

Zogu kërkoi mendimin e Ministrisë së Jashtme, përpara nisjes së ftesave drejtuar të gjitha prefekturave. Ministria u përgjigj më 14 gusht 1922 se çdo veprim që kishte të bënte me qeverinë greke duhet të zgjidhej përpara se të përfundonte lufta në Anadoll. Prandaj, ajo vlerësonte se ato ditë ishin koha më e përshtatshme për mbledhjen e kongresit dhe nisjen e një dërgate për të hyrë në bisedime me Patriarkanën në Stamboll. Ministria gjykonte se zgjedhja e dërgatës nga një kongres, do t'i jepte epërsi shpirtërore dhe do të përshpejtonte autoqefalinë. Ajo theksonte se gjuha ishte çështje dytësore, që mund të lihej për më vonë. Rëndësi përbënte ndarja e kishës shqiptare nga ajo e Kostandinopojës.[369]

Arsyetimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme u vërtetua një gjykim i përsosur i zhvillimeve ndërkombëtare, në vetëm pak ditë. Greqia dhe Turqia nuk ishin përleshur drejtpërdrejt prej thuajse një viti, që kur trupat greke patën arritur pranë Ankarasë. Mirëpo, trupat turke kishin përfunduar betejat ushtarake me Italinë, Britaninë dhe Francën në thellësi të Anadollit. Ato ishin gati për kundërsulmin e madh. Përballë, trupat greke ishin ligështuar nga pritja shumëvjeçare e një fitoreje të paarritur. Kryeministri grek Gunaris kishte kërkuar me ngulm zgjidhjen e çështjes kufitare, sipas Traktatit të Sevrës, që çonte Greqinë në kufij të Stambollit dhe në brendësi të Anadollit, duke përvetësuar Izmirin. Mirëpo, Turqia ishte ringritur tashmë nga hiri i Perandorisë Osmane. Ajo ishte gati për betejën përfundimtare, nën drejtimin e Mustafa Qemal Ataturkut.

[366] AQSH, Ypi drejtuar MPB, cit.
[367] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 49, f. 1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 9 gusht 1922.; Ypi ndodhej në Korçë, ditën që u krye orvatja nga prefekti dhe pleqësia kishtare.
[368] Letra ishte përgatitur për t'u nisur me 13 gusht dhe shkruante "ortodoksat e Durrësit me insisjationin e tyne duan të bëjnë nji mbledhje në Durrës". Ajo ishte ndryshuar, teksa i ishte hequr vizë fjalës mbledhje, për t'u zëvendësuar me fjalën "kongres", ndërsa fjala "Durrës" me fjalën "Berat". AQSH, F. 152 "MPB", D. 49, f. 3, Shkresë-Koncept, 13 gusht 1922.
[369] AMPJ, D. 186, f. 7, MPJ drejtuar MPB, 14 gusht 1922.

Turqia do të niste kundërsulmin dymbëdhjetë ditë pas dërgimit të arsyetimit të sipërpërmendur të Ministrisë së Jashtme Shqiptare. Trupat qemaliste hodhën Greqinë në det brenda 16 ditëve prej nisjes së sulmit, më 26 gusht 1922. Greqia nënshkroi dorëzimin, që përbënte gjëmën ushtarake më të madhe bashkëkohore të saj, pikërisht ditën që në Berat mblidhej kongresi për çështjen e atuoqefalisë.[370]

Zogu nuk qe vonuar. Ai kishte urdhëruar Paftalin të shpërndante ftesat, sapo kishte marrë gjykimin e Ministrisë së Jashtme.[371] Paftali u shkruante prefekturave:

> "I nënshkruari, tue marrë para sysh përçarjet dhe mosmarrëveshjet që po vazhdojnë ndërmjet vëllezërve shqyptarë orthodoks mbi çështjen që përkasin Qishës Orthodhokse dhe tue u bint që këjo gjindje po damton jo vetëm çështjen fetare orthodokse por damton reptësisht si shtetin tonë Shqiptar si dhe Kombësinë po marrë lejen me i proponu vëllazërve Shqiptarë orthodoksë që të formohet sa më parë një Konkres për të i shërue këtë plagë të hapur dhe të caktojë sa ma parë nga çdo vendi Delegatët e duhun kur gjinden shqiptarë orthodoksë dhe kujtojmë që vendi ma i mirë për majtjen e këtij Konkresi është Berati nga çdo pikëpamje".[372]

Theofan Noli nuk do të merrte pjesë në kongres. Ai qëndroi i mënjanuar, në marrëveshje me qeverinë, për të mundësuar mospërplasje në radhët e rrymave kishtare. Qëllimi parësor i kongresit ishte të bindte Patriarkanën dhe qenia e një episkopi të vetëshpallur do ta minonte përpjekjen. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se përzgjedhja e fuqiplotëve nuk ishte në frymën e dyluftimit mes Nolit dhe Xhuvanit. Episkopi i vetëshpallur përfaqësohej nga Atë Vasil Marko, Atë Vangjel Çamçe dhe dhjetëra fanolistë të tjerë, që e shihnin kongresin si vendin ku Theofani do të zgjidhej Kryepiskop.

Rryma e përfaqësuar nga Visarion Xhuvani u ishte mbivendosur fanolistëve në hartimin e planveprimit të kongresit. Mirëpo, kjo nuk nënkuptonte doemos që Visari kishte mbështetje më të madhe se Noli. Theofani kundërshtohej për mënyrën, por udhëheqja e tij mund të pranohej, nëse përkohësisht vendoste të mënjanohej. Xhuvani u përpoq të rriste mbështetjen ndaj tij në Korçë në janar 1922. Ai tha në një takim se dorëzimi i Nolit ishte i papërfunduar, çka shkaktoi kundërshtitë e vatranëve. Ata kërcënuan me ndodhi të papëlqyera, nëse Xhuvani nuk ikte i detyruar nga qeveria.[373]

Arkimandriti u largua, por dyluftimi sapo kishte nisur. Ai kishte qenë ndikuesi themelor i përgatitjeve: shpalli autoqefalinë një vit më parë, paralajmëroi kongresin dhe ishte këshilltari besnik i qeverive shqiptare në çështje kishtare. Visar Xhuvani nisi lobimin. Ai do të ishte vetëm një hap larg kryesimit të Kishës, nëse u mbivendosej mbështetësve të Nolit në kongres. Arkimandriti vizitoi mbarë vendin dhe sugjeroi mbështetësit e tij për përfaqësues fuqiplotë. Prefekti i Shkodrës, Abedin Nepravishta,

---

[370] Duhet theksuar se vetëm data dhe kundërveprimi i shpejtë ishin pasojë e marrëdhënieve shqiptaro-greke, pasi autoqefalia e Kishës Ortodokse në Shqipëri vinte si rrjedhim i fuqizimit të brendshëm të bashkësive fetare. Bashkësia myslimane ishte ndarë nga qendra në Stamboll më 12 mars të atij viti. Edhe bektashinjtë do të ndiqnin këtë rrugë pak kohë më vonë. Ndaj, siç shënon Akademiku Beqir Meta "fenomeni i pavarësimit të institucioneve fetare ishte i natyrshëm dhe gjithëpërfshirës. Ai nuk drejtohej kundër ndonjë subjekti të huaj, por ishte rezultat logjik i progresit të kombit shqiptar". Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar 1939-1949* (Tiranë: Geer, 2002), 37.

[371] Paftali ia kishte pranuar Vasil Dilos se qe urdhëruar (Dilo, "Psikoza e Vorioepirit", cit.).

[372] AQSH, F. 156 "Gjykata e Diktimit", D. 4, f. 13, Paftali drejtuar Mitropolisë Gjirokastër, 14 gusht 1922.

[373] AQSH, F. 152, "MPB", D. 51, f. 12, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 21 janar 1922.

lajmëronte më 16 gusht 1922 se miku i Xhuvanit, Dushan Kallajxhia, u zgjodh fuqiplotë i atyshëm. Qeveria pranoi me kusht që Kallajxhia të mbështeste autoqefalinë.[374]

Visari drejtoi pleqësitë kishtare të prefekturave e nënprefekturave të Mitropolisë së Qendrës, ku u përpoq të ndikonte në zgjedhjen e përfaqësuesve. Ai la të fundit qytetin ku kishte ndikim më së shumti. Arkimandriti kryesoi mbledhjen e Pleqësisë Kishtare në Durrës, më 23 gusht. Pleqësia zgjodhi fuqiplotë Visar Xhuvanin, në cilësinë e "Kryetarit të Mitropolisë" dhe tregëtarin Gjergj Manushi. Ata u ngarkuan të vendosnin drejtimin e rregulltë të Kishës, në marrëdhënie të vazhdueshme me Patriarkanën Ekumenike në çështje besimi dhe qeverisjen si simotrat e shteteve të tjera.[375]

Fortesa e Nolit, Korça, shqetësohej për tjetër çështje më 17 gusht. Kryetari i Bashkisë dhe kryetari i Këshillit të Mitropolisë i shprehën prefektit frikën mos mbështetësit e Kishës Greke bënin shumicën në Kongresin e Beratit, çka do të shkaktonte dëm të madh në politikën kombëtare. Ata kërkuan që qeveria të siguronte se autoqefalistët do të ishin shumica. Këshilli i Mitropolisë sundohej nga fanolistë prej ditës kur Jakovi ishte larguar. Këshilli i Bashkisë përfaqësonte rrymën që kundërshtonte Nolin.[376]

Gjithsesi, gjendja u anua nga fanolistët shumë shpejt. Mihal Grameno shkruante në "Koha" se Noli nuk ishte kundër nisjes së një dërgate për në Stamboll, me kusht njohjen e autoqefalisë së Kishës dhe të tij si kryepiskop.[377] Nënprefekturat ku shtrihej Mitropolia e Korçës zgjodhën mbështetës të flaktë të Theofanit. Arritja më e madhe ishte kur kufijtë e Mitropolisë u thyen. "Koha" njoftonte se shumica e fuqiplotëve do të kundërshtonin Xhuvanin dhe Noli do të ngadhënjente.[378] Arkimandrit Visari mori goditjen përfundimtare pak ditë para nisjes së punimeve. Përfaqësuesit e vendlindjes dhe pikënisjes së betejës së tij kishtare, Elbasanit, i kthyen kurrizin dhe përkrahën Nolin.[379]

Berati zgjodhi përfaqësuesit mes pak kundërshtive.[380] Trevat e Mitropolisë së Gjirokastrës nuk kishin kthyer përgjigje deri në fundgusht. Pleqësia kishtare u mblodh më 28 gusht 1922, nën kryesinë e zëvendësmitropolitit Thanas Duka. Ajo vendosi të mos pranonte kërkesën e Paftalit, duke thënë se përfaqësonte vetëm qytetin dhe jo Qarkun Kishtar. Anëtarët e Pleqësisë arsyetonin se çështja duhet t'i lihej në marrëveshje mes Shtetit dhe Patriarkatës, sikundër ishte bërë kudo dhe kurdo në çdo shtet të sapolindur, duke mbajtur përkohësisht Status-quo-në e vjetër kishtare.[381]

Vendimi nënkuptonte mosshpalljen e menjëhershme të autoqefalisë. Ai shprehej se duhej bërë si në shtetet e tjera, edhe pse shembulli i Ballkanit, nisur me Greqinë në vitin 1833, tregonte se autoqefalia ishte e njëanshme, e pranuar pas dhjetëvjeçarësh nga

[374] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 49, f. 8, Prefektura Shkodër drejtuar MPB, 16 gusht 1922.
[375] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* 122.
[376] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 49, f. 22-24, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 17 gusht 1922.
[377] Mihal Grameno. "Kisha Orthodhokse", *Koha* nr. 95, 2 shtator 1922, 2.
[378] "Andej-Këndej", *Koha* nr. 95, 2 shtator 1922, 2.
[379] *Koha* nr. 96, 10 shtator 1922, 2.
[380] Pleqësia kishtare në Berat kishte pranuar në parim, por kishte vendosur dy kushte. Ajo donte të kishte paraprakisht rregulloren për zgjedhjen e fuqiplotëve dhe një ditar të punimeve. (AQSH, F. 152 " MPB", V. 1922, D. 49, f. 28, Bashkia Berat drejtuar MPB, 17 gusht 1922) Por, qeveria u përgjigj prerazi që fuqiplotët të zgjidheshin menjëherë. Ndaj, këto kërkesa u anashkaluan. Ministri Zogu udhëzoi prefekturën që "të kujdeseni tepër që të mos lejë ndo nji kundërshtim prej orthodhoksve t'atjeshëm, mbassi aty do të jetë edhe qendra e kongresit, se për ndryshe gjithë përgjegjësia i ngarkohet asaj Prefekture" (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 49, f. 31 MPB drejtuar Prefekturës Berat, 21 gusht 1921).
[381] AQSH, F. 156 "Gjykata e Diktimit", V. 1923, D. 4, f. 37, Vendimi i Pleqësisë Kishtare, 28 gusht 1922.

Patriarkana Ekumenike. Përbërja e Pleqësisë Kishtare të Gjirokastrës anonte nga grekomanët; atdhetarë shqiptarë, si nënshkruesi i pavarësisë, Jani Papadhopulli, apo Aleks Çeçi, Kristo Dilo etj., bënin pjesë në të, por ata ishin pakicë.[382]

Vendim i ngjashëm ishte marrë nga Pleqësia e Libohovës. Kjo nënprefekturë përbëhej nga shumicë dërrmuese grekë të Dropullit dhe Pogonit. Prefekti i Gjirokastrës, Tromara, shpresonte dërgimin e fuqiplotëve nga Tepelena. Gjirokastra, Delvina dhe Libohova mund të zgjidhnin përfaqësues vetëm nga një grup atdhetar shqiptar dhe mbështetësit e qeverisë. Zogu udhëzoi që përfaqësuesit të zgjidheshin nga pakica, duke sygjeruar Athanas Notin, të njohur për gjithëpranueshmërinë dhe qëndrimet atdhetare.[383]

Zyrtarët e Libohovës dhe Delvinës zgjodhën Spiro Katin dhe Kosta Thomajn, me pjesëmarrje të një pjese të ortodoksëve dhe jo të pleqësive kishtare. Gjirokastra dhe Tepelena zgjodhën katër përfaqësues, në çastin e fundit. Ata nuk u zgjodhën rregullisht. Një përfaqësi e mbarë qarkut me anëtarë të pleqësive kishtare dhe kryepleq të fshatrave u mblodh nën kryesinë e Atë Pano Gjirokastrës, më 11 shtator. Përligjja ishte vetë vendimi i Pleqësisë Kishtare, që nuk pranonte të përfaqësonte mbarë qarkun. Mbledhja vendosi shkarkimin e Thanas Dukës dhe vijoi me çështjen e përfaqësuesve.[384] Anëtarët e Pleqësisë, tregtari Jani Papadhopulli dhe farmacisti Aleks Çeçi, u votuan si anëtarë të kongresit. Zagoriti Stathi Kondi dhe anëtari i Gjykatës Fillore të Beratit, Vasil Haxhijani, u zgjodhën krahas tyre. Ata ishin fuqiplotë, me kusht të mos prekeshin çështjet dogmatike dhe ndryshimet në qeverisjen e kishës të merrnin edhe pëlqimin e Patriarkanës. Vendimet i nënshkruan katër nga dhjetë anëtarët e pleqësisë kishtare të qytetit dhe përfaqësues nga të gjitha fshatrat ortodokse shqiptare të Lunxhërisë, Rrëzës, Libohovës dhe Tepelenës. Dropulli ishte i papërfaqësuar.[385] Mirëpo, vetëm Stathi Kondi mori pjesë në punimet e Kongresit e Beratit. Anëtarët e tjerë nuk arritën të shkonin, pasi zgjedhja u bë shumë vonë.[386]

2.2. Kongresi i Beratit

Fuqiplotët kishin mbërritur sipas planifikimit në Berat dhe gjithçka ishte gati që mbledhja të niste. Përfaqësuesit nga mbarë vendi kaluan në rrugicat e ngushta të lagjes Mangalem, nën hijen e kalasë qindravjeçare që mbizotëronte në kodrën përmbi, mëngjesin e së hënës, 10 shtator 1922. Punimet u çelën në një ndërtesë dykatëshe, që shërbente si Shkolla Qendrore e qytetit. Përfaqësuesi i Beratit, Perikli Kona, drejtoi komisionin për kqyrjen e plotfuqive. Anëtarët e tjerë ishin Vasil Llapushi nga Elbasani, Atë Vangjel Çamçe nga Leskoviku, Stathi Kondi nga Gjirokastra e Përmeti dhe Taqi Buda nga Shpati.[387] Komisioni vërejti se përfaqësuesi i Shijakut dhe i Libohovës kishin plotfuqi të parregullta. Ndërkaq, përfshiu nismëtarin Kostë Paftali si përfaqësues të

[382] Po aty.
[383] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 49, f. 39, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 28 gusht 1922.
[384] Thanas Duka do të fajësohej për veprimtari kundërkombëtare dhe për mosbindje ndaj zyrtarëve të lartë, pasi nuk pranoi të njihte Këshillin e Lartë Kishtar. Gjithsesi, Gjykata do ta shpallte të pafajshëm. AQSH, F. 156 "Gjykata e Diktimit", V. 1923, D. 4, f. 237, Vendimi i Gjykatës, pa datë.
[385] AQSH, F. 156 "Gjykata e Diktimit", D. 4, f. 39, Procesverbal, 29 gusht/11 shtator 1922.
[386] AQSH, F. 156 "Gjykata e Diktimit", D. 4, f. 38, Bashkia Gjirokastër drejtuar MPB, 21 shtator 1922.
[387] AQSH, F. 141 "Mitropolia Korçë", D. 436, f. 1, Vendimi i Kongresit të Beratit, 13 shtator 1922.

Dibrës, prej nga nuk ishin zgjedhur fuqiplotë.[388] Qeveria kishte emëruar dy përfaqësues zyrtarë: Llazër Puli ishte përfaqësues i Prefekturës së Beratit dhe prokurori Harilla Theodhos përfaqësonte qeverinë. Zyrtarët frikësoheshin mos kongresi nuk shkonte sipas parashikimit, edhe pse nuk kishte mundësi që ndokush të kundërshtonte autoqefalinë.[389]

Ajo çka brente qeverinë ishte si rrymat kishtare do të silleshin me njëra-tjetrën. Noli kishte ngadhënjyer bindshëm. Mitropolia e Korçës kishte zgjedhur vetëm fanolistë: Atë Josif Qirici dhe Dhosi Havjari nga Korça, Atë Jorgji dhe vatrani Anastas Çekrezi nga Bilishti, Oshënar Sofroni dhe Dhimitri Ndini nga Kolonja, Atë Vangjel Çamçe dhe Thomo Prifi nga Leskoviku dhe dr. Stathi Kondi dhe Vasil Zoto nga Përmeti. Fanolistët ishin përhapur edhe më tej. Krahu i djathtë i Theofanit, Vasil Marko, ishte zgjedhur fuqiplotë i Pogradecit, pjesë e Mitropolisë së Durrësit, bashkë me vatranin Thanas Kërxhalliu.[390]

Visarion Xhuvani ndikonte mbi përfaqësuesit e pak trevave: Gjergj Manushit të Durrësit; kryebashkiakut durrsak Kostë Paftalit, bashkëfuqiplotit të Dibrës Leonidha Nishkut dhe shkodranët me prejardhje malazeze Rist Gjybabiç dhe Gjok Nikolliç. Xhuvani kishte miqësi me Taq Budën e Dhimitër Paparistën nga Shpati dhe Tol Arapin nga Vlora, edhe pse nuk kishte ndikuar në zgjedhjen e tyre. Fuqiploti tjetër i Vlorës, Jani Skrame, dhe përfaqësuesit e Elbasanit, Vasil Llapushi dhe Simon Shuteriqi ishin përplasur me Arkimandritin. Ata nuk do ta mbështesnin, por do të kundërshtonin edhe çdo përsiatje për shpalljen e Nolit Kryepiskop. Anëtarët e tjerë, përkatësisht të Kavajës, Tiranës, Beratit, Fierit, Lushnjës, Libohovës dhe Delvinës ishin ende pa kahje.[391]

Mbledhja e parë përfundoi. Bisedimet do të nisnin zyrtarisht të nesërmen, më 11 shtator. Qeveria mbështeti haptazi Visar Xhuvanin, tek i cili shihte një besnik të aftë për të arritur autoqefalinë. Miqësia e Zogut me Theofanin ishte ftohur që kur Noli kishte dhënë dorëheqjen nga qeveria e Xhaferr Ypit. Mirëpo, fanolistët ishin shumicë dërrmuese në kongres. Ata kërkonin që Noli të shpallej Kryepiksop që në këtë mbledhje. Gjithsesi, zyrtarët qeveritarë ia dolën t'i bindin se ishte më e rëndësishme të arrihej autoqefalia dhe Noli mund të mënjanohej përkohësisht.[392]

Kështu, gjuha e përbashkët u gjet në mbledhjen e dytë. Josif Qirici u zgjodh njëzëri kryetar i kongresit. Prifti i sprovuar kishte shqiptarizuar kishën në Korçë edhe në vitin 1914, edhe në vitin 1921. Ai ishte në moshë të thyer, porse atdhetar i bindur, partizan i gjuhës amtare e njëkohësisht kishte mbijetuar në Mitropolinë e Korçës, pa u dëbuar nga Gjermanosi apo Jakovi. Josifi hapi mbledhjen, duke njoftuar shkurtazi se qëllimi ishte shpallja e Kishës Autoqefale Ortodokse Kombëtare. Atë Vasil Marko shpalosi betejën për autoqefali, si domosdoshmëri kombëtare. Fjalët e tij u cilësuan nga

---

[388] Kaliopi Naska, "Kongresi Themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat", *70 Vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare* (Tiranë: Instituti i Historisë, 1993), 14-15.

[389] Perikli Kona dhe Dhimitër Tutulani, fuqiplotë të Beratit, kishin shprehur fillimisht dyshime, duke menduar se shpallja e autoqefalisë mund të priste edhe pak kohë, deri sa të arrihej një marrëveshje me Patriarkanën, apo edhe thjesht një mendim i saj. Por, ata u bindën pa shumë vështirësi që shpallja e njëanshme ishte e domosdoshme; mendim ky që mbështetej nga të gjithë anëtarët e tjerë. AQSH, F. 152 "MPB", D. 53, f. 11, Prodani drejtuar MPB, 13 shtator 1922.

[390] "Andej-Këndej", *Koha* nr. 95, 2 shtator 1922, 2.

[391] Ata ishin Pal Xhumari dhe Andre Ikonomi për Kavajën; Papa Simoni dhe Mark Hobdari për Tiranën; Lon Xoxa dhe Mit Qilica për Fierin; Tun Gjergji dhe Llaz Boxhja për Lushnjën, Spiro Kati për Libohovën; dhe Kosta Thomaj për Delvinën.

[392] AQSH, Prodani drejtuar MPB, cit.

përfaqësuesi qeveritar "aq të ëmbla dhe plot mjeshtëri e logjikë" sa që tërhoqën mbarë fuqiplotët, me përjashtim të atyre të Durrësit, Dibrës dhe Tol Arapit të Vlorës.[393] Arkimandrit Visar Xhuvani mori menjëherë fjalën dhe shpalli autoqefalinë.

> "Të gjith neve të autorizuemit Delegatët të Kongresit, Klerik e Llaik, me nji za dhe entusiazëm në emnin e të gjith klerit e të popullit orthodhokës të Shqipniës, duke u bazuar që Shqipnia u njoft prej gjith shtetevet të botës si nji shtet Independantë dhe sovran dhe mbi këtë bazë, mbas kanonevet të shenjta të kishës orthodhokse, në shtet independentë, kishë endependente e të tjera [shpallim] autoqefalin të kishës orthodhokse Kombëtare të Shqipniës edhe de fakto, se de jure ka qenë që prej ditës së shpalljes Independencës politike të shtetit shqiptar duke mbajtur lidhje spirituale dhogmatike dhe apostolike plotësisht me Mamën Kishën të Patrikanës shenjtë Ekumenike dhe me Patrikanat dhe kishat e tjera orthodokse autoqefale të botës, por administrativisht Independantë, pra, Rroftë Kisha Autoqefale".[394]

Vlefshmëria e autoqefalisë ishte e pakundërshtueshme, edhe pa përfaqësuesit e rregullt të Mitropolisë së Drinupojës. Fuqiplotët e trevave të tjera përbënin shtatëfishin e Qarkut Kishtar me qendër në Gjirokastër. Përligjja e vendimit u mundësua nga teologu dr. Visar Xhuvani. Ajo ishte një përqasje e pashoqe e së drejtës kishtare. Vendimi i Kongresit të Beratit njihte Kishën Ortodokse në Shqipëri autoqefale prej vitit 1912, kur u shpall pavarësia. Kjo bazohej në kanonin se një kishë e një shteti nuk mund të veprojë në një kishë tjetër dhe parimin "kishë e pavarur në shtet të pavarur".[395] Autoqefalia e qenë veçse *u shpall* në vitin 1922 dhe Patriarkana Ekumenike do ta *njihte*, kur t'i vinte çasti. Vështirësia kryesore ishte se nuk kishte asnjë episkop të rregullt në Shqipëri. Kisha Mëmë do të duhet t'i zgjidhte, dorëzonte dhe emëronte kryepriftërinjtë, nëse Kisha në Shqipëri do të shihej pjesë e Patriarkanës Ekumenike. Mirëpo, përqasja e Kongresit të Beratit ishte se Kisha Shqiptare ishte autoqefale prej vitit 1912. Rrjedhimisht, asnjë kishë e huaj nuk kishte të drejtë t'i zgjidhte episkopët, përfshi edhe atë të Kostandinopojës. Arsyetimi sillte nevojën e krijimit të Këshillit të Lartë Kishtar, në bazë të parimit "kat'ikonomian". Këshilli do të kishte vetëm një qëllim: thirrjen e katër episkopëve të rregullt për plotësimin e numrit të domosdoshëm për një kishë autoqefale. Sinodhi i krijuar prej tyre do të merrte frenat e kishës, prej atij çasti.[396]

---

[393] AQSH, F. 152 "MPB", D. 53, f. 122, Theodhosi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, 23 shtator 1922.

[394] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe Intrige*, 186.

[395] Ky parim ishte përcaktuar fillimisht nga teologu Arkimandrit Theoklitos Farmaqidhis, që ishte udhëheqësi i autoqefalisë së Kishës Greke. Më vonë, parimi u përpunua nga Patriarku Joakimi III. Atë Zhivko Panev, "Some remarks on the Notion of Autocephaly [Disa shënime mbi konceptin e autoqefalisë], *Sourozh* 63 (1996): 25-32.

[396] Ky arsyetim mund të vlerësohet si risi në të drejtën kanonike. Studiuesit e mëvonshëm të çështjes kishtare ishin kryesisht grekë dhe do ta quanin Kongresin e Beratit "kundërkanonik". Mirëpo, arsyeja që i çonte në këtë përfundim nuk është trajtuar asnjëherë gjerësisht. Vetëm teologu Pirro Kondili ka vlerësuar se duhet të ishte një Sinodh episkopësh që duhet të kërkonte Tomosin e Autoqefalisë. (Pirro Kondili, "Η Ορθόδοξη Εκκλησία της Αλβανίας κατά τη διάρκεια της κομμουνιστικής δικτατορίας" ["Kisha Ortodokse e Shqipërisë gjatë diktaturës komuniste"] (Master, Universiteti Athinës, 2002), 21) Gjithsesi, ky arsyetim nuk mund të qëndrojë, teksa kanonet kishtare nuk trajtojnë çështjen e autoqefalisë. Kanonet i përkasin një periudhe kur vetë kuptimi i Autoqefalisë së kishave të reja nuk ishte zhvilluar. Të gjitha kishat e tjera janë të mëvonshme, me përjashtim të Kishës së Qipros, pa një përcaktim të së drejtës kanonike të mënyrës së dhënies së Autoqefalisë, e aq më pak të kërkesës së saj. Ndaj, arsyetimi i Xhuvanit se Kisha ishte autoqefale prej vitit 1912, edhe pse shpallja do të bëhej 10 vite më vonë, bazohej në parimin "Kishë e

Visar Xhuvani i rrëfeu Atë Vasil Markut, gjatë pushimit të mbledhjes, se kishte përgatitur planin B, nëse Patriarkana nuk do të pranonte autoqefalinë. Ai kishte takuar përfaqësues të Kishës Serbe dhe kishte marrë premtimin se ajo do të dërgonte dy episkopë që më pas do të dorëzonin kryepriftërinjtë shqiptarë.[397] Mirëpo, Patriarkana dërgoi Mitropolit Jakovin në Beograd për të biseduar me drejtuesit qeveritarë dhe kishtarë serbë, duke parandaluar zhvillimet.[398]

Qendra e Kishës Autoqefale Shqiptare solli mjaft kundërshti. Fuqiplotë të ndryshëm sugjeruan Beratin, Tiranën, Gjirokastrën dhe Korçën. Përfundimisht, u vendos Korça, me kërkesë të Pal Xhumarit, i cili renditi veprat e shkëlqyera kombëtare kishtare të saj.[399]

Përplasja e madhe do të lindte të nesërmen mbi anëtarët e Këshillit të Lartë Kishtar. Visari kishte krijuar pakënaqësi nga kryeneçësia e treguar në mbledhjen e parë. Ai kishte marrë përsipër të shpallte autoqefalinë dhe ishte shprehur ngado se kishte mbështetjen qeveritare për të kryesuar kishën.[400] Fanolistët këmbëngulnin në zgjedhjen e Atë Vangjel Çamçes si kryetar të Kishës. Zyrtarët qeveritarë u shprehën fillimisht për Atë Josifin. Përzgjedhja e parapëlqyer, Arkimandrit Visari, kishte humbur përkrahjen nga fuqiplotët, edhe pse ai fajësonte prefektin dhe kryetarin e Bashkisë për këtë dështim.[401]

Qeveria dhe fanolistët u pajtuan që Atë Vasil Marko të zgjidhej në krye të Këshillit të Lartë Kishtar. Marko nuk mund të bëhej episkop, pasi ishte i martuar, në ndryshim nga Çamçe. Kjo duhet të jetë arsyeja përse Visari pranoi kryesimin e Kishës nga Atë Vasili, në pamundësi për t'u zgjedhur vetë. Këshilli i Lartë Kishtar do të përbëhej nga nëntë anëtarë: kryetari, nga një anëtar klerik dhe nga një laik për çdo qark kishtar. Anëtarët klerikë do të luanin rolin e zëvendësmitropolitit, deri në ardhjen e episkopëve. Arkimandrit Visari u mjaftua me zgjedhjen anëtar klerik dhe

---

pavarur, në shtet të pavarur". Madje, nuk ka asnjë rast të vetëm që Autoqefalia të jetë pasojë e një kërkese zyrtare të një Sinodhi vendor. Autoqefalia u shpall në Greqi me dekret, nga një mbret protestant, pas një mbledhjeje të disa arkimandritëve, edhe pse kishte dhjetra episkopë në mbarë Greqinë. Patriarkana Ekumenike i dha Tomosin pas njëzetë viteve, mirëpo kjo u quajt nga Kisha e Greqisë si "njohje" e autoqefalisë dhe jo si "shpallje" (Faqja zyrtare e Kishës Greke e quan veten "të njohur" me Tomosin e vitit 1850, porse autoqefale prej vitit 1833. htp: //www. ecclesia. gr/grek/monshrines/megaspilaion5. html; Vetëm pak autorë e vlerësojnë kundërkanonike shpalljen e vitit 1833, si Emanuil Kostandinidhis, *Η ανακηρυξις του αυτοκεφαλου της εν Ελλαδι Εκκλησιας (1850) και η θεσις των μητροπολεων των Νεων Χωρων (1928) [Shpallja e autoqefalisë së Kishës në Greqi (1850) dhe vendi i mitropolive të vendeve të reja]* (Athinë: 1974), 13-45. Edhe KOASH theksonte deri në vitin 1967 se ishte "shpallur" autoqefale më 1922 dhe "njohur" më 1937, diçka që do të ndryshonte pas vitit 1991, ku drejtuesit e rinj e përkujtojnë si Kishë Autoqefale vetëm pas 1937). Kongresi i Beratit u thirr si një kongres kleriko-laik, në kushtet e mungesës së episkopëve (në ndryshim nga rasti grek ku kishte episkopë dhe ata nuk u mblodhën) dhe për të shmangur keqkuptimet, pasi ortodoksët nuk ishin shumicë në Shqipëri (edhe pse në rastin grek autoqefalia u dekretua nga një Mbret protestant). Autoqefalia e Kishës Shqiptare është ndoshta rasti i vetëm që ka një arsyetim të plotë kanonik që çoi në Kongresin e Beratit. Kjo e bën atë jo domosdoshmërisht të saktë, porse doemos një pjesë të veçantë të së drejtës kanonike. Ndërkaq, Aurela Anastasi arsyeton se përkohshmëria e këtij statuti dhe njohja e së drejtës ekskluzive të Sinodhit dhe të episkopëve për një sërë veprash dhe vendimesh dëshmon për rregullsinë ligjore të Kongresit të Beratit dhe të Statutit të tij. Aurela Anastasi, "Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe evoluimi i tij", *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare* (Tiranë: Instituti i Historisë, 1993), 54-55.

[397] AQSH, Theodhosi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, cit.

[398] Glavinas, "Mitropoliti i Durrësit", 70.

[399] Naska, "Kongresi Themeltar ...", 16.

[400] AQSH, Theodhosi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, cit.

[401] Po aty.; AQSH, Prodani drejtuar MPB, cit.

zëvendësmitropolit i Durrësit. Atë Vasil Marko kërkoi zgjedhjen e Xhuvanit Mitropolit të Durrësit dhe dorëzimin e tij sapo të gjendeshin dy episkopë të tjerë, pasi u udhëzua nga qeveria.[402]

Atë Josif Qirici u zgjodh anëtar klerik për Korçën, Atë Anastasi për Beratin, ndërsa anëtari klerik për Gjirokastrën do të zgjidhej pak ditë më vonë Atë Pano. Mësuesi Dhosi Havjari u zgjodh anëtar laik në Korçë, Stathi Kondi në Gjirokastër, Simon Shuteriqi në Durrës dhe Tol Arapi në Berat.[403]

Kongresi hartoi statutin dhe rregulloren, nisur nga skica të paraqitura nga Arkimandrit Visari. Statuti u miratua më 17 shtator. Ai përcaktonte se Kisha Orthodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë ishte e pandarë nga Kisha e Përgjithshme Apostolike Ortodokse. Ajo përbëhej nga ortodoksët e shtetit shqiptar dhe sundohej nga episkopët e rregullt dhe Gojëdhënat e Shenjta. Kisha drejtohej nga Mitropoliti dhe ndahej në pesë episkopata, të drejtuara nga episkopë. Ata përbënin Sinodhin e Shenjtë, që qëndronte në kryeqytet. Kisha do të drejtohej nga Këshilli i Lartë, derisa të zgjidheshin kryepriftërinjtë. Këshilli i Lartë detyrohej të sillte së paku dy episkopë shqiptarë nga Patriarkana Ekumenike ose kisha të tjera brenda dy viteve. Po ashtu, ngarkohej të niste bisedimet me to për njohjen zyrtare. Episkopët që do të vinin do të ishin *ipso jure* anëtarë të Këshillit të Lartë duke u betuar me ndërgjegje kryepriftërore para Perëndisë për besnikëri ndaj shtetit dhe Kishës.[404]

Statuti përcaktonte që gjuha e kishës ishte shqipja. Mirëpo, vazhdimi i meshimit në gjuhët e deriatëhershme lejohej përkohësisht, duke qenë se mungonin përkthimet dhe disa priftërinj nuk ishin të stërvitur me gjuhën kishtare shqipe. Paqësorët, Ungjilli dhe Ati Ynë do të meshoheshin detyrimisht në shqip, me aq sa ishte e mundur.[405] Këshilli Kishtar do të njihte librat shqip të përdorur deri atëherë dhe do të botonte libra të rinj. Pika 11 përcaktonte se episkopatat e shtetit shqiptar do të bashkoheshin me trevat e episkopatave, qendrat e të cilave kishin mbetur jashtë Shqipërisë. Kjo solli që një pjesë e Kolonjës dhe një pjesë e Devollit që ishin pjesë të Mitropolisë së Velës të bashkoheshin me Korçën; ndërsa Shkodra dhe Dibra të bashkoheshin me Durrësin. Neni i fundit i statutit caktonte se të gjitha nenet, përveç 1 dhe 11, do të ishin në fuqi derisa të krijohej Sinodhi Episkopal, i përbërë prej katër episkopësh. Një Asamble Kishtare do të mblidhej tre muaj nga ngritja e tij për të miratuar statutin dhe rregulloren përfundimtare.[406]

Kongresi miratoi rregulloren e Kishës, po atë ditë. Neni 1 ndante Kishën në katër episkopata, sipas mitropolive të deriatëhershme. Ato do të sundoheshin sipas rregulloreve të Patriarkanës: zëvendësitë lokale do t'i drejtoheshin zëvendësmitropolitit dhe ky i fundit Këshillit të Lartë. Këshilli kishte të drejta për të mbrojtur gjithçka që ishin fuqi ligjore e gjykatave kishtare, sipas ligjeve të shtetit. Mbledhjet e Këshillit drejtoheshin nga kryetari ose nga ai që e pasonte në shkallë kryepriftërore, në rast mungese. Mbledhjet duhet të kishin më shumë se gjysmën e anëtarëve dhe vendimet duhet të miratoheshin me shumicë; në rast barazie fitonte ana e kryetarit. Anëtari i Këshillit shpallej i rrëzuar nëse mungonte pa shkak në të dyja mbledhjet vjetore. Punonjësit e Kishës emëroheshin nga

[402] AQSH, Theodhosi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, cit.
[403] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 192.
[404] KOASH, *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë* (Korçë: Dhori Koti, 1923).
[405] Përkthimet e deriatëhershme ishin rrjedhojë e punës së Arkimandrit Theofan Nolit, i cili kishte përkthyer një pjesë të rëndësishme të teksteve liturgjike nga viti 1908 deri në vitin 1914. Shih edhe Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë: Nga bujtja e Nolit tek zhvarrosjet e Përmetit* (Tiranë: Globus R., 2006), 1-22.
[406] KOASH, *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë* (Korçë: Dhori Koti, 1923).

kryetari. Arkëtari përbënte përjashtim, pasi zgjidhej nga Këshilli. Ai nuk kishte të drejtë të kryente pagesa pa nënshkrimin e kryetarit, ndërsa kryetari nuk kishte të drejtë të urdhëronte pagesa jashtë buxhetit pa vendim të Këshillit. Neni i fundit përcaktonte pagesat e anëtarëve të këshillit dhe të të gjithë trupës së Kishës.[407]

Ministria e Jashtme kishte goditur në shenjë para një muaji dhe ndante kënaqësinë e rrjedhojave të atij gjykimit me ministrin e Brendshëm, Ahmet Zogun. Ministri shkruante më 14 shtator se analet kombëtare do ta shënonin rëndësinë e ngjarjes dhe falënderonte Zogun për punën e tij në këtë vepër kombëtare.[408] Këshilli i Ministrave vendosi njohjen e vendimeve të kongresit, më 18 shtator.[409] Prefekturat u lajmëruan menjëherë për gjendjen e re kishtare.[410]

Kisha Shqiptare njoftoi patriarkanat, kishat autoqefale dhe mërgatat shqiptare. Atë Josifi nënshkruante telegramin që lajmëronte se Kongresi Kishtar shpalli njëzëri dhe i ngazëllyer Kishën Autoqefale Orthodokse Kombëtare të Shqipërisë.[411] Patriarkanat dhe kishat ortodokse njoftoheshin se kisha qeverisej e pavarur, por mbetej e lidhur shpirtërisht me të gjitha kishat autoqefale dhe Kishën e Madhe Ekumenike.[412] Shteti shqiptar ishte aq i varfër, sa as lajmërimin nuk mund ta kryente shpejt. Ministria e Jashtme arsyetonte më 25 shtator se ishte shtrënguar që lajmërimin ta bënte me pak fjalë, duke përmendur vetëm shpalljen e Kishës, meqenëse telegramet kushtonin tepër. Ndaj, Atë Josifi u lut të dërgonte letra për sqarime të mëtejshme. Letra me arsyet e detajuara të vendimit do të mbërrinte në dyert e Kishave Autoqefale dhe mërgatave vetëm pas një muaji.[413]

Brishtësia e një shteti që nuk mundej as të dërgonte telegrame pa numëruar fjalët tregon se kjo fitore ishte e madhe dhe e arritur për shkak të rrethanave ndërkombëtare. Mitropoliti i Trapezundës e më pas Kryepiskop i Athinës, Krisanthos, arsyetonte pak vite më vonë se Patriarkana Ekumenike jepte asokohe betejën e ankthshme të mbijetesës dhe Greqia ndodhej e shkatërruar nga gjëma e Azisë së Vogël, pa fuqi a denjësi që të ndikonte.[414] Çasti i duhur i dha përparësinë shtetit shqiptar të shpallte autoqefalinë. Mirëpo, beteja veçse kishte filluar...

Kisha Ortodokse në Shqipëri shihte se si episkopët iknin e vinin prej vitit 1900. Mitropolitë qëndronin pa kokë shumicën e kohës dhe kur kishin drejtues, mitropolitët merreshin me punët e shtetit grek më shumë sesa me çështjet kishtare. Ndaj, Këshilli i Lartë Fetar përballej me sfidën e ngritjes së një ngrehine të tërë, që i mungonte Kishës prej 20 vitesh. Frika se mos një pjesë e priftërinjve kundërshtonte vendimet e kongresit doli e pathemeltë. Mitropolia e Korçës u bë e para që mblodhi të gjithë priftërinjtë rreth Kishës Autoqefale. Ata meshuan së bashku më 8 tetor 1922. Grekomanët habitën zyrtarët vendorë, duke u bashkuar me nismën kombëtare. Prefekti i Korçës njoftonte se përpiqej

[407] Xhuvani, *Vepra*, 150.
[408] AMPJ, D. 186, f. 15, MPJ drejtuar MPB, 14 shtator 1922.
[409] AQSH, F. 155 "Ministria e Drejtësisë", V. 1922, D. 5, f. 1, VKM nr. 809, 18 shtator 1922.
[410] AQSH, F. 141 "Mitropolia Korçë", D. 436, f. 9, Qarkore e MPB, 24 shtator 1922.
[411] AMPJ, V. 1922, Dosja 186, f. 25-32, Telegram i Kongresit të Beratit, 24 shtator 1922.
[412] AMPJ, V. 1922, Dosja 186, f. 18, Telegram i Kongresit të Beratit, 18 shtator 1922.
[413] AMPJ, V. 1922, D. 186, f. 21, MPJ drejtuar MPB, 25 shtator 1922.
[414] Gjeorgjios Tasudhis, *Βιογραφικαί αναμνήσεις του Αρχιεπισκόπου Αθηνών Χρύσανθου του από Τραπεζούντος: 1881-1949 [Kujtimet biografike të Kryepiskopit të Athinës Krisanthosit nga Trapezunda: 1881-1949]* (Athinë: Kostandinidhi & Mihala, 1970), 29.

butësisht të fitonte zemrat e tyre.[415] Anëtarët e Këshillit të Lartë u thirrën sërish në Korçë, më 2 dhjetor, për të biseduar mbi vështirësitë e Kishës.[416] Ringritja e shpejtë bënte besimplotë Atë Vasil Markon. Ai mendonte se trupëzimi i Sinodhit mund të kryhej brenda 6 muajsh, pa pritur dy vjet, siç parashihte statuti. Qeveria e miratoi këtë mendim dhe i dha Atë Vasilit pëlqimin që të vepronte.[417]

Përplasjet e vetme ishin të brendshme, gjatë muajve të parë. Fanolistët nuk kursenin asnjë çast për të treguar epërsinë e Nolit.[418] Mëria që krijuan ndaj Visarion Xhuvanit nuk vonoi të shfaqej. Arkimandriti ishte zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë, por gjendja kishte ndryshuar. Përfaqësuesi laik i Mitropolisë së Durrësit në Këshillin e Lartë Kishtar, Simon Shuteriqi, kundërshtoi i pari. Ai u kërkoi pleqësive kishtare të qarkut të zgjidhnin një tjetër zëvendësmitropolit në vend të Xhuvanit. Pleqësitë zgjodhën Atë Dhimitër Dhimitrukën. Durrësi ishte i fundit nga pesë pleqësitë që rrëzoi Arkimandrit Visarin. Xhuvani fajësonte Shuteriqin dhe Atë Vasil Markon për marrëveshje të fshehtë. Ai kundërshtonte rrëzimin me votë të lirë, duke thënë se asnjë anëtar i këshillit nuk do të zgjidhej nëse do të pyeteshin pleqësitë kishtare, prandaj diçka e tillë iu la në dorë fuqiplotëve të Kongresit.[419]

Xhuvani shkoi në Korçë në mesnëntorin 1922 për të marrë pjesë në punimet e Këshillit të Lartë. Shtypi fanolist e priti ftohtë, pa kursyer vërejtjet. "Koha" nënqeshte se Korça plakë kishte parë shumë si Xhuvani, po i kishte "përcjell me limonj".[420] Atë Vasil Marko nuk e pranoi në mbledhjet e këshillit, duke e shpallur të shkarkuar. Visari pandehte se qeveria do të ndërhynte. Mirëpo, zyrtarët nuk dëshironin të krijonin përçarje dhe ftohje të fanolistëve. Prandaj, arkimandriti iu drejtua miqve të vjetër. Mbështetja më e fortë i erdhi nga Shpati. Kryepleqtë e fshatrave të trevës kërkuan riemërimin e Arkimandrit Visarit, si zëvendësmitropolit i Durrësit. Edhe lagjja e Shën Kollit në Elbasan mori në mbrojtje Arkimandritin, duke u shprehur më 18 nëntor se nuk përfaqësohej nga Lagjja Kala e qytetit. Në fund, mbi 100 besimtarë nga Lagjja Kala, mes të cilëve emra të njohur si Aleksandër Xhuvani, Dhimitër Taja, Jeftimi Buda, Jan Nosi etj., dolën kundër vendimit të pleqësisë. Kërkesat nuk morën përgjigje. Këshilli i Lartë Kishtar vendosi të mos pranojë asnjë anëtar klerik nga Mitropolia e Durrësit sa të zgjidhej mosmarrëveshja.[421]

Durrësi nuk ishte vendbeteja e vetme. Gjendja ishte e ngjashme në qarkun kishtar të Drinupojës. Këshilli kishte emëruar Atë Pano Gjirokastrën zëvendësmitropolit për të fuqizuar parinë atdhetare. Zgjedhja solli grindje, që u ashpërsua kur zëvendësmitropoliti takoi anëtarët e Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve. Atë Pano ishte shprehur se meshimi në shqip do të ishte i detyruar për të krishterët shqipfolës. Sipas Komisionit, prifti kishte pranuar se ata që donin shqipen në kishë ishin shumë pakë, pasi shumica e të krishterëve dhe myslimanëve ishin nën ndikimin e të huajve.[422]

Inspektori i administratës, Vasil Dilo, kërkoi në emër ortodoksëve të qytetit zëvendësimin e menjëhershëm të Atë Panos dhe djalit të tij, që ishte inspektor i

[415] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 538, f. 48, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 18 tetor 1922.
[416] "Andej-Këndej", *Koha* nr 108, 2 dhjetor 1922, 3.
[417] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 1177, f. 26, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 20 janar 1923.
[418] "Kisha Autoqefale dhe Pishkop Theofan Noli", *KOHA* nr. 109, 9 dhjetor 1922, 2.
[419] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 23
[420] *Koha* nr. 106, 18 nëntor 1922, 2.
[421] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 36
[422] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 70, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 14 shkurt 1923.

Arsimit.[423] Atë Vasil Marko nuk pranoi ta merrte parasysh kërkesën. Ai fajësoi si shkaktar të ngjarjes përkthyesin e Komisionit, njëherazi bashkëpunëtor i Vasil Dilos. Marko theksonte se Atë Pano ishte ndër të parët në lëvizjen kishtare dhe kombëtare në Gjirokastër që përpara pavarësisë. Sipas tij, zëvendësmitropoliti nuk kishte diturinë dhe dhelpërinë e kundërshtarëve. Ai shprehej se Atë Pano mund të zëvendësohej me dikë tjetër që do të kishte më tepër njohuri, por jo më tepër atdhetari.[424]

Ministria e Brendshme ia la në dorë Atë Vasilit zgjidhjen e çështjes dhe njoftoi se do të vijonin hetimet për Vasil Dilon.[425] Atë Vasil Marko kërkoi dorëheqjen e Atë Panos në fillimmars dhe e zëvendësoi me priftin pogradecar, Atë Thanas Nikolla. Vendimi erdhi pasi u vlerësua nga zyrtarët vendorë se prania e Atë Panos krijonte përçarje me grekomanët e fshatrave përreth Gjirokastrës.[426] Zgjidhja e dy çështjeve mundësoi fuqizimin e brendshëm të Kishës. Çështjet e rëndësishme që kishin mbetur: njohja e autoqefalisë dhe plotësimi i Sinodhit ishin pikat kryesore të veprimtarisë së Këshillit të Lartë dhe shtetit shqiptar.

2.3.Luhatja e Patriarkanës: Bekimi fillestar dhe mosnjohja zyrtare

Mitropolit Jakovi e përshëndeti fillimisht Kongresin e Beratit. Ai i dërgoi një telegram nismëtarit Kostë Paftali më 14 shtator, ku kërkonte paraqitjen e vendimeve të kongresit para Patriarkanës.[427] Shtypi parashtronte se Jakovi mbështeste autoqefalinë me anë të letrës, çka do të provohej e pavërtetë.[428]

Ndërkaq, Mitropoliti i Drinupojës, Vasili, u ankua në Lidhjen e Kombeve se kryetarë myslimanë bashkish të shtyrë nga qeveria organizuan një kongres laikësh ortodoksë për krijimin e një kishe autoqefale. Vasili arsyetonte se veprimi ishte kryer në mënyrë që shteti mysliman shqiptar të nënshtronte Kishën. Ai njoftonte Lidhjen se përfaqësues të vërtetë të ortodoksëve në Shqipëri ishin vetëm mitropolitët, të gjithë të dëbuar nga Atdheu. Vasili, shqiptar nga Labova, kundërshtoi edhe përfshirjen e gjuhës shqipe në meshim si një gjuhë e pagdhendur, e cila ishte përjashtuar edhe nga xhamitë e myslimanëve.[429]

Qeveria shqiptare u përgjigj se nisma e kongresit ishte e kryetarit ortodoks të Bashkisë së Durrësit, Kostë Paftalit. Ajo tha se nuk ishte marrë ndonjëherë me çështje fetare dhe për këtë citoi një qarkore të dërguar nga Ahmet Zogu, që rrëfente paanshmërinë qeveritare. Çështja e zëvendësmitropolitit të Gjirokastrës, Thanas Duka, ishte më e brishta. Qeveria shprehej se u detyrua të ndërhynte pasi u krijuan dy palë dhe rrezikoheshin trazira.[430]

---

[423] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 26, Vasil Dilo drejtuar MPB, 3 shkurt 1923.
[424] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 71, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 15 shkurt 1923.
[425] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 72, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 16 shkurt 1923.
[426] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 28-29, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 28 shkurt 1923.
[427] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 53, Mitropolit Jakovi drejtuar Bashkisë Durrës.
[428] *Koha* nr. 100, 7 tetor 1922, 2.
[429] Roberto Morozzo della Rocca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, (Tiranë: Elena Gjika, 1994), 53-54.
[430] AMPJ, V. 1922, D. 102 f. 38-39, MPB drejtuar MPJ, 12 nëntor 1922.

Nga ana tjetër, Ministria e Jashtme udhëzoi Këshillin e Lartë të përgjigjej për pjesën kishtare të ankesës së Vasilit.[431] Atë Vasil Marko mbrojti ligjshmërinë dhe gjithëpranueshmërinë e shpalljes së autoqefalisë, në letrën drejtuar Lidhjes së Kombeve. Ai citoi kanonet dhe parimet kishtare që kishin çuar në kongres dhe tëhuajti mendimet se qeveria kishte ndikuar në vendim. Marko përfundonte se Mitropolit Vasili po fliste në kundërshti me dobinë dhe dashjen e njëzëshme të bashkëkombasve shqiptarë.[432]

Italia e mbështeti shpalljen e autoqefalisë, si një mënyrë që sillte zvenitjen e stërfaljes dhe çonte në bashkëpunim mes feve.[433] Njëherazi, italianët trembeshin nga çështjet politike që lindnin nga ndërlikimet fetare dhe dyshonin se çështja kishtare mund ta çonte Shqipërinë më afër Jugosllavisë.[434]

Pandeli Evangjeli parashtronte nga Gjeneva kundërveprimet greke dhe pritshmërinë e kombeve të tjera. Ai kërkonte ndërhyrje nga qeveria shqiptare, pas botimeve të shumta në shtypin ndërkombëtar.[435] Greqia ishte tërësisht kundër autoqefalisë. Përfaqësuesi i saj në Gjenevë u sigurua nga i dërguari i Patriarkanës se autoqefalia nuk do të njihej.[436]

Patriarkana Ekumenike vendosi krijimin e një komisioni që do të shqyrtonte çështjen shqiptare më 11 shtator. Kryetar u zgjodh Mitropoliti i Rodhit, ndërsa anëtarë ishin ish kryepriftërinjtë e katër qarqeve shqiptare.[437] Mitropolitët u lajmëruan më 15 shtator. Anëtar ishte edhe ish-kryeprifti i Beratit, Joakim Martishti, shqiptar nga Voskopoja.[438] Ai vendosi në dijeni anëtarin e Këshillit të Lartë të Shtetit, Sotir Peci, të cilin e kishte mik.[439] Joakimi rendi në zyrën e Konsullatës Shqiptare, sapo mbërriti në Stamboll. Ai i tha konsullit Leskoviku se Komisioni kërkonte dërgimin e një pleqësie të zgjedhur nga ortodoksët e Shqipërisë. Vetëm Jakovi ishte shfaqur kundër autoqefalisë, ndërsa anëtarët e tjerët ishin pro.[440]

Ish-mitropoliti i Beratit ritakoi konsullin pas tri javësh. Ai shoqërohej nga një episkop tjetër shqiptar, Jerotheu i Militupojës. Joakimi e njoftoi Leskovikun se Jerotheu ishte ngarkuar të vizitonte Shqipërinë dhe të merrej vesh me qeverinë dhe deputetët e krishterë, si përfaqësues të ligjshëm të ortodoksëve në Shqipëri. Leskoviku iu përgjigj se do ta vizonte pasaportën e Jerotheut, meqënëse ishte shqiptar. Po ashtu, i shpalli se qeveria shqiptare nuk merrej me çështje fetare, duke qenë se ishte qeveri kombëtare. Joakimi u largua, pasi e siguroi se Patriarkana ishte pro autoqefalisë.[441]

Hirësi Jerotheu ishte lindur në Çarshovë të Përmetit me emrin Janaq Andon Jaho. Ai kishte kryer shkollën fillore në Korçë, përpara se të ikte në Greqi e më pas në

---

[431] AMPJ, V. 1922, D. 102, f. 37, MPJ drejtuar MPB, 6 nëntor 1922.
[432] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 181 f. 23, Këshilli i Lartë Kishtar drejtuar Sekretarit të Lidhjes së Kombeve, 14 nëntor 1922.
[433] Della Rocca, *Kombësia dhe feja,* 53-54.
[434] Çështja kishtare shqiptare ndiqej me kujdes nga pala italiane. Shih: AQSH, F. 163 "Legata Italiane", V. 1922, D. 13; e gjithë dosja voluminoze i kushtohet çështjes kishtare shqiptare.
[435] AQSH, F. 14 "Fan Noli", V. 1922, D. 208, f. 40-45, Evangjeli drejtuar MPJ, pa datë.
[436] Tritu, *Kisha në Ilirik,* 64.
[437] AQSH, F. 55 "Sotir Peci", D. 92, f. 12, Patriark Meleti drejtuar Mitropolit Joakimit, 15 shtator 1922.
[438] Për Joakim Martishtin: Apostolos Glavinas, "Ιωακείμ Μαρτίστης η Μαρτινιανός [Joakim Martishti ose Martiniani]", *Ηπειρωτικό Ημερολόγιο [Ditari Epirotas]* 3 (1981). (Janinë: IMIAX, 1981); Dr. Dion Tushi, "Joakim Martiniani", *Kërkim* nr. 6, (Tiranë: KOASH, 2010).
[439] AQSH, Patriark Meleti drejtuar Mitropolit Joakimit, cit.
[440] AMPJ, V. 1922, D. 186, f. 48, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 6 tetor 1922.
[441] AMPJ, V. 1922, D. 186, f. 53, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 4 nëntor 1922.

Kostandinopojë. Aty kishte përfunduar studimet në shkollën teologjike të Halkit në vitin 1907 dhe ishte dorëzuar Episkop ndihmës i Militupojës, nga vetë Patriarku.[442] Hirësi Jerotheu mbërriti në Korçë më 30 nëntor dhe u takua me zyrtarët vendorë, Këshillin e Lartë Kishtar dhe deputetët ortodoksë që kishin dalë ta prisnin. Ai u shpreh i ngazëllyer nga mbështetja popullore për autoqefalinë. Hirësia u takua edhe me konsullin grek, përpara se të merrte vendimin përfundimtar.[443] Prefekti i Korçës, Suma, shprehej i bindur se Episkopi nuk mund të shprehej kundër autoqefalisë, pas të gjitha takimeve, ngazëllimit popullor dhe patundësisë së Atë Vasil Markos.[444]

Hirësi Jerotheu lexoi shpalljen që njihte autoqefalinë e Kishës Ortodokse në Shqipëri, në Kishën e Shën Gjergjit, më 2 dhjetor 1922. Ai tha se qe dërguar për të vëzhguar dhe shkoqitur dëshirën e ortodoksëve të mitropolive të Shqipërisë. Jerotheu njoftoi se gjendja kishtare dhe dëshira e mbarë popullit ishte e qartë dhe e kthjellët, sipas vendimeve të Kongresit të Beratit dhe Statutit të KOASH-it. Hirësia përshëndeti zellin, dashurinë e nderin për Fronin Ekumenik dhe lëvdoi mosdaljen nga kufiri i kanoneve të shenjta. Ai bekoi me gjithë zemër vendimet e kongresit, me fuqinë që buronte nga cilësia vetjake dhe dërgimi patriarkal. Jerotheu përfundoi me besimin se Kisha e Madhe e Krishtit do ta njihte me urime dhe bekime bijën e saj, Kishën Ortodokse të Shqipërisë. Sipas tij, kjo ishte dëshira edhe e Patriarkut Meletit IV. Episkop Jerotheu i dërgoi Patriarkut Ekumenik një kërkesë zyrtare për pranimin e autoqefalisë, pak ditë më vonë. Po ashtu, kërkoi dërgimin e një episkopi tjetër shqiptar që gjendej në Stamboll, Hirësi Kristofor Kisit, për ta ndihmuar në ngritjen e Sinodhit të Shenjtë të KOASH-it.[445]

Hirësi Kristofori ishte lindur në Lagjen Kala të Beratit, në vitin 1882, me emrin Sotir Kisi.[446] Ai përfundoi Shkollën Teologjike të Halkit në vitin 1908 dhe u emërua profesor në gjimnazin Jovan Banga në Korçë. Mirëpo, nuk do të qëndronte shumë në Shqipëri dhe do të rikthehej në Stamboll. Ai u dorëzua dhjak më 20 prill 1910, duke marrë emrin Kristofor dhe episkop i Sinadhonit më 2 nëntor 1917.[447] Hirësi Kristofori u përgjigj se ishte i gatshëm t'i bashkohej përpjekjes për ngritjen e KOASH-it, kur u lajmërua mbi ngjarjet. Ai e kishte të pamundur të mbërrinte në Shqipëri përpara shkurtit, për shkak të punëve të pambyllura në Stamboll. Kisi shprehej se ishte më shumë i nevojshëm si ndërmjetësues me zyrtarët e Patriarkanës, deri në shkurt. Në çdo rast, ai shpallte gatishmërinë ta linte Stambollin nëse zyrtarët shqiptarë nguteshin në përvijimin e çështjes kishtare.[448]

Joakim Martishti u hidhërua. Ish-mitropoliti i Beratit ishte përpjekur të bindte kryepriftërinjtë e tjerë ta emëronin Mitropolit të Korçës. Ai kishte kërkuar edhe mbështetjen e korçarëve në Stamboll dhe kishte ndikuar në përzgjedhjen e Jerotheut si ekzark. Joakimi nisi të kundërshtonte ashpërsisht Episkopin e Militupojës, duke kërkuar të dërgohej vetë si ekzark, kur u pa se Jerotheu thirri Kristoforin.[449]

---

[442] Ilia S. Vasili, "Si e gjeta Episkop Jerotheos", *Ngjallja* Nr. 8, gusht 1996, 9.
[443] *Koha* nr. 108, 2 dhjetor 1922, 3.
[444] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 53, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 30 nëntor 1922.
[445] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1922, D. 53, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 12 dhjetor 1922.
[446] "Personalitet madhor i Kishës sonë Orthodhokse: Imzot Kristofor Kisi", *Ngjallja* nr. 7, korrik 1996, 9.
[447] Apostol Glavina, "Ο Συναδών Χριστόφορος και οι δραστηριότητες του για το εκκλησιαστικό ζήτημα της Αλβανίας [Kristofori i Sinadhon dhe veprimtaria e tij në zgjidhjen e çështjes kishtare të Shqipërisë]", *Ηπειρότηκο Ημερολόγιο [Ditari Epirotas]* 2 (1984): 69-103.
[448] Glavinas, "Kristofori i Sinadhon", 71-72.
[449] Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 74.

Hirësi Jerotheu nisi me zell punën e fuqizimit dhe bekimit të KOASH-it. Ai ngriti Atë Vangjel Çamçen në rangun e Arkimandritit, më 15 dhjetor, vetëm dy ditë pasi mbërriti në Korçë. Kështu, Çamçe ishte përgatitur për t'u zgjedhur episkop.[450]

Veprimet e ekzarkut bindën qeverinë shqiptare se çështja ishte drejt zgjidhjes përfundimtare dhe të shpejtë. Ministria e Brendshme gjykonte se bekimi i Jerotheut për vendimet e Kongresit të Beratit i buronin nga zemra, por edhe nga bindja se Patriarkana do ta njihte Kishën Shqiptare. Për këtë arsye, ajo udhëzoi Ministrinë e Jashtme t'i njoftonte të gjitha legatat se kisha pritet të njihej nga çasti në çast.[451]

Patriarku Ekumenik Meleti i kërkoi Jerotheut të kthehej sa më shpejt në Kostandinopojë, më 3 shkurt 1923. Ai ftonte një përfaqësues prej secilës prej katër mitropolive për të biseduar çështjen nga afër.[452] Kërkesa nuk u pranua nga Jerotheu, pas këshillimit me zyrtarët shqiptarë. Hirësia iu përgjigj Patriarkut më 7 shkurt se Kisha në Shqipëri drejtohej nga Atë Vasil Marko dhe përfaqësuesit e zgjedhur ligjërisht dhe kanonikisht nga katër qarqet kishtare shqiptare. Ai arsyetonte se zgjidhja e vetme ishte dërgimi i një përfaqësie të Kishës Autoqefale në Kostandinopojë. Ndërkaq, jo vetëm që vetë duhet të rrinte në Korçë për çështje me rëndësi, por kërkonte të dërgohej sa më shpejt edhe Kristofor Kisi. [453] Patriarkana e pranoi arsyetimin. Ajo kërkoi një dërgatë të përbërë nga ortodoksë të shquar, mes të cilëve doemos deputetë të krishterë. Patriarku vijonte të mendonte se Jerotheu duhet të shkonte sa më shpejt në Stamboll. Sidoqoftë, Episkopi duhet të dërgonte një parashtresë të shkoqitur me anë të dërgatës, nëse qëndrimi në Korçë ishte i domosdoshëm.[454]

Sinodhi i Shenjtë bisedoi mbi çështjen shqiptare më 24 shkurt. Joakimi foli gjatë pro autoqefalisë. Ai i shprehu Jerotheut po atë ditë se çështja kishtare do të merrte fund sipas dëshirës së Atdheut të shumëvuajtur. Joakimi udhëzonte nisjen e dërgatës.[455] Kristofor Kisi kishte të njëjtën përshtypje. Ai i sugjeroi Jerotheut që nisja të kryhej sa më shpejtë.[456]

Mirëpo, gjendja kishte ndryshuar kryekëput. Tulatja e Greqisë ishte drejt fundit. Anëtarët kryesorë të qeverisë së Gunarisit dhe pasardhësit të tij ishin rrëzuar me grusht shteti, gjykuar, dënuar me vdekje dhe pushkatuar, në një rast të pashoq në Greqi. Një qeveri e re provenizeliste e ushtarakëve drejtues të luftës në Azinë e Vogël ishte vendosur, derisa vetë Venizelos të merrte zyrtarisht pushtetin. Këto zhvillime do të kishin pasoja edhe në çështjen kishtare shqiptare...

Lufta Greko-Turke do të përfundonte në Lozanë. Turqia sapo ishte krijuar nga hiri i Perandorisë Osmane dhe po bisedonte fundin e pranisë së huaj në tokën e vet. Grekët ishin dëbuar tërësisht nga Izmiri dhe u njëmendësuan shpejt me fituesin e luftës. Një milion e gjysmë ortodoksë të Turqisë do të këmbeheshin me pesëqind mijë myslimanë të Greqisë. Marrëveshja u pa me dobi nga të dyja shtetet dhe u miratua me të shpejtë më 30 janar 1923, teksa bisedimet ende vijonin në Lozanë.[457]

---

[450] *Koha* nr. 110, 16 dhjetor 1922, 2.
[451] AMPJ, V. 1922, D. 186, f. 56, MPB drejtuar MPJ, 28 dhjetor 1922.
[452] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 96, Patriark Meleti drejtuar Ekzark Jerotheut, 3 shkurt 1923.
[453] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 96, Ekzark Jerotheu drejtuar Patriark Meletit, 6 shkurt 1923.
[454] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 97, Patriarku Meleti drejtuar Ekzark Jerotheut, 9 shkurt 1923.
[455] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 98, Hirësi Joakimi drejtuar Ekzark Jerotheut, 24 shkurt 1923.
[456] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 32, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 27 shkurt 1923.
[457] Daskarolis, *Lëvizjet ushtarake*, 31-37.

Shkëmbimi i popullsisë nënkuptonte shumëçka për Greqinë dhe Turqinë; mirëpo për Patriarkanën Ekumenike do të thoshte gjithçka. Ajo do të zhdukej, nëse do të ndiqej parimi i deriatëhershëm i zgjerimit të trojeve kishtare sipas atyre shtetërore: Kisha e Greqisë do të zgjeronte kufijtë në Kretë, ishujt e Egjeut dhe në trojet e reja të Maqedonisë, Trakës dhe Epirit. Ndërkaq, Kisha në Shqipëri kishte shpallur autoqefalinë. Vetëm Turqia bashkëkohore do të mbetej në varësi të Patriarkanës së Kostandinopojës. Kjo do të thoshte se dëbimi i ortodoksëve nga Turqia shuante Patriarkanën. Zhvillimi solli një ndryshim të beftë. Trojet e Patriarkanës Ekumenike të përfshira në shtetin grek prej vitit 1913 nuk kaluan në varësi të Kishës së Greqisë. Sakaq, Sinodhi i Shenjtë në Athinë kaloi në varësi të Kishës Mëmë, përfaqësitë e ngritura në mërgatë, kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kisha e Aleksandrisë dhe Jeruzalemit, pra të gjitha kishat me kryepriftërinj grekë, do t'i kalonin qarqet kishtare të mërgatës në varësi të Kishës së Kostandinopojës, vitet në vijim. Vendimet u përligjën me sajimin se vetëm Patriarkana Ekumenike kishte të drejtë të krijonte qarqe kishtare në tokat ku nuk kishte Kishë Ortodokse. Ky parim nuk do të njihej nga asnjë kishë jogreke.[458]

Ringritja e Greqisë solli edhe ndryshimin e kursit të politikës në Athinë. Nevoja për të pasur ndikim në Kishën Ortodokse në Shqipëri e bënë të përkujdesej sërish për çështjen kishtare. Ajo kishte edhe një arsye shtesë për t'iu rikthyer rastit shqiptar: humbja e pranisë në Azinë e Vogël e bënte të vendosur që të ruante një bashkësi greke jashtë Greqisë.[459] I dërguari shqiptar në Lozanë, Mehdi Frashëri njoftoi dërgatat greke e turke se Patriarkana kishte njohur autoqefalinë e Kishës Shqiptare, duke u nisur nga fjalët e Episkop Jerotheut. Kaq mjaftoi për të përshpejtuar ngjarjet. Ndryshimi i beftë në Kostandinopojë rrëfen për një ndikim të jashtëm, edhe pse nuk kemi një shkresë që të vërtetojë se zyrtarët grekë ndërhynë për të shfuqizuar vendimin e shprehur zyrtarisht prej Jerotheut. Patriarkana Ekumenike u kundërpërgjigj ashpërsisht, nëpërmjet të dërguarit në Gjenevë, Mitropolitit Gjermanos. Patriarku Meleti njoftoi se Jerotheu ishte udhëzuar të rivendoste në Shqipëri mitropolitët grekë të dëbuar jashtëligjshmërisht dhe të njoftonte se autoqefalia në një shtet mysliman përbënte rrezik e duhej ndaluar me çdo mënyrë.[460]

Patriarkana u shfaq mosdashëse edhe për përdorimin e shqipes. Ajo nuk e quante herezi këtë herë, si mitropolitët grekë në fillesat e atij qindvjeçari. Mirëpo, thoshte se do ta lejonte shqipen vetëm në bashkësitë që do ta kërkonin zyrtarisht dhe me kusht lejimin e përdorimit të greqishtes ndër bashkësitë shqiptare që e dëshironin. Së fundmi, paralajmëronte se do të mundësohej vetëdrejtimi i Kishës, siç ndodhte me Mitropolitë e Kretës dhe të Amerikës, me parakusht rikthimin e mitropolitëve të dëbuar.[461]

Diplomacia shqiptare kishte arritur një fitore gjysmake. Ajo kishte dalluar në mënyrë të përsosur çastin e duhur të shpalljes së autoqefalisë. Kjo nuhatje kishte mundësuar vulosjen e ligjshmërisë së vendimeve të Kongresit të Beratit prej Ekzarkut të Patriarkut. Mirëpo, Patriarkana nuk e njohu autoqefalinë siç kishte paralajmëruar nëpërmjet Mitropol Joakimit dhe Episkop Jerotheut. Marrëveshja për shkëmbimin e popullsisë diku larg, solli mosnjohjen e autoqefalisë dhe përvijimin e çështjes për disa vjet.

---

[458] Përjashtim do të përbënte vetëm KOASH pas vitit 1990, që është kisha e vetme jogreke, e cila nuk ka qarqe kishtare në mërgatë.
[459] Meta, "Autoqefalia e Kishës Ortodokse Shqiptare në procesin...", 82.
[460] AMPJ, V. 1923 , D. 331 f. 10, Konsullata e Sofjes drejtuar MPJ, 25 shkurt 1923.
[461] Po aty.

Fati i dërgatës kishtare ishte paracaktuar. Ajo do të shkonte në Stamboll me kërkesën për autoqefali, ndërsa Patriarkana kishte shpallur paraprakisht se së shumti mund të pranonte vetëdrejtim. Sidoqoftë, sa më shpejt të bisedohej, aq më mirë do të ishte për palën shqiptare, çka nuk u shfrytëzua. Dërgata nuk u nis as në shkurt e as në mars. Mungesa e të hollave e pamundësoi udhëtimin. Ndërlidhësi mes Kishës dhe qeverisë, prefekti i Korçës, Suma, kërkonte me ngulm 20 mijë frangat e arit që nevojiteshin.[462] Ai tregonte rrezikun se vonesa e të hollave bënte të paarritshme mbërritja e dërgatës përpara 7 prillit, kur Sinodhi ndërpriste punët për shkak të pashkëve.[463]

Ndërkaq, Ministria e Punëve të Jashtme kërkonte ndihmën te shteti grek. Legata Shqiptare në Paris u udhëzua më 8 mars, të kërkonte ndërmjetësimin e Venizelosit, i cili ndodhej aty.[464] E njëjta kërkesë iu përcoll Legatës në Greqi për t'ia drejtuar qeverisë greke. Legata duhet t'u kujtonte zyrtarëve në Athinë se dobia thelbësore e Greqisë ishte pavarësia shqiptare në çdo pikëpamje dhe marrëdhëniet e mira mes të dyja shteteve.[465] Mirëpo, Mid'hat Frashëri nuk pranoi, pasi kishte kuptuar nga bisedimet jozyrtare se Greqia do të kërkonte dëmshpërblim të majmë për të ndërhyrë pranë Patriarkanës.[466]

Përfundimisht, dërgata u bë gati të nisej. Fillimisht, ishin parashikuar si anëtarë: Thoma Orollogai, Dhosi Havjari, deputetët Dhimitër Kacimbara dhe Kristo Qirka, dhe kryetari i Bashkisë së Korçës, Vasil Avrami.[467] Mirëpo, Këshilli i Lartë Kishtar kërkoi që ajo të drejtohej nga një prift dhe pikërisht nga kryetari Atë Vasil Marko.[468] Qeveria pranoi me kusht që Marko të linte pas një zëvendës të besueshëm.[469] Ai emëroi mëkëmbës Atë Josif Qiricin dhe dërgata u nis për në Kostandinopojë në fundmars. Mihal Grameno i përcillte nëpërmjet "Kohës" me urim për t'ia dalë mbanë dhe sigurinë se do të ktheheshin ngadhënjimtarë.[470]

Qeveria ishte e gatshme të përdorte çfarëdo mjeti. Ministria e Jashtme udhëzoi dërgatën të lajmëronte Patriarkanën se Kisha Shqiptare do të kalonte 200 mijë franga ari për përdorim të Kishës Mëmë, me pranimin e autoqefalisë.[471]

Dërgata mbërriti në Stamboll në mesprill, me detyrë të dyfishtë. Ajo ishte ngarkuar të bindte Kristofor Kisin të kthehej në Atdhe, përveçse të bisedonte me Patriarkanën mbi nevojën e dhënies së autoqefalisë. Patriarku priti përfaqësuesit shqiptarë, të shtunën, më 7 maj 1923. Atë Vasil Marko paraqiti vendimet e Kongresit të Beratit, si edhe dëshirën e shtetit shqiptar për të vijuar në ndërtimin e një Kishe Autoqefale, sikurse ishte vepruar në Greqi, Serbi dhe Rumani. Mirëpo, Patriarku nuk ishte i të njëjtit mendim. Ai kundërshtoi njësimin me shtetet e tjera, duke theksuar se Shqipëria nuk kishte shumicë ortodokse, çka do të mundësonte që ligjet e vendit të ishin në përputhje me dogmat fetare. Patriarku tha se e kaluara e Shqipërisë dëshmonte se

[462] Qeveria shpenzoi 22.400,96 franga ari, duke mbuluar të gjitha shpenzimet e dërgatës shqiptare. AQSH, F. 141 "Mitropolia Korçë", D. 462 , f. 8, Llogaritë e shpenzimeve, pa datë.
[463] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 36, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 7 mars 1923.
[464] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 47, Legata e Parisit drejtuar MPJ, 8 mars 1923.
[465] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 27, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, 12 prill 1923.
[466] AMPJ, V 1923, D. 143, f. 17, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 14 prill 1923.
[467] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 16, MPB drejtuar MPJ, pa datë.
[468] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 43, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 10 mars 1923.
[469] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 44, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 12 mars 1923.
[470] Mihal Grameno, *Koha*, 31 mars 1923, 3.
[471] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 25, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, 10 prill 1923.

ortodoksia shpëtoi pikërisht për shkak të lidhjes së kishave vendore me Patriarkanën Ekumenike.[472]

Ai njoftoi se autoqefalia nuk mund të jepej. Megjithatë, Kisha Mëmë ishte e gatshme të mundësonte vetëdrejtimin e Kishës Ortodokse në Shqipëri, duke qenë se shteti shqiptar ishte shpallur i pavarur. Patriarku paraqiti statutin e gatshëm që do të kishte "Kryepiskopata Orthodhokse e Shqipërisë". Pika e parë përcaktonte se Kryepiskopata do të themelohej mbi dogmat dhe kanonet apostolike dhe sinodhike dhe do të përmbante katër Mitropoli: të Durrësit, Korçës, Beratit dhe Gjirokastrës, që mund të shtoheshin sipas nevojave të mëvonshme. Pika e dytë emërtonte Mitropolitin e kryeqytetit "Kryepiskop i Gjithë Shqipërisë" me detyrë kryesimin e Sinodhit, të përbërë nga mitropolitët të qarqeve. Sinodhi kishte të gjitha fuqitë dhe përgjegjësitë e Sinodhit të Qarkut, duke qenë përgjegjës përpara Patriarkanës për ruajtjen e dogmave, sipas nenit tre. Mitropolitët do të përzgjidheshin nga priftërinjtë dhe populli i qarqeve kishtare, do të votoheshin nga Sinodhi dhe do të miratoheshin nga Patriarku. Ata duhet të ishin mbi 30 vjeç, me shkolle teologjike, me përvojë së paku pesëvjeçare si meshtarë dhe pjesëtarë të listës të së zgjedhshmëve të miratuar nga Sinodhi. Neni i gjashtë caktonte se Kryepiskopi dhe mitropolitët mund të shkarkoheshin vetëm me dorëheqje ose rrëzim, për të cilin mund të kundërshtonin pranë Patriarkut. Nenet shtatë dhe tetë u jepnin mitropolitëve të drejtat dhe përgjegjësitë e Episkopit, sikurse edhe të drejtuesve të gjykatave shpirtërore, vendimet e të cilave do të shqyrtoheshin përpara Sinodhit Kryepiskopal. Po ashtu, caktohej se Kryepiskopi do të kujtonte në meshë Patriarkun. Statuti ishte tërësisht ngurrues mbi mollën e sherrit të lëvizjes kishtare shqiptare. Gjuha e meshës do të vijonte të ishte gjuha e përdorur prej qindvjeçarësh, ajo e Ungjillit të Shenjtë, pra greqishtja. Shqipja do të lejohej krahas saj, sipas kushteve të caktuara nga Sinodhi, që do të përkthente librat e shenjtë. Së fundmi, statuti caktonte se nenet ishin të pandryshueshme dhe se çdo rregullore do të kishte fuqi vetëm nëse miratohej nga Patriarkana Ekumenike.[473]

Pala shqiptare e tëhuajti qëndrimin patriarkal. Arsyetimi se në shtete pa shumicë ortodokse nuk lejoheshin Kisha Autoqefale, nuk nisej nga e drejta kishtare. Në të vërtetë, vetë Patriarkana do të njihte pak muaj më vonë Kishën e Polonisë, që kishte vetëm 1 për qind ortodoksë, shumë më pak se Shqipëria me 20 për qind. Ndërkaq, statuti kishte brenda të gjitha arsyet përse Kongresi i Beratit shpalli autoqefalinë. Së pari, në të caktohej se episkopët do të miratoheshin nga Patriarku, diçka që nuk do të ndodhte as në Kishën e Kretës dhe as në atë të Amerikës, në më pak se katër vjet. Së dyti, statuti i jepte greqishtes vend parësor në Kishën në Shqipëri, ndonëse kërkesa kryesore e palës shqiptare ishte meshimi vetëm në gjuhën amtare. Së fundmi, Patriarkana detyronte që çdo rregullore të miratohej prej saj. I vetmi ndryshim ishte se në Shqipëri, njëri nga mitropolitët do të quhej Kryepiskop dhe do të drejtonte një Sinodh me fuqi sugjeruese.

Qeveria shqiptare ishte lajmëruar tri ditë më parë për skicën e paraqitur nga Patriarku. I dërguari i tij në Gjenevë, Kryepiskopi Gjermanos, ishte takuar me përfaqësuesin shqiptar, Benedikt Blinishtin. Gjermanos kërkoi nga qeveria shqiptare të ndërhynte pranë dërgatës që të mos këmbëngulte në autoqefali. Blinishti iu përgjigj se qeveria nuk përfshihej në çështjen kishtare, por vlerësonte kërkesat dhe dëshirat e

[472] "Kryepiskopata Orthodhokse Shqipërisë", *Ekklisiastiki Alithia*, 19 maj 1923, 4; ribotuar me të njëjtin titull në *Zëri i Gjirokastrës*, 7 korrik 1923, 2.
[473] Po aty.

ortodoksëve shqiptarë.[474] Patriarku i dërgoi një telegram edhe Kryeministrit Ahmet Zogu. Ai sqaronte se Kisha në Shqipëri do të ishte e vetëdrejtuar dhe Kisha Mëmë do të mbante vetëm ato detyra që ishin të domosdoshme për ruajtjen e kanoneve dhe dobisë së ortodoksisë.[475]

Ndërkaq, Patriarku thirri ngutshëm Episkop Jerotheun në Stamboll, duke e njoftuar se dërgimi i tij në Shqipëri kishte përfunduar.[476] Hirësi Jerotheu u dëshpërua. Ai nuk priste gjë tjetër veç autoqefalisë, që Patriark Meleti i kishte shpallur përpara se të nisej nga Stambolli. Çarja mes Episkopit të Militupojës dhe Patriarkanës ishte e madhe. Kryepiskopi Gjermanos fajësonte tejkalimin e detyrave dhe qëndrimin e padrejtë të Jerotheunt, si shkaktar për përkeqësimin e gjendjes.[477]

Mospranimi i palës shqiptare ishte i menjëhershëm. Atë Vasil Marko arsyetonte se Patriarkana nuk njihte vendimet e Kongresit të Beratit dhe si pasojë e kishte të pamundur pranimin e kundërsugjerimeve.[478] Dërgata shqiptare nuk kishte fuqi të plotë të shkonte përtej pikave të statutit të hartuar në Kongresin e Beratit. Kështu, rrugëzgjidhja e mbetur ishte gjetja e një episkopi tjetër që do të trupëzonte Kishën, duke dorëzuar krah Hirësi Jerotheut dy kryepriftërinj të tjerë. Gjithçka ishte lehtësuar, me sigurimin e ardhjes së Kristofor Kisit. Atë Vasil Marko pyeti Jerotheun, në cilësinë e teologut, nëse Patriarkana kishte të drejtë të ndërhynte, pas atij çasti. Jerotheu iu përgjigj se ajo nuk kishte të drejtë të mallkonte as atë e as Kishën Autoqefale. Kështu, gjithçka do të vijonte sipas planit të parashikuar në statut.[479]

Njëherazi, qeveria shqiptare përgatiti plane të tjera në rast nevoje. Nënkryetari i Sinodhit të Shenjtë të Bullgarisë, Mitropoliti Boris, i shprehu konsullit shqiptar gatishmërinë e tij për dorëzimin e kujtdo episkopi të përzgjedhur nga shteti, me kusht që të ishte i pranuar nga Kisha Shqiptare. Arkimandriti i Kishës Greke në Sofje ia kishte paraqitur qëllimin e Kishës Bullgare eprorëve të tij në Athinë. Borisi vlerësonte se kjo mund të shërbente për njohjen e Autoqefalisë nga Patriarkana.[480]

2.4. Veprimi i njëanshëm për krijimin e Sinodhit, 1923-1924

Marrëdhëniet shqiptaro-greke ishin drejt ripërcaktimit. Shoqatat vorioepirote kishin humbur ndikimin gjatë qeverisjes së Gunarisit. Mirëpo, ato u fuqizuan së tepërmi me kthimin e venizelistëve në pushtet. Zërat për zgjerim të Greqisë në kurriz të kufijve shqiptarë ishin shtuar, pas zhgënjimit në Azi. Megjithatë, qeveritarët grekë ishin të kujdesshëm në takimet me zyrtarët shqiptarë. Ministri i Jashtëm, Aleksandris ishte i biri i një shqiptari nga Llaka e Sulit. Ai i ishte përgjigjur pyetjes së Mid'hat Frashërit për gjeopolitikën e re të Greqisë, duke shtënë vëmendjen te rreziku sllav, imperializmi italian, komunizmi bolshevik dhe kërcënimi turk. Ministri grek u zotua për përfarimin e shpejtë mes dy kombeve.[481]

---

[474] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 60-64, Konsullata e Gjenevës drejtuar MPJ, 4 maj 1923.
[475] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 65-66, Patriarku Meleti drejtuar Ahmet Zogut, pa datë.
[476] *Koha* nr. 129, 12 maj 1923, 2.
[477] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 70-81, Raporti i K. Gjermanos drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë.
[478] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 56, Këshillit i Lartë Kishtar drejtuar MPJ, 7 maj 1923.
[479] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 4, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 20 maj 1923.
[480] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 90, Zyra e Pashaportave në Bullgari drejtuar MPJ, 28 qershor 1923.
[481] AMPJ, V. 1923, D. 142, f. 4-9, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 28 shkurt 1923.

Frashëri shihte me kureshtje kundërthëniet greke. Nga njëra anë, Mbreti Gjergji II e kishte habitur, kur i kishte shprehur dy herë dëshirën për të mësuar shqipen. Kreu i shtetit grek kishte thënë se ishte lindur në Tatoi, ku të gjitha fshatrat rreth e qark flisnin shqip. Rrjedhimisht, edhe ai ndihej gjysmë shqiptari.[482] Nga ana tjetër, zyrtarët shtetërorë grekë përkujdeseshin për shkollat dhe kishat greke në Korçë. Korçari Vasil Kondi i tha ministrit grek Panurjas, kur e thirri, se "edhe ai" kishte qenë grek deri atë kohë. Mirëpo, puna duhet quajtur e mbyllur, pas djegies së dyfishtë të "vorioepirotëve" në 1914 dhe 1919 dhe Greqia duhet t'i linte e të mos i merrte në qafë.[483]

Ministri shqiptar në Itali, Mehmet Konica, do të merrte pohimin më të fortë për rrjetin përgjues grek në Shqipëri. Ministri Aleksandris i foli më hapur se kurdoherë, gjatë një takimi, në qershor 1923. Ai pohoi se kishte thirrur në zyrë të gjithë përgjuesit e "Epirit dhe të Shqipërisë" të cilët i paguante Greqia dhe u kishte thënë se rroga greke do të ndërpritej. Aleksandris ishte shprehur se Greqia nuk dëshironte të trazohej në punët e brendshme të Shqipërisë, por dëshironte fqinjësi të mirë. Ai kishte udhëzuar përgjuesit të bëheshin qytetarë të mirë shqiptarë dhe të jetonin mirë, siç jetonin shqiptarët e Greqisë. Vetëm kështu, do të mund të shiheshin me sy të mirë nga shqiptarët, pas fushatave të shumta kundërshqiptare që kishin bërë.[484]

Mirëpo, Aleksandris pohoi të kundërtën në një bisedë me Mid'hat Frashërin, një muaj më vonë. Ai u shtir në vështirësi përballë kërkesave të shoqatave vorioepirote për shkolla greke në Shqipëri, sidomos në prag të zgjedhjeve. Frashëri vërejti se ministri vijonte të ngatërronte shkollat e pakicës me shkollat që Patriarkana kishte dikur për ortodoksët shqiptarë. Mid'hati ia preu pyetjes së Aleksandris se çfarë mund t'u thoshte shoqatave: Shqipëria mbante me të hollat e saj 40 shkolla greqisht dhe Greqia asnjë shkollë shqip.[485]

Ky ishte sfondi i marrëdhënieve të ndryshuara shqiptaro-greke. Dërgata kishtare nuk kishte ngadhënjyer, mirëpo plani i Kongresit të Beratit mbetej në fuqi. Dërgata nuk erdhi e plotë nga Stambolli. Dhosi Havjari mbeti pas, për të ndihmuar në vështirësitë që kryqtari i dytë i autoqefalisë, Hirësi Kristofor Kisi, mund të haste.[486] Episkopi nënshkroi se pranonte autoqefalinë dhe çdo nyje të Statutit të Beratit.[487] Ai i kishte rrëfyer Mitropolit Jakovit se kishte nxjerrë pasaportën për t'u nisur në Shqipëri. Jakovi e udhëzoi ta kthente vendimin, por Kristofori e vlerësonte detyrë kombëtare rrugëtimin për në Atdhe.[488] Kisi kërkoi leje sipas rregullave, por Patriarkana i tha se duhet të priste dy muaj. Ai kishte marrë leje nga eprori i tij, Mitropoliti i Dherkonëve, por Sinodhi e shfuqizoi, kur mësoi arsyen e largimit.[489] Havjari u kthye me plaçkat e episkopit më 14 korrik, ndërsa Kisi do të priste edhe tri javë, për të marrë përgjigjen zyrtare.[490]

Përfundimisht, Hirësi Kristofori u prit nga Hirësi Jerotheu në Korçë, të shtunën, 17 gusht 1923.[491] Ai qe nisur me vendim vetjak, pasi leja nuk ishte miratuar, por as ishte

[482] AMPJ, V. 1923, D. 142, f. 22, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 23 mars 1923.
[483] AMPJ, V. 1923, D. 142, f. 23, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 23 mars 1923.
[484] AMPJ, V. 1923, D. 141, f. 1, Legata e Londrës drejtuar MPJ, 13 qershor 1923.
[485] AMPJ, V. 1923, D. 142, f. 27, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 24 korrik 1923.
[486] *Koha* nr. 133, 9 qershor 1923, 2.
[487] AMPJ, V. 1923, D. 331, f. 68, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 7 qershor 1923.
[488] Glavina, "Mitropoliti i Durrësit, 69.
[489] Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 78.
[490] *Koha* nr. 138, 14 korrik 1923, 2.
[491] *Koha* nr. 143, 18 gusht 1923, 2.; Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 84-85.

mohuar zyrtarisht.[492] Patriarkana urdhëroi ndalimin e çdo veprimtarie kishtare të Kisit, të cilin e shpalli nën gjyq kishtar. Mirëpo, as Hirësi Jerotheu e as Hirësi Kristofori nuk e zbatuan urdhrin e Sinodhit të Shenjtë.[493]

Tashmë, gjithçka përvijohej sipas Statutit të Beratit. Qeveria u jepte zemër priftërinjve dhe sidomos dy episkopëve që lanë Kostandinopojën për atdhetari, se Patriarkana do të tërhiqej shpejt, duke qenë në gjendje të keqe prej Turqisë.[494] Kisha Mëmë bëri një orvatje të fundit. Ajo emëroi ekzark të ri të Shqipërisë Mitropolitin e Follorinës. Mirëpo, hyrja e tij në vend u ndalua, pas kërkesës së Atë Vasil Markos[495]

Qeveria shqiptare rendi të miratonte edhe ligjin për bashkësitë fetare, që përcaktonte se drejtuesit e cilësdo fe do të duhej të ishin nga familje shqiptare, prej mbi tre brezash. Ky përcaktim nuk përjashtonte pakicat, që qeveria sqaronte se jetonin në truallin shqiptar, më se njëqind vitesh. Vetëm ata që nuk vinin nga Shqipëria ishin të papranueshëm.[496]

Ndërkaq, vendi ishte bërë gati të zhvillonte zgjedhjet e para demokratike, në fundvitin 1923. Episkopi i zgjedhur, Theofan Noli, ia kishte dalë të kthehej në një politikan kyç në vend dhe udhëhoqi kundërshtarët e qeverisë së Ahmet Zogut, në zgjedhjet e vitit 1923. Qeveria greke nuk qëndronte duarkryq. Ajo vendosi të mos udhëzonte mospjesëmarrjen e grekomanëve si zgjedhjet e kaluara, nga frika e dobësimit të ndikimit. Ambasadori grek në Durrës, Panurjas, shënonte se grekomanët do të ishin të papërfillshëm, pasi ortodoksët atdhetarë shqiptarë ishin shumicë dërrmuese. Ai gjykonte se mospjesëmarrja nuk do të sillte asnjë përfitim, veçse do të inatoste shqiptarët. Greqia vendosi të udhëzonte mbështetësit të merrnin pjesë në zgjedhje dhe të mbështesnin Ahmet Zogun, i cili shihej si një politikan i fortë dhe i sinqertë, por mbi të gjitha kundërshtar i ashpër i italianëve.[497]

Nuk përbën habi që Greqia përzgjodhi myslimanët çifligarë që sundonin shumicën qeveritare dhe që ajka ortodokse e mbledhur rreth Nolit nuk ishte e parapëlqyera e saj. Shteti grek kërkonte ndikimin në Shqipëri dhe grekomanët e pakët ishin në këtë shërbim. Noli mbërriti në Korçë më 18 gusht dhe u prit me bujë nga mbështetësit e shumtë. Ai kishte mbajtur fjalime rrugës në Vlorë, Fier dhe Berat, në mbështetje të listës së Partisë së tij.[498] Fushata e Nolit ishte e gjallë, e mbushur me tubime politike që shiheshin në Shqipëri për herë të parë. Ai nuk rendi të bindte vetëm zgjedhësit

---

[492] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 116, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 8 gusht 1923.; Disa autorë kanë botuar se Kisi u dërgua nga Patriarkana, pasi Patriarkana nuk e kundërshtoi në parim autoqefalinë. (Fatmira Rama, "Shteti dhe njohja e Kishës Autoqefale Shqiptare (1922-1929)", *Studime Albanologjike* 11:1 (2008), 67-68.) Mirëpo, burimet arkivore rrëfejnë se këto përfundime janë të pasakta. Patriarkana kundërshtoi rreptësisht dhe haptazi autoqefalinë, ndërsa Kisi u nis me vendim vetjak dhe në përplasje me Patriarkanën për në Shqipër. Madje, edhe Jerotheu që ishte dërguar si ekzark u ftoh me Patriarkanën, pasi njohu Kishën Shqiptare si Autoqefale dhe shërbeu në të bashkë me Hirësi Kristoforin.

[493] Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 82-83.

[494] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 117, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 8 gusht 1923.

[495] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 120, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 25 gusht 1923.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 119, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 25 gusht 1923.

[496] AMPJ, V. 1923, D. 210, f. 39, Konsullata e Gjenevës drejtuar Lidhjes së Kombeve, 1 shtator 1923.

[497] Vasilios Kondis, *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 3, 1922-1929*. [*Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet grekoshqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 3, 1922-1929]* (Athinë: Estia, 1995), 104: IDAYE, D. a/5 (2), nr. 7237, Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 20 korrik 1923.

[498] "Pishkop Noli në Korçë", *Koha* nr. 143, 18 gusht 1923, 2.

e dytë, të cilët votonin deputetët, por zhvilloi takime të zjarrta atdhetare për të bindur mbarë popullsinë. Noli doli fitimtar bindës në Korçë, në fund të zgjedhjeve të dhjetorit 1923. Mirëpo, nuk ia arriti të fitonte në rang vendi.[499]

Gjithsesi, ai ishte gati t'i jepte drejtim të rregullt rrugës kishtare që kishte nisur në vitin 1908. Vendimi për zgjedhjen e tij Mitropolit nuk shtangu askënd. Mbështetësit e Nolit sundonin Këshillin e Lartë Kishtar, me mirëkuptimin e qeverisë. Vendimet e pleqësive kishtare të Durrësit u morën më 3 dhjetor 1923. Këshilli i Lartë Kishtar kishte emëruar Episkop Jerotheun Mitropolit të Korçës dhe Episkop Kristoforin Mitropolit të Beratit, prej tetorit 1923 dhe ata u fronëzuan në nëntor. Dy mitropolitët e rinj u mblodhën dhe zgjodhën rregullisht Nolin episkop, po më 3 dhjetor. Në këtë mënyrë, dorëzimi ishte i pakundërshtueshëm sipas çdo rregulli kishtar dhe sipas përcaktimeve të Statutit të dalë nga Kongresi i Beratit.[500] Kisha Kombëtare sqaronte se gëzonte tërë mjetet që i duheshin për organizimin dhe rregullimin e saj.[501] Ndërsa, mbështetësit e Nolit shpallën se dorëzimi bëhej për të sheshuar armiqësitë dhe për të sjellë paqen midis ortodoksëve shqiptarë.

Dorëzimi u vendos të zhvillohej në Kishën e Shën Gjergjit vetëm një ditë pas vendimit. Kisha ishte mbushur përplot mëngjesin e 4 dhjetor. Shërbesa madhështore u drejtua nga mitropolitët Jerotheu dhe Kristofori, në praninë e ministrit të Jashtëm Pandeli Evangjeli, kryebashkiakut Vasil Avrami dhe Këshilli Bashkiak, prefektit, oficerëve të ushtrisë dhe xhandarmërisë, zyrtarëve të shumtë vendorë dhe një teprie populli. Mitropoliti i sapodorëzuar mbajti një fjalim për detyrën që çdo shqiptar ka përpara Atdheut dhe fesë. Tre mitropolitët dolën të shoqëruar nga priftërinjtë dhe u përshëndetën nga mijëra besimtarë që kishin mbushur rrugët e Korçës. Noli u vendos të fronëzohej në fillimjanar. Kështu, vetëm Mitropolia e Gjirokastrës do të mbetej e zbrazët.[502]

Mitropolit Theofani rimori drejtimin e lëvizjes kishtare shqiptare, që e kishte nxitur prej dorëzimit të tij prift. Gjendja anoi sërish në anën e njohjes së autoqefalisë. Mosbindja e dy mitropolitëve Jerotehu dhe Kisi ishte një goditje e rëndë për palën greke. Tashmë, Patriarkana Ekumenike nuk mund ta zhbënte drejtimin kishtar të krijuar në Kishën e Shqipërisë.

Theofan Noli u nis për disa çështje private në Itali, përpara se të fronëzohej, ndërsa mëkëmbësi Arkimandrit Vangjel Çamçe u dërgua menjëherë në Durrës. Ambasada greke i ndiqte zhvillimet me kujdes. Ajo vlerësonte se Noli kishte ikur në Itali për "të marrë udhëzime", teksa Theofani cilësohej vegël e Vatikanit.[503] Mirëpo, Noli përbënte kërcënim edhe për Italinë. Ambasada italiane parashtronte se Mitropoliti kërkonte arritjen e një autoqefalie për ortodoksët, përhapjen e bektashizmit për myslimanët dhe metodizmit për katolikët. Lajmi kishte mbërritur nga prifti katolik i Tiranës, i cili spiunonte për Italinë, sikurse disa priftërinj ortodoksë përgjonin për Greqisë.[504]

---

[499] GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", D. 725/2, f. 1, Trupa Ushtarake V drejtuar Venizelos, 14/27 dhjetor 1923.
[500] Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 85-86.
[501] AMPJ, V. 1923, D. 210, f. 53, Këshilli i Lartë Kishtar drejtuar Prefekturës Korçë, 13 nëntor 1923.
[502] "Ceremonia e Imzot Nolit në Shën Gjergj", *Koha* nr. 157, 8 dhjetor 1923, 1.
[503] Kondis, *Elinizmos III*, 125: IDAYE, D. B/35, nr. 1707, Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 7 janar 1924.
[504] AQSH, F. 163 "Legata Italiane", V. 1922, D. 13, f. 6, Legata Italiane drejtuar MPJI, 22 dhjetor 1922.

Legata greke njoftohej rregullisht për lëvizjet në terren. Ajo njoftonte se Çamçja meshoi në shqip e greqisht për Krishtlindje dhe shpërndau libra shqip për të gjithë psaltët, si një masë që do të mundësonte shqiptarizimin e shpejtë të Kishës. Ambasada theksonte se mbajtja e meshës edhe në greqisht ishte një përpjekje për të shmangur pakënaqësitë e rretheve të ulëta të popullsisë përpara fronëzimit të Mitropolitit. Noli pritej të vendoste vetëm shqipen në meshë, çka do të mbështetej nga shumica e ajkës së ortodoksëve, të cilët vlerësonin se greqishtja në Kishë ishte dëm ndaj atdhetarizmit shqiptar. Fronëzimi i Mitropolitit u krye me madhështinë e nevojshme. Grekomanët e pakët të qytetit u shprehën të gatshëm të krijonin ndonjë ndodhi gjatë shërbesës, por kjo u kundërshtua nga ambasada si e padobishme për Greqinë.[505]

Legata vlerësonte se dëmi ishte madhor, por nuk mund të bënte asgjë për shkak të prishjes së marrëdhënieve ndërmjet Ekzarkatës Shqiptare dhe Patriarkanës Ekumenike. Mosnjohja e autoqefalisë ishte parë nga Hirësi Jerotheu si besëprerje. Prandaj, ai nuk denjoi të uronte as zgjedhjen e Patriarkut të ri Ekumenik e jo më të pranonte të rihynte në bisedime. Ambasada greke mendonte se rifillimi i bisedimeve nuk mund të prodhonte asgjë tjetër veçse një Kishë Ortodokse Shqiptare tërësisht të pavarur nga Patriarkana. Ajo udhëzonte që të fitohej kohë në mënyrë që ndikimi kombëtar grek të mund të rivendosej pasi të ishin afruar edhe disa fanolistë. Ndërkaq, vlerësonte të nevojshëm bashkërendimin me qeveritë serbe dhe rumune, përpara çdo vendimi. Parashtresa e Ambasadës Greke përfundonte se duhet të matej pulsi i zyrtarëve shqiptarë për bisedimet.[506] Ministri grek në Shqipëri, Panurjas, i tha Mid'hat Frashërit se një dërgatë duhet të nisej për në Stamboll, pasi Patriarkana ishte gati të njihte autoqefalinë.[507] Njoftimi i Panurjasit nuk ishte i vërtetë, teksa Konsullata në Stamboll mohoi të kishte ndonjë vendim nga Patriarkana.[508] Qëllimi ishte ndalimi i vijimit me zgjidhjen e njëanshme në Shqipëri.

Vrasja e kreut të Komisionit të Caktimit të Kufijve, gjeneralit italian, Enriko Telini, do të përbënte një pikë kthese për politikën greke. Ngjarja bëri që ndjenjat kundërgreke në Shqipëri të rriteshin në nivel të rrezikshëm. Ambasada në Durrës lajmëronte në fillimmarsin 1924 se ndikimi grek në Shqipëri ishte zeruar prej shkatërrimit në Azinë e Vogël dhe vrasja e gjeneral Telinit e kishte çuar gjendjen në skaj. Prandaj, udhëzonte zgjidhjen e shpejtë të çështjes kishtare, nëpërmjet pranimit të autoqefalisë me kushte.[509]

Tre mitropolitët e Kishës Shqiptare i kishin dërguar Patriarkanës vendimin për ngritjen e një Sinodhi të përkohshëm me pjesëmarrjen e Hirësi Jerotheut, Hirësi Kristoforit dhe Hirësi Theofanit. Patriarkana vendosi të mos përgjigjej dhe nuk pranoi sugjerimin e Hirësi Jakovit për rrëzimin e tre kryepriftërinjve. Për më tepër, u vendos njohja e autoqefalisë me kushte, sipas udhëzimit të Athinës zyrtare. Kryepiskop u paracaktua Jerotheu, edhe pse ai, Kisi dhe ortodoksët shqiptarë parapëlqenin Hirësi Theofan Nolin.[510] Patriarkana lajmëroi qeverinë shqiptare, e cila thirri Atë Vasil Markon për të biseduar detajet e autoqefalisë.[511] Mirëpo, ai do të kthehej duarbosh nga Tirana, në rrethanat e reja politike të Shqipërisë.

---

[505] Kondis, *Elinizmos III*, 125: IDAYE, Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 7 janar 1924, cit.
[506] Po aty.
[507] AMPJ, V. 1924, D. 501, f. 1-2, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 18 janar 1924.
[508] AMPJ, V. 1924, D. 501, f. 7, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 19 shkurt 1924.
[509] Kondis, *Elinizmos III*, 137: IDAYE, D. a/5, nr. 139, Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 5 mars 1924.
[510] Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 87.
[511] *Koha* nr. 171, 29 mars 1924, 2.

Prilli 1924 do të shënonte nisjen e përçarjes së madhe kombëtare. Ahmet Zogu i kishte mbijetuar një sulmi të armatosur brenda mjediseve të Kuvendit Kushtetues në shkurt të atij viti. Ai u dorëhoq për të qetësuar gjendjen, por përcaktoi për Kryeministër bashkëpunëtorin e ngushtë, Shefqet bej Vërlacin. Guximtari ndaj Zogut, Beqir Valteri, filloi të fliste, duke fajësuar deputetin Avni Rustemi si frymëzues të ngjarjes. Vrasja e Avni Rustemit pak ditë më vonë solli përçarjen e madhe kombëtare, duke e lënë lëvizjen kishtare të parëndësishme. Pakica kuvendore iu drejtua Vlorës ku Rustemi u varros dhe u krijua një kuvendi i ri. Ata shpallën mosnjohjen e qeverisë së Shqefqet Vërlacit, të prirë nga Mitropoliti i Durrësit, Theofani. Iljaz Vrioni u emërua Kryeministër i ri për të qetësuar gjakrat.[512]

Parimi kishtar, se një kryeprift nuk duhet të merrej me politikë, do të shfrytëzohej në ashpërsimin e betejës mes palëve. Zogistët gjetën mbështetjen e Vasil Dilos, i cili kishte nisur të botonte fletoren "Tirana", kundërshtare e ashpër e veprimtarisë fanoliste në çështjen kishtare.[513] Një pjesë e të krishterëve të Durrësit ngritën zërin pranë Këshillit Kishtar dhe kërkuan më 20 maj ose Mitropoliti Theofan të linte mënjanë politikën, ose të zëvendësohej nga një episkop tjetër.[514]

Mirëpo, qeveria nuk ishte më e aftë të mbante rendin. Ushtria ngriti krye: Divizionet e Përmetit dhe të Shkodrës nisën marshimin në Tiranë për të hedhur poshtë qeverinë e dalë nga shumica kuvendore. Grushti ushtarak do të ngadhënjente, me largimin e trupave qeveritare dhe politikanëve të shumicës më 10 qershor. Dy divizionet ushtarake, së bashku me deputetët e pakicës, hynë fitimtarë në kryeqytet. Vetëm një nga katër anëtarët e Këshillit të Lartë të Shtetit, Sotir Peci, kishte mbetur. Ai dekretoi Mitropolitin e Durrësit, Theofanin, Kryeministër të ri, duke shënuar fitoren e Revolucionit të Qershorit.[515]

Ambasadori grek u rikthye në Durrës prej korrikut 1924, por as e njihte, as e kundërshtonte qeverinë e re. Çështja kishtare ishte kthyer sërish në vendnumëro. Qeveria greke kishte udhëzuar Patriarkanën të njihte autoqefalinë shqiptare vetëm para dy muajsh, por mungesa e qëndrueshmërisë politike ndaloi çdo përpjekje. Edhe Jerotheu mendonte se duhej pritur, në një letër të gjatë drejtuar kolonelit grek Avramidhit.[516] Hirësia arsyetonte qëndrimin që kishte mbajtur në fillim. Ai thoshte se kishte qenë i detyruar të mbante anën shqiptare, pasi popullsia ishte thartuar nga veprimet e kryera në kohën e Mitropolit Jakovit.[517]

---

[512] Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar,* 74.

[513] Dilo kishte qenë botues i gazetave "Ipirotiqi Amina" (Mbrojtja epirotase) dhe dygjuhëshes grekoitaliane "Omonia-Konkordia" në Gjirokastër. Ai ishte filogrek dhe nënshkrues i Protokollit të Korfuzit, porse qartazi bënte pjesë në rrymës kombëtare, që kërkonte shtet të pavarur shqiptar. Vasil Dilo, "Përgjigje 'politikës' Vlonës", *Tirana* nr. 5, 24 maj 1924, 3.

[514] "Nisezat", *Tirana* nr. 6, 30 maj 1924, 3.

[515] Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar,* 74.

[516] Letra e Jerotheut drejtuar kolonelit Avramidhis mban datën 10 gusht 1924. Kondis, *Elinizmos III,* 161: IDAYE, D. B/35, nr. 32072, MPJG drejtuar Ambasadës së Durrësit, 4 shtator 1924.

[517] Jerotheu shprehet në këtë letër se qëllimi i tij i vërtetë ishte të qetësonte gjendjen. Ai kuptoi kur erdhi në Shqipëri se kishte marrëveshje me qeverinë serbe dhe ardhja e Episkop Viktorit në Shkodër ishte në këtë kornizë. "Duke ardhur në Korçë u gjenda në rrethana të këqija, të cilat kërcënuan të shkatërrojnë vetëbesimin tim. Nuk vonova të kuptojë se çfarë detyrohesha të bëja, pasi më ishte në dobi dhe e kërkuar nga gjendja. Me çdo kusht, për shkak të detyrës time, duhet të rilidhja marrëdhëniet me Patriarkanën" – shkruante Jerotheu. Ai shprehet se orvatja për të dërguar komisionin në Stamboll ishte që anëtarët të bindeshin nga Patriarku se Kisha e Madhe nuk ishte kundër shqiptarëve. Jerotheu shkruante se komisioni u

Ai vlerësonte se qeveria kryengritëse haste vështirësi të mëdha dhe të rëndësishme, si zgjedhjet dhe ekonomia, të cilat i pamundësonin të përqendrohej në çështjen kishtare. Jerotheu nuk shihte ngutje, pasi ai përmendte emrin e Patriarkut në meshim, duke treguar varësinë ndaj Patriarkanës, edhe pse dy mitropolitët e tjerë, Kisi dhe Theofani, nuk e ndiqnin. Sipas Jerotheut, Kisha vijonte të ishte thuajse e varur nga Patriarkana. Në fund, Jerotheu pyeste nëse dobia greke ishte zgjidhja e shpejtë e çështjes kishtare për të pasur një marrëdhënie më të afërt mes dy vendeve, në betejë ndaj armiqve të përbashkët. Ai vlerësonte se qenia e një burri kishtar si Noli në krye të shtetit e bënte të lehtë arritjen e një marrëveshjeje për të kundërshtuar çfarëdo ndikimi otoman. Jerotheu nënshkruante si "Mitropoliti i Shenjtë Jerotheos" dhe jo "Mitropolit i Korçës", siç qe zgjedhur dhe fronëzuar.[518] Qëndrimi i tij u mbështet edhe nga ministri grek në Durrës, Panurjas, i cili vlerësonte rinisjen e bisedimeve të papërshtatshme politikisht, aq më tepër kur diplomatët dhe shumica e popullit gjykonin se qeveria Noli nuk do të ishte jetëgjatë.[519]

Qeveria greke ndiqte me vëmendje zhvillimet në lëmin politik dhe kishtar të një Kryeministri-Mitropolit. Ambasadori grek parashtronte më 12 tetor se disa nga të krishterët më të njohur të qytetit do të kërkonin dorëheqjen përfundimtare të Nolit nga politika dhe përqendrimin e tij në detyrat episkopale, duke u vendosur në krye të betejës kundërmyslimane.[520]

Noli i besonte vendimet Arkimandrit Vangjel Çamçes, gjatë periudhës që nuk drejtonte dot Mitropolinë. Meshimi kryhej vetëm në shqip, duke e hequr njëherë e mirë gjuhën greke. Një kor muzikor rus u ftua në Tiranë dhe u krijua edhe kori shqiptar kishtar. Librat që Noli kishte përkthyer në SHBA u përhapën në mbarë vendin, ndërsa kisha rumune e Elbasanit u mbyll, për të treguar se në Mitropolinë e Durrësit nuk mund të kishte asgjë tjetër veçse Kisha Shqiptare.[521] Kalendari i ri u vendos përfundimisht në përdorim, pas pranimit përkatës nga Këshilli i Lartë Kishtar.[522]

Ministri Stavro Vinjau dhe mëkëmbësi Sotir Peci u përpoqën në emër të Nolit të ngrinin një shkolle priftërore, që do të rriste brezin e ri në shërbim të Kishës Autoqefale Shqiptare. Vinjau dhe Peci u takuan me ministrin grek në Durrës për të kërkuar që trashëgimia e mirëbërësit korçar Jovan Bangës të përdorej, sipas dëshirës të të ndjerit. Shteti grek e kishte bllokuar prej dëbimit të Jakovit. Pleqësia e Korçës ishte zbatuesja e dëshmisë së trashëgimisë, por nuk ishte lejuar të ndërhynte në shumën e ruajtur në Bankën e Athinës. Arsyeja e pengesës së papërligjur u zbulua kur qeveria shqiptare

---

prek nga takimi me Patriarkun dhe stërfalja e anëtarëve të tij ra. Arsyeja e dytë e këtij veprimi ishte që të dobësoheshin ndërhyrjet e huaja teksa ato "shfrytëzonin pakënaqësinë shqiptare ndaj çdo gjëje greke dhe ndaj Patriarkanës". Sinqeriteti i veprimit të Jerotheut në dobi të dobisë grek vihet në dyshim, teksa Ambasada e Durrësit njoftonte ato kohë se ai nuk pranonte t'i dërgonte patriarkut të ri as një urim, pas përplasjes që kishte me Meletin IV. (Kondis, *Elinizmos III*, 125). Së dyti, zhgënjimi që Jerotheu mori kur pa se autoqefalia nuk do të jepej, apo pohimi se gjithçka bëhej në Shqipëri ishte tërësisht kanonike (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1923, D. 26, f. 4, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 20 maj 1923.) dhe mbi të gjitha dorëzimi i rregulltë i Mitropolit Theofanit dëshmojnë se qëndrimi i Jerotheut në letrën ndaj kolonelit Avramidhis janë ose një orvatje për riafrim me palën greke, ose një përpjekje për ta mbajtur mirë me të dyja palët, edhe pse ishte tërësisht i bindur në lëvizjen kishtare shqiptare.

[518] Kondis, *Elinizmos III*, 161.

[519] Kondis, *Elinizmos III*, 178: IDAYE, D.B/35, nr. 37929, Ambasada Durrës drejt. MPJG, 23 shtator 1924.

[520] Kondis, *Elinizmos III*, 181: IDAYE, D. A/5, nr. 9018, Ambasada Durrës drejtuar MPJG, 12 tetor 1924.

[521] AMPJ, V. 1924, D. 292, f. 5-6, Kryekonsullata e Bukureshtit drejtuar MPJ, 8 tetor 1924.

[522] *Gazeta e Korçës* nr. 72, 1 prill 1924, 1.

kërkoi shumën për shkollë priftërore. Pyetja e parë që ministri Panurjas i bëri Sotir Pecit ishte nëse do të mësohej greqishtja. Peci u përgjigj se ajo do të ishte në mësim si gjuhë e shkrimeve. Panurjas i shprehte Ministrisë së Jashtme Greke pëlqimin për shkollën priftërore, pasi hapja e saj do të riçelte kohën e mbisundimit të arsimimit grek në Shqipëri.[523]

Qeveria greke pranoi me tri kushte: gjuha e mësimit të ishte vetëm greqishtja, programi të ishte i njëjtë me shkollën Rizario të Athinës dhe mësuesit të ishin edhe nënshtetas grekë, nëse nuk mund të gjendeshin shqiptarë.[524] Në të kundërt, shteti grek nuk do të lejonte Mitropolinë e Korçës të merrte fondet sipas vullnetit të mirëbërësit Banga. Gjithsesi, zhvillimet e vrullshme politike bënë që kushtet të mos trajtoheshin.

Kryeministri-Mitropolit do ta gjente qortimin më të ashpër brenda Kishës. Kundërshtari i kahershëm, Arkimandrit Visari, kishte nisur të botonte fletoren prozogiste, kundërnoliste "Gjergj Kastrioti" më 17 maj 1924. Xhuvani emërtohej "Drejtor-përgjegjës dhe artikullshkronjës".[525] Botimi u shndërrua në të përmuajshme kishtare fetare prej numrit të tretë, pas fitores së kryengritjes së qershorit.[526] Arkimandrit Visari bënte të ditur në numrin e parë nën qeverisjen e re se nuk botonte letra kundër Këshillit të Lartë Kishtar, pasi nuk dëshironte ta sulmonte Kishën për çështje vetjake. Po ashtu, ai linte të hapur mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen.[527]

"Gjergj Kastrioti" do të ishte një zë i fortë kundërshtar i Hirësi Theofanit, edhe pse fletore kishtare. Xhuvani e fajësonte Mitropolitin e Durrësit se kishte mohuar kungimin për disa njerëz në Kishën e kryeqytetit.[528] Ai doli haptazi kundër korit të ri muzikor rus që u paraqit në kryeqytet, pasi arsyetonte se ortodoksët shqiptarë ishin mësuar me muzikën bizantine.[529] Fletorja do të bëhej gjithnjë e më shumë politike, me kalimin e muajve. Visari shkruante në shtator se populli donte më shumë bukë sesa politikë, duke nënkuptuar mungesën e të korrave të atij viti.[530] Ai do të rrëfehej haptazi kundërqeveritar, pas fjalës së Mitropolit Theofanit kundër nevojës për kuvend në Lidhjen e Kombeve. Visari shkruante se Fuqitë e Mëdha ishin zemëruar mjaft dhe nuk kishte arsye që Kryeministri t'i mërziste me fjalë, nga një shtet që nuk kishte arritur të rregullonte vetveten. Ai kërkonte zgjedhje të lira, pasi koha nuk priste dhe populli kërkonte të shprehej me anë të një kuvendi.[531]

Numri i ardhshëm do të ishte i fundit. "Gjergj Kastrioti" u çel me kushtrimin: "Ku asht puna dhe buka për popullin? Ku asht qetësia?" Visari shkruante se populli e priti Kryeministrin plot gaz dhe hare për flluskat që kishte sjellë prej Lidhjes së Kombeve.

---

[523] Kondis, *Elinizmos III*, 184-185: IDAYE, D. B/33, nr. 44754, Ambasada Durrës drejtuar MPJG, 1 nëntor 1924.
[524] Kondis, *Elinizmos III*, 189-190: IDAYE, D. B/33, nr. 44754, MPJG drejtuar Ambasadës Durrës, 17 nëntor 1924.
[525] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, *Gjergj Kastrioti* nr. 1, 17 maj 1924, 1.
[526] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, *Gjergj Kastrioti* nr. 3, 7 korrik 1924, 1.
[527] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, *Gjergj Kastrioti* nr. 3, 7 korrik 1924, 2.
[528] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, "Një vepër andikanonike me rëndësi", *Gjergj Kastrioti* nr. 6, 28 gusht 1924, 1.
[529] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, "Populli do dritë shpirtënore ma parë dhe pastaj muzika", *Gjergj Kastrioti* nr. 6, 28 gusht 1924, 1-2.
[530] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, "Populli do ma shumë bukë se politikë", *Gjergj Kastrioti (Skënderbeu)* nr. 7, 9 shtator 1924, 1.
[531] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, "Shqipnia në Këshillën e L. Kombevet – Kryeministri ynë zemëron Evropën", *Gjergj Kastrioti (Skënderbeu)* nr. 10, 10 tetor 1924, 1.

Arkimandriti vijonte se këto zbrazëti nuk u nevojiteshin qytetarëve, pas flluskave të panumërta të qeverisë të Nolit.[532] Visari u dëbua për në Vlorë, shumë larg zhvillimeve kishtare që përqendroheshin në Tiranë dhe Korçë, më 1 nëntor 1924.[533]

Ndërkaq, pala greke shihte se si të besuarit e saj në Shqipëri shprehnin pakënaqësinë ndaj mungesës së mitropolitëve, sidomos në zonën e Gjirokastrës. Drejtori i shkollës së Delvinës, Thanas Nathanaili, ishte pjesëtar i pakicës greke. Ai shprehej se beteja për shqipfolësit e krishterë ishte e humbur, teksa ata ishin përfshirë në shqiptarizëm, por mund të ktheheshin prapë në rrymën kombëtare greke, nëse mitropolitë do të vepronin siç duhej.[534] Çështja kishtare e Mitropolisë së Drinupojës u zgjidh pas disa vitesh paqartësie. Mitropoliti Vasili kishte zhvendosur qendrën nga Gjirokastra në Delvinaq, që gjendej brenda shtetit grek. Kjo lëvizje bënte që ai të vijonte të ishte mitropoliti i rregullt, teksa nuk ishte larguar prej qarkut kishtar, por veç kishte ndryshuar qendrën. Patriarkana krijoi Mitropolinë e re të Drinupojës, në trojet që ishte brenda shtetit grek në nëntor 1924. Si pasojë, pjesa e qarkut të vjetër kishtar që ishte brenda kufijve shqiptarë mbeti pa mitropolit.[535]

Kështu, rruga u çel për plotësimin e kushteve që vendoste Statuti i Kongresit të Beratit për të fronëzuar mitropolitin e fundit. Arkimandrit Vangjel Çamçe u dërgua me shërbim në Korçë, më 6 nëntor 1924. Ai mori pjesë në përshpirtjen për Themistokli Gërmenjin, të drejtuar nga Vasil Marko dhe i paraqiti Këshillit Kishtar dhe mitropolitëve gjendjen e re.[536] Nuk kemi dijeni se cila ishte zgjidhja, por rrethanat rrëfejnë se Arkimandrit Vangjel Çamçe do të dorëzohej episkop dhe do të fronëzohej Mitropolit i Gjirokastrës, duke formuar Sinodhin e Parë të Shenjtë me katër mitropolitët: Theofanin, Jerotheun, Kristoforin dhe Vangjelin. Dëbimi i para pak ditëve i të përfolurit tjetër për episkop Arkimandrit Visar Xhuvanit dëshmon për këtë skenar. Mirëpo, zhvillimet politike do të kalonin sërish në dëm të Shqipërisë. Qeveria e Fan Nolit ra dhe qeveria e mëparshme e Iljaz Vrionit u rikthye, ditën e Krishtlindjeve 1924. Mitropolit Theofani iku nga Shqipëria për të mos u kthyer më kurrë, pas një viti qëndrimi në krye të Mitropolisë së Durrësit, pas gjashtë muajsh qëndrimi në krye të Shqipërisë dhe vetëm pak ditë përpara se të zgjidhej dhe fronëzohej Kryepiskop. Fuqitë e drejtuara nga Ahmet Zogu hynë ngadhënjimtare në Atdhe...

[532] Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvani, *Gjergj Kastrioti (Skënderbeu)* nr. 11, 19 tetor 1924, 1.
[533] *Gazeta e Korçës* nr. 138, 1 nëntor 1924, 1; *Liria*, 8 nëntor 1924, 3.
[534] Kondis, *Elinizmos III*, 185-189: IDAYE, D. B/33, nr. 9731, Komanda e Përgjithshme e Epirit drejtuar MPJG, 6 nëntor 1924.
[535] Fotios G. Ikonomu, "Η Εκκλησια εν Βορειω Ηπειρω απο της πρωτης διαδοσεως του Χριστιανισμου μεχρι των καθ' ημας χρονων [Kisha në Epirin e Veriut nga përhpapja e parë e Krishtërimit deri në kohët e sotshme]", *Η Ιστορια των τοπικων εκκλησιων της Ηπειρου Τομος Β' [Historia e kishave lokale të Epirit, Vëllimi 2]* (Athinë: 1969), 32.
[536] *Koha* nr. 198, 8 nëntor 1924, 2.

KREU III:
BISEDIMET PËR NJOHJEN E KOASH-it, 1924-1928

3.1. Marrëveshja e fshehtë e Beogradit mes Zogut dhe Greqisë

Zogu kishte arritur disa marrëveshje, përpara se të mbërrinte në Shqipëri. Ai kërkoi mbështetjen e fqinjëve nga Beogradi, ku qëndronte. Trupat besnike nevojitej të hynin nga Jugosllavia ose nga Greqia, dy vendet që kishin kufij tokësorë me Shqipërinë, për të hedhur poshtë qeverinë e Mitropolit Theofanit. Kështu, Zogu arriti në marrëveshje me Jugosllavinë, në shkëmbim të disa lëshimeve që Shqipëria do t'i bënte në të ardhmen. Disa studiues shprehen se kjo marrëveshje detyronte Shqipërinë të cedonte edhe në çështjen kishtare. Sipas tyre, Ahmet Zogu kishte pranuar vendosjen e Kishës në Shqipëri nën drejtimin e Patriarkut serb. Gjithsesi, marrëveshja e gushtit 1924 përqendrohej në lëshime tokësore dhe çështja kishtare prekej vetëm tërthorazi, në nenin 11.[537]

Kjo marrëveshje përshpejtoi përgatitjet e Zogut. Mirëpo, mbështetja greke ishte e domosdoshme, jo vetëm që trupat ushtarake të hynin nga Jugu për të asgjësuar çdo qëndresë të qeverisë së Nolit, por edhe thjesht për të shmangur ndërhyrje greke përgjatë paqëndrueshmërisë politike. Ambasada greke në Beograd vendosi në lëvizje Mihal Kason. Ai ishte deputet i Gjirokastrës, besnik i Zogut, i ikur së bashku me shumicën kuvendore, kur trupat noliste erdhën në pushtet. Kaso i radhiti Zogut kushtet e ndihmës greke, më 3 shtator 1924.[538]

Kushti i parë ishte që të krishterët që jetonin në Shqipëri të kishin të drejta të barabarta dhe të mos trysnoheshin. Pala greke synonte të merrte në mbrojtje ortodoksët në Shqipëri, ashtu sikurse kishte bërë Perandoria Ruse gjatë periudhës otomane. Greqia do ta kërkonte haptazi këtë të drejtë më vonë, duke u nisur pikërisht nga ky zotim.[539]

Tri pikat e tjera kishin të bënin me çështjet shkollore dhe kishtare. Kaso i tha Zogut se Greqia kërkonte mosndërhyrjen në çështjet kishtare të ortodoksëve, shkolla të lira në Epirin e Veriut dhe mësimin e greqishtes në shkollat shqipe, nëse kërkohej nga bashkësitë vendore.[540] Kjo nënkuptonte se Ahmet Zogu nuk do të ndërhynte në çështjen e autoqefalisë. Çështja kishtare ishte njëkohësisht edhe politike për të, teksa ajo kryesohej nga Mitropolit Theofani, Kryeministri që e kishte hedhur nga pushteti. Prandaj, ai pohoi gabimin e kryer për shpalljen e kotë të autoqefalisë në vitin 1922. Zogu njoftoi se do të

---

[537] Ksenofon Krisafi, *Për tokën dhe detin e Shqipërisë,* (Tiranë: UET Press, 2014); Faton Mehmetaj, *Veprimtaria kriminale e "Dorës së Zezë" serbe në trojet shqiptare* (Prishtinë: Anatema, 2004), 207.

[538] Telegrami që përmban kushtet greke, nuk është i plotë në Arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë. Ai përmban vetëm se "Z. Kaso u takua me Zogun. I tha kushtet e ndihmës së Greqisë...zgjerimin mbi Epirin e Veriut, mosndërhyrjen në çështjet kishtare të ortodoksëve, shkolla të lira tonat në Epirin e Veriut dhe mësimin e greqishtes në shkollat shqipe nëse kërkohet nga bashkësitë. Zogu i pranoi kushtet duke i gjetur ato të pranueshme dhe logjike, por pres ta takoj vetë Zogun" (Kondis, *Elinizmos III*, 160: IDAYE, V. 1924-1925, D. Γ/62/α, pa nr., Ambasada e Beogradit drjetuar MPJG, 3 shtator 1924). Mirëpo, hapësira e pazbardhur e shkresës përmban thelbin e kushteve. Rindërtimi i kërkesave greke është bërë fal takimit të shtatorit 1925, ndërmjet ministrit grek në Durrës, Panurjas me Kryetarin e Republikës, Ahmet Zogu, ku panurjas i renditi zotimet e Beogradit. (Kondis, *Elinizmos III*, 233: IDAYE, V. 1924-1925, D. Γ/62, nr. 12655, Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 5 shtator 1925).

[539] Ministri shqiptar në Athinë, Mid'hat Frashëri parashtronte këtë prirje mbisunduese në politikën greke në vitin 1926. AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 20, Frashëri drejtuar MPJ, 19 prill 1926.

[540] Kondis, *Elinizmos III*, 160: IDAYE, Ambasada e Beogradit drjetuar MPJG, cit.

synonte marrëveshje me Patriarkanën. Ai mori përsipër që të krishterët të zhvillonin fenë e tyre në cilën gjuhë të donin pa pasur dhunë qeveritare, duke riligjëruar meshimin në greqisht, nëse do të kërkohej nga bashkësitë vendase.[541] Zotimi i tretë për hapjen e shkollave greke në Shqipëri pa ndërhyrje qeveritare ishte pranuar në të vërtetë që prej Shpalljes për Mbrojtjen e Pakicave. Ndërkaq, pika e katërt ishte një lëshim domethënës, teksa Zogu zotohej se do të lejonte mësimin e greqishtes në shkollat e ortodoksëve shqiptarë nëse do ta kërkonin. Kjo i përngjante sistemit otoman, ku greqishtja do të rikthehej në arsim në vendbanimet ortodokse, krahas gjuhës zyrtare. Zotimi i pestë dhe i fundit fliste për Himarën. Greqia kërkoi rinjohjen e venomeve që kjo trevë kishte gjatë Perandorisë Otomane, të ripohuara në marrëveshjen e vitit 1920 me Jorgo Kolekën, por të shfuqizuara nga qeveria e Fan Nolit. Zogu i cilësoi kërkesat të pranueshme dhe të arsyeshme, duke ngarkuar Mihal Kason t'i përcillte ambasadës greke pranimin e tyre.[542]

Kështu, trupat e Ahmet Zogut nuk do të vinin vetëm nga Jugosllavia, Krishtlindjet e vitit 1924. Një trupë e armatosur drejtuar nga Myfit Libohova dhe Koço Kota u nis nga kufiri shqiptaro-grek, duke mbajtur ballin jugor të kundërsulmit. Leja greke ishte pasojë e zotimeve të Beogradit.

3.2. Plani i fshehtë i Hirësi Jerotheut

Rikthimi i Ahmet Zogut në pushtet përbënte një tronditje të thellë në çështjen kishtare, teksa Mitropolit Theofani ishte njëkohësisht Kryeministër e kryetar i lëvizjes. Ajo kishte marrë trajtën; ishte përshtatur sipas nevojave dhe kishte trupëzuar një ngrehinë që i shërbente Nolit. Kryetar i Këshillit të Lartë të Kishës ishte mbështetësi më i flaktë, Atë Vasil Marko. Dy mitropolitët e ardhur nga Stambolli e kishin dorëzuar rregullisht, një hap përpara zgjedhjes së Mitropolitit të katërt dhe shpalljes së Nolit Kryepiskop. Arkimandrit Vangjel Çamçe, krahu tjetër i djathtë i Theofanit, ishte i përzgjedhuri i fundit për të plotësuar Sinodhin e Shenjtë. Kështu, largimi i Nolit kishte minuar përpjekjet për zgjidhje të njëanshme. Për më tepër, asnjëri nuk e dinte në janar nëse qeverisja e re do të hakmerrej ndaj fanolistëve Marko dhe Çamçe që përbënin thelbin e mbetur të lëvizjes.

Në këto kushte, Mitropoliti i Korçës kaloi në nga skaji në skaj. Jerotheu nuk pranonte t'i dërgonte Patriarkut asnjë letër urimi pak muaj më parë. Tashmë, ai shihte se Greqia përbënte zgjidhje të detyruar. Mitropoliti nisi në Athinë ish-profesorin e shkollës greke të Korçës, Pandeli Kotoko.[543] I dërguari ishte ngarkuar t'i paraqiste qeverisë greke qëndrimin e Jerotheut dhe të kërkonte mbështetje për çështjen kishtare. Kotoko i dorëzoi Ministrisë së Jashtme Greke një plan të fshehtë me 13 pika, më 2 shkurt 1925.[544]

---

[541] Kondis, *Elinizmos III*, 233: IDAYE, Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, cit.

[542] Kondis, *Elinizmos III*, 160: IDAYE, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJG, cit.

[543] Mitropoliti i mëvonshëm i Gjirokastrës, Kotoko kishte qenë ndër grekomanët më të njohur të Korçës. Ai kishte shërbyer në ushtrinë greke gjatë vitit 1915 dhe u vendos nën udhëzimet e konsullatës greke në dëm të çështjes shqiptare, më vonë. Për të shih: Maria Janaku, "Ο Μητροπολίτης Αργυροκάστρου Παντελεήμων και το Βορειοηπειρωτικό Ζήτημα [Mitropoliti i Gjirokastrës Pandelejmon dhe Çështja Vorioepirotase]", (Mikrotezë, Universiteti i Selanikut, 2009); Sifi Kola, *Ο Αργυροκάστρου Παντελεήμων: Ο Αγωνιστής Ιεράρχης της Β. Ηπείρου [Pandelejmoni i Gjirokastrës: Kryeprifti luftues i Epirit V.]* (Athinë: 1970).

[544] Kondis, *Elinizmos III*, 196-207: IDAYE, V. 1924-1925, D. Γ/62, nr. 2470, Zyra e Tretë Politike MPJG drejtuar Zyrës së Parë Politike MPJG, 16 shkurt 1925.

Kotoko sqaronte në pikën e parë se nevojitej dërgimi i një episkopi tjetër grekoman në Shqipëri për të përfunduar çështjen kishtare. Jerotheu kishte vendosur t'i kërkonte Patriarkanës rikthimin e Vasilit të Drinupojës pas rënies së qeverisë së Fan Nolit. Krahu i djathtë i Ahmet Zogut, Myfid Libohova, mund ta pranonte Vasilin në Gjirokastër, duke qenë se ortodoksët dolën në krah të kundërsulmit zogist. Ligji i posaçëm që ndalonte ardhjen në Shqipëri të atyre që kishin punuar kundër pavarësisë nuk do të përbënte vështirësi. Sipas mendimit të Jerotheut të shprehur nga Kotoko, ligjet nuk kishin natyrë të qëndrueshme në Shqipëri, prandaj mjaftonin disa veprime në Gjirokastër për ndryshimin e gjendjes. Jerotheu mendonte se përpjekja do të rindezte kërkesat e ortodoksëve, duke e vendosur nën trysni qeverinë për t'i dhënë fund çështjes kishtare, edhe nëse rikthimi i Vasilit do të ndalohej. Sipas tij, Vasili ishte i vetmi nga mitropolitët e vjetër që mund të pranohej. Kjo, teksa rikthimi i Mitropolit Jakovit "pas veprimtarisë së tij kombëtare [greke] është e papranueshme", ndërsa për Joakimin, Kotoko shkruante se "qeveria shqiptare kishte të dhëna për italofilinë dhe veprimtarinë e tij tërësisht kundërkombëtare [kundërgreke]". Jerotheu u përpoq të mirëvendosej në përplasjet e brendshme kishtare në Shqipëri. Kotoko shkruante në emër të tij se bashkëpunimi me Vasilin ose me cilindo kryeprift të dhënë pas Greqisë ishte domosdoshmëri, teksa dy episkopët e tjerë nuk mund të vepronin në këtë mënyrë. Hirësi Theofani ishte dëbuar, ndërsa Hirësi Kristofori ishte nën ndikimin e Kishës Autoqefale Shqiptare. Sipas Jerotheut, Kisi kishte kërkuar bashkëpunimin e ngushtë nga Ekzarku Patriarkal me kërkesa të vazhdueshme, letra e telegrame, nën frikën pse ishte mbështetës i Fan Nolit gjatë kryengritjes së qershorit 1924. Ai vlerësonte se nevoja dhe rëndësia e ngjarjeve do ta detyronin Kisin të bashkëpunonte dhe përafrohej me sinqeritet.[545]

Jerotheu shprehej në pikën e dytë se do të kërkohej mbledhja e një kongresi të ri kishtar për zgjidhjen e çështjes. Ky kongres do të thirrej nga kryebashkiaku i Korçës, Vasil Avrami, dhe vetë Jerotheu, duke prishur Këshillin e Lartë Kishtar, të kryesuar nga Atë Vasil Marko.[546] Kotoko shkruante se gjendja do të qartësohej, pasi "shumë i rrezikshmi Fan Noli" kishte ikur nga skena politike e kishtare. Jerotheu do të kërkonte që Kisha të ishte ose autoqefale, ose e vetëdrejtuar me kushte, sipas planit që kishte paraqitur Patriarkana Ekumenike. Sipas Jerotheut, mundësitë e thirrjes së kongresit ishin të shumta prej qarqeve të tjera, por jo edhe prej Mitropolisë së Korçës, ku një "bandë e vogël" vepronte kundër mendimit të tij. Jerotheu sqaronte në pikën e tretë se do të kërkonte rishikimin e punimeve të Kongresit të Beratit dhe dërgatës që u nis në Stamboll në vitin 1923. Kështu, ai do të mbështeste idenë që Kisha Shqiptare të ishte në një kohë të gjatë nën mbikëqyrjen e Kishës së Madhe, pasi i mungonin ata burra me përvojë dhe besueshmëri që do të mundësonin sigurimin e qenies dhe të traditave të saj. Jerotheu zotohej të kërkonte arritjen e një marrëveshjeje me ndërmjetësues përfaqësuesit grekë në Tiranë, nëse përfshirja e Kishës së Shqipërisë nën Patriarkanën Ekumenike do të kundërshtohej. Ai shprehej i gatshëm të pranonte largimin nga Shqipëria, nëse do të nevojitej.[547]

Pika e katërt trajtonte mendimin e Jerotheut për t'u takuar me Nolin në Greqi. Ai shpresonte të arrinte në një marrëveshje për qëndrim të përbashkët të mbarë ortodoksëve,

[545] Po aty.
[546] Hirësi Kristofor Kisi kërkoi diçka të ngjashme, në një letër që i dërgoi Jerotheut më 25 janar 1925. Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 91.
[547] Kondis, *Elinizmos III*, 196-207.

teksa ishin përhapur fjalë se Noli kishte kaluar në mbështetje të Greqisë, pas frikës së qëndrimit nën "qeverisjen e Veriut". Jerotheu këmbëngulte në pikën e pestë që të gjithë "vorioepiriotët" duhet të ktheheshin në Shqipëri, përfshi Hirësi Polikarpin, profesori i fesë në Janinë, Harallamb Dhonato, drejtori i shkollave greke në Aleksandrupoli, Vasil Joanidhi, mësuesi Mihal Kriqi etj. Njëkohësisht, ai sugjeroi që Patriarkana të ngrinte episkopatë në zonën e Gjirokastrës, teksa krijimi i Mitropolisë së Drinupojës brenda territorit grek e kishte lënë të paqartë gjendjen pjesën brenda tokës shqiptare. Jerotheu kërkonte përmes pikës gjashtë të emërohej Mitropolit i Korçës në mënyrë të rregullt nga Patriarkana Ekumenike, teksa ai përdorte këtë emërtim në marrëdhënie me zyrtarët dhe shqiptarët në përgjithësi.[548]

Pika e shtatë trajtonte fjalët e përhapura në Shqipëri se qeveria e re do të kthente mbrapsht gjendjen kishtare. Ndërkaq, ai kërkonte krijimin e shkollave priftërore në Korçë, Gjirokastër dhe Vlorë, për t'u shfrytëzuar edhe si shkolla greke, në pikën e tetë. Pamundësia e plotësimit të kësaj kërkese duhet të zhdëmtohej me ofrimin e bursave. Jerotheu kërkonte në pikën e nëntë që qeveria greke të zhbllokonte trashëgimitë e bamirësve nga Shqipëria, që u linin pasuritë mitropolive. Ai kërkonte me anë të pikës dhjetë të lehtësohej tregtia mes Korçës dhe Follorinës dhe Janinës me Leskovikun, për të mundësuar një rritje të mirëqenies së popullsisë ortodokse. Ndërkaq, trajtonte në pikën pasardhëse gjendjen e shqiptarëve në Amerikë. Ai udhëzonte hapjen e kishave dhe shkollave shqiptaro-greke nga epirotë për të mundur shqiptaromëdhenjtë.[549]

Pas kësaj pasqyre, Mitropoliti i Korçës bënte të qartë qëndrimin që do të mbante në të ardhmen. Ai theksonte se veprimtaria e tij do të ishte e një natyre të brendshme. Hirësia do të përdorte ndikimin shqiptar për të shmangur ndikimet e huaja dhe për t'i çuar gjërat në një drejtim të caktuar. Sipas tij, ndërtimi ishte më i vështirë sesa shkatërrimi, mirëpo vetë Jerotheu ishte besimplotë. Ai do të vepronte brenda Shqipërisë, nën ndikimin shqiptar për të rritur Kishën dhe do të lidhej sërish me Greqinë, nëse do t'i duhej ndihmë. Në fund, ai udhëzonte që ky bashkëbisedim të bëhej nëpërmjet ministrit grek në Durrës, Panurjas.[550]

Parashtresa e Jerotheut përbën një çast kyç në lëvizjen kishtare. Ajo u hartua menjëherë pas Marrëveshjes së Beogradit dhe fitores së Ahmet Zogut, si një plan i rëndësishëm për të dyja palët. Jerotheu, nëpërmjet Kotokos, përdor një gjuhë grekomane dhe disa herë kundërshqiptare. Mirëpo, sugjerimet e tij i shkonin tërësisht për shtat lëvizjes kishtare shqiptare. Gjuha grekomane ishte një domosdoshmëri, teksa ajo ishte përpjekja për t'u ripajtuar me Greqinë, pas veprimtarisë së tij në kundërshtim të hapur me Patriarkanën Ekumenike. Ikja e Mitropolit Theofanit tregonte për Jerotheun se Greqia kishte marrë fuqi të re në çështjen kishtare dhe bashkëpunimi me të ishte i domosdoshëm. Ai tregon se ishte në dijeni për fjalët e përhapura për rikthimin e gjendjes kishtare, çka ka pikënisjen në Marrëveshjen e Beogradit. Kështu, Jerotheu nuk kishte lëvizje tjetër përveçse të rifitonte besimin e Athinës.

Kjo duket në disa pika. Së pari, thirrja e kongresit të ri nga atdhetari Vasil Avrami tregon se lëvizja e Jerotheut ishte bashkërenduar mes atdhetarëve shqiptarë. Së dyti, rënia e Këshillit të Lartë Kishtar dhe zëvendësimi i tij me një Sinodh ishte i vetëkuptueshëm, teksa vetë Këshilli kishte tejkaluar afatin dyvjeçar sipas Statutit të Kongresit të Beratit

[548] Po aty.
[549] Po aty.
[550] Po aty.

dhe ishte i jashtëligjshëm prej shtatorit 1924. Për më tepër, të gjithë prisnin shkrirjen e Këshillit, teksa Atë Vasil Marko pritej të ishte i flijuari i parë i hakmarrjes së qeverisë së re. Dalja përpara një skenari të tillë ishte një veprim i matur i Jerotheut, pasi Kisha mund të duhej të vendosej nën një ekzark të ri patriarkal, nëse këshilli do të shkrihej. Kjo do të dëmtonte përfundimisht lëvizjen kishtare shqiptare. Lënia hapur e mundësinë së autoqeflaisë nëse "vetëdrejtimi kundërshtohet", çka ishte e sigurt se do të ndodhte, rrëfen pikërisht drejtimin e lëvizjes së Hirësisë. Ndërkaq, arsyetimi se "vorioepirotët" duhet të ktheheshin për të plotësuar vendet në Kishë, ishte i njëjti me përligjen e përdorur kur Hirësia thirri Kristofor Kisin, një vit më parë. Edhe kundërthëniet ndaj Mitropolitit Theofan duhen parë në këtë sfond. Nga njëra anë, e cilëson "më të rrezikshmin", nga ana tjetër kërkon mendim e shtetit grek nëse duhet të takohet me Nolin për të arritur në një qëndrim të përbashkët. Ndërkaq, Kristofor Kisin e cilëson fanolist, porse thotë se kishte ndryshuar qëndrim pas rënies së Nolit, duke e përligjur edhe Mitropolitin e Beratit. Dëshira e Jerotheut për të qenë Kryepiskopi i ardhshëm i Shqipërisë ishte e fuqishme, ndaj ai e përligj Kristoforin si mbështetës të çështjes, siç do ta donte Greqia, por duke e lënë në hije përpara vetes. Jerotheu kërkon të vendoset si Mitropolit i Korçës edhe nga Patriarkana, të lirohen fondet që mund të mbanin gjallë Kishën në Shqipëri, të bllokuara në bankat greke, të çeleshin me to shkolla priftërore që do të mund të rrisnin brezin e ardhshëm të priftërinjve në Shqipëri dhe paralajmëronte Greqinë se do të sillej si shqiptar i mirë për shërbimin e madh.

Këto lëvizje tregojnë se qëllimi i Jerotheut ishte pikërisht autoqefalia dhe rënia e varësisë ekonomike nga Greqia, porse kjo bëhej e mundur vetëm me ndërmjetësimin e saj, në kushtet e reja. Përparësia që fitoi Greqia për shkak të rënies së qeverisë së Nolit dhe pasiguria nga qëndrimi i qeverisë së Ahmet Zogut, sidomos pas Marrëveshjes së Beogradit, ndryshoi sërish baraspeshat në tërheqjen e litarit mes dy vendeve për çështjen kishtare. Prandaj, edhe Jerotheu nisi një rrugë të tij...

3.3 Dorëzimi Episkop i Visarion Xhuvanit

Ahmet Zogu u gjend përballë rrymave të ndryshme në muajt e parë të rikthimit. Përkrahësit e Nolit e shihnin veten në rrezik. Grekomanët po përpiqeshin të prishnin autoqefalinë, të mbështetur haptazi nga legata greke. Ndërkaq, rryma e tretë e krijuar rreth Jerotheut kërkonte afri të luhatshme me grekomanët për të siguruar autoqefalinë. Në këtë sfond, atdhetarët liberalë u kthyen te i përzgjedhuri i vjetër, Arkimandrit Visari, i cili kishte mbetur në hije të zhvillimeve kishtare për dy vjet. Xhuvani u la i lirë të lëvizte nga Vlora pas rënies së qeverisë së Nolit dhe riçeli "Skënderbeun". Fletorja mbështeti haptazi nevojën e një kishe autoqefale dhe shqiptare. Lëvizja e Arkimandritit bëri që fanolistët ta përgëzonin dhe të shtrinin dorën për bashkëpunim. Mihal Grameno shkruante në "Koha" më 21 shkurt 1925 se nuk kishte dyshime që teologu shqiptar do ta mbështeste Kishën Kombëtare dhe uronte ta shihte shumë shpejt në fronin episkopal.[551]

Nga ana tjetër, Arkimandrit Visari ishte në përplasje të hapur me Hirësi Kristoforin e rrjedhimisht me një pjesë të rëndësishme të rrymës kombëtare. Xhuvani e qortonte Kisin si mbështetës të flaktë të qeverisë noliste dhe njëkohësisht si të

[551] "Lavdërim", *Koha* nr. 211, 21 shkurt 1925, 2.

dyfytyrshëm, teksa kishte lejuar meshimin në gjuhën greke.[552] Mbështetja e Mitropolitit të Beratit gjatë qeverisë së Nolit theksohet edhe nga Hirësi Jerotheu në parashtresën e dërguar në Athinë. Gjithashtu, ajo dallohet në marrëdhëniet mes dy burrave kishtarë, të cilët janë takuar së paku tri herë gjatë qeverisjes së Nolit. Ndërkaq, padia e dytë duket se është thjesht një zmadhim.

Hirësi Kristofori nuk u përgjigj drejtpërdrejt. Ai tha për fletoren "Liria" se do ta rrëzonte shumë denjësinë po t'i përgjigjej një njeriu të cilësisë së Xhuvanit, të cilin të gjithë shqiptarët e njihnin. Qëndrimi kundër Visarit u shpalos në të njëjtin shkrim. Përplasja kishte nisur në Manastirin e Zvërnecit, ku Arkimandriti ishte veçuar nga qeveria e Nolit. Xhuvani fajësohej për shpenzime të mëdha dhe madje se i kishte dhënë zëvendësmitropolitit të Vlorës, Kristo Karbunarës, një letërtërheqje të rreme prej 3000 frangash ari. Shkrimi nënvizonte se Visari shpenzonte treçerekun e ditës në shërbim të barkut dhe Hirësi Kristofori ishte bërë gati ta dëbonte për shkak të shpërdorimit. Përgojimet përfundonin se Xhuvani fliste vetëm greqisht gjatë qëndrimit në Zvërnec.[553]

Shkrimet u provuan shpejt të pavërteta. "Liria" u detyrua të botonte një letër të Kristo Karbunarës në numrin pasardhës. Zëvendësmitropoliti shpallte se Arkimandrit Visari i kishte shlyer të gjithë huanë prej 7000 lirash, duke botuar dëshmitë përkatëse.[554]

Xhuvani kishte mbështetjen e plotë të zyrtarëve shtetërorë, aq më tepër pas sulmit të pashoq që fletorja "Skënderbeu" kishte ndërmarrë ndaj qeverisë, tashmë të rrëzuar, të Fan Nolit. Kështu, Arkimandriti ishte një zgjedhje e duhur në planin kishtar për Kryetarin Ahmet Zogu. Ai ishte teolog, doktor i shkencave prej Universitetit të Athinës, atdhetar e njëherazi besnik i sundimit të ri. Përzgjedhja e tij shihej si dhuratë e çmueshme për qeverinë, e gjendur mes trysnisë greke prej Marrëveshjes së Beogradit nga njëra anë dhe kundërshtarëve politikë fanolistë nga ana tjetër. Ministria e Brendshme i kërkoi zyrtarisht e fshehtazi Këshillit të Lartë Kishtar, më 24 mars 1925, që Arkimandrit Visar Xhuvani të emërohej zëvendësmitropolit i Durrësit, në vendin e zbrazur prej Hirësi Theofan Nolit.[555]

Visari nuk kishte qëndruar duarlidhur. Ai kishte përdorur ndikimin vetjak dhe mbështetjen qeveritare, për të bindur tre nga gjashtë zëvendësitë kryepriftërore ta lakonin emrin e tij për mitropolit të Durrësit. Pikënisja kishte qenë Elbasani, ku Pleqësia Kishtare e drejtuar nga atdhetari i sprovuar, Ikonom Dhimitër Dhimitruka, u mblodh më 8 mars dhe kërkoi emërimin e Visarit Mitropolit. Vendimi kujtonte se Arkimandrit Visari ishte zgjedhur episkop edhe tri herë të tjera, në shtator dhe nëntor 1919, sikurse edhe gjatë Kongresit të Beratit. Pleqësia e Pogradecit mori vendim të ngjashëm, më 14 mars. Ndërsa, pleqësia dhe 130 familje të krishtera të Tiranës pasuan pesë ditë më vonë.[556] Kështu, Këshilli i Lartë Kishtar e emëroi Arkimandrit Visarin zëvendësmitropolit të Durrësit, Gorës dhe Shpatit, më 28 mars 1925.[557]

---

[552] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 21.
[553] "Tribunë e Lirë", *Liria* nr. 27/43, 17 mars 1925, 1-2.
[554] *Liria* nr. 31, 31 mars 1925, 1.
[555] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1925, D. 58, f. 3, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 24 mars 1925.
[556] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 19-22.
[557] Vissarion Xhuvani, *Vepra, Për Kishën Orthodhokse Shqiptare; Në Kuvendin e Shqipërisë; Për jetën dhe veprën*, përg. Nos Xhuvani dhe Pavli Haxhillazi (Tiranë: "55", 2007), 8-9.

Ai nisi detyrën zyrtarisht më 8 prill, duke iu drejtuar besimtarëve me një qarkore, ku kërkonte mbështetje dhe bashkëpunim.[558] Xhuvani udhëzonte priftërinjtë dhe grigjën të përkrahnin njëri-tjetrin, shtetin dhe Kryetarin e Republikës, të zbatonin rregullat e statutin, si edhe të fuqizonin radhët e Kishës Autoqefale të Shqipërisë. Arkimandriti shpaloste qëllimet për krijimin e shoqërive bamirëse; rritjen e arsimimit, diturisë dhe gjendjes ekonomike të priftërisë; rritjen e cilësisë së mësimit të fesë për fëmijët; hartimin e një rregulloreje për veprimtarinë e pleqësive dhe kujdestarëve etj. Ai zotohej se do të gjendej në krah të zëvendësive dhe mbarë popullit dhe do të ishte mbrojtës i palodhur në çdo nevojë dhe punë fetare, duke udhëzuar besimtarët t'i drejtoheshin pa ndrojtje për çdo çështje, sipas mësimeve të Jisu Krishtit.[559]

Qarkorja rrëfente bindjen e Arkimandritit se ai do të zgjidhej Mitropoliti i ardhshëm i Durrësit. Një lëvizje e shpejtë do të shpëtonte edhe Kryetarin Zogu nga trysnia greke për plotësimin e vendeve të zbrazëta nga të parapëlqyerit e Athinës. Mirëpo, rrethanat e reja e vështirësonin. Arkimandrit Visari mund të merrte emërimin nga Këshilli i Lartë Kishtar, me mbështetjen e fanolistëve, porse nevojitej dorëzimi nga Hirësi Kristofori dhe Hirësi Jerotheu, të cilët nuk do ta pranonin kurrsesi pas përplasjes të të parit me Arkimandritin dhe joshjes të Athinës nga i dyti. Një zgjidhje e mundshme mbetej që emërimi nga Këshilli i Lartë Kishtar të përfundohej nga episkopë të huaj, sikurse vetë Xhuvani kishte lënë të hapur që në ditët e Kongresit të Beratit. Mirëpo, një skenar i tillë nuk ishte i parapëlqyer. Nga njëra anë, ai do të zbulonte ndikimin qeveritar pas vendimit, në një kohë kur Ahmet Zogu shtirej i gatshëm të zbatonte Marrëveshjen e Beogradit. Nga ana tjetër, do të krijonte çarje mes dy mitropolitëve dhe pjesës tjetër të Kishës Autoqefale, me gjasë edhe me qeverinë.

Sidoqoftë, Visari e quante domosdoshmëri kombëtare dorëzimin episkop jashtë shtetit. Ai botoi pas një viti, arsyet që e çuan në këtë vendim. Xhuvani shpaloste se gjendja kishtare në Shqipëri e kishte tejkaluar kufirin e rregullsisë përpara dorëzimit të tij. Priftërinjtë meshonin në emër të ish-mitropolit Vasilit në Gjirokastër, në emër të Patriarkut dhe çdo episkopi në Berat, në emër të Patriarkut në Korçë, në emër të çdo episkopi ortodoks në Durrës-Tiranë dhe në emër të Patriarkut serb në Shkodër. Kjo vinte në kundërshti me Kongresin e Beratit që caktonte se duhet të meshohej vetëm në emër të çdo episkopi ortodoks derisa të ngrihej Sinodhi. Statuti ishte shkelur edhe në drejtime të tjera, sipas Xhuvanit. Patriarkana kishte pranuar në heshtje autoqefalinë, pasi nuk kishte kundërshtuar emërimin e Jerotheut dhe Kristoforit në mitropolitë e Korçës dhe Beratit. Ndërkaq, Këshilli i Lartë nuk kishte përkthyer librat në shqip, nuk kishte emëruar Visarin Mitropolit dhe nuk kishte plotësuar Sinodhin brenda dy viteve.[560]

Visari ankohej se Këshilli i Lartë nuk e kishte mbështetur, pavarësisht nga ndihma që ai kishte dhënë. Arkimandriti pyeti dy kryepriftërinjtë në prill 1925 nëse ishin të gatshëm ta dorëzonin. Jerotheu e njoftoi se nuk do të dorëzonte asnjë episkop pa urdhrin e Patriarkanës. Sakaq, Kristofori ishte i hapur, me kusht gjetjen e një episkopi që njihej nga Patriarkana për kryerjen e rregullt të dorëzimit. Visari shihte se gjendja kishte ndryshuar nga dy vite më parë, kur dy episkopët kishin dorëzuar Theofanin në mënyrë

[558] Zëvendësmitropoliti kishte mbërritur më herët në Tiranë, ku u votua për pleqësinë kishtare. Zgjedhjet kishin nxjerrë fitues atdhetarë të shquar si Pandeli Jorgoni, Marko Hobdari, Leonidha Nishku, Spiro Leka, Gavril Lasku dhe Spiro Janko. ("Mitropoli e Durrësit", Liria nr. 33/49, 7 prill 1925, 2.)
[559] Xhuvani, *Vepra*, 8-9.
[560] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, 23-28.

kryengritëse. Ai theksonte se vetëm një episkop ishte i nevojshëm për krijimin e Sinodhit, teksa Theofani ende nuk ishte dënuar nga Gjykata Politike. Arkimandrit Visari mendonte se të qenit episkop e ndihmonte çështjen në dy drejtime. Së pari, ai do të shndërrohej në episkopin e parë autoqefalist me mish dhe shpirt, tërësisht i bindur ndaj Këshillit të Lartë. Së dyti, do të shkundte nga mosveprimi i deriatëhershëm zyrtarët kishtarë dhe politikë.[561]

Rrjedhimisht, Arkimandrit Visari zgjodhi të ndiqte hapat e Fan Nolit më me maturi. Ai iu drejtua episkopëve të Kishës Ruse në Mërgim për t'u dorëzuar rregullisht episkop. I ngarkuari me punë i Shqipërisë në Beograd vërteton se lëvizja ishte kryer me urdhër të Ahmet Zogut, duke cituar fletoren "Pravda". Visar Xhuvani rrëfen se kishte marrë pëlqimin e atdhetarëve të Elbasanit dhe drejtuesve të shtetit përpara nisjes. Ndërkaq, kishte kërkuar lejen përkatëse nga Atë Vasil Marko, i cili i qe përgjigjur se do të shkonte në Tiranë për t'u marrë vesh gojazi. Sipas Xhuvanit, këto fjalë dëshmonin se Atë Vasili e mbështeste në parim dorëzimin, pasi në të kundërt do ta kishte mohuar prerazi. Dy kryepriftërinjtë rusë dorëzuan episkop Visar Xhuvanin, bazuar në kërkesat e pleqësive kishtare të Mitropolisë së Durrësit në Manastirin e Savinës, në Kotorr të Dalmacisë. Dorëzimi u krye në gjuhën shqipe dhe në shërbim të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ai mori emrin Visarion dhe u betua:[562]

> "Kam me kjenë ruejtës besnik i të gjithë dogmavet, kanonevet dhe rregullavet të shenjta të Kishës Orthodhokse që përmblidhen në shkrimet e Shenjta, në gojdhanat e Hyjnushme, dhe në vendimet e shtat Sinodhevet Ikumenike si edhe në mësimet të Etnëve Shenjtë, të kishës Shejtë Orthodhokse, dhe siguroj me ndërgjegjen T'ime fetare se kam me qenë gjith jetën T'ime besnik i Kishës Autoqefale Orthodhokse kombëtare të Shqipnis të kryesueme sot prej Këshillit nalt të saj; dhe nuk kam me i u përulë asnji fuqie që mund të kërcënohet menjiherë kondra detyrave të mija të Shenjta Episkopale, si pjestar i Kishës së sipërpërmendun. I Lutemi Perëndisë për Këshillin e nalt Kishtar të Shqipnis, Republikën Shqiptare si dhe për paqen e gjith botës, dhe bashkimin e të gjithëve. Lavdi qoft mi të madhin Perëndi".

Episkop Visarioni e cilësoi dorëzimin të rregullt. Së pari, ai qe dorëzuar prift për të shkuar në meshtarinë e Tepelenës. Xhuvani kishte qëndruar shkurtazi në Sofje, pa emërim zyrtar dhe ishte nisur për në Shqipëri, ku filloi shërbesat. Prandaj, ai arsyetonte se nuk i përkiste varësisë së asnjë kishe të huaj. Rrjedhimisht, kishte kërkuar ndihmën fillestare të dy episkopëve që gjendeshin në Shqipëri, të cilët Visarioni i cilësonte si "të Patriarkanës së Kostandinopojës", nisur nga vendimi i Kongresit të Beratit që e kishte zgjedhur episkop. Mospranimi prej tyre bëri që ai t'i drejtohej ndihmës shpirtërore të kryepriftërinjve të huaj, sipas kanonit 6 të Sinodhit të Sardhiqisë.[563]

Arsyetimi i Hirësi Visarionit ishte i drejtë, vetëm nëse dy mitropolitët në Shqipëri vareshin nga Patriarkana Ekumenike dhe jo nga Kisha Autoqefale. Këndvështrimi i Visarionit përdorej nga pala greke, që nuk njihte emërimet e bëra nga Këshilli i Lartë Kishtar. Arsyetimi kishte themele të shëndosha, duke përdorur këndvështrimin e Patriarkanës, nëse pranohej e mirëqenë se Kisha ishte Autoqefale prej pavarësisë, edhe pse shpallja vonoi dhjetë vjet. Mirëpo, mitropolitët, Këshilli i Lartë Kishtar dhe qeveria shqiptare i njihnin Hirësi Jerotheun dhe Hirësi Kristoforin si episkopë vendas. Hirësi

[561] Po aty.
[562] AMPJ, V. 1925, D. 260, f. 2, Legata e Beogradit drejtuar MPJ, 15 maj 1925.
[563] AQSH, KOASH drejtuar MD, 14 dhjetor 1931, cit.

Visarioni duhet të dorëzohej nga dy mitropolitët e Kishës Shqiptare, pa kërkuar ndihmë në një Kishë të huaj, nëse pikëpamja shqiptare merrej parasysh.[564]

Dorëzimi i Visarionit solli pështjellim. Ai e vlerësoi heshtjen dyjavore të Këshillit Kishtar si pëlqim dhe vijoi të drejtonte Mitropolinë e Durrësit.[565] Shtypi shfaqi habinë. Mihal Grameno e quajti të dyshimtë zgjedhjen e mikut të tij të ri, duke nënkuptuar se ai do t'i shërbente një kishe të huaj. Ai e vlerësoi të parregullt dorëzimin, pasi Xhuvani nuk ishte emëruar nga Këshilli i Lartë Kishtar. Gjithsesi, Grameno shprehej besimplotë se Visarioni do të rrinte mënjanë për të mos shkaktuar përçarje ndër ortodoksë.[566] "Gazeta e Korçës" ishte më e ashpër. Ajo e cilësoi "episkop serb natyrisht", duke nënqeshur me veprën "atdhetare" dhe shprehu bindjen se pushimi nga zëvendësmitropolit i Durrësit nuk do të vononte.[567]

Visari njoftoi se dorëzimi episkop nuk fshihte fronëzimin e vetvetishëm si Mitropolit i Durrësit, teksa kjo vendosej nga Këshilli i Lartë Kishtar. Ai vendosej në shërbim të Këshillit, duke pritur një emërim. Atë Vasil Marko nuk e njohu dorëzimin, në përpjekje për të ruajtur baraspeshat e brishta që ishin krijuar mes mitropolitëve dhe Këshillit Kishtar. Ai njoftoi ministrin e Drejtësisë, Petro Poga, se dorëzimi ishte i paligjshëm dhe i dëmshëm për Kishën dhe vendin. Marko kërkoi ndalimin e Xhuvanit nga çdo shërbesë fetare dhe vendosjen nën vërejtje.[568] Ministri Poga u përgjigj më 16 maj se Kisha ishte e lirë të mos e njihte dhe të mos e lejonte të meshonte si episkop.[569]

Qeveria u tregua e matur. Sidoqoftë, ajo kishte tashmë një episkop në shërbim, nëse pala greke do të tregohej e vrazhdë në kërkesa. Athina ishte paralajmëruar nga Jerotheu për mundësinë e plotësimit të shpejtë të episkopatave të zbrazëta nga pala shqiptare. Ndaj, kryepriftëria e Visarionit veniste trysninë greke. Këshilli i Lartë emëroi civilin Vasil Rusi zëvendësmitropolit të Durrësit, në kundërshtim me Statutin e Beratit, që caktonte se anëtarët klerikë të Këshillit ishin *ipso facto* zëvendësmitropolitë në qarqet kishtare. Rrjedhimisht, shkarkimi i Rusit do të ishte lehtësisht i përligjur në çdo çast që do ta lypte nevoja. Ndërkaq, Pleqësia Kishtare e Elbasanit kërkoi njëzëri për herë të pestë emërimin përfundimtar të Visarionit, Mitropolitit të Durrësit, më 19 qershor.[570] Shkresa nuk mori përgjigje. Mirëpo, ajo do të përbënte pikënisjen e një vendimi të shpejtë, nëse emërimi i Episkop Visarionit do të shihej i domosdoshëm nga qeveria dhe Këshilli Kishtar. Çështja u bisedua në mbledhjen e Këshillit të Lartë Kishtar në fillimkorrik, pa dalë në vendime. Xhuvani mori mbështetjen botore të fanolistëve, të cilët kujtonin veprimtarinë atdhetare, por edhe të qeverisë që kishte udhëzuar emërimin e tij Mitropolit të Durrësit.[571] Madje, Ahmet Zogu i shprehu haptazi Atë Vasil Markos habinë për mosemërimin e Visarionit, duke e vlerësuar si një çështje me rëndësi për politikën e brendshme dhe sidomos atë të jashtme.[572] Gjithsesi, emri i Episkop Visarion Xhuvanit ishte i gatshëm të përdorej në çdo çast nga ana e qeverisë.

---

[564] Dorëzimi u quajt kundërkanonik fillimisht, por u pranua nga Patriarkana Ekumenike në vitin 1937.
[565] AQSH, KOASH drejtuar MD, 14 dhjetor 1931, cit.
[566] "Arqimandrit Xhuvani Episkop", *Koha* nr. 221, 16 maj 1925, 1.
[567] "Arqimandrit Xhuvani", *Gazeta e Korçës* nr. 185, 16 maj 1925, 2.
[568] AQSH, F. 155 "MD", V. 1925, D. VIII-31, f. 34, Këshilli i Lartë Kishtar drejtuar MD, 14 maj 1925.
[569] AQSH, F. 155 "MD", V. 1925, D. VIII-31, f. 33, MD drejtuar Këshillit të Lartë Kishtar, 16 maj 1925.
[570] Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* 31.
[571] "Mbledhja e Këshillës të Kishës Autoqefale Orthodhokse", *Koha* nr. 227, 27 qershor 1925, 2.
[572] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1925, D. 58, f. 1, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 24 korrik 1925.

3.4.Trysnia greke ndaj Ahmet Zogut për zbatimin e zotimeve të Beogradit

Asi nën mëngë me emrin Visarion Xhuvani nuk mund të përdorej ende nga një qeveri e vendosur me shpatulla për muri prej zotimeve të dhëna në Beograd. Ahmet Zogu ishte i detyruar të vepronte me kujdes në çështjen kishtare. Ai do të haste trysninë greke për zbatimin e Marrëveshjes së Beogradit dhe përpjekjet për vendosjen në zbatim të planit të fshehtë të Jerotheut dhe Kotokos, gjatë muajve të parë të kryesimit të Republikës. "Liria" e Vasil Dilos nisi sulmin e parë ndaj Këshillit Kishtar. Fletorja shkruante më 11 janar, dy javë pas riardhjes në pushtet të Zogut, se një prift nga Korça, Atë Vasil Marko, i vetëquajtur kryetar i një Këshille Kishtare, dëshironte të ndërhynte në kishat e Gjirokastrës. Dilo arsyetonte se nuk kishte më këshillë kishtare, pas ardhjes së episkopëve në Shqipëri. Shkrimi ngrinte domosdoshmërinë e thirrjes së një kongresi të ri, çka sipas tij dëshirohej edhe nga qeveria dhe i përngjanin planit të fshehtë të Jerotheut.[573]

"Liria" u përgjigj ashpër, kur Visarion Xhuvani botoi në "Skënderbeu" qarkoren qeveritare se Këshilli i Lartë Kishtar vijonte të kishte nën drejtim manastiret e të gjitha mitropolive. Ish-deputetët dhe anëtarët e pleqësive kishtare në Gjirokastër, Labovitiadhi, Dilo, Vasil Shahini, Sokrat Bozhori e të tjerë u shprehën të tronditur nga qarkorja dhe kundërshtuan në emër të të gjithë të krishterëve të qarkut, duke kërkuar ruajtjen e status quo-së kishtare. "Liria" sulmonte edhe Mitropolit Theofanin, me synim njësimin e tij me lëvizjen atdhetare në Kishë. Shkrimi e quante Nolin idhullin e simotrave, që Asambleja e shpalli fals dhe Pleqësia Kishtare e Durrësit e tëhuajti.[574] Fletorja vijoi botimin e kërkesave të ortodoksëve për thirrjen e një kongresi të ri, duke shtuar trysninë ndaj qeverisë.[575] Nga ana tjetër, i mbështeturi prej qeverisë Visarion Xhuvani bënte të ditur se një kongres i tillë ishte i domosdoshëm, teksa Kisha ishte bërë vegël e shumë synimeve qesharake. Mirëpo, ai mendonte se kongresi duhet të përbëhej nga paria e zgjedhur e ortodoksëve. Xhuvani shprehej se nuk duhet të vendosnin arkimandritët apo episkopët, duke hedhur poshtë thelbin e kërkesave të rrymës së Jerotheut.[576]

Trysnia ndaj Zogut drejtohej prej Greqisë. Ministri i saj në Durrës, Panurjas, u takua me Kryetarin e Republikës, Ahmet Zogu, në fillimshkurt 1925. Zogu u shpreh se çështjet kishtare dhe arsimore do të zgjidheshin në çdo mënyrë të ligjshme. Ai zotohej se do të përdorej edhe dhuna, nëse do të haseshin kundërshtime. Bashkëbiseduesit vendosën që banorët duhet të kërkonin vetë mësimin e greqishtes në shkollat e fshatrave ortodokse shqiptare "për nevojat fetare të ortodoksëve".[577]

Rrjeti i deputetëve që mbanin lidhje me ministrin grek në Durrës ishte i gjerë. Ai përbëhej nga shumica e përfaqësuesve të qarkut të Gjirokastrës, Lezo, Papadhopulli, Haxhogllu dhe Muzina, me përjashtim vetëm të atdhetarit të sprovuar Petro Poga.[578]

---

[573] Vasil Dilo, "Tribun'e Lirë", *Liria* nr. 17/33, 24 janar 1925, 2.
[574] "Çështja Qishëtare e Ortodoksëvet", *Liria* nr. 20/36, 14 shkurt 1925, 1.
[575] "Çështja qishtare", *Liria* nr. 22/38, 27 shkurt 1925, 2.
[576] Visar Xhuvani, "Punët e ditës", *Skënderbeu* nr. 20, 16 fruer 1925, 1.
[577] Kondis, *Elinizmos III*, 195: IDAYE, D. Γ/62/a, nr. 2215, Ambasada Durrës drejt. MPJG, 13 shkurt 1925.
[578] Të gjithë deputetët që mbështetën këtë fushatë rridhnin nga pakica, me përjashtim të Ilia Muzinës që ishte shqiptar nga fshati Muzinë. Deputetët e pakicës në Kuvend ishin Vasil Bamiha nga Delvina, Dhimosthen Haxhogllu nga Skoriati, Telemak Labovitiadhi nga Dhuvjani, Niko Lezo nga Leshnica e Poshtme, Jan Papadhopulli nga Koshovica dhe Sokrat Bozhori nga Dhuvjani, në vitet 1922-1928. Ata u

Deputetët ngritën çështjet e zotimeve të Beogradit gjatë një takimi me Ahmet Zogun, porsa ishte shpallur Kryetar i Republikës. Zogu kishte thënë se kishte për qëllim shkatërrimin e gjendjes kishtare dhe kthimin e së vjetrës. Ministri grek i udhëzoi të mblidhnin popullin në qarkun e Gjirokastrës për t'i kërkuar qeverisë të mblidhte një kongres mbarortodoks për zgjidhjen e çështjes kishtare dhe përfshirjen e greqishtes në shkollat shqiptare.[579]

Kërkesa zyrtare u dorëzua në Ministrinë e Drejtësisë më 4 prill 1925. Ajo ishte shkruar në emër të shumicës së deputetëve të Gjirokastrës dhe 120 pleqësive të fshatrave të krishtera të qarkut. Nënshkruesit lypnin ngritjen e një seminari fetar në Gjirokastër dhe mësimin e "gjuhës fetare" në shkollat e ortodoksëve.[580] Vasil Dilo i cilësoi grekofobë kundërshtarët e kërkesës. Ai sqaronte se greqishtja ishte për ortodoksët si arabishtja e turqishtja për myslimanët dhe latinishtja për katolikët. Ndalimi i këtyre gjuhëve përbënte luftë kundër feve, pasi ato ishin përkohësisht të domosdoshme.[581] Arsyetimi i Dilos përmbante parakushtin se kjo gjendje ishte derisa shqipja të vendosej si gjuha e vetme në Kishë. Ai e quajti Shqipërinë rast të pakrahasueshëm me vendet e tjera të Ballkanit.[582]

Përkohshmëria e nevojës së greqishtes si gjuhë kishtare, nga niste arsyetimi i Dilos, ishte në të vërtetë përpjekja për të tejkaluar trysninë greke. Pa dyshim, autoqefalia përbënte thelbin e kërkesave shqiptare, teksa të gjitha lëshimet e tjera mund të shfuqizoheshin me të shpejtë pas pavarësisë së Kishës. Gjithsesi, shkrimet e "Lirisë" ngacmuan simotrat e saj si "Koha" apo "Gazeta e Korçës". Deputeti Rauf Fico sulmoi drejtpërdrejt Vasil Dilon, duke i kujtuar të kaluarën e dyshimtë. Dilo kishte cilësuar flamurin shqiptar "lepushkë", siç përdorej në kohën e autonomisë vorioepirote në Gjirokastër. Fico kërkoi të merren masa përpara kësaj tradhëtie.[583]

Arritja e vetme për palën greke ishte pranimi i çeljes së një shkolle priftërore në qytetin e Korçës, ku do të mësohej edhe greqishtja. Mirëpo, fitorja ishte e dyfishtë, teksa shkolla do të çelej sipas kërkesave të Sotir Peçit dhe Stavro Vinjaut, gjatë qeverisjes së Mitropolit Theofanit. Vendimi liroi trashëgiminë e Jovan Bankës, që prej vitesh mbahej bllokuar nga qeveria greke. Kërkesa u zyrtarizua në takimin e parë mes Ahmet Zogut dhe Mitropolitit të Korçës. Hirësi Jerotheu u paraqit në pritjen e Kryetarit të Republikës më 8 mars, i shoqëruar nga sekretari i Ministrisë së Brendshme, Sotir Martini, dhe atdhetari i sprovuar Ikonom Atë Josifi. Ai iu lut Zotit t'i jepte jetë të gjatë e fatbardhësi Kreut të Shtetit. Zogu vlerësoi rëndësinë e Kishës Autoqefale dhe u zotua për lartësimin e saj dhe përparimin e vëllezërve ortodoksë.[584]

Kjo bisedë është ndoshta më e rëndësishmja për përballimin e trysnisë greke të kësaj periudhe. Mirëpo, nuk kemi asgjë të shkruar. Dy çështjet që jemi të sigurt se janë biseduar janë njohja e autoqefalisë nga Patriarkana dhe shkolla priftërore e Korçës. Të dyja kanë rëndësi të shumëfishtë. Së pari, Jerotheu shprehet në një letër të pas disa muajve se gjatë takimit u njëmendësua vajtja e një dërgate të re në Stamboll për

---

pasuan nga Jani Melo nga Delvina dhe Harallamb Papadhopulli nga Koshovica, në vitet 1928-1932. Thanas Vaso, *Οι βουλευτές της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας στο Αλβανικό Κοινοβούλιο 1920-2011 [Deputetë të Pakicës Etnike Greke në Kuvendin Shqiptar 1920-2011]* (Tiranë: Neraida, 2012).

[579] Kondis, *Elinizmos III*, 208: IDAYE, D. Γ/62/a, nr. 3803, Ambasada Durrës drejtuar MPJG, 6 mars 1925.

[580] "Një nevojë e ngutshme", *Liria* nr. 33/49, 7 prill 1925, 1.

[581] "Gjuha Greke", *Liria* nr. 34/50, 10 prill 1925, 1.

[582] "Gjuha Greke", *Liria* nr. 35/51, 14 prill 1925, 1.

[583] *Liria* nr. 37/53, 25 prill 1925, 2.

[584] "Rëndësia e Kishës Autoqefale", *Koha* nr. 214, 14 mars 1925, 1.

përfundimin e çështjes kishtare.[585] Kjo do të thotë se Jerotheu, ose nuk e përmendi fare planin e fshehtë të dorëzuar në Athinë dhe të shpallur kudo ndër grekomanë, ose hartoi një marrëveshje të re me Kryetarin Zogu për të mundësuar autoqefalinë e kishës. Ndërkaq, vendimi për seminarin ortodoks u miratua nga qeveria shqiptare më 23 mars.[586] Kjo nënkuptonte se brezat e ardhshëm të priftërinjve do të arsimoheshin në Shqipëri, duke mundësuar vijimësinë e një kishe autoqefale.[587]

Qëndrimi i Jerotheut në Tiranë ishte i gjatë. Ai meshoi në Kishën e kryeqytetit menjëherë pas takimit me Zogun.[588] Ndërkaq, vendosi të qëndronte në Durrës, duke u arsyetuar me ngushtësinë e Mitropolisë së Tiranës.[589] Mitropolia në kryeqytet ishte e vogël, por kishte qenë e mjaftueshme për të mbrujtur Mitropolit Theofan Nolin. Zhvendosja për dhjetë ditë në Durrës lidhej me përpjekjen për sigurimin e drejtimit të Kishës Autoqefale. Jerotheu duhet të bashkërendohej me zyrtarët e Mitropolisë së Durrësit, sikurse edhe me legatën greke që strehohej po aty. Ai u largua më 23 mars, duke shprehur kënaqësinë për sigurinë e dhënë nga Kryetari i Republikës, teksa autoqefalia nuk vendosej më në pikëpyetje.[590]

Ahmet Zogu priti Mitropolitin e Beratit, Hirësi Kristoforin, më 28 mars.[591] Kisi udhëtoi të nesërmen për në Korçë përmes Gjirokastrës.[592] Kryetari i Kishës, Atë Vasil Marko, ishte i fundit që u thirr para Kryetarit të Republikës. Ai u nis për në Tiranë, duke u lajmëruar se çështja kishtare po shkonte drejt zgjidhjes.[593] Takimi ishte i rëndësishëm, teksa vërtetonte mbështetjen qeveritare ndaj Këshillit të Lartë Kishtar dhe vetë Atë Vasilit. Marko u prit me nderimet të veçanta më 23 maj. Zogu u zotua të ndihmonte në fuqizimin e mëtejshëm të Kishës dhe vlerësoi kreun e saj, si punëtor i palodhur që lufton pa trembur penguesit e çështjes. Në fund, i dha mbështetje të plotë Atë Vasil Markos të vendosi punën në vijë.[594]

Marko thirri menjëherë mbledhjen e Këshillit të Lartë për të biseduar mbi çështje me rëndësi dhe fuqizimin e gjuhës amtare në kisha.[595] Episkop Visarioni pritej të

---

[585] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1925 D. 271, f. 1, Hirësi Jerotheu drejtuar Kryetarit Zogu, 22 korrik 1925.
[586] *Liria* nr. 32/45, 3 prill 1925, 2.
[587] Qëndrimi proshqiptar i Jerotheut rrëfehet edhe nga shqiptarizimi i plotë i kishës në Korçë. Qytet vijonte të ishte vatër e përdorimit vetëm të shqipes në Kishë. Konsulli i ri grek Çorbaxhi mendonte se vetëdrejtimi kishtar ishte gjithçka që dëshirohej, kur u emërua, në prillin 1925. Mid'hat Frashëri e kishte paralajmëruar se nuk përballej me Turqinë, por me Shqipërinë, ku myslimanët dhe ortodoksët ishin shqiptarë, me shtetin, gjuhën dhe kishën e tyre (AMPJ, V. 1925, D. 261, f. 1, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 11 prill 1925). Ai do ta vërtetonte fjalët e Frashërit në më pak se dy javë qëndrimi. Çorbaxhi i shkruante Ministrisë së Punëve të Jashtme Greke se fëmijët nuk dinin aspak greqisht dhe mbarë popullsia fliste vetëm shqipen, për shkak të mungesave të shkollave greke. Ai shtonte se mesha ortodokse zhvillohej në shqip, sikurse lexohej edhe Ungjilli, me përjashtime të pakta. Konsulli theksonte se vetëm Korça përdorte vetëm gjuhën shqipe në meshim (Kondis, Elinizmos III, 273: IDAYE, D. Γ/62, nr. 6094, Konsullata Korçë drejtuar MPJG, 23 prill 1925). Kjo ishte mundësuar krahas Atë Vasil Markos edhe nga Mitropolit Jerotheu.
[588] *Liria* nr. 25/41, 11 mars 1925, 1.
[589] *Liria* nr. 26/42, 13 mars 1925, 1.
[590] *Liria* nr. 29/45, 24 mars 1925, 2.
[591] "Audiencë", *Liria* nr. 32/45, 3 prill 1925, 1.
[592] "Hirësi e Tij z. Kristoforo Kisi në Gjinokastrë", *Liria* nr. 40/56, 9 maj 1925, 1.
[593] *Koha* nr. 222, 23 maj 1925, 2.
[594] "Kryetari i Kishës Autoqefale, i Përndershmi Atë Vasil Marko u prit me nderime të posaçme në sallën e Kryetarit të Republikës", *Koha* nr. 223, 30 maj 1925, 1.
[595] *Koha* nr. 225, 20 qershor 1925, 3.

emërohej në një mitropoli gjatë mbledhjes, sipas kërkesës së Zogut dhe fanolistëve, të drejtuar nga Mihal Grameno.[596]

Mitropolit Kristofori ishte në takime nëpër fshatra të Gjirokastrës, në kohën e mbledhjes së Këshillit Kishtar.[597] Ai u shpreh se çështja ishte drejt zgjidhjes dhe Sinodhi ishte domosdoshmëri. Kisi tha se Kisha kishte për detyrë të frymëzonte atdhedashurinë ndër ortodoksë dhe të përpiqej për përparimin e kombit. Mirëpo, kjo nuk bëhej me fjalë të mëdha e të kota, por me vepra.[598]

Njohja e autoqefalisë pengohej prej turbullirave në Stamboll. Patriarkana kishte mbetur pa krye prej fundvitit 1924. Patriark Gregori VII vdiq më 17 nëntor 1924. Pasardhësi, Kostandini VI, u zgjodh në fillim të dhjetorit, por qëndroi vetëm 43 ditë, pasi u dëbua nga ushtria turke më 30 janar 1925. Bisedimet mes Turqisë dhe Greqisë kishin sjellë një periudhë të gjatë mosdrejtimi të Patriarkanës Ekumenike. Zgjedhja e Patriarkut të ri, Vasili III, u arrit vetëm më 13 korrik. Jerotheu e vlerësoi çastin e duhur për zbatimin e marrëveshjes së arritur për një dërgatë në Stamboll. Ai i shkroi Zogut se arriti koha për përfundimin kanonik të çështjes. Jerotheu sugjeronte që dërgata të përbëhej nga ligjvënësit ortodoksë, si përfaqësues me cilësitë e duhura për plotësimin e detyrës, duke përjashtuar këshillin e lartë, si të papërputhshëm me ligjet kishtare.[599]

Ministria e Jashtme u ngarkua të vepronte pranë Patriarkanës me qëllim që dërgata të nisej pasi të sigurohej pranimi i autoqefalisë.[600] Konsulli shqiptar në Stamboll, Nezir Leskoviku, takoi Patriarkun dhe i shprehu dëshirën e qeverisë shqiptare për të dërguar një përfaqësi mbi detajet e njohjes së autoqefalisë. Vasili shprehu se priste me kënaqësi një marrëveshje, por nuk mund të jepte fjalë për autoqefali, pasi kjo vendosej prej Sinodhit dhe jo prej tij.[601] Leskoviku i kërkoi Patriarkanës që përgjigjen t'ia jepte me shkrim, për ta kthjelluar qëndrimin. Patriarkana sqaronte në shkresën e dorëzuar më 8 gusht se ishte e gatshme të priste një dërgatë për të vendosur më të mirën për të krishterët ortodoks të Shqipërisë, në përputhje me kanonet e shenjta dhe rregullat kishtare.[602] Leskoviku kërkoi sqarime të mëtejshme nëse do të pranohej apo jo autoqefalia. Patriarkana ridërgoi të njëjtën përmbajtje më 15 gusht, veçse në fund përcaktonte "në limitet e kanoneve të shenjta dhe rregullave kishtare" dhe jo "në përputhje" siç ishte shkresa e parë.[603] Nezir Leskoviku arriti në përfundimin se Patriarkana nuk pranonte autoqefalinë dhe ndaj iu kundërvu nisjes së ndonjë dërgate.[604]

Rrjedhimisht, qeveria udhëzoi Këshillin Kishtar të shtynte zbatimin e Statutit të Beratit, derisa të përfundonte çështja kishtare. Ndërkaq, Këshilli vendosi të mos dorëzonte më asnjë prift që nuk dinte shqip, pas thirrjes përkatëse të mërgatës shqiptare në SHBA.[605]

Ahmet Zogu ia kishte dalë të mënjanonte trysninë greke për plot nëntë muaj të vitit 1925. Panurjas u takua me Kryetarin e Republikës për të vendosur pikat mbi "i", në

[596] "Mbledhja e Këshillës të Kishës Autoqefale Orthodhokse", *Koha* nr. 227, 27 qershor 1925, 2.
[597] "Lajme të Shkurtëra", *Tirana* nr. 29/70, 23 qershor 1925, 2.
[598] "Çështja Kishëtare", *Gazeta e Korçës* nr. 200, 11 korrik 1925, 2.
[599] AQSH, Hirësi Jerotheu drejtuar Kryetarit Zogu, 22 korrik 1925, cit.
[600] AMPJ, V. 1925, D. 261, f. 9, Vendimi i Këshillit Ministruer nr. 384, 30 korrik 1925.
[601] AMPJ, V. 1925, D. 261, f. 3, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 15 gusht 1925.
[602] AMPJ, V. 1925, D. 261, f. 7, Notë verbale e Patriarkut Ekumenik, 8 gusht 1925.
[603] AMPJ, 1925, V. 1925, D. 261, f. 8, Notë verbale e Patriarkut Ekumenik, 15 gusht.
[604] AMPJ, V. 1925, D. 261, f. 4, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 15 gusht 1925.
[605] *Koha* nr. 234, 22 gusht 1925, 3.

fund të gushtit 1925.[606] Zogu e quajti të paqenë çështjen e venomeve të Himarës, teksa himarjotëve nuk u ishin kërkuar aspak taksa. Ministri grek u qa se të krishterët trysnoheshin nga malësorët e Zogut dhe Myfit Libohova, krejt ndryshe nga zotimi në Beograd. Ndërkaq, kërkoi mosshtyrjen e dërgatës kishtare për në Stamboll. Zogu u shpreh se kishte lënë dorë të lirë ndaj Greqisë në çështjen kishtare dhe vërtetim për këtë ishte shtytja e Jerotheut për Kryepiskop të Shqipërisë. Kryetari e cilësoi Mitropolitin e Korçës grek dhe vegël e Greqisë. Kreu i shtetit tha se ishte i gatshëm të niste dërgatën me kushtin e vetëm të mos kthehej duarzbrazët, pra të njihej autoqefalia. Çështjet dytësore mund të zgjidheshin mes Patriarkanës dhe Jerotheut. Panurjas kërkoi të shqyrtonte mundësinë e vetëdrejtimit të Kishës, duke rikujtuar shpalljen e Zogut në Beograd se autoqefalia ishte gabim. Mirëpo, ai kundërshtoi duke thënë se autoqefalia e shpallur nga Noli ishte gabim, porse autoqefalia në vetvete ishte domosdoshmëri. Zogu tha se ai kishte urdhëruar që Visarioni të mos merrte mitropoli, edhe pse besimtarët e kërkonin, duke e dorëzuar Kishën në duart e Jerotheut. Panurjas vlerësoi se pala shqiptare nuk kishte mendime të qarta, duke këmbëngulur në fjalën Autoqefali dhe duke i lënë mënjanë të gjitha të tjerat.[607] Mirëpo, autoqefalia ishte kyçi në këndvështrimin e Zogut. Gjithçka tjetër mund të rregullohej me ndërhyrje të mëvonshme. Qoftë gjuha në kishë, qoftë kryepriftërinjtë, qoftë prirje të mundshme rrezikuese ndaj shtetit dhe kombit mund të pengoheshin në një kishë të pavarur. Veçse, asgjë nuk ishte e mundur pa autoqefalinë.

Ahmet Zogu iu shmang çështjes së shkollave, duke thënë se ua kishte lënë në dorë deputetëve Bamiha dhe Kaso. Mirëpo, në të vërtetë, Inspektoria e Arsimit të Gjirokastrës kishte kundërshtuar çdo përpjekje të deputetëve për të çelur shkolla greke. Mbikëqyrësi i atyshëm, Jani Minga, e cilësonte kërkesën zbatim të politikës greke dhe "ngjalljen e një nepërke me dy kokë", duke e ngjasuar me Protokollin e Korfuzit.[608] Qeveria kishte hedhur poshtë çeljen e një shkollë greke në Sarandë, qytet i banuar nga shqiptarë ortodoksë. Arsyetimi ishte se nuk mund të lejohej greqishtja në shkollat e bashkësive shqiptare.[609] Ministri shqiptar në Athinë e cilësoi kërkesën përkatëse të Greqisë ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë.[610] Zogu tha se nuk kishte dijeni për moslejimin e greqishtes në bashkësi shqiptare ortodokse. Kryetari i Republikës i tha ministrit grek se ishte në gjendje të vështirë, për shkak të çështjeve të Vermoshit dhe Shën Naumit, të cilat e kishin bërë të dukej keq në sytë e shqiptarëve. Prandaj, ai kërkoi më shumë kohë dhe luhatshmëri në drejtim të zotimeve të dhëna në Beograd.[611]

Mirëpo, koha shteronte për Greqinë. Ministria e Jashtme Greke njoftohej se korçarët ortodoksë mohonin prerazi të kërkonin greqishten në shkolla, duke u arsyetuar se mund të vriteshin. Sipas Ministrisë, ata po humbisnin ndjenjat kombëtare greke dhe po shqiptarizoheshin në vetëm dy vite, pasi kishin humbur shpresën për çlirim. Ky

[606] Të gjitha pikat e Marrëveshjes së Beogradit të trajtuara edhe në bisedat nëpërmjet Ahmet Zogut dhe ministrit Panurjas ndodhen edhe në arkivën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë në një shkresë në greqisht të përkthyer me shkrim dore, pa datë, pa autor dhe pa vend. Ky përkthim vërteton së paku se pala shqiptare ishte në dijeni të pikave të marrëveshjes dhe e ndiqte hap pas hapi zhvillimin e kërkesave greke. AMPJ, V. 1925, D. 137, f. 4, shënim, pa datë.

[607] Kondis, *Elinizmos III*, 233: Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 5 shtator 1925, cit.

[608] Beqir Meta, "Përpjekjet për konsolidimin e institucioneve kombëtare (1925-1935)", *Studime Historike*, 3-4 (Tiranë: Instituti i Historisë, 2008), 88.

[609] AMPJ, Shënim, pa datë, cit.

[610] AMPJ, V. 1925, D 234, f. 9, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 2 shtator 1925.

[611] Kondis, *Elinizmos III*, 233: Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 5 shtator 1925, cit.

"shqiptarizim" i shpejtë i shqiptarëve ortodoksë dëftonte në të vërtetë se e gjithë lëvizja grekomane në Shqipëri ishte kryer pikërisht me frikën e pushtimit grek. Ruajtja e këtij mendimi ishte një domosdoshmëri kombëtare për Greqinë, qoftë edhe thjesht nëpërmjet mbajtjes së shkollave greke.[612]

Ahmet Zogu u vendos shpeshherë me shpatulla pas muri, nga janari deri në shtator 1925. Përdorimi i shtypit dhe shumicës së deputetëve të Gjirokastrës e vunë Kryetarin e Republikës në vështirësi përpara kërkesës për zbatimin e Marrëveshjes së Beogradit. Mitropoliti i Korçës zbuti peshën e trysnisë greke. Takimi Zogu-Jerotheu kthjelloi mendimin e përbashkët për mospranim e asnjë përfundimi tjetër përveç autoqefalisë. Ky vendim gjeti përkrahjen edhe nga Hirësi Kristofori dhe Atë Vasil Marko. Ndërkohë, Hirësi Visarion Xhuvani mund të ishte asi nën mëngë në çdo rast. Përdorimi i Jerotheut si pika përbashkuese bëri që trysnia greke të mos sillte emërimin e një ekzarku të ri, që me gjasë do të ishte grekoman. Kjo mundësoi shtyrjen e kërkesave greke deri në pikën kur Athina u zmbraps në marrëdhëniet greko-shqiptare. Ndryshimi i baraspeshave kishte sjellë një gjendje të re, ku Shqipëria po rifitonte hapësirën e humbur. Mirëpo, kjo erdhi më së shumti për shkak të zhvillimeve në kryeqytetin grek...

3.5. Përafrimi i dytë shqiptaro-grek dhe Protokolli Kishtar i Tiranës

Vera e vitit 1925 ishte shumë e nxehtë në skenën politike të Athinës. Greqia kishte arritur të rimëkëmbej ngadalë nga gjëma e pësuar në Azinë e Vogël. Qeveria e ushtarakëve, që kishte marrë pushtetin më 1922, duke vrarë si tradhtarë anëtarët kryesorë të qeverisë së Gunarisit, arriti të qëndronte për dy vjet, deri në janar 1924. Venizelistët ridolën në skenë, fillimisht me vetë Eleftherios Venizelos që krijoi një qeveri pakditore deri më 6 shkurt. Ai vit do të shihte edhe katër qeveri të tjera të krijuara nga aleatë të Venizelosit, të cilët shfronësuan Mbretin dhe shpallën Republikën. Qeveria e fundit e vitit 1924 do të ishte më jetëgjata. Ajo drejtohej nga Andreas Mihalakopulos dhe nisi punën më 7 tetor, duke vijuar të njëjtën politikë ndaj shtetit shqiptar. Qeveria paraardhëse kishte arritur që të merrte zotimet e Beogradit prej Zogut dhe ishte pikërisht qeveria e Mihalakopulosit që mundësoi hyrjen e trupave të Myfit Libohovës dhe Koço Kotës në Shqipëri.[613]

Mirëpo, gjendja do të ndryshonte kryekëput në vetëm pak kohë. Një ndër gjeneralët më të njohur grekë, me prejardhje shqiptarie nga ujdhesa Salamina, afër Pireut, Theodhoros Pangalos, ishte i pakënaqur nga zhvillimet politike në vendin e tij. Ai kishte qenë ministër në shumicën e qeverive të vitit 1924 dhe ishte ndër gjeneralët kryesorë të lëvizjes që hodhi qeverinë e Gunarisit pas shkatërrimit në Azinë e Vogël. Pushteti që kishte arritur të grumbullonte gjatë dy viteve të fundit i kishte rritur edhe më emrin, e fuqizuar që prej Luftërave Ballkanike, kur kishte shkëlqyer për herë të parë. Kështu, gjenerali Pangalos ishte bërë njëfarë Leonidhe bashkëkohor, nën urdhrat e të cilit qëndronin njësitë më të vlerësuara të ushtrisë, edhe pse vetë gjenerali nuk kishte detyrë të caktuar. Pangalos u vu në lëvizje, kur qeveria Mihalakopulos mendoi ta arrestonte për t'i

[612] Kondis, *Elinizmos III*, 271: IDAYE, D. B/33, nr. 16224, Komanda e Selanikut drejtuar MPJG, 4 nëntor 1925.

[613] Për zhvillimet politike në Greqi shih edhe: Alkis Rigos, Η Β΄ Ελληνική Δημοκρατία 1924-1935. [Republika e Dytë Greke 1924-1935], (Athinë: Themelio, 1988), 30-80.

asgjësuar pushtetin. Ai urdhëroi mbështetësit të nisnin sulmin darkën e 24 qershorit. Përkrahësit e tij vendosën nën kontroll bazat detare në Egjeun Verior, ndërsa ushtarët morën drejtimin e bazave ushtarake në shumicën e Greqisë. Pangalos i kërkoi Kryetarit të Republikës, Pavllo Kundurioti, dorëheqjen e qeverisë së Mihalakopulosit, çka ndodhi të nesërmen. Ai ngriti një qeveri të re, të cilën e paraqiti përpara Kuvendit, duke e ligjëruar grushtin ushtarak, nëpërmjet një votimi.[614]

Korriku dhe gushti vijues do të ishin të rëndësishëm. Pangalos fuqizoi pushtetin në të gjitha këndvështrimet dhe u bë gati për lëvizjen përfundimtare. Ai urdhëroi shpërbërjen e Kuvendit në shtator, me arsyetimin se kishte humbur besimin e kombit grek. Kështu, një sundim proshqiptar po vendosej në Athinë, ditët që Panurjas rriste trysninë ndaj Zogut. Pangalos e kishte mësuar gjuhën shqipe nga e ëma, një shqiptare nga fshati Elefsina, pak kilometra mbi Athinën. Ajo ishte martuar me deputetin kulluriot, po shqiptar, Dhimitër Pangalos, dhe kishte lindur gjeneralin e ardhshëm.[615] Pangalos shpreh në kujtime mahnitjen për gjuhën shqipe, të cilës arrinte t'i shqiptonte disa fjali, sikurse dhe për racën shqiptare, pjesë e së cilës ishte. Theodhoros Pangalos u përfshi në ushtri, aty ku kulluriotët kishin një të kaluar të gjatë arritjesh dhe në të vërtetë shkëlqeu. Ai do të tregonte me zell nevojën për përafrimin e sinqertë mes dy kombeve, gjatë periudhës që qeverisi Greqinë.[616]

Tirana i ndiqte me kujdes zhvillimet që po tronditnin Athinën. Vizita e fundit e Panurjasit në fillimshtator 1925 shënonte përfundimin e periudhës së qeverisjes venizeliste. Greqia i jepte Mid'hat Frashërit shenjat e para të bashkëpunimit të ri. Rrjedhimisht, qeveria shqiptare e kishte kuptuar se laku në fyt nuk ishte më. Qeveria e re greke u tregua e gatshme për një bashkëpunim të sinqertë, në të cilin nuk përmendeshin aspak zotimet e marra në Beograd, që për qeverinë e drejtuar nga Theodhoros Pangalos ishin të paqena. Këto shenja do të zyrtarizoheshin vetëm pak muaj më vonë, më 9 dhjetor 1925, kur ministri i Jashtëm grek, Rufos, i tha haptazi Frashërit se Greqia e kishte ndryshuar qëndrimin ndaj Shqipërisë dhe përpiqej drejt përafrimit. Ajo tërhiqej nga mëtimet tokësore dhe njihte shqiptarët e Çamërisë si pakicë kombëtare, që rrjedhimisht nuk do të dëboheshin drejt Turqisë.[617]

Pangalos do të fliste për herë të parë botërisht për marrëdhëniet mes dy vendeve në shkurt 1926, duke hedhur poshtë kërkesat e deriatëhershme greke. Ai i dha një intervistë Vangjel Nasho Qirkos të "Gazetës së Korçës", ku shpalli se vetëm ortodoksët greqishtfolës të Shqipërisë së Jugut përbënin pakicë greke. Krejt ndryshe, ortodoksët shqipfolës i vlerësonte si "zot shtëpie". Pangalos shprehej kundër mendimit të gabuar se çdo ortodoks ishte grek. Ai bënte të ditur se kishte urdhëruar mbylljen e shoqatave vorioepirote.[618]

Mirëpo, ndryshimi i kursit ishte i qartë për Tiranën, edhe përpara pohimeve zyrtare. Zëvendësimi i menjëhershëm i ministrit të Greqisë në Durrës ishte treguesi më i dukshëm. Një tjetër shqiptar nga të Greqisë, kolonel Konduli, u emërua në vend të

[614] Po aty.
[615] Kulluri është emri shqip për ujdhesën Salamina, dhe emri zyrtar prej vendosjes aty të popullsive shqiptare në Mesjetë e deri në shekullin XIX, emri u rivendos emri i lashtë Salamina nga shteti grek.
[616] Për kujtimet e tij shih: Theodoros Pangalos, *Τα απομνημονεύματά μου 1897-1947 [Kujtimet e mia 1897-1947]*, (Athinë: 1959).
[617] Luan Malltezi dhe Sherif Delvina, përg., *Mid'hat Frashëri Ministër fuqiplotë: Athinë (1923-1926)*, 259-261: dok nr. 197 Frashëri dejtuar MPJ, 12 dhjetor 1925.
[618] "Intervistë me Pangallosin", *Zëri i Korçës* nr. 65, 27 shkurt 1926, 2.

Panurjasit. "Koha" e Mihal Gramenos e mirëpriti me ngazëllim, duke përmendur çaste kyçe të jetëshkrimit të kolonelit, ndër të cilat edhe qëndrimi i tij i mirë gjatë pushtimit grek në kohën e lëvizjes vorioepirotase. Kondulis u kishte dorëzuar menjëherë Korçën ushtarakëve holandezë të Princ Vidit. Emërimi vlerësohej si rrëfim i përafrimit shqiptarogrek.[619]

Qeveria shqiptare rendi të rikthente gjendjen në dobi të saj. "Viktimë" e parë do të ishin fletoret "Liria" dhe "Tirana" të Vasil Dilos. Rënia e trysnisë greke bënte që këto fletore të mos kishin më arsye të mbijetonin. Qeveria vendosi t'i mbyllte më 14 shtator, duke theksuar se ato ishin përpjekur të turpëronin kombin dhe shtetin duke u ngatërruar në çështjen kishtare dhe shkollore.[620]

Qëndrimi i ri i qeverisë greke i dha mundësinë shtetit shqiptar të rifuqizonte Këshillin e Lartë të Kishës. Veprimi i parë do të kryhej me çështjen e kishës së vllehëve në Korçë. Mitropolit Jerotheu kishte mbërritur në qytet më 15 tetor dhe ishte takuar me Dhimitër Texhën, kryetar i komitetit rumun, që kishte financuar një kishë të re, të ngritur për vllehët e qytetit, duke caktuar 25 tetorin si ditë përurimi.[621] Texha ftoi deputetë, madje edhe vetë Kryetarin Zogu.[622] Mirëpo, Dhoma e Deputetëve nuk e mirëpriti ftesën. Ajo arsyetoi më 21 tetor se çelja e kishës vinte në kundërshtim me vendimet e Kongresit të Beratit dhe mbillte farën e ndasisë mes popullit. Dhoma urdhëroi mosçeljen dhe marrjen e masave kundër komitetit dhe organizmave që e kishin lejuar.[623] Megjithatë, Kisha e Shën Sotirit u çel nën drejtimin e Hirësi Jerotheut, sipas paralajmërimit, më 25 tetor.[624] Rrugëzgjidhja e artë ishte që ajo nuk do të vepronte si kishë vllehe, përgjatë katër viteve në vijim.[625]

Drejtuesit kishtarë u kujdesën të ringrinin ndjenjën kombëtare në kisha, që ishte dobësuar në muajt e fundit. Përpjekja nisi më 10 shtator, kur u kremtua me madhështi trevjetori i Kongresit të Beratit nën drejtimin e Atë Vasil Markos.[626] Një përshpirtje për heroin Themistokli Gërmenji u zhvillua në fund të tetorit, në Korçë. Ajo u drejtua përsëri nga Atë Vasili, pasi mitropoliti nuk mori pjesë.[627] Jerotheu mbajti fjalën kryesore pak ditë më vonë, pas dhoksologjisë së flamurit kombëtar, më 28 nëntor. Ai shprehu rëndësinë e madhe të kësaj dite për kombin shqiptar dhe u bëri thirrje ortodoksëve për atdhedashuri dhe mbrojtje të kombit.[628]

Rritja e frymës së atdhedashurisë në kisha e kishte përmbysur gjendjen përgjatë vitit 1925: fillimi i vitit ishte dëshpërues, teksa Greqia dukej se po fitonte hapësirë, por ndryshimet qeveritare në Athinë kishin prodhuar rrethana të reja. Atë Vasil Marko u thirr në Tiranë më 21 nëntor për të trajtuar mundësitë e zgjidhjes së çështjes kishtare. Shumë emra qarkullonin për krijimin e Sinodhit të Shenjtë.[629] Në çdo rast, ata ishin atdhetarë

[619] *Koha* nr. 239, 26 shtator 1925, 2.
[620] *Zëri i Korçës* nr. 17, 14 shtator 1925, 1.
[621] *Zëri i Korçës* nr. 27, 17 tetor 1925, 1.
[622] AQSH, F. 155 "MD", D. 33, f. 1, Komiteti Rumun drejtuar Kryetarit të Republikës, 20 tetor 1925.
[623] AQSH, F. 155 "MD", D. 33, f. 2, Rezolutë e Dhomës së Deputetëve, 21 tetor 1925.
[624] "Parëdie u inaugura kisha e këtushme e Vllehëve shën Sotiri", *Zëri i Korçës* nr. 30, 27 tetor 1925, 4.
[625] *Zëri i Korçës* nr. 34, 10 nëntor 1925, 2.
[626] "Kisha Autoqefale Orthodhokse", *Koha* nr. 233, 10 shtator 1925, 1; *Zëri i Korçës* nr. 19, 15 shtator 1925, 4.
[627] *Zëri i Korçës* nr. 31, 31 tetor 1925, 4.
[628] *Zëri i Korçës* nr. 39, 1 dhjetor 1925, 2.
[629] Ndër të tjerë: Episkop Visarion Xhuvani, Arkimandrit Vangjel Çamçe, Episkop Joakim Martishti, murgu Evlogji Kurilla, Kostë Çekrezi etj. ("Çështja kishtare", Gazeta e Korçës nr. 237, 21 nëntor 1925, 2.).

shqiptarë. Fryma kombëtare e fundvitit 1925 do të dukej edhe në zgjedhjet bashkiake. Fitues në Korçë ishin të gjithë ortodoksët atdhetarë, si: Vasil Avrami, që do të emërohej kryebashkiak, Llambi Bimbli, Misto Lako, Koço Grameno, Kostaq Gode, Kol Rodhe, Ahile Fundo e të tjerë.[630]

Qeveria miratoi kalimin e të gjitha manastireve nën drejtim të Këshillit të Lartë Kishtar, çka ishte pamundësuar pak muaj më parë, kur trysnia greke kapte kulmin.[631] Ndërkaq, Këshilli arriti të siguronte drejtimin edhe në Himarë. Një përplasje ekonomike kishte shkaktuar zëvendësimin e Mitropolitit të atyshëm, me nismën e anëtarit të Pleqësisë Kishtare Anargjir Nushit. Atë Spiro Kokaleshi shihej si i dyjëzuar mes shqiptarëve dhe grekomanëve. Ai u shkarkua dhe u zëvendësua nga Stavro Lito, nga Vunoi, një fshat me shumicë dërrmuese atdhetarësh. Qeveria u shtrëngua të burgoste Jani Milon, një anëtar të parisë që bënte fushatë kundër zgjidhjes në fjalë. Paria e Himarës i dërgoi një letër me 40 nënshkrime Kryesisë së Kishës, duke njohur drejtimin prej saj, çka solli edhe ligjërisht bashkimin me Kishën Autoqefale në fundvitin 1925.[632]

Një tjetër çështje e mbetur pezull ishte ajo e Visarion Xhuvanit. Mihal Grameno shihte se Hirësia ishte pjesë e zgjidhjes atdhetare në fushën kishtare. Ai shkruante më 20 shkurt 1926 se çështja "Xhuvani" duhet të zgjidhej, teksa ai e kishte të lidhur fatin me Kishën Shqiptare. Sipas Gramenos, nismëtarët duhet të gjykojnë me dorë në zemër dhe gjakftohtësi për episkopin, ose t'i jepnin vendin e duhur, ose ta dënonin, por duke kujtuar se koka e falur nuk pritet.[633]

Visarioni ishte kthyer në një mollë sherri, jo vetëm për shkak të përplasjeve të moçme me fanolistët, Jerotheun dhe Kisin, por edhe për shkak të dyshimeve se ishte në varësi të Kishës Serbe. Mbështetja që i kishte dhënë Episkop Viktorit në Shkodër dhe dorëzimi i tij në Savinë kishte bërë të shihej me sy të mirë në Beograd. Madje, fletorja më e madhe serbe, "Politika", botoi një shkrim më 26 nëntor 1925 nga Miroslav Jeliç, ku bënte thirrje për të ndihmuar autoqefalinë e Kishës Shqiptare. Mirëpo, shumica e shkrimit përqendrohej në figurën e Episkop Visarion Xhuvanit, i parë qoftë si mbrojtës i autoqefalisë kishtare, qoftë si kundërshtar i regjimit të Nolit e përkrahës i Kryetarit Ahmet Zogu. Shkrimi nuk harronte të përmendte mbështetësit e Visarionit, si: Mihal Grameno, Lef Nosi, Atë Pano, Haxhi Jakovi e të tjerë dhe ftonte serbët të shihnin me dashamirësi përpjekjen shqiptare për autoqefali.[634]

Ftesa vinte në rrjedhim të betejës qindravjeçare që Kisha Serbe kishte me simotrën Greke, çka sillte që Xhuvani të mblidhte të gjithë armiqësinë e të dytëve. Një gazetar grek e kishte takuar gjatë një qëndrimi në Beograd. Ai nuk ishte aspak miqësor ndaj orvatjes së Xhuvanit. Shkrimi i botuar në "Eleftheros Tipos" dhe i rishtypur në "Gazetën e Korçës" ishte fshikullues ndaj episkopit shqiptar. Shkruesi e quante Xhuvanin pak grek e pak shqiptar, duke mos iu shmangur mendimit se ortodoksët nuk mund të mos ishin veçse grekë. Ai shkruante se ministri serb i Feve, Trifunoviç, kishte dalë nga dhoma e Episkop Visarionit kur shkoi ta takonte. Pasi hyri, Visarioni u shpreh i lumtur që takoi një gazetar grek, duke i rikujtuar kohën që kishte studiuar në Athinë. Ai u shpreh i hidhëruar që vlerësohej armik nga Greqia, vetëm pse dëshironte Kishë Shqiptare të

[630] *Zëri i Korçës* nr. 43, 12 dhjetor 1925, 1.
[631] AQSH, F. 155 "MD", V. 1925, D. 32, f. 1, VKM nr. 585, 26 nëntor 1925.
[632] Meta, "Përpjekjet për konsolidimin", 92-93.
[633] "Kisha Autoqefale dhe Pishkop Xhuvani", *Koha* nr. 258, 20 shkurt 1926, 2.
[634] AMPJ, V. 125, D. 261, f. 11-12, Legata e Beogradit drejtuar MPJ, 1 dhjetor 1925.

veçantë, si çdo shqiptar. Visarioni qortonte Greqinë dhe Patriarkanën që e përndiqnin, edhe nëpërmjet dy episkopëve të dërguar në Shqipëri, duke parapëlqyer dorëzimin e parregullt të Nolit, përpara teologut të vetëm të diplomuar në vend. Visarioni siguroi se nuk do të pranonte kurrë të vendoste Kishën Shqiptare nën atë Serbe, porse kërkonte vetëm autoqefali.[635]

Në të vërtetë, një plan tjetër përflitej në Shqipëri. Visarioni dhe Hirësi Viktori që vijonte të qëndronte në Shkodër mund të dorëzonin dy episkopë të tjerë dhe të krijonin Sinodhin e Shenjtë, me bekimin e Kishës Serbe dhe më pas të asaj Rumune. Plani parashihte që Rumanisë do t'i jepej si "shpërblim" emërimi i një episkopi rumun për vllehët e Shqipërisë.[636] Megjithatë, ky skenar nuk u pohua kurrë zyrtarisht.

Lëvizja kishtare ishte sërish në vrullin e përpara qershorit 1924, teksa Greqia nuk po sillej penguese në synimet e ortodoksëve shqiptarë. Ortodoksët u bënë gati për të jetësuar detyrimet që rridhnin nga Kongresi i Beratit, në shkurt 1926, pasi Pangalos kishte shprehur botërisht qëndrimin e tij. Vasil Avrami drejtoi mbledhjen e një grupi atdhetarësh të ajkës ortodokse shqiptare, të cilët vendosën të krijonin Sinodhin e Shenjtë të përbërë nga dy mitropolitët Jerotheu dhe Kisi, nga Atë Vasil Marko me titullin Ikonom i Përgjithshëm, si edhe dy priftërinj të tjerë në cilësinë e zëvendësmitropolitëve të Durrësit dhe Gjirokastrës, përkatësisht Episkop Visarion Xhuvanin dhe të përzgjedhurin për episkop që më tetor 1924, Arkimandrit Vangjel Çamçen. Vasil Avrami mori pëlqimin e Mitropolitit të Korçës, Jerotheut, me kusht që edhe Kisi i Beratit të shprehte mendim pohues për planin.[637]

Shtypi kombëtar u njoftua me të shpejtë. "Koha" e Mihal Gramenos shkruante më 20 shkurt se çështja kishtare ishte në rrugë të mbarë, duke përgëzuar nismëtarët dhe në veçanti kryebashkiakun Vasil Avrami, i cili nuk pushonte së punuari për rregullimin e Kishës.[638]

Ndërkaq, Atë Vasil Marko vlerësonte se krijimi i Sinodhit ishte domosdoshmëri. Ai shprehej se në të kundërt nuk mund ta drejtonte më Kishën, teksa mitropolitët dhe zëvendësmitropolitët nuk zbatonin më urdhrat e Këshillit të Lartë Kishtar. Mirëpo, kjo ide u hodh poshtë vetëm pak javë më vonë, në fillim të prillit. Greqia zotohej të pranonte të ndërmjetësonte me Patriarkanën, në mënyrë që zgjidhja të ishte e gjithëpranuar.[639]

Mid'hat Frashëri shprehej në parashtresën e tij të fundit si ministri shqiptar në Athinë se ministri i Jashtëm grek, Rufo, i kishte pohuar pranimin e autoqefalisë së Kishës nga Patriarkana me ndërhyrjen e qeverisë greke, duke dërguar Mitropolitin e Trapezundës, Krisanthos. Frashëri udhëzoi Kryeministrin Pangalos të mos ndërhynte në çështjen kishtare shqiptare. Ai u vetëshpall filogrek dhe arsyetoi se mosndërhyrja greke

---

[635] "Visar Xhuvani në Beligrad", *Gazeta e Korçës* nr. 274, 27 prill 1926, 1.

[636] Tasudhis, *Kujtimet biografike*, 32.

[637] AQSH, F. 155 "MD", V. 1925, D. 50, f. 1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 17 shkurt 1926. Ndryshimi i beftë i qëndrimit të Jerotheut nga plani i fshehtë që kishte paraqitur pak muaj më parë në Athinë, në një zgjidhje tërësisht në dobi të çështjes kombëtare shqiptare vërteton se lëvizja e tij ishte për të parandaluar pasojat që mund të prodhonte zbatimi nga ana e Zogut i zotimeve të Beogradit.

[638] *Koha* nr. 258, 20 shkurt 1926, 2.

[639] Përpjekja e fundit për zgjidhje pa miratim nga Patriarkana, u bë nga Mitropoliti i Beratit Kristofori. Ai u dërgoi pleqësive të Durrësit dhe Gjirokastrës një kërkesë për të krijuar Kishën Autoqefale duke emërtuar dy mitropolitët e fundit. Pleqësitë kthyen përgjigje pohuese, por lajmëruan se do t'i zgjidhnin emrat vetëm nëse dështonin bisedimet që priteshin me ekzarkun e ri patriarkal. Ekzarku Krisanthos pohonte më vonë se Patriarkana do të gjendej përpara një rrethane ku nuk do të kishte mundësi të bënte asgjë tjetër veçse të pranonte atë Sinodh që ishte krijuar, nëse ky plan do të zbatohej (Tasudhis, Kujtimet biografike, 32-34.)

do të bënte që Greqia të mos fajësohej për dredhi në rast mosmarrëveshjeje, në një çështje të brendshme të Shqipërisë. Frashëri theksonte se dashamirësia e palës greke në këtë çështje duhej parë me kursim, sepse qëllimi mund të ishte tjetër. Ai frikësohej se ndërhyrja synonte mbikëqyrjen mbi ortodoksët shqiptarë.[640]

Kjo frikë nuk do të vërtetohej. Qeveria greke kishte ndërhyrë me të vërtetë pranë Patriarkanës. Kisha e Madhe kishte vendosur sipas qëndrimeve të reja të Athinës edhe këtë herë. Patriarku Vasil i shkroi një letër Kryetarit Ahmet Zogu më 13 prill 1926. Ai theksonte përkujdesjen atërore dhe mirëdashjen patriarkale ndaj ortodoksëve të Shqipërisë, çka e bënte të dëshironte nxehtësisht dhënien e një fundi të shpejtë dhe të vlefshëm. Patriarku njoftonte dërgimin e ekzarkut për të hartuar një parashtresë mbi zgjidhjen e çështjes kishtare.[641]

Krisanthos nuk ishte rastësor. Ai kishte qenë Mitropolit i Trapezundës, qytet i ndodhur në hapësirën që laget nga Deti i Zi, përpara Traktatit të Lozanës. Madje, ishte paraqitur si drejtues i grekëve të atyshëm në Konferencën e Paqes në Paris, duke kërkuar krijimin e një shteti të Pondit në ato troje.[642] Krisanthos u zhvendos në Athinë, pas dështimit të nismës dhe shkëmbimit të popullsisë. Hirësia luante rolin e ndërmjetësuesit të qeverisë greke me Patriarkanën Ekumenike dhe njëkohësisht mbante marrëdhëniet diplomatike të Kishës Mëmë me vendet e tjera. Shtypi grek e cilësonte shpesh si ministri i Jashtëm i Patriarkanës Ekumenike.[643] Krisanthos dhe një tjetër Mitropolit i njohur për shqiptarët, Jakovi i Durrësit, kishin zyrën në mjediset e Ministrisë së Jashtme të Greqisë.[644] Kështu, përzgjedhja e tij si ekzarku i ri kishte rëndësi të dyfishtë. Ai ishte i besuar i qeverisë greke dhe ndiqte udhëzimet e saj me përpikmëri. Njëherazi, ishte besnik i Sinodhit të Shenjtë dhe mënjanonte mundësinë e një kryengritjeje të tretë si ato të Jerotheut dhe Kisit.

Krisanthos do të lajmërohej për detyrën e re dy ditë pas Zogut, më 15 prill.[645] Ai shqyrtoi gjendjen kishtare dhe marrëdhëniet ndërmjet ortodoksëve shqiptarë dhe atyre grekë, përpara se të nisej për në Shqipëri. Një përkujtesë e gjatë e nënshkruar nga ish-kryeministri Nikolaos Theotoqis qëndronte në dosjen e tij të punës. Ajo ishte hartuar gjatë periudhës përpara shpalljes së Autoqefalisë nga Kongresi i Beratit. Përkujtesa shkruante se Shqipëria mund të kërkonte të drejta për shqiptarët ortodoksë në Greqi. Sipas saj, 300 mijë shqiptarët ortodoksë që kishin mërguar prej qindvjeçarësh në Greqi dhe vijonin të kishin gjuhë amtare shqipen jetonin brenda një mjedisi kombëtar grek. Ndërkaq, Epiri i Veriut ose Shqipëria e Jugut ishte shtëpia e 40 mijë greqishtfolësve dhe dhjetëra mijëra ortodoksëve shqiptarë, të cilët kishin ende vetëdije kombëtare greke, për shkak të drejtimit pakvjeçar shtetëror shqiptar.[646]

Përkujtesa sqaronte qëndrimin zyrtar grek përgjatë Konferencës së Paqes në Paris, ku arsyetonte shifrat e dhëna, ndërkaq trajtonte çështjen e pakicës greke në Shqipëri, duke e vendosur përballë qëndrimit atëror të Greqisë ndaj pakicës së shqiptarëve të

[640] AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 20, Mid'hat Frashëri drejtuar MPJ, 19 prill 1926.
[641] AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 26, Patriarku Vasili drejtuar Kryetarit të Republikës, 13 prill 1926.
[642] *Τραπεζούντος Χρύσανθος: Επίσημα έγγραφα περι της Εκκλησιαστικής και Εθνικής δράσεως του* (Aleksandri: 1925).
[643] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 79, Shkrim i "Politia", 13 mars 1929.
[644] AMPJ, V. 1932, D. 99, f. 141, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 20 qershor 1932.
[645] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 20.
[646] ELIA, F. "Hrisanthos, Kryepiskopi i Athinës", D. 3/1 "Autoqefalia e Kishës Shqiptare 1927-1937", f. 7-67, Parashtresë mbi marrëdhëniet shqiptaro-greke.

Çamërisë. Ajo trajtonte në detaje çështjet e pakicave në të dyja vendet, përfshi edhe shqiptarët ortodoksë të Greqisë Qendrore, që deri në atë çast nuk ishin shpallur nga Shqipëria si pakicë kombëtare shqiptare. Krisanthosi përgatitej të përballej me kërkesa për qëndrime të ndërsjella nga pala shqiptare, që mund të ngrinte çështjen e meshimit të shqipes, për 300 mijë shqiptarët ortodoksë të Greqisë, të cilët asokohe nisën të quheshin arvanitas.[647]

Pasja e përkujtesës në dosjen diplomatike të Mitropolitit tregonte detyrën që ai kishte ndërmarrë. Ai do të trajtonte në Shqipëri nevojën e njohjes së autoqefalisë, siç ishte udhëzuar nga Rufos dhe Pangalos, të cilët dëshironin t'i jepnin fund amullisë në marrëdhëniet mes dy vendeve. Kufijtë e shërbimit nuk i ishin lënë në pikëpyetje, aq sa e shihte jothelbësor qëndrimin vetjak. Krisanthos shkruante pak kohë më vonë se vendimi për njohjen e autoqefalisë ishte marrë dhe ai duhet të merrej jo me thelbin e çështjes, por vetëm me formalitete. Hirësia kishte krijuar bindjen se pala greke ishte në gjendje të palakmueshme. Ai shkoi në Tiranë me besimin se frika shqiptare ndaj Greqisë ishte pasojë e gabimeve të politikës greke, teksa shqiptarët mendonin se shteti grek nuk u ishte tërhequr nga mëtimi mbi Vorio Epirin dhe luftimi i lëvizjes kombëtare shqiptare, duke i cilësuar ortodoksët shqiptarë si grekë.[648]

Njëherazi, Mitropoliti i Trapezundës do të përkujdesej që pakica greke në Shqipëri të gëzonte të drejta sipërore, një zotim jokishtar, por pjesë e detyrave politike të rangut të tij. Hirësia ishte takuar në Athinë edhe me deputetin shqiptar, Vasil Bamiha.[649] Deputeti delvinjot ndërmjetësoi pranë qeverisë dhe Krisanthosit në shkurt dhe mars, në mënyrë që zgjidhja kishtare shqiptare të mos ishte e njëanshme. Ai i kishte thënë të dërguarit të Patriarkanës se nuk do të pranohej asgjë më pak se autoqefalia.[650] Bamiha ishte takuar me drejtuesit më të lartë të shtetit, si gjenerali Pangalos, ministri Rufos dhe zyrtarët e lartë Camandos dhe Panurjas. Ai u kthye në Tiranë më 6 mars, me bindjen se dërgimi i tij në Athinë kishte qenë i frytshëm.[651]

Lajmi i nisjes së Krisanthosit për në Shqipëri u përhap nëpërmjet fletoreve greke. Simotrat e tyre në Tiranë rendën ta paraqisnin në faqet e para, duke përcjellë njoftimet nga Greqia dhe jo nga qeveria shqiptare, që vijonte të qëndronte gojëkyçur.[652] Ndërkaq, lëvizja shihej me dyshim nga disa pjesë të ortodoksëve atdhetarë.[653]

---

[647] Tasudhis, *Kujtimet biografike*, 33-34.

[648] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 20-25.

[649] Arkiva e Krisanthosit përmban edhe shkresa të Bamihës që duhet t'ia ketë dorëzuar Hirësisë gjatë takimeve me të. ELIA, F. "Hrisanthos, Kryepiskopi i Athinës", D. 3/1 "Autoqefalia e Kishës Shqiptare 1927-1937", f. 1, MD drejtuar Vasil Bamihës, 19 maj 1926.

[650] Tasudhis, *Kujtimet biografike*, 33-34.

[651] Beqir Meta, "Përpjekjet për konsolidimin e Kishës Autoqefale Shqiptare sipas optikës së diplomatëve britanikë në vitet 1925-1928", *Studime historike* 1-2 (2012), 41-65.

[652] "Patriarkana Ekumenike dhe Shqipëria", *Zëri i Korçës* nr. 79, 17 prill 1926, 1.

[653] Këto ngjarje nënkuptonin frikën e Hirësi Jerotheut dhe arsyet se përse ai rendi nëpërmjet Kotokos në Athinë me një plan të fshehtë, në dukje grekoman, por në thelb atdhetar. Dërgimi i një ekzarku të ri rrezikonte të niste gjithçka nga e para, teksa kjo nënkuptonte se ekzarku i deriatëhershëm, Hirësi Jerotheu nuk kishte më mbështetjen e Patriarkanës. Moslënia e nismës në dorë të tij përbënte rrezik, teksa askush nuk e dinte nëse ekzarku i ri do ta mbështeste lëvizjen në Shqipëri. Prandaj, Jerotheu nisi sërish përpjekjen e përafrimit, duke vendosur lidhje të drejtpërdrejtë bashkëpunimi me konsullatën greke në Korçë. Kjo lëvizje nuk u kuptua nga zyrtarët vendas, të cilët arritën deri aty sa të kërkojnë zëvendësimin e Hirësi Jerotheut me Hirësi Kristofori, me arsyetimin se Jerotheu po dredhonte nëpërmjet konsullatës (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 102, f. 1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 29 prill 1926.). Njëkohësisht, nisi të meshohej edhe greqisht në kremtime të rëndësishme në kishat e qytetit, si përpjekje për të rifituar pëlqimin

Sidoqoftë, gjithë frika dhe pasiguria do të merrte fund shpejt. Mitropoliti i Trapezundës, Krisanthosi, mbërriti në Tiranë në fillim të majit. Ai u mbrujt në legatën greke në Durrës, me anë të së cilës ruante lidhjen si me Athinën, ashtu edhe me Patriarkun në Kostandinopojë. Mitropoliti nisi punën, duke vizituar legata të huaja, të cilat i siguroi se kishte për qëllim arritjen e një zgjidhjeje të shpejtë.[654]

Pala greke pati fillimisht ankesa se qeveria shqiptare nuk u tregua mikpritëse ndaj Hirësisë, mendim që ndanin edhe diplomatë të huaj.[655] Gjithsesi, ngërçi u zgjidh shpejt. Këshilli i Ministrave vendosi ngritjen e një komisioni të posaçëm për të biseduar me Krisanthosin. Ai nuk përmbante asnjë përfaqësues të Këshillit të Lartë Kishtar dhe as dy mitropolitët kryengritës ndaj Patriarkanës. Qeveria vendosi që komisioni të përbëhej nga senatorët dhe deputetët ortodoksë, nën kryesimin e kreut të Senatit, Pandeli Evangjeli, dhe kryetarit të Dhomës së Deputetëve, Koço Kota. Anëtarë ishin senatori Pilo Papa dhe Andon Beça dhe deputetët Mihal Kaso, Dr. Simonidhi, Vasil Rusi dhe Vasil Bamiha.[656] Deputeti i Vlorës, Dr. Simonidhi dhe ata të Gjirokastrës, Mihal Kaso dhe Vasil Bamiha u dolën në krah të gjitha kërkesave të sjella nga Hirësi Krisanthosi dhe sipas tij, dhanë betejë deri në fund për çështjet që ai ngriti.[657] Gjithsesi, ata nuk u thirrën më në komision pas 24 majit dhe bisedimet vijuan mes Krisanthosit dhe pjesës së mbetur.[658]

Shtypi grek e njoftonte këtë zhvillim me ngazëllim. Eleftheros Tipos shkruante se mençuria e Krisanthosit dhe dëshira e Zogut përbënin sigurinë e zgjidhjes. Nga ana tjetër, nënvlerësonte dhe sulmonte kryesuesit e deriatëhershëm të lëvizjes kishtare shqiptare, si Atë Vasil Markon, të cilin e cilësonte prift të pashkollë, apo Episkop Visarion Xhuvanin, të cilin e quante vegël të politikës serbe. Eleftheros Tipos e vlerësonte çështjen kishtare shqiptare si një betejë ndikimesh serbo-greke, ndërkohë shprehte besimin se do të emëroheshin episkopë të denjë në Shqipëri, ndër ta edhe Mitropoliti i Korfuzit, Athinagora, i cili përflitej për Kryepiskop.[659]

Bisedat nisën zyrtarisht më 24 maj dhe menjëherë u përhapën fjalët se çështja kishtare u zgjidh. "Gazeta e Korçës" botonte shkrimin se "Patriarkana e njeh Autoqefalin e Kishës", duke përmendur madje dhe emrin e Evlogji Kurillës si Kryepiskop.[660]

Bisedimet zgjatën plot 40 ditë dhe, sipas Krisanthosit, rrezikuan shpesh të ndërpriteshin. Vetëm pasja në krah të tij të deputetëve Simonidhi, Bamiha dhe Kaso mundësuan që të arrihej një gjuhë e përbashkët.[661] Krisanthos pa nga afër se udhëzimet e Pangalosit dhe Rufosit ishin rrugëzgjidhja e vetme. Kryetari Zogu i kishte bërë të qartë që në takimin e parë se nuk do të pranonte asgjë më pak sesa autoqefali. Akoma edhe

---

politik të Greqisë. Mesha me rastin e festës kombëtare të Greqisë, më 25 mars nisi të kryhej tërësisht në greqisht. Mirëpo, konsulli në Korçës kërkoi që mesha të bëhej në shqip, në nderim të marrëdhënieve të reja mes dy popujve. ("Kishët dhe Gjuha amtare", Zëri i Korçës nr. 85, 11 maj 1926, 2.).

[654] AQSH, F. 163 "Legata Italiane", V. 1926, D. 115, f. 6. Legata Italiane drejtuar MPJI, 5 maj 1926.

[655] Meta, "Përpjekjet për konsolidimin", 72.

[656] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1926, D. VI-220, f. 2, VKM nr. 141, 8 maj 1926.

[657] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 36; Simonidhi reshtohet si grekoman edhe nga Italia. Konsullata italiane në Vlorë radhiste ndër fanolistë figura si Jani Minga, Jani Stringopulli, Kristo Karbunara, Nikolla Karbunara, Sotir Kolea, Pandeli Anastasi, Nikolla Mërkuri etj. Ndërsa, Doktorët Simonidhi, Qirko, Luka dhe Filip Dogën dhe Atë Kristoforin cilësoheshin grekomanë. (AQSH, F. 163 "Legata Italiane", V. 1922, D. 13, f. 3. Legata Italiane drejtuar MPJI, 28 janar 1922.).

[658] Meta, "Përpjekjet për konsolidimin", 74.

[659] AMPJ, V. 1926, D. 239 f. 33, Shkrim i Eleftheros Tipos, 22 maj 1926.

[660] "Patriarkana e Njeh Autoqefalin e Kishës", *Gazeta e Korçës* nr. 281, 25 maj 1926, 1.

[661] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 36.

deputetët grekomanë i shprehën mendimin se nuk kishte zgjidhje tjetër, në kushtet që ishte çuar gjendja. Të njëjtin mendim kishin përfaqësuesit e bashkësive ortodokse që Krisanthos vizitoi në Lushnjë, Berat, Nartë, Vlorë, Përmet, Gjirokastër, Delvinë dhe Sarandë. Madje, ai nuk u prit fare mirë nga atdhetarët e Korçës.[662]

Komisioni i deputetëve e senatorëve dhe Mitropoliti Krisanthos nënshkruan marrëveshjen përfundimtare, të quajtur Protokolli i Tiranës, më 6 qershor 1926. Marrëveshja përcaktonte krijimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ministri i Jashtëm, Hysni Vrioni, shpejtoi që t'ia përcillte Patriarkut Vasil. Protokolli i Tiranës përmbante tetë nene dhe një shtojcë. Neni i parë përcaktonte se Kisha Ortodokse Shqiptare do të përmbante pesë mitropoli: Tiranë, Korçë, Gjirokastër, Berat dhe Durrës. Neni i dytë shënonte se Mitropoliti i kryeqytetit shqiptar, pra Mitropoliti i Tiranës, do të ishte Kryepiskopi i Kishës Ortodokse Shqiptare dhe Kryetar i Sinodhit të përbërë prej pesë mitropolitëve. Neni tre përcaktonte se tre kryepriftërinj të shquar të paraqitur nga komisioni i posaçëm ortodoks shqiptar do të emëroheshin nga Patriarku Ekumenik në mitropolitë e paplotësuara. Ndërkaq, Jerotheu dhe Kristofori do të emëroheshin në mitropolitë që drejtonin.[663]

Neni i katërt kishte të bënte me gjuhën. Ai vendoste se do të ruhej *status quo*-ja, duke përdorur gjuhën amtare kudo ku kishte bashkësi ortodokse shqiptare, në të cilat shqipja ishte përdorur deri atëherë; ndërkaq Sinodhi do të kujdesej të përkthente tekstet e shenjta. Shteti shqiptar merrte përsipër t'i siguronte pavarësi dhe liri të plotë zhvillimit të jetës fetare dhe kishtare, përfshi edhe organizmat kulturorë për klerin dhe seminaret. Protokolli përmbante edhe një pikë për pakicën greke, çka ishte çështje politike. Ai caktonte se të drejtat e pakicës do të përmbusheshin duke u nisur nga Shpallja për Mbrojtjen e Pakicave të dorëzuar në Lidhjen e Kombeve. Neni shtatë caktonte se Shqipëria do të dëmshpërblinte Patriarkanën Ekumenike për manastiret e kryqcaktuara, që kalonin në varësi të Kishës Ortodokse Shqiptare.[664] Ndonëse, Krisanthos i sugjeronte Patriarkut Vasil të mos pranonte të holla nga Shqipëria.[665] Neni i tetë dhe i fundit ishte edhe më i rëndësishmi: Patriarkana Ekumenike merrte përsipër bekimin e autoqefalisë së Kishës, duke dorëzuar Tomosin përkatës.[666] Shtojca e Protokollit kishte të bënte me nenet dy dhe tre, pra me emrat që do të përbënin Sinodhin e Shenjtë. Ajo caktonte se Mitropoliti i Triqesë, me origjinë nga Përmeti, Mitropoliti i Pelagonisë së Re, Joakimi, Sekretari i Manastirit të Llavros në Malin e Shenjtë, Evlogji Kurilla, dhe Pandeli Kotoko ishin emrat e mundshëm për tre mitropolitë e paplotësuara.[667]

Protokolli ishte i një rëndësie të veçantë. Ai njihte autoqefalinë dhe e shpallte Kishën Ortodokse në Shqipëri si një kishë kombëtare, duke e quajtur madje Kisha Orthodhokse Shqiptare. Së dyti, caktonte se gjuha do të ruhej sipas gjendjes së

[662] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 20-34.
[663] AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 1-5, Kryetari i Republikës dhe MPJ drejtuar Patriarkut, 7 qershor 1926. Shih edhe: Rama, "Shteti dhe njohja...", 69-70.
[664] Manastiret stavropijike (e kryqcaktuara sipas përkthimit të Mitropolit Theofan Nolit) janë manastire në varësi të drejtpërdrejtë të Patriarkut Ekumenik.
[665] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 33.
[666] AMPJ, Kryetari i Republikës dhe MPJ drejtuar Patriarkut, 7 qershor 1926, cit.
[667] Emri i Mitropolitit të Triqesë nuk paraqitet në shtojcë, bëhet fjalë për Polikarpin. Patriarkana do të plotësonte vendet me tre të mbeturit, nëse një prej tyre nuk do të pranonte. Mohimi i emërimit nga më shumë se një i përzgjedhur do të bënte që komisioni i posaçëm të paraqiste emra të tjerë. AMPJ, Kryetari i Republikës dhe MPJ drejtuar Patriarkut, 7 qershor 1926, cit.

deriatëhershme. Mirëpo, pas autoqefalisë do të mbetej në dorë të Sinodhit të Shenjtë të caktonte se çfarë gjuhe do të përdorej për bashkësitë shqiptare. Krisanthos arsyetonte se kjo ishte një arritje për palën greke. Ai i përcillte Patriarkanës se kishte kërkuar përdorimin e shqipes në bashkësitë që e përdornin dhe të greqishtes në të gjitha të tjerat, duke marrë parasysh që ishin shtuar përpjekjet për vendosjen e shqipes në shërbesa. Mirëpo, Hirësia vijonte se gjuha nuk mund të ishte gjithnjë kështu dhe të rinjtë shqiptarë do të kërkonin afërmendsh gjuhën amtare në kishë, ndaj këshillonte të ndihmohej Kisha Shqiptare për përkthimin e drejtë të shërbesave në shqip. Madje, ai theksonte se të rinjtë ortodoksë shqiptarë ishin të gjithë pjesë e rrymës atdhetare dhe të pandikuar nga Greqia.[668]

Krisanthos vlerësonte se përcaktimi për të drejtat e pakicave ishte një domosdoshmëri, në mënyrë që shkollat greke të shërbenin si shkolla edhe për shqiptarët. Ai shfaqte përbuzjen dhe përçmimin që kishte ndaj ortodoksëve shqiptarë, teksa i shprehte Patriarkanës se kultura greke që përhapej nëpërmjet këtyre shkollave do të mund të "bëjë njerëz dhe të zhvillojë popullin ortodoks shqiptar". Së fundmi, gjuha e përdorur në nenin e fundit ligjëronte vendimet e marra në Kongresin e Beratit, teksa Patriarkana merrte përsipër të "njihte" dhe jo të "shpallte" autoqefalinë. Krisanthos i kishte bërë të ditur qeverisë shqiptare se zotimet e dhëna prej saj dhe Tomosi do të dorëzoheshin në Lidhjen e Kombeve. Ai shihte si parakusht shfuqizimin e Statutit të Beratit dhe të Këshillit të Lartë Kishtar të drejtuar nga Atë Vasil Marko, si edhe heqjen zyrtare nga detyra të Mitropolitit të Durrësit, Hirësi Theofan Nolit.[669]

Ndërkaq, emrat e episkopëve u sugjeruan nga Komisioni Ortodoks Shqiptar, i krijuar nga qeveria.[670] Mitropoliti i Triqesë, Polikarpi, ishte përmendur edhe nga Mitropolit Jerotheu, nëpërmjet Pandeli Kotokos, në planin e tyre të fshehtë të dorëzuar në Athinë. Ndërkaq, Joakimi ruante marrëdhënie shumë të mira me qeverinë shqiptare, jo vetëm prej detyrës së tij si Mitropolit i Beratit, por edhe prej veprimtarisë gjatë udhëtimit të Komisionit Shqiptar në Stamboll më 1923. Evlogji Kurilla nuk ishte emër i panjohur. Ai kishte marrë pjesë në lëvizjen kombëtare shqiptare nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër ishte filogrek që kërkonte bashkëpunim të sinqertë mes dy kombeve. Përzgjedhja e emrit të tij për Kryepiskop të Tiranës duhet të shihet si pajtimi mbi një njeri të shquar që as shqiptarët dhe as grekët nuk mund ta kundërshtonin, për shkak të veprimtarisë së tij që prej periudhës përpara pavarësisë. I fundit, teologu Pandeli Kotoko, nderohej nga shteti grek, si një prej grekomanëve të orëve të para që prej periudhës së pushtimit të Korçës. Ndërkaq, ai gëzonte edhe mbështetjen e Jerotheut, si ndërlidhësi i këtij të fundit me shtetin grek. Në çdo rast, edhe Hirësi Kristofori duket se dha siguri për Kotokon, pasi iu lut që ta pranonte emërimin, që ishte nevojë e Kishës.[671]

Mosbesimi i Patriarkanës dhe i Greqisë ndaj Jerotheut dhe Kristoforit, që kishin treguar qëndrim atdhetar shqiptar, ishte i dukshëm. Krisanthos siguronte Patriarkun se kishte punuar që tre emrat për episkopë të ishin të gatshëm për të ndikuar të tjerët, në mënyrë që të ishin të denjë për pritshmërinë e Patriarkanës. Madje, ai pohonte se

[668] Tasudhis, *Kujtime biografike,* 34-44.
[669] Tasudhis, *Kujtime biografike,* 40-43.
[670] Tasudhis, *Kujtime biografike,* 40.
[671] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 34, f. 83, Mitropoliti Kristofor drejtuar Pandeli Kotokos, pa datë.

këmbënguli që numri i mitropolitëve të ishte pesë, për të shtuar më shumë "elementë të shëndetshëm".[672]

Episkop Visarioni shkruante në fletoren "Dajti" se Kotoko ishte zgjedhja e fundit, pra ai do të dorëzohej episkop vetëm nëse ndonjë nga tre emrat e tjerë do të kundërshtonte. Visarioni theksonte se të qenit me kombësi shqiptare ishte e mjaftueshme, edhe pse të katërt kishin nënshtetësi greke. Rritja e atdhetarisë në Kishë do të rriste edhe vetë Kishën e për këtë duhej punë kombëtare. Visarioni vlerësonte se pesë episkopët shqiptarë do të punonin si atdhetarë të flaktë dhe kryqtarë të shqiptarizmës, duke bashkuar ortodoksët në një shpirt me zemër të flaktë shqiptare. Frymëzimi i brezit të ardhshëm të djelmërisë dhe mbarë vendit do të varej prej tyre.[673]

Vasil Joanidhi ishte përfolur më herët, nën ndikimin e Jerotheut. Mirëpo, Prefektura e Korçës udhëzoi që ai të përjashtohej, pasi ishte nip i Mitropolitit, si edhe kuçovllah.[674] Emrat e dy të përzgjedhurve të kahershëm, Episkop Visarionit dhe Arkimandrit Vangjel Çamçes, u lakuan, por nuk morën pjesë në shkresën përfundimtare. Episkop Visarioni ishte i mallkuar nga shteti grek dhe nga një pjesë e rëndësishme e atdhetarëve shqiptarë, ndaj ishte thuajse e pamundur të përfshihej. Ai botoi dy vëllimet e librit "Çështje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë", gjatë periudhës së bisedimeve. Vëllimi i parë arsyetonte përse Kisha në Shqipëri duhet të ishte thjesht kombëtare.[675] Vëllimi i dytë u botua më 10 qershor 1926. Episkop Visarioni sqaronte përse Kisha Shqiptare duhet të ishte autoqefale dhe përse arsyetimi i deriatëhershëm grek kundër autoqefalisë nuk qëndronte. Ai shpallte se ortodoksia në Shqipëri do të përparonte vetëm nëse ortodoksët shqiptarë kërkonin nderin e vet fetar, duke bashkëpunuar vllazërisht, ungjillësisht dhe shqiptarisht.[676] Krisanthos i kallëzonte Patriarkanës se ishte takuar në Tiranë me Visarionin. Sipas tij, Episkopi shqiptar kishte pranuar se kishte vepruar në kundërshti me kanonet, mirëpo jo aq sa vetëshpallja e Nolit.[677]

Edhe Arkimandrit Vangjel Çamçe do të haste një kundërshti të pritshme, teksa nuk ishte i parapëlqyer në baraspeshën e re të fuqive. Prefektura e Korçës udhëzoi që të ruhej vend në Sinodhin e Shenjtë edhe për Atë Vasil Markon, si Kryeikonom ose Ikonom i Mitruar. Ndërkaq, udhëzohej të lihej e hapur mundësia që anëtarë të Sinodhit të ishin edhe priftërinj të tjerë joepiskopë, për të mbrojtur nevojat e shtetit dhe për të siguruar shumicën në Sinodh. Diçka e tillë ndodhte edhe në Kishat e Malit të Zi dhe Jeruzalemit.[678] Mirëpo, këto udhëzime nuk u morën parasysh.

Protokolli u krye në kushtet e shpejtësisë dhe pa pjesëmarrjen e të gjitha palëve. Shtypi shprehej se nuk kishin asnjë njoftim mbi çka u arrit.[679] Ndërkaq, njëri prej anëtarëve të Këshillit të Lartë do ta shihte veten të ndaluar nga organet e rendit. Tol Arapi, përfaqësuesi i Mitropolisë së Beratit, i kërkoi Atë Vasil Markos të mos binte viktimë e dhelpërisë fanarjote. Ai shkroi më 10 qershor se Statuti i Beratit nuk duhet të

[672] Tasudhis, *Kujtime biografike,* 42.
[673] Episkop Visarion, "Përfundime Orthodhokse", *Dajti n*r. 122, 9 Qershor 1926, 1.
[674] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 103, f. 11, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 1 qershor 1926.; si edhe AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 37.
[675] Visarion Xhuvani, *Çështje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë Pjesa I* (Tiranë: Tirana, 1926).
[676] Visarion Xhuvani, *Çështje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë Pjesa II* (Tiranë: Tirana, 1926), 23.
[677] Tasudhis, *Kujtime biografike,* 31.
[678] AQSH, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 1 qershor 1926, cit.
[679] *Zëri i Korçës* nr. 93, 8 qershor 1926, 4.

cenohej, i njoftuar mbi vizitën që Hirësi Krisanthosi kryente në Korçë.[680] Qeveria do të urdhëronte menjëherë ndalimin e tij.[681] Ai tërhoqi fjalët e kundërshtimit, kur u njoftua mbi Protokollin e arritur. Megjithatë, kundërpërgjigjet nuk do të ishin të pakta brenda ajkës atdhetare ortodokse në Korçë, që shihte të tepruar lëshimin që caktonte se Patriarkana do të emëronte episkopët e parë, edhe pse ata do të dëftoheshin nga pala shqiptare.[682]

Qeveria dyshonte se Mitropoliti atdhetar Hirësi Kristofori trazonte ujërat në fshehtësi pas këtyre kundërshtive.[683] Mirëpo, prefekti i Korçës, Hil Mosi, mendonte se të dy mitropolitët ishin të njëmendtë në përcaktimet e Protokollit.[684]

Mërgata shqiptare kundërveproi më ashpër. Ajo ishte fanoliste dhe shihte te Protokolli një rrezik kombëtar. Kryetari i Kuvendit Shqiptar në Boston, Stili Mihali, e quajti tradhti marrëveshjen e arritur.[685] Po ashtu, drejtuesi i Kishave Shqiptare në Amerikë, Atë Dhosi Katundi, pyeti se cilat ishin kushtet, kush mori pjesë, nga erdhi nisma dhe kush përfaqësonte Kishën. Konsullatat e Nju Jorkut, Barit dhe Stambollit shprehnin shqetësimin se mërgata kundërshtonte zhvillimin. Një lajm i rremë, i botuar fillimisht në fletoren "Politika" të Beogradit, nxehu gjakrat. Ai u përhap me shpejtësi në "Taxidromos" të Athinës dhe prej aty në shumicën e shtypit të vëmendshëm ndaj kësaj çështjeje. Shkrimi i datës 10 qershor ishte "Rikthehet gjuha greke në Kishat Ortodokse të Shqipërisë - një sukses i Mitropolitit të Trapezundës Krisanthit" dhe shkruante se mitropolitët do të ishin grekë. Politika sulmonte Zogun për Protokollin, duke e cilësuar kundër dobisë jugosllave. Konsullata shqiptare u detyrua të përgjigjej më 26 qershor, duke i cilësuar të pavërteta pandehjet e shkrimit. Ndërkohë, Ministria e Jashtme udhëzonte të gjitha konsullatat të sqaronin mërgatën se mitropolitë e paplotësuara do të përmbusheshin nga shqiptarë dhe Sinodhi i krijuar do të shqiptarizonte kishën në kohë shumë të shkurtër, duke përkthyer dhe bekuar librat e shërbimit fetar shqip.[686] Njëkohësisht, Zyra e Shtypit botonte se lajmet e përhapura kishin prapaveprim dhe nuk i përshtateshin së vërtetës. Marrëveshja nuk sillte ndryshim në status quo-në e Kishës dhe nuk cenonte autoqefalinë. Përkundrazi, shuante mosmarrëveshjet me Patriarkanën.[687]

Vasil Bamiha u nis sërish për në Athinë, në fundkorrik, me qëllim përfundimin e formaliteteve.[688] Legata greke rrëfeu dashamirësinë e saj, duke lajmëruar qeverinë shqiptare më 26 korrik se seminari i Korfuzit do të fillonte mësimdhënien edhe në shqip, derisa të mundësohej çelja e seminarit në Shqipëri.[689] Kjo vinte në dallim të theksuar me kërkesat e deriatëhershme që edhe seminari i Korçës të mësonte në greqisht. Njëkohësisht, qeveria në Athinë përballej me tubime të "vorioepirotëve", të cilët e quanin

[680] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 34, f. 69, Arapi drejtuar Këshillit të Lartë Kishtar, 10 qershor 1926.
[681] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 103, f. 12, MPB drejtuar Prefekturës Vlorë, 11 qershor 1926.
[682] AQSH, F. 163 "Legata Italiane", V. 1926, D. 115, f. 3, Legata Italiane drejtuar MPJI, 13 qershor 1926.
[683] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 103, f. 18, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 25 qershor 1926.
[684] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 103, f. 19, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 26 qershor 1926.
[685] AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 39, Kuvendi Shqiptar në SHBA drejtuar MPJ, qershor 1926.
[686] AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 40, MPJ drejtuar Kuvendit Shqiptar në SHBA, 3 korrik 1926.
[687] "Çështja e Kishës Autoqefale", *Zëri i Korçës* nr. 99, 29 qershor 1926, 1.
[688] GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", D. 959, f. 1, Konduli drejtuar Kryeministrit, 29 korrik 1926.
[689] AMPJ, V. 1926, D. 138, f., 7, Legata greke në Durrës drejtuar MPJ, 26 korrik 1926.

tradhti njohjen e shqiptarëve ortodoksë si jogrekë. Ambasadori Konduli gjendej në qendër të qortimeve, pasi kishte ndryshuar baraspeshat me politikën e tij proshqiptare.[690]

Mirëpo, të pakënaqur kishte edhe nga pala shqiptare. Episkop Visarioni dhe fanolistët ishin përjashtuar. Gjithsesi, Çamçe dhe Atë Josifi u pritën nga Kryetari Zogu më 14 gusht, për t'i siguruar se ata do të kishin rol qendror në Kishën Shqiptare, në të ardhmen.[691] Autoqefalia e shumëpritur ishte arritur. Tashmë mbeste vetëm miratimi i mitropolitëve të rinj, në mënyrë që Kisha Ortodokse Shqiptare të merrte trajtën përfundimtare. Krisanthos ishte ekzarku i dytë pas Jerotheut që bekoi Kishën Autoqefale Kombëtare më të re në botë në emër të Patriarkanës Ekumenike...

3.6. Rikthimi në pushtet i Venizelosit dhe zvarritja e zgjidhjes

Mitropoliti Krisanthos kishte ikur nga Shqipëria me një marrëveshje të pranuar nga të dyja shtetet. Ai la tokën shqiptare nëpërmjet Kakavijës, më 17 qershor 1926, i shoqëruar nga Hirësi Kristofori dhe deputetët Harito, Çako, Kaso, Simonidhi, Bamiha dhe Bozhori. Zyrtarët ushtarakë dhe vendorë grekë dhanë një pritje madhështore për të në fshatin Kalpaqi. Krisanthos u shpreh i ngazëllyer. Ai tha se ikte i kënaqur nga Shqipëria, i ndihmuar nga ndërhyrja e Kryetarit Zogu dhe deputetëve e senatorëve ortodoksë. Po ashtu, ai shprehej i mallëngjyer nga bindja e popullsisë ortodokse ndaj rendit kishtar. Hirësia iu përgjigj me gaz pyetjes mbi përmbajtjen e marrëveshjes, duke thënë se gazetarët kishin marrë vesh gjithçka, edhe pse ajo nuk ishte dorëzuar ende në Stamboll.[692]

Mirëpo, gjendja që kishte lënë në Athinë po ndryshonte me hapa të shpejtë. Udhëzimet e qarta që kishte marrë për qëndrimin e ri që Greqia mbante ndaj Shqipërisë kishin mbetur njësoj. Ajo që po ndryshonte ishte mbarë politika greke, që te Pangalos nuk shihte më zgjidhjen e vështirësive të vendit. Vera e vitit 1926 do të ishte po aq e nxehtë sa viti i kaluar. Çarja mes Pangalosit dhe venizelistëve ishte zyrtarizuar kur gjenerali dha dorëheqjen nga Kryeministër. Ai emëroi një qeveri të re me Athanasios Eftaksiasin në krye, më 19 korrik 1926, të përbërë nga shumë kundërvenizelistë. Sundimtari grek do të shihte një lëvizje të përbërë nga të njëjtat pjesë të ushtrisë që e ndihmuan të vinte në pushtet, veçse këtë herë kundër tij. Grushti i drejtuar nga venizelisti Gjeorgjios Kondilis do ta detyronte t'i dorëzonte Kryesinë e Republikës shqiptarit tjetër Pavlo Kundurioti, më 24 gusht. Pangalos u zu rob dhe u dërgua në burg po atë ditë, prej nga do të lirohej vetëm më 13 korrik 1928.[693]

---

[690] Delvinjoti Janaqi Spiro ankohej në Athinë se Konduli kishte tradhëtuar çështjen kishtare. "E zgjidha çështjen e Kishës në mënyrë filozofike mburret z. Konduli! Kur ta zgjidhësh i përgjigjen ata që dinë gjërat nga afër. Nuk ka të drejtë askush të shpreh se u zgjidh çështja kishtare para se të vendosen Mitropoliti dhe Episkopët dhe para se të merret tomi nga parlamenti shqiptar, këto kam guximin të them se nuk do të ndodhin kurrë gjatë qeverisjes së Zogut, nëse nuk njëmendësohet Beogradi dhe Beogradi nuk do të njëmendësohet kurrë, sepse jo pa qëllim plaku Pashiç vendosi në Tiranë mëkëmbësin e tij". GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", D. 959, f. 4, Janaqi Spiro drejtuar MPJG, 12 gusht 1926.

[691] "U pranuan n'audiencë Arhimandriti V. Çamçe dhe Ikonom Atë Josifi, prej Shkëlqesës së tij Kryetarit Republikës", *Koha* nr. 282, 21 gusht 1926, 1.

[692] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 46-47.

[693] Ky zhvillim njoftohej pa bujë në fletoret shqiptare të atyre ditëve, të cilat gjithsesi shprehnin simpatinë për filoshqiptarin Pangalos. *Koha* nr. 283, 28 gusht 1926, 2.

Rikthimi i venizelistëve në pushtet do të thoshte një qëndrim të ri ndaj Shqipërisë, pas përafrimit njëvjeçar të arritur nga proshqiptaria e Pangalosit. Qeveria e re e kolonel Kondilit lejoi shoqatat "vorioepirote" të rishfaqeshin kudo në Greqi, një shenjë e qartë se gjërat nuk do të shkonin si më parë. Këto shoqata drejtoheshin nga vëllai i Vasil Bamihës, Themistokliu, dhe rifilluan të shpallnin grekësinë e të gjithë ortodoksëve shqiptarë. Ato përpiqeshin të rifitonin terrenin e humbur me ndihmën e qeverisë së re.[694]

Gushti i nxehtë i politikës greke nuk pati ndikim në Tiranë. Qeveria vijonte të shpresonte se Protokolli Kishtar do të gjente zbatim. Katërvjetori i Kongresit të Beratit u kremtua në Korçë, nën drejtimin e Atë Vasil Markos dhe Arkimandrit Vangjel Çamçes. Hirësi Jerotheu mungoi edhe këtë herë.[695] Ai duket se kishte nuhatur rëndësinë e ndryshimeve në Athinë nëpërmjet lidhjes me konsullin Çorbaxhi dhe si pasojë kishte rimarrë qëndrim të paanshëm. Shtypi do t'i kundërvihej, duke përdorur shumë pandehje, përfshi shpërdorime ekonomike nga më të parëndësishmet.[696] Burim i shkrimeve ishin fanolistët, të cilët përpiqeshin të ulnin fuqinë që Jerotheu merrte nëpërmjet Protokollit Kishtar.

Ndryshimet e pushtetit kishin rritur nacionalizmin grek edhe në Gjirokastër. Prefekti parashtronte se deputetët dhe senatorët e qarkut kishin nisur të rindiznin urrejtjen ndaj Kishës Autoqefale, me përjashtim të Petro Pogës. Ai shprehej më 7 nëntor se fushata kundërshqiptare po përhapej ndaj ortodoksëve, të cilëve u mungonte ndërgjegjja kombëtare, edhe pse përkrahnin regjimin. Prandaj, autoqefalia u tingëllonte keq, falë punës së Bamihës, Kasos dhe sekretarit të Mitropolisë, Jani Dados. Prefekti udhëzonte pushimin e menjëhershëm të Dados, pasi Mitropolia nuk ndryshonte në asgjë nga periudha turke. Një shqiptar atdhetar, i ndershëm dhe besnik duhet të emërohej në vend të tij.[697] Paria greke e qarkut kishte peshë të pakundërshtueshme, edhe pse dy të tretat e ortodoksëve ishin shqiptarë. Edhe italianët ndiqnin nga afër gjendjen dhe e quanin Mitropolinë një qendër politike të Greqisë.[698]

Mirëpo, Tomosi nuk mund të vinte. Patriarkana Ekumenike ishte në pritje të qetësimit të gjendjes politike në Athinë, për të parë zhvillimet, që tregonin ftohje të re me Shqipërinë. Konsulli shqiptar në Stamboll përcillte, më 3 tetor, sigurinë e Patriarkut se Tomosi do të jepej. Mirëpo, Patriarkana e lidhi çështjen me kërkesën italiane për autoqefali të Kishës së Dodekanezit. Patriarku i tha Leskovikut se çështja shqiptare ishte lënë pa u mbaruar, për të mos u dhënë italianëve një armë të re. Leskoviku shënonte se nuk fshihej ndonjë djallëzi tjetër këtë herë.[699] Ai njoftoi një muaj më vonë se Greqia kishte udhëzuar dhënien e autoqefalisë në Dodekanez, çka do të hapte rrugë për Kishën Shqiptare.[700]

---

[694] Vasilios Kondis dhe Eleftheria Manda, përg., *The Greek Minority in Albania: A Documentary record (1921-1993) [Pakica Greke në Shqipëri: Një përmbledhje dokumentash (1921-1993)]* (Selanik: Instituti i Studimeve Ballkanike 1994), 52.

[695] *Zëri i Korçës* nr. 121, 14 shtator 1926, 4.

[696] Për shembull, një prej qortimeve ishte se ai zhvillonte tregti me makinën e Mitropolisë. *Zëri i Korçës* nr. 117, 31 gusht 1926, 4.

[697] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1926, D. 34, f. 18, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 7 nëntor 1926.

[698] Kondis dhe Manda, *Pakica Greke në Shqipëri*, 53: Arkiva e Ministrisë së Jashtme Italiane (ASMAE), D. 738/489, nr. 243/75, MPJI drejtuar Ambasadës Italiane në Durrës, 24 janar 1927.

[699] AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 47, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 3 tetor 1926.

[700] AMPJ, V. 1926, D. 239, f. 48, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 3 nëntor 1926.

Konsulli i moshuar nuk e kishte kuptuar çfarë luhej në prapaskenë. Ndryshimi i pushteteve në Greqi kishte sjellë qëndrim të ri për të dyja çështjet. Qeveria greke nuk dëshironte të mbyllte vështirësitë me fqinjët pa kushte. Kisha e Dodekanezit ishte haptazi zgjatim i saj. Ajo drejtonte shkollat e qyteteve dhe fshatrave të grupujdhesës, si edhe jetën shpirtërore të grekëve të atyshëm. Patriarkana nuk vepronte asnjëherë pa fjalën e qeverisë greke. Madje, ajo kërkonte udhëzime nga Ministria e Jashtme, akoma edhe për çështje të parëndësishme. Patriarkana shprehej e befasuar, kur mungonin udhëzimet e shtetit grek, duke mos ditur se çfarë duhet të bënte për të mirën e çështjes së Dodekanezit.[701]

Ajo ishte bërë gati të jepte autoqefalinë gjatë qeverisjes së Pangalosit. Mirëpo, lidhja mes dy çështjeve nuk vinte prej frikës italiane, siç kishte njoftuar Leskoviku. Ministria e Jashtme Greke shënonte më 30 gusht 1926 se çështja e Kishës Shqiptare ishte arsyeja e vetme që Kisha e Dodekanezit nuk shpallej autoqefale.[702] Kjo tregon se Kisha në Shqipëri ishte shumë më e rëndësishme për politikën greke. Ortodoksët në grupujdhesë ishin grekë dhe një Kishë Autoqefale nuk përbënte lëshim, pasi ajo sërish do të drejtohej prej tyre. Ndërkaq, një Kishë e pavarur në Shqipëri nuk mund të mos ishte veçse shqiptare, teksa 90 për qind e besimtarëve i përkisnin asaj kombësie. Kjo dobësonte ndikimin grek.

Protokolli për Kishën e Dodekanezit parashikonte kujdes të veçantë për grekët. Qeveria e Athinës arsyetonte se duhej ruajtur helenizmi, çka kryhej nga Patriarkana Ekumenike deri atë kohë. Mospasja e përcaktimeve të ngjashme në tomoset e deriatëhershme, vinte pasi Serbia dhe Rumania kishin kundërshtuar çdo kusht mbi pakicat.[703]

Mirëpo, qeveria e re venizeliste udhëzoi Patriarkanën Ekumenike, ose të jepte autoqefalinë me një sërë kushtesh që nuk do të cenonin përfshirjen e ardhshme të grupujdhesave në shtetin grek, ose të shtynte me çdo kusht bisedimet, pa i mbyllur ato. Kushtet e palës greke përcaktonin që Kisha e Dodekanezit do të kishte vetëqeverisje të plotë nga zyrtarët italianë dhe drejtuesit e saj të parë do të emëroheshin nga Patriarkana. Po ashtu, Kisha do të kishte lëshime në arsim dhe pandëshkueshmëri para zyrtarëve shtetërore, duke e bërë *de facto* shtet brenda shtetit. Patriarkana kërkoi të merrej mendimi i banorëve, çka vërteton se qëllimi i qeverisë venizeliste ishte shtyrja e zgjidhjes deri në një çast të dytë, kur ajo të ishte fuqizuar për të ndryshuar baraspeshat.[704]

Edhe italianët e shihnin se Patriarkana nuk po kujdesej për dobinë e saj, por kërkonte të siguronte dobinë e Greqisë. Përkthyesi i qeveritarit të Dodekanezit, njëherazi njeriu kyç i betejës për autoqefali, Mankuzo Pietro, vlerësonte se Patriarkana ishte kthyer në varësinë e plotë të të ardhurave që merrte nga Greqia, duke mos qenë më e aftë të kryente asnjë lëvizje pa marrë paraprakisht pëlqimin nga Athina.[705]

Rrjedhimisht, pohimi i Patriarkanës ndaj qeverisë shqiptare ishte thellësisht i pavërtetë. Së pari, qeveria greke shihte më shumë rrezik te autoqefalia shqiptare sesa te

[701] Kostas Calahuris, *Το Αυτοκέφαλο της Εκκλησίας της Δωδεκανήσου : από τα αρχεία του Υπουργείου των Εξωτερικών της Ελλάδος [Autoqefalia e Kishës së Dodekanezit: nga arkivat e Ministirsë së Jashtme të Greqisë]* (Athina: 1992), 95.
[702] Calahuris, *Dodekanezi*, 146.
[703] Calahuris, *Dodekanezi*, 146-147.
[704] Calahuris, *Dodekanezi*, 158-164.
[705] GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", Dosja 545, nr. κ. 103. α, Parashtresë e fshehtë e Mankuzio, pa datë.

ajo e Dodekanezit, ndaj edhe udhëzonte që nëse e para kryhej, e dyta nuk kishte rëndësi. Së dyti, ajo po e zvarriste pafundësisht çështjen e Dodekanezit dhe me këtë rast zvarriste edhe çështjen kishtare shqiptare, duke i ndërlidhur. Kjo vinte në kundërshti me shtypin që e quante çështjen të mbyllur, sidomos pas nëntorit, kur Evlogji Kurilla pranoi të dorëzohej, për të zënë vendin e Kryepiskopit, sipas Protokollit të Tiranës.[706]

Gjithsesi, qeveria greke nuk ishte në gjendje të lakmueshme. Ajo nuk mund të përdorte më Marrëveshjen e Beogradit, që ishte djegur diplomatikisht nga Theodoros Pangalos. Për më tepër, gjeopolitika në Ballkan kishte ndryshuar rrënjësisht. Qeveria shqiptare nënshkroi Paktin e Parë të Tiranës me Italinë më 27 nëntor, duke u shkëputur njëherë e mirë nga trysnitë greke dhe jugosllave. Mbrojtësi i ri siguronte si pushtetin vetjak të Ahmet Zogut, ashtu edhe tërësinë tokësore të Shqipërisë.[707] Ndaj, kërcënimet dhe trysnia që shoqëronin çdo bisedë të Ahmet Zogut me cilindo përfaqësues grek gjatë vitit 1925 ishin venitur. Megjithatë, tërheqja e litarit kishte kaluar sërish në të mirën e Athinës, për shkak të ndryshimit të qeverisë greke.

Ministri i Jashtëm, Hysen Vrioni, kërkoi të reja nga Konsullata në Stamboll, më 11 janar 1927. Nezir Leskoviku u përgjigj se Patriarkana do të kthente përgjigje pohuese nëpërmjet Legatës Greke.[708] Shtypi përhapi menjëherë lajmin se autoqefalia ishte siguruar.[709]

Ministri Vrioni ishte i sigurt se Tomosi kishte mbërritur në duart e Krisanthosit, ndaj kërkoi që Legata Shqiptare ta takonte kryepriftin grek dhe të përfundonte çështjet gojarisht. Mirëpo, lajmi i mirë do të përgënjeshtrohej shumë shpejt. Ministri shqiptar në Athinë, Stavro Stavri, e takoi Krisanthosin. Kryeprifti i tha se çështja nuk ishte përfunduar dhe Tomosi do të dorëzohej kur dy palët të nënshkruanin Protokollin.[710] Patriarkana e kishte udhëzuar të rishkonte në Tiranë për të biseduar një protokoll të veçantë, në të cilin vendoseshin kushtet për të përfunduar autoqefalinë.[711] Patriarku Vasil i dërgoi një letër Ahmet Zogut, pak ditë më vonë. Ai shprehu mirënjohjen ndaj Kreut të Shtetit Shqiptar dhe e lajmëronte për detyrën e re të Krisanthosit.[712]

Kryeprifti grek mbërriti në Tiranë në fillimshkurt. Ai u takua me Kryetarin e Republikës, të cilit i paraqiti dy kërkesat e Patriarkanës. E para kishte të bënte me Kryepiskopin. Krisanthosi i tha Zogut se Patriarkana kërkonte që të përzgjidhej një emër jashtë listës së paraqitur nga komisioni i posaçëm. Pala greke synonte të vendoste në krye të Kishës Shqiptare Mitropolitin e Korfuzit, Athinagorën, shqiptar nga fshati Vasiliko i Çamërisë. Mirëpo, Ahmet Zogu kundërshtoi, duke këmbëngulur se emrat duhet të pranoheshin nga komisioni, për të shmangur përplasje në të ardhmen. Krisanthos arriti të bënte vetëm një ndryshim në listën e të sugjeruarve, duke shtuar nipin e Jerotheut, Vasil Joanidhin. Ndërkaq, i dorëzoi Zogut protokollin e ri që Patriarkana kishte hartuar.[713]

---

[706] "Çështja Kishëtare merr fund E. Korilla pranoj të dorëzohet Episkop", *Koha* nr. 331, 30 nëntor 1926, 2.
[707] Puto, *Shqipëria Politike*, 350-450.
[708] Sekretariati i Sinodhit të Shenjtë Shqiptar, *L'Eglise Autocephale Orthodoxe d'Albanie [Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë]* (Gjenevë: Imprimerie Albert Kundig, 1929), f. 27; kopje e librit ruhet në AMPJ, V. 1929, D. 333, f. 115-150.
[709] *Zëri i Korçës* nr. 156, 15 janar 1927, 2.
[710] Sinodi i Shenjtë, *Kisha Ortodokse*, 28.
[711] ELIA, F. "Hrisanthos, Kryepiskopi i Athinës", D. 3/1 "Autoqefalia e Kishës Shqiptare 1927-1937", f. 5, Krisanthos drejtuar Patriarkut Ekumenik, pa datë.
[712] AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 10, Patriarku Vasil drejtuar Kryetarit të Republikës, 22 janar 1927.
[713] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 48-52.

Kryetari i Republikës i tha se qeveria ia kishte besuar çështjen komisionit të posaçëm, i cili do ta shqyrtonte dhe do të vendoste. Anëtarët u grumbulluan në kryeqytet, me përjashtim të Vasil Bamihës, i cili e pati të pamundur të merrte pjesë.[714] Mbledhja e parë u krye nën drejtimin e Pandeli Evangjelit, më 13 shkurt. Kryesuesi shpërndau protokollin dhe caktoi 15 shkurtin për të marrë vendimin përfundimtar. Protokolli që Krisanthos kishte sjellë me vete ishte shumë i ndryshëm nga Protokolli i Tiranës. Protokolli i ri përbëhej nga 10 pjesë, secila prej tyre me një sërë nenesh dhe kryeradhësh.

Pjesa e parë me dy nene kishte të bënte me krijimin e Kishës. Ajo caktonte se Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, pjesë e Kishës së Shenjtë Katolike dhe Apostolike, përbëhej nga të gjithë të krishterët ortodoksë që jetonin në Shqipëri dhe ndahej në pesë qarqe kishtare: të Tiranës, Durrësit, Korçës, Gjirokastrës dhe Beratit. Kryeprifti i qendrës mbante emërtimin e Kryepiskopit të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, ndërsa të tjerët mitropolit. Ndryshimi i parë nga Protokolli i Tiranës ishte emri, teksa tashmë ajo nuk quhej Kisha Ortodokse Shqiptare, që nënkuptonte një kishë kombëtare, porse Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Tri nenet e pjesës së dytë, "Sinodhi i Shenjtë", përcaktonin se ai përbëhej nga Kryepiskopi dhe mitropolitët. Sinodhi kishte disa fuqi ligjore: mësimi i vërtetë dhe i drejtë i dogmave, ruajtja dhe zbatimi i Kanoneve Apostolike dhe Sinodhike dhe Gojëdhënave të Shenjta, përcaktimet mbi adhurimin, plotësimi i qendrave episkopale, mbikëqyrja, ndryshimi, krijimi dhe prishja e faltoreve, mbarështimi dhe përdorimi i Arkës Kishtare, krijimi i një arke për shkollat priftërore, marrja e Miros së Shenjtë, predikimi i besimtarëve dhe rregullat kishtare.[715]

Pjesa e tretë, "Mitropolitët", përbëhej nga tetë nene. Ajo caktonte se mitropolitët sugjeroheshin nga kleri dhe besimtarët e qarkut kishtar dhe emëroheshin nga Sinodhi, me përjashtim të Kryepiskopit, që sugjerohej nga besimtarët e të gjitha qarqeve. Kryepriftërinjtë duhet të ishin pjesë e listës që Sinodhi miratonte çdo vit, të ishin dorëzuar klerikë të shkallëve të ulëta dhe të kishin diplomë teologjie. Ata do të qëndronin për gjithë jetën, pasi të dorëzoheshin mitropolitë, dhe do të largoheshin vetëm nëse dorëhiqeshin ose shkarkoheshin sipas rregullave. Nenet e tjera kishin të bënin me gjykimin. Një episkop do të gjykohej vetëm përpara një Gjyqi Kishtar me 13 anëtarë sipas përcaktimeve të qëmotshme kishtare. KOASH-i do të kishte vetëm pesë kryepriftërinj. Ndaj, shtatë anëtarët e tjerë do të thirreshin nga Patriarkana. Gjykata kishtare ngriheshin pranë çdo mitropolie dhe Kryepiskopatës për gjykimin e shkeljeve dhe për fejesën, martesën, ndarjen, trashëgiminë, kujdestarinë etj. Një gjykatë e përzier do të gjykonte çështje civile, si: paja, trashëgimia, bërsimi, atësia etj. Vendimet apeloheshin pranë Kryepiskopatës. Gjykatat gjykonin në bazë të ligjeve kishtare.[716]

Pjesa e katërt, "Adhurimi i Perëndisë", caktonte se adhurimi mbrohej nga shteti pa asnjë ndalim, kryhej në gjuhën e Ungjillit të Shenjtë "e konsakrueme prej shekujsh", ndërsa gjuha shqipe mund të përdorej në ato bashkësi që përdorej deri atëherë, derisa tekstet të përktheheshin me pëlqim të Sinodhit. Ajo ndalonte shitjen, shpronësimin apo çdo përdorim të padenjë të kryqeve, ikonave, petkave e çdo sendi të shenjtë. "Ndërtesat fetare dhe kishtare" përbënin pjesën e pestë me gjashtë nene. Faltoret ishin të nderuara, të

[714] Lajmërimet e ministrisë dhe shkëmbimi i mendimeve me anëtarët e komisionit gjenden në AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 13-18.
[715] Sinodhi, Kisha , f. 18-25; përkthimi zyrtar në shqip i protokollit gjendet në AMPJ, V. 1928, d. 333, f. 29-34, Protokolli i Patriarkanës Ekumenike.
[716] Po aty.

patatuara, me pasuri të patjetërsueshme, të drejtuara nga komisione nën mbikëqyren e Mitropolitit. Manastiret dhe shkollat vareshin nga Sinodhi. "Kleri i shenjtë" trajtohej në gjashtë nene të pjesës së gjashtë, ku caktohej se kleri kishte mbrojtje të veçantë nga ligjet, ndërsa episkopët gëzonin pandëshkueshmëri e nuk mund të veprohej kundër tyre pa vendim të Sinodhit. Ata mund t'i dorëzoheshin drejtësisë shtetërore, vetëm nëse Sinodhi i rrëzonte nga detyra. Dëshmia e tyre merrej në vendbanim, në rast padish. Episkopët dhe priftërinjtë betoheshin përpara drejtuesve kishtarë, si dhe nuk detyroheshin të zbulonin të fshehtat e rrëfimit. Një prift mund të gjykohej nga gjykatat civile, por burgosej vetëm pas vendimit sinodhik për zhveshje. Tri nenet e pjesës së shtatë trajtonin çështjen e "Arkës Kishtare". Arka formohej dhe drejtohej nga Sinodhi me të ardhura nga manastiret dhe kishat, një taksë për besimtarët që do të mblidhej nga qeveria, dhuratat, trashëgimitë dhe të ardhura të tjera. Arka do të përdorej për rrogat e Kryepiskopit, mitropolitëve dhe priftërinjve, shkollat priftërore, botimin e një të përkohshmeje dhe nevoja të tjera kishtare.[717]

Shteti merrte përsipër katër detyrime sipas pesë neneve të pjesës së tetë mbi "marrëdhëniet e kishës dhe shtetit". Ai siguronte liri të plotë në veprimtarinë e organizimin kishtar, duke mos pasur të drejtën e vetos, ndalonte fendërrimin e sforcuar dhe ndihmonte Kishën për zbatimin e vendimeve të saj në gjykatat kishtare dhe gjykatat e përziera. Ndërkaq, Kisha do të zbatonte dhe nxiste besimtarët të zbatonin ligjet e shtetit, sipas parimit biblik "Cezarit ato që i takojnë Cezarit dhe Zotit ato që i takojnë Zotit". Pjesa e vetme e pandryshuar nga Protokolli i Tiranës i 6 qershorit ishte pjesa e nëntë e protokollit të ri mbi "Pakicën Greke në Shqipëri". "Nene të përgjithshme" quhej pjesa që përmbyllte protokollin dhe përmbante pikat kalimtare. Së pari, Sinodhi i Shenjtë kishte të drejtën e caktimit të hollësive mbi organizimin e KOASH-it. Së dyti, vendimet e Kongresit të Beratit shpalleshin të paqena nga pikëpamja kishtare dhe politike, duke shfuqizuar Këshillin e Lartë dhe Statutin. Së treti, Patriarkana ndërhynte vetvetiu si gjyqtar, në raste grindjesh fetare ose kishtare me rëndësi. Së katërti, vendosej që Tomosi jepej në bazë të këtyre kushteve dhe shfuqizohej, nëse nuk zbatohej ndonjë prej përcaktimeve. Së fundmi, Tomosi i Autoqefalisë do të vërtetohej nga qeveria dhe me ligj nga Parlamenti. Ligji dhe protokolli do të dorëzoheshin në Sekretariatin e Lidhjes së Kombeve, krahas dy shpalljeve të Shqipërisë dhe Patriarkanës.[718]

Ndryshimet nga Protokolli i Tiranës ishin të dukshme dhe thelbësore. Qeveria shqiptare i kërkoi Patriarkanës sqarime se përse Hirësi Krisanthos shkoi me një protokoll krejt të ri, ndërkohë që kishin arritur tjetër marrëveshje vetëm para gjashtë muajsh.[719] Mirëpo, Kisha e Madhe tha se veçse kishte detajuar nenet e Protokollit të Tiranës.[720]

Krisanthos u takua me deputetët Simonidhi dhe Kaso, dy mbështetësit e vetëm që kishte në komision, por nuk arriti të bindte të tjerë. Mbledhja e dytë u krye më 15 shkurt, nën kryesinë e Pandeli Evangjelit dhe me pjesëmarrjen e Kotës, Beçës, Kasos, Rusit, Simonidhit dhe Papës. Ajo u nda në dy grupime.[721] Kaso dhe Simonidhi e shihnin protokollin si një detajim të marrëveshjes së mëparshme, në përputhje të plotë me Statutin e Kongresit të Beratit. Ata vlerësonin se disa çështje duheshin ndryshuar ose

[717] Po aty.
[718] Po aty.
[719] AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 19, MPJ drejtuar Konsullatës së Stambollit, 14 shkurt 1927.
[720] AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 20, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 17 shkurt 1927.
[721] AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 30-35, Raporti i Komisionit, 17 shkurt 1927.

shfuqizuar. Mirëpo, mendonin se protokolli duhej pranuar në parim dhe më pas të bisedohej nen për nen se cili duhej ndryshuar, kundërshtuar dhe pranuar.[722]

Nga ana tjetër, shumica e përbërë nga Evangjeli, Kota, Beça, Rusi dhe Papa e cilësoi protokollin e ri të papranueshëm. Ata theksonin se përcaktimet krijonin një shtet fetar brenda Shqipërisë me të drejtën e qeverisjes së shqiptarëve ortodoksë. Përcaktimi se protokolli dhe Tomosi duheshin dorëzuar pranë Lidhjes së Kombeve vlerësohej i papranueshëm. Ata shkruanin se kjo nënkuptonte sikur ortodoksët shqiptarë ishin pakicë e huaj dhe e shkelur, që do të mbroheshin nga Patriarkana me anë të Lidhjes. Shumica e komisionit shënonte në veçanti disa nene. Së pari, neni 3 i pjesës së tretë përcaktonte se mitropolitët do të ishin të përjetshëm. Ligjvënësit e shihnin të padrejtë, pasi dobia e Kishës ose arsye shtetërore mund të lypnin një ndryshim në fron të kryepiskopëve ose mitropolitëve ose një këmbim mes qarqeve kishtare. Së dyti, ata kundërshtonin thirrjen e shtatë episkopëve nga Patriarkana për krijimin e Gjykatës Kishtare. Komisioni vlerësonte se pavarësia e KOASH-it nënkuptonte se ajo do të kishte të drejtën të caktonte vetë cilët episkopë shtesë do të thërriste për të arritur numrin e duhur. Gjithashtu, ndërhyrja e vetvetishme e Patriarkanës si gjyqtar ishte e tepërt. Deputetët pyesnin përse nuk u lihej shqiptarëve të vlerësonin rëndësinë e grindjes dhe t'i drejtoheshin Kishës Mëmë për vendim të paanshëm, nëse e gjykonin vetë.[723]

Komisioni hidhte poshtë kërkesën e Patriarkanës që Sinodhi të ishte i vetmi që drejtonte Arkën, duke theksuar se të gjithë besimtarët kishin të drejtë të vendosnin mbi fatin e pasurisë kishtare. Po ashtu, gjykimi i çështjeve civile nga gjykatat fetare quhej ndërhyrje e papranueshme në çështjet shtetërore. Pesë deputetët e cilësonin kërkesën për mosgjykimin penal ose civil të klerikëve si dorëzim pa kushte, çka ngjasonte me kohën e Perandorisë Osmane. Nenet që do të ngjallnin më së shumti zemërimin ishin të pjesës së dhjetë. Shumica e komisionit vlerësonte se Patriarkana arrinte në kulmin e guximit, duke i dhënë vetes të drejtën e vetos, si të ishte shtet brenda shtetit. Ata shprehnin të njëjtën zemëratë në çështjen e heqjes së Tomosit në rast moszbatimi të protokollit. Deputetët e vlerësonin si kërcënim, duke mbajtur një dorë mbi shpatë dhe dorën tjetër te tehu. Si pasojë, komisioni arriti në përfundimin se protokolli ishte i papranueshëm si kusht për njohjen e Kishës Autoqefale nga ana e Patriarkanës. Deputetët përsërisnin se Protokolli i 6 qershorit 1926 ishte miratuar njëzëri nga pala shqiptare dhe ishte pëlqyer nga Ekzarku i Patriarkanës. Kështu, ai kishte të gjitha kushtet dhe siguritë e kërkuara nga Kanonet Kishtare për njohjen e Autoqefalisë. Prandaj, deputetët udhëzonin qeverinë të merrte të gjitha masat që Autoqefalia të pranohej në bazë të Protokollit të 6 qershorit.[724]

Këshilli i Ministrave shqyrtoi parashtresat e shumicës dhe pakicës, në disa mbledhje rresht, të drejtuara nga Ahmet Zogu. Ai vendosi mospranimin e Protokollit të ri, si të papajtueshëm me dobinë e lartë të shtetit shqiptar, më 24 shkurt.[725] Zogu priti Hirësi Krisanthosin, të nesërmen. Ai e cilësoi protokollin "të rëndë", një përpjekje për një trajtim të veçantë të klerit ortodoks përkundrejt myslimanëve dhe katolikëve, ndërkohë që Shqipëria ishte vend demokratik dhe kishte vendosur të zbatonte kodet franceze, në kundërshtim me shumë nene të protokollit. Zogu e cilësoi të pashoq dorëzimin e

[722] AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 38-40, Raporti i Pakicës në Komision, 17 shkurt 1927.
[723] Po aty.
[724] Po aty.
[725] AMPJ, V. 1927, D. 238 f. 28, VKM nr. 72, 24 shkurt 1927.

Protokollit në Lidhjen e Kombeve, teksa vetëm shtetet dorëzonin marrëveshje aty. Prandaj, ai kundërshtoi çdo marrëveshje me përjashtim të Protokollit të 6 qershorit.[726]

Hirësi Krisanthosi vërejti se nuk kishte rrugëzgjidhje tjetër. Ai pohonte në parashtresën përfundimtare drejtuar Patriarkut më 7 mars se protokolli i mëparshëm duhej parë si fitore. Fuqizimi i Shqipërisë pas Paktit me Italinë mund të rrëzonte edhe marrëveshjen e arritur më 6 qershor. Mitropoliti i Trapezuncës kishte kuptuar në takimet me diplomatët britanikë, italianë dhe jugosllavë se pala shqiptare ishte në gjendje të vështirë prej çështjes së gjuhës së meshimit dhe listës së mitropolitëve. Për më tepër, Krisanthos shihte rrezik nga lëvizja unite, për shkak të marrëdhënies së re mes Shqipërisë dhe Italisë. Ai vlerësonte se vonesa e Patriarkanës do të bënte që Shqipëria të vijonte me plotësimin e njëanshëm të vendeve të pazëna dhe do ta krijonte Kishën Ortodokse me apo pa pëlqimin e Kostandinopojës. Rrjedhimisht, ai udhëzonte të pranoheshin kushtet e Protokollit të 6 qershorit 1926.[727]

Patriarkana Ekumenike iu përgjigj qeverisë shqiptare se nuk kuptonte cilat pika ishin të papërputhshme me Protokollin e Tiranës dhe kërkoi nenet që kundërshtoheshin. Konsulli vlerësonte se Patriarkana dëshironte ta zvarriste çështjen, e udhëzuar nga Greqia.[728] Leskoviku gjykonte saktë këtë herë. Protokolli për Kishën Shqiptare ishte i njëjtë me atë që iu dorëzua italianëve për Dodekanezin. Shkresat e brendshme të qeverisë greke rrëfejnë se kushtet ishin vendosur si një orvatje për të zvarritur çështjen. Shtyrja në kohë i mundësonte Athinës të rifitonte terrenin e humbur nga sundimi i Pangalosit.[729] Gjendja e re bëri Ahmet Zogun të urdhëronte ruajtjen e Statutit të Beratit dhe Këshillit të Lartë Kishtar, deri në një vendim të ri. Atë Vasil Marko mbetej zyrtarisht në krye të Kishës.[730]

Gjithsesi, ulje-ngritjet e paparashikuara në marrëdhëniet me jashtë i kundërviheshin qëndrueshmërisë së brendshme, ku atdhetarët zotëronin gjithçka. Ata ngadhënjyen në zgjedhjet e para për Pleqësinë Kishtare në Korçë, të zhvilluara më mars 1927, me pjesëmarrjen e mbarë ortodoksëve të qytetit. Të gjithë fituesit ishin të krahut kombëtar: Misto Lako, Thimi Opari, Llambi e Dhimitri Bimbli, Sotir Kota, Mina Frashëri, Lluka Fundo dhe Llambo Mborja.[731]

Ata nuk kishin qenë të pakundërshtarë. Konsullata greke e Korçës ishte orvatur të ndikonte, duke ndihmuar fshehtazi një listë të përbërë nga grekomanë. Mirëpo, Çorbaxhi hasi vështirësi. Ai vlerësonte se mbarë priftërinjtë e Korçës ishin kombëtaristë të flaktë shqiptarë, me përjashtim të vetëm dyve. Konsulli shkruante se vizita e Vangjel Çamçes ndikoi në fitoren e listës shqiptare, pasi Arkimandriti njihej për mbështetjen që kishte nga Zogu. Çorbaxhi theksonte se shqiptarët ishin të njëzëshëm. Njëkohësisht, edhe vllahishtfolësit u rreshtuan në listën e atdhetarëve, falë ndërhyrjes së kryebashkiakut të gjithëpëlqyer, Vasil Avrami. Konsulli kërkoi ndihmën e Mitropolitit Jerotheu, për të mundësuar fitoren e ndonjë grekomani. Mirëpo, Hirësia nuk e mbështeti, duke u arsyetuar se ishte e pamundur të ndërhynte pa marrë sulmin e drejtpërdrejtë të

[726] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 49-50.
[727] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 52-55.
[728] AMPJ, V. 1927, D. 28, f. 28, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 23 shkurt 1927.
[729] GAK, F. "Zyra Politike e Kryeministrit", Dosja 545, nr. κ. 103. α, Parashtresë e fshehtë e Mankuzio, pa datë.
[730] AQSH, V. 1927, F. 155 "MD", D. 66, Kryetari i Republikës drejtuar MPB, 13 prill 1927.
[731] "Dhimogjerondia e re", *Zëri i Korçës* nr. 179, 5 prill 1927, 4.

shqiptarizuesve të atyshëm.[732] Natyrisht, Jerotheu përpiqej të ruante baraspeshat, por nuk dëshironte një pleqësi grekomane, e cila do të dilte pengesë në nismat e tij atdhetare.

Çorbaxhi përcillte në Athinë se Sotir Kota pati rol të rëndësishëm në fitoren dërrmuese të listës kombëtare. Ai ishte vëllai i Kryetarit të Kuvendit, Koço Kotës, dhe fitoi në garën për Pleqësinë Kishtare. Sotiri i cyste të mbështeturit nga konsullata të ndryshonin fletëvotimin, sapo shihte se ata do të mbështesnin listën kundërshtare. Çorbaxhi shkruante se pati raste, kur kombëtaristët ndryshonin ngjyrat e fletëvotimit, në mënyrë që të dukeshin si të grekomanëve dhe shënonin në to emrat e atdhetarëve. Konsulli njoftonte se Kota i pyeste qortueshëm: "Autonomi do të bëni në Korçë?" Çorbaxhi e quante të tepërt të theksonte rëndësinë e veçantë që do të kishte fitorja e grekomanëve, por kjo ishte thuajse e pamundur. Ai arsyetonte se përpjekjet e konsullatës ishin të pasuksesshme, pasi ndërhyrja e kombëtaristëve shqiptarë e detyroi të rrinte në prapaskenë, për të mos humbur pëlqimin prej atdhetarëve korçarë.[733] Kështu, asnjë grekoman nuk fitoi, duke vërtetuar edhe me votë se ata ishin një pakicë e papërfillshme ndër ortodoksët e Korçës.

Ndërkaq, Durrësi shqetësohej nga përplasje brenda llojit. Rryma atdhetare vijonte përleshjet. Vangjel Çamçe drejtonte Mitropolinë, prej 9 nëntorit 1926.[734] Emërimi i tij ishte një përpjekje për t'i dhënë fund orvatjes së Episkop Visarionit. Xhuvani u ftua nga zëvendësmitropoliti i Elbasanit, Veniamin Haxhijakovi dhe meshoi si Episkop, më 16 janar 1927.[735] Arkimandriti pushoi zëvendësmitropolitin "kryengritës të Elbasanit", duke emëruar në vend të tij atdhetarin e sprovuar Atë Dhimitër Dhimitrukën.[736] Haxhijakovi kundërshtoi, duke mos i dorëzuar pasardhësit arkivat, pasi e cilësoi politike përplasjen me "kryengritësin e Nolit" Arkimandrit Çamçen.[737]

Muskujt mes dy atdhetarëve do të vijonin të tregoheshin edhe për ca kohë. Çamçe do të njoftonte zyrtarët shtetërorë më 8 mars se Episkop Visari kishte meshuar sërish në Elbasan. Arkimandriti lajmëronte ministrin e Brendshëm se asnjë prift nuk mund të meshonte pa lejen e zëvendësmitropolitit, duke lëshuar kushtrimin se një veprim i tillë çonte në grindje brenda bashkësisë.[738] Atë Vasil Marko dënoi ndodhinë më 22 mars, duke rikujtuar letrën e majit 1925, që quante të paqenë dorëzimin episkop të Xhuvanit.[739] Saga do të përfundonte vetëm më 7 maj, kur ministri i Brendshëm, Abdurrahman Dibra, urdhëroi prefekturat të ndalonin çdo meshim që Visarioni do të përpiqej të kryente.[740] Policia e vendosi nën vërejtje, në tetor 1927, në mënyrë që të mos merrte më pjesë në zhvillimet kishtare, për të cilat qeveria kishte plane të tjera.[741]

Nga ana tjetër, Hirësi Kristofori haste vështirësi të natyrës ekonomike në Berat[742] dhe aspak të asaj kombëtare, teksa Mitropoliti dhe pleqësia e atyshme ishin tërësisht

[732] Kondis, *Elinizmos III*, 294: IDAYE, D. a/5/x, nr. 5821, Konsullata e Korçës drejt. MPJG, 14 prill 1927.
[733] Po aty.
[734] *Zëri i Korçës* nr. 137, 9 nëntor 1926, 4.
[735] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1927, D. 210, f. 3, Haxhijakovi drejtuar Prefekturës Elbasan, 21 shkurt 1927.
[736] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1927, D. 210, f. 1, Mitropolia e Durrësit drejtuar MPB, 22 janar 1927.
[737] AQSH, Haxhijakovi drejtuar Prefekturës Elbasan, 21 shkurt 1927, cit.
[738] AQSH, F. 155 "MD", V. 1927, D. VIII-61, Mitropolia Durrës drejtuar MD, 8 mars 1927.
[739] AQSH, F. 155 "MD", V. 1927, D. VIII-61, Këshilli i Lartë Kishtar drejtuar MD, 22 mars 1927.
[740] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1927, D. 210, f. 24, MPB drejtuar të gjitha prefekturave, 7 maj 1927.
[741] "Visar Xhuvani nënë vërejtje", *Zëri i Korçës* nr. 234, 18 tetor 1927, 2.
[742] Mitropoliti i Beratit ankohej se mitropolia që drejtonte nuk kishte marrë asnjë fond shtetëror prej shpalljes së autoqefalisë, edhe pse kishte kërkuar shumë herë për nevoja emergjente (AQSH, F. 155 "MD", V. 1927, D. VIII-64, f. 1, Mitropolia e Beratit drejtuar MD, 10 tetor 1927) Mirëpo, kjo ankesë binte në vesh

atdhetare. Kështu, mbarë popullsia ishte rreshtuar në radhën e kombëtaristëve në krye të vitit 1927, me përjashtime të pakta që nuk ndikonin dot në tërësi.

Këto përjashtime kishin të bënin me zonën e pakicës greke dhe me fshatin Hoçisht të Bilishtit. Për shembull, gjendja ishte rënduar në Delvinë, qytetin e vetëm ku popullsia ortodokse i përkiste pakicës. Akoma edhe lejet e martesës hartoheshin në greqisht, si në kohën e Perandorisë Osmane.[743] Zhvillimet ishin nën drejtimin e Konsullatës Greke të Gjirokastrës, që përkohësisht drejtohej nga një shtetas shqiptar i pakicës greke, Vasil Shahini. Ai i ankohej Athinës se shqiptarët talleshin në çështjet kishtare dhe shkollore, duke përdorur mënyrën neoturke të shkatërrimit të shkallëshkallshëm, duke ndihmuar unitizmin.[744] Edhe ambasada greke i frikësohej ndikimit të ri italian. Ajo shprehej se nevojitej plotësimi i vendeve të zbrazëta të mitropolitëve dhe çelja e shpejtë e shkollës priftërore në Korçës.[745] Ndërkaq, prifti i Hoçishtit meshonte në greqisht, përkundër dëshirës së banorëve. Ministria e Drejtësisë urdhëroi ndalimin e kësaj dukurie, çka u vu në zbatim nga ana e nënprefekturës dhe Këshillit të Lartë Kishtar.[746]

Pasja nën kontroll e gjendjes së brendshme e bënte qeverinë shqiptare të priste Patriarkanën në rehati. Kisha Mëmë e shihte se kishte humbur terren, pas lajmeve të marra nga Krisanthosi. Rrjedhimisht, gjithçka mund të bënte ishte të zvarriste zgjidhjen pa kundërshtuar kërkesat shqiptare. Kështu, Patriarkana iu përgjigj zyrtarisht qeverisë shqiptare, më 19 maj 1927. Sinodhi i Shenjtë kishte vendosur për dhënien e autoqefalisë të Kishës Shqiptare, sipas Protokollit të Tiranës. Patriarku Vasil sqaronte se ishte e nevojshme të ruhej fryma e nenit të pestë që siguronte për pavarësi të plotë të Kishës Ortodokse. Kështu, ai shprehej se pranimi i marrëveshjes do të pasohej nga ngritja e Kishës me dorëzimin e pesë mitropolitëve. Më pas, përfaqësues të mitropolive nën drejtimin e Mitropolitit të Tiranës do të dërgoheshin në Stamboll, për dorëzimin e tomosit.[747]

Nezir Leskoviku vendoste theksin te "pavarësia e plotë" e Kishës nga shteti që përcaktonte vendimi Sinodhik. Sipas tij, Patriarkana Ekumenike kishte ndryshuar qëndrim pas përkujtesave të qeverisë shqiptare ndaj legatës greke, e megjithatë kërkonte pavarësi të plotë për qëllimet e fshehta që ushqente mbi Kishën Shqiptare.[748] Patriarkana lajmëroi edhe Hirësi Krisanthosin, i cili vlerësoi si lajm të mirë.[749]

Lajmi u përhap fillimisht në shtypin grek, e më pas te simotrat shqiptare. "Mesanxheri" i Athinës e botoi i pari, duke shkruar se Patriarkana e kishte njohur Kishën dhe një dërgatë shqiptare do të nisej përsëshpejti në Stamboll.[750] Ndërkaq, Jerotheu i

---

të shurdhër bënte përgjegjës Këshillin e Lartë Kishtar, si drejtuesin e njohur të KOASH. (AQSH, F. 155 "MD", V. 1927, D. VIII-64, f. 2, MD drejtuar Mitropolisë Berat, 12 tetor 1927).

[743] AQSH, F. 155 "MD", V. 1928, D. VIII-67, f. 9, MD drejtuar Këshillit të Lartë Kishtar, pa datë.

[744] Kondis, *Elinizmos III*, 291-292: IDAYE, D. A/5/X, nr. 4975, Nënkonsullata e Gjirokastrës drejtuar MPJG, 27 mars 1927.

[745] Kondis, *Elinizmos III*, 321: IDAYE, D. A/5/X, nr. 12404, Ambasada e Tiranës drejtuar MPJG, 17 shtator 1927.

[746] AQSH, F. 155 "MD", V. 1928, D. 70, f. 9, Nënprefektura Bilisht drejtuar MD, 2 maj 1928.

[747] AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 48-49, Patriarkana drejtuar Konsullatës së Stambollit, 19 maj 1927.

[748] AMPJ, V. 1927, D. 238, f. 43-44, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 20 maj 1927.

[749] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 134, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 30 maj 1927; Sinodhi, *Kisha*, 36-37.

[750] *Zëri i Korçës* nr. 212, 2 gusht 1927, 2.

kishte kërkuar Patriarkanës leje që të kryente disa lëvizje politike brenda Shqipërisë për të siguruar ndenjësen e Kryepiskopit.[751]

Qëndrimi i ri grek ndaj Shqipërisë u përforcua nga pjesëmarrja e pashoqe e konsullit grek në festimet e përvjetorit të Kongresit të Beratit. Jerotheu mungonte sërish në meshën e drejtuar nga Atë Vasil Marko.[752] Zyra e shtypit e qeverisë shpërndante fshehtazi në tetor 1927 se çështja kishtare do të përfundonte dhe se qeveria do të vijonte me zgjidhje të njëanshme, nëse Patriarkana nuk do ta dërgonte Tomosin.[753] Shtypi botoi edhe emrat e përfolur për episkopë: Jerotheu për Korçën, Kisi për Beratin, Kotoko për Gjirokastrën, Joanidhi për Durrësin dhe Kurilla si Kryepiskop në Tiranë.[754]

Emri i Mitropolitit të Pelagonisë së Re, Joakimit, dallonte nëpërmjet mungesës. Ai kishte vendosur veten në gatishmëri të Atdheut në korrik 1927, duke u lidhur me qeverinë shqiptare. Hirësia kishte takuar dy herë ambasadorin në Athinë, duke i bërë të ditur se dëshironte t'i shërbente Kishës në Shqipëri, edhe pse si Mitropolit i Pelagonisë së Re ishte i kënaqur materialisht dhe shpirtërisht.[755] Lëvizja vinte, pasi ai qe lajmëruar se ishte pjesë e listës së mundshme për Mitropolit. Atë Vasil Marko ishte pyetur për emrin e tij, por nuk kishte dhënë vlerësim, pa ditur si do të shkonte marrëveshja me Patriarkanën.[756] Mirëpo, ndërhyrja e Krisanthosit për shtimin e emrit të Joanidhit kishte bërë që Joakimi të shmangej, edhe për shkak të qëndrimit proshqiptar të tij. Krisanthos i shkruante Patriarkanës se Joanidhi ishte sugjeruar nga Kryepiskopi i Thiatirës, Gjermanosi, si një emër i denjë për Mitropolit. Ndërkaq, Kotoko, Joanidhi dhe Kurilla do të ishin "më të shëndoshë" se Kisi dhe Jerotheu.[757] Kirsanthos nuk i shmangte dot dy kryepriftërinjtë që gjendeshin në Shqipëri, mirëpo nuk donte të shtonte një atdhetar të tretë, çka do ta shmangte tërësisht ndikimin grek.[758] Hirësi Joakimi e kishte kuptuar se Krisanthos do të përpiqej ta minonte emërimin e tij. Ai i shkruante fshehtazi Xhafer Ypit në fundvit 1927 se Krisanthos e kishte mënjanuar karrierën 20-vjeçare të Joakimit për ta zëvendësuar me një laik, falë lidhjes që krijoi në Tiranë me Kisin, Jerotheun dhe disa të tjerë. Ai kërkoi ndërhyrjen pranë Patriarkanës, ku të theksohej se qeveria shqiptare nuk

---

[751] Apostolos Glavinas, *Εγγραφα περί της πραξικοπηματικής συγκροτήσεως της συνόδου της Ορθοδόξου Εκκλησίας της Αλβανίας (1929) [Dokumente mbi organizimin grushtshtetas të Sinodhit të Kishës Ortodokse të Shqipërisë (1929)* (Janinë: Fondacioni i Hapësirës së Jonit dhe Adriatikut, 1981), 11-12.

[752] *Zëri i Korçës* nr. 224, 13 shtator 1927, 4.

[753] "Çështja e Kishës", *Zëri i Korçës* nr. 230, 4 tetor 1927, 2.

[754] *Zëri i Korçës* nr. 232, 8 tetor 1927, 4.

[755] AMPJ, V. 1927, D. 239, f. 1, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 26 korrik 1927.

[756] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1927, D. VI-239, f. 25, Prefektura Korçë drejtuar MPB, pa datë.

[757] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 42.

[758] Gjykimi i Hirësi Krisanthosin nuk ishte tërësisht i saktë. Ai do të kishte të drejtë vetëm për Pandeli Kotokon. Mirëpo, Evlogji Kurilla do të vijonte të njëjtën lëvizje atdhetare shqiptare që kishte kryer gjatë gjithë jetës, edhe pse filogrek. E njëjta gjë mund të thuhet për Vasil Joanidhin, i cili, do të jepte ndihmesën tij për fuqizimin e një Kishe Shqiptare vite më vonë. Ai pati ulje-ngritje në marrëdhëniet me Jerotheun, pavarësisht se të dy përkrahën lëvizjen shqiptare. Vlen të theksohet se Patriarkana tregoi standarde të dyfishta. Ajo kishte vendosur si kusht të padiskutueshëm më herët që episkopët të ishin për një kohë të caktuar priftërinj përpara se të dorëzoheshin episkopë. Ky kusht nuk vlejti për asnjë prej tre emrave të kësaj liste, teksa Kurilla, Kotoko dhe Joanidhi nuk ishin dorëzuar priftërinj. Kjo ndodhte, ndërkohë që një numër i madh arkimandritësh gjendeshin në Shqipëri (ndër të cilët episkopët e mëvonshëm Çamçe, Ambrozi, Eugjeni, Paisi etj.), apo edhe episkopë shqiptarë (Joakimi, Polikarpi, Visarioni, Nolit). Mirëpo, qëllimi i Patriarkanës duket se ka qenë pikërisht gjendja e tre njerëzve që mund t'i udhëhiqte. Kjo, teksa të gjithë të tjerët kishin dhënë shenja shërbimi ndaj atdheut dhe kombit të tyre dhe jo ndaj Greqisë, duke u bërë, siç shënon Krisanthosi, "jo të shëndetshëm" për Kishën.

kishte asnjë ngurrim për emrin e tij.[759] Kështu, Ministria e Jashtme lajmëroi Kostandinopojën se Joanidhi do të pranohej vetëm nëse Joakimi kundërshtonte emërimin.[760]

Mirëpo, çështja kishtare mbeti në vendnumëro për gjashtë muaj. Arsyet janë të paqarta, për mungesë provash burimore. Mirëpo, mund të thuhet se vëmendja e qeverisë shqiptare nuk ishte në çështjen kishtare, teksa një zhvillim i rëndësishëm zaptonte politikën e jashtme. Shqipëria kishte nënshkruar një marrëveshje me Italinë, prej vitit 1926, dhe po bisedonte thellimin e saj. Pakti i Dytë i Tiranës u nënshkrua në nëntor 1927. Ai përcaktonte se Italia do të ndërhynte ushtarakisht, nëse rrezikohej tërësia tokësore e Shqipërisë. Përshpejtues për bisedimet e reja kishte qenë ftohja italiano-jugosllave. Jugosllavia dhe Greqia patën ndihmuar Zogun të vinte në pushtet dhe prisnin zbatimin e marrëveshjeve përkatëse. Zogu u qe shmangur trysnive, kryesisht falë ndihmës italiane. Prandaj, pakti i dytë përbënte një arritje të madhe për të ruajtur vendin nga fqinjët.[761]

Kjo duhet të shihet si arsyeja e mungesës së vëmendjes së qeverisë shqiptare gjatë vitit 1927. Komisioni i posaçëm Ortodoks Shqiptar miratoi njëzëri përgjigjen vetëm më 23 nëntor. Ai falënderoi Patriarkanën për pranimin e protokollit dhe shprehu mendimin se vendimi sinodhik i jepte fund çështjes kishtare, duke gëzuar të gjithë ortodoksët dhe mbarë shqiptarët në përgjithësi. Komisioni i kërkonte Patriarkut të vijonte me plotësimin e vendeve të zbrazëta, trupëzimin e Kishës dhe dorëzimin e Tomosit.[762]

Ministri i Jashtëm, Iljaz Vrioni, u përgjigj më 17 dhjetor se qeveria shqiptare e mbështeste dhe falënderonte Kishën Mëmë për zgjidhjen në përputhje me Protokollin e Tiranës. Qëndrimi shqiptar u dorëzua më 12 janar dhe sekretari i Patriarkanës, Arkimandriti Maksimos, u përgjigj se ajo do të shqyrtohej në mbledhjen e ardhshme të Sinodhit. Përgjigjja nuk erdhi siç pritej. Patriarku Ekumenik i tha konsullit shqiptar më 3 prill se autoqefalia nuk ishte vendosur ende. Ai e trajtoi si çështje pa rëndësi dhe tha se Patriarkana kishte tepër punë e pak njerëz. Patriarku njoftoi se ajo do të shqyrtohej pasi të përfundonte Pashka dhe të rimblidhej Sinodhi. Mirëpo, lajmet që Leskoviku kishte siguruar tregonin një të vërtetë tjetër. Anëtarët e Sinodhit ishin urdhëruar nga Greqia të zvarrisnin çështjen, pavarësisht pse Patriark Vasili ishte pro dhënies së Tomosit.[763]

Zvarritja me arsyetime nga më të ndryshmet po përdorej ato ditë edhe me italianët për Kishën e Dodekanezit. Qeveria shqiptare nuk ishte e gatshme të priste pafundësisht, teksa vlerësonte se Patriarkana po tallej me palën shqiptare. Akoma edhe grekomani Pandeli Kotoko kishte shprehur të njëjtin mendim. Ai shpallte më 21 janar 1928 se Kisha duhet të ngrihej me kryengritje.[764] Ndaj, ai vit niste me mendimin e kthjellët se Patriarkana nuk kishte lënë shteg tjetër përveçse një zgjidhje të njëanshme. Lajmi që dha Nezir Leskoviku se Sinodhi do ta shtynte dhënien e Tomosit u bë përshpejtues për qëndrimin e ri shqiptar. Ministri i Jashtëm, Xhafer Vila, i dërgoi Leskovikut udhëzimin përfundimtar, më 13 prill. Ai duhet t'i bënte të qartë Patriarkanës se vendimi duhet të merrej sa më shpejt, pasi çështja ishte vonuar për shumë kohë.[765]

---

[759] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 135-137, Hirësi Joakimi drejt. Ypit, 29 dhjetor 1927.; Sinodhi, Kisha, 38-42.
[760] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 67, MPJ drejtuar Konsullatës së Stambollit, 3 shkurt 1928.
[761] Puto, *Shqipëria Politike*, 350-450.
[762] AMPJ, V. 1927, D. 238 f. 56, Komisioni i Posaçëm për Çështjen e KOASH drejtuar Patriarkut Ekumenik, 22 nëntor 1927.
[763] Sinodhi, Kisha , 37-44.
[764] Glavinas, *Dokumente 1929*, 12.
[765] Sinodhi, Kisha , f. 44.

Njëkohësisht, qeveria nisi zbatimin e planit "B": krijimin e Sinodhit të Shenjtë në mënyrë të njëanshme. Lajmi u bë i ditur edhe në shtypin e huaj. Fletorja greke "Patridhos" botonte më 21 prill 1928 se zgjidhja e çështjes kishtare shqiptare po përgatitej me anë të puçit, duke dorëzuar Kotokon dhe Joanidhin dhe duke zgjedhur Kryepiskop Jerotheun.[766]

Hirësi Kristofori mbërriti në Tiranë më 5 maj. Ai mbajti një fjalim atdhetar, pasi meshoi në shqip dhe greqisht bashkë me Arkimandrit Çamçen.[767] Atë Vasil Marko dhe Pandeli Kotoko u thirrën nga qeveria dhe mbërritën në kryeqytet, pas dy ditësh.[768] Patriarkana u gjend në vështirësi. Hirësi Krisanthos i shprehu qeverisë shqiptare më 8 maj pakënaqësinë e Kishës Mëmë mbi ndonjë veprim të njëanshëm. Ai shpresonte se pala shqiptare nuk do të lejonte diçka të tillë teksa çështja ishte afër zgjidhjes.[769]

Krisanthosi i përcolli qeverisë një letër të Patriarkut Vasil. Letra përpiqej ta zvarriste sërish çështjen, sikurse kishte paralajmëruar konsulli në Stamboll. Arsyetimi ishte krejt i ri, madje nuk i ishte thënë as Leskovikut gjatë takimit që pati me Tërëshenjtërinë e Tij. Sinodhi kishte vendosur të ribisedohej për të sqaruar disa çështje që mund të krijonin pengesa gjatë përfundimit të autoqefalisë.[770] Krisanthos i kishte thënë qeverisë shqiptare se Patriarkana do të kërkonte të sqaroheshin vetëm se cilat shkelje do të bënin që palët ta quanin Protokollin të rrëzuar.[771] Patriarkana dëshironte të dërgonte sërish Krisanthosin në Tiranë, me qëllim që të merreshin përgjigjet e nevojshme dhe pastaj do të vijonte me krijimin kanonik të Kishës Autoqefale. Gjithashtu, ajo njoftonte se një prej pesë mitropolitëve duhet të ishte doemos Vasil Joanidhi dhe do të vendosej mes Joakimit, Kotokos dhe Kurillës për dy të tjerët, çka nënkuptonte heqjen e të parit.[772] Njëkohësisht, Hirësi Krisanthos lajmëroi Hirësi Jerotheun dhe Hirësi Kristoforin se i bënte përgjegjës për thyerje të kanoneve të shenjta, në rast se do të vijohej me zgjidhje të njëanshme.[773]

Qeveria shqiptare kishte dy zgjidhje. E para ishte të priste edhe një herë kërkesa të reja të paraqitura nga Hirësi Krisanthosi, që do të shqyrtoheshin nga Komisioni i posaçëm Ortodoks Shqiptar, do të miratoheshin nga Këshilli i Ministrave, do t'i përcilleshin Patriarkanës nëpërmjet Mitropolitit të Trapezundës; Patriarkana do të mblidhte Sinodhin, do t'ia përcillte një komisioni të posaçëm, mendimi i të cilit do të trajtohej sërish nga Sinodhi, që do të merrte vendimin, që Krisanthosi dhe Leskoviku do t'ia përcillte qeverisë shqiptare. Në fund, autoqefalia do të shpallej vetëm nëse të gjitha hallkat e këtij zinxhiri do të vendosnin pro dhe Patriarkana do të kishte vullnet për të dhënë Tomosin.

Zgjidhja e dytë ishte krijimi i njëanshëm i Sinodhit, çka edhe sipas Hirësi Krisanthosit do ta vendoste Patriarkanën para faktit të kryer dhe ajo do të detyrohej ta pranonte herët a vonë. Komisioni Ortodoks Shqiptar dhe drejtuesit e Kishës, Vasil

---

[766] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 88, Shkrim i gazetës "Patridhos", 21 prill 1928.

[767] *Zëri i Korçës* nr. 290, 5 maj 1928, 2. Drejtuesit kishtarë shqiptarë treguan maturi që Patriarkana të mos mund të kundërshtonte për çështjen e gjuhës. Kisha do të mund të shqiptarizohej, pasi të krijohej Sinodhi, prandaj deri atëherë mund të pritej duke ruajtur zyrtarisht traditën e kishave përkatëse.

[768] *Zëri i Korçës* nr. 291, 8 maj 1928, 4.

[769] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 83-84, Mitropoliti Krisanthos drejtuar MPJ, 8 maj 1928.

[770] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 84-87, Patriarku Vasil drejtuar MPJ, 5 maj 1928.

[771] AMPJ, Mitropoliti Krisanthos drejtuar MPJ, 8 maj 1928, cit.

[772] AMPJ< Patriarku Vasil drejtuar MPJ, 5 maj 1928, cit.

[773] Glavinas, *Dokumente 1929*, 43: Arkivat e Studimeve Vorio-Epirotase (ASVE), , F. "Mitropoliti Jerotheu", Jerotheu drejtuar Patriarkut, 13 mars 1929.

Marko, Jerotheu, Kristofori e Kotoko ndodheshin në Tiranë prej 7 majit.[774] Mirëpo, trazirat qeveritare i detyruan të prisnin dy javë pa kryer asnjë takim.[775] Ata u mblodhën vetëm në fund të muajit. Bisedimet zgjatën disa ditë. Fillimisht, komisioni qeveritar dhe kryepriftërinjtë nuk ishin të njëmendtë për disa çështje.[776]

Drejtuesit kishtarë kërkuan që zgjidhja të bëhej në bazë të Protokollit të Tiranës, mirëpo Kota dhe Evangjeli kundërshtuan.[777] Gjithsesi, çështjet u tejkaluan dhe ata vendosën njëzëri krijimin e Sinodhit me katër episkopë, Jerotheun, Kristoforin, Kotokon dhe Joanidhin. Sipas vendimit, një kuvend i ri kishtar do të mblidhej, do të hartonte dhe miratonte Statutin Themeltar të KOASH-it dhe do t'i jepte votëbesim Sinodhit të Shenjtë. Episkopët e rinj do të dorëzoheshin vetëm pas mbledhjes. Marrëveshja përcaktonte se Atë Vasil Marko do të vijonte të kryesonte Kishën derisa të mblidhej Kuvendi i ri Kishtar.[778]

Këto përcaktime përkonin me planin e fshehtë të dorëzuar nga Jerotheu dhe Kotoko në fillimvitin 1925 në Athinë, me përjashtim se krijimi i Sinodhit nuk do të kryhej nga Patriarkana, por në mënyrë të njëanshme. Hirësi Jerotheu, Kotoko dhe Atë Vasil Marko u kthyen menjëherë në Korçë, ku prisnin ardhjen e Joanidhit për të zbatuar planin.[779]

Vasil Joanidhi i dërgoi letër Arkimandrit Vangjel Çamçes nga Selaniku më 20 korrik. Ai shprehej se pala shqiptare duhet të pranonte disa nga kushtet e Patriarkanës dhe se rruga që ishte vendosur sillte disa pikëpyetje. Joanidhi pyeste se kush do të zgjidhte, vendoste dhe dorëzonte episkopët dhe mbi të gjitha me lejen e kujt, për aq sa një Kuvend Kishtar kishte fuqi vetëm në vendet me shumicë të krishterë. Megjithatë, ai shprehej i gatshëm të kthehej në Shqipëri dhe të dorëzohej episkop edhe me kushtet e përcaktuara.[780]

Drejtuesit kishtarë ishin shpërndarë, në pritje të Joanidhit. Kjo e shqetësoi Atë Vasil Markon. Ai i ankohej prefektit të Korçës se Hirësi Jerotheu do të shkonte për banjat vjetore, pasi kishte qëndruar një muaj në Përmet. Hirësi Kristofori pyeste kur do të vinte Joanidhi, në mënyrë që të mund të ikte në Evropë siç e kishte paracaktuar. Ndërkaq, Pandeli Kotoko nuk pranonte të dorëzohej dhjak, pa ardhur më parë i përfoluri tjetër për episkop. Moszbatimi i përcaktimeve të marrëveshjes së Tiranës bënte Atë Vasil Markon të mos ishte në gjendje të kuptonte qëllimin e sjelljeve të mitropolitëve dhe Kotokos.[781]

Frika e Atë Vasilit nuk kishte bazë për Kisin. Ai dëshironte të vizitonte kishat autoqefale të vendeve të tjera, me qëllim fuqizimin e kishës shqiptare. Hirësia po punonte për zbatimin e marrëveshjes, duke kërkuar statutet e kishave autoqefale, në bazë të të cilave do të hartohej edhe ai i kishës shqiptare.[782] Qeveria i dha sërish siguri të plotë Atë Vasilit më 2 gusht se do të njihte vetëm Këshillin e Lartë, deri në zyrtarizimin e Sinodhit.[783]

---

[774] "Çështja e kishës orthodhokse së çpejti mer funt", *Zëri i Korçës* nr. 292, 12 maj 1928, 2.
[775] *Zëri i Korçës* nr. 294, 19 maj 1928, 4.
[776] "Çështja e Kishës Autoqefale", *Zëri i Korçës*, 29 maj 1928, 2.
[777] Glavinas, *Dokumente* 1929, 43.
[778] "Çështja e Kishës Orthodhokse mori funt", *Zëri i Korçës* nr. 302, 16 qershor 1928, 2.
[779] *Zëri i Korçës* nr. 302, 16 qershor 1928, 4.
[780] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 28, Joanidhi drejtuar Arkimandrit Çamçes, 20 korrik 1928.
[781] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1928, D. VI-271, f. 3, Prefektura Korçë drejt. MPB, 19 korrik 1928.
[782] AMPJ, V. 1928, D. 336, f. 1, Mitropolia Berat drejtuar Legatës së Bukureshtit, 17 gusht 1928.
[783] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1928, D. VI-271, f. 4, VKM nr. 481, 2 korrik 1928.

Vendimi i qeverisë për të mos pritur ishte përforcuar në qershor, korrik dhe gusht të atij viti. Patriarkana Ekumenike kishte nxjerrë një sërë pengesash për çështjen kishtare shqiptare, por nuk hezitoi të nënshkruante kalimin në varësi të Kishës së Greqisë të të gjitha mitropolive të trojeve të përfshira në Greqi në vitin 1913: në Epir, Maqedoni, Trakë dhe ishuj. Kisha e Greqisë qeveriste deri atëherë vetëm truallin e vjetër të Greqisë dhe trojet e reja vijonin të ishin nën varësinë e Patriarkanës Ekumenike. Dobësia pas ikjes së ortodoksëve nga Turqia kishte bërë që kalimi të mos ishte i menjëhershëm. Shteti grek vendosi nëpërmjet një ligji të veçantë përfshirjen e trojeve të reja në Kishën e Greqisë në korrik 1928. Patriarkana pasoi në gusht, duke dorëzuar qeverisjen e trojeve të reja, megjithëse shpirtërisht ato vijonin të ishin nën varësinë e Kishës Mëmë.[784]

Kalimi i beftë ishte ngacmim për Shqipërinë. Patriarkana kishte pranuar të ndiqte një ligj të shtetit grek, i cili nuk e pyeti fare nëse Vendet e Reja duhet të kalonin apo jo në Kishën e Greqisë. Ndërkaq, ajo nuk pranonte autoqefalinë përballë ortodoksëve shqiptarë, pavarësisht pse shpallja ishte kryer me vendim të një kongresi mbarortodoks. Njëherazi, vijonte të zvarriste bisedimet përballë komisionit qeveritar. Qëndrimi i dyfishtë i Patriarkanës u bë përshpejtues që qeveria shqiptare të mos pranonte më të hynte në bisedime, e bindur se kishte vetëm një zgjidhje: krijimin e njëanshëm të Sinodhit!

[784] Kostandinidhi, *Shpallja e autoqefalisë,* 65-105.

KREU IV:
KRIJIMI I SINODHIT DHE KONGRESI I KORÇËS, 1928-1929

4.1.Dështimet e përpjekjeve fillestare për krijimin e Sinodhit, 1928

Ajo çfarë nuk përbënte më çështje në Shqipëri ishte se kush po e drejtonte vendin. Udhëheqësi i pakundërshtueshëm ishte Ahmet Zogu, i cili kishte qenë politikan kyç që prej rikrijimit të shtetit, me anë të Kongresit të Lushnjës. Ai kishte mbetur i pasfiduar prej rikthimit në fundvitin 1924 dhe në krye të muajit pasardhës ishte shpallur Kryetar i Republikës. Përparësi ishte ngjizja e shtetit dhe pushtetit, shmangia e rreziqeve të jashtme që asokohe dalloheshin nga Jugosllavia e Greqia dhe fuqizimi i ngrehinës shtetërore. Ngjizja e brendshme u pasurua në pak kohë me fuqizimin e jashtëm. Jugosllavia dhe Greqia nuk përbënin më kërcënim pas ujdive të nënshkruara me Italinë në kryeqytetin shqiptar. Rrugët e Tiranës gumëzhinin nga thashethemet për të ardhmen e vendit, verën e 1928-ës. Askush nga ajka politike nuk kishte shkuar për pushime atë vit. Kahkundërt, po përgatisnin veprën përfundimtare të planit të nisur në Krishtlindjet 1924. Vendimi ishte marrë në fundmaj. Dhoma e Deputetëve dhe Senati ndryshuan statutin më 7 qershor, duke përcaktuar se rishikimi i tij mund të bëhej me anë të një Asambleje Kushtetuese. Zgjedhjet për Asamblenë u kryen me votim të drejtpërdrejtë më 17 gusht 1928. Kërkesa për shpalljen e Ahmet Zogut Mbret erdhi nga poshtë. Mbledhja themeluese e 25 gushtit u pasua nga ajo për betimin e anëtarëve dhe zgjedhjen kryetar të Pandeli Evangjelit dy ditë më vonë. Kërkesat u lexuan në mbledhjen e tretë të datës 29. Asambleja vendosi njëzëri dhe në këmbë që Shqipëria të shpallej Mbretëri dhe Ahmet Zogu të shpallej Mbret i Shqiptarëve me emrin Zogu I, Skënderbeu III, në orën 9 të datës 1 shtator. Mbreti e pranoi kurorën pas një ore dhe betimi u zhvillua në orën 16:40, shoqëruar nga festime treditore në mbarë Shqipërinë.[785]

Mbretëria e re ishte gati të fuqizonte ngrehinat kombëtare. Kisha Ortodokse ishte një synim i kahershëm i Mbretit të ri, i cili si ministër i Brendshëm kishte ndihmuar në punimet e Kongresit të Beratit. Emërimi i korçarit të njohur, Koço Kota, në vendin e Kryeministrit ishte ndër veprimet e para të Mbretit. Lajmi do të kishte rrjedhoja edhe në çështjen kishtare. Kota ishte mbështetës i flaktë i autoqefalisë si shumica dërrmuese e korçarëve. Mbi të gjitha, ai ishte nxitësi më i madh politik i çështjes. Ai kishte qenë prefekt në Berat në vitin 1922, kur u shpall Autoqefalia. Më vonë, kishte qenë nënkryetar i Komisionit Ortodoks Shqiptar, nën kryesimin e Pandeli Evangjelit, në të gjitha bisedimet me Hirësi Krisanthosin. Për më tepër, miku i tij Zoi Xoxa pohonte se Kota e shihte autoqefalinë si një çështje të denjësisë kombëtare dhe në veçanti të denjësisë së shqiptarëve ortodoksë, shumica dërrmuese e të cilëve nuk donin të ishin nën varësinë e Patriarkanës Ekumenike dhe rrjedhimisht shtetit grek.[786]

---

[785] Mbreti i Shqiptarëve, dhe jo i Shqipërisë, tregonte edhe një herë natyrën atdhetare që do të përvijonte shteti i drejtuar tashmë nën një kurorë. Ndërkaq, Zogu I ishte një emër i pranueshëm për mbarë kombin, teksa kishte natyrë kombëtare dhe jofetare, siç do të kishte emri Ahmet. Ai nuk do të vetëcaktohej mysliman, porse Mbret i një kombi shumëfetar, gjatë gjithë karrierës politike. Po ashtu, kurora mori emërtimin Skënderbeu III, duke vijuar traditën e vendosur nga paraardhësi Princ Vidi, i cili u shpall Skënderbeu II.

[786] Zoi Xoxa, *Kujtimet e një gazetari* (Tiranë: "55", 2007), 121.

Një shërbesë për përvjetorin e Autoqefalisë u zhvillua në Tiranë, më 13 shtator. Kongresi i Beratit u kremtua edhe në Korçë, sërish nën drejtimin e Atë Vasil Markos. Mirëpo, habia e të gjithëve erdhi ngase Hirësi Jerotheu nuk kishte ikur më herët nga qyteti për të mos marrë pjesë. Mitropoliti u nis për në Përmet, vetëm gjysmë ore përpara nisjes së shërbesës. Shtypi e tëhuajti veprimin.[787] Edhe prefekti Jella ishte zhgënjyer nga kjo sjellje. Mitropoliti ishte parë nga të gjithë në lagjen Radenec, duke pritur me ankth makinën, për të ikur me shpejtësi. Kjo kishte lënë një shije shumë të hidhur. Prefekti thoshte se duhet të kishte sugjeruar dëbimin e Jerotheut, siç kërkonte "Gazeta e Korçës", por nuk kishte se ku të gjendej një episkop tjetër për të zënë vendin e tij. Prandaj, Jella mendonte se duhet të durohej edhe 3-4 muaj me kusht që të përdorej çdo mjet për ngritjen e shpejtë të Sinodhit.[788]

Arsyet e sjelljes së Jerotheut janë të paqarta. Ai mungonte qëllimisht nga përvjetori i shpalljes së Autoqealisë, gjatë viteve të kaluara, por e përligjte paraprakisht mungesën. Hirësia përpiqej të ruante marrëdhëniet me konsullin grek, me synim mbrojtjen edhe të lëvizjes kishtare, teksa qeveria shqiptare shpesh dukej se luhatej dhe marrëdhëniet shkonin disa herë në dobi të Greqisë. Mirëpo, ai ishte në Korçë më 13 shtator 1928, edhe pse e dinte se kremtimi do të zhvillohej. Natyrisht, Hirësi Jerotheu do të ishte i fundit që donte të dallohej mosprania e tij. Qenia në Korçë atë mëngjes lë të kuptohet se ai dëshironte të merrte pjesë në gjashtëvjetorin e Kongresit të Beratit, për herë të parë, tashmë që Shqipëria ishte fuqizuar si mbretëri dhe autoqefalia ishte vendosur të shpallej njëanshmërisht. Diçka e rëndësishme e detyroi të ikte në çastin e fundit.

Arsyeja duhet parë te zhvillimet e brendshme në çështjen kishtare. Vasil Joanidhi kishte mbërritur në Korçë prej pak kohësh. Ai u përplas me Jerotheun dhe Atë Vasil Markon që në ditët e para. Sjellja e dy drejtuesve kishtarë e kishte dëshpëruar në atë pikë, saqë i shprehu prefektit Jella dëshirën për të ikur sa më shpejt nga Shqipëria.[789] Arsyet e vërteta të përplasjes nuk dihen. Mirëpo, dallohet se Kotoko dhe Joanidhi kishin krijuar njëfarë mosmarrëveshjeje me drejtuesit e Kishës në Korçë. Prefekti Jella i thirri në zyrë dy të përfolurit për episkopë më 3 tetor dhe u kërkoi të jepnin fjalën se do të dorëzoheshin. Të dy pohuan se ishin të gatshëm.[790] Prandaj, qeveria kërkoi nga Hirësi Kristofori të shkonte në Korçë për t'i dhënë krye krijimit të Sinodhit të Shenjtë. Kisi u zotua se do të ndodhej në qendrën e lëvizjes kishtare shqiptare, më 19 tetor.[791]

Mirëpo, Joanidhi u paraqit sërish në Prefekturë më 10 tetor, duke njoftuar ikjen në Selanik, si pasojë e dëshpërimit nga sjelljet e kryepriftërinjve. Prefekti Jella i kërkoi Joanidhit të shkonte në Tiranë, së bashku me dërgatën që do të uronte Mbretin për fronëzimin, pasi e kishte kërkuar Kryeministri Kota. Kjo nuk ishte e vërtetë. Jella gënjeu me shpresë se Kryeministri do ta bindte të përzgjedhurin për episkop.[792]

Joanidhi u nis bashkë me Hirësi Jerotheun, Atë Vasil Markon dhe Atë Josif Qiricin për në Tiranë.[793] Ata u pritën nga Mbreti Zog pas dy ditësh. Dërgata i shfaqi fronit mbretëror urimet dhe përulje.[794] Patriarku Vasili do ta uronte Mbretin pak ditë më

[787] *Zëri i Korçës* nr. 328, 15 shtator 1928, 4.
[788] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 37, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 26 shtator 1928.
[789] Po aty.
[790] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 46, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 3 tetor 1928.
[791] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 53, Prefektura Berat drejtuar MPB, 9 tetor 1928.
[792] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 58, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 10 tetor 1928.
[793] *Zëri i Korçës* nr. 336, 12 tetor 1928, 4.
[794] *Zëri i Korçës* nr. 338, 20 tetor 1928, 2.

vonë dhe do të shprehte lidhjet e shenjta që ka pasur Kisha e Madhe me Shqipërinë dhe kombin shqiptar.[795] Përpara këtij urimi, Patriarku kishte marrë zotimin nga Mitropolit Jerotheu se çështja kishtare shqiptare nuk do të rregullohej kurrë sipas dëshirës së qeverisë për aq sa ai dhe kolegët e tij do të ishin në Shqipëri; çka kishte mbërritur në duart e qeverisë shqiptare, nga konsulli Nezir Leskoviku.[796]

Hirësi Jerotheu kërkoi zgjidhjen e çështjes kishtare nëpërmjet bisedimeve gjatë qëndrimit në Tiranë. Qeveria i tha se nuk pranonte të hynte në një rreth të ri kundërshtish, në të cilat Patriarkana Ekumenike do ta turpëronte dhe ulte përsëri.[797] Dërgata u kthye në Korçë dhe u takua me Hirësi Kristoforin, i cili u gjend në qytet prej datës 19, siç kishte paralajmëruar. Dy mitropolitët dhe dy të lakuarit për episkopë vendosën që Hirësi Kristofori të dërgohej në Tiranë me disa kushte përpara zgjidhjes së çështjes kishtare. Ai u nis më 25 tetor, pa lajmëruar as prefektin Jella, as kryebashkiakun Avrami, pavarësisht se i kishte premtuar prefektit dorëzimin e shpejtë të Kotokos dhe Joanidhit.[798] Jella mori vesh për ikjen e Kisit nga Atë Vasil Marko.[799] Kreu i Këshillit Kishtar ishte kundër vendimit të kryepriftërinjve të tjerë, por nuk pranoi të bënte të ditur arsyen e vizitës së re të Mitropolitit të Beratit.[800]

Marko nuk zbatoi as kërkesën e Prefektit për të zgjedhur Joanidhin dhe Kotokon si episkop, siç përcaktohej në Statutin e Beratit, derisa Hirësi Kristofori të kthehej në Korçë. Jella ishte gjendur në vështirësi. Ai nuk kuptonte çfarë kishte ngjarë: ishte njoftuar për një mosmarrëveshje mes Joanidhit e Kotokos dhe Atë Vasil Markos. Mirëpo, keqkuptimi u zhduk me ndërmjetësimin e Vasil Avramit dhe Atë Vasili pranoi të vepronte sipas udhëzimeve të qeverisë. Lajme të tjera thoshin se Kisi do të kërkonte prishjen e Këshillit të Lartë, përpara se të vijonin me planin. Jella vlerësonte se kjo mund të bëhej, pasi Joanidhi dhe Kotoko të ishin dorëzuar dhjakë dhe përpara se të dorëzoheshin episkopë. Ai ishte bindur se faji qëndronte mbi dy mitropolitët, sidomos pas fjalëve të Joanidhit se xhaxhai i tij, Jerotheu, kishte kryer tradhti kombëtare. Jella rrëfente se nuk do t'i harronte kurrë fjalët e Joanidhit që fajësonte Mitropolitin, me mjetet e të cilit ishte arsimuar.[801]

Hirësi Kristofori u takua me Kryeministrin Kota në fundtetor dhe i shfaqi dëshirën e tij, Jerotheut, Kotokos dhe Joanidhit për të përvijuar bisedimet me Patriarkanën. Mirëpo, qeveria ishte e prerë. Ajo e kundërshtoi sugjerimin dhe njoftoi se do ta trupëzonte vetë Kishën Autoqefale, ndaj duhet të dorëzoheshin sa më shpejt dy episkopët, të hartohej statuti dhe të mblidhej kongresi për të zgjedhur Sinodhin.[802] Plani ishte që Joanidhi dhe Kotoko të dorëzoheshin dhjakë dhe të pritej një muaj për t'u dorëzuar episkopë.[803]

Hirësi Kristofori u kthye në Korçë më 4 nëntor. Koço Kota urdhëroi Jellën të mblidhte episkopët dhe të kërkonte të shpallnin zyrtarisht qëndrimin e tyre.[804] Hirësi

[795] *Zëri i Korçës* nr. 339, 23 tetor 1928, 1.
[796] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 104, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 16 tetor 1928.
[797] Glavina, *Dokumente 1929*, 44.
[798] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 78, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 30 tetor 1928.
[799] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 74, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 25 tetor 1928.
[800] Glavina, *Dokumente 1929*, 44.; AQSH, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 25 tetor 1928, cit.
[801] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 77, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 27 tetor 1928.
[802] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 81, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 4 nëntor 1928.
[803] *Zëri i Korçës* nr. 340, 27 tetor 1928, 2.
[804] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 82, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 5 nëntor 1928.

Kristofori foli sërish në emër të të katërtëve. Sipas tij, drejtuesit kishtarë kërkonin që detyra e zgjidhjes së njëanshme t'u ngarkohej me anë të një vendimi qeveritar, në mënyrë që të vepronin në dobi të Kishës Autoqefale dhe shtetit shqiptar.[805] Kryeministri nuk e plotësoi kërkesën për të marrë vendim qeveritar mbi trupëzimin e Kishës. Mirëpo, ai gjeti një rrugë të ndërmjetme, duke u dërguar një letër dy mitropolitëve, ku kërkonte të dorëzonin Joanidhin dhe Kotokon dhe të mblidhnin Sinodhin, sipas marrëveshjes së arritur në Tiranë. Kota shfaqte dëshirën që t'i jepej fund çështjes së Kishës Autoqefale. Letra u botua në shtyp, si një siguri shtesë për kërkesat e Hirësi Kristoforit.[806]

"Gazeta e Re" e përshëndeti menjëherë. Zoi Xoxa shkruante se vullneti i atdhetarëve nuk kishte munguar kurrë, por disa dredharakë dëshironin të peshkonin në ujëra të turbullta, duke i dhënë ngjyrë politike mungesës së rendit kishtar. Ai shprehte besimin se këto vështirësi do të kapërceheshin me hapa vigani, në qeverisjen e "një burri gjenial si Lart Madhëria e Tij Mbreti dhe një Kryeministër energjik dhe atdhetar si Z. Koço Kota". Xoxa shprehte siguri edhe mbi atdhetarinë e dy episkopëve, e cila do të bëhej shtysë për zgjidhjen e çështjes. Ai përfundonte duke kujtuar theroritë e së kaluarës për t'u çliruar nga dredhitë e huaja e për të siguruar pavarësinë e shtetit dhe autoqefalinë e Kishës.[807]

Mirëpo, gjendja ishte ndryshe në Korçë. Vasil Joanidhi u përpoq të ikte për në Selanik sërish më 12 nëntor. Prefekti Jella ishte lajmëruar në kohë dhe pagoi makinën e shoqërisë "Starova" të largohej më shpejt pa e kuptuar i përzgjedhuri për episkop. Joanidhi u ankua se mitropolitët kishin ndërmend ta zgjidhnin çështjen me anë të Patriarkanës dhe ndaj nuk dëshironte të rrinte.[808] Kryeministri Kota udhëzoi Jellën t'i kujtonte Joanidhit se kishte ardhur në Shqipëri me pranim të qeverisë qendrore dhe duhet t'i paraqeste asaj arsyet që e çonin në vendimin e largimit, nëse nuk dëshironte të qëndronte.[809]

Joanidhi u përgjigj sërish se çështja kishtare po pengohej dhe ndaj donte të largohej. Episkopët kërkonin disa të drejta, të cilat qeveria i mohoi. Ata vijuan duke kërkuar që trupëzimi i Kishës t'u ngarkohej nëpërmjet një vendimi qeveritar. Kjo nënkuptonte prishjen e Statutit të Beratit, çka Joanidhi e kundërshtonte. Ai vendoste në pah se dy episkopët kishin dorëzuar në të kaluarën një Mitropolit, Theofan Nolin. Ndaj, nuk shihte arsye pse tani nuk pranonin përsëritjen e të njëjtit veprim. Së fundmi, Joanidhi parashtronte mendimin se katër drejtuesit kishtarë nuk mund të bënin kurrë Kishë, për shkak të përplasjeve mes tyre. Ai shprehej i gatshëm të kthehej kurdoherë, nëse mitropolitët ose qeveria do të ndryshonin mendim.[810] Joanidhi nuk priti përgjigjen e qeverisë dhe njoftoi prefektin të nesërmen se po ikte për në Selanik. Kjo e bindi Jellën për mungesën e sinqeritetit të të përzgjedhurit për episkop.[811]

Kryeministri Kota mori gjendjen në dorë. Ai thirri menjëherë Atë Vasil Markon, Joanidhin dhe Kotokon në kryeqytet.[812] Ata mbërritën darkën e së enjtes më 15 nëntor

[805] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 89, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 9 nëntor 1928.
[806] "Një shkresë e Kryeministrisë mbi çështjen e Kishës Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 11, 13 nëntor 1928, 1.
[807] Zoi Xoxa "Rreth Kishës Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 12, 14 nëntor 1928, 1.
[808] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 85, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 12 nëntor 1928.
[809] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 88, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 12 nëntor 1928.
[810] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 97, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 13 nëntor 1928.
[811] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 92, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 14 nëntor 1928.
[812] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 95, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 14 nëntor 1928.

dhe takuan Kryeministrin, por u kthyen duarbosh në Korçë.[813] Ky takim u bë arsye që qeveria të hiqte dorë nga plani për të dorëzuar Joanidhin dhe Kotokon, edhe në qoftë se kjo nënkuptonte mënjanimin e Hirësi Jerotheut apo Hirësi Kristoforit. Paqartësia e krijuar kishte lënë shije të keqe. "Gazeta e Korçës" e quante "gangrenë" çështjen kishtare, duke u kërkuar episkopëve të hiqnin dorë nga mendësia e vjetër që mbronte tezën fanariote dhe të mendonin për mbarëvajtjen e Kishës, nga e cila mbaheshin dhe nderoheshin. Fletorja kanoste se shqiptarët dinin edhe mënyra të tjera për të kryer veprën, duke kujtuar se kishin krijuar kishë, priftërinj dhe episkopë nga asgjëja në të kaluarën.[814]

Të gjithë fajësonin të gjithë në tetor dhe nëntor. Ajo që mund të thuhet me siguri është se Joanidhi dhe Kotoko penguan zgjidhjen e çështjes kishtare. Ata paditën Hirësi Jerotheun si drejtues të një "dredhie kundërshqiptare" dhe bashkë me të edhe Hirësi Kristoforin. Letra që Hirësi Jerotheu kishte dërguar në Patriarkanë me zotimin se çështja do të zgjidhej sipas kërkesave të saj e bënte qeverinë shqiptare të sigurt se Mitropoliti i Korçës po punonte për dobinë greke. Megjithatë, shkaku nuk duhet të jetë ky. Hirësi Jerotheu dëshironte që në zgjidhjen e njëanshme të çështjes kishtare të mos kishte mallkimin e Patriarkanë siç do të ndodhte me pasardhësin e tij. Ai kërkonte të gjendej një zgjidhje sipas planit që kishte dorëzuar tri vite më parë në Athinë, nëpërmjet Pandeli Kotokos. Përvijimi i zgjidhjes sipas atij plani do të bënte që Kisha të arrinte autoqefalinë sipas dobisë kombëtare, e përbërë vetëm nga episkopë shqiptarë dhe me denjësi të paulur. Njëherazi, Greqia e rrjedhimisht Patriarkana nuk do ta kundërshtonte.

Shteti grek mund të mos sulmonte, nëse shihte zbatimin e një plani që i ishte paraqitur si më grekomani i mundshëm. Zbatimi nga dy drejtues kyç si Jerotheu dhe Kotoko mund ta zbusnin edhe më. Madje, Patriarkana Ekumenike mund të ishte e kujdesshme, teksa biri i dhembsur, Jerotheu, që e kishte siguruar se asgjë nuk do të bëhej në dëm të saj, u detyrua të ngrinte Sinodhin nga një "qeveri e huaj"; e megjithatë kishte "treguar nderim të plotë" ndaj dobisë greke në trupëzimin e Kishës. Kjo dallohet në kërkesën e parë që Hirësi Kristofori i dorëzon Kryeministrit Kota. Kundërshtimi i zgjidhjes me marrëveshje me Patriarkanën ishte i sigurt pas zhvillimeve të qershorit e gushtit. Mirëpo, shprehja e kundërshtimit u nevojitej kryepriftërinjve që t'i paraqitej Patriarkanës si një detyrim, të cilit nuk mund t'i shmangeshin. Kërkesa e dytë që të "detyroheshin" të plotësonin Sinodhin me anë të një vendimi qeveritar e vërteton edhe më tej këtë mendim. Aq më tepër, ata kërkonin shkrirjen e Këshillit të Lartë Kishtar dhe thirrjen e kongresit, sikurse ishte njëmendësuar në Tiranë në qershor. Kjo do të hiqte pengesën e fundit për zbatimin në detaj të planit të fshehtë Jerotheu-Kotoko të paraqitur në Athinë në janar 1925.

Përçarjet e brendshme e pamundësuan këtë plan. Vasil Joanidhi shihte te këto zhvillime tradhti kombëtare. Megjithatë, pranohet se Hirësi Kristofori dhe fanolisti Atë Vasil Marko merrnin pjesë heshtazi në to. Atdhetaria e dy burrave nuk vihej në dyshim. Në fund, Kryeministri Kota u detyrua të hiqte dorë nga plani për dorëzimin e grekomanit Pandeli Kotoko dhe Vasil Joanidhit në mes të nëntorit. Kjo tregon se ata ishin pengesa kryesore e trupëzimit të Kishës. Konsulli grek në Korçë rrëfen se Pandeli Kotoko vepronte gjithnjë nën udhëzimet e tij, Kotoko nuk e pranoi ndenjësen e Mitropolitit vetëm pas trysnisë që konsulli i kishte bërë. Prandaj, Kotoko kërkoi të shpërblehej në para nga

[813] "Përsëri vizitojnë Kryeqytetin Atë Markoja dhe Kandidatët Episkopë", *Zëri i Korçës* nr. 347, 20 nëntor 1928, 2.; "Çështja e rregullimit të Kishës Autoqefale Korçë", *Gazeta e Re* nr. 25, 30 nëntor 1928, 3.
[814] *Zëri i Korçës* nr. 346, 17 nëntor 1928, 2.

Greqia, çka përbente domosdoshmëri për konsullin. Sipas tij, vetëm kjo mbështetje ekonomike mund ta mbante të përzgjedhurin për episkop në anën e Athinës.[815]

Dështimi i planit nuk e la duarlidhur Kryeministrin Kota. Ai udhëzoi Prefekturën e Korçës të dërgonte një njeri të besuar në afërsi të Follorinës, aty ku kishte qendrën Mitropolit Joakimi. Ish-mitropoliti i Beratit kishte shprehur ethshëm dëshirën për të marrë pjesë në zgjidhjen e çështjes kishtare dhe ndaj u mendua për detyrën e Kryepiskopit. Njëherazi, emri i episkop Visarionit doli sërish në skenë, për të shmangur çfarëdolloj kushti të ri që mund të vendoste dyshja Jerotheu-Kisi. Xhuvani kishte qenë për disa kohë nën mbikëqyrje të rreptë policore, si dikush që mund të prishte baraspeshat në çështjen kishtare. Kryeministri Kota urdhëroi që Joakimi të pyetej nëse do të vinte të bashkëpunonte me Hirësi Visarionin për dorëzimin e dy episkopëve të tjerë që qeveria i kishte gati. Marrëveshja me Patriarkanën do të kërkohej vetëm pasi të krijohej Sinodhi e të hartohej statuti. Kota urdhëroi që Mitropoliti të nisej menjëherë për Tiranë, pa u lidhur me Jerotheun dhe Kisin.[816]

Joakimi i pranoi gjitha kushtet qeveritare më 22 nëntor dhe u shpreh i gatshëm të nisej për në Atdhe. Ai kërkoi një hua prej 400 napolonash me afat shpagimi dyvjeçar, me qëllim larjen e borxheve dhe blerjen e petkave të reja. Joakimi njoftonte se do të shkonte në Athinë të jepte dorëheqjen përpara se të vinte në Shqipëri.[817] Hirësia nënshkroi në librin e shënimeve të të dërguarit shqiptar, drejtorit të "Gazetës së Korçës" Zhanka Gurguzi, ndërkohë që shpallja u dorëzua veçmas me shkrim dore, për siguri.

Mitropoliti pranonte tërësisht mendimin qeveritar: Kisha do të trupëzohej siç e lypte dobia e Atdheut, pra në baza kombëtare. Joakimi paralajmëronte se shteti nuk do të kishte të drejtë të ndërhynte vetëm në çështjet dogmatike, teksa Kisha ishte nën mbrojtjen atërore të qeverisë në çështje të tjera. Ai shprehej se do të merrej vesh për detajet me të shkuar në Shqipëri, porse pranonte të dorëzonte cilindo qeveria dëshironte. Kongresi do të mblidhej pas dorëzimeve dhe do të shpallte dëshirën e popullit në dobi të atdhetarisë. Joakimi arsyetonte se huaja ishte e domosdoshme, pasi nuk ishte i lirë të udhëtonte, duke qenë në borxhe. Ai nuk i njihte askujt të drejtën ta ndalonte për të shkuar në Atdhe, pasi të shlyente huatë dhe të jepte dorëheqjen, që nuk mund t'i mohohej. Hirësia kujtonte se kishte mbetur pa petka dhe në borxhe që prej vitit 1913, kur haxhiqamilistët kishin grabitur Mitropolinë e Beratit. Joakimi fuqizonte arsyetimin se Kisha ishte autoqefale prej pavarësisë së vendit.[818]

Qeveria shqiptare nisi të nesërmen Zhanka Gurguzin me shumën e kërkuar, me kusht që të hollat t'i jepeshin Joakimit, vetëm nëse nisej në atë çast. Dorëheqja mund të jepej nga Shqipëria, ndaj moskthimi së bashku me të dërguarin do të shihej si mospranim i kërkesave qeveritare.[819] Qeveria shqyrtoi ngërçet e mundshme për t'u dalë para të papriturave: prefekti grek mund të mohonte pasaportën e Joakimit, me arsyetimin se nuk ishte marrë paraprakisht leja e Sinodhit të Kishës së Greqisë, nëse ai nisej pa dhënë dorëheqjen.[820] Prandaj, i dërguari Gurguzi u pajis me një pasaportë shqiptare. Ai u udhëzua që Joakimi të shfaqte nevoja të ngutshme familjare ose çështje me ndonjë

[815] Kondis, *Elinizmos III*, 403: IDAYE, D. A/22/1β, nr. 3731, Konsullata Korçë drejt. MPJG, 27 mars 1929.
[816] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 102, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 20 nëntor 1928.
[817] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 105, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 22 nëntor 1928.
[818] AQSH, Shkresa e Mitropolitit Joakim, 21 nëntor 1928, cit.
[819] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 109, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 23 nëntor 1928.
[820] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 110, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 23 nëntor 1928.

kushëri në Korçë, prej nga kishte prejardhjen. Joakimi duhet të nisej me pashaportën shqiptare nga Follorina ose Manastiri, nëse zyrtarët kufitarë nuk e lejonin të kalonte me pashaportë greke.[821] Qeveria caktoi 9 dhjetorin si afat të fundit për ardhjen e Hirësisë.[822]

Zhanka Gurguzi dhe Mitropoliti u nisën nga Follorina për në Korçë, më 7 dhjetor. Mirëpo, xhandarmëria greke nuk i lejoi të kalonin kufirin, bashkë me 27 kasa dhe 6 valixhe me sende vetjake. Hirësia u nis për në Selanik i pezmatuar. Ai i tha Mitropolitit të atyshëm se do të shkonte në Athinë për të dhënë dorëheqjen me qëllim rikthimin në Shqipëri.[823] Dëshira e Joakimit për të shkuar në Korçë nuk mund të vendosej më në pikëpyetje. Hirësia shprehte synimin e patundur për t'u kthyer në Atdhe, në një letër të fshehtë që i dërgonte një kushëriri në Korçë.[824] Ministria e Jashtme e udhëzoi më 8 dhjetor, të gjente një arsye dhe të shkonte në Korfuz, ku do të hypte në një varkë italiane dhe do të lundronte për në Sarandë.[825]

Ndërkaq, qeveria ishte kujdesur të mos përfshinte sërish Hirësi Jerotheun në planet e saj. Ajo ishte bindur prej fjalëve të Joanidhit dhe zotimit që Mitropoliti i kishte bërë Patriarkut se Jerotheu ishte penguesi i vërtetë i zhvillimeve kishtare. Prandaj, qeveria ishte kufizuar në një zgjidhje që përmbante vetëm Kisin, Xhuvanin dhe Kryepiskopin e përzgjedhur Joakim Martishtin. Hirësi Jerotheu vijonte të kryente detyrat kishtare në Korçë. Madje, ai mbajti fjalimin e përvitshëm atdhetar në përvjetorin e 16-të të pavarësisë, veçse këtë herë me kumbim më të fuqishëm kombëtar.[826]

Mitropoliti do të do të ndiqte nga larg botimet mbi përvijimin drejt zgjidhjes së çështjes kishtare, nëpërmjet vizitave të Xhuvanit dhe Kisit në pallatin mbretëror. Hirësi Visarioni kishte qenë i prituri i parë, në fundnëntor. Mbreti shpalosi qëllimin e patundur për zgjidhjen e çështjes dhe kërkoi zotimin e Xhuvanit. Takimi zgjati një orë, kohë e gjatë për takimet e Mbretit. Hirësi Visarioni u kursye në përgjigje pasi doli nga mbledhja, por siguroi se çështja ishte drejt fundit, në mbështetje të pikëpamjes kombëtare dhe kanonike. Ai i tha shtypit se shpirti i ortodoksisë do të lulëzojë si meriton për të mirën e Atdheut.[827]

Hirësi Kristofor u paraqit para Mbretit më 29 nëntor dhe u njoftua mbi qëllimin e thirrjes së Joakimit në Shqipëri. Kisi pranoi të merrte pjesë në këtë trajtë-zgjidhje.[828]

Hirësi Jerotheu nuk qëndroi pa vepruar. Ai ftoi kryebashkiakun Vasil Avrami në Mitropolinë e Korçës, më 10 dhjetor. Jerotheu shprehu dëshirën për të marrë pjesë në zgjidhjen e çështjes kishtare, duke i shërbyer dobisë kombëtare. Ai iu lut Avramit të ndërmjetësonte në mënyrë që të shkonte në Tiranë dhe t'ia sqaronte gojarisht Kryeministrit Kota qëllimin e tij. Mitropoliti la të kuptohej se nuk këmbëngulte më në ndërmjetësinë e Patriarkanës dhe pranonte zgjidhje të njëanshme.[829] Lëvizjet në Tiranë ishin më të shpejta. Hirësi Visarioni kishte takuar sërish Mbretin, më 14 dhjetor. Ai

[821] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 111, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 24 nëntor 1928.
[822] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 121, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 29 nëntor 1928.
[823] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 127, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 7 dhjetor 1928.
[824] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 141, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 10 dhjetor 1928.
[825] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 114, MPJ drejtuar Konsullatës së Selanikut, 8 dhjetor 1928.
[826] *Zëri i Korçës* nr. 350, 1 dhjetor 1928, 4.
[827] "Hirësi e Tij Visarion Xhuvani në Pallat", *Zëri i Korçës* nr. 350, 1 dhjetor 1928, 2.
[828] "Imzot Kisi përsëri në Tiranë", *Zëri i Korçës* nr. 350, 1 dhjetor 1928, 2.; AQSH, F. 152 "MPB", D. 119/2, f. 5, Mitropolit Kristofori drejtuar Kotës etj., 15 mars 1929.
[829] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 136, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 11 dhjetor 1928.

shprehu bindjen se rregullimi i kishës do të përfundonte përpara vitit të ri.[830] Prefekti Jella e takoi Hirësi Jerotheun për t'i kthyer përgjigjen zyrtare, më 17 dhjetor. Ai njoftoi se qeveria ishte e gatshme ta pranonte zotimin e fundit të Mitropolitit për bashkëpunim në baza kombëtare.[831]

Hirësi Jerotheu do t'i mësonte kushtet e reja qeveritare vetëm më 28 dhjetor. Prefekti e lajmëroi se çështja kishtare do të zgjidhej sipas Kongresit të Beratit me anëtarë të Sinodhit, Hirësitë Joakim, Kristofor, Visarion dhe Jerothe. Tre episkopët e tjerë i kishin pranuar kushtet dhe pritej vetëm ardhja e Joakimit për përvijimin e zgjidhjes. Kisi dhe Xhuvani do të dorëzonin episkopët e tjerë, nëse Joakimi nuk arrinte të vinte.[832] Hirësi Jerotheu u tregua i drejtpërdrejtë këtë herë. Ai do të pranonte zgjidhjen me Hirësi Joakimin, mirëpo nuk ishte i gatshëm të vijonte nëse do të mbetej vetëm Hirësi Kristofori dhe "i quajturi Xhuvan". Jerotheu u shpreh ushtar i Kishës dhe shërbëtor i Atdheut, por vlerësonte se Kisha nuk mund të mbante një vend të lartë nderi siç do të dëshironte Mbreti, vetëm me Kisin dhe Xhuvanin.[833]

Ndaj, ardhja e Mitropolitit Joakim nënkuptonte një Sinodh të përbërë prej katër episkopësh me përvojë të gjatë, çka do të rriste denjësinë e Kishës. Mosardhja e tij nuk përbënte pengesë në planin qeveritar, veçse përbërja e Sinodhit do të kufizohej me episkopët Kristofor dhe Visarion dhe dy episkopë që do të dorëzoheshin prej tyre. Qeveria shqiptare e ndiqte dhe e ndihmonte Hirësi Joakimin në çdo veprim. Ajo udhëzoi Legatën në Athinë më 18 dhjetor ta lehtësonte në veprimet që duhet të kryente në kryeqytetin grek dhe t'i plotësonte çdo kërkesë që mund të parashtronte.[834]

Hirësi Joakimi njoftoi në funddhjetor se asgjë nuk kishte ndryshuar, në planin për të ardhur në Shqipëri. Ai do të jepte dorëheqjen dhe pas saj nuk shihte asnjë frikë për pengesa të tjera të qeverisë greke.[835] Kryeministri Kota urdhëroi të ngarkuarin me punë të Shqipërisë, Lec Kurti, të maste pulsin e drejtuesve shtetërorë grekë.[836] Kurti takoi drejtorin politik të Ministrisë së Jashtme, i cili i tha se asnjë episkop nuk mund të lëvizte pa lejen e Sinodhit dhe për këtë arsye do t'i drejtohej Kryepiskopit të Athinës.[837]

Legata Shqiptare u lajmërua në fillim të janarit se Sinodhi nuk kishte marrë kërkesë nga Hirësi Joakimi për lejen e domosdoshme për të shkuar në Shqipëri.[838] Kryeministri Kota njoftoi Mitropolitin më 14 janar se bashkëbisedimi do të vijonte vetëm nëse ai dorëzonte kërkesën në Sinodhin e Shenjtë të Kishës Greke.[839]

Ky ishte bashkëbisedimi i fundit mes tyre. Qeveria shqiptare e quajti zvarritje të qëllimshme mospërgjigjen ndaj shkresës së 14 janarit. Qëndrimi i Hirësi Joakimit dëfton se ai ndodhej nën një trysni të fortë. Synimi për të ardhur në Shqipëri ishte i pamohueshëm, teksa ai ishte përpjekur të kalonte kufirin nëpërmjet Follorinës dhe kishte

[830] "Rreth zhvillimeve mbi çështjen e Autoqefalisë së Kishës", *Zëri i Korçës* nr. 354, 15 dhjetor 1928, 2.
[831] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 135, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 17 dhjetor 1928.
[832] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 143, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 28 dhjetor 1928.
[833] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 148, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 30 dhjetor 1928. Hirësi Jerotheu shkruante pak muaj më vonë se kishte pohuar pjesëmarrjen e tij në Sinodh vetëm nëse Joakimi vinte si ekzark (Glavina, *Dokumente 1929*, 47) Mirëpo, kjo nuk njoftohet nga Jella dhe për më tepër, bashkëbisedimi me Vasil Avramin tregon se Hirësi Jerotheu nuk kërkonte më miratimin patriarkal.
[834] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 112, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, 18 dhjetor 1928.
[835] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 112, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 29 dhjetor 1928.
[836] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 113, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, 24 dhjetor 1928.
[837] AMPJ, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 29 dhjetor 1928, cit.
[838] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 113, Legata e Athinës drejtuar MPJ, 5 janar 1928.
[839] AMPJ, V. 1928, D. 333, f. 114, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, 14 janar 1928.

lajmëruar të afërmit e tij në Korçë për këtë "qëllim të patundur". Shkuarja në Athinë ndryshoi gjithçka. Lec Kurti kishte pyetur zyrtarisht drejtorin politik të Ministrisë së Jashtme, pas kërkesës së Kryeministrit Kota që të "maste pulsin". Shfaqja e përkujdesjes zyrtare të Shqipërisë duhet të ketë vendosur në veprim Greqinë. Pjesëmarrja e Hirësi Joakimit në zgjidhjen ë njëanshme të çështjes kishtare bëhej i vetëkuptueshëm, nëse largimi i tij kryhej me përkujdesjen e shtetit shqiptar. Ky zbulim mund të ketë çelur rrugën e trysnisë ndaj Mitropolitit, ndërkohë që asnjë gjë nuk ishte e vërtetuar deri atëherë. Joakimi i kishte kërkuar qeverisë t'i siguronte mbështetje dhe ndihmë gjatë qëndrimit në Athinë, nëpërmjet të dërguarit Zhanka Gurguzi. Mirëpo, qeveria shqiptare duket se e vendosi në gjendje të palakmueshme, aq sa dorëheqja përpara Sinodhit nuk do të pranohej. Qeveria humbi të paracaktuarin si Kryepiskop, por njëkohësisht humbi edhe Hirësi Jerotheun që e kishte lidhur qenien e tij në Sinodh me qenien Joakimit. Kështu, Sinodhi Joakim-Kristofor-Visarion-Jerotheu u shkërmoq brenda një muaji.

Shteti grek ishte në ballë të betejës për të kundërshtuar autoqefalinë në rrugë të njëanshme. Ministri i ri grek në kryeqytetin shqiptar, Leon Melas, "s'linte mjet pa përdorur, duke ushtruar tërë ndikimin e tij moral e material pranë ortodoksëve shqiptarë". Ai shpalli në një takim se zgjidhja kryengritëse e çështjes kishtare do të bënte që Greqia të mos dëmshpërblinte pronat që u kishte përvetësuar shqiptarëve. Ato ishin mijëra hektarë, në pronësinë e shqiptarëve të Çamërisë dhe bejlerëve të shumtë korçarë dhe beratas sidomos në Prevezë, Trikallë dhe Janinë. Kryeministri Koço Kota miratoi kërkesën e mikut të tij, Zoi Xoxa, që t'i përgjigjej kanosjes së hapur greke. "Gazeta e Re" ndiqej me vëmendje nga ata që dëshironin të dinin mendimin e qeverisë për shkak të ndikimit që Koço Kota kishte në të. Kryeshkrimi "Sovraniteti i Shtetit nuk cënohet" u botua më 10 janar.[840]

Xoxa shkruante se shqiptarët kishin fituar ndërgjegje shumë të lartë kombëtare, çka ambasadori grek duhet ta kuptonte më mirë se bashkatdhetarët e tij që i shihnin punët për së largu. Ai vlerësonte Mbretin si meritues të kurorës së Skënderbeut, pikërisht prej ruajtjes së patrembur dhe të patundur të të drejtave kombëtare. Moskuptimi i rrethanave të reja nga Melasi vendoste në dyshim përfaqësimin diplomatik të vendit të tij në Shqipëri, sipas Xoxës. Shkruesi shënonte se autoqefalia nuk kishte thjesht kuptim fetar për shtetin shqiptar, por edhe kombëtar dhe ishte e rrënjosur në shpirtrat e shqiptarëve, ndaj ndërhyrja e të huajve ishte e papranueshme. Ai theksonte se çështja e pronave të bashkatdhetarëve në Greqi kishte një rëndësi të veçantë, pasi ishin kryer disa padrejtësi ndaj shqiptarëve. Prandaj, qeveria e Tiranës do të kërkonte zhdëmtim sipas ligjit grek, pa ndërhyrë në punët e brendshme të Greqisë. Mirëpo, kjo çështje nuk mund të përdorej si kërcënim. Xoxa shkruante se shteti shqiptar nuk flijonte të drejtat dhe sovranitetin për disa pasuri, qofshin me aq rëndësi sa pasuritë shqiptare në Greqi. Ai përfundonte se edhe familjet shqiptare të dëmtuara nga përvetësimi i padrejtë i tokave nga Greqia bashkoheshin me kuptimin e lartë dhe atdhetar që shprehte shkrimi.[841]

Trysnia greke solli edhe dorëheqjen e ministrit të Jashtëm, Iljaz Vrionit. Ai kërkonte një përafrim më të madh me Greqinë, ndryshe nga Kryeministri Kota, i cili

[840] Zoi Xoxa, *Kujtimet e një gazetari*, 121.

[841] Një patriot, "Sovraniteti i Shtetit nuk cënohet!", *Gazeta e Re* nr. 57, 10 janar 1929, 1. Xoxa pranon se shkrimi është shkruar prej tij në *Kujtimet e një gazetari*, 122; edhe pse në "Gazeta e Re" është nënshkruar thjesht "një patriot".

dëshironte t'i jepte fund kombëtar çështjes kishtare, e më pas të përvijohej përafrimi shqiptarogrek.[842]

Patundshmëria e Kotës në vendimin për të krijuar Sinodhin njëanshmërisht solli në krye të saj, emrin e katërt të lakuar në më pak se katër muaj. Radha i kishte ardhur Hirësi Kristofor Kisit, pas Evlogji Kurillës, Jerotheut dhe Joakimit. Mitropoliti i Beratit u thirr përpara Mbretit më 20 janar, kur u pa se Joakimi nuk do të vinte në Shqipëri. Hirësia pranoi se çështja kishtare duhet të zgjidhej në rrugë të brendshme dhe Sinodhi duhet të krijohej sa më shpejt me klerikë që gjendeshin në Shqipëri, ishin të njohur për ndjenjat kombëtare dhe gëzonin pëlqimin e qeverisë. Kristofori i kërkoi Zogut lejen për të hartuar një Statut Kishtar, që do të miratohej nga Këshilli i Ministrave. Miratimi qeveritar do të pasohej nga krijimi i Sinodhit, që do ta kalonte për pranimin përfundimtar nga Kuvendi dhe Kongresi Kishtar. Kisi mendonte se kjo ishte një rrugë e pashmangshme, për të tejkaluar qorrsokakun ku ishte Kisha.[843]

Mbreti e pranoi kërkesën dhe i dha një afat njëjavor. Hirësi Kristofori i dorëzoi Kryeministrit skicën fillestare më 25 janar. Koço Kota nuk kundërshtoi asnjë pikë. Mirëpo, Mbreti i dorëzoi një kundërskicë, të ndryshuar në disa nene, tri ditë më vonë. Kisi e shqyrtoi dhe i vlerësoi të arsyeshme shumë pika të ndryshimeve qeveritare. Ndaj, ai i paraqiti Mbretit skicën përfundimtare në fundjanar. Palët nuk njëmendësoheshin vetëm në gjashtë pika. Nenet që qeveria tëhuante kishin të bënin me episkopët, pasuritë e kishave, trajtimin ligjor të Kryepiskopit dhe çështjen e ndërrimit të fesë. Neni i parë fliste për Sinodhin e Shenjtë. Hirësi Kristofori përcaktonte në skicën e tij se Sinodhi përbëhej nga Kryepiskopi dhe mitropolitët. Ai gjykonte se kjo siguronte zbatimin e nenit II të Statutit të Beratit që caktonte se Sinodhi përbëhej vetëm prej episkopëve. Qeveria sugjeronte të shtohej si anëtar edhe kryeserketari. Ky vend ishte ruajtur për kryetarin e deriatëhershëm të Këshillit të Lartë Kishtar, Atë Vasil Marko.[844]

Dy nenet e tjera kishin të bënin me episkopët. Hirësi Kristofori sugjeronte që episkopët duhet të kishin cilësitë e duhura prej kanoneve kishtare, të ishin prej gjuhe dhe nënshtetësie shqiptarë dhe të zotëronin diplomë teologjike ose një degë tjetër universitare. Po ashtu, ai shënonte se episkopët zgjidheshin prej Sinodhit me shumicë votash. Qeveria shtonte një kryeradhë që përcaktonte se një Arkimandrit në shërbim të Kishës Autoqefale do të dorëzohej vetëm për atë herë, duke qenë se Arkimandrit Vangjel Çamçe nuk kishte diplomë. Ndërkaq, qeveria shtonte se kryepriftërinjtë duhet të pëlqeheshin dhe dekretoheshin prej Mbretit. Sinodhi do të zgjidhte një episkop tjetër, në rast se qeveria nuk pëlqente të votuarin e parë. Kisi sugjeronte të përcaktohej se pasuritë e kishave dhe manastireve nuk mund të shpronësoheshin, ndërsa qeveria sugjeronte të përcaktohej se këto pasuri siguroheshin sipas ligjeve të shtetit. Dy nenet e fundit që kundërshtoheshin nga skica e Hirësi Kristoforit përcaktonin se Kryepiskopi i Shqipërisë gjykohej si ministrat e Shtetit dhe se kush donte të ndryshonte fenë duhet t'ia shfaqte dëshirën Mitropolitit, sipas traditës së deriatëhershme.[845]

Bisedimet e Kisit dhe Kryeministrit përfunduan me heqjen e këtyre dy neneve, ndërsa neni katër mbi pasurinë e kishave u pranua sipas përcaktimit të Hirësi Kristoforit.

---

[842] Xoxa kujton se ministri i Jashtëm, Iljaz Vrioni, e thirri të nesërmen për ta qortuar. Ministri kuptoi gjatë bisedës se Xoxa ishte udhëzuar nga Koço Kota dhe vendosi të dorëhiqej. Xoxa, *Kujtimet*, 123-125.
[843] AQSH, Mitropolit Kristofori drejtuar Kotës etj., 15 mars 1929, cit.
[844] Po aty.
[845] Po aty.

Palët u njëmendësuan që neni tre të mbeste vetëm fjalia e parë e skicës qeveritare, pra që episkopët zgjidheshin prej Sinodhit dhe pëlqeheshin e dekretoheshin prej Mbretit. Biseda u përqendrua në nenin e parë dhe të dytë në dy takime të zhvilluara në fundjanar dhe fillimshkurt. Zyrtarët e Kryeministrisë ia prenë shkurt Mitropolitit Kristofor në takimin e fundit, duke i kërkuar të punonte me statutin qeveritar ose të hiqte dorë nga përpjekjet.[846]

Gjithçka rrotullohej rreth një emri, sipas Hirësi Kristoforit. Ai pranoi tre njerëzit që duhet të përbënin Sinodhin, të cilët u pëlqyen prej qeverisë. Ata ishin Hirësi Visarioni, Arkimandrit Vangjel Çamçja dhe Atë Efthim Hoshteva.[847] Kisi njoftonte Atë Josif Qiricin pak ditë më vonë se ngërçi i mbetur ishte Atë Vasil Marko, të cilin qeveria e kishte paracaktuar si anëtar në Sinodh, pavarësisht pse nuk ishte kryeprift. Hirësi Kristofori e vlerësonte në kundërshtim me nenin II të Statutit të Beratit, që paracaktonte se Sinodhi përbëhej vetëm prej episkopëve. Ai shprehej se nuk kishte kundërshti me Atë Vasilin, por mbante një qëndrimi parimor. Mitropoliti sugjeroi një zgjidhje të ndërmjetme: mbledhjen e një kongresi brenda javës, që do të ndryshonte këtë nen të Statutit dhe rrjedhimisht veprimet e mëtejshme do të përputheshin me vendimet e Kongresit të Beratit.[848]

Qeveria pa te kjo ide një përpjekje të re për të zvarritur çështjen. Ajo kishte vendosur që kongresi të mblidhej pasi të ishin dorëzuar episkopët, në mënyrë që të merrej vetëm me miratimin e Sinodhit dhe Statutit. Bisedat bënë që i paracaktuari për Kryepiskop, Hirësi Kristofori, të gjendej befas i dëbuar në Manastirin e Ardenicës. Ai mohoi prerazi pandehjen se ishte përpjekur ta mbante çështjen varur. Kisi u dërgoi një letër të gjithë drejtuesve të lartë të shtetit në mars 1929. Ai theksoi se episkopët nuk mund të donin vazhdimin e një gjendjeje që ulte denjësinë e tyre dhe krijonte përçarje. Ai fajësonte paditësit e tij për dashakeqësi për të mbuluar të vërtetën ose padije të thellë në punët kishtare. Kisi bënte përgjegjës Këshillin e Lartë, teksa vetëm ai mund të zgjidhte episkopë për mitropolitë e paplotësuara, sipas Statutit të Beratit. Mitropolitët veçse i dorëzonin në kryepriftërinj. Hirësi Kristofori sfidonte drejtuesit e shtetit të thoshin nëse Këshilli kishte emëruar ndonjë episkop dhe dy mitropolitët nuk kishin pranuar ta dorëzonin. Ai u kujtonte se ishte orvatur të mblidhte një kongres për t'i dhënë fund çështjes në rrugë kombëtare, në prill 1926, përpara mbërritjes së Hirësi Krisanthosit. Mirëpo, diçka e tillë nuk ishte pranuar nga Pleqësia Kishtare e Korçës.[849] Për më tepër, ai shpaloste arsyet se pse kishte përfunduar në Ardenicë. Kisi fajësonte dredhitë në prapaskenë për mosarritjen e marrëveshjes mes tij dhe qeverisë.[850]

Dredhitë kishin të bënin me dy drejtues kishtarë, dikur armiqësorë në lëvizjen kishtare: Hirësi Visarionin dhe Atë Vasil Markon. I fundit kishte qenë drejtues i Kishës prej Kongresit të Beratit. Ai ishte një zgjidhje baraspeshe dhe u mbështet pa asnjë kusht nga Zogu, kur Fan Noli u dëbua nga Shqipëria në fundvitin 1924. Marko ishte sugjeruar për anëtar Sinodhi, edhe gjatë bisedimeve me Hirësi Krisanthosin, për të vlerësuar shërbimin në krye të lëvizjes kishtare. Mirëpo, Krisanthos nuk kishte pranuar. Fati e

[846] Po aty.
[847] Thanas Ambrozi thëritet me ngutshmëri për në Tiranë, vetëm ditët e fundit. Kisi rrëfen se kundërshtimi mbeti vetëm në një emër dhe përmend nevojën e ndryshimit të Statutit të Beratit, që përjashtonte joepiskopët si anëtarë të Sinodhit. Kjo na bën të kuptojmë se ai u njëmendësua për emirn e Hirësi Agathangjelit, duke u përqëndruar vetëm në emrin e Atë Vasil Markos.
[848] AQSH, F. 152 "MPB", D. 119/2, Mitropolit Kristofori drejtuar Atë Josif Qiricit, 28 mars 1929.
[849] AQSH, Mitropolit Kristofori drejtuar Kotës, etj., 15 mars 1929, cit.
[850] AQSH, Mitropolit Kristofori drejtuar Atë Josif Qiricit, 28 mars 1929, cit.

donte që shpërblimi për mundin e dhënë të kryhej në një Sinodh me kryetar armikun e kahershëm, atë që Kryesia e Kishës e përndiqte vazhdimisht duke e cilësuar kundërkanonik: Hirësi Visarionin. Xhuvani kishte qenë nën vërejtjen policore vetëm pak muaj më parë për të mos meshuar si episkop. Më pas, ai u thirr si i përzgjedhuri për një nga mitropolitë e vendit, kur u pa se Joanidhi dhe Kotoko nuk dëshironin më të merrnin pjesë në zgjidhjen e çështjes kishtare. Ndenjësja e Mitropolitit u sigurua në më pak se një muaj, kur edhe drejtimi prej Joakimit dështoi. Ditët e para të vitit 1929 do t'i jepnin dy lajme kundërthënëse. Ai mësoi se babai ndërroi jetë në fillimjanar.[851] Ndërkaq, u njoftua në më pak se një muaj se ishte shndërruar nga i papëlqyeri në zgjidhjen e vetme për t'u bërë Kryepiskopi i parë i Shqipërisë.

4.2.Trupëzimi i Kishës dhe fronëzimi i episkopëve

Hirësi Visarioni nuk mund të dorëzonte episkopë të tjerë i vetëm. E drejta kishtare përcaktonte se nevojiteshin së paku dy kryepriftërinj për këtë detyrë. Mbreti Zogu I e thirri edhe një herë në Pallatin Mbretëror në fillim të shkurtit. Takimi u bë në praninë e Kryeministrit Koço Kota, Kryekuvendarit Pandeli Evangjeli, ministrit Hiqmet Delvina dhe kreut të Kishës Atë Vasil Marko.[852] Mbreti njoftoi se Kristofor Kisi nuk do të ishte pjesë e zgjidhjes; një zhvillim i kryer edhe nëpërmjet fjalëve që Hirësi Visarioni ishte kujdesur të shkonin në vesh të Zogut se kinse Mitropoliti i Beratit dëshironte të zvarriste trupëzimin e Kishës.

Visarion Xhuvani u shpreh i gatshëm të merrte përsipër zgjidhjen përfundimtare. Ai i kërkoi Mbretit liri të plotë veprimi, duke i sqaruar se do të shkonte në Jugosllavi, prej nga do të vinte doemos me një episkop tjetër. Mbreti dha *carta bianca* pas udhëzimit të Kryeministrit. Zoi Xoxa kujton se Zogu edhe Kota i njihnin të metat e Xhuvanit dhe pa dyshim do të parapëlqenin një njeri me moral të lartë, intelekt dhe atdhedashuri të pamohueshme si Hirësi Kristofori. Mirëpo, Visarioni ishte zgjidhja e vetme në kushtet e reja. Aq më tepër, ai vlerësohej se i merrte përsipër dhe i çonte detyrat deri në fund, pa u tutur nga të papriturat.[853]

Atë Vasil Marko, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar, e emëroi zyrtarisht Visarion Xhuvanin Mitropolit të Durrës-Tiranës, sipas përcaktimeve të Statutit të Beratit.[854] Vendimi i ngarkoi detyrën për të shkuar në Beograd dhe për t'i dhënë fund çështjes kishtare.[855] Qeveria urdhëroi shtypin të mos shkruante asgjë rreth çështjes, për të mos minuar përpjekjen e radhës, pas dështimit të tri ndërthurjeve të mëparshme.[856] Xhuvani u nis më 3 shkurt. Ai takoi Patriarkun Dhimitër dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Jashtme Jugosllave, me të cilët mbante përherë lidhje. Bisedat e kryera nuk mbijetuan

[851] *Zëri i Korçës* nr. 361, 8 janar 1929, 4.
[852] Shih edhe Fatmira Rama, "Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i Dytë Panortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare", *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare* (Tiranë: Instituti i Historisë, 1993), 60-67.
[853] Xoxa, *Kujtimet*, 126.
[854] "Çështja e Kishës Autoqefale u-zgjith: Arqimandrit Çamçeja u-dorëzua episkop", *Gazeta e Re* nr. 85, 12 shkurt 1929, 1.
[855] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Vendim i Këshillit të Lartë Kishtar, 3 shkurt 1929.
[856] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar të gjitha prefekturave, 2 shkurt 1929.

të shkruara, porse ai u kthye në Atdhe në më pak se një javë, nëpërmjet pikëkalimit të Muriqanit, me mbështetjen e zyrtarëve jugosllavë.[857]

Ai mbërriti vetëm, ndryshe nga sa kishte premtuar. Hirësia solli një leje, të mjaftueshme për t'i kryer detyrat pa nevojën e një episkopi që gjendej jashtë vendit. Ai hyri në Shkodër dhe rendi të takonte mikun e vjetër, Hirësi Viktorin, që prej shtatë vitesh qëndronte në qytet, pas ndërhyrjes së atëhershme të Visarionit. Hirësi Visarioni i paraqiti Viktorit kërkesën që të dorëzonin tre anëtarë të tjerë për të krijuar Sinodhin. Kjo nënkuptonte se Kisha e Shqipërisë do të kishte katër episkopë shqiptarë, pa domosdoshmërinë që të përfshihej edhe Hirësi Viktori në të. Episkopi serb do të shpërblehej duke qëndruar në Shkodër si ndihmës i Kryepiskopit dhe do të shihej mundësia e zgjerimit të Sinodhit të Shenjtë në një të ardhme. Dy kryepriftërinjtë morën rrugën për në Tiranë me këtë marrëveshje.[858]

Koço Kota ishte në zyrën e tij në Kryeministri, kur mori vesh se Hirësi Visarioni ia kishte dalë. Ai telefonoi drejtorin e së përditshmes më të madhe, Zoi Xoxa, dhe i kërkoi ta shoqëronte në kishë.[859]

Hirësitë kishin thirrur Atë Vasil Markon dhe parinë e Kishës, të cilët zgjodhën Arkimandrit Vangjel Çamçen si Episkop, me emrin Agathangjel. Mesha e dorëzimit nisi në Kishën e Kryeqytetit, të nesërmen, në orën 10 paradite, me pjesëmarrjen e Kryeministrit, ministrit Delvina, deputetëve, përfaqësuesit të Mbretit, Kolonel Sereqit, dhe teprisë së besimtarëve.[860]

Hirësi Visarioni dhe Hirësi Viktori ishin veshur me petkat madhështore, të ulur në dy frone në mes të Kishës, fare pranë Arkimandrit Çamçes. Xhuvani foli për vullnetin e Mbretit dhe qeverisë për zgjidhjen e çështjes kishtare ashtu siç i ka hije një kombi fisnik dhe të pavarur. Ai vlerësoi betejën e gjallë dhe atdhetare të Kryeministrit, si dhe përballjen e Atë Vasil Markos me dredhitë greke. Kryepsikopi i përzgjedhur u lut për Mbretin, Kombin dhe Kishën. Hirësi Agathangjeli nisi fjalimin duke përkujtuar krijimin e Kishës Autoqefale në Amerikë. Ai vlerësoi vullnetin e Mbretit dhe Kryeministrit dhe u zotua se do të përpiqej të plotësonte detyrat me të cilat u ngarkua. Lajmin e përhapi Zoi Xoxa nëpërmjet "Gazetës së Re", ku shënonte me lëvdata se pavarësia e Kishës iu shtua Kurorës së Mbretërisë Shqiptare si një margaritar i bekuar.[861]

Hirësitë Visari, Viktori dhe Agathangjeli drejtuan meshën e dorëzimit episkop të një tjetër prifti kombëtar, Atë Efthim Konomit, i cili mori emrin Eugjen, të nesërmen, 13 shkurt.[862]

Atë Efthimi kishte lindur më 1870 në fshatin Hoshtevë të Gjirokastrës, ku kishte shërbyer si mësues përpara se të shkollohej për teologji në Athinë. Ai u dorëzua prift në Kavallë dhe u kthye në Atdhe i emëruar fillimisht në Mitropolinë e Korçës e më pas në atë të Durrësit, ku u shqua për kombëtari.[863]

Dorëzimi u krye në praninë e Kryeministrit Kota dhe përfaqësuesve diplomatikë. Atë Vasil Marko përshëndeti veçanërisht përfaqësuesin jugosllav. Ai e vlerësoi Kishën

[857] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura e Shkodrës drejtuar MPB, 13 shkurt.
[858] Xoxa, *Kujtimet*, 126-127.
[859] Po aty.
[860] "Çështja e Kishës Autoqefale...", 1.
[861] Po aty.
[862] "Dje u konsakrua episkop dhe Atë Efthim Hoshteva", *Gazeta e Re* nr. 86, 13 shkurt 1929, 1.
[863] Alqi Jani, "Të njohim dhe nderojmë klerikët e Kishës Ortodokse të Shqipërisë: Episkopi Eugjen Hoshteva", *Republika* nr. 123, 27 maj 2009, 14-15.

Serbe si të vetmen që u soll më shumë se simotër, porsi një nënë kundrejt Kishës Shqiptare. Urata theksoi se ndihma ishte shpirtërore,[864] duke nënkuptuar se Hirësi Viktori punonte në emër të Kishës Serbe dhe nuk do të ishte pjesë e Kishës Shqiptare.

"Gazeta e Re" e shtjellonte zhvillimin si një zgjidhje atdhetare, që u kundërshtua nga ish-mitropolitët e Korçës dhe Beratit. Shkrimi nuk linte pa lëvduar tërthorazi punën e Mitropolit Theofan Nolit. Xoxa shkruante se Kisha lindi në Amerikë, kur pavarësia e vendit nuk ishte siguruar, prej idealit atdhetar që solli edhe zhvillimet e atyre ditëve, pavarësisht pse nisma ishte cilësuar atëherë e guximshme dhe krejt heretike.[865] Ai përshkruante ndodhitë e së kaluarës dhe përpjekjen e Patriarkanës për krijimin e një shteti brenda shtetit. Xoxa arsyetonte domosdoshmërinë e veprës së kryer nëpërmjet Hirësi Visarionit. Ai sqaronte se ideali i atdhetarëve u plotësua dhe Sinodhi do të krijohej së shpejti, duke i dhënë KOASH-it mundësinë të ecte me hapa viganë drejt rrënjosjes së atdhetarizmit. Hirësi Eugjeni cilësohej si një meshtar që i jepte Kishës një frymë të lirë. Kështu, ajo kishte në gjirin e vetë tre kryepriftërinj me ndjenja kombëtare, të cilët vepronin sipas Kongresit të Beratit.[866]

Emri i episkopit të katërt që do të farkëtonte Sinodhin nuk ishte saktësuar. Qeveria shpresonte se Hirësitë Kristofori, Jerotheu, Joakimi ose ndonjë tjetër do të pranonte. Kështu, të paracaktuar për episkopë ishin vetëm Çamçe dhe Atë Efthimi ditën që çështja mori drejtim. Mospasja e një episkopi të katërt do ta detyronte qeverinë të pranonte Hirësi Viktorin si anëtar të Sinodhit ose do të hidhte në erë përpjekjet, teksa ishte e domosdoshme pasja e katër episkopëve, sipas së drejtës kishtare dhe Statutit të Beratit.

Kishte disa mundësi për këtë fron, teksa së paku gjashtë arkimandritë dhe një sërë priftërinjsh të ve shërbenin në Kishën Shqiptare. Qeveria thirri ngutshëm në Tiranë zëvendësmitropolitin e Gjirokastrës, Atë Thanasin, më 13 shkurt, pasi ishin dorëzuar dy episkopët e parë. Ai drejtonte qarkun kishtar më me vështirësi në vend prej vitit 1923.[867]

Atë Thanasi u dorëzua episkopi i katërt të dielën më 17 shkurt, duke marrë emrin Ambrozi. Hirësi Viktori shqiptoi këtë herë lëvdimet ndaj Mbretit. Episkop Ambrozi bekoi Kuvendin dhe popullin, ndërsa Hirësi Visarioni lartësoi Kryeministrin dhe qeverinë. Atë Vasil Marko shtjelloi rëndësinë që kishte krijimi i Sinodhit dhe u kërkoi besimtarëve të nderonin barinjtë e tyre dhe të donin njëri-tjetrin.[868]

Hirësi Visarioni kujtoi të gjithë drejtuesit e kishave autoqefale për herë të fundit, duke nisur nga Atë Vasil Marko, si Kryetar i Këshillit të Lartë Kishtar, e me radhë patriarkët dhe kryepiskopët e mbarë botës. Po ashtu, ai përmendi episkopët e Kishës Shqiptare, përfshi dhe Hirësi Viktorin, sikurse dhe të gjithë ata që e kishin ndihmuar ose kishin rënë "Dëshmorë për idealin e shejtë të Shqipënisë".[869]

Këshilli i Lartë Kishtar emëroi të nesërmen Visarion Xhuvanin si Mitropolit i Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit; Agathangjel Çamçen, në Mitropolinë e Beratit dhe të Vlorës, ndërsa Ambroz Nikolla emërohej në qarkun kishtar të Gjirokastrës, Delvinës dhe Himarës. Atë Vasil Marko nënshkruante në fund të vendimit:

---

[864] "Dje u konsakrua episkop dhe Atë Efthim Hoshteva", *Gazeta e Re* nr. 86, 13 shkurt 1929, 1.
[865] Zoi Xoxa, "Triumfi i Kishës Kombëtare", *Gazeta e Re* nr. 87, 14 shkurt 1929, 1.
[866] "Kisha Orthodhokse Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 89, 16 shkurt 1929, 2.
[867] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Gjirokastër, 13 shkurt 1929.
[868] "Sinodhi Kishtar i Shqipëris uformua dhe udeklarua dje", *Gazeta e Re* nr. 91, 19 shkurt 1929, 1.
[869] Po aty.

> "Në këtë mënyrë deklarojmë formimin e Sinodhit Episkopal të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, sipas dispozitave të statutit, dhe i paraqisim Sinodhit dorëheqjen tonë nga kryesija e këshillit të lartë, dhe sipas zakonit edhe dorëheqjen e gjithë këshillit në fjalë..."[870]

Mitropolia e Korçës kishte mbetur e zbrazët. Pleqësia Kishtare e qytetit, me pjesëmarrjen e kryebashkiakut Vasil Avrami, vendosi që Hirësi Visarioni të ishte zëvendësisht Mitropolit i Korçës, pas kërkesës përkatëse të qeverisë.[871] Sinodhi i Shenjtë u mblodh për herë të parë për të zgjedhur Xhuvanin Kryepiskop. Njëherazi, Hirësi Eugjeni u emërua ndihmës i Mitropolitit Visarion, si Episkop i Peshkopisë.[872]

Mbledhja e parë vendosi të përfshinte si anëtar edhe Atë Vasil Markon, duke e denjuar ikonom të madh mitrofor, sipas shembullit të kishave rumune dhe ruse. Sinodhi do të kishte përkohësisht qendër Korçën, ndërsa vendimi përfundimtar do të merrej në statutin e ri. Kryepriftërinjtë falënderuan Patriarkun serb dhe Hirësi Viktorin dhe njoftuan patriarkanat dhe kishat autoqefale. Sinodhi ngriti një komision për përkthimin e librave të shenjtë, të përbërë nga gjuhëtarët e njohur, prof. Aleksandër Xhuvani, Mihal Sherko, Zoi Xoxa etj.[873]

Atë Vasil Marko u dorëzua Ikonom i Madh Mitrofor nga Fortlumturi Visarioni, në prani të të gjithë episkopëve, të dielën e radhës, më 24 shkurt. Hirësi Viktori ishte sërish i pranishëm, veçse këtë herë si i ftuar. Madje, mitra e tij u përdor për dorëzimin e Atë Vasilit, teksa mitra pa kryq nuk kishte ardhur ende.[874] Ndërkaq, Zoi Xoxa u emërua Sekretar i Sinodhit deri në rregullimin përfundimtar të KOASH-it. Kryeministri i arsyetoi Xoxës se Visarioni kishte mbetur zgjedhja e vetme, pas dështimit të mundësive të tjera dhe kundërshtive të Kisit, të cilin e nderonte. Porse, nevojitej një kujdes i veçantë, pasi grekët kërkonin të bënin qimen tra. Sipas Kotës, Xoxa nuk do t'i ndahej Visarionit duke vepruar si këshilltari, pa të cilin nuk do të merrej asnjë vendim.[875]

Ligji për bashkësitë fetare dhe Statuti i Beratit caktonin se Sinodhi i Shenjtë duhet të pëlqehej nga Mbreti dhe anëtarët duhet të betoheshin para tij. Gjashtë makina u rreshtuan përpara hotelit "Internacional" ku qëndronin drejtuesit kishtarë mëngjesin e 26 shkurtit, për të shoqëruar pesë anëtarët e Sinodhit dhe sekretarin Xoxa. Veturat i çuan të ftuarit në Pallatin Mbretëror, ku u pritën nga trupa muzikore dhe me nderimet e një kompanie ushtarake. Rreth katërqind persona, përfshi intelektualët më në zë të kryeqytetit ishin radhitur për të ndjekur pritjen. Zogu I i priti në këmbë e buzagaz një nga një të gjithë anëtarët e Sinodhit. Kryepiskop Visarioni ishte i pari që u betua. Episkopët u zotuan për besnikëri ndaj dogmave dhe të drejtës kishtare, si edhe ndaj Mbretit dhe Atdheut.[876]

Mbreti rrëfeu kënaqësinë që ndiente dhe vlerësoi se shqiptari e quan lirinë aq të nevojshme dhe të shtrenjtë sa edhe jetën e tij. Zogu kujtoi se kjo dashuri i shtyu

---

[870] "Meditim rreth dy fotografive", *Autoqefalia Ortodokse Shqiptare* nr. 5, 1994, f. 3.
[871] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Vendim i Pleqësisë Kishtaer, 18 shkurt 1929.
[872] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 262, f. 1, KOASH drejtuar Kryeministrit, pa datë.
[873] "Sinodhi Kishtar i Shqipëris ...", 1.
[874] "I përndershmi Vasil Markoja u konsakrua Ikonom i Math Mitrofor", *Gazeta e Re* nr. 97, 26 shkurt 1929, 3.
[875] Xoxa, *Kujtimet*, 127.
[876] "Sinodhi i Shenjtë përpara Lartmadhnisë së Tij Mbretit", *Gazeta e Re* nr. 98, 27 shkurt 1929, 1.

shqiptarët drejt derdhjes së gjakut për lirinë e popujve të tjerë, të cilët pandehte se i kishte miq. Ai tha se nuk kishte shqiptar pa liri të plotë dhe atë e kishte fituar me mundime të çmuara, përfshi edhe mundin e priftërinjve shqiptarë. Mbreti shprehu nevojën e kombit për të ngritur atdhedashurinë. Shqiptarët duhet të kishin besim në vetvete për të arritur ngritjen e një shteti me rëndësinë që meritonte. Zogu e quajti qeverinë e tij jofetare, por që nderonte fetë që kishte populli. Ai u zotua për përkrahje ndaj Kishës dhe uroi arritje të mëtejshme.[877]

Mbreti mbante fjalime shumë rrallë. Hirësi Visarioni u shpreh se nuk e dinte që Lartmadhëria do t'i nderonte me fjalim e për pasojë nuk kishte përgatitur përgjigje. Gjithsesi, gojëtaria nuk e la në baltë për të shprehur falënderimet për gjithë mbështetjen e dhënë nga shteti. Visarioni ripohoi nevojën e shqiptarëve për liri dhe kujtoi theroritë e së kaluarës për lëvizjen kombëtare. Po ashtu, përmendi veprimtarinë atdhetare të Mbretit, në kohën e Kongresit të Beratit dhe përfundoi duke thirrur "Rroftë Mbreti i Shqiptarëve".[878]

Pesë anëtarët e Sinodhit u bënë gati për detyrat e rëndësishme. Ata do të zhvillonin takimin e parë, për t'i hapur rrugën mbledhjes së Kongresit Kishtar. Nisja e punimeve të Sinodhit u la për në fundmars, që përkonte me Ditën e Ortodoksisë dhe me përvjetorin e meshës së parë që Hirësi Theofani kishte mbajtur në Amerikë.[879]

Vonesa e mbledhjes kishte edhe një arsye krejt të rëndomtë. Atë Vasil Marko ishte kthyer në Korçë më 5 mars i pritur nga zëvendësmitropoliti i sapoemëruar Ikonom Atë Josifi, Atë Sofroni, psalti Pandi Progri dhe paria e qytetit. Ai njoftoi se arsyeja kryesore e vonesës ishte se episkopët kishin porositur rroba të denja e të shtrenjta, që nuk ishin bërë ende gati.[880]

Sidoqoftë, arsyeja kryesore e vonesës njëmujore të mbledhjes së Sinodhit të Shenjtë, kishte të bënte me nevojën e episkopëve për t'u fronëzuar në qarqet përkatëse kishtare. Ministria e Brendshme lajmëroi prefekturat për zgjedhjen e mitropolitëve, më 27 shkurt. Ajo kërkoi që Kisi dhe Jerotheu të qëndronin si qytetarë të thjeshtë. Gjithashtu, urdhëroi prefektët të kryenin pritjet më madhështore e tërësisht në përputhje me kremtimet fetare që u bëhen mitropolitëve kur shkojnë në qarqet e tyre. Madhështia do të përdorej si një përgjigje ndaj fushatës që kishte çelur shtypi i huaj.[881]

Mitropolit Kristofor Kisi kishte qenë i mënjanuar në Manastirin e Ardenicës. Mirëpo, ai u zhvendos në Manastirin e Shën Joan Vladimirit në Elbasan më 6 mars, përpara se Episkopi i ri, Agathangjeli, të mbërrinte në Berat.[882]

---

[877] Po aty.
[878] Po aty.
[879] *Zëri i Korçës* nr. 377, 5 mars 1929, 4.
[880] "Sinodhi i Parë i Kishës Shqiptare do hapet së shpejti në Korçë", *Zëri i Korçës* nr. 377, 5 mars 1929, 2. Kërkesa për teshat e reja do të bëhej pak ditë më vonë nga qeveria shqiptare (AMPJ, V. 1929, D. 854, f. 1, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, 9 mars 1929.). Qeveria dëshironte që episkopët e sapodorëzuar të kishin denjësi të plotë. Ajo ngarkoi blerjen e petkave, kryqeve e librave më të shtrenjtë me çmim prej 100.000 dhrahmish (AMPJ, V. 1929, D. 854, f. 7, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, mars 1929.). Mirëpo, ajo i uli kërkesat në më pak se një muaj, duke kërkuar rroba të cilësisë së mesme, që vlenin një të katërtën e shumës së menduar fillimisht (AMPJ, V. 1929, D. 854, f. 9, MPJ drejtuar Legatës së Athinës, mars 1929.). Marko shprehej se petkat ishin arsyeja e mosardhjes së menjëhershme të episkopëve, por drejtuesit e rinj të kishës nuk do t'i merrnin as për mbledhjen e Sinodhit dhe as për Kongresin Kishtar. Teshat mbërritën më 4 korrik dhe qeveria u lajmërua vetëm më 23 gusht që ato qëndronin të pamarra në Skelën e Durrësit (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar MPJ, 23 gusht 1929).
[881] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar të gjitha prefekturave, 27 shkurt 1929.
[882] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Berat, 6 mars 1929.

Kisi u urdhërua të mos vetëquhej më "Mitropolit i Beratit" në letërkëmbime dhe të qëndronte si shtetas i thjeshtë.[883] Hirësi Kristofori nuk kursente vërejtjet për Fortlumturi Visarionin, duke vendosur në pikëpyetje edhe gradën shkencore të doktorit të teologjisë.[884] Sinodhi i Shenjtë i përdori këto shpifje për të përligjur lutjen zyrtare për dëbimin e Kristoforit nga Shqipëria. Sinodhi padiste Kisin për përgojim kundër Kishës, por qeveria e hodhi poshtë një masë të tillë.[885] Prefektura e Korçës shprehej se do të ishte mirë që Kisi të qëndronte brenda Shqipërisë, pasi do të përbënte dobi për Kishën dhe Shtetin në rast se bindej në të ardhmen.[886]

Pasardhësi i tij, Hirësi Agathengjeli, do të pritej me madhështi në të gjitha qytetet e Mitropolisë, nga priftërinjtë, besimtarët dhe zyrtarët vendorë. Përgatitjet kishin nisur prej kohësh.[887] Ai u nis më 13 mars.[888] Fillimisht ndaloi në Lushnjë dhe më pas u nis për në Berat i shoqëruar nga djemtë dhe vajzat e shkollës së mesme.[889]

Flamujt kuqezinj kishin zbukuruar mbarë qytetin në pritje të Mitropolitit. Hirësi Agathangjeli u rrethua nga ushtarët, nxënësit, zyrtarët, priftërinjtë dhe besimtarët.[890] Fronëzimi u krye në Kishën Katedrale, ku episkopi theksoi se Kisha Autoqefale synonte bashkimin në mes të vëllezërve shqiptarë dhe përparimin e fesë në themele kombëtare.[891] Ai vizitoi Fierin dhe Vlorën më 18 mars, përpara se të nisej për në Korçë.[892]

Kryepiskopi Visarion do të haste pritje të ngjashme gjatë udhëtimit në qendrat kryesore të Mitropolisë së Durrësit-Tiranës. Ai shkoi në Shkodër më 13 mars, ku u prit nga zyrtarët vendorë, besimtarët dhe zëvendësmitropoliti i sapoemëruar, Hirësi Viktori.[893] Episkopi serb nuk ishte anëtar i Sinodhit, por do të vijonte të qëndronte në qytet në varësi të Kishës Shqiptare.[894] Fortlumturi Visarioni la Shkodrën dhe iu drejtua Durrësit, qendrës së qëmotshme të Mitropolisë. Ai u pranua me nderimet më të larta më 16 mars. Sekretari i Sinodhit, Zoi Xoxa, lexoi dekretin e emërimit të Fortlumturisë dhe dr. Ilia Lavda theksoi ndihmën shpirtërore që i dhanë çështjes kishtare Mbreti dhe Kryeministri.[895]

Xoxa kishte përgatitur një fjalim të përmbajtur, por Fortlumturi Visarioni vendosi të shpaloste gojëtarinë e zjarrtë e atdhetare, duke e shoqëruar me gjeste skenike. Ai tha se e pranoi detyrimin shpirtëror ta ringrinte Kishën Ortodokse, përpara rënies që po pësonte. Fortlumturia foli për detyrën ndaj kombit, atdheut dhe fesë.[896] Kryepiskopi drejtoi meshën e parë episkopale në krye të Mitropolisë dhe ngriti priftin e qarkut Atë Anastasin

[883] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 66, Prefektura Berat drejtuar MPB, 6 mars 1929.
[884] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 76, Mitropolit Kristofori drejtuar Vasil Thomos, pa datë.
[885] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/2, Sinodhi i Shenjtë drejtuar MPB, 8 prill 1929.
[886] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/2, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 10 mars 1929.
[887] "Formimi i Sinodhit të Shenjtë dhe populli i Beratit Berat", *Gazeta e Re* nr. 106, 8 mars 1929, 3.
[888] "Emz. V. Xhuvani u nis për në Shkodër dhe Emz. Agathangjeli për në Berat", *Gazeta e Re* nr. 110, 14 mars 1929, 1.
[889] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Nënprefektura Lushnjë drejtuar MPB, 11 mars 1929.; "Pritja e Emz. Agathangjelit në Lushnjë", *Gazeta e Re* nr. 110, 14 mars 1929, 1.; AQSH, Nënprefektura Lushnjë drejtuar MPB, 11 mars 1929, cit.
[890] "Populli i Beratit i bëri një pritje të çkëlqyer Imzot Agathangjelit", *Gazeta e Re* nr. 114, 19 mars 1929, 2.
[891] "Kleri orthodhoks i qarkut të Beratit dhe Imzot Agathangjeli", *Gazeta e Re* nr. 116, 21 mars 1929, 3.
[892] "Pritja e Imz. Agathangjelit në Fier", *Gazeta e Re* nr. 115, 20 mars 1929, 1.; "Imzot Agathangjeli në Vlorë", *Gazeta e Re* nr. 115, 20 mars 1929, 1.
[893] "Emz. V. Xhuvani u nis për në Shkodër dhe Emz. Agathangjeli për në Berat", 1.
[894] V. K., "Kryetari i Synodhit të Shenjtë në Shkodër", *Gazeta e Re* nr. 112, 16 mars 1929, 4.
[895] "Imzot Visarioni uprit me nderime të mëdha në Durrës", *Gazeta e Re* nr. 113, 17 mars 1929, 6.
[896] Xoxa, *Kujtimet*, 129-130.

në ikonom.[897] Paria ortodokse e Durrësit falënderoi Kryeministrin Kota për zgjidhjen e çështjes kishtare, sipas dëshirës së ortodoksëve shqiptarëve.[898]

Fortlumturia vijoi me një shërbesë në Kavajë dhe vizitoi vendlindjen e tij. Elbasani kishte të drejtë të ishte kryelartë me rrjedhën që kishin marrë ngjarjet, pasi edhe Visarioni, edhe Hirësi Ambrozi rridhnin nga ky qytet.[899] Xhuvani u shoqërua nga Hirësi Eugjeni, prefekti i Elbasanit dhe deputeti korçar Llambi Bimbli. Ai pa të rreshtuar të gjithë zyrtarët vendorë, ushtarakë dhe fetarë, djemtë e shkollave dhe pjesën më të madhe të popullit. Mirëseardhjen ia shqiptoi i sprovuari në lëvizjen kishtare, Thanas Floqi. Ai foli për ngadhënjimin e lëvizjes dhe për ndihmesën që kishte dhënë Elbasani, nga Dhaskal Todri e Kostandin Kristoforidhi te Xhuvani e Ambrozi. Fortlumturia u shpreh i drithëruar para bashkëqytetarëve që i ndiente eshtër prej eshtre e gjak prej gjaku. Bashkia dhe Paria Ortodokse u kujdesën të falënderonin Kryeministrin Kota për zgjidhjen kombëtare.[900] Visarioni u nis për në Korçë, duke meshuar edhe në qytetin e fundit të Mitropolisë, në Pogradec.[901]

Themelet e patundura kombëtare që dalloheshin në mitropolitë e Korçës, Beratit dhe Durrësit nuk ngjasonin me Mitropolinë e Gjirokastrës. Ajo kishte në përbërje mbarë pakicën greke. Njëkohësisht, Konsullata në Gjirokastër dhe Nënkonsullata në Sarandë orvateshin të ndikonin edhe ortodoksët shqiptarë. Shumica e fshatrave ortodokse të zonës së Sarandës dhe Delvinës, përfshi edhe lagjen ortodokse të Delvinës, ishin të banuara nga pakica greke. Përjashtim përbënin vetëm fshatrat Shkallë, Vrinë, Mursi, Xarrë, Sopik, Muzinë, Pecë, Senicë, Nivicë, Shën Vasil, Lukovë, Piqeras dhe qyteti i Sarandës, që banoheshin nga shqiptarë ortodoksë. Shqiptarët ishin shumicë e paluhatshme edhe në këtë hapësirë, duke shtuar popullsinë myslimane. Ortodoksët shqiptarë ishin shumicë në zonën e Himarës dhe në Gjirokastër, ku përbënin tërësinë e popullsisë në zona si Lunxhëria, Zagoria, Libohova apo edhe në lagjet ortodokse të qytetit, Varoshi dhe Pazari i Vjetër. Dropulli dhe Pogoni kishin popullsi greke. Mirëpo, numërimi i vitit 1923 tregonte se Lunxhëria, Zagoria, Riviera, fshatrat ortodokse të Çamërisë dhe Libohovës si dhe ortodoksët e Sarandës e Gjirokastrës përbënin dy në tre besimtarë ortodoksë në tërësinë e Mitropolisë. Kjo i linte grekët e Dropullit, Vurgut, Pogonit dhe lagjes ortodokse të Delvinës në pakicë edhe brenda radhëve të ortodoksëve.[902]

Pasqyra e mësipërme bënte që Hirësi Ambrozi të kishte detyrën më të vështirë, teksa i duhej të përballej me rryma kundërthënëse që shkonin nga kombëtaristët stërfalë shqiptarë të përfaqësuar nga Petro Poga, Ikonom Atë Pano Gjirokastra, Thoma Papapano etj. deri në rrymat kombëtariste greke të përfaqësuara nga të mbështeturit e konsullatave. Hirësia dhe qeveria shqiptare i kishin marrë shenjat mbi sjelljen që do të hasnin nga partia grekomane, përpara se të mbërrinte në qarkun kishtar. Prifti shqiptar i Gjirokastrës, Atë Jani, shkoi më 1 mars për të bekuar Konsullatën Greke sipas traditës. Mirëpo,

[897] "Mesha e parë Episkopale në Durrës", *Gazeta e Re* nr. 115, 20 mars 1929, 3.
[898] "Një shumicë dursakësh i paraqiti falënderimet z-it Kryeministër", *Gazeta e Re* nr. 115, 20 mars 1929, 4
[899] "Pritja madhështore e Kryetarit të Sinodhit në Kavajë", *Gazeta e Re* nr. 115, 20 mars 1929, 1.; "Elbasani dhe Kisha Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 110, 14 mars 1929, 2.
[900] "Pritja Madhështore e Emzot Visarion Xhuvanit n'Elbasan", *Gazeta e Re* nr. 119, 24 mars 1929, 4; "Urimet telegrafike të popullit t'Elbasanit", *Gazeta e Re* nr. 120, 26 mars 1929, 3.; "Parësia e Elbasanit për formimin e Sinodhit të Shenjtë", *Gazeta e Re* nr. 121, 27 mars 1929, 1.
[901] "Populli Pogradecit falënderon Z-it Kota", *Gazeta e Re* nr. 117, 23 mars 1929, 4.
[902] Për të dhënat e ortodoksëve sipas numërimeve të popullsisë, shih Arqile Bërxholli, *Bashkësia shoqërore ortodokse në Shqipëri* (Tiranë: 2013), 48-52.

konsulli i tha që kjo ishte hera e fundit që do ta pranonte, pasi Kisha Shqiptare ishte shpallur përçarëse.[903]

Nënkonsullata në Sarandë ishte në ballë të trysnisë. Ajo njoftonte në fillim të marsit se shumica e priftërinjve të atyshëm ishin me mish e shpirt pro Greqisë. Ata prisnin udhëzime si duhet të vepronin, pasi nëse do të pranonin të përmendnin Hirësi Ambrozin, do të njihnin "grushtin e shtetit të kryer pa dëshirën e tyre". Mospranimi i episkopit do të shoqërohej me pasoja, çka nuk mund t'i përballonin, pasi ishin familjarë të varfër.[904]

Hirësi Ambrozi zhvilloi një meshë në Tiranë më 10 mars dhe lundroi të nesërmen nga Durrësi në Sarandë.[905] Zyrtarët vendorë e pritën në molin e qytetit, krah nxënësve të shkollës dhe fjetores "Çamëria", të cilët e përshëndetën me lule dhe fjalime atdhetare. Të pranishmit iu drejtuan Bashkisë, ish-deputeti, Ilia Muzina, përshëndeti në emër të qytetarëve. Ambrozi drejtoi një shërbesë në Kishë dhe iu drejtua hotelit të vetëm "Piro Palace".[906]

Pjesëmarrja ishte mbresëlënëse në Sarandë, teksa thuajse të gjithë ortodoksët pranuan të dilnin për të pritur kryepriftin e ri. Kjo ishte më e thjeshtë për zyrtarët, të cilët nuk hasën vështirësi, teksa qyteti ishte tërësisht shqiptar. Hirësi Ambrozi u prit nën një mjedis festiv në Delvinë, në prani të të gjithë zyrtarëve vendorë dhe ushtarakë, si edhe rreth 700 banorëve, të cilët e duartrokitën pa ndërprerë dhe brohoritën pro Kishës dhe Mbretit.[907]

Disa anëtarë të parisë ortodokse kishin dalë në pritje, nën drejtimin e nënprefektit Dhimitër Jovani. Madje, shqiptarët ortodoksë të qytetit, si Avokati Aristidh Totozani, kishin në krah edhe anëtarë të pakicës, si Timo Bamiha, Oresti Anastasiadhi, dr. Marto etj., të cilët i dërguan falënderime Kryeministrit Kota.[908] Mirëpo, meshtari i qytetit, Atë Nikolla, u shtir i sëmurë dhe nuk doli fare në pritje. Hirësia u mirëprit nga nxënësit dhe u përshëndet nga Aristidh Totozani në Bashki. Episkopi la Delvinën dhe u nis për në Gjirokastër, më 13 mars.[909]

Hirësi Ambrozi i gjeti jomikpritëse disa fshatra të pakicës, si Jergucati dhe Derviçani, përpara se të rigjendej nën një frymë festive në qendrën e mitropolisë. Sheshi "Çerçiz Topulli" kishte mbledhur banorët dhe disa prej zyrtarëve të qytetit, përfshi prefektin Zef Kadarja dhe kryebashkiakun Bajo Topulli. Një dërgatë, e drejtuar nga Jani Dado, e priti Mitropolitin në Kordhocë. Hirësia nuk ishte i panjohur për qytetin. Ai kishte drejtuar Mitropolinë për gjashtë vite, duke ruajtur baraspeshat e nevojshme e duke i shërbyer me besnikëri Kishës Autoqefale dhe shtetit shqiptar. Episkopi ia kishte dalë të bindte edhe sekretarin Jani Dado, i cili shpesh fajësohej si kundërshqiptar, se zgjidhja

---

[903] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 7, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 7 mars 1929.

[904] Kondis, *Elinizmos III*, 399: IDAYE, D. A/22/1β, nr. 3383, Nënkonsullata e Sarandës drejtuar Ambasadës Tiranë, 10 mars 1929.

[905] "Episkopi i Gjinokastrës do të meshojë në Tiranë", *Gazeta e Re* nr. 106, 8 mars 1929, 2.

[906] "Ardhja e Dhespotit të Gjirokastrës Pritja e tij triumfale në Sarandë, Delvinë e Gjirokastrë. Fjalët e mbajtura", *Gazeta e Re* nr. 114, 19 mars 1929, 3. Paria e Sarandës, përfshi Ilia Muzinën, Vasil Papën, Timo e Spiro Gjinin, Bektash Abdinë, Nehip Kokën, vëllezrit Lambro e të tjerë i dërguan një urim Kryeministrit Kota për zgjidhjen atdhetare të çështjes kishtare ("Populli i Sarandës rëfen ndjenjat e tij patriotike", Gazeta e Re nr. 113, 17 mars 1929, 6.).

[907] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Nënprefektura Delvinë drejtuar MPB, 13 mars 1929.

[908] "Populli i Delvinës falënderon Z-in Kryeministër", *Gazeta e Re* nr. 111, 15 mars 1929, 1.

[909] "Pritja e Episkop Ambrozit në Gjinokastër", *Gazeta e Re* nr. 111, 19 mars 1929, 1.

kishtare duhej kryer njëanshmërisht. Prefekti Kadarja i uroi mirëseardhjen, duke folur për rëndësinë kombëtare të autoqefalisë. Sekretari i Bashkisë, Koço Lito, përshëndeti në emër të popullit dhe më pas u zhvillua shërbesa e fronëzimit. Të gjithë priftërinjtë e qytetit, Atë Pano, Atë Vasili dhe Atë Jani, nënshkruan falënderimet ndaj Mbretit dhe Kryeministrit, krahas parisë ortodokse shqiptare.[910]

Ambrozi zhvilloi meshën e parë episkopale, në kishën e mbushur plot nga ortodoksët e qytetit, të dielën, më 17 mars. Ai u lut për Kombin dhe Mbretin, duke thënë se stërnipërit e Gjergj Kastriotit kishin të drejtë të lëvdoheshin se ishin bijtë e Shqipërisë, që shpëtoi qytetërimin evropian në mesjetë.[911]

Shqiptarët që përbënin shumicën e ortodoksëve, por edhe një pjesë e pakicës greke, iu bind autoqefalisë, krejt ndryshe nga sa kishte ndodhur gjashtë vite më parë. Mirëpo, ndryshimi kishte ardhur me mjaft mund. Prefekti Zef Kadarja njoftonte më 14 mars se kishte bërë përpjekje që paria ortodokse të merrte pjesë në pritje, pasi shumica donte të mungonte. Disa grekë të parisë, si Vasil Shahini dhe Telo Cici, kishin dalë kundër pjesëmarrjes dhe nënshkrimit të falënderimeve. Kadarja sugjeronte që ata të dëboheshin për gjashtë muaj në Krujë, teksa njiheshin për qëndrime grekomane.[912]

Qeveria pranoi masën, me kusht që përligjja e dëbimit të mos ishte çështja kishtare, pasi kjo mund të dëmtonte vendin.[913] Prefektura caktoi dëbimin, por Këshilli i Ministrave e shfuqizoi pas një muaji.[914] Shfuqizimi erdhi pas lutjes që nëna e Shahinit i drejtoi Zogut se i biri ishte qytetar i bindur dhe i ndershëm ndaj Mbretit dhe Atdheut. Ajo shprehej se Shahini ishte arrestuar vetëm që ta shmangnin nga tregtia.[915]

Qeveria kundërveproi edhe ndaj meshtarit të Delvinës. Atë Nikolla përfliste se Ambrozi nuk ishte episkop, pasi i mungonte bekimi i shenjtë. Madje, ai kishte zhveshur dhe riveshur rrobat fetare në shenjë neverie, kur psalti i Delvinës kishte kënduar edhe në shqip, më 4 nëntor. Urata nuk përmendte Hirësi Ambrozin në asnjë rast, sikurse nuk e kujtonte asnjë kishë e pakicës në qarkun e tij.[916] Vetëm mbarë kishat e fshatrave shqiptare përmendnin episkopin e ri. Nënprefektura e Delvinës kërkoi dëbimin e meshtarit, por Prefektura e Gjirokastrës u shpreh se kjo do të bënte përshtypje të keqe dhe sugjeroi që Atë Nikolla të mbyllej në ndonjë manastir.[917] Qeveria i kërkoi Kryesisë së Kishës më 2 prill ta shpërngulte priftin në Berat ose Elbasan.[918] Fortlumturi Visarioni vendosi ta lëvizte në Tepelenë, por Atë Nikolla u kundërpërgjigj se më mirë të pushohej.[919] Ai u pezullua nga detyrat dhe u ndalua të rikthehej në Shqipëri në fillim të shtatorit, pasi qe larguar për në Greqi. Megjithatë, urdhri u shfuqizua në pak muaj.[920]

---

[910] Po aty.
[911] "E para meshë Episkopale në Gjirokastrë", *Gazeta e Re* nr. 119, 24 mars 1929, 3.
[912] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 35, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 14 mars 1929.
[913] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 44, MPB drejtuar Prefekturës Gjirokastër, 15 mars 1929.
[914] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 75, VKM nr. 286, 19 prill 1929.
[915] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Shahini drejtuar Kryetarit të Republikës, mars 1929.
[916] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 124, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 4 prill 1929.
[917] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 57, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 26 mars 1929.; AQSH, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 4 prill 1929, cit.
[918] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 64, MPB drejtuar KOASH, 2 prill 1929.
[919] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, KOASH drejtuar MPB, 13 korrik 1929.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 91 MPB drejtuar Prefekturës Korçë, korrik 1929.
[920] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 98 MPB drejtuar Prefekturës Korçë, shtator 1929.

4.3.Mbledhja e Sinodhit të Shenjtë dhe Kongresi i Dytë Kishtar

Episkopi i Beratit, Agathangjeli, mbërriti i pari në Korçë, më 21 mars.[921] Hirësi Ambrozi e pasoi të nesërmen në mëngjes. Kështu, gjithçka ishte gati për të pritur Kryepiskopin Visarion, i cili po vinte i shoqëruar nga Hirësi Eugjeni dhe deputeti Bimbli. Një pritje madhështore ishte organizuar, me pjesëmarrjen e të gjithë zyrtarëve vendorë dhe përafërsisht dhjetë mijë qytetarëve.[922]

Fortlumturia drejtoi meshën e parë sinodhike në Kishën e Shën Gjergjit, të dielën, përpara nisjes së Mbledhjes së Sinodhit të Shenjtë. Atë Josif Qirici u ngrit në kryqmbajtës për shërbimin ndaj Kishës dhe Atdheut. Atë Vasil Marko nuk la pa u kujtuar Hirësi Theofanin, ndonëse pa i përmendur emrin, duke çmuar priftin e parë të dorëzuar në Amerikë 20 vite më parë.[923]

Askush nuk dyshonte se pritja do të ishte mbresëlënëse në Korçë. Qyteti kishte treguar që përpara pavarësisë se kërkesa e vetme e ortodoksëve të atyshëm ishte

---

[921] Ai ishte mbrujtur në Ersekë në mjediset e bashkisë nga zëvendësmitropoliti, Arkimandriti Paskal Vodica, që vite më vonë do të bëhej Kryepiskop i Shqipërisë. Gjashtëmbëdhjetë makina ishin radhitur jashtë Korçës, për t'i uruar mirëseardhjen kryepriftit. *Zëri i Korçës* nr. 382, 23 mars 1929, 4.

[922] Dërgata kishte dalë prej orës 3, në fshatin Plasë, aty ku ndaheshin rrugët mes Zvezdës dhe Bilishtit. Ajo përbëhej nga kryebashkiaku Vasil Avrami, Hirësitë Agathangjeli dhe Ambrozi, I Përndershmi Atë Vasil Marko, priftërinjtë, zyrtarët dhe drejtuesit e shtypit ("Pritja madhështore e Kryepiskopit Imzot Vissarion", *Gazeta e Re* nr. 124, 30 mars 1929, 3). Visarioni mbërriti dhe puthi në ballë të gjithë anëtarët e dërgatës, teksa ata i puthnin dorën. Atë Josif Qirici mbajti fjalën përshëndetëse, pasuar nga një përgjigje e shkurtër e Kryepiskopit. Mirëpo, pritja e mahnitshme ishte organizuar në qytet. Shtypi i kohës është i njëmendtë mbi numrin e njerëzve që kishin dalë në shesh. Rrugët e Korçës ishin mbushur plot me së paku 10 mijë banorë, pa dallim gjinie. Ky numër përbënte pak a shumë gjysmën e banorëve të qytetit ("Ardhja e Kryepiskopit Visarion në Korçë", *Zëri i Korçës* nr. 382, 19 mars 1929, 1). "Ishin radhitur me një rregull të bukur ushtëria, nxënësit dhe nxënëset e shkollave fillore e të mesme, kleri orthodhoks i veshur me rrobat e kishës, kleri muhamedan, Banda e Bashkis etj. Me të zbritur Hirësi e Tij nga automobili u përshëndet me "armët për nder" prej ushtëris, me buçimet e Bandës dhe me brohorimet enthusiastike të popullit. Dhe të gjitha brohorimet për Mbret e për Atdhe mbaronin me një britmë, që dukej sikur dilte nga goja e nonjë vigani 'Rroftë Kisha Autoqefale'!", – shkruante i dërguari i Gazetës së Re. Vasil Avrami mbajti fjalimin kryesor, duke theksuar udhëheqjen e Korçës në zhvillimet kombëtare, si prijëse e çështjes kishtare. Kryepepiskopi nuk i la pa lëvduar këto merita të korçarëve në përgjigjen e tij ("Pritja...", 3.). Populli dhe kryepriftërinjtë iu drejtuan Kishës së Shën Gjergjit, ku Atë Vasil Marko i dorëzoi Fortlumturi Visarionit kryqin e KOASH-it, si shenjë e kalimit të kryesisë së Kishës. Kryesekretari Xoxa lexoi dekretin mbretëror dhe u zhvillua shërbesa e rastit, që përfundoi me një fjalim "të zjarrtë" të Visarionit. Konsujt italianë dhe jugosllav kishin marrë pjesë në shërbesë. Shëtitorja dhe rrugët përreth kishës ishin të pamundur të kaloheshin për shkak se mijëra banorë ishin radhitur në pamundësi për të hyrë brenda. Dita përfundoi me një gosti në Mitropoli ("Ardhja...", 1.)

[923] Konsulli grek në Korçë, Haliakopoulos, njoftonte se kishte shumë pak njerëz në Kishë gjatë kësaj meshe, aq sa Fortlumturi Visarioni u shqetësua dhe pyeti Atë Vasilin se çfarë kishte ngjarë. Sipas konsullit grek, Atë Vasili iu përgjigj: "'Po, e dimë që nuk erdhën të na presin dhe nuk na duan, por mos vallë ne bazohemi te ta? Ne bazohemi te forca e Atij' dhe u kthye duke treguar me gisht Mbretin Zog në vendin e ikonës së ulur të Joakimit të Tretë." Haliakopoulos vijonte se besimtarët shkonin në Mborje ku Atë Anastasi meshonte në greqisht. Konsulli kërkonte të holla, pasi kështu do të mund të sillte gjendjen në favor të Greqisë. (Kondis, *Elinizmos III*, 403: IDAYE, D. A/22/1β, nr. 3731, Konsullata e Korçës drejtuar MPJG, 27 mars 1929). Ai përhapte fjalë nëpër fshatrat e Korçës pak muaj më vonë se Kisha në Shqipëri do të rilidhej shumë shpejtë me Patriarkanën (AQSH, F. 317 "Prefektura Korçë", V. 1929, D. 198, f. 1, Komanda e Xhandarmërisë drejtuar Prefekturës Korçë, 19 shtator 1929). Mirëpo, fletoret shqiptare tregojnë se mesha u krye në prani të mijëra pjesëmarrësve. Zoi Xoxa nuk shënon ndonjë të papritur për atë meshë, në kujtimet e tij. Mosvërtetimi i pohimit të konsullit në shkresa e kujtime të tjera të bën të mendosh se konsulli ka zmadhuar njoftimin, në shërbim të të hollave që kërkonte.

shqiptarizimi i Kishës. Korçarët treguan pakënaqësinë ndaj shtetit grek, më 25 mars, teksa mitropolitët e rinj meshonin për Ditën e Ungjëllizimit: Agathangjeli në "Shën Gjergj", Eugjeni në "Shën Mëri" dhe Ambrozi në Pogradec.[924] Ajo ditë ishte festë kombëtare për Greqinë dhe korçarët uronin Konsullatën çdo vit. Mirëpo, askush nuk shkoi këtë 25 mars, për shkak të qëndrimit që Greqia mbante ndaj çështjes kishtare shqiptare.[925] As Konsullata nuk qëndronte mospërfillëse. Konsulli kishte paguar 20 lira angleze punonjësin e hotelit "Palace", Kristo Veliun, nga Dardha, për të përgjuar mitropolitët.[926]

Kryepiskopi, paria ortodokse dhe zyrtarët vendorë uruan Mbretin, më 26 mars.[927] Fortlumturi Visarioni u kujdes të dërgonte një falënderim edhe për Kryeministrin Kota, përpara se të shpallte të hapur mbledhjen e Sinodhit të Shenjtë.[928] Punimet u çelën paraditen e 27 marsit me ujin e bekuar dhe me pjesëmarrje të zgjeruar të anëtarëve të pleqësisë, priftërinjve dhe zyrtarëve ortodoksë. Kryepiskopi u tha të pranishmëve se përfaqësonin mbarë ortodoksët shqiptarë në mbledhjen e parë të Sinodhit të KOASH.[929]

Sinodhi miratoi falënderimet dhe trajtoi përgatitjen e Statutit të Kishës, që do të shqyrtohej nga Kongresi.[930] Një afat dyjavor u la për këtë qëllim.[931] Mbledhja u mbyll në më pak se një orë. Sinodhi u ritakua me një statut të përgatitur më 9 prill. Fortlumturia e lexoi dhe statuti u miratua njëzëri. Më pas, u trajtua dhe u miratua buxheti, që parashihte të ngrinte një shkollë priftërore, një komision përkthimi e botimi për tekstet kishtare, një Drejtori të Përgjithshme për pasuritë e manastireve e kishave dhe bursa për të dërguar studentë jashtë shtetit.[932] Punimet e Sinodhit u mbyllën më 14 prill dhe Hirësitë u nisën për në qarqet përkatëse kishtare me përjashtim të Visarionit dhe Atë Vasil Markos.[933]

Fortlumturia qëndroi dhe drejtoi mbledhjen e Pleqësisë Kishtare, ku u vendos ndërtimi i Katedrales së re.[934] Ai u kujdes të fuqizonte vetveten në Mitropolinë e Korçës ku kishte mjaft kundërshtarë. Kryepiskopi meshoi në Kishën Rumune në qytet, në

---

[924] "Pritja madhështore...", 3.

[925] "Pritjet madhështore që iu bënë në gjithë anët e Shqipërisë episkopëve tanë", *Zëri i Korçës* nr. 384, 30 mars 1929, 1.

[926] Kondis, *Elinizmos III*, 403: IDAYE, Konsullata e Korçës drejtuar MPJG, 27 mars 1929, cit.

[927] "Telegramet që i u drejtuan L. M. T. për zgjidhjen e çështjes së Kishës", *Gazeta e Re* nr. 125, 31 mars 1929, 1.

[928] "Falënderime z-it Kryeministër për zgjidhjen e çështjes Kishëtare", *Gazeta e Re* nr. 121, 27 mars 1929, 4.

[929] "Mbledhja e parë e Sinodhit", *Zëri i Korçës* nr. 384, 30 mars 1929, 1.

[930] Rendi i ditës përmbante falënderime për Mbretin, Kryeministrin, prefektët, nënprefektët, kryebashkiakët, këshillat dhe kujdestarët e mitropolive dhe kishave për pritjen e episkopëve, si edhe të patriarkut dhe Sinodhit rus për ndihmën e dhënë.

[931] "Mbledhja e parë e Synodhit në Korçë", *Gazeta e Re* nr. 123, 29 mars 1929, 4.

[932] "Sinodhi i Shejtë e plotësoi Statutin Kishëtar", *Gazeta e Re* nr. 132, 10 prill 1929, 1.

[933] "Mbledhjet e Sinodhit të Shenjtë Kishtar", *Gazeta e Re* nr. 139, 18 prill 1929, 2.; Hirësi Agathangjeli u nis me vonesë, në pritje të disa teshave që kishte porositur në Greqi ("Sinodhi i Shenjtë iu dha fund punëve të tij", *Gazeta e Re* nr. 141, 20 prill 1929, 3). Ai mbërriti në Berat në fillim të majit dhe mblodhi Pleqësinë e Mitropolisë. ("Imzot Agathanjgeli në Berat", *Gazeta e Re* nr. 158, 11 maj 1929, 3.) Hirësi Eugjeni do të kishte si qendër Elbasanin. Ai mbërriti në qytet më 23 prill ("Ardhja e Emzot Eugjenit", *Gazeta e Re* nr. 144, 24 prill 1929, 3.) pas një peripetësie të vogël, teksa makina e tij e drejtuar nga shoferi Gaqo Polena ishte përplasur rrugës duke plagosur një djal të ri, fatmirësisht lehtë ("Një Aksident automobili", *Gazeta e Re* nr. 146, 26 prill 1929, 3.).

[934] "Sinodhi i Shejtë e plotësoi Statutin Kishëtar", 1.

Boboshticë dhe në Manastirin e Shën Prodhromit.[935] Visarioni qëndroi në Korçë gjatë pashkëve, që u festua me numrin më të madh të besimtarëve që qyteti kishte parë ndonjëherë.[936] Kryepiskopi u sigurua të vendoste nën drejtim edhe Mitropolinë e Durrës-Tiranës. Ai u kthye më 13 maj, duke zgjedhur Pleqësinë Kishtare në Kavajë, dhe duke drejtuar mbledhjen e parë të Pleqësisë së re të Durrësit.[937] Ai u largua, duke vizituar Përmetin, ku emëroi zëvendësmitropolit mikun e tij, Dhimitër Kacimbrën, dhe u rikthye në Korçë më 4 qershor.[938]

Episkopi i vetëm që haste vështirësi, Hirësi Ambrozi, mbërriti në Gjirokastër më 21 prill.[939] Ai do të shihte dy zhvillime tërësisht të kundërta përpara se të nisej për punimet e Kongresit Kishtar. Hirësia udhëtoi drejt qendrës së fundit të Mitropolisë që nuk kishte vizituar, Himarës, më 6 maj, të Hënën e Pashkëve. Pritja ishte madhështore. Zëvendësmitropoliti Atë Spirua ishte lajmëruar vetëm në orën tre pasdite se Hirësi Ambrozi ishte nisur për në zëvendësinë e tij. Nxënësit, mësuesit, priftërinjtë dhe paria e qytetit ishin rreshtuar menjëherë përpara kishës. Kambanat nisën të gjurmonin njëkohësisht në orën 5, pas shenjimit se makina e Hirësi Ambrozit ishte parë. "Gazeta e Re" përshkruante një pamje "që rrallë i paraqitet njeriut", ku nxënësit me flamurin në dorë prinin Hirësinë e rrethuar prej popullit që tejkalonte 500 frymë. Ata hynë në kishë dhe morën pjesë në meshën episkopale, që përfundoi me një lutje në shqip që Mbreti i Shqiptarëve "të lartësojë dhe përparojë Kombin".[940]

Zgjidhja e çështjes kishtare ishte pritur me hare në Himarë, por jo edhe në një pjesë të pakicës greke. Ndodhia më e rëndë kundër Kishës Autoqefale do të gjente terren pikërisht në Delvinë. Mënyra e zgjedhur për shfaqjen e neverisë ishte një përpjekje jo fort fetare. Ngjarja ndodhi të Premten e Madhe, kur disa gra dhe vajza u dërguan në kishë, të pajisura me enë me ujë të përvëluar. Disa burra nisën të përplasnin këmbët sapo nisi mesha. Ndërkaq, gratë hodhën ujin e nxehtë nga lart, duke ulëritur kundër gjuhës shqipe dhe Shqipërisë dhe duke brohoritur pro Greqisë dhe greqishtes. Mjaft njerëz u lënduan në fytyrë dhe qafë nga uji i nxehtë. Shumë të tjerë u lemerisën duke dalë jashtë me vrap, ngaqë nuk kuptonin se çfarë kishte ngjarë. Zyrtarët vendas arritën të rivendosnin qetësinë. Udhëheqësit e ngjarjes u ndaluan, me ndihmën e besimtarëve, përfshi shumë anëtarë të pakicës. Të ndaluarit ishin tregtarët Nikolla Gjati e Vaso Tereziu, financierët Jorgji Kanaçi e Stafan Lezo dhe farmacisti Jorgji Pandezi. Ata u dërguan në Tiranë për të dalë

[935] *Zëri i Korçës* nr. 389, 16 prill 1929, 4; *Zëri i Korçës* nr. 391, 23 prill 1929, 4.

[936] *Gazeta e Re* rrëfen për 12 deri në 15 mijë besimtarë, që dolën në rrugët e qytetit, për të marrë pjesë në kremtim. "Pa dyshim, pra mund të thuhet se gjith ky popull, q'i vazhdoj me kaqë zell ceremonitë fetare, shtyhej për këtë në një pjesë të madhe prej gëzimit të tij se më në fund, pas kaqë mundimesh e përpjekjesh, ia arriti realizimit t'autoqefalis së Kishës Orthodhokse Shqiptare"- nënvizonte fletorja, duke vlerësuar rolin e Fortlumturi Visarionit. Shkruesi shënonte se "populli orthodhoks i Korçës ka të drejtë të lëvdohet se edhe këtë herë, si gjithënjë, diti t'u përgjigjet me vepra "dashamirësve" *t'interesuar*" ("Manifestim madhështorë për Kishën Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 159, 12 maj 1929, 3.).

[937] *Gazeta e Re* nr. 160, 14 maj 1929, 4; "Hirësia e Tij Kryepiskopi Visarion", *Gazeta e Re* nr. 173, 30 maj 1929, 2; "Aktivitet dhe reforma të çuditëshme në çështjet kishëtare", *Gazeta e Re* nr. 169, 25 maj 1929, 3.

[938] Pleqësia kishtare e Përmetit përmbante emra atdhetarësh si ish-deputeti Agathoki Xhitomi, Spiro Adhami dhe Pandeli Kristeqe. "Populli i Përmetit për Kishën Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 178, 5 qershor 1929, 1.; "Hirësia e Tij Imz. Xhuvani u nis për në Korçë", *Gazeta e Re* nr. 169, 25 maj 1929, 1; "Imzot Visarioni u kthye në Korçë", *Gazeta e Re* nr. 177, 4 qershor 1929, 3.

[939] "Kthimi i episkopit", *Gazeta e Re* nr. 148, 28 prill 1929, 6.

[940] "Pritja madhështore që i u bë Episkop Ambrozit në Himarë", *Gazeta e Re* nr. 163, 17 maj 1929, 4.

përpara gjyqit. Një përpjekje e ngjashme ishte orvatur edhe në Sarandë. Mirëpo, qyteti ishte i përbërë nga ortodoksë shqiptarë dhe rrjedhimisht orvatja u parandalua lehtë.[941]

Gjithsesi, ky ishte veprimi i vetëm i brendshëm kundër zgjidhjes së njëanshme, krahas kundërshtive të Atë Nikollës, Vasil Shahinit dhe Telo Cicit. Gjendja iu rikthye natyrshmërisë, pas gjykimit të pesë të pandehurve. Pakënaqësia ndaj zgjidhjes ishte e madhe ndër greqishtfolësit, sipas zyrtarëve vendas.[942] Mirëpo, fryma e fushatave kundërkishtare ra shumë shpejt, aq sa të gjithë anëtarët e pakicës në Gjirokastër, Delvinë dhe Sarandë morën pjesë në zgjedhjet e dërgatës për në Kongresin Kishtar, në fillim të qershorit. Masat e marra ndaj pesë të pandehurve të Delvinës kishin ndikuar, por arsyeja e vërtetë që i bindi se nuk kishte rrugëzgjidhje tjetër veçse të pranonin gjendjen e re ishte mungesa e një ndihme të prekshme nga qeveria greke.[943]

Kështu, mbarë shqiptarët dhe pakica greke iu bashkuan KOASH-it, në ndryshim nga Kongresi i Beratit, kur një pakicë e shqiptarëve arriti të zgjidhte jorregullisht përfaqësues shtatë vjet më parë. Kongresi ishte paracaktuar që do të zhvillohej në Korçë, që prej punimeve të Sinodhit. Ai përbënte një detyrim të paracaktuar në Statutin e dalë nga Kongresi i Beratit.[944] Fortlumturi Visarioni vlerësonte se qyteti juglindor ishte zgjidhja më e pëlqyeshme. Ai arsyetonte se Korça ishte qendër qytetarie për ortodoksët shqiptarë, e mbi të gjitha ishte zgjidhje më e mirë nga pikëpamja ekonomike dhe drejtuese. Mbledhja do të do të kushtonte 500 napolona në Tiranë, teksa nuk kishte ndërtesë dhe pajime, për të cilat Mitropolia e Korçës nuk vuante. Gjithashtu, ndërhyrjet do të ishin të shumta në kryeqytet, ndërsa përfaqësuesi qeveritar do vepronte i pandikuar në Korçë.[945]

Fortlumturi Visarioni u dërgoi të gjitha prefekturave dhe nënprefekturave dy qarkore në fundmaj. Ai thërriste mbledhjen e Kongresit në Korçë, më 16 qershor, me anë të qarkores së parë. Arsyeja zyrtare ishte pëlqimi i priftërinjve dhe popullit ortodoks për organizimin e Kishës.[946] Kryepiskopi përcaktoi mënyrën e zgjedhjeve po atë ditë. Votimet do të zhvilloheshin me dy shkallë. Populli do të votonte zgjedhësit e dytë më 9 qershor dhe fuqiplotët do të zgjidheshin dy ditë më vonë.[947] Besimtarët ortodoksë votonin për 8 zgjedhës të dytë, të mbledhur në Kishën Katedrale të qendrës së prefekturave. Ndërsa, nënprefekturat do të zgjidhnin katër. Përjashtim përbënte Shpati, që votonte si të ishte nënprefekturë, për shkak të së kaluarës së lavdishme në mbrojtje të fesë. Zgjedhësit e dytë u mblodhën nën drejtimin e episkopëve dhe zëvendësmitropolitëve më 11 qershor. Ata dhanë plotfuqitë për 3 përfaqësues për prefekturat dhe nga një për nënprefekturat. Përjashtimisht, Korça do të zgjidhte pesë përfaqësues, ndërsa Shpati një.[948]

Qeveria mbajti një qëndrim të përmbajtur, në ndryshim nga Kongresi i Beratit. Ministria la prefekturat të vepronin si u dukej e arsyeshme, mjafton që përfaqësuesit të ishin të pëlqyer nga populli.[949] Kryepiskopi udhëhiqte zgjedhjet. Ai u takua me Mbretin,

---

[941] "Axhentat grekë kanë dashur të nxjerrin turbullime në Delvinë", *Gazeta e Re* nr. 172, 29 maj 1929, 1.
[942] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Komanda e Kompanisë së Parë të Ushtrisë Gjirokastër drejtuar Komandës së Batalionit IV Përmet, 4 qershor 1929.
[943] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 15 qershor 1929.
[944] Aurela Anastasi, "Statuti i Kishës ...", 55.
[945] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 61-63, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 1 prill 1929.
[946] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 34, f. 2, Qarkore nr. 4 e Sinodhit të Shenjtë, 30 maj 1929.
[947] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 34, f. 1, Qarkore nr. 5 e sinodhit të Shenjtë, 30 maj 1929.
[948] "Kongresi Kishëtar mblidhet në Korçë", *Gazeta e Re* nr. 183, 11 qershor 1929, 1.
[949] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/2, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 10 qershor 1929.

me qëllim që ta falënderonte për përkrahjen, por edhe për të rritur fuqinë e tij në sytë e zgjedhësve. Ai u shpreh në shtyp se Kisha kishte siguruar një të ardhme të shpejtë dhe të frytshme, ashtu si ëndrra më e mirë e atdhetarëve nuk e kishte përfytyruar.[950]

Visarioni drejtoi zgjedhjet në Elbasan.[951], prej nga përfaqësues u zgjodhën dr. Kov Deliana, prof. Kostaq Cipo, tregtari Dhimitër Papajani. Shpati dërgoi Taq Budën.[952] Kryepiskopi u zgjodh fuqiplotë i Tiranës, bashkë me Kryesekretarin e Sinodhit, dr. Zoi Xoxën, dhe dr. Athanas Shundin.[953] Durrsakët votuan në Katedrale dhe zgjodhën zëvendësmitropolit Kristaq Zaguridhin, Vasil Bakallin dhe dr. Moisi Popën.[954] Prefektura e Dibrës zgjodhi Kryqmbajtësin Atë Josif Qirici, dr. Filip Papajanin dhe Gavril Laskun. Ndërsa, dy nënprefekturat e tjera të Mitropolisë së Durrës-Tiranës, Kavaja dhe Pogradeci, zgjodhën përkatësisht zëvendësmitropolitët Kleanth Mineu dhe Spiro Naço. Shkodra dërgoi Naum Plevneshin, si përfaqësues i shqiptarëve të qytetit dhe Mitro Langarin (Lazareviçin) e Atë Velisha Popoviçin, si përfaqësues të Vrakës.[955]

Prefektura e Beratit zgjodhi Episkop Agathangjelin, Ikonom Theodhor Briskun dhe këshilltarin bashkiak dr. Nikolla Haxhistasa. Vlora emëroi tre qendrorët e lëvizjes atdhetare shqiptare, priftin e sprovuar Atë Isaia, zëvendësmitropolitin Kristo Karbunara dhe tregtarin Kristaq Ikonomi. Lushnja do të përfaqësohej nga Llazar Bozdo, ndërsa Fieri zgjodhi Uan Xoxën.[956] Së fundmi, Mallakastra dërgoi Ikonom Atë Polizoin.

Akoma edhe Mitropolia më e brishtë, Gjirokastra, nuk pati asnjë vështirësi gjatë zgjedhjeve. Mbarë qytetarët, shqiptarë dhe greqishtfolës, morën pjesë në votime më 9 qershor. Nënprefektura e Delvinës zgjodhi anëtarin e pakicës Mihal Maksuli, ndërsa nënprefekturat e Sarandës dhe Çamërisë kishin shumicë shqiptare ndër ortodoksë dhe zgjodhën shqiptarët Apostol Dhima dhe Gole Qesko.[957] Himara dërgoi me votë të lirë anëtarin e parisë kombëtariste dr. Mihal Cane. Libohova zgjodhi Dhimosthen Haxhogllun, nga fshati i pakicës Skore, ndërsa qyteti i Gjirokastrës do të kishte përjashtimisht nga katër fuqiplotë: Hirësi Ambrozin, deputetin Thoma Papapano, Koço Liton dhe priftin e Dhuvjanit, Atë Vllasin. Ky i fundit u zgjodh për të përfaqësuar pakicën greke, që kishte prani në pak fshatra të Nënprefekturës.[958] Pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve të pakicës greke në votime ishte arritje. Ata zgjodhën tre nga nëntë përfaqësuesit e Mitropolisë, çka ishte në përputhje edhe me baraspeshën kombëtare të saj.

---

[950] "Kisha Autoqefale po ecën me çape të forta në udhën e pregatitur prej Sinodhit të Shenjtë ", *Zëri i Korçës* nr. 401, 1 qershor 1929, 1.

[951] Kjo përkoi me shërbesën e martesës së vëllait të tij, priftit të mëvonshëm Prokop Xhuvanit ("Emzot Visarioni n'Elbasan", Gazeta e Re nr. 183, 11 qershor 1929, 3.), nën drejtimin e Hirësi Eugjenit ("Delegatët për mbledhjen Panorthodokse që do të mbahet në Korçë", Gazeta e Re nr. 186, 14 qershor 1929, 3.). Visarioni falenderoi Kotën për zgjidhjen e çështjes kishtare, përpara nisjes së mbledhjes ("Populli i Elbasanit i çfaq Mirnjohjen Z-it Kota", *Gazeta e Re* nr. 183, 11 qershor 1929, 1.).

[952] "Delegatët për mbledhjen Panorthodokse që do të mbahet në Korçë", 1.

[953] "Lajme të Shkurtra", *Gazeta e Re* nr. 184, 12 qershor 1929, 4.

[954] "Shpallje nga Zëv. Mitropolit i Durrësit. ", *Gazeta e Re* nr. 181, 8 qershor 1929, 2; *Gazeta e Re* nr. 184, 12 qershor 1929, 4.

[955] "Delegatët e Shkodrës për në Kongresin Panorthodokës", *Gazeta e Re* nr. 188, 16 qershor 1929, 3.

[956] *Gazeta e Re* nr. 186, 14 qershor 1929, 4; *Gazeta e Re* nr. 187, 15 qershor 1929, 4.

[957] "Delegatët e krahinës së Gjirokastrës në Kongresin Kishtar", *Gazeta e Re* nr. 185, 13 qershor 1929, 4.

[958] *Gazeta e Re* nr. 191, 20 qershor 1929, 2; "Delegatët e Gjirokastrës në Kongresin e Korçës", *Gazeta e Re* nr. 191, 20 qershor 1929, 3.

Episkopi siguroi Kryeministrin më 12 qershor se Kisha do të ishte pararojë në ngadhënjimin e frymës kombëtare.[959]

Përfaqësuesit e Mitropolisë së Korçës rridhnin të gjithë nga rryma atdhetare. Qendra e Prefekturës zgjodhi Atë Vasil Markon, kryebashkiakun Vasil Avrami dhe anëtarët e Pleqësisë Kishtare Stavraq Ballauri, Thoma Turtulli dhe Sotir Kota. Përmeti dërgoi zëvendësmitropolitin Dhimitër Kacimbra, Erseka Petro Prodanin, Leskoviku Andon Kiton dhe Bilishti Petro Ilinë. Ndërkaq, qeveria emëroi përfaqësues anëtarin e Gjykatës së Diktimit, Vasil Bidoshin.[960]

Fuqiplotët mbërritën në Korçë më 15 qershor. Shpenzimet e kongresit ishin mbuluar nga qeveria.[961] Qëllimi kryesor ishte miratimi i Statutit dhe rregullores. Zbatimi i vendimeve të Kongresit parashihej të ishte i rreptë, aq sa ministri Hiqmet Delvina linte të hapur mundësinë e zgjedhjes së Kryetarit të Sinodhit, nisur nga statuti i miratuar prej tij.[962]

Mbeti dhe Kryeministri uruan përpara nisjes së punimeve. Zogu shpresonte se Kongresi nuk do të kursehej për kryerjen e detyrës së shenjtë të ngarkuar nga ortodoksët shqiptarë për hartimin e Statutit në frymë atdhetare, për lumturinë e Kombit dhe të Atdheut. Kryeministri Kota vijonte në të njëjtën frymë. Ai cilësonte mbledhjen e përfaqësuesve të ortodoksëve shqiptarë si një çast historik dhe shprehte bindjen se vendimet do të përbënin shtylla të gëzueshme të kombit.[963]

Kongresi çeli punimet në Kishën e Shën Gjergjit, më 16 qershor.[964] Mbledhja e parë e vërtetë ishte ajo e 17 qershorit. Një komision i posaçëm këqyri plotfuqitë dhe më pas u votuan drejtuesit e Kongresit: Kryetar Fortlumturi Visarionin, nënkryetar Vasil Avrami, Kryesekretar dr. Zoi Xoxën dhe Kujdestar Thoma Papapanon.[965]

Kryepiskopi paraqiti skicën e Statutit, duke theksuar se ai ishte bazuar mbi Ungjillin e Shenjtë, Gojëdhënat e Hirëshme, rregullat e Sinodheve Ekumenike dhe përvojës së kishave simotra. Gjithashtu, statuti kishte në thelb dobinë kombëtare, sipas parimit "Kishë e lirë në shtet të lirë". Sipas tij, Statuti ishte kujdesur për mbarëvajtjen ekonomike të kishës, si edhe ishte përpjekur të vendoste një rend të fortë kishtar. Kongresi la një afat dyjavor që komisioni i posaçëm të shqyrtonte Statutin.[966]

---

[959] "Urime Z Kryeministër për konsolidimin e Kishës Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 186, 14 qershor 1929, 1.
[960] *Gazeta e Re* nr. 187, 15 qershor 1929, 4.
[961] Bashkia e Korçës kishte harxhuar 10 mijë franga ari për gjithçka që nevojitej. AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. VIII-94, f. 3, KOASH drejtuar MPB, 20 qershor 1929.
[962] AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. VIII-91, f. 1, MD drejtuar Vasil Bidoshit, 15 qershor 1929.
[963] "L. M. Mbreti Uron Kongresin Kishtar", *Gazeta e Re* nr. 188, 16 qershor 1929, 1.
[964] Anëtarët e Kongresit shoqëroheshin nga përfaqësuesi i Mbretit, Kolonel Leon Gilardi, mijra besimtarë, zyrtarët vendas dhe konsujt e Italisë dhe të Jugosllavisë. Drejtori i shkollës, Sotir Papahristo dhe përfaqësuesi i Kryepiskopit Atë Josifi mbajtën fjalët përshëndetëse dhe të pranishmit iu drejtuan mitropolisë, ku Kongresi u shpall i hapur. Koloneli Gilardi kërkoi që fuqiplotët të gjykonin me shpirtin e lirë e me gjykimin e lartë atdhetar. Kongresi u la të riniste punimet të nesërmen. Kryepiskopi Visarion ftoi Kryeministrin Kota të merrte pjesë në Kongres, kërkesë që nuk do të miratohej. "Kongresi i dytë panorthodhoks çelet në Korçë me madhështi", *Gazeta e Re* nr. 189, 18 qershor 1929, 1.
[965] "Kongresi panorthodhoks shqiptar filloj nga veprimet", *Gazeta e Re* nr. 190, 19 qershor 1929, 2.
[966] Komisioni përbëhej nga nga Mitrofori Vasil Marko, Vasil Avram, Dhimitri Kacimbra, Taq Buda, Vasil Bakalli, Athanas Shundi, Llazar Bozo, Nikolla Haxhi-Stasa, Kriataq Ikonomi, Thoma Papapano, Mihal Çani, Milo Maksakuli e dr. Zoi Xoxa.

Kolonel Gilardi shtroi darkë dorëgjerë në mjediset e kinemasë "Luks", pas përfundimeve të takimit të dytë.[967] Fuqiplotët u pritën nga himni i Mbretit dhe Flamurit, si edhe këngë atdhetare, të kënduara nga trupa muzikore e bashkisë. Gilardi kishte ftuar zyrtarët vendorë dhe të huaj, përfshi edhe konsullin grek. Mirëpo, ai ishte përgjigjur se nuk mund të shkonte, pasi qe sëmurë. Koloneli, Fortlumturi Visarioni, Vasil Avrami, Taq Buda dhe Dhimitër Kacimbra përshëndetën gostinë.[968]

Komisioni arriti të përfundonte shqyrtimin nen për nen në fund të qershorit. Dy çështje kishin hasur kundërshti, krahas asaj të Hirësi Viktorit.[969] Pesë përfaqësuesit e Korçës kishin kërkuar që qendra e Kishës të caktohej qyteti i tyre, duke i thirrur traditës së krijuar nga periudha e Këshillit të Lartë Kishtar. Sugjerimi nuk u pranua nga qeveria. Ndërkaq, çështja e dytë ishte ngritur nga tre delegatët grekë të Kongresit Kishtar, Haxhogllu, Maksuli dhe Atë Vlashi, të cilët kërkonin ndryshimin e nenit 16 që përcaktonte se episkopët dhe zëvendësit e tyre duhet të ishin prej gjaku dhe gjuhe shqiptarë. Ata shprehnin frikën se gjuha e meshimit do të ishte shqipja kudo.[970] Mirëpo, edhe kjo çështje u shmang. Qeveria nuk pranoi të ndryshohej neni 16. Ajo udhëzoi Vasil Bidoshin të siguronte gojarisht fuqiplotët greqishtfolës se qeveria ishte zotuar para Lidhjes së Kombeve mbi lirinë e meshimit në gjuhën greke në kishat e tyre dhe Statuti nuk kishte qëllim të zhdukte këto të drejta.[971] Kongresi miratoi njëzëri Statutin përfundimtar më 30 qershor. Votimi u shoqërua nga një festë me këngë atdhetare dhe kishtare të trupës së drejtuar nga profesor Kozmo.[972] Statuti u nënshkrua gjatë një pritjeje në Pallatin e Mitropolisë.[973]

Këshilli i Mitropolisë mbajti një gosti të fundit zyrtare në "Splendit Park". Fjalimet ishin të një rëndësie të veçantë. Fjala hapëse i takoi anëtarit të Pleqësisë Kishtare të Korçës, Stavraq Ballauri. Ai u pasua nga një prej tre përfaqësuesve të pakicës greke, Dhimosthen Haxhogllu, i cili u shfaq po aq atdhetar. Fuqiploti i Libohovës tha se sjellja fisnike e korçarëve kishte lënë përshtypjen më të thellë për bashkëveprimin fetarokombëtar, fenë, Mbretin dhe Atdheun. Haxhogllu përfundoi me thirrjet: "Rroftë Kisha Autoqefale Ortodokse Shqiptare! Rroftë Mbreti! Rroftë Shqipëria! Rroftë komuniteti orthodhoks Shqipëtar i Korçës!" Takimi u përshëndet me radhë nga Fortlumturi Visarioni, Atë Vasil Marko, Filip Papajani, Myftiu i Korçës dhe prefekti. Hil Mosi u kujtoi të pranishmëve se ishte bashkëpunëtor i Mihal Gramenos në "Lidhjen Ortodokse" që ishte themeluar kur nuk kishte shtet shqiptar. Ndaj, ai shprehte bindjen se sfidat e çështjes kishtare do të tejkaloheshin.[974]

---

[967] Darka ishte aq e bollshme saqë i kushtoi arkës së shtetit plot 1400 franga ari ose një të tetën e të gjitha shpenzimeve të Kongresit (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Korçë drejt. MPB, pa dt.).

[968] "Darka madhështore për nder të Kongresistëve", *Gazeta e Re* nr. 191, 20 qershor 1929, 4.; "Darkë për nder të Kongresistëve në Korçë", *Gazeta e Re* nr. 197, 27 qershor 1929, 1.

[969] Shih sythin pasardhës.

[970] AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. VIII-86, f. 30, Vasil Bidoshi drejtuar MD, 17 qershor 1929.

[971] AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. VIII-86, f. 36, MD drejtuar Vasil Bidoshit, 18 qershor 1929.

[972] Sotir Kozmo ishte drejtuesi i korit kishtar shqiptar në Korçë në periudhën më të madhe të kohës. Ai ishte një atdhetar me veprimtari të dalluar në Rumani, ku kishte marrë pjesë në lëvizjen kishtare shqiptare. Madje, ai i përsosi aftësitë muzikore nën drejtimin e profesor Kiriakut, drejtuesit të Korit Kishtar Shqiptar të Rumanisë, që u bë edhe burimi i Himnit të Flamurit (Lasgush Poradeci, "Himni kombëtar "Flamurit pranë të bashkuar" dhe gjeneza e tij", *Vepra 2* (Tirana: "Onufri", 1999)).

[973] "Kongresi panorthodoks mori fund", *Gazeta e Re* nr. 200, 2 korrik 1929, 1.

[974] Milto Sotir Gurra "Darka e Këshillës së Mitropolisë për nder të delegatëve të kongresit Panorthodhoks Shqipëtar në Korçë", *Gazeta e Re* nr. 200, 2 korrik 1929, 5.

Përfundimet e punimeve patën jehonë anekënd Shqipërisë. Kryepiskopi rendi të shkëmbente urime me Kryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, Hiqmet Delvina.[975] Shërbesa fetare u mbajtën në mbarë vendin, për të kujtuar mbylljen e Kongresit Kishtar.[976] Mbreti ishte kujdesur t'i jepte rëndësinë e duhur çastit. Ai i dërgoi një letër falënderimi Kryeministrit Koço Kota, pa mbaruar ende punimet, më 19 qershor. Shkrimi pati jehonë në shtypin vendas dhe ndërkombëtar. Mbreti kujtonte mundimet që rridhnin prej traditave të gabuara qindravjeçare dhe ngatërrimet e sjella prej drejtuesve kishtarë që ishin përballuar nga vullneti i patundur i popullit shqiptar për lirinë. Ai kujtonte se autoqefalia ishte shpallur në vitin 1922, kur ai ishte ministër i Brendshëm dhe Kota, prefekt i Beratit. Po ashtu, rikujtonte mundimet e hequra nga ortodoksët dhe kohën e çmueshme që birrte me dërgatat dhe bisedimet e papërfunduara në Stamboll e Tiranë nga viti 1922 në vitin 1929. Mbreti shënonte se Kryeministri Kota dhe paraardhësit e tij ishin dëshmitarë të vuajtjeve, therorive dhe mundimeve që kishte bërë shteti shqiptar pa nxjerrë asnjë fryt. Ai arsyetonte veprimin e kryer, duke shkruar se shteti shqiptar ishte përpjekur të arrinte zgjidhje paqësisht dhe me përulje. Porse, Shqipëria kishte mbetur me dy rrugëzgjidhje, të nënshtrohej e të hiqte dorë prej të drejtave që ia kishte falur natyra ose të vepronte siç veproi.[977]

Zogu rrëfente se dashuria e shqiptarit për lirinë ishte aq e thellë sa e kishte shtyrë të bëhej theror për popujt miq. Ai theksonte se nuk ishte dobia vetjake që e shtynte shqiptarin të derdhte gjak, se mercenarët nuk luftonin por iknin, ndërsa shqiptari nuk i ishte ndarë asnjë lufte pa gjak. Mbreti arsyetonte se veprimi ishte i ligjshëm e i drejtë, sikurse kishte qenë edhe në shtete të tjera. Fuqia ligjore sigurohej nga sovraniteti i popullit, përtej se ishte kryer çdo veprim i kërkuar nga e drejta kishtare.[978]

---

[975] "Çkëmbime telegramesh midis Z-it Kryeministër dhe Kryesisë së Kongresit Kishëtar", *Gazeta e Re* nr. 201, 3 korrik 1929, 4; "Shkëmbim telegramesh ndërmjet Z. Ministër të Drejtësis dhe Kongresit Orthodoks", *Gazeta e Re* nr. 202, 4 korrik 1929, 4.

[976] Mesha në Shkodër u krye më 30 qershor nga Hirësi Viktori ("Nji te deum në Kishën Orthodhokse për përfundimin e Statutit", Gazeta e Re nr. 202, 4 korrik 1929, 3.). Durrësi pasoi pas një dite (Gazeta e Re nr. 200, 2 korrik 1929, 4.), ndërsa Hirësi Eugjeni drejtoi shërbesën në Elbasan ("Te Deumi në Kathedralin e Elbasanit", Gazeta e Re nr. 205, 7 korrik 1929, 2.). Kongresi u festua me madhështi edhe në Mitropolinë e Beratit. Shërbesa u zhvillua në Kishën e lagjes Vakëf më 30 qershor, me pjesëmarrjen e zyrtarëve vendas. Me këtë rast, iu dërgua një urim Kryepiskopit Visarion që theksonte shkëputjen e vargonjëve fetarë të Fanarit, "që nuk duroheshin më prej orthodhoksëve shqiptarë" ("Një Te Deum madhështor për Kishën Autoqefale Kombëtare", Gazeta e Re nr. 203, 5 korrik 1929, 1.). Zëvendësmitropoliti i Vlorës Jani Skrami drejtoi lutjet për ditën e shënuar në qytetin bregdetar. "Gëzohu o popull se tash ëndërra jote u realizua! Gëzohu se ata që liturgjimin në gjuhën amtare e quanin argëtim teatror sot të ndritur nga Trinija e Shënjtë, e dëgjojnë me këndje të përulur, sot vet ata e njohën dhe i binden së vërtetës. I bekuar qoftë Perëndija e jonë gjithmonë e jetës!", – u dëgjua në fjalimin e mbajtur në Kishë ("Te Deum", Gazeta e Re nr. 209, 12 korrik 1929, 3.). Bashkimi mes shqiptarëve dhe pakicës u riduk në Mitropolinë e Gjirokastrës, teksa përfaqësues të fshatrave greqishtfolëse morën pjesë në Kishën e lagjes Varosh, sikurse shërbesa u zhvilluan edhe në Kishat e tjera të mitropolisë. Mjedisi përreth kishës në qytet ishte stolisur me flamuj kombëtar ("Një "Te-Deum" në Kishën e Mitropolisë", Gazeta e Re nr. 202, 4 korrik 1929, 3.). Saranda dhe Delvina kremtuan më 30 qershor me pjesëmarrjen e shumë besimtarëve ("Festimet për mbarimin e punëve të Kongresit Panorhtodhoks", Gazeta e Re nr. 200, 2 korrik 1929, 4.). Ndërkaq, shtatë fshatrat e Himarës zhvilluan shërbesa me shkëlqimin e viseve të tjera të vendit. Vunoi falenderoi veçanërisht Mbretin dhe Kryeministrin, duke theksuar se bijtë e atij fshati kishin bashkëpunuar prej vitesh për zgjidhjen e çështjes kishtare shqiptare. ("Kisha Autoqefale n'Himarë", Gazeta e Re nr. 210, 13 korrik 1929, 3.).

[977] "Mbreti i drejton letër falënderimi Z. Kryeministër për triumfin Kishëtar", *Gazeta e Re* nr. 191, 20 qershor 1929, 1.

[978] Po aty.

> "Shteti Shqiptar nuk ndahet nër Orthodoksë, Katolikë e Myslimanë, por asht i pa ndamë, Shtet i lirë, nuk ka shumicë e pakicë, nuk ka nji fe zyrtare, por të gjitha fetë i mpron e i nderon. Me gjith këtë nuk lejon në as nji mënyrë e prej kërkuj, qi feja të përdoret si mjet cenimi të këtij vllaznimi të nji gjaku e të nji gjuhe. Dashamirët dhe ata, qi kanë relacione me këtë Shtet, duhet t'a dijnë se çashtjet e mbrendshme të Shtetit janë ekskluzivisht çashtje, qi i takojnë vetëm popullit sovran, i cili nuk mund të tolerojë as nji ndërhyrje prej çdo ane e prej kujtdo qoft".[979]

Mbreti shpallte se populli shqiptar nuk mund të mbeste peng, duke pasur shumë vështirësi mbijetese. Ai theksonte se drejtuesit e shtetit ishin shërbëtorë të popullit dhe e pranonin përgjegjësinë pa iu shmangur. Në fund, Zogu i drejtohej në veçanti Koço Kotës. Ai rrëfente kënaqësinë që vepra qe kryer nën drejtimin e një prej bashkëpunëtorëve më të vjetër dhe më të gjallë si Kryeministri. Mbreti përfundonte me falënderimin ndaj Kotës dhe priftërinjve për atdhetarinë dhe shtypit që diti të mbronte dobinë kombëtare.[980]

Kongresi falënderoi Mbretin për përkrahjen.[981] Letra kishte një rëndësi në dy drejtime. Ajo ishte letra e parë dhe e fundit botore që Ahmet Zogu ka shkruar gjatë mbretërimit dhe përpiqej të tregonte mbështetjen e pakufizuar që kishte Kryeministri Kota në zgjidhjen e çështjes kishtare. Mbreti i vishte arritjet e kësaj çështjeje një prej anëtarëve më të zëshëm të parisë ortodokse, përkushtimi fetar dhe atdhetarizmi i të cilit nuk mund të vendoseshin në pikëpyetje nga askush. Kjo hidhte poshtë çfarëdolloj përfoljeje se dredhitë e prapaskenës kishin tejkaluar fuqinë e Mbretit apo përgojimet se lëvizja kishtare ishte zgjidhur nga myslimanët, ndërkohë që, në të vërtetë, Kryeministri Kota ishte në krye. "Gazeta e Re" shënonte të nesërmen se rëndësia e letrës ishte për të treguar se feja nuk mund të përdorej më për qëllime të shteteve, çka ishte e papranueshme për besimtarët. Fletorja theksonte se parimi "Kishë e lirë në Shtet të lirë" nuk nënkuptonte lejimin e çdo veprimi të kryepriftërinjve, por vetëm lejimin e atyre veprimeve brenda dobisë së shtetit dhe kombit. Ajo theksonte se letra e Mbretit rrëfente se Shqipëria merrte masa, që u përngjanin atyre të marra nga çdo shtet i qytetëruar.[982]

Statuti i miratuar nga Kongresi i Korçës përbëhej nga tetë kapituj dhe 64 nene, një punë që Kryesekretari i Sinodhit, Zoi Xoxa, e quante të një rëndësie kombëtare. Ai shkruante se miratimi i një statuti të përkryer nga çdo pikëpamje nuk ishte bërë për t'u mbyllur gojën fqinjëve që luftojnë kombin, por për t'i shërbyer çështjes kombëtare që ishte në shpirtin dhe veprën e fuqiplotëve të Kongresit.[983]

Kreu i parë, "Kisha", ndahej në pesë nene. Ato përcaktonin se KOASH do të ishte pjesë e pandarë e Kishës të Përgjithshme dhe Apostolike dhe përbëhej prej banorëve të Mbretërisë Shqiptare që i besojnë Krishtit dhe pohojnë Simbolin e Shenjtë të Fesë Orthodhokse. KOASH-i mbetej e bashkuar dogmatikisht dhe shpirtërisht me të gjitha patriarkanat e kishat e tjera, duke ruajtur të pandryshueshme shkrimet e shenjta, Gojëdhënat e Hirëshme dhe Kanonet. Gjuha zyrtare ishte shqipja. Kisha do të drejtohej

[979] Po aty.
[980] Po aty.
[981] "Kongresi kishtar i dërgon letër N. M. Tij Mbretit", *Gazeta e Re* nr. 195, 25 qershor 1929, 1. Zogu I do të kujdesej ta tregonte mbështetjen ndaj Kishës, edhe me gjeste, si vizita e të gjithë Princeshave, Princëve dhe Nënës Mbretëreshë në Manastirin e Shën Vlashit në Durrës. (Gazeta e Re nr. 239, 17 gusht 1929, 2.).
[982] "Letra Falenderimie N. M. T Mbretit për Z. Kryeministër", *Gazeta e Re* nr. 194, 23 qershor 1929, 1.
[983] Zoi Xoxa, "Kongresi kishtar i dërgon letër N. M. Tij Mbretit", *Gazeta e Re* nr. 200, 2 korrik 1929, 1.

nga Sinodhi, i përbërë prej Kryepiskopit, episkopëve dhe Ikonomit të Madh Mitrofor. KOASH trashëgonte të drejtat e bashkësive të deriatëhershme ortodokse.[984]

Tetë nenet e kreut të dytë flisnin për Sinodhin. Ai kishte të drejtën e patjetërsueshme në çështjet e besimit, adhurimit, rendit, bashkërendimit dhe drejtimit të Kishës, nisur nga e drejta kishtare dhe në përputhje me ligjet. Kjo kryhej duke këqyrur episkopët, themeluar, mbajtur dhe drejtuar shkolla fetare, për të rritur përgatitjen fetare-kombëtare dhe qytetarinë e priftërinjve, si edhe duke u kujdesur për përgatitjen fetare të popullit, me anë të fjalimeve dhe botimeve. Librat e mësimit duhet të kishin pëlqimin e Sinodhit dhe të Ministrisë së Arsimit. Ndërkaq, Kisha do të mundësonte përkthimin e saktë të librave të shenjta. Sinodhi kujdesej që të mos cenoheshin apo çnderoheshin dogmat ortodokse në çdo pjesë të jetës shoqërore. Sinodhi mblidhej për 15 ditë deri një muaj, çdo 1 tetor dhe drejtohej nga Kryetari. Ai mund ta thërriste në mbledhje të jashtëzakonshme me pëlqimin e shumicës së anëtarëve. Vendimet merreshin nga shumica e të pranishmëve; vota e Kryetarit mbivendosej, në rast barazie. Kryepiskopi emëronte Sekretarin e Përgjithshëm, detyrat e të cilit detajoheshin në rregullore. Sinodhi kryesohej nga anëtari më i vjetër, në mungesë të Kryetarit.[985]

Pesëmbëdhjetë nenet në vijim trajtonin episkopatat dhe episkopët. Ato caktonin se Kisha do të ndahej në katër episkopata, në kufijtë e deriatëhershëm që mund të ndryshonin me vendim Sinodhi, pëlqim qeverie dhe dekret mbretëror. Episkopatat ishin të Korçës, Përmetit Voskopojës, Leskovikut dhe Kolonjës; e Durrësit, Tiranës, Shkodrës, Kavajës, Elbasanit, Shpatit, Gorës, Mokrës, Pogradecit dhe Dibrës; e Beratit, Vlorës, Myzeqesë dhe Kaninës; dhe e Gjirokastrës, Delvinës, Dropullit, Pogonit dhe Himarës. Qendra e Kishës do të vendosej me dekret mbretëror, ndërsa më së shumti dy episkopë mund të dorëzoheshin pa qark kishtar. Sinodhi zgjidhte një tjetër Kryepiskop ose episkop, nëse i zgjedhuri i parë nuk pëlqehej nga Mbreti, veprim që mbahej i fshehtë. Neni 16 përcaktonte se Kryepiskopi, episkopët, zëvendësit, Ikonomi i Madh Mitrofor, Sekretari i Përgjithshëm dhe ndihmësit e Kryepiskopit dhe episkopëve, duhet të ishin shqiptarë prej gjaku, gjuhe dhe nënshtetësie. Ata duhet t'u përmbaheshin përcaktimeve të së drejtës kishtare dhe të kishin përfunduar një fakultet teologjie. Përjashtimisht, një i diplomuar për drejtësi, filologji ose nga një seminar ortodoks mund të dorëzohej brenda 5 vitesh.[986]

> "Betohem dhe premtoj mbi nderin t'im (si Kryepiskop ose Episkop) përpara Perëndisë se do te jem kurdoherë besnik i Mbretit të Shqiptarëvet, i Atdheut dhe i Statutit të Mbretërisë. Detyrohem të vë në be në këtë mënyrë dhe gjithë Klerikët që do të dorëzohen prej meje", - përcaktonte betimi i episkopit ose Kryepiskopit, ndërsa i Sinodhit ishte "Betohem mbi ndergjegjen time (Kryepiskopale ose Episkopale) përpara Perëndisë se do të ruaj besnikërinë kundrejt dogmave, kanoneve dhe rregullave Kishtare që përmbajnë bashkimin dogmatik fetar dhe solidarësinë me Patriarhitë dhe Kishat Orthodhokse Autoqefale të botës".[987]

Episkopët ishin të përjetshëm, por mund të zhvendoseshin me vendim Sinodhi dhe dekret mbretëror. Pushimi mund të bëhej vetëm për faje të rënda dhe arsye të

[984] Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipris* (Korçë: Gazeta e Korçës, 1929).
[985] Po aty.
[986] Po aty.
[987] Po aty.

jashtëzakonshme. Ai pushohej për arsye dogmatike nga gjykata 12-anëtarëshe, e përbërë nga episkopë dhe priftërinj. Ndërkaq, shkarkohej nga Sinodhi, pasi të ishte dënuar nga gjykatat shtetërore me më shumë se një vit. Mbreti mund t'i pushonte kryepriftërinjtë me dekret, për arsye të jashtëzakonshme. Ata mund të paraqisnin dorëheqjen, për shkak të sëmundjeve ose pleqërisë. Ndërkaq, Sinodhi mund të kërkonte një përshkrim mjekësor, duke mos i shkarkuar, por duke emëruar një ndihmësepiskop që merrte përsipër drejtimin e episkopatës. Episkopët ishin përgjegjës para Sinodhit, ku paraqisnin parashtresa të përvitshme. Detyrat mbështeteshin në të drejtën kishtare dhe rregulloret. Ata duhet të udhëtonin së paku një herë në vit në qarkun kishtar, ku emëronin zëvendësmitropolitë e nuk mund të largohehsin prej qarkut të tyre pa lejen e Kryepiskopit. Atë Vasil Marko caktohej se Ikonomi i Madh dhe merrte detyra të posaçme prej Sinodhit. Mirëpo, ky vend shfuqizohej pas ikjes së Markos dhe ai nuk zëvendësohej.[988]

Kreu i katërt detajonte masat për shkelje. Episkopi vendoste për priftërinjtë nga qortimi deri në pezullim 15-ditor për falje të lehta. Gjykatat fetare ngriheshin në çdo qendër episkopate, të drejtuar nga episkopi. Ato mund të caktonin pezullim ose prerje rroge deri një vit, vendime që apeloheshin në Këshillin Kishtar Disiplinor të qendrës së Kishës. Këshilli kishte të drejtën e zhgradimit të priftërinjve, sipas kreut të pestë. Apelimi i vendimeve mund të kryhej përpara Sinodhit. Dy krerët në vijim trajtonin pasurinë e Kishës dhe manastireve, që ishin të siguruara sipas ligjit. Burimet e të ardhurave të Kishës ishin edhe ndihma shtetërore, pagesat vullnetare dhe dhuratat. Këshilli Mikst ngrihej për qeverisjen ekonomike të kishës. Ai ishte vetmi organ që vendoste për drejtimin, shfrytëzimin dhe tjetërsimin e pronave. Këshilli përbëhej nga anëtarët e Sinodhit dhe një laik për çdo qark kishtar. Ai detajonte rregulloren, ku përcaktoheshin pagat e shpërblimet dhe mënyra e zgjedhjes së pleqësive dhe kujdestarëve. Këshilli hartonte buxhetin vjetor, që sugjerohej nga episkopatat, 30 ditë pasi merrnin mendimet e pleqësive.[989]

Kreu i fundit shënonte detyra kalimtare. Meshat do të përmbanin lutje për Mbretin, Kombin dhe Ushtrinë. Kisha nuk mund të pranonte dhurata nga një fuqi e huaj, ndërkaq kujdesej për përmirësimin e kushteve shoqërore. Dikush ishte prift, vetëm nëse emërohej nga KOASH dhe ishte i lidhur me të. Prifti duhet të kishte diplomë seminari ortodoks dhe pëlqimin e Sinodhit. Kishat e manastiret i mbeteshin KOASH-it, edhe në rast herezie të popullsisë së një treve. Tri nenet e para nuk mund të ndryshoheshin në asnjë rrethanë, ndërsa përcaktimet e tjera mund të ndryshoheshin me vendim kongresi.[990]

Hartimi i rregullores nga Këshilli Mikst u pa i nevojshëm pas miratimit të Statutit. Anëtarët laikë të Këshillit zgjidheshin nga pleqësitë, mirëpo përjashtimisht këtë herë u zgjodhën drejtpërsëdrejti nga Kongresi. Afati i lënë për miratimin e rregullores ishte gjashtë muaj, por Fortlumturi Visarioni nuk mund ta qeveriste Kishën pa rregullore dhe rrjedhimisht e thirri këshillin më shpejt.[991] Anëtarët u mblodhën në Korçë në fillim të korrikut.[992] Punimet nisën më 6 dhe mbledhja u mbyll pas 15 ditësh bisedime.[993]

---

[988] Po aty.
[989] Po aty.
[990] Po aty.
[991] "Rregullorja e Kishës Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 206, 9 korrik 1929, 2.
[992] "Lajme të Shkutra", *Gazeta e Re* nr. 203, 5 korrik 1929, 4.
[993] "Rregullorja e Kishës Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 214, 18 korrik 1929, 3.; Zoi Xoxa, "Rregullorja e Kishës Autoqefale Shqiptare", *Gazeta e Re* nr. 218, 23 korrik 1929, 1.

Tre krerët e parë të rregullores detajonin zgjedhjen dhe fuqitë e Këshillit Mikst, Këshillit të Përhershëm Ekonomik dhe Këshillit të Manastireve. Rregullorja sqaronte zgjedhjen e pleqësive kishtare, gjashtë anëtarët e të cilave votoheshin në dy nivele. Ata duhet të dinin të shkruanin dhe të lexonin shqip e të ishin së paku 30 vjeç. Pleqësitë e fshatrave mblidheshin nën drejtimin e meshtarit dhe qeverisnin pasuritë e kishave. Pleqësia emëronte kujdestarët, zgjidhte priftërinjtë dhe dhjakët, këqyrte mbarëvajtjen e kishës dhe hartonte buxhetin. Rregullorja caktonte rrogat, cilësitë, mënyrën e emërimit dhe detyrat e kujdestarëve. [994] Ajo vendoste mbi pagesat vullnetare dhe shënonte se një prift dërgohej nga Këshilli Disiplinor në manastir, nëse nuk përballonte dot jetesën. Ndërkaq, manastiret që nuk përballonin dot shpenzimet e kryemurgut përthitheshin nga manastiri më i afërt. Priftërinjtë, koret dhe psaltët që nuk përdornin shqipen në kishë do të pushoheshin. Po ashtu, Këshilli Mikst vendosi dërgimin e dy deri në katër studentëve në një fakultet teologjik të Perëndimit dhe themelimin e një seminari.[995]

Ndërkohë, Kuvendi Shqiptar kishte miratuar ligjin për bashkësitë fetare, më 16 korrik 1929. Ai i mundësonte shtetit të rriste atdhetarizmin, të mbikëqyrte të ardhurat dhe të shkarkonte drejtuesit e tyre. Masat synonin uljen e ndërhyrjes së jashtme ndaj katër bashkësive fetare shqiptare.[996] Bashkësitë fetare njiheshin si persona moralë, që gëzonin të gjitha të drejtat, përveç pjesëmarrjes në politikë. Statuti i tyre duhet të miratohej nga Këshilli i Ministrave dhe të shpallej nga Mbreti. Ndërkaq, krerët, ndihmësit dhe zëvendësit e tyre duhet të ishin me shtetësi, prejardhje dhe gjuhe shqiptarë dhe të dinin të shkruanin e të flisnin gjuhën zyrtare. Ata duhet të ishin mbi 25 vjeç dhe të mos kishin kryer vepra kundërkombëtare. Mbreti shpallte krerët e bashkësive dhe kishte të drejtë t'i shkarkonte, nëse vërente se shkelnin ligjin. Bashkësitë fetare nuk mund të merrnin të holla nga jashtë dhe duhet të siguronin miratim qeveritar për shpenzimet për qëllime humanitare. Ligji i ri parashikonte se statutet e bashkësive fetare do të shpalleshin nga Mbreti. Rrjedhimisht, Statuti i miratuar në Kongresin e Korçës, përpara ligjit, u botua në "Fletoren zyrtare" më 14 gusht 1929.[997]

Kështu, Kisha kishte plotësuar themelin e vet ligjor dhe ishte e gatshme të vijonte në rrugën e pavarur me një Sinodh të Shenjtë të miratuar nga një Kongres Kishtar, me pjesëmarrje mbarortodokse, me bekimin e shtetit dhe të qeverisë. Qëndrimi grek, këtë herë, nuk kishte qenë vendimtar...

4.4.Qëndrimi jugosllav në kundërshtitë shqiptaro-greke për KOASH-in

[994] Rroga e Kryepiskopit ishte 800 franga ari me një shpërblim shtesë prej 300 frangash ari në muaj; e episkopëve, 600 franga ari dhe e Ikonomit të Madh Mitrofor, 400 franga ari, përveç shtesës prej 100 frangash si anëtar i Sinodhit. Sekretari i Përgjithshëm merrte rrogë prej 300 frangash ari, llogaritari, 250, Sekretari 160, kopisti 150, dhjaku 120, shërbëtorët 100 dhe predikuesi 300. Anëtarët e Këshillit Mikst paguheshin 400 franga ari për mbledhje, ndërsa ata të këshillave ekonomik 10 franga ari për mbledhje. Rregullorja detajonte edhe rrogat e nëpunësve të episkopatave, nga 200 për Sekretarin, 100 për dhjakun, 80 për shërbëtorët dhe 30 për zëvendësit vendor. Ndërkaq, 600 franga liheshin për botimin e të përkohshmes.

[995] Xoxa, "Rregullorja e Kishës...", 1.

[996] Beqir Meta, "Debati shqiptarogrek për problemet e minoriteteve dhe të Kishës Autoqefale Shqiptare në organizmat ndërkombëtare në vitet 1929-1934", *Studime historike*, nr. 3-4 (Tiranë: Instituti i Historisë, 2011), 37-61.

[997] Valentina Duka, "Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut: një vështrim të legjislacionit të kohës (1928-1939", *Studime Albanologjike* 11:1 (2008), 48-54.

Baraspeshat e vendosura në Shkodër që në vitin 1923, me ndërhyrjen e Visarion Xhuvanit, kishin mundësuar krijimin e Sinodhit të Shenjtë, shtatë vite më vonë.[998] Legata greke e cilësonte qëndrimin e Hirësi Viktorit në Shqipëri si një mundësi trysnie serbe ndaj palës shqiptare, në fillimjanar 1924. Ministri grek shkruante se fitorja e Beogradit me vendosjen e Viktorit në Shkodër nënkuptonte se Patriarkana Serbe nuk do të pranonte njohjen e autoqefalisë shqiptare nga Patriarkana Ekumenike, me frikën se arritja jugosllave do të zhbëhej. Ndaj, udhëzonte që qeveria greke të merrte edhe mendimin e shtetit serb mbi çështjen e autoqefalisë.[999]

Mirëpo, pikëpamja e Greqisë ndaj zhvillimeve në Shkodër do të ndryshonte shumë shpejt. Mitropoliti i Korçës, Jerotheu, i pati rrëfyer në fundjanar 1925 se kishte zbuluar një marrëveshje ndërmjet drejtuesve të Kongresit të Beratit dhe Kishës Serbe për njohjen e autoqefalisë së Kishës Shqiptare, kur kishte mbërritur në Shqipëri. Jerotheu ia vishte kësaj marrëveshjeje pranimin e Hirësi Viktorit në Shkodër.[1000]

Drejtimi i Mitropolisë së Durrësit nga Hirësi Theofani nuk nxiti ndryshime, edhe pse Hirësi Viktori u përfshi në një ngatërresë politike. Qeveria shqiptare kishte vendosur të shpërndante misër për familjet e varfra në mbarë vendin dhe Episkopi iu ankua përfaqësuesit të Lidhjes së Kombeve se ortodoksët nevojtarë të atyshëm ishin anashkaluar. Hirësia i dorëzoi përfaqësuesit Kuenod listën e banorëve. Lista u përqas me atë të qeverisë dhe doli se Viktori kishte gënjyer. Megjithatë, Theofan Noli nuk mori asnjë masë, qoftë si Kryeministër, qoftë si Mitropolit.[1001]

Rikthimi i Zogut në pushtet rindezi përllogaritjet politike. Kisha Ortodokse do të vihej nën varësinë e Patriarkanës Serbe pas njëfarë kohe, sipas marrëveshjes me Jugosllavinë. Ujdia nuk njihej botërisht, por ndihma e dukshme e Serbisë ndaj Zogut bënte që Viktori të shihej ndryshe. Jerotheu kishte njoftuar Athinën se po përflitej plotësimi i vendit të zbrazët Mitropolitit të Durrësit, nga Viktori, si rrjedhojë e detyrimeve të Zogut ndaj Serbisë.[1002] Dorëzimi i Visarionit u përfol se nënkuptonte dorëzimin e dy anëtarëve të tjerë nga ai dhe Episkop Viktori. Ky plan shihte bekimin e kishave serbe dhe rumune për krijimin e Sinodhit të Shenjtë të Kishës Shqiptare.[1003]

Kërkesa e vetme për largimin e Hirësi Viktorit nga Shkodra u bë nga zëvendësmitropoliti i Durrësit, Arkimandrit Vangjel Çamçe, më 26 janar 1927.[1004] Mirëpo, asnjë veprim nuk u ndërmor. Gjendja do të ndryshonte kur shteti dhe kryepriftërinjtë e Kishës Shqiptare vendosën të trupëzonin njëanshmërisht Sinodhin me Joanidhin dhe Kotokon. Zgjidhja kombëtare nënkuptonte që edhe Kisha në Shkodër do të vendosej nën drejtimin e KOASH-it. Marko emëroi Arkimandrit Sofron Borovën si zëvendësmitropolit në Shkodër në gusht 1928. Ai shkoi për të marrë detyrën, por

[998] Çështja kishtare e Shkodrës është e ndërlikuar dhe nis me pavarësinë e shtetit shqiptar. Pjesa fillestare e kësaj çështjeje nuk është përfshirë në këtë punim, pasi nuk prek marrëdhëniet shqiptaro-greke. Ajo është botuar veçmas në: Ardit Bido, "The Church Issue of Shkodra between Albania and Yugoslavia in its Initial Phase (1912-1923)", *International Journal of Humanities and Social Science* ["Çështja kishtare e Shkodrës mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në periudhën e saj fillestare (1912-1923)", *Revista Ndërkombëtare e Humaniteteve dhe Shkencave* Shoqërore] 4:12 (2014).

[999] Kondis, *Elinizmos III*, 125: IDAYE, Ambasada e Durrësit drejtuar MPJG, 7 janar 1924, cit.

[1000] Kondis, *Elinizmos III*, 161: IDAYE, MPJG drejtuar Ambasadës së Durrësit, 4 shtator, cit.

[1001] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1924, Komiseria e Policisë drejtuar Prefekturës Shkodër, 8 korrik 1924.

[1002] Kondis, *Elinizmos III*, 196-207: IDAYE, Zyra e Tretë Politike MPJG drjetuar Zyrës së Parë Politike MPJG, 16 shkurt 1925, cit.

[1003] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 32.

[1004] AQSH, F. 155 "MD", V. 1927, D. 57, Mitropolia Durrës drejtuar MD, 26 janar 1927.

priftërinjtë dhe Viktori nuk pranuan dorëzimin e zëvendësisë.[1005] Borova u pranua vetëm pas ndërhyrjes shtetërore.[1006] Qeveria mendoi në tetor se zgjidhja më e mirë ishte emërimi i Episkop Visarion Xhuvanit si zëvendësmitropolit. Hirësia do të gjente edhe një herë një vend brenda KOASH-it, prej së cilës ishte dëbuar që kur ishte dorëzuar kryeprift dhe nga ana tjetër, do të pranohej më lehtë në zëvendësinë kryepriftërore, për shkak të ndikimit ndaj Hirësi Viktorit dhe politikës jugosllave. Atë Vasil Marko pranoi fillimisht.[1007] Mirëpo, ai shpalli më vonë se emërimi do të trondiste ngrehinën kishtare, duke cituar arsye dogmatike. Kryetari i Këshillit të Lartë sugjeroi që Hirësi Visarioni ta merrte me kryengritje Episkopatën e Shkodrës dhe Kisha ta njihte më vonë.[1008] Qeveria nuk shihte asnjë ndalim dogmatik, ndaj udhëzoi Atë Vasilin ta përfundonte emërimin sa më shpejt.[1009]

Hirësi Viktori kundërveproi. Ai nuk pranoi të largohej. Për më tepër, dorëzoi një dhjak në fshatin Vrakë në fund të tetorit, duke vepruar si episkop vendas, në kundërshtim me marrëveshjen e arritur, sipas së cilës ai do të ishte episkop i ftuar.[1010] Njëherazi, Serbia u orvat të çelte një ballë të dytë: Kryepiskopi i Ohrit emëroi një prift për trevën e Gollobordës, brenda shtetit shqiptar. Qeveria nuk pranoi hyrjen e priftit dhe vuri nën vërejtje veprimtarinë e Episkopit në Shkodër.[1011]

Mirëpo, zhvillimet në planin e brendshëm do t'i jepnin një rëndësi të papritur Hirësi Viktorit, duke vendosur në jetë frikën greke të fillimvitit 1925. Mënjanimi i të përzgjedhurve Joanidhi, Kotoko e Hirësive Joakimit, Jerotheut dhe Kristoforit lanë Episkop Visarionin me vetëm një mundësi për trupëzimin e Kishës. Ai thirri në ndihmë miqtë serbë e mbi të gjitha Hirësi Viktor Mihajloviçin, me të cilin dorëzoi të përzgjedhurit e tjerë për ngritjen e Sinodhit të Shenjtë. Marrëveshja ishte arritur me dijeninë e shtetit shqiptar. Pala serbe shprehej pak muaj më vonë se qeveria shqiptare i kishte premtuar përfaqësuesit jugosllav në Tiranë, Stanoje Mihajloviç, se do të ruhej gjendja në Shkodër dhe do të pranohej Hirësi Viktori si anëtar Sinodhi i KOASH-it.[1012]

Pa dyshim se pala shqiptare ka premtuar diçka, mirëpo vështirë që lëshimi të ketë qenë pranimi i Viktorit në Sinodh: Episkopi serb kishte pranuar dorëzimin e tre episkopëve, ndërkohë vetëm dy ishin të nevojshëm, nëse ai do të bëhej anëtar i trupit drejtues të Kishës. Për më tepër, shtypi i kohës e përmend praninë e Hirësisë si ndihmë shpirtërore të Patriarkanës Serbe. Kjo fjalëpërzgjedhje e fletoreve shqiptare do të haste kundërshtitë jugosllave e ndoshta ndërprerje të punimeve të mëtejshme, nëse marrëveshja do të parashihte përfshirjen e Viktorit në Sinodh. Për më tepër, mosdhënia shkoqur e një zotimi përkon me pohimet e Fortlumturi Visarionit dhe me falënderimet drejtuar Patriarkun serb për ndihmën e dhënë ndaj Kishës Shqiptare.[1013] Së fundmi, Patriarkana Serbe e mirëpriti lajmin e krijimit të Sinodhit, edhe pse Viktori nuk merrte pjesë. Madje, ajo premtoi njohjen e Kishës, çka tregon se Hirësia nuk përbënte kusht të Beogradit.

[1005] P. S., *Zëri i Korçës* nr. 320, 18 gusht 1928, 2.
[1006] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 73, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 22 tetor 1928.
[1007] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 65, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 17 tetor 1928.
[1008] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 70, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 19 tetor 1928.
[1009] AQSH, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 22 tetor 1928, cit.
[1010] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39, f. 173, MPB drejtuar Prefekturës Shkodër, 25 tetor 1928.
[1011] Shih AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 39.
[1012] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1928, D. 119/1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 7 dhjetor 1929.
[1013] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 16, MPJ drejtuar Ambasadës Serbe në Tiranë, 20 shkurt 1929.

Mbreti Zogu I denjoi Patriarkun serb, Dhimitrin, me "Kordonin e Madh të urdhrit të Skënderbeut", ndërsa Hirësi Viktorin me "Oficer i Madh i Urdhrit të Skënderbeut". Nderimi iu dorëzua Hirësi Viktorit në Tiranë më 25 shkurt.[1014] Dekorata i qe dorëzuar Patriarkut të Pejës, në këmbim me falënderimet e rastit, dy ditë më herët.[1015] Ministri shqiptar në Beograd, Rauf Fico, e takoi Kreun e Kishës Serbe më 23 shkurt. Patriarku i tha se Sinodhi i Shenjtë i Patriarkanës do ta njihte shumë shpejt autoqefalinë e KOASH-it. Dhimitri u ndal në rrezikun unit, që rritej prej marrëdhënieve të reja shqiptaro-italiane dhe u zotua se do ta udhëzonte Patriarkanën Ekumenike ta njihte Kishën Shqiptare.[1016]

Kisha Serbe kishte qëllime të veçanta në Shkodër, por ajo nuk mund të pengonte çështjen kishtare për pak qindra frymë sllavishtfolëse të Veriut të Shqipërisë. Lëvizja kishtare shqiptare shihej si një shqetësim mes Shqipërisë dhe Patriarkanës së Kostandinopojës e si pasojë edhe Greqisë. Rrjedhimisht, ndërhyrja serbe nënkuptonte që ajo do të dëmtonte rëndë synimet greke. Jugosllavia dhe Greqia nuk kishin më marrëdhëniet e dikurshme, kur arritën të dyfishonin sipërfaqen e tyre si bashkëluftuese përgjatë Luftërave Ballkanike. Kahkundërt, rënia e beftë e Greqisë pas luftës greko-turke kishte ndikuar me Jugosllavinë, njëtrajtësisht si me Shqipërinë. Beogradi e kishte parë dobësimin e Athinës si rastin e artë për arritjen e disa lëshimeve politike dhe ekonomike, që në kushte të tjera ishin të papërfytyrueshme.[1017]

Dy shtetet kishin mëtime të mëtejshme që prej mbarimit të Luftërave Ballkanike. Jugosllavia mëtonte daljen në Egje, duke u shtrirë përmbi gjithë Maqedoninë. Kërkesa përligjej me përbërjen e popullsisë së këtyre trojeve, ku kishte më shumë sllavë sesa grekë deri me Traktatin e Lozanës. Nga ana tjetër, Greqia mundohej të përfshinte në kombin grek sllavët që kishin qenë nën varësinë e Patriarkanës Ekumenike.[1018]

Prandaj, Jugosllavia vendosi një sërë çështjesh ndaj Greqisë, përfshi pakicat kombëtare dhe të drejtën për dalje në Skelën e Selanikut në vitet 1922-1926. Jugosllavia kërkoi në vitin 1924 që sllavët e Maqedonisë, përfshi edhe të Selanikut, të kishin mundësi të ndiqnin shkollat gjashtëvjeçare në serbisht. Ajo kërkoi vitin e ardhshëm që meshat e atyshme të zhvilloheshin në sllavonisht,[1019] me priftërinj të zgjedhur prej bashkësive vendore. Beogradi mëtonte që një ndër kishat kryesore të Selanikut, ajo e Shën Gjergjit, të shërbente posaçërisht për sllavët e qytetit.[1020]

Kërkesat serbe do të merreshin parasysh vetëm gjatë qeverisjes së Pangalosit, njëlloj si me çështjen kishtare shqiptare. Kryeministri grek me prejardhje arbërore cilësonte të domosdoshme marrëveshjen me Jugosllavinë, për të mbyllur njëherë e mirë vështirësitë e pazgjidhura me vendet fqinje. Ai u shpreh i gatshëm të pranonte kërkesat arsimore, kishtare, si edhe çështjen e Skelës së Selanikut. Pangalos udhëzoi Ministrinë e Arsimit të lejonte meshimin në sllavisht në Maqedoninë Greke, t'u njihej sllavishtfolësve

[1014] "Partike serb dhe Vikaris i tij u dekoruan", *Gazeta e Re* nr. 97, 26 shkurt 1929, 1.
[1015] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 22, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJ, 27 shkurt 1929.
[1016] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 20, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJ, 23 shkurt 1929.
[1017] Antonios Kulas, "Ελληνογιουγκοσλαβικές σχέσεις άπο το 1923 εώς το 1928 [Marrëdhëniet grekojugosllave nga 1923 deri më 1928]" (Disertacion, Universiteti i Selanikut, 2007), 102-117. Serbia shprehej se kishte 450 mijë serbë në Greqi, duke i quajtur sllavët e atyshëm serbë. Kërkesa e parë për meshim në sllavisht u bë më 6 maj 1925.
[1018] Po aty.
[1019] Sllavonishtja është gjuha e vjetër sllave, ose liturgjike e kishave sllave
[1020] Po aty.

e drejta e përzgjedhjes së priftërinjve, madje edhe pranimi i shkresave sllavishte para gjykatës.[1021]

Çështja më e rëndësishme ishte Skela në Selanik. Ajo do të merrte zgjidhje në kënaqje të Jugosllavisë me anë të marrëveshjes së miqësisë të nënshkruar nga ministrat e Jashtëm Rufo dhe Ançiç më 17 gusht 1926. Ujdia përcaktonte se një pjesë e madhe e Skelës së Selanikut do të kalonte nën sovranitetin jugosllav, ndërsa linja hekurudhore Selanik-Gjevgjeli do të qeverisej tërësisht nga Jugosllavia dhe një gjyqtar francez do të vendoste në rast përplasjesh mes palëve. Beogradit iu njoh mbrojtja e veçantë mbi Manastirin e Hinlandarit në Malin e Shenjtë. Ndërkaq, çështja e pakicave nuk do të trajtohej më ndërmjet Greqisë dhe Lidhjes së Kombeve, porse qeveria e Athinës do t'i përgjigjej Jugosllavisë, duke i lejuar ndërhyrjen në çështjet e brendshme të shtetit grek.[1022]

Këto përcaktime detyruan fuqitë venizeliste të Kondilit të ndërhynin ushtarakisht dhe të hidhnin qeverinë e Pangalosit. Ata do të shfuqizonin marrëveshjet shumë shpejt dhe do të mohonin çfarëdo të drejte kombëtare dhe fetare për popullsitë sllave. Rikthimi i Venizelosit në pushtet pas zgjedhjeve të vitit 1928 ndryshoi sërish baraspeshat. Kërkesat kombëtare dhe kishtare jugosllave dukej se nuk do të trajtoheshin. Mirëpo, mbrojtësja e Jugosllavisë dhe mbështetësja e Venizelosit, Franca, trysnoi që Kryeministri grek të riniste bisedimet me Beogradin për çështjen e Selanikut.[1023]

Në këtë sfond, çështja kishtare shqiptare gjeti fillimisht përkrahjen dhe pastaj kundërshtinë jugosllave. Mbështetja e Patriarkanës Serbe nuk erdhi vetëm si pasojë e të drejtave kishtare në Shkodër dhe as prej pranimit të Hirësi Viktorit. Ajo përbënte trysni ndaj palës greke. Madje, qenia e Hirësi Viktorit si anëtar i Sinodhit ishte dytësore dhe e parëndësishme për Jugosllavinë. Kështu, mëtimet serbe u kënaqën plotësisht, kur ai u emërua zëvendësmitropolit, pa qenë anëtar i Sinodhit, më 28 shkurt.[1024]

Hirësi Viktori u shoqërua prej Fortlumturi Visarionit deri në Vorë mëngjesin e asaj dite dhe u nis me vendmbërritje përfundimtare Jugosllavinë.[1025] Qeveria shqiptare i dha pëlqimin Kryepiskopit për ta emëruar Viktorin zëvendësmitropolit në Shkodër, në çastin e fundit. Visarioni sqaronte se episkopi serb do të ishte pjesë e KOASH-it, duke shkëputur lidhjet me kishat e huaja. Vendimi përligjej nga Statuti i Beratit, pasi Viktori ishte nënshtetas shqiptar. Sinodhi njoftonte se Hirësi Viktori filloi detyrën si ushtar besnik i Mbretit dhe Kishës.[1026] Qeveria udhëzoi zyrtarët vendas ta ndihmonin në veprimtarinë e tij dhe të falënderonin konsullatën jugosllave për ndihmën e dhënë.[1027] Detyra e re e Hirësi Viktorit u shpalos botërisht nga vetë Kryepiskopi, në vizitën e parë si kreu i kishës.[1028] Ai e paraqiti përpara grigjës më 13 mars, duke nënvizuar se Viktori kishte shërbim 15-vjeçar në Shkodër. Episkopi serb u lut për Mbretin e Shqiptarëve, Zogun I, Sinodhin dhe popullin.[1029]

[1021] Kulas, "Marrëdhëniet grekojugosllave...", 154.
[1022] Kulas, "Marrëdhëniet grekojugosllave...", 170-171.
[1023] Kulas, "Marrëdhëniet grekojugosllave...", 189-242.
[1024] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 257, Vendim emërimi, 28 shkurt 1929.
[1025] "Imzot Viktori u këthye në Jugosllavi", *Gazeta e Re* nr. 100, 1 mars 1929, 1.
[1026] "Imz. Viktori zëv. Mitropolit i Shkodrës", *Gazeta e Re* nr. 101, 2 mars 1929, 1.
[1027] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Shkodër, 28 shkurt 1929.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Shkodër, 1 mars 1929.
[1028] "Emz. V. Xhuvani u nis për në Shkodër dhe Emz. Agathangjeli për në Berat", 1.
[1029] V. K., "Kryetari i Synodhit të Shenjtë në Shkodër", 4.

Kënaqësia jugosllave u dallua menjëherë. Nënkryetari i Sinodhit të Patriarkanës Serbe, Mitropoliti i Cetinjës, Gabrieli, i dërgoi Hirësi Viktorit një urim, më 3 mars. Letra shprehte mbështetje për zhvillimet e fundit dhe shënonte se qenia e Mitropolit Visarionit në krye të lëvizjes kishte bërë që Kisha Serbe të pranonte kërkesën për pjesëmarrjen e Viktorit në dorëzimin e episkopëve. Trupëzimi i Kishës vlerësohej si arritje e madhe për Mbretërinë Shqiptare dhe mbarë ortodoksinë. Kisha Serbe përshëndeste dhe uronte Sinodhin e KOASH-it. Hirësi Gabrieli vlerësonte sfidat e brendshme për fuqizimin e Kishës, por shprehte sigurinë se themelet ishin vendosur me ndihmën e Perëndisë dhe vullnetin e Mbretit të Atdheut të ri të Viktorit. Kisha Serbe mbetej e hapur për të bashkëpunuar dhe për ta ndihmuar Kishën Shqiptare në të ardhmen.[1030] Bekimi i Kishës Serbe u pasqyrua si njohje e Kishës Shqiptare, ndërkohë që ato ditë botohej telegrami i dërguar nga Kisha Ruse në Mërgim që uronte Visarionin për krijimin e Sinodhit.[1031]

Dorëzimi i të gjithë episkopëve brenda shkurtit do të provohej se përbënte rastësi fatlume për Kishën Shqiptare. Dërgatat jugosllave dhe greke u rimblodhën në Lozanë për të biseduar për çështjen e Selanikut, në fund të atij muaji. Hirësi Krisanthos mbërriti në Beograd po atë ditë, në cilësinë e të dërguarit të Patriarkanës Ekumenike. Ai u takua me Patriarkun Dhimitri në fillim të marsit. Kreu i Kishës Serbe pohoi se dërgimi i Viktorit ishte kryer me lejen e tij, për të hedhur poshtë Protokollin e Tiranës që e shmangte Jugosllavinë. Vepra u krye për të vendosur kryepriftërinj të besuar si Fortlumturi Visarioni, që do t'i mundësonin Hirësi Viktorit qëndrimin në Shkodër.[1032]

Hirësi Krisanthos u prit nga Mbreti Aleksandër më 16 mars.[1033] Kryeprifti grek u shpreh se Protokolli i Tiranës i vitit 1926 siguronte të gjitha të drejtat e ortodoksëve dhe mbi të gjitha pamundësonte ndërhyrjen e shumicës myslimane në Kishë. Mbreti e siguroi Mitropolitin se do të bënte çmos që të mos dëmtoheshin marrëdhëniet e kishave të Kostandinopojës dhe Serbisë. Krisanthos kërcënoi se Patriarkana do të zhvishte Hirësi Viktorin nëse ai nuk kthehej në Shkodër, duke ndërprerë bashkëpunimin me zyrtarët shqiptarë. Ai mori përgjigjen pohuese nga Patriarkana Serbe në fund të qëndrimit në kryeqytetin jugosllav. Mitropoliti i Malit të Zi, Gabrieli, i shpalli Krisanthosit se Kisha e Serbisë nuk do ta njihte Kishën Shqiptare, do të kërkonte mosbashkëmeshimin e Viktorit me episkopët e tjerë dhe do ta qortonte për veprimet e parregullta.[1034]

Arsyeja e tërheqjes jugosllave nuk kishte të bënte fare me Shqipërinë. Qeveria dhe Patriarkana Serbe shpreheshin të sigurta në njohjen e autoqefalisë, ditët e para të Krisanthosit në Beograd.[1035] Vetë ministri jugosllav në Tiranë kishte lajmëruar Fortlumturi Visarionin më 10 mars se njohja ishte çështje e dy-tri ditëve.[1036] Ndryshimi i beftë i qëndrimit nuk kishte ardhur as nga kërcënimi i shkishërimit të Hirësi Viktorit e as nga udhëtimi atëror i Hirësi Krisanthosit. Kryeprifti grek kishte mbërritur në Beograd i pajisur me një njoftim të qeverisë greke ndaj zyrtarëve të vendit fqinj. Krisanthos ishte shprehur se nënshkrimi i marrëveshjes mbi Skelën e Selanikut do të shtyhej, nëse njihej

[1030] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Mitropolia Cetinjë drejtuar Episkop Viktorit, 3 mars 1929.
[1031] "Përgjigja e Shenjtërisë së Tij Patrikut të Sërbëve", *Gazeta e Re* nr. 112, 16 mars 1929, 1.; "Kisha Autoqefale Ruse uron Imzotin Visarion", *Gazeta e Re* nr. 113, 17 mars 1929, 1.
[1032] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 56-59.
[1033] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 68, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJ, 21 mars 1929.
[1034] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 56-59. Më vonë, Krisanthos takoi në Bukuresht Patriarkun Miron dhe në Varshavë Mitropolitin Dionisin që i premtuan mosnjohjen e Kishës Shqiptare.
[1035] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 40, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJ, 5 mars 1929.
[1036] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 960, f. 1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, pa datë.

Kisha Shqiptare. Mbreti dhe ministri i Jashtëm u tërhoqën përpara kërcënimit, edhe pse Kryeministri ishte kundër.[1037]

Bisedimet që po zhvilloheshin në Gjenevë përfunduan me marrëveshje të nesërmen e takimit mes Krisanthosit dhe Mbretit Jugosllav. Traktati i Miqësisë dhe Fqinjësisë së Mirë mes Greqisë dhe Jugosllavisë u nënshkrua në Beograd, më 27 mars. Marrëveshja i njihte Jugosllavisë të drejtën e përdorimit të posaçëm të zonës tregtare të Skelës së Selanikut, edhe pse nuk njihte sovranitetin e saj mbi të. Po ashtu, përcaktohej e drejta e përdorimit të posaçëm të lidhjes hekurudhore Selanik-Gjevgjeli.[1038]

Lajmi gjeti hapësirë të vogël në shtypin shqiptar, por ishte pikërisht kjo marrëveshje që i hoqi KOASH-it mundësinë e një njohjeje zyrtare.[1039] Çështja kishtare e Shkodrës mori tjetër drejtim. Qeveria shqiptare nuk kishte asnjë dëshirë t'i siguronte të drejta të posaçme Jugosllavisë, sidomos teksa qyteti i Shkodrës kishte popullsi ortodokse në shumicë shqiptare. Ndryshimet në marrëdhëniet greko-serbe ishin të dukshme dhe zotimet e Beogradit për njohjen e autoqefalisë ishin sa për sy e faqe gjithnjë e më shumë. Qeveria shqiptare ishte njoftuar në prill se Patriarkana Ekumenike e kishte marrë zotimin për mosnjohje të KOASH-it. Për më tepër, Patriarku serb kishte njoftuar se arsyeja e vetme pse nuk e zhveshi Viktorin ishte se ai kishte kaluar në varësi të Kishës Shqiptare.[1040]

Takimi që do ta zyrtarizonte gjendjen e re u krye në Beograd më 15 maj, mes ambasadorit shqiptar dhe ministrit të Jashtëm të Jugosllavisë. Ministri Jeftiç u shpreh se çështja kishtare ishte e përfunduar, por njohja nuk do të vinte shpejt. Ai kërkoi durim, pasi nuk mund t'i kërkonte Patriarkanës njohjen e shpejtë të KOASH-it për disa arsye.[1041]

Lajmërimi bëri që Shqipëria të ndryshonte qëndrim. Hirësi Viktori vijoi punët e përditshme si zëvendësmitropolit për tre muaj. Përplasja me qeverinë shqiptare do të vinte në kohën e kongresit kishtar. Qeveria sugjeroi dy emra gjatë përzgjedhjes së përfaqësuesve, por Hirësi Viktori nuk pranoi, duke u shprehur se ata nuk njiheshin nga besimtarët.[1042] Përfundimisht, u zgjodhën përfaqësues të tjerë, si një pajtim mes palëve. Episkopi serb u shfaq në Korçë gjatë punimeve të kongresit, duke habitur Kryepiskopin dhe zyrtarët. Viktori u shpreh se kishte shkuar si nismëtar i zgjidhjes së çështjes kishtare për t'i përgëzuar nga afër për ngadhënjimin e Autoqefalisë.[1043]

Mirëpo, qeveria shqiptare nuk dëshironte qëndrimin e Viktorit në Korçë. Prefekti Hil Mosi u urdhërua të ndalonte pjesëmarrjen e tij në punime dhe në meshën sinodhike.[1044] Hirësi Viktori u largua më 16 qershor për në Shkodër.[1045] Frika e qeverisë

[1037] AMPJ, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJ, 21 mars 1929, cit.
[1038] Kulas, "Marrëdhëniet grekojugosllave...", 189-242.
[1039] *Zëri i Korçës* nr. 386, 6 prill 1929, 1.
[1040] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/2, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 6 prill 1929.
[1041] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 158, Ambasada e Beogradit drejtuar MPB, 15 maj 1929.
[1042] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura e Shkodrës drejtuar MPB, 24 qershor 1929.
[1043] AQSH, Prefektura e Shkodrës drejtuar MPB, 24 qershor 1929, cit. Ai nuk ishte episkopi i vetëm që nuk ishte ftuar në Kongres. Hirësi Eugjeni qëndroi në Elbasan, teksa nuk ishte zgjedhur fuqiplotë.
[1044] Xoxa, *Kujtimet*, 133.
[1045] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Elbasan, 16 qershor 1929; Zoi Xoxa shkruan në kujtime se Visarioni e thirri në zyrë Viktorin dhe i tha: "Sivëlla fort i nderuar, kam një lajm të hidhur për t'ju komunikuar. Prefekti, zoti Hil Mosi, ka marrë këtë telegram nga qeveria". Fortlumturia përktheu çalë telegramin në serbisht. Viktori i kujtoi zëdridhur zotimet e bëra, përfshi dhe të qenit anëtar i Sinodhit, duke përfunduar me një çurg lotësh që i rodhën në faqe. "Po ç'të bëj? Edhe mua më rrejtën", – iu përgjigj Visarioni. Hirësi Viktori u largua nga Korça më 16 qershor, ditën e nisjes së

shqiptare u provua e vërtetë. Përfaqësuesit e Shkodrës në Kongresin e Korçës dorëzuan një qarje për mospjesëmarrjen e Viktorit dhe kërkuan që episkopi i tyre të bëhej anëtar i Sinodhit, priftërinjtë vendas të ishin sllavë dhe festat të kremtoheshin sipas kalendarit të vjetër, siç ndodhte në të gjitha kishat sllave.[1046] Përfaqësuesi qeveritar, Vasil Bidoshi, ndaloi leximin e qarjes përpara kongresit.[1047]

Një ndër nenet më kryesore të Statutit prekte drejtpërsëdrejti Hirësi Viktorin. Neni 16 përcaktonte se mitropolitët, zëvendësmitropolitët dhe Kryepiskopi duhet të ishin shqiptarë prej nënshtetësie, gjaku dhe gjuhe. Kjo nënkuptonte se Episkop Viktori nuk mund të ishte më zëvendësmitropolit, pasi kishte prejardhje malazeze. Atë Velisha kërkoi fjalën për të ringritur çështjen ditën e fundit të punimeve, por Bidoshi nuk e lejoi sërish. Përfundimisht, prifti i Vrakës nuk pranoi të nënshkruante Statutin.[1048]

Shërbesa për Statutin e Kishës u drejtua në Shkodër nga Hirësi Viktori dhe Atë Miho Strikiç, i cili lexoi shpalljen për krijimin e plotë të Kishës Autoqefale.[1049] Shpallja nënkuptonte shkarkimin e episkopit, si joshqiptar prej gjaku dhe gjuhe. Prefekti Kol Rodhe thirri kryepriftin në zyrë më 28 gusht dhe e pyeti në cilin prej manastireve të Shqipërisë dëshironte të banonte. Në të kundërt, do të largohej jashtë vendit. Sinodhi i Shenjtë kishte emëruar zëvendësmitropolit të Shkodrës Atë Josif Qiricin, që edhe këtë herë do të merrte një sfidë të veçantë.[1050] Kryqmbajtës Josifi mbërriti në Shkodër më 1 shtator, i pritur nga të gjithë zyrtarët vendas.[1051]

Hirësi Viktori u emërua kryemurg i Manastirit të Shën Vlashit në Durrës. Episkopit iu caktua një rrogë pensioni prej 400 frangash ari, si edhe u emërua anëtar i Komisionit të Përkthimeve të Librave Kishtar në Shqip, si njohës i sllavishtes.[1052] Ai qëndroi zyrtarisht si kryemurg vetëm tetë ditë dhe kërkoi pasaportën më 10 shtator me qëllim udhëtimin për në Jugosllavi.[1053] Edhe Atë Josifi nuk do të qëndronte shumë kohë në Shkodër. Ai u zëvendësua si zëvendësmitropolit nga Episkopi Titullar i Peshkopisë, Hirësi Eugjeni, në tetor 1929; një përpjekje për të ringritur frymën e ortodoksëve të qytetit, duke riemëruar një episkop në drejtimin e tyre. "Gazeta e Re" niste shkrimin përkatës me "sëmundjen" e Hirësi Viktorit, një fatkeqësi, që detyroi Kishën ta zëvendësonte me Eugjenin.[1054]

---

punimeve të Kongresit (Xoxa, Kujtimet, 133). Megjithatë, "Gazeta e Re" shkruante se Hirësi Viktori kishte marrë pjesë në meshën sinodhike. Është e paqartë nëse ikja e tij nga Korça ndodhi para apo pas meshës. Kujtimet e Xoxës e shënojnë para meshës, bashkë me fjalinë e prerë se "Hirësi Viktori nuk mori pjesë në meshë" (Xoxa, *Kujtimet*, 133). Ndërsa "Zëri i Korçës" botonte më 18 qershor se Hirësi Viktori kishte marrë pjesë ("Ceremonia e çelljes së kongresit panorthodhoks shqiptar", *Zëri i Korçës* nr. 406, 18 qershor 1929, 1).

[1046] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 22 qershor 1929.

[1047] AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. VIII-86, f. 49, Vasil Bidoshi drejtuar MD, 22 qershor 1929.

[1048] AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. VIII-86, f. 49, Vasil Bidoshi drejtuar MD, 1 korrik 1929.

[1049] "Nji te deum në Kishën Orthodhokse për përfundimin e Statutit", 3.

[1050] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Shkodër drejtuar MPB, 28 gusht 1929.

[1051] "Zavendës mitropoliti i ri në Shkodër", *Gazeta e Re* nr. 253, 3 shtator 1929, 4.

[1052] Anëtarët e tjerë të komisionit ishin dr. Zoi Xoxa për rumanishten, prof. Mihal Sherko për rusishten, prof. Sotir Papahristo dhe prof. Konda për greqishten dhe prof. Aleksandër Xhuvani dhe Kostaq Cipo për shqipen. "Stavrofor Atë Josifi Zev. Mitropolit i Shkodrës", *Gazeta e Re* nr. 254, 4 shtator 1929, 4.

[1053] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Shkodër drejtuar MPB, 10 shtator 1929.

[1054] "Zgjedhja e Emzot Eugjenit për Episkop të Shkodrës dhe shvillimi fetar i komunitetit Orthodoks të këtushëm", *Gazeta e Re* nr. 293, 20 tetor 1929, 3.

Shqiptarizimi i Kishës në Shkodër ishte vendosur, duke ndjekur shembullin e Dibrës, ku një prift atdhetar ishte dërguar për të meshuar shqip, prej korrikut 1929.[1055] Korçari Atë Stavro Kanxheri u nis bashkë me Hirësi Eugjenin. Kanxheri njoftonte drejtpërdrejt dhe kishte mbështetjen e plotë të Kryeministrit Kota. Madje, qeveria iu kundërpërgjigj ashpër Kryepiskop Visarionit, kur ai u përpoq ta zhvendoste në qytet tjetër, në fillimdhjetor. Visarioni e shfuqizoi menjëherë urdhrin dhe siguroi qeverinë për besnikërinë e tij.[1056]

Atë Stavro ia doli të meshonte në gjuhën amtare të shumicës së besimtarëve brenda pak kohësh. Prifti vendas, Atë Miho Strikiç, ishte i bindur ndaj Kishës e qeverisë dhe ndihmoi në orvatjen për shqiptarizim.[1057] Pashkët e vitit 1930 ishin të parat që u kremtuan në shqip. Krahas zyrtarëve, morën pjesë të gjithë ortodoksët, përfshi dhe pak shtëpi sllavishtfolëse të qytetit.[1058]

Gjendja ishte më e ndërlikuar në Vrakë, ku banonte një popullsi ortodokse tërësisht me prejardhje malazeze. Atë Velisha Popoviç dhe tetë të tjerë u ndaluan nga policia për qëndrim kundërkombëtar në fundvitin 1929.[1059] Ai u dërgua në Manastirin e Shën Joan Vladimirit në Elbasan. Hirësi Viktori i kërkoi Patriarkut Dhimitri të ndërhynte për lirimin e Velishës dhe lejimin e sllavishtes në Shkodër. Pasardhësi i Dhimitrit, Varnava, i kërkoi qeverisë shqiptare lirimin e priftit në fillimvitin 1930.[1060] Qeveria kishte dërguar Atë Erazmi Jorgon në Vrakë, por banorët nuk pranuan, duke varrosur pa prift një bashkëfshatar të tyre, në shenjë kundërshtimi ndaj mosmeshimit në sllavisht. Atë Velisha u rikthye në Vrakë, në maj 1930, pas tetë muajsh dënimi në Elbasan.[1061]

Hirësi Viktori do të kthehej për herë të fundit në Shkodër në mes të shtatorit 1930. Mirëpo, të gjithë i kishte kundër këtë herë. Fjalët se Viktori mund të ripërfshihej në KOASH trembën korçarët.[1062] Fortlumturi Visarioni ishte në ballë të betejës për mospranimin e Viktorit. Ai qortoi zyrtarët shqiptarë në Beograd që i kishin dhënë shkresat për t'u kthyer, pavarësisht mundimeve të mëdha që Kryepiskopi kishte bërë në dobi të atdhetarisë për ta larguar.[1063]

Fortlumturia i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë më 20 shtator dëbimin e Hirësi Viktorit, duke vënë në pah se prania e tij kishte lënë shije të hidhur në popullsinë ortodokse. Visarioni theksonte se qeveria duhet të kishte lajmëruar paraprakisht kryesinë e Sinodhit për të përgatitur mendimin shoqëror nëse do të dëshironte rikthimin e episkopit serb.[1064] Trysnia bëri që qeveria të shtirej se vizita e Hirësi Viktorit u krye për çështje vetjake, ndërsa Visarioni rendi të shpallte se bëri gjithçka që ishte e mundur që episkopi serb të largohej i kënaqur. Përfundimisht, Viktori iku më 15 tetor, për të mos u

[1055] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, KOASH drejtuar MPB, 21 korrik 1929.
[1056] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 7 dhjetor 1929.
[1057] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Atë Stavro Kanxheri drejtuar Kryeministrit, 8 nëntor 1929.
[1058] "Për herën e parë orthodhoksët e Shkodrës meshojnë shqip", *Zëri i Korçës* nr. 498, 10 maj 1930, 2.
[1059] AQSH, Atë Stavro Kanxheri drejtuar Kryeministrit, 8 nëntor 1929, cit.
[1060] Dimitrije M. Kalezić, "Srpske škole u Albaniji [Shkollat serbe në Shqipëri]", Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore "Popullësia me origjinë sllave në Shqipëri", Cetinjë, Mali i Zi, 21-23 qershor 1990.
[1061] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-127, f. 11-15, KOASH drejtuar MD, maj 1930.
[1062] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-123, f. 6, KOASH drejtuar MD, 18 shtator 1930.
[1063] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 260, KOASH drejtuar MPB, shtator 1930.
[1064] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-123, f. 3, KOASH drejtuar MD, 20 shtator 1930.

kthyer më.[1065] Ai do të ndërronte jetë në Manastirin e Deçanit, në Kosovë, më 8 shtator 1938.[1066]

Beteja shqiptaro-serbe për Kishën në Shkodër, Vrakë dhe Dibër mori fund dhe mesha mbahej vetëm në shqip prej atij çasti.[1067] Shqiptarizimi u pasqyrua nga KOASH-i, si një ndër arritjet kryesore në vitin e parë të trupëzimit të Sinodhit.[1068] Fortlumturi Visarioni kujtonte gjithnjë se kishte dëbuar Hirësi Viktorin për dobinë e kombit dhe atdhetarisë, kur quhej proserb nga armiqtë.[1069] Fundi i rrëfenjës serbo-shqiptare kishte lënë vetëm një rrugëzgjidhje: njohjen e KOASH-it nga Patriarkana Ekumenike...

4.5.Kundërveprimet e Patriarkanës, shtetit grek dhe mërgatës shqiptare

Qeveria e Athinës shprehej zyrtarisht e paanshme. Madje, pati raste kur diplomatë të saj e mbështesnin qëndrimin e Tiranës, në takime me zyrtarët shqiptarë. Ambasadori grek në Romë, Mavrudhi, iu shpreh Milto Tutulanit se përballja me murgjit ishte e zorshme, pasi ata nuk u ndaheshin kurrë metodave bizantine. Ai tha se qeveria greke kishte hasur vështirësi derisa zgjidhi çështjen e trojeve të përvetësuara pas Luftërave Ballkanike. Mavrudhi theksoi se askush nuk mund të përzihej në çështjen e brendshme të Shqipërisë.[1070]

Ky qëndrim ishte sa për sy e faqe. Qeveria greke parapëlqeu të heshtte muajt e parë, por thuri një sulm ballor të shtypit grek, të "vorioepirotëve" të Athinës, të proshqiptarëve të Greqisë, si edhe sajoi kundërshtime në emër të Hirësi Jerotheut. Patriarkana Ekumenike bënte të ditur se kishte marrë zotime nga qeveria greke për t'i nxjerrë pengesa Shqipërisë në fushën politike. Ajo ngriti një komision të posaçëm, drejtuar nga Episkopët Gjermanos, Polikarpi dhe Foti dhe një sërë përfaqësuesish të pakicës greke e ortodoksësh shqiptarë grekomanë.[1071]

Patriarkana u nisi një letër të gjitha kishave autoqefale më 21 shkurt. Ajo njoftonte se disa priftërinj kundërshtarë kishin bashkëpunuar me një kryeprift të huaj dhe vijuan me dorëzimin e parregullt e të pashenjtë të episkopëve, pavarësisht se Kisha Mëmë kishte bërë të gjitha përpjekjet për shpalljen e rregullt të autoqefalisë.[1072]

Patriarku Vasili shprehu habinë për dorëzimin "grushtshtetas johyjnor të episkopëve", në kundërshtim me Protokollin e Tiranës. Ai u kujtoi zyrtarëve shqiptarë se Patriarkana ishte pushteti më i lartë kishtar për besimtarët në Shqipëri, i quajti të paqena dorëzimet dhe rrëzoi fajtorët: Fortlumturi Visarionin dhe Hirësitë Agathangjelin, Eugjenin e Ambrozin. Patriarku kërkoi nga qeveria shqiptare të merrte masa për nderimin e Protokollit të Tiranës dhe parandalimin e turbullirës së dëmshme kishtare.[1073]

[1065] "Episkopi Imzot Viktori u kthye përsëri n'Atdhen'e vet", *Zëri i Korçës* nr. 544, 18 tetor 1930, 1.
[1066] Kalezić, "Shkollat serbe", 10.
[1067] Kjo do të zgjaste deri në vitin 1967. Fotlumturi Visarioni vendosi të lejonte kthimin e festave në kalendarin e vjetër në vitin 1934. Mirëpo, e shfuqizoi vendimin pas kundërshtimit qeveriar. AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-315, f. 1, Prefektura Shkodër drejtuar MPB, 28 dhjetor 1934.
[1068] "Deklaratë zyrtare mbi vepërimet e Kishës Autoeqefale", *Zëri i Korçës* nr. 475, 15 shkurt 1930, 1.
[1069] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1932, D. 256, KOASH drejtuar MPB, 10 shkurt 1932.
[1070] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 44, Ambasada e Romës drejtuar MPJ, 2 mars 1929.
[1071] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 99, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 6 prill 1929.
[1072] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 181-199, Patriarku Vasili drejtuar të gjitha Kishave, 21 shkurt 1929.
[1073] Glavina, *Dokumente 1929*, 15.

Patriarku dhe Sinodhi i Shenjtë i dërguan një qarkore popullit shqiptar, pas katër ditësh, këtë herë edhe në shqip. Qarkorja shënonte dhembshurinë dhe dashurinë e Patriarkanës ndaj ortodoksëve në Shqipëri dhe pasqyronte qëndrimin e saj mbi ndodhitë. Ajo shprehej se qeveria shqiptare ishte fajtore për moszbatimin e Protokollit të Tiranës dhe u drejtohej me fyerje episkopëve të dorëzuar.[1074] Patriarkana i dërgoi një kopje të qarkores Hirësi Jerotheut, për t'ia lexuar popullit. Në pamundësi, Mitropoliti i rrëzuar i Korçës ia ngarkoi detyrën Pandeli Kotokos.[1075] Qeveria greke shpallte botërisht se nuk përfshihej, por konsullatat në Shqipëri shpërndanin qarkoren dhe udhëzimet përkatëse.[1076]

Patriarkana Ekumenike mori masa për mosnjohjen e Kishës Shqiptare nga simotrat e tjera në mbledhjen e radhës së Sinodhit, më 5 mars. Ajo vendosi rrëzimin edhe të Ikonomit të Madh Mitrofor, Atë Vasil Markos, dhe urdhëroi dërgimin e Hirësi Krisanthosit në Beograd, Bukuresht dhe Varshavë.[1077] Kisha Mëmë përsëriti thirrjen me një gjuhë më të ashpër ndaj kryepriftërinjve. Ajo i quajti "bandë e pathemeltë kundërshtarësh", të cilët gjetën përkrahjen e qeverisë shqiptare, pa mbështetje nga ortodoksët. Sinodhi nënvizonte se qeveria kishte veçuar Hirësi Kristoforin dhe kishte dëbuar Hirësi Jerotheun.[1078]

Patriarkana ishte e sigurt se nuk do të haste vështirësi me kishat e Jeruzalemit, Greqisë, Qipros, Antiokisë dhe Aleksandrisë, teksa ato ishin pjesë e Kishës Greke Ortodokse, pra drejtoheshin nga kryepriftërinj grekë dhe prisnin udhërrëfimet e Ministrisë së Jashtme të Greqisë. Kryepiskopi i Greqisë, Krisostomi, e quajti ndodhinë grusht shteti dhe episkopët të paudhë. Ai sulmoi Fortlumturi Visarionin, duke thënë se ndaj tij rëndonin padi që kur kishte qenë Arkimandrit në Kishën Greke në Sofje, edhe pse nuk bëri të ditur se për çfarë përgojohej.[1079] Po ashtu, qëndrimi i Patriarkanës Ekumenike u përshëndet nga Kryepiskopi i Qipros dhe Patriarku i Aleksandrisë, Meleti, i cili iu qa Lidhjes së Kombeve. Drejtuesi i Kishës së Afrikës i dërgoi letër edhe Mbretit Zogu I më 13 prill. Meleti kërkoi ndalimin e përndjekjes ndaj ortodoksisë, në mënyrë që të mos mendohej se shteti i ri nuk kishte frymën e nderimit të lirisë fetare.[1080]

Vajtja e një kryeprifti në Patriarkanën Ruse ishte e pamundur, për shkak të sundimit komunist të Bashkimit Sovjetik. Kështu, kërcënimi i vërtetë mund të vinte nga patriarkanat serbe e rumune dhe nga Kisha e sapokrijuar Autoqefale e Polonisë. Kishat

---

[1074] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 201-206, Qarkore drejtuar popullit ortodoks të Shqipërisë, 25 shkurt 1929.

[1075] Glavina, *Dokumente 1929*, 21-23.

[1076] Besimtarët ortodoksë padisnin raste të tilla te zyrtarët vendas. Prefekti i Vlorës siguroi një qarkore të shkruar vetëm në greqisht (Qarkorja ruhet në AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 165-167.), që i ishte përcjellë konsullatës së Vlorës nga Legata e Tiranës më 20 prill 1929 (AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 164, MPB drejtuar MPJ, 6 qershor 1929.). Sekretari i konsullatës greke, Milto Zerva, ia kishte dorëzuar besimtarit Dhimitër Mano, nga Narta, fshati i vetëm i pakicës greke në Vlorë. Zerva e kishte udhëzuar Manon t'ia jepte kujdestarit të Kishës, Vasil Shtatos. Qarkorja ishte e shkruar në greqishten e vjetër, prandaj Shtato ia dha për lexim priftit të fshatit Atë Kristoforit, i vetmi që mund ta përkthente. Prifti ia paraqiti menjëherë kryetarit të komunës Nartë, i cilli ia përcolli prefektit, kur u njoh me përmbajtjen (AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 168-170, Procesverbali i Prefektit Kryeziu.). Qeveria shqiptare dënoi Legatën Greke për ndërhyrje në çështjen kishtare, mirëpo nuk kërkoi dëbimin e konsullit, duke mos pasur mjaftueshëm vërtetime (AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 183, MPJ drejtuar Legatës Greke në Tiranë, 8 qershor 1929.).

[1077] Vendimet u morën në bazë të sugjerimeve të Komisionit për çështjen shqiptare. Glavina, *Dokumente 1929*, 25.

[1078] Glavina, *Dokumente 1929*, 26-27. AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 181-199, Revista Ortodoksia.

[1079] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 77, Fletorja Progres, 9 mars 1929.

[1080] Glavina, *Dokumente 1929*, 31-37.

jogreke qëndruan të paanshme dhe shpeshherë shprehën mirëkuptim ndaj çështjes kishtare shqiptare. Sinodhi i Patriarkanës së Bashkimit Sovjetik u shpreh fillimisht se autoqefalia e Kishës Shqiptare përmbante pikëpyetje ligjshmërie porsi autoqefalitë e kishave që dikur ishin pjesë e Perandorisë Ruse. Ai shtoi pas një jave se vlerësonte parimin e autoqefalisë sipas kanonit apostolik nr. 34, që caktonte se çdo shtet duhet të kishte kishën e vet. Kisha Ruse shprehej se nuk mund të fliste për rregullsinë e rastit shqiptar, sepse nuk e njihte, por kallëzonte se shembulli i ndjekur në Poloni mund të shërbente si themel për autoqefalinë.[1081] Thumbimi vinte pasi Patriarkana e Kostandinopojës kishte vepruar me shpejtësi dhe pa kushte në njohjen e autoqefalisë në rastin polak, vetëm për ta hequr nga varësia e Patriarkanës Ruse, duke u nisur nga parimi "Kishë e pavarur në shtet të pavarur".

Hirësi Krisanthosi ia doli, pasi siguroi mosnjohjen nga Patriarkana Serbe. Kishat rumune dhe polake nuk do të dilnin të vetme kundër të gjitha kishave të tjera. Takimi i Hirësi Krisanthosit me Patriarkun e Bukureshtit, Miron, i vendosi vulën mospranimit të kërkesës shqiptare. Kreu i Kishës Kombëtare Rumune u zotua se nuk do të ishte i pari që do të merrte vendimin e njohjes.[1082] Qëndrimi shkonte përtej mirëdashjes që krerët rumunë shprehnin haptazi ndaj çështjes kishtare shqiptare. Konsulli në Stamboll, Juanesko, vlerësonte se qëndrimi shqiptar ishte i arsyeshëm, i pëlqyer dhe i rregullt, por Patriarkana Ekumenike nuk do ta njihte KOASH-in, pasi ishte vegël e shtetit grek.[1083]

I fundit në radhën e drejtuesve kishtarë, Mitropoliti i Varshavës, u tregua i matur. Ai i tha Hirësi Krisanthosit që nuk do ta njihte autoqefalinë shqiptare, por në letrën që i drejtoi Patriarkut nuk rendi të sulmonte kishën e re. Mitropoliti shënonte pa hollësi se mori sqarimet e Krisanthosit dhe nuk do t'i përgjigjej kërkesës së Fortlumturi Visarionit.[1084]

Arsyetimet e Patriarkanës Ekumenike ishin bazuar në lajmërimet e përcjella prej Hirësi Jerotheut. Mitropoliti i Korçës kishte varur shpresat te ndihma jugosllave, përpara se të rrëzohej. Ai kishte vizituar dy herë konsullatën jugosllave në Korçë për të biseduar rreth çështjes kishtare.[1085] Mirëpo, as këto takime nuk ishin të frytshme. Hirësi Jerotheu nuk ndoqi rrugën e Hirësi Kristoforit, i cili zgjodhi të mbyllej në manastir në Shqipëri, pas urdhrit qeveritar për mënjanimin e dy mitropolitëve. Prefekti Rexhep Jella i dorëzoi Mitropolitit njoftimin qeveritar, sipas të cilit ai mund të qëndronte në vendlindje, Çarshovë, ose në një manastir të përzgjedhjes së tij, më 27 shkurt.[1086] Mirëpo, Jerotheu kërkoi pasaportën për të udhëtuar jashtë vendit.[1087]

Ai u nis për në Greqi, nëpërmjet Kapshticës, më 5 mars, i shoqëruar nga priftërinjtë e Mitropolisë.[1088] Jerotheu kishte thënë se do të shkonte në Stamboll, por pala shqiptare ishte lajmëruar se qëllimi i tij ishte të qëndronte në shtetin fqinj.[1089] Hirësia i

[1081] Glavina, *Dokumente 1929,* 32-35.
[1082] Tasudhis, *Kujtime biografike,* 56-59.
[1083] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 118, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 17 prill 1929.
[1084] Glavina, *Dokumente 1929,* 40-41.
[1085] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 18 shkurt 1929.
[1086] Glavina, *Dokumente 1929,* 24.
[1087] AQSH, F 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 1 mars 1929.
[1088] *Zëri i Korçës* nr. 377, 5 mars 1929, 4.
[1089] "Ish Mitropoliti Imz. Ierotheos shkon në Greqi", *Gazeta e Re* nr. 106, 8 mars 1929, 2.

dorëzoi dhjakut që e shoqëronte një telegram përpara se të ikte, me udhëzimin që t'ia niste menjëherë Mbretit Zogu I.[1090]

Ai shkruante se i linte lamtumirën e fundit Atdheut të dashur me hidhërim të madh, duke dalë jashtë kufirit pas një urdhri të paligjshëm qeveritar. Jerotheu falënderoi Mbretin për aq sa kishte dëgjuar prej gojës së tij për lartësimin dhe mbarëvajtjen e ortodoksisë, e cila kishte krijuar shtetin dhe dëshironte përparimin e kombit me gjallërinë e bijve të saj. Telegrami përfundonte me urimet e përzemërta për Mbretin dhe Kishën.[1091] Dhjaku që kishte porositur Hirësia për ta dorëzuar, i kërkoi paraprakisht leje prefektit. Jella ia përcolli Ministrisë së Brendshme, që t'ia përçonte fshehtazi Zogut. Prefekti përgënjeshtronte Jerotheun se shteti e shtrëngoi të ikte. Sipas tij, vetë Mitropoliti kërkoi të largohej nga Atdheu.[1092]

Hirësi Jerotheu nuk hasi pritje më të mirë në Greqi. Qeveria e Athinës e urdhëroi të qëndronte në Follorinë, afër kufirit, nën mbikëqyrjen e prefektit të atyshëm. Ai u mirëprit nga Mitropoliti i Follorinës vetëm për dy javë dhe u detyrua të zhvendosej në hotel prej mesmarsit. Jerotheu shprehu gatishmërinë për të shkuar në Athinë dhe për të ndihmuar zgjidhjen e çështjes kishtare. Mirëpo, qeveria greke e kanosi se qëndrimi i tij në Greqi nuk kishte asnjë arsye, nëse lëvizte nga Follorina. Hirësia u gjend në rrethana të palakmueshme. Ai i shkroi Patriarkut Ekumenik se qëndrimi në një fjetore në Follorinë ishte fyerje për cilësinë kryepriftërore. Prandaj, Jerotheu u lut të shkonte në Malin e Shenjtë, larg vëmendjes së njerëzve, fyerjes që i ishte bërë, duke e lënë në hotel, dhe mospranimit në asnjë shërbim tjetër, qoftë dhe në Mitropolinë e Militupojës që qëndronte e zbrazët duke e pritur.[1093]

Ishte e qartë se Hirësi Jerotheu nuk i duhej Athinës dhe Patriarkanës. Veprimtaria atdhetare shqiptare e kishte bërë të dyshimtë për palën greke. Patriarkana zbatoi sërish dëshirat e Athinës dhe Hirësi Jerotheu nuk u kthye kurrë në një detyrë kryepriftërore. Ndryshimi me Hirësi Kristoforin ishte i dukshëm. Mitropoliti i rrëzuar i Beratit qëndroi i mbyllur në Manastir në Shqipëri dhe pas pak vjetësh do të merrte kryesimin e Kishës Shqiptare, si shpërblim për veprimtarinë atdhetare. Hirësi Jerotheu iku nga Shqipëria me bindjen se e priste një emërim. Mirëpo, ai do të përfundonte në Malin e Shenjtë, si episkopi i vetëm i shtetit murgjëror, për plot 30 vjet, derisa ndërroi jetë në vitin 1965.[1094]

Njëherazi, Athina do të përdorte emrin e tij për të vijuar lojën politike me Shqipërinë. Qeveria greke sajoi disa qarje në Lidhjen e Kombeve në emër të Hirësi Jerotheut. Mirëpo, ato nuk ishin shkruar prej tij. Jerotheu pohon se qeveria greke i bëri një kërkesë të veçantë, që ai e plotësoi. Mitropoliti u dorëzoi zyrtarëve shtetërorë 100 letra të bardha të nënshkruara dhe vulosura, që qeveria greke t'i përdorte siç dëshironte.[1095]

Qarja e parë e nënshkruar në emër të Jerotheut u dorëzua në Lidhjen e Kombeve, më 6 mars. Ajo shënonte se Hirësia ishte dëbuar nga trualli shqiptar dhe kërkonte

---

[1090] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 4, Prefektura Korçë drejtuar MPB, pa datë.
[1091] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119, f. 34, Mitropoliti Jerotheu drejtuar Mbretit Zogu, pa datë.
[1092] Prefektura Korçë drejtuar MPB, pa datë, cit. Shtypi i atyre ditëve do ta përforconte se Jerotheu qe dëbuar (AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 41, Telegram, 8 mars 1929), mirëpo vetë Hirësia pranon në parashtresën që i dërgoi Patriarkut se kishte kërkuar vetë pasaportën që të largohej. (Glavina, *Dokumente 1929*, 52-54).
[1093] Glavina, *Dokumente 1929*, 52-54: Jerotheu drejtuar Patriarkut, 20 mars 1929.
[1094] Ilia Spiro Vasili, "Si e gjeta Episkop Jerotheos", *Ngjallja* nr. 8, gusht 1996, 9.
[1095] Glavina, *Dokumente 1929*, 50: Jerotheu drejtuar Patriarkut, 13 mars 1929.

ndërhyrjen e menjëhershme të Lidhjes për të ndihmuar grigjën e rrezikuar.[1096] Parashtresa ishte sajuar nga Ministria e Jashtme e Greqisë nga 100 letrat e nënshkruara dhe të vulosura, teksa nënshkruhej "Kryepiskopi i Korçës", cilësi që një kryeprift si Jerotheu nuk do të guxonte kurrë ta mbante në mënyrë të parregullt. Ajo solli fillimisht kundërveprimin ndërkombëtar, si të ishte e shkruar prej vetë Jerotheut. Sekretari i Lidhjes së Kombeve, Drumond, ua përcolli vendeve anëtare dhe kërkoi sqarime nga qeveria shqiptare më 25 mars.[1097] Zëvendësisht Ministri i Jashtëm, Mihal Turtulli, u përgjigj se Mitropoliti kishte ikur me vullnetin e tij për në Greqi, kur pa se nuk mund të vijonte më rrëmujën kishtare. Turtulli e quante të papërputhshme me të vërtetën pandehjen se ai u dëbua.[1098]

Qeveria greke paditi sërish palën shqiptare më 17 prill, duke përdorur emrin e Hirësi Jerotheut. Qarja shkruante se populli ortodoks shqiptar iu nënshtrua dhunshëm një rendi kishtar. Ajo shtonte se zyrtarët myslimanë ndihmonin në mesha, ndërsa populli dhe priftërinjtë nuk shkonin, në qytetet ortodokse të Korçës, Gjirokastrës, Përmetit, Delvinës dhe Sarandës. Xhandarët shqiptarë fajësoheshin se përndiqnin ortodoksët dhe i detyronin të nënshkruanin falënderime drejtuar qeverisë. Veçanërisht, përmendej veçimi i Shahinit dhe Cicit nga Gjirokastra.[1099] Shqipëria nuk pranoi se kishte ndërhyrje qeveritare. Ministri Fico u përgjigj se ortodoksët e Shqipërisë po përdornin të drejtat e tyre pa asnjë lloj shtrëngimi, duke shprehur ndjenjat e atdhetarisë së kulluar dhe duke shpallur autoqefalinë e Kishës në themele të pastra kombëtare. Fico e cilësoi Jerotheun me shërbim kundërshqiptar që ka vendosur qendrën e fushatës së tij në tokë të huaj për të shpifur kundër Shqipërisë e kombit shqiptar.[1100] Natyrisht, ai nuk e dinte se qarjet që nënshkruheshin në emër të Jerotheut nuk ishin të shkruara prej tij.

Qeveria greke do ta shpërdoronte edhe dy herë të tjera emrin e Hirësisë, duke dërguar dy shkresa më 20 dhe 27 maj. Letrat mbanin nënshkrimin e kryepriftit dhe vendnisje Follorinën, por Hirësi Jerotheu ishte shpërngulur në Malin e Shenjtë. Qarjet shënonin se Delvina ishte "qytet grek" dhe myslimanët bënin meshën, ndërsa popullsia e donte në greqisht. Ato parashtronin se as turqit nuk kishin guxuar ta kryenin një sulm të tillë.[1101] Ministri Rauf Fico u kundërpërgjigj me 5 dhe 8 qershor, duke rrëfyer se qyteti shqiptar i Delvinës kishte parë një ndodhi të padenjë, që e kishin kundërshtuar edhe banorët, përfshi pakica greke.[1102]

Paditë e sajuara në emër të Hirësi Jerotheut nuk arritën pritshmërinë e qeverisë greke. Sekretari i Lidhjes së Kombeve e mbylli serinë e telegrameve më 28 tetor, duke hedhur poshtë ankesat e "Hirësi Jerotheut". Lidhja nuk pranoi të gjykonte mbi rregullsinë kishtare dhe ligjshmërinë e trupëzimit të Kishës Shqiptare. Ajo u përqendrua në lirinë e besimit dhe adhurimit, por siguritë e paraqitura nga pala shqiptare u vlerësuan të

[1096] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 1, "Kryepiskop i Korçës" drejtuar Lidhjes së Kombeve, 6 mars 1929.
[1097] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 2, Lidhja e Kombeve drejtuar MPJ, 25 mars 1929.
[1098] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 3, MPJ drejtuar Lidhjes së Kombeve, 12 prill 1929.
[1099] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 5, "Kryepiskopi i Korçës" drejtuar Lidhjes së Kombeve, 17 prill 1929.
[1100] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 7, MPJ drejtuar Lidhjes së Kombeve, 19 prill 1929.
[1101] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 16, "Kryepiskopi i Korçës" drejtuar Lidhjes së Kombeve, 20 maj 1929; AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 18, "Kryepiskopi i Korçës" drejtuar Lidhjes së Kombeve, 27 maj 1929.
[1102] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 34-36, MPJ drejtuar Lidhjes së Kombeve, 5 qershor 1929.; AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 41-42, MPJ drejtuar Lidhjes së Kombeve, 8 qershor 1929.

mjaftueshme.[1103] Letra e përfaqësuesve të pakicës greke nga Delvina ishte përcaktuese për vendimin. Ajo theksonte se pakica nuk ishte përndjekur nga zyrtarët shqiptarë.[1104]

Qeveria greke përdori edhe mjete të tjera. I ngarkuari me punë i Shqipërisë në Athinë, Lec Kurti, njoftonte më 2 mars 1929 se proshqiptari gjeneral Konduli i kishte shprehur kundërshtitë për zgjidhjen e bërë.[1105] Kryetari i Lidhjes Greko-Shqiptare, admirali Nikoll Voci, i dorëzoi një shkresë në emër të anëtarëve arbërorë të saj, duke dënuar veprimin e njëanshëm. Ata shpreheshin kundër Fortlumturi Visarionit që e cilësonin të padenjë dhe vegël të Serbisë. Anëtarët e Lidhjes frikësoheshin se gjendja mund t'i jepte krah unitizmit.[1106] Stafetën e morën grekomanët, pas proshqiptarëve. Ata zhvilluan takime, ku theksonin se ortodoksët në Shqipëri ishin grekë.[1107] Grekomanët zhvilluan tubime përpara legatës shqiptare, të kryesuara nga Kostandin Skënderi dhe Mitropoliti i Drinupojës, Vasili. Ata hodhën parulla fyese ndaj Shqipërisë, duke bërë që Kurti të kërkonte masa nga qeveria greke. Ministri i Jashtëm Grek, Karapanos, nuk pranoi të bisedonte për thelbin e çështjes, duke theksuar se padija e kryepriftërinjve shqiptarë kishte sjellë rrezik në marrëdhëniet dypalëshe.[1108] Skënderi dhe Vasili drejtuan edhe një mbledhje në Pire, ku u dorëzua një padi prej "të krishterëve ortodoksë të Shqipërisë", të cilët sërish shpalleshin grekë.[1109] Po ashtu, u vendos që dhjetë grekomanë do të dërgoheshin në Shqipëri për të zhvilluar një fushatë kundër Kishës.[1110]

Gjithsesi, mjeti më i fortë kundër Kishës Shqiptare ishte shtypi. Ai nisi një sulm të përditshëm ballor ndaj Shqipërisë prej shkurtit 1929. Vala e parë u çel ditën e dorëzimit të Hirësi Agathangjelit. Lec Kurti frikësohej se sulmi do të kalonte caqet si përherë. Rreziku vinte, pasi fletoret lexoheshin edhe në Shqipërinë e Jugut.[1111] Ndaj, qeveria urdhëroi një javë më vonë që asnjë fletore greke të mos hynte në Shqipëri.[1112]

"Elinikos Tahidromos" (Postieri grek) theksonte se parimet e zbatuara në shtete të tjera ballkanike për autoqefalinë nuk mund të viheshin në jetë në Shqipërinë që kishte shumicë joortodokse. "Postieri" e shihte autoqefalinë si një përpjekje të shumicës myslimane për të pakësuar liritë fetare të pakicës ortodokse.[1113]

"Ethnos" shkruante se Ahmet Zogu përpiqej të ndiqte shembullin e Qemal Ataturkut kundër ortodoksëve.[1114] Shtypi grek u përpoq të ulte vlerat e episkopëve, duke pasqyruar Kishën Shqiptare si të drejtuar nga kryepriftërinj të rremë, duke e përqasur me Papa Efthimin, i cili kishte shpallur një kishë ortodokse turke. "Postieri" shkruante më 10 prill se qemalistët në Turqi ishin treguar më të arsyeshëm, pasi nuk e kishin përqafuar çdo vepër të kishës turkortodokse.[1115] Vetëm një shkrim nuk pandehte se autoqefalia ishte

[1103] AMPJ, V. 1929, D. 852, f. 54, Lidhja e Kombeve drejtuar MPJ, 28 tetor 1929.
[1104] AMPJ, Shtesë Fondi 1, D. 178, f, 1, Talo, Marangos, etj., drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë. Ndër nënshkruesit ishin Panajto Talo, Kostas Marangos, Ilia Dalla, Kosta Pilo e të tjerë.
[1105] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 42, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 2 mars 1929.
[1106] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 50, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 9 mars 1929.
[1107] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 97, Fletorja Eleftheria, 4 prill 1929.
[1108] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 86-87, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, prill 1929.
[1109] AMPJ, 11 prill 1929, V. 1929, D. 850, f. 101, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ.; AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 104-105, Kopje e protestës "vorioepiriote", 11 prill 1929.
[1110] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 124, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 20 prill 1929.
[1111] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 35, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 14 shkurt 1929.
[1112] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar të gjitha prefekturave, 21 shkurt 1929.
[1113] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 19-21, Fletorja Elinikos Tahidromos, 14 shkurt 1929.
[1114] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 30, Fletorja Ethnos, 5 mars1929.
[1115] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 113, Fletorja Elinikos Tahidromos, 10 prill 1929.

kryer nga myslimanët. "Kathimerini" e 14 marsit sqaronte se autoqefalia ishte nisur nga poshtë dhe jetësuar nga Kryeministri Koço Kota dhe Kryekuvendari Pandeli Evangjeli, të dy ortodoksë korçarë, "grekë të shqiptarizuar".[1116]

Fortlumturi Visarioni ishte në qendër të sulmit, i cilësuar "kryeprift i rremë", dhe "kuturitës".[1117] Atë Vasil Marko u quajt "prift i paarsimuar e pa farë vlere", Hirësi Agathangjeli "pa dije", Hirësi Eugjeni "pa kuptim", Hirësi Viktori "kundërkanonik" dhe Hirësi Ambrozi "mësues kimie e matematike".[1118] Shtypi grek theksonte se mitropolitët e rinj nuk ishin pritur mirë në qarqet e tyre, sidomos Hirësi Ambrozi.[1119] Ai pasqyronte ndalime, rrahje dhe dhunë ndaj ortodoksëve, shkrime që u përgënjeshtruan menjëherë nga shtypi shqiptar.[1120]

Vala e sulmit nuk shmangte sajime, që tronditnin lexuesit grekë, edhe pse ishin të pabaza. "Kairon" (Koha) theksonte më 25 shkurt se Kisha Shqiptare kishte pranuar unitizmin, duke lehtësuar martesën e Mbretit shqiptar me Princeshën italiane,[1121] ndonëse asnjë prej tyre nuk ishte as unit, as ortodoks. "Proia" (Mëngjesi) theksonte në 8 mars se Jerotheu u dëbua nga Shqipëria, sepse tha që do të fliste shqip në kishë, kur hoxha të thërriste sipër minares në shqip;[1122] në një kohë kur Hirësia meshonte shqip gjatë shtatë viteve të qëndrimit në Korçë.

Krahasimi me çështjen e Kishës së Dodekanezit nuk mund të mënjanohej, pasi shtypi grek shihte Italinë pas lëvizjes shqiptare. "Klio" e 18 majit dhe simotra e saj "Kairon" e 17 majit u kujtuan zyrtarëve grekë se Patriarkana Ekumenike duhet të veprojë njësoj si me Kishën Shqiptare, duke mos e njohur autoqefalinë e Dodekanezit. "Gazeta e Dodekanezit" fajësonte Patriarkanën se nuk kishte treguar aq vëmendje sa ndaj Kishës Shqiptare, edhe pse popullsia ishte tërësisht greke në Dodekanez.[1123]

Sulmi ballor synonte të bënte të qartë për palën shqiptare se nuk do të kishte asnjë zgjidhje të çështjes kishtare pa pranimin e Greqisë. "Politia" theksonte më 13 mars se shqetësimi i qeverisë greke ishte detyrim kushtetues, teksa ortodoksët në Shqipëri ishin grekë.[1124] Ajo rriti kumbimin të nesërmen, duke kërkuar nga qeveria se çfarë masash do të merrte për mbrojtjen e të drejtave fetare të "vorioepirotëve", që ishin shkelur nga sllavët, të cilët po përhapeshin në vise që nuk kishin të bënin me ta. "Politia" shprehej se çështja kishtare shqiptare ishte e huaj për Serbinë dhe ishte një "çështje greke".[1125]

Qëndrimet greke shfaqeshin nga këshilla dhe thirrje deri në kërcënime të drejtpërdrejta. "Klio" citonte Hirësi Krisanthosin më 15 mars se Mbreti shqiptar do të ndryshonte mendim.[1126] "Imerisios Tipos" (Shtypi i përditshëm) shkonte në skajin tjetër se Greqia do të ishte armiqësore, sepse "mashtruesit e Tiranës" lypsej të kuptonin se Greqia kishte mjetet dhe fuqinë e duhur për të dalë kundër përparimit të Shqipërisë, nëse e vendoste. Ajo kërkonte sqarime nga qeveria shqiptare pse kishte përzier episkopë serbë

[1116] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 58, Fletorja Elinikos Kathimerini, 14 mars 1929.
[1117] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 15, Fletorja Imerisios Tipos, 15 shkurt 1929.
[1118] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 12, Fletorja Estia, 15 mars 1929.
[1119] "Çpifjet e një fletore greke të Janinës", *Gazeta e Re* nr. 127, 4 prill 1929, 3.
[1120] Shih AMPJ, V. 1929, D. 851.
[1121] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 21, Fletorja Kairon, 25 shkurt 1929.
[1122] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 44, Fletorja Proia, 8 mars 1929.
[1123] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 240, Fletorja e Dodekanezit, pa datë.
[1124] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 75, Fletorja Politia, 13 mars 1929.
[1125] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 16, Fletorja Politia, 14 mars 1929.
[1126] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 22, Fletorja Klio, 15 mars 1929.

në Kishën "helenorthodhokse" të Shqipërisë.[1127] Fletorja "ISIS" bënte dallimin më 9 mars, duke shkruar se nuk kuptonte përse lëshohej kushtrimi për çështjen e Kishës Shqiptare. Ajo fajësonte Patriarkanën se ishte kujtuar kofini pas të vjeli.[1128] Ky ishte shkrimi i vetmuar pro çështjes shqiptare në shtypin grek.[1129]

Pala shqiptare nuk mbeti pas. Zyra e Shtypit dërgoi për botim një shkrim të gjatë në fillim të marsit. Qeveria theksoi se dredhitë e njerëzve të Patriarkanës kishin detyruar qarqet ortodokse atdhetare të ndiqnin rrugën e vetme në përputhje me dobinë kombëtare.[1130] "Elefthero Vima" u përgjigj më 5 mars. Telegrami i Zyrës së Shtypit u quajt paturpësi e pashoqe, që rrëfente si u krijua Kisha Autoqefale e Shqipërisë, me priftërinj të padenjë e të dyshimtë, të dorëzuar shkel e shko nga një episkop i rremë kuturitës i quajtur Visarion Xhuvani dhe nga një i huaj. Shkrimi përgënjeshtronte qëndrimin shqiptar për marrëveshjen e Tiranës dhe padiste qeverinë e Koço Kotës si kundërshtare të ndërgjegjes fetare të mijëra ortodoksëve të Shqipërisë së Jugut. Qeveria cilësohej nacionaliste e flaktë dhe me mendësi shtypëse myslimane. "Elefthero Vima" kërcënonte me armiqësi, duke i quajtur kundërgreke qëndrimet e qeverisë shqiptare. Fletorja theksonte se durimi kishte kufi dhe grekët pyesnin si mund të pajtohej politika miqësore dhe e sinqertë mes vendeve me qëndrimet e palës shqiptare. Ajo vlerësonte se Greqia nuk duronte kërcënime dhe fyerje nga një shtet i vogël.[1131]

Zoi Xoxa kundërpërgjigjej në "Gazetën e Re" se nuk priteshin duartrokitje nga Athina, por theksonte se shtypi grek po mashtronte. Ndërhyrja e Hirësi Viktorit ishte ndihmë shpirtërore e Patriarkanës Serbe dhe rrjedhimisht dorëzimet dhe autoqefalia ishin të rregullta. Xoxa fajësonte grekët se përdornin gënjeshtra për të mbuluar dëshirat e fshehta të dala kohe, që fushatat progreke të Fanarit të vazhdonin në Shqipëri. Drejtori i "Gazetës së Re" kujtonte fjalët e Mbretit se shqiptari e quante lirinë të nevojshme dhe të shtrenjtë, sikurse Mjaulli, Xhavella, Bubullima etj., të cilët kujtuan se do të siguronin edhe pavarësinë shqiptare, duke u bazuar në miqësinë mes dy kombeve. Xoxa përfundonte se shqiptarët nuk do të lejonin cenimin e sovranitetit të Shqipërisë, tashmë që pavarësia ishte siguruar.[1132] Ai u drejtohej shifrave, duke theksuar se në Shqipëri kishte një pakicë shumë të vogël greqishtfolësish, më pak se pakica shqiptare e Çamërisë.[1133] "Gazeta e Re" pasqyroi në disa numra, në shqip dhe frëngjisht, të kaluarën e Kishës Shqiptare.[1134] Ndërsa, "Gazeta e Korçës" qortoi përpjekjen greke për të turpëruar Shqipërinë.[1135]

Shtypi shqiptar shënonte se Patriarkana dhe Greqia dëshironin të ndërhynin në Shqipëri, nëpërmjet Kishës. Tollovia e tyre vinte pasi zgjidhja e çështjes ishte e rregullt dhe kombëtare. "Gazeta e Re" theksonte më 9 mars se Sinodhi dhe Kisha Autoqefale ishin bazuar në kanonet fetare për fetarët dhe në plotësim të qëllimit kombëtar për

[1127] AMPJ, Fletorja Imerisios Tipos, 15 shkurt 1929, cit.
[1128] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 9-10, Fletorja ISIS, 9 mars 1929.
[1129] Shtypi shqiptar vlerësonte jashtë mase heshtjen e disa gazetave si "Qiriks" i Janinës, mirëpo nuk shihnin të pasqyruar asnjë shkrim pro çështjes kishtare shqiptare. *Gazeta e Re* nr. 111, 15 mars 1929, 3.
[1130] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 28, Qarkore e Drejtorisë së Shtypit, 2 mars 1929.
[1131] AMPJ, D. 850, f. 10-12, Elefthero Vima, 5 mars 1929, V. 1929.
[1132] "Shtypi grek dhe Kisha Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 102, 2 mars 1929, 1.
[1133] "Realizimi i një vepre kombëtare", *Gazeta e Re* nr. 117, 23 mars 1929, 1.
[1134] "Çkoqitje kategorike të huajve mbi Kishën Autoqefale Shqiptare", *Gazeta e Re* nr. 105, 7 mars 1929, 1.
[1135] "Grekët të çqetësuar për zgjidhjen e çështjes së kishës sonë Përdorin çdo mjet për të na diskredituar përpara botës së huaj", *Zëri i Korçës* nr. 378, 9 mars 1929, 1.

atdhetarët. Prandaj, të gjithë shqiptarët ortodoksë e atdhetarë nuk duhet t'u vinin veshin qortimeve keqdashëse të armiqve, duke u shmangur nga tufani i dredhive të huaja, që për qindvjeçarë kishin verbuar shqiptarët.[1136]

Fletorja arsyetonte trupëzimin e Kishës në pikëpamjen e së drejtës kishtare. Shkruesi theksonte se shpifjet e shtypit grek nuk meritonin përgjigje, por mbarë bota nevojitej të mësonte të vërtetën. Fletorja citonte shkrimtarin grek Adhamandios Korais se Kisha duhet të drejtohej prej priftërinjve vendas. Ajo parashtronte arsyetimin e profesorit të së drejtës kishtare, Saropulos, se krijimi i Kishës Autoqefale Greke u bazua në kanonin 17 të Sinodhit të katërt Ekumenik, që përcaktonte se organizimi kishtar pasonte atë politik. Profesori grek vijonte se Kisha Mëmë e njohu Kishën Greke si të pavarur në vitin 1850, por ajo ishte e tillë që prej vitit 1833, sepse njohja e pavarësisë nuk ishte e domosdoshme ligjërisht dhe kanonikisht. Prandaj, njohja nuk u kërkua kurrë. Ky arsyetim grek ishte përdorur edhe për krijimin e Sinodhit të Kishës Shqiptare. Autoqefalia kërkonte vetëm dy parakushte: pasjen e popullsisë vendase ortodokse dhe pavarësinë politike. Për më tepër, Patriarku e kishte njohur Kongresin e Beratit nëpërmjet Ekzarkut të tij.[1137]

Arsyetimi ishte shkruar nga Kryepiskopi Visarion dy ditë më parë. Ai i ishte përgjigjur një qëndrimi zyrtar të Kryepiskopit të Thiaterës, Gjermanos, i cili këmbëngulte se Kisha në Shqipëri ishte në varësinë e Kishës së Kostandinopojës. Fortlumturia arsyetonte për shtypin e huaj se nuk ka rregull kanonik që i jep Patriarkut të drejtën të ndërhyjë në çështje kishtare të shteteve të pavarura.[1138]

Çështja kishtare quhej e mbyllur njëherë e përgjithmonë nga pala shqiptare.[1139] "Gazeta e Re" fajësonte kryeministrin grek, Eleftherios Venizelos, si nxitës i ngjarjes së Delvinës, ku gra hodhën ujë të nxehtë mbi pjesëmarrësit në kishë. Mbrojtja e pesë të ndaluarve nga shtypi grek cilësohej ndërhyrje në punët e brendshme, teksa ata ishin nënshtetas shqiptarë.[1140] Xoxa theksonte se shtypi grek nuk çirrej, sepse veprimet ishin kundërkanonike, por sepse u parapëlqyen episkopët serbë nga agjentët e Fanarit, për të dhënë ndihmën shpirtërore në ngritjen e Kishës Autoqefale. Ai nënvizonte se Shqipëria ishte një vend pa fe zyrtare, por me Kryeministër ortodoks.[1141]

Qeveria shqiptare nuk dëshironte ashpërsimin e grindjes në shtypin e dy vendeve. Kryeministri Kota kishte urdhëruar ndalimin e shkrimeve të ngjashme më 10 maj, pas një vendimi të ngjashëm të palës greke.[1142] Vetëm ndodhitë e Delvinës e bënë ta shfuqizonte përkohësisht urdhrin pas pak ditësh.[1143] Gjithsesi, grindja u mbyll zyrtarisht në qershor, pas ndërhyrjes së ministrit të Jashtëm, Rauf Fico. Ministri nuk i shihte me sy të mirë përplasjet dhe shprehu dëshirën e qeverisë shqiptare për marrëdhënie të mira mes dy

[1136] Laiku Orthodhoks, "Rreth çështjes s'onë kishëtare", *Gazeta e Re* nr. 107, 9 mars 1929, 3-4.
[1137] Një orthodhoksë shqiptar, "Formimi i Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare nga pikëpamja juridike dhe kanonike", *Gazeta e Re* nr. 108, 10 mars 1929, 3-4.
[1138] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 7, Buletini i Përditshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, 7 mars 1929; "Nji deklaratë me randsi e Hirësis së Tij Imzot Visarion", *Gazeta e Re*, 8 mars 1929, 4.
[1139] Gjergj Meksi, "Një lëvizje e kotë", *Gazeta e Re* nr. 131, 9 prill 1929, 1.
[1140] A. N., "Politika antishqiptare e Greqisë", *Gazeta e Re* nr. 171, 28 Maj 1929, 1.
[1141] "Një përgjigje gazetës greke 'Elefteron Vima'", *Gazeta e Re* nr. 199, 29 qershor 1929, 1.
[1142] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1929, D. VI-336, f. 1, Vendim i Kryeministrit, 10 maj 1929.
[1143] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1929, D. VI-336, f. 2, Vendim i Kryeministrit, 18 maj 1929.

vendeve. Ai theksoi se grindjet ishin kundër udhëzimeve të qeverisë dhe kishte besimin e plotë se edhe shtypi grek do ta kuptonte se duhet t'i jepte fund fushatës.[1144]

Përplasja përfshiu edhe pak fletore ndërkombëtare.[1145] Patriarkana Ekumenike kishte paguar mjaft të holla për të siguruar shkrime në shtypin turk, francez dhe anglez. Konsulli shqiptar në Stamboll kërkoi një shumë për të përballuar këtë fushatë.[1146] Francezja "Le Temps" kishte dalë në krah të Patriarkanës, ndërsa simotra "Journal des Debates" përkrahte anën shqiptare.[1147] Kisha Shqiptare mori mbështetje nga shtypi bullgar e rumun, si dhe nga britanikja "The Near East and India".[1148] Ndërkaq, "Times" e Londrës pasqyroi shkrime të ambasadorit Eqrem Vlora dhe Kryepiskopit të Thiatirës, Gjermanosit, të cilët përsëritën arsyetimet e shpalosura në shtypin shqiptar dhe grek.[1149]

Sekretariati i KOASH-it botoi një libër të posaçëm në frëngjisht, për të fituar mbështetje ndërkombëtare. Ai quhej "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë" dhe u botua në Gjenevë. Libri përshkruante të kaluarën e Kishës nga bisedimet me Hirësi Krisanthosin te zvarritja e Patriarkanës. Ajo pasohej nga shkresa zyrtare, si letrat e shkëmbyera me Patriarkun, parashtresat e konsullit në Stamboll dhe ambasadorit në Athinë, letërkëmbimet e Hirësi Joakimit me Xhafer Ypin etj. Libri përfundonte me letrën e Mbretit drejtuar Kryeministrit dhe një pasthënie që theksonte se Shqipëria siguronte lirinë e besimeve, trajtën jofetare të shtetit dhe trajtën mbifetare të kombit.[1150]

Autoqefalia ishte kryer në mungesë të një nismëtari të madh, siç ishte Hirësi Theofani. Qëndrimi që do të mbanin fanolistët nuk ishte i qartë, edhe pse përkrahësit e tij Çamçe dhe Marko ishin anëtarë kyçë të Sinodhit. Mërgata në SHBA mbështeste fuqimisht Nolin. Njëkohësisht, shumë politikanë të krahut fanolist jetonin në Evropë, të dëbuar në fundvitin 1924. Fortlumturi Visarion Xhuvani u dërgoi një qarkore mërgatave shqiptare në Uashington, Ankara, Aleksandri, Bukuresht, Sofje dhe Athinë, më 16 mars. Kryepiskopi njoftoi krijimin e Sinodhit dhe kërkoi mbështetjen e të gjithë shqiptarëve.[1151] Mërgatat e Bullgarisë dhe Turqisë e mirëpritën. Jani Vreto, kryetar i shoqërisë shqiptare "Gjergj Kastrioti" në Sofje, e përshëndeti me zell krijimin e Sinodhit. Ai e vlerësoi si sigurinë e besimit të plotë që ushqejnë ortodoksët shqiptarë brenda dhe jashtë atdheut. Vreto shkruante se lotët e vuajtjeve dhe përbuzjeve ishin ndryshuar në diamante që do të ndriçonin ngadhënjimtarë.[1152] Ortodoksët shqiptarë të Stambollit nisën falënderime të shkurtra drejtuar Kryeministrit dhe Kryetarit të Kishës.[1153]

[1144] Zoi Xoxa, "Intervista e jonë me Z-in Ministër të Punëvet të Jashtme", *Gazeta e Re* nr. 173, 30 maj 1929, 1.

[1145] Shtypi serb mbështeste palën shqiptare në çdo rast. "Dy fletorja të hueja me shumë rëndësi flasin në favor të Thezës Shqiptare", *Gazeta e Re* nr. 114, 19 mars 1929, 1.

[1146] AMPJ, 25 mars 1929, V. 1929, D. 852, . 92, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ.

[1147] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 43, Fletorja "Le Temps", 14 mars 1929.; AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 44, Fletorja "Journal des Debates", 18 mars 1929.

[1148] Ç'shkruan "The Near East and India" për Kishën Orthodhokse Shqiptare", *Gazeta e Re* nr. 117, 23 Mars 1929, 1.

[1149] AMPJ, V. 1929, D. 851, f. 23-24, Fletorja "Times", mars 1919.

[1150] Sinodhi, *Kisha*.

[1151] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 47, KOASH drejtuar Legatave Shqiptare në Uashington, Ankara, Aleksandri, Bukuresht, Sofje dhe Athinë, 16 mars 1929.

[1152] "Shqiptarët e Sofies për formimin e Sinodhit të Shenjtë", *Gazeta e Re* nr. 114, 19 mars 1929, 1.

[1153] Nënshkrues i urimit ishte edhe Atë Noni. "Shqiptarët e Stambollit për formimin e Sinodhit të Shenjtë", *Gazeta e Re* nr. 121, 27 mars 1929, 1.

Vetë Noli botoi disa shkrime në fletoren "Liria Kombëtare", në prill 1929, ku qortonte rrugën e ndjekur për Krijimin e Sinodhit me ndihmën e Kishës Serbe dhe me një Kryepiskop si Visarion Xhuvani. Mirëpo, ai bashkohej me thelbin e lëvizjes, duke vlerësuar se kjo rrugë e shmangu vendosjen e Kishës Shqiptare nën Patriarkanën Greke, që hiqej se trajtonte një çështje kishtare, në një kohë kur ajo ishte çështje tërësisht politike, me maskë fetare.[1154]

Dy qendrat, prej nga përgjigjja pritej me kureshtje, ishin SHBA dhe Greqia. Froni i Kishës Shqiptare në Amerikë ndodhej në Boston. Kundërshtarët e hershëm të Hirësi Theofanit, Atë Nikolla Kristofori, Atë Naum Çere dhe Atë Marko Kondili, nisën të meshonin për Mbretin dhe Sinodhin e Shenjtë Shqiptar, porse kishat e tjera i qëndruan besnike episkopit në mërgim.[1155] Mbledhja e përvitshme e Kishës vendosi të priste rikthimin e Hirësi Theofanit nga Evropa për të vendosur se çfarë do të bënin. Përfundimisht, vetëm Kisha e Shën Trinisë u bashkua me KOASH-in, më 14 qershor 1933.[1156]

Zëri më i ashpër kundërshtar ishte Koço Tasi. Ai qëndronte herë në Athinë dhe herë në Aleksandri dhe nisi një fushatë kundër zgjidhjes së gjetur për çështjen kishtare. Tasi ishte ndër përfaqësuesit më të zëshëm të atdhetarëve shqiptarë konservatorë-ortodoksë. Ai ishte një mbështetës i orëve të para i një Kishe Autoqefale, të drejtuar vetëm nga episkopë atdhetarë shqiptarë, me gjuhë meshimi shqipen. Mirëpo, njëkohësisht ai i frikësohej një sundimi të mundshëm të shumicës myslimane ndaj pakicës ortodokse. Atdhetarizmi i Tasit nuk mund të vendoset në pikëpyetje. Ai kishte dëbuar kushëririn e tij, zëvendësmitropolitin grekoman të Përmetit, për ta zëvendësuar me atdhetarin Atë Stathi Melani në kohën e Luftës së Parë Botërore.[1157] Nga ana tjetër, ai ishte ndër kundërshtarët e flaktë të Hirësi Theofanit, kur ende nuk ishte dorëzuar rregullisht episkop. Tasi ishte ndër deputetët që kundërshtuan hyrjen e Nolit në Shqipëri dhe kërkoi që Kisha e Shën Gjergjit t'i kthehej Jakovit, gjatë drejtimit prej tij të Mitropolisë së Korçës.[1158] Ai vijonte të shihte rrezikun që mund të kanosej nga një shumicë myslimane. Ndaj, kërkoi përpjesëtim fetar për punësimin në zyrat shtetërore, kur u emërua nënministër i Brendshëm në vitin 1921.[1159]

Megjithatë, Koço Tasi ishte ithtar i autoqefalisë dhe nxiti qeverinë të mos pranonte asnjë mitropolit grek, kur një thashethem i tillë u përhap. Po ashtu, mbështeti vendimet e Kongresit të Beratit në Lidhjen e Kombeve, duke iu kundërpërgjigjur qarjeve greke.[1160] Dorëzimi i rregullt i Hirësi Theofanit bëri që Tasi të shndërrohej ndër përkrahësit e tij politikë dhe u emërua prefekt i Gjirokastrës me ardhjen e Nolit në pushtet. Ai do të detyrohej të dorëhiqej pas pak muajsh, pasi kishte shpërndarë një qarkore në greqisht për pakicën greke. Qeveria e Nolit arsyetonte se pakica e kuptonte gjuhën zyrtare shqipe, ndaj nuk kishte nevojë për shkresa shtetërore në gjuhën e saj amtare.[1161]

[1154] Rama, "Shteti dhe njohja...", 76-77.
[1155] "Peshkopata e Kishës Shqiptare në Boston Uron Guvernën për zgjidhjen e çështjes kishëtare", *Gazeta e Re* nr. 221, 26 korrik1929, 1.
[1156] AMPJ, V. 1933, D. 483, f. 13-18, Konsullata e Bostonit drejtuar MPJ, 21 prill 1933.
[1157] Verli, *Spiro Kosova I*, 152-153.
[1158] AQSH, MPB drejtuar Prefekturës së Korçës, 12 shtator 1921, cit.
[1159] Laonikus, "Fushata e një të shituri", *Gazeta e Re* nr. 237, 15 gusht 1929, 3.
[1160] AMPJ, Evangjeli etj. Drejtuar Lidhjes së Kombeve, pa datë, cit.
[1161] Laonikus, "Fushata e një të shituri", 3.

Koço Tasi iku në mërgim mes Aleksandrisë dhe Athinës pas rikthimit të Zogut, duke qenë i vetëm kundër të gjithëve. Mbarë jeta politike e ndante me Zogun, ndërsa Noli e kishte zhgënjyer. I vëllai, Arqile Tasi, drejtonte "Vatrën" në SHBA dhe mbështeste krijimin e Sinodhit të Shenjtë në vitin 1929. Krejt ndryshe, Koço Tasi u bë zëri më i ashpër kundër.[1162]

Tasi botoi në Athinë libërthin "Shqiptarëvet të Krishten Bashkëpunëtorë të Muhamedanëvet", më 16 prill 1929. Ai padiste se Shqipëria po sundohej nga myslimanët dhe fajësonte ashpër bashkëpunëtorët e tyre, Kryeministrin Kota, Kryekuvendarin Evangjeli, pushtetrrëzuarin Theofan Noli apo edhe Zoi Xoxën. Tasi shpaloste veprat e këqija të myslimanëve kundër Atdheut dhe të krishterëve, që bëheshin me dëbime e burgosje dhe me qarje në Lidhjen e Kombeve. Ai vlerësonte se kjo ishte rrjedha e pritshme e punëve dhe parashihte përkeqësim, nëse myslimanët nuk hiqnin dorë nga udha që kishin ndërmarrë. Tasi e shihte të vështirë kthimin pas, teksa një pjesë e mirë e myslimanëve nuk e kuptonin që po dëmtonin Atdheun, duke e çuar në kufijtë e luftës vëllavrasëse fetare. Ai fajësonte kryesisht Koço Kotën dhe Pandeli Evangjelin, të cilët i quante vegla që nxisnin drejt greminës, për shkak të nevojës për lavdi vetjake. Tasi shigjetonte edhe drejtorin e "Gazetës së Re", Zoi Xoxa.[1163]

Gjithsesi, shkruesi ia kushtoi shumicën e libërthit ish-bashkëpunëtorit të ngushtë, me të cilin pati ulje-ngritje të mëdha: Hirësi Theofanit. Tasi vendoste në pikëpyetje maturinë kishtare dhe kombëtare të Nolit, nisur nga vetëshpallja e tij komunist. Ai shfajësohej se e kishte njohur për atdhetar të madh në shërbim të kombit dhe gjuhës, ndaj i ishte bashkuar, mirëpo komunizmi dhe kombëtarizmi mund të përputheshin vetëm për shaka. Tasi theksonte se populli shqiptar e kishte ngarkuar Nolin të qeveriste një shtet kombëtar dhe kapitalist e jo komunist. Ish-bashkëpunëtori e fajësonte Nolin si mbështetës të krijimit të Sinodhit, që për Tasin ishte vepër e "myslimanëve" dhe "veglave ortodokse".[1164]

Tasi çonte ujë në mullirin e Athinës. Ai përdorte arsyetimin që i shërbente Greqisë, pra se në çështjen kishtare ishte vepruar nga një "qeveri myslimane". Qenia e pamohueshme në krye të shtetit e ortodoksëve të njohur si Kota dhe Evangjeli tejkalohej duke i quajtur "vegla të myslimanëve". Për më tepër, ai ndante vërejtje për të gjithë të përfshirët në çështjen kishtare, pa harruar Nolin, kundërshtarin më të rreptë të Zogut.

Përgjigjet ndaj Tasit ishin edhe më të ashpra. Mërgata e Egjiptit kundërshtoi e para. Vasil Tako (Novosela) botoi libërthin "Përgjigje e Shqiptarëvet Krishten të Misirit për Botimet e Koço Tasit", më 10 maj. Tako e fajësoi Tasin se merrte anën e Greqisë në Shqipëri, në përpjekje për të greqizuar vendlindjen e tij, Përmetin, gjë së cilës s'do ia dilte kurrë, teksa shqiptarët dhe në veçanti përmetarët ishin atdhetarë të kulluar. Novosela shkruante se cilido shqiptar që përdor fenë në kurriz të Atdheut nuk mund të quhet shqiptar, por armik i kombit dhe tradhtar, si fjala më e rëndë që mund t'i thuhet.[1165]

[1162] *Gazeta e Re* nr. 241, 20 gusht 1929, 2.

[1163] Koço Tasi, *Shqiptarvet të Krishtern bashkëpunëtorë të Muhamedanëvet*, (Athinë: 1929), gjendur në AMPJ, V. 1929, D. 850.

[1164] Po aty.

[1165] Vasil J. Tako (Novosela), *Përgjigje e Shqiptarëvet Krishten të Misirit për Botimet e Koço Tasit* (Misir: 1929), gjendur në AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 210-213. Shkrimi u përpoq t'i paraprinte daljes së mundshme në krah të Tasit të shumë miqve të tij që jetonin në Aleksandri. Mirëpo, fjalët e përhapura se do të kishte lëvizje kundër autoqefalisë në Egjipt nuk u vërtetuan dhe Tako mbeti zëri i vetëm i atyshëm (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 6 korrik 1929.).

Zoi Xoxa i kushtoi Koço Tasit dy numra të "Gazetës së Re". Xoxa arsyetonte se kundërshtia e të huajve ishte e natyrshme, mirëpo dalja kundër e bashkatdhetarëve ishte e papranueshme. Drejtori i "Gazetës së Re" shënonte se ndiente keqardhje ndaj të tillë bashkatdhetarëve, që nuk do të kundërshtonin veprën e kryer, po të mos ishin bërë vegla të Greqisë. Krijimi i Sinodhit ishte bërë duke siguruar dobinë kombëtare dhe duke nderuar punën dhe theroritë e atdhetarëve shqiptarë. Rrjedhimisht, Patriarkana nuk kishte veç se t'i bindej me kohë. Xoxa padiste Tasin se e trajtonte Shqipërinë si vend të prapambetur të Afrikës dhe theksonte se po të mos ishte verbuar nga të hollat e Greqisë, do të shihte përparimin perëndimor të vendit.[1166] Xoxa i rikthehej çështjes në numrin e 15 gushtit, nën nofkën Laonikus. Ai sfidoi Tasin të tregonte një rast kur ishin përndjekur të krishterët nga myslimanët. Ndërkaq, theksonte se nuk kishte ndryshime fetare në Shqipëri dhe një shqiptar që dilte në fushën e politikës duke folur për përçarje ishte turp që i thoshte vetes shqiptar. Xoxa shqyrtonte të punësuarit e qeverisë, që ishin kryesisht të krishterë, e veçanërisht ortodoksë, dhe lëvdonte bashkëjetesën fetare, që Tasi përpiqej ta nxinte "për të zezë të vetes".[1167]

Lëvizja kishtare shqiptare ishte e përqafuar nga të gjithë shqiptarët kudo që ndodheshin. Krijimi i Sinodhit të Shenjtë u përshëndet nga shqiptarët në Shqipëri, nga mërgata, akoma edhe nga të pushtetrrëzuarit rreth Hirësi Thoefanit. Koço Tasi kishte qenë kundërshtari i vetëm, duke u bërë përjashtimi që vërtetonte rregullin.[1168] Krijimi i Sinodhit pati mbështetje të zjarrtë nga ortodoksët në Shqipëri, të cilët morën pjesë gjallërisht në zgjedhjet për Kongresin e Dytë të KOASH-it dhe në mbështetje të Kishës së re, krahas shumicës së pakicës greke. Kjo përkrahje shënohej edhe nga diplomatët e huaj, si ambasadori britanik në Tiranë.[1169]

[1166] "Një zë i shitur!", *Gazeta e Re* nr. 235, 11 Gusht 1929, 1.
[1167] Laonikus, "Fushata e një të shituri", 3.
[1168] Tasi do ta vijonte rrugën atdhetare kur Mbreti Zog të mos ishte më në Shqipëri. Ai do të merrte përsipër qeverisjen e Kosovës e mbi të gjitha bashkimin e Qarkut Kishtar të Prizrenit me KOASH gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke ripohuar se nuk i mungonte atdhetaria dhe dëshira për një Kishë të Madhe Shqiptare.
[1169] Meta, *Tensioni shqiptarogrek,* 39.

KREU V:
FUQIZIMI I KOASH-it DHE NJOHJA ZYRTARE, 1929-1937

5.1.Bisedimet e reja me Patriarkanën Ekumenike, 1929-1931

Përplasja e ashpër u la radhën bisedimeve. Pala greke e dinte se çështja kishtare ishte një fitore e pashmangshme shqiptare. Mitropoliti i Korfuzit, Athinagora, i parashtronte Sinodhit të Shenjtë të Kishës së Greqisë se Jugosllavia nuk kishte peshë. Qeveria dhe Kisha Serbe kishin dhënë mbështetjen, por fitorja ishte kryekëput shqiptare. Ndihma serbe nuk qe vetëdashëse, por e kërkuar nga Fortlumturi Visarioni. Athinagora fajësonte qeverinë greke për gjendjen. Njëherazi, gjykonte se zhvillimet ishin pasojë e qëllimeve vetjake të Mbretit Zog dhe në shërbim të politikës italiane. Athinagora sugjeronte krijimin e një Kishe Greke Ortodokse në Shqipëri, krahas asaj Shqiptare të Visarionit. Nisma do të përligjej me marrëveshjet ndërkombëtare, që shpallnin liri besimi. Ai parashikonte animin e shumicës së popullsisë nga Kisha Greke. Shqiptari ortodoks nga fshati Vasiliko i Çamërisë parashihte se humbja e kësaj çështjeje do të sillte humbjen e grekëve në Shqipëri, fitoren e katolicizmit, që do të shoqërohej nga rreziku i shqiptarëve në Çamëri. Ai përfundonte se qeveria shqiptare nuk do të tërhiqej, pasi nuk kishte kundërshti ndërkombëtare apo trysni nga Greqia.[1170]

Eleftherios Venizelos foli zyrtarisht vetëm më 10 gusht 1929. Kryeministri grek dha intervistë të posaçme për të dërguarin e Zyrës së Shtypit, dr. Vangjel Nasho Qirkon.[1171] Venizelos kërkoi përafrimin shqiptaro-grek, por theksoi se çështja kishtare ishte një re e zezë që shkatërroi politikën e përzemërt mes dy vendeve. Ai e cilësoi çështje të brendshme të Shqipërisë, por tha se qeveria shqiptare duhet të merrte parasysh lidhjet shpirtërore mes popullit grek dhe Patriarkanës. Kryeministri u vetëcilësua mik i mirë i shqiptarëve dhe theksoi se kishte pasur gjithnjë bashkëpunëtorë grekë prej racës shqiptare, si Kundurioti, Repuli, Mjauli, Dhiomidhi etj.[1172] Ministri Mihalakopulos u shfajësua pak ditë më vonë se ndërhyrja e padëshiruar në çështjen e brendshme shqiptare ishte shtrënguar nga kundërsulmi i shtypit grek.[1173]

Mendimet e Athinagorës për "zgjidhje të dyfishtë" dhe Kryeministrit grek për paqtim kishin një emërues të përbashkët: rinisjen e bisedimeve me Athinën zyrtare.

Lajmi se qeveria do të kërkonte marrëveshje me Patriarkanën u përhap sapo përfundoi Kongresi i Dytë Kishtar, në verën e vitit 1929. Qeveria e përgënjeshtroi si të pathemeltë. Ajo theksoi se rrugëzgjidhja e vetme ishte njohja pa kushte e Sinodhit të Shenjtë të porsakrijuar.[1174] Mohimi u krye pas lutjes së Fortlumturi Visarionit, i cili falënderoi qeverinë, më 9 gusht.[1175]

Mirëpo, marrëveshja e mundshme vijonte të përflitej. Shtypi grek këmbëngulte se Kryeministrit Venizelos dhe ministri i Jashtëm, Rauf Fico, kishin biseduar për zgjidhjen e

---

[1170] Kondis, *Elinizmos III*, 167: IDAYE, D. A/22/1β, nr. 4845, Mitropoliti Athinagora drejtuar Sinodhit të Shenjtë të Kishës së Greqisë, 27 maj 1929.
[1171] "Dekllaratë e z. Venizellos mbi marrëdhëniet grekoshqiptare", *Zëri i Korçës* nr. 423, 17 gusht 1929, 1.
[1172] *Gazeta e Korçës* nr. 663, 29 gusht 1929, 1.
[1173] "Deklarata të Rea të Ministrit grek për çështjen kishtare", *Gazeta e Korçës* nr. 678, 21 shtator 1929, 1.
[1174] Qeveria s'ka bërë asnjë ndërhyrje për marrëveshje me Patriarkanën", *Zëri i Korçës* nr. 420, 6 gusht 1929, 1.
[1175] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1929, D. VI-340, f. 1, KOASH drejtuar Kryeministrit, 9 gusht 1929.

çështjes kishtare. Zyra e Shtypit përgënjeshtroi sërish.[1176] Fortlumturi Visarioni rendi të shpallte fjalët që Mbreti kishte shqiptuar pro Sinodhit;[1177] një përpjekje që synonte bindjen e besimtarëve se ai vijonte të kishte besimin qeveritar. Diplomacia greke në Shqipëri ishte kujdesur të njoftonte zhvillimet. Konsulli grek në Korçë kishte shpallur në Hoçisht se KOASH do të lidhej shumë shpejt me Patriarkanën.[1178] Po ashtu, ai ishte përpjekur të përfshinte besnikë të tij në pleqësitë kishtare, por nuk ia kishte dalë.[1179]

Qeveritë e dy vendeve ishin njëmendësuar të bisedonin, pavarësisht nga përgënjeshtrimet e njëpasnjëshme. Ministri grek në Shqipëri, Leon Melas, siguroi qeverinë shqiptare se do të gjente dashamirësi në Athinë.[1180] Njëherazi, ai i shfaqte pakënaqësinë për zhvillimet ambasadorit britanik në Tiranë dhe shënonte se Mbreti Zog kishte pranuar "çmendurinë e vendosjes në krye të Sinodhit të një personi të njohur për natyrën e keqe, siç ishte Visarioni". Mirëpo, shpallja e ligjit për bashkësitë fetare ia kishin venitur shpresat.[1181]

Qeveria ngarkoi kryebashkiakun e Korçës më 19 tetor, të shkonte në Athinë për arritjen e një marrëveshjeje të re kishtare. Vasil Avrami njihej si atdhetar e mbështetës i flaktë i autoqefalisë dhe njëherazi i gjithëpranuar nga rrymat ortodokse shqiptare.[1182]

Fortlumturi Visarioni mbeti thellësisht i pakënaqur. Ai pa se qeveria kishte përdorur gjendjen e re për të kthyer baraspeshat në anë e saj, porse nuk hiqte dorë nga një zgjidhje e pranuar prej Patriarkanës. Prandaj, ai u kujdes të vononte nisjen e Avramit. Fortlumturia duhet t'i jepte plotfuqinë e kryesisë së Kishës për të zhvilluar bisedimet. Prefekti i Korçës njoftonte më 28 tetor se Visarioni ende nuk e kishte çuar dëshminë, duke u vendosur në dyshime se vonesa ishte e qëllimshme.[1183] Vasil Avrami u pajis me shkresën pas pak ditësh dhe u gjend në Athinë në fillimnëntor. Plotfuqia shënonte se kryebashkiaku i Korçës ishte dërguar për "rregullimin e marrëdhënieve vëllazërore dhe kishtare ndërmjet Kishës së Madhe të Krishtit të Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës dhe bijës së saj më Krisht, Kishës Orthodhokse Shqiptare". Avrami bisedoi me Mitropolitin e Trapezundës.[1184]

Hirësi Krisanthos shpalosi zhvillimet pas vitit 1926, duke fajësuar qeverinë shqiptare dhe duke këmbëngulur në zbatimin e Protokollit të Tiranës. Pala shqiptare kishte epërsi në kushtet e reja. Avrami tha se gjendja e krijuar nuk mund të përmbysej. Si pasojë, vlerësonte se bisedimet nuk ishin detyrimore, porse bashkëbiseduesit do të ndanin disa mendime vetjake, me pikënisje Protokollin e Tiranës, pa përfunduar me një shkresë të detyrueshme. Epërsia i mundësoi Avramit të arrinte një sërë ndryshimesh në Protokollin e Tiranës. Ato u përmblodhën në një marrëveshje të njëmendësuar më 9 dhjetor 1929. Avrami arriti ta mënjanonte pikën më të kundërshtuar të protokollit, se gjuha greke do të vijonte të përdorej përkohësisht në meshim nga bashkësitë shqiptare.

[1176] "Asnjë bisedim i Z-it Reuf Fico me Z-in Venizelos mbi çështjen e Kishës", *Gazeta e Re* nr. 275, 28 shtator 1929, 4.
[1177] "Një deklaratë e Kryetarit të Kishës Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 290, 17 tetor 1929, 1.
[1178] AQSH, Komanda e Xhandarmërisë drejtuar Prefekturës Korçë, 19 shtator 1929, cit.
[1179] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 130, f. 5, Prefektura Korçë drejtuar MPB, janar 1930.
[1180] AMPJ, V. 1929, D. 850, f. 247-249, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 26 nëntor 1929.
[1181] Meta, "Debati shqiptarogrek...", 37-61.
[1182] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Autorizim, 19 tetor 1929.
[1183] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 28 tetor 1929.; dhe AQSH, F. 317 "Prefektura Korçë", D. 197, f. 82.
[1184] Tasudhis, *Kujtime biografike,* 61-63.

Hirësi Krisanthos e kundërshtoi rreptë fillimisht kërkesën e përdorimit vetëm të shqipes, duke këmbëngulur se lejimi i greqishtes ishte pranuar nga komisioni, më 1926. Mirëpo, e pranoi ndryshimin, duke lënë meshimin e greqishtes vetëm për pakicën greke. I ngarkuari me punë në Athinë, Lec Kurti, paraqiste si shkak të tërheqjes mbrojtjen "aq të bukur" të çështjes nga Avrami.[1185] Patriarkana e arsyetoi lëshimin me traditat e Kishës për fuqizimin e gjuhës kishtare kombëtare, duke shtuar se kjo do të mundësonte përdorimin e huazimeve nga greqishtja në gjuhën kishtare shqiptare, në vend të huazimeve sllave dhe latine.[1186]

Gjithashtu, palët hoqën përcaktimin që Shqipëria do të dëmshpërblinte Patriarkanën për manastiret e saj në Shqipëri, me nismën e Hirësi Krisanthosit.[1187] Ndërkaq, ai kishte kërkuar mbrojtjen e çdo pakice ortodokse, me anë të nenit 6 të Protokollit të Tiranës, duke nënkuptuar edhe serbët e vllehët. Patriarku serb dhe ai rumun i patën kërkuar meshimin në gjuhë amtare të sllavëve në Shkodër dhe vllehëve në Korçë, si kusht për mosnjohjen e Kishës Shqiptare.[1188]Avrami kundërshtoi rreptësisht, me arsyetimin se krijimi i pakicave të reja nuk i shërbente as Shqipërisë, as Greqisë. Patriarkana arriti atë që donte. Ministria e Jashtme Greke lajmëronte se Krisanthos e parashihte dhe "e dëgjoi me gëzim" kundërshtimin shqiptar. Mospranimi i Avramit i mundësonte Patriarkanës t'u shfajësohej kishave rumune dhe serbe se ajo kishte kërkuar mbrojtjen e pakicave përkatëse, mirëpo kishte hasur në kundërshtimin e prerë të palës shqiptare.[1189] Rrjedhimisht, u vendos të hiqej përcaktimi politik që mbronte pakicën greke dhe të përmendej vetëm detyrimi i ndërmarrë nga Shqipëria në Lidhjen e Kombeve.[1190]

Çështja e fundit e biseduar ishin mitropolitët. Hirësi Krisanthos pranoi pasjen e një mitropoliti dhe tre episkopëve në Shqipëri, sipas përcaktimeve të Statutit të Korçës dhe jo pesë mitropolitë, sipas Protokollit të Tiranës. Ai kundërshtoi pjesëmarrjen e Atë Vasil Markos si anëtar i Sinodhit, por la përshtypjen se kjo çështje mund të tejkalohej. Hirësi Krisanthos kërkoi që të gjithë episkopët të dorëhiqeshin dhe të kërkonin ndjesë për veprimet e ndërmarra. Patriarkana zotohej t'i falte. Avrami e quajti të papranueshëm përmbysjen e gjendjes, duke e cilësuar çnderim ndaj qeverisë dhe ortodoksëve të Shqipërisë. Ai tha se nuk do të kishte pranuar të bisedonte, nëse do ta dinte këtë kusht. Kryebashkiaku i Korçës fajësoi Patriarkanën që nuk pranoi të dërgonte episkopë shqiptarë, duke detyruar KOASH-in të kërkonte ndihmë nga kishat e tjera ortodokse, thirrje së cilës iu përgjigj Kisha Serbe.[1191]

Megjithatë, palët u njëmendësuan që Evlogji Kurilla të zgjidhej Kryepiskop, Hirësi Kristofori episkop i Korçës dhe Pandeli Kotoko episkop i Gjirokastrës. Hirësi Agathangjeli do të pranohej në qarkun kishtar që drejtonte: Berat. Hirësi Ambrozi dhe

---

[1185] AMPJ, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 26 nëntor 1929, cit.
[1186] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 60.
[1187] AMPJ, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 26 nëntor 1929, cit; dhe Tasudhis, *Kujtime biografike*, 61.
[1188] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 61.
[1189] Vasilios Kondis, *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 4, 1930-1940*. [*Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet grekoshqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 4, 1930-1940]* (Athinë: Estia, 1995, 49-53: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, pa nr., Shënim i Zyrës së Parë Politike MPJG për bisedimet për Çështjen Kishtare të Shqipërisë, 12 qershor 1930.
[1190] AMPJ, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 26 nëntor 1929, cit.
[1191] Po aty.

Hirësi Eugjeni do të përligjnin dorëheqjen me moshën e thyer, ndërsa Fortlumturi Visarioni do të tërhiqej në manastir.[1192] Të tre do të ruanin denjësinë kryepriftërore, pas faljes dhe njohjes patriarkale.

Hirësi Krisanthos i tha Avramit se kjo ishte fjala e fundit e Patriarkanës.[1193] Kryebashkiaku i Korçës shfaqi kënaqësinë për marrëveshjen dhe falënderoi Patriarkanën për qëndrimin e përkorë.[1194] Ministri i Jashtëm, Rauf Fico, e përkrahu marrëveshjen. Ai njoftoi ambasadorin Melas, se do të kërkonte miratimin e shpejtë në Këshillin e Ministrave.[1195] Vasil Avrami u kthye në Korçë më 15 dhjetor.[1196] Mirëpo, marrëveshja nuk u prit mirë në Tiranë, krejt ndryshe nga parashikimi. Kundërshtimi vinte nga Kryeministri Koço Kota, i cili bindi Avramin që Shqipëria nuk duhet të bënte lëshime.[1197] Paria ortodokse e Korçës tëhuajti rreptësisht ujdinë, pas ndërhyrjes së Kotës.[1198] Qeveria përligji mospranimin e marrëveshjes, me arsyetimin se ndryshimi i rendit kishtar do të sillte kundërshtim të ashpër nga atdhetarët ortodoksë.[1199]

Mbreti Zog i bëri të ditur Greqisë qëndrimin zyrtar. Ai i shpalli ambasadorit Melas se prania e nenit 5 për pakicat ishte e papranueshme për Shqipërinë, pasi kishte natyrë politike. Mbreti sugjeroi rregullimin e të drejtave për pakicën greke në një tjetër marrëveshje të nënshkruar mes qeverive; një orvatje që synonte marrëdhënie të ndërsjella me Greqinë.[1200] Shqipëria nuk kishte asnjë vështirësi prej atij neni, shumë më i zbutur se Protokolli i Tiranës apo detyrimet e marra para Lidhjes së Kombeve. Mirëpo, Zogu kërkonte të drejta të ndërsjella të pakicës greke në Shqipëri me pakicën shqiptare në Çamëri. Qeveria greke e kuptoi arsyen e sugjerimit, ndaj nuk pranoi.[1201]

Gjithashtu, Mbreti Zog kërkoi zgjedhjen Kryepiskop të Mitropolit Joakimit ose Kristoforit. Ata do të dorëzonin më vonë Pandeli Kotokon. Mitropoliti i Gjirokastrës Ambrozi do të emërohej zëvendësisht Kryetar i Sinodhit të Shenjtë, deri në trupëzimin e Kishës.[1202] Përjashtimi i Evlogji Kurillës u arsyetua me natyrën e shumanshme, jo thjesht fetare të tij. Fico rrëfente se Shqipëria kishte pasur përvojën e hidhur nga veprimet e Fan Nolit dhe nuk pranonte të rrezikonte për së dyti.[1203] Rikthimi i Joakimit dhe Kristoforit u përhap shpejt edhe në shtypin shqiptar. Lajmi u përgënjeshtrua menjëherë nga Ministria e Brendshme.[1204] Qeveria u tregua më e matur pas dështimeve të kaluara. Ajo urdhëroi heshtje në lidhje me detyrën e Avramit, derisa të përfundonte çështja.[1205]

Shenjat e para të synimit qeveritar u dhanë në fillimvitin 1930. Qeveri cyti zëra kundër Fortlumturi Visarionit brenda bashkësisë ortodokse. Ambasada greke gjykonte se kjo ishte një përpjekje për të arsyetuar shkarkimin e mundshëm të Visarionit. Largimi nga

---

[1192] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 61.
[1193] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, nr. 1083, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930.
[1194] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 61.
[1195] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-53: IDAYE, Shënim, cit.
[1196] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 15 dhjetor 1929.
[1197] Meta, "Debati shqiptarogrek...", 37-61.
[1198] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-53: IDAYE, Shënim, cit.
[1199] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.
[1200] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-53: IDAYE, Shënim, cit.
[1201] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.
[1202] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-53: IDAYE, Shënim, cit.
[1203] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.
[1204] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar prefekturave, 24 dhjetor 1929.
[1205] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 130, f. 1, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 10 janar 1930.

drejtimi i Kishës duhej lexuar si kërkesë e brendshme dhe jo shtrëngim nga Patriarkana. Gjithsesi, kjo ishte e panevojshme përkohësisht. Sugjerimet e palës shqiptare hasën kundërshtimin e Patriarkanës, që i quajti shkelje të marrëveshjes së 9 dhjetorit.[1206]

Përgjigjja shqiptare vonoi dy muaj. Vendi kaloi një trazirë politike që çoi në dorëheqjen e qeverisë së Koço Kotës. Pasardhësja do të ruante qëndrimin atdhetar në çështjen kishtare. Kryesimi iu besua bashkëdrejtuesit të lëvizjes, Pandeli Evangjeli. Vasil Avrami u emërua ministër i Drejtësisë, përgjegjës edhe për fetë. Ndryshimi ngjalli për pak kohë shpresat e Athinës. Ministri i Jashtëm grek, Mihalakopulos, mendonte se emërimi i Avramit do ta bënte më të lehtë zhdukjen e kundërshtimeve të lindura për marrëveshjen e 9 dhjetorit. Megjithatë, qëllimet e qeverisë së re u dukën shumë shpejt. Mihalakopulos udhëzoi Melasin të takonte Evangjelin dhe Avramin dhe t'u shprehte dëshirën për zgjidhjen e çështjes kishtare. Dashamirësia shoqërohej nga një kërcënim i hapur: Athina kushtëzonte zgjidhjen me çështjen e pronave të shqiptarëve në Greqi, për të cilat shprehej se nuk kishte ndonjë detyrim ndërkombëtar.[1207]

Shtypi grek u përpoq të arsyetonte fjalët e rënda. Tashmë, shkruhej se askujt në Greqi nuk i kishte shkuar në mendje ndërhyrja greke në çështjen kishtare mes ortodoksëve shqiptarë dhe Patriarkanës Ekumenike. Kundërveprimi përligjej me ndjeshmërinë e grekëve ndaj shkeljes të së drejtave të ortodoksëve.[1208] Shtypi grek do të botonte vetëm një shkrim kundër Shqipërisë, përgjatë fundvitit 1929 dhe fillimvitit 1930. Ai njoftonte krijimin e shoqatës "Dora e Zezë", drejtuar nga ministri Rauf Fico, që synonte vrasjen e ortodoksëve. Rrena vijonte se Koço Kota, Irakli Noçka dhe Zef Sereqi kishin kundërshtuar ashpër dhe viktimë e parë ishte prifti i Humelicës. Mirëpo, as kjo rrenë nuk kishte pikënisjen në Greqi, por vinte nga Beogradi.[1209]

Qeveria shqiptare pranoi nenin 5 për pakicat në qershor, me kusht që ai të rishkruhej. Marrëveshja Avrami-Krisanthos përmbante: "Njëmendësohen se shpallja e bërë përpara Këshillit të Lidhjes së Kombeve nga Qeveria Shqiptare më datë 2 tetor 1921, do të zbatohet tërësisht". Ndryshesa e qeverisë shqiptare shënonte: "Për ushtrimin e adhurimit të tyre hyjnor, qytetarët shqiptarë të racës dhe gjuhës greke do të vijojnë të kenë, sikurse edhe sot, edhe në të ardhmen, të gjitha të drejtat e përdorimit të gjuhës së tyre".[1210]

Ambasadori Melas e vlerësonte ndryshimin të pranueshëm. Ai theksonte se lëshimet ndaj grekëve nuk shoqëroheshin me lëshime ndaj pakicave të tjera. Melas mendonte se Greqia mund të përfitonte nga rasti për t'u hakërryer ndaj Patriarkanës Serbe. Ai arsyetonte se Jugosllavia nuk kishte gojë të kundërshtonte pas veprimit të një viti më parë në mbështetje të Kishës Shqiptare.[1211] Ambasadori britanik në Tiranë,

---

[1206] Kondis, *Elinizmos IV,* 49-53: IDAYE, Shënim, cit.

[1207] Kondis, *Elinizmos IV,* 44-46: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, nr. 3461, MPJG drejtuar Ambasadës së Tiranës, 19 mars 1930.

[1208] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 138, f. 270, Fletorja Pitharhia, 6 prill 1930.

[1209] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 138, f. 80, Fletorja Klio, 31 janar 1930; dhe AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 138, f. 166, Fletorja Ethnos, 23 janar 1930.

[1210] Kondis, *Elinizmos IV,* 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.

[1211] Serbia ndiqte zhvillimet. Konsulli jugosllav kishte pyetur prefektin e Korçës, Hil Mosin, më 23 prill. Mosi bëri të paditurin, duke u shprehur se nuk dinte nëse kishte bisedime, porse gjithsesi ato nuk do të ishin të vlefshme. Konsulli pyeti nëse kishte ndonjë përfitim ekonomik, mirëpo Mosi tha se jo vetëm ortodoksët, por edhe myslimanët dhe katolikët kombëtarë do të ishin të gatshëm të ndihmonin, po të ishte për të holla, pasi KOASH ishte një çështje kombëtare. Mosi shprehu keqardhjen që Kisha Serbe nuk e njohu siç kishte premtuar, por konsulli iu përgjigj se faji ishte i Shqipërisë për mozbatimin e detyrimeve ndaj Viktorit. Mosi

Hodgson, ndante mendim të njëjtë. Ai i tha diplomatit grek se Patriarkana Ekumenike do të shihej si vegël e Greqisë, nëse nuk pranonte marrëveshjen.[1212]

Çështja e emrave u trajtua sërish nga qeveria shqiptare. Ajo pranonte Kristoforin dhe Joakimin, pa pasur parapëlqim për Kryetar të Sinodhit, me kusht që Ambrozi të ishte zëvendësisht Kryetar deri në përfundimin e formaliteteve. Pandeli Kotoko do të dorëzohej episkop brenda tre muajve.[1213] Avrami ishte i gatshëm të nisej për në Athinë ose Stamboll për nënshkrimin e marrëveshjes, nëse Patriarkana pranonte ndryshesën shqiptare. Mosdorëzimi i menjëhershëm i Kotokos arsyetohej me kohën që kërkonte dorëzimi në dhjak, prift dhe së fundmi episkop. Pala greke shihte dashakeqësi te kjo vonesë, teksa qeveria shqiptare nuk jepte siguri për dorëzimin përfundimtar të Kotokos. Pandeliu përbënte një rëndësi të veçantë për Athinën. Ai do të ishte besniku grek brenda Sinodhit. As Joakimi, as Kristofori, as Ambrozi, as Kurilla nuk ishin të besuarit e Greqisë. Melas njoftonte se nuk do të kishte në Sinodh asnjë që të ishte i sigurt se nuk do të pranonte t'u shërbente qëllimeve të qeverisë shqiptare, deri në zgjedhjen e mëvonshme dhe të pasigurt të Kotokos.[1214] Pala greke kërkoi zotim me shkrim që Kotoko do të dorëzohej pas tre muajsh. Ministri i Jashtëm Fico pranoi të zotohej vetëm me gojë, çka vendosi Melasin në dyshime. Mosbesimi u kthye në bindje, kur Kryeministri Pandeli Evangjeli e parapa dorëzimin "brenda vitit" dhe jo më në tre muaj.[1215]

Bisedimet e reja dështuan. Melas i tha Ficos se ndryshesat shqiptare "vështirësisht mund të cilësohen të pranueshme". Ai shihte mungesë maturie për shkak të mosnënshkrimit të një zotimi zyrtar. Melas arsyetonte se Kurilla mund të zëvendësonte Kotokon dhe të bëhej vegël e verbër e qeverisë shqiptare, krah Joakimit dhe Kristoforit. Ambasadori vlerësonte se Greqia përfitonte vetëm në ndjenjën që do të krijohej te grekomanët se largimi i Visarionit ishte pasojë e ndërhyrjes greke. Melas e quante shtirje keqdashëse qëndrimin shqiptar se Avrami nuk kishte nënshkruar marrëveshje, por kishte ndarë mendime me Krisanthosin.[1216] Mirëpo, kjo ishte e parashprehur nga pala shqiptare, pasi Avrami ia pati thënë Hirësi Krisanthosit dhe ambasadori shqiptar në Athinë, Lec Kurti, kishte njoftuar eprorët në Tiranë, përpara se të përfundohej marrëveshja e 9 dhjetorit.[1217]

Melas shihte se ndër përgjegjësit: Evangjeli, Avrami dhe drejtuesit e kishës, vlonte një ndjenjë kombëtarizmi i skajshëm. Ortodoksët shqiptarë vlerësoheshin të dehur nga pavarësia dhe ishin të bindur se mendimet e tyre do të ngadhënjenin, duke u përplasur akoma edhe me fuqitë e mëdha. Ai shihte në prapaskenë dorën e Italisë, që vendoste Shqipërinë kundër Greqisë.[1218] Melas dallonte ndërhyrje italiane edhe në sugjerimin e Hirësi Joakimit, duke kujtuar bashkëpunimin e tyre gjatë Luftës së Parë Botërore.[1219]

---

i tha se shumica ishin shqiptarë nga 3900 ortodoksët e Shkodrës. AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 23 prill 1929.; dhe AQSH, F. 317 "Prefektura Korçë", D. 197, f. 113.

[1212] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.

[1213] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-53: IDAYE, Shënim, cit.

[1214] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.; IDAYE, Shënim, cit.

[1215] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.

[1216] Po aty.

[1217] AMPJ, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 26 nëntor 1929, cit.

[1218] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.

[1219] Meta, "Debati shqiptarogrek...", 37-61.

Ambasadori përfundonte se nevojitej shfuqizimi i ligjit për bashkësitë fetare i vitit 1929, që përcaktonte se episkopët duhet të ishin shqiptarë dhe mund të pushoheshin nga Mbreti, nëse merreshin haptazi apo tërthorazi me politikë.[1220] Ai frikësohej se çdo marrëveshje mund të prishej sapo të nënshkruhej Tomosi, pasi shqiptarët ishin zotër të gjendjes.[1221] Shembulli i dhënë me dëbimin e Hirësi Viktorit kishte fuqizuar mëdyshjen greke. Melas paralajmëronte edhe mundësinë e shtimit të episkopëve, si mënyrë për shqiptarizimin e kishës. Ai arsyetonte se do t'ia vlente të përpiqeshin edhe pa pasur siguri të plotë, nëse do të kishim përballë një shtet tjetër, që do të njihte zbatimin e detyrimeve. Mirëpo, ai vlerësonte se kjo ishte e rrezikshme me Shqipërinë.[1222]

Dështimi i bisedimeve nuk u njoftua. Përfaqësuesit politikë të dy vendeve ruanin dyert e hapura. Melas iku nga Tirana dhe Mbreti Zog priti zëvendësuesin e përkohshëm Pipinelis në fillimshtator. Ai tha se Patriarkana dhe qeveria greke nuk duhet të tregonin kaq shumë këmbëngulje në qindvjeçarin XX që çështjet kishtare nuk ndikonin te popujt si dikur, sidomos në një vend me bashkëjetesë si Shqipëria. Zogu kërkoi që Patriarkana të mos kërkonte kushte të papërputhshme me frymën e kohës dhe që fyenin denjësinë e popullit shqiptar. Pipinelis nuk ndau të njëjtin mendim. Ai tha se historia e popujve kishte treguar që çështjet kishtare ishin shfaqje e nevojave më të thella shoqërore. Sipas diplomatit grek, lidhja shpirtërore me Kishën e Madhe nuk mund të mënjanohej në rastin e shqiptarëve. Pipinelis tha se KOASH ishte në një vend me shumicë myslimane dhe Patriarkana i kishte kërkuar po aq sa Kishës në Dodekanez, që ishte në Italinë me shumicë të krishterë. Ai tha se Greqia nuk mund të kërkonte më shumë lëshime nga Patriarkana, pasi si shtet ortodoks nuk mund të sugjeronte thyerjen e kanoneve.[1223]

Zogu pohoi se Shqipëria ishte shtet laik dhe shfaqi gatishmërinë të niste një dërgatë shqiptare në Stamboll ose në Athinë. Dërgata do të përbëhej nga anëtarët e sugjeruar të Sinodhit ose nga të tjerë. Ai shprehu gatishmërinë për përfundimin e çështjes dhe kërkoi përkujdesjen greke, nëse bisedimet kryheshin në Athinë. Pipinelis udhëzoi qeverinë e tij të vononte çfarëdo zhvillimi deri sa Rauf Fico të largohej nga Ministria e Jashtme, pasi ishte kundërgrek. Gjithçka do të lehtësohej nëse emërohej filogreku Hysni Vrioni, siç përflitej. Pipinelis mendonte se Greqia duhet ta pranonte fjalëpërzgjedhjen shqiptare për nenin për pakicat. Ai anashkaloi çështjen e episkopëve dhe u përqendrua në ligjin për bashkësitë fetare. E drejta e ndërhyrjes në drejtimin e Kishës nuk mund t'i mohohej Shqipërisë, pasi ishte traditë e Kishës Ortodokse. Ai sugjeronte përfshirjen e një neni të ri, për tejkalimin e ngërçit. Neni do të caktonte se Sinodhi dhe qeveria do të trupëzonin Kishën sipas përcaktimeve të Tomosit. Kjo nënkuptonte se ndryshimi i ligjeve mbi Kishën do të kryhej me njëmendësi të Sinodhit të Shenjtë, në të ardhmen.[1224]

Përgjigjja zyrtare greke u shty derisa ministri i Jashtëm, Mihalakopulos, të kthehej nga Gjeneva.[1225] Çështja kishtare ishte e pandashme nga çështjet e tjera mes dy vendeve, si pakicat e ndërsjella dhe pronat e shqiptarëve në Greqi. Shtypi grek njoftonte rrejshëm zgjidhjen, më 11 nëntor. "Kirkis" shkruante më 11 nëntor 1930 se Kisha Shqiptare ishte e

[1220] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-53: IDAYE, Shënim, cit.
[1221] Meta, "Debati shqiptarogrek...", 37-61.
[1222] Kondis, *Elinizmos IV*, 54-64: IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 12 korrik 1930, cit.
[1223] Kondis, *Elinizmos IV*, 71-82: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, nr. 11781, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 9 shtator 1930.
[1224] Po aty.
[1225] Kondis, *Elinizmos IV*, 85-91: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, nr. 12674, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 15 tetor 1930.

gatshme të njëmendësohej me Patriarkanën, pasi nuk u njoh nga Kisha Serbe.[1226] Ajo shtonte të nesërmen se një dërgatë fetarësh shqiptarë pritej të nisej në Stamboll.[1227]

Zgjidhja nuk u arrit as në takimin diplomatik të radhës mes ambasadorit të ri grek në Tiranë, Kola, dhe Vasil Avramit. Ministri i Drejtësisë shprehu bindjen se Patriarkana do të pranonte heqjen e nenit mbi pakicat. Ndërkaq, Avrami tha se largimi i episkopëve me dekret mbretëror duhej mundësuar për raste shumë të veçanta. Ambasadori Kola u përgjigj se u takonte patriarkanave të vendosnin nëse ligji ishte i pranueshëm për zgjidhjen e çështjes kishtare.[1228]

Pala greke nuk u përgjigj zyrtarisht. Mirëpo, as pala shqiptare nuk ngutej. Shqipëria nuk do të tërhiqej, siç kishte parashikuar Mitropoliti i Korfuzit, Athinagora. Ajo e vlerësonte çështje denjësie dhe nuk kishte trysni ndërkombëtare. Ministria e Jashtme shënonte në një përkujtesë të atyre ditëve se gjykimet greke nuk duhet të pranoheshin. Mendimi mbizotërues ishte mosndërrimi i episkopëve. Tërheqja do të shihej si përulje para Greqisë. Tre kryepriftërinjtë kishin shërbyer kur ishte nevoja dhe nuk mund të lihej përshtypja që "Patriarkana mundi dhe i rrëzoi" apo që ajo solli episkopët zëvendësues.[1229]

Njohja nga Kisha Mëmë çmohej e rëndësishme, për të arritur përafrimin shqiptaro-grek dhe për t'u bërë ballë fushatave serbe dhe unite. Ndaj, përkujtesa paraqiste një rrugëzgjidhje: Kisi dhe Joakimi do të thirreshin fshehtazi, për të mos menduar se ishin të dërguar të Patriarkanës, porse ishin thirrur prej Mbretit dhe Atdheut. Zëvendësimi i kryepriftërinjve do të bëhej përpara nënshkrimit të marrëveshjes me Patriarkanën. Mirëpo, edhe marrëveshja duhet të kishte ndryshime. Së pari, Tirana duhet të përcaktohej qendër e KOASH-it dhe Mitropoliti i qendrës duhet të quhej Kryepiskop i Shqipërisë, sipas Statutit të Kishës Autoqefale. Marrëveshja duhet të caktonte se Agathangjeli do të mbeste Mitropolitit i Beratit. Çelja e shkollave fetare duhet të bëhej sipas përcaktimeve të Statutit Themeltar të Mbretërisë. Ndërsa, Mbreti duhet të kishte të drejtë të hiqte dekretin e emërimit të episkopëve, kur e lypte nevoja. Përkujtesa përfundonte se gjuha e kërkesave të faljes të episkopëve të rrëzuar duhet të ishte më e matur.[1230]

Greqia kishte dalë në skenë për herë të parë, si bashkëbiseduesja zyrtare e palës shqiptare. Ajo përligjte ndërhyrjen, duke thënë se ishte një "shtet ortodoks" që përkujdesej për bashkëfetarët, edhe pse ortodoksët në Shqipëri ishin në masë dërrmuese shqiptarë. Mirëpo, pala shqiptare nuk ishte e gatshme të bënte lëshime të panevojshme. Ajo nuk i dha Athinës të drejtën ta trajtonte si çështje dypalëshe, por vetëm si një "ndihmesë greke" përkundrejt Patriarkanës. Palët fajësuan njëra-tjetrën për dështimin e pashpallur të bisedimeve. Melas ishte shfaqur i zemëruar, duke e quajtur pabesi qëndrimin kundrejt marrëveshjes së 9 dhjetorit. Pala shqiptare e vlerësonte të pakuptimtë këmbënguljen greke në një çështje të saj të brendshme. Ndërmjetësuesi jozyrtar, ambasadori britanik Hodgson, e shihte problemin te Greqia dhe te përdorimi i Patriarkanës si vegël e saj. Ai vlerësonte se grekët e kishin keqpërdorur çështjen dhe mendësia e tyre e kishte penguar mirëkuptimin me shqiptarët, pasi vërtetonin dyshimin se

[1226] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 138, f. 91, Fletorja Kirkis, 11 nëntor 1930.
[1227] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 138, f. 97, Fletorja Kirkis, 12 nëntor 1930.
[1228] Kondis, *Elinizmos IV*, 94-98: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, nr. 14949, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 19 nëntor 1930.
[1229] AMPJ, Shtesë Fondi 3, D. 300, f. 1-2, Përkujtesë e MPJ, pa datë.
[1230] Po aty.

Patriarkana ishte një maskë e Greqisë për të rritur ndikimin në Shqipëri. Hodgson e shihte të mundshëm kalimin e ortodoksëve shqiptarë drejt unitizmit, siç frikësohej Greqia. Ai bënte fajtor pikërisht "kryeneçësinë e [Greqisë] dhe nervozizmin e Melasit".[1231]

Zogu I i tha ambasadorit grek, më 14 prill 1931, se kriza qeveritare në Shqipëri e bënte të pamundur një dërgatë në Athinë për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të mbetura. Ai u zotua se do të kishte zhvillime pas mbylljes së krizës.[1232] Pala greke ishte gati për bisedime. Ajo urdhëroi shtypin të mos botonte asnjë shkrim kundër Shqipërisë dhe Mbretit Zog prej fillimshtatorit 1931.[1233] Edhe qeveria shqiptare ishte përgatitur të mos tërhiqej.[1234] Kryeministri Pandeli Evangjeli e quajti të paqenë ujdinë e dhjetorit 1929 mes Krisanthosit dhe Avramit. Ai premtoi se do t'i shqyrtonte nenet e saj për të parë nëse mund të përbënin bazë për një marrëveshje të ardhshme.[1235]

Bisedimet do të shtyheshin për shkak të rrethanave politike. Vonesa u la hapësirë të papriturave. Atdhetari Leonidha Naçi takoi Mitropolitin e Follorinës në maj 1931. Naçi i sugjeroi të bëhej Kryepiskop i Shqipërisë. Mitropoliti shkoi në Athinë për të shprehur gatishmërinë, duke menduar se Naçi kishte ndonjë plotfuqi.[1236] Edhe shtypi botoi shkrime se Mitropoliti i Follorinës do të shkonte shumë shpejt në Tiranë.[1237]

Gjendja e nderë në marrëdhëniet dypalëshe dallohej edhe ndër shqiptarët e Greqisë. Domethënës është kujtimi i arbërorit, Tasos Parasqevopulos, anëtar i Këshillit Bashkiak të Athinës. Ai mori pjesë në Kongresin Ballkanik të Bashkive në Tiranë, në vitin 1931. Parasqevopulos zbriti në Elbasan, ku përshëndeti parinë e qytetit, duke shprehur vëllazërinë. "Jemi vëllezër, por ne jo grekë, por shqiptarë", – iu përgjigj prerazi farmacisti Taqi Buda, me të cilin u bë mik. Buda i sqaroi se kishin dashur ta paraqisnin si grek, kur kishte studiuar në Athinë, gjë të cilën ai e kundërshtonte.[1238] Parasqevopulos fjalosi shqip në Tiranë, duke rrëfyer rëndësinë e shqiptarëve në Greqi nga Xhavella te Pangalos e Repuli.[1239] Mirëpo, ai e shihte me sy të keq Mitropolitin Visarion. Parasqevopulos e takoi Kryepiskopin, por nuk arriti të bashkëbisedonte. Veshja e bukur dhe paraqitja mbizotëruese e Kryepiskopit i bënë përshtypje. Pamja vinte në kundërshti

[1231] Meta, "Debati shqiptarogrek...", 37-61.
[1232] Kondis, *Elinizmos IV*, 103: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, nr. 5336, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 14 prill 1931.
[1233] Kondis, Elinizmos IV, 115: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/I, nr. 11220, MPJG drejtuar Zyrës së Shtypit, 3 shtator 1931.
[1234] AMPJ, V. 1931, D. 70, f. 1-11, Përkujtesë për të ngarkuarin për bisedimet grekoshqiptare V. Avrami.
[1235] Kondis, Elinizmos IV, 126-129: IDAYE, V. 1930-1931, D. A/4/ Iβ, nr. 1948, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 20 dhjetor 1931.
[1236] AMPJ, V. 1931, D. 70, f. 12, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 15 maj 1931.
[1237] AMPJ, V. 1931, D. 73, f. 221, Fletorja Indipendent, 10 qershor 1931.
[1238] Tasos P. Paraskevopulos, *Δεκαπέντε ημέραι εις την Αλβανία [Pesëmbëdhjetë ditë në Shqipëri]* (Athinë: Pyrsou, 1931), 28.
[1239] "Neve greqishtë, nëk harrojmë kurr pse ndë luftë për independencën tën na ndihtë juve Shqiptarët. Kishim Kapetane ka deti, dhe Kapetane ka dheu gjithë trima, burra të fortë, Xhavella, Boçari, Miauli, Krieziu, Kunturioti. Mitsa, ndë gluhë Shqiptarishte thojnin ordërt ndë asqerë. Sot jemi ndë greçi milra shpyrtë çë flasmë gluhën shqiptarishte. Amiral Kunturioti flet shiptarisht. Kryetari i Bashkis Athinës Spiro Mërkuri, shumë gëzonet kur flet gluhën e zogivet. Sahturi, Ministre ndë Vjen, generalët Kondulis dhe Mica, Senator Stringo, Deputato Kosmai Panuci, general Pangalos, K. Repouli e mila të tjerë, shqiptarisht fllasën. Mëma jime s'dije grecisht po vetëm Shqiptarisht. E para fjalë tsë gjejsh ka mëma kur u lesh, ish fjale shqiptarishte. Mëma ime – t'i kem uratënë - më psoj gluhën shqiptare e sa herrë si sot kur çojn gjë okazione e përzihem me shqiptarë, më hapet zëmëra të flas shqiptarisht" Paraskevopulos, *Pesëmbëdhjetë ditë*, 39.

me mendimin e krijuar në Greqi. Parasqevopulos shkruante se kryeprifti ishte mirëpritur në Athinë, por ia doli të ftohte grekët e Shqipërisë dhe shumë ortodoksë shqiptarë, duke harruar t'i jepte mirënjohjen shpirtërore vendit ku studioi, u qytetërua dhe arsimua.[1240]

5.2. Fuqizimi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë

Sinodhi i Shenjtë i KOASH-it gjendej përpara një sfide të veçantë. Kisha kishte rigjetur drejtimin e dukshëm, për herë të parë pas 20 vitesh. Ringritja e domosdoshme në lavdinë që i takonte ishte beteja e kryepriftërinjve të rinj. Sinodhi ngriti grupe pune për çështje kishtare, ku spikasnin Aleksandër Xhuvani, Mihal Sherko, Zoi Xoxa, Kostaq Cipo, Sotir Papahristo, Agathokli Xhitomi, Thoma Turtulli etj. Pasurimi i Kishës me përfshirjen e intelektualëve më të njohur ortodoksë do ta ndihmonte në fuqizimin e shpejtë të brendshëm. Këshilli Ekonomik i Përhershëm përthithi ortodoksë të zëshëm. Anëtarë u zgjodhën deputetët Andon Beça dhe Stavro Stavri, ish-ministri Dhimitër Kacimbra, krahas rrobaqepësit të Mbretit, Mihal Shanit.[1241]

Kryepiskopi u kujdes të formonte pleqësitë kishtare në mbarë Mitropolinë e Tiranës dhe qarkun kishtar të Korçës, shembull që u ndoq në Berat dhe Gjirokastër. Kryeqyteti ishte i fundit që votoi në janar 1930. Një ndër mësuesit e parë të shkollës shqipe të Tiranës, dr. Athanas Shundi, u zgjodh zëvendësmitropolit.[1242]

Tirana do të caktohej qendra përfundimtare e Kishës. Kongresi i Dytë Kishtar kishte sjellë përplasje, sidomos ndërmjet përfaqësuesve të Korçës dhe atyre të kryeqytetit. Pajtimi ishte gjetur, duke ia lanë në dorë Mbretit. Neni 14 i Statutit përcaktonte se qendra e Kishës caktohej me dekret mbretëror dhe do të qëndronte deri atëherë në Korçë.[1243] Dekreti u miratua në fillimprill 1930 dhe zhvendoste qendrën në Tiranë. Vendimi u përligj me nevojën e lidhjes së Kryesisë së Kishës me qeveritarët.[1244] Lajmi u botua edhe në shtypin grek. "Proia" shkruante se shumica e banorëve të Korçës ishin të krishterë, duke e bërë atë kryeqytet të ortodoksisë në Shqipëri. Shkrimi nënqeshte se Fortlumturi Visarioni u zhvendos në Tiranë, ku kishte vetëm myslimanë e rrjedhimisht do të rrinte i qetë.[1245] Qendra e Sinodhit u vendos në shkollën dykatëshe në oborrin e Kishës së Ungjëllizimit.[1246] Kryeqyteti nuk kishte qenë më parë as qendër episkopale dhe si pasojë kishte shumë pak ndërtesa kishtare. Akoma edhe ndërtesa e Mitropolisë ishte kthyer në vendbanim të përkohshëm të Kryeministrit, që nga koha e Hirësi Theofan Nolit. Mitropolia do t'i rikthehej KOASH-it, fundvitin 1930.[1247] Për këto arsye, Sinodhi ngriti një komision të posaçëm për të shtuar dhe ndërtuar prona kishtare në kryeqytetin e Atdheut.[1248]

[1240] Paraskevopulos, *Pesëmbëdhjetë ditë*, 49.
[1241] "Deklarata VI", *Kisha Kombëtare*, 9 nëntor 1930, 1.
[1242] Anëtarët e tjerë ishin Leonidha Nishku, Kristo Luarasi, Krisanth Janku, Marko Hobdari dhe Gavril Lasku. "Dhimogjerondia e re e Komunitetit Orthodhoks të Tiranës", *Zëri i Korçës* nr. 468, 21 janar 1930, 2.
[1243] Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipris* (Korçë: Gazeta e Korçës, 1929).
[1244] "Qendra e Kishës Orthodhokse Autoqefale Vendoset në Tiranë", *Zëri i Korçës* nr. 490, 8 prill 1930, 1.
[1245] AMPJ, V. 1930, D. 138, f. 59, Fletorja Proia, prill 1930.
[1246] Kristofor Beduli, përg., *Atë Marko Papajani dhe shënimet e tij* (Tiranë: Neraida, 2004), 16.
[1247] "Kryesia e Kishës Orthodhokse në Mitropolin e Shenjtë", *Zëri i Korçës* nr. 563, 23 dhjetor 1930, 1.
[1248] "Deklarata V", *Kisha Kombëtare*, 9 nëntor 1930, 1.

KOASH ringriti strukturat kishtare në vend. Atë Josif Qirici u emërua zëvendësmitropolit i qytetit të Korçës. Ndërsa, Ikonomi i Madh Mitrofor Atë Vasil Marko u caktua drejtues i qarkut kishtar.[1249] Mirëbesimi i Episkopatës së Korçës në duart e Atë Vasilit bëri që secili prej anëtarëve të Sinodhit të drejtonte një qark kishtar, me përjashtim të episkopit ndihmës Eugjenit.

Fortlumturi Visarioni i dha rëndësi të veçantë numërimit të dytë të popullsisë të zhvilluar në vitin 1930. Ai u kërkoi besimtarëve të shpallnin me çiltërsi të dhënat vetjake. Kryepiskopi gjykonte se ishte detyrë e shenjtë e krishterë për një besimtar të mirë, të thoshte vetëm të vërtetën, akoma edhe kur ajo e dëmtonte.[1250] Rritja e atdhetarizmit shqiptar ishte shoqëruar me rritjen e numrit të ortodoksëve. Ata numëroheshin 20.1 për qind në vitin 1922, ndërsa Teki Selenica i numëronte 21.4%, pesë vite më vonë. Prirja rritëse u ruajt në numërimin e vitit 1930, që numëroi 22% ortodoksë në Shqipëri ose dy për qind më shumë sesa kur Kisha nuk ishte autoqefale.[1251] KOASH kishte 384 kisha të rregullta, 38 manastire dhe 300 kishëza që nuk çeleshin rregullisht, në një total prej 722 ngrehinash besimi dhe rreth 400 priftërinj.[1252]

Pjesa ekonomike përbënte kokëçarjen kryesore. Sinodhi hartoi dhe votoi një buxhet të qendërzuar për herë të parë. Të ardhurat do të vinin kryesisht nga dhuratat dhe arka e kishave e manastireve, pa taksa të veçanta për besimtarët.[1253] Këshilli Mikst kishte hartuar një buxhet prej 216 mijë frangash ari, nga të cilat 50 mijë ishin ndihmë shtetërore.[1254] Mirëpo, ndihma u përgjysmua, për shkak të vështirësive ekonomike. Kisha u detyrua ta ulte buxhetin në 162 mijë franga ari. Sinodhi uli veçanërisht shpenzimet e manastireve, të cilat nuk duhet të kishin për qëllim dëfrimin, por lartësimin dhe shpëtimin e shpirtit. Manastiret u urdhëruan të hiqnin ushqimin, si në mbarë kishat e Ballkanit dhe të shisnin gjënë e gjallë deri në fundmarsin 1930. Njëkohësisht, rrogat e shërbëtoreve të mitropolitëve u zhbënë dhe detyra e dhjakut u lidh me atë të sekretarit.[1255]

Hirësi Agathangjeli kundërshtoi ashpërsisht ndryshimet, duke fajësuar Xhuvanin se kishte përvetësuar fuqitë e Këshillit Ekonomik.[1256] Ai kërkoi të vizitonte Tiranën për t'i ndarë mendimet gojazi.[1257] Fortlumturi Visarioni iu përgjigj prerë se nuk duhet të kalonte kufirin e qarkut kishtar deri në një lajmërim të ri, për arsye me rëndësi dhe për të mirën e vetë Agathangjelit.[1258] Episkopi i Beratit e falënderoi shpirtmirësinë e Shenjtërisë dhe i kërkoi leje, pasi duhet të gjendej doemos në Tiranë për dobi vetjake.[1259] Kryepiskopi e mbylli bashkëbisedimin me një "letër nate", të dërguar pas pak orësh. Ai shkruante se dobia e Kishës ishte më e lartë se vetjakja dhe kanosi Hirësi Agathangjelin me pasoja të padëshiruara, nëse shkonte në Tiranë pa leje, çka do të gëzonte armiqtë e Kishës dhe Kombit.[1260] Fortlumturia i kërkoi qeverisë ta këshillonte Agathangjelin të mos

[1249] "Transferimi i Kryesis së Kishës Orthodhokse Autoqefale në Kryeqytet", *Zëri i Korçës* nr. 491, 12 prill 1930, 1.
[1250] "Një apel për regjistrimin popullit orthodhoks shqipëtar", *Zëri i Korçës* nr. 501, 20 maj 1930, 1.
[1251] Arqile Bërxholli, *Bashkësia shoqërore ortodokse në Shqipëri* (Tiranë: 2013), 48-52.
[1252] AMPJ, V. 1932, D. 268, f. 2, KOASH drejtuar MPB, 15 prill 1932.
[1253] "Deklarata V", 1.
[1254] AQSH, F. 155 "MD", D. VIII-93, f. 1, Buxheti i KOASH, pa datë.
[1255] Xhuvani, *Vepra*, 88-165.
[1256] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-127, f. 2, Mitropolia Berat drejtuar KOASH, 24 shkurt 1930.
[1257] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-127, f. 3, Mitropolia Beratit drejtuar KOASH, 28 shkurt 1930.
[1258] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-127, f. 4, KOASH drejtuar Mitropolisë Berat, 28 shkurt 1930.
[1259] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-127, f. 5, Mitropoli Berat drejtuar KOASH, 28 shkurt 1930.
[1260] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-127, f. 6, KOASH drejtuar Mitropolisë Berat, 28 shkurt 1930.

këmbëngulte.[1261] Përplasja mes kryepriftërinjve do të përsëritej pak muaj më vonë, pas kërkesës së Kryepiskopit për rizgjedhjen e anëtarëve të mëparshëm të Këshillit Mikst. Hirësi Agathangjeli kundërshtoi. Ai sugjeroi ish-kryesekretarin, Zoi Xoxa, si anëtar të ri, duke mposhtur mendimin e Kryepiskopit.[1262] Në të vërtetë, përplasjet tregonin se Kisha po drejtohej rregullisht. Vendimmarrja ishte e përbashkët, sipas traditës së Kishës Ortodokse, dhe përplasjet parimore ishin të pashmangshme, sidomos në fushën e qeverisjes kishtare.

Sinodhi i Shenjtë dhe Këshilli Mikst numëronin një sërë arritjesh në më pak se një vit. Ata kishin krijuar për herë të parë një amëz për pasuritë e manastireve, kishave, bashkësive, besimtarëve të martuar dhe vullnetarëve. Priftërinjtë kishin dosjet përkatëse me fotografi dhe jetëshkrim dhe rendi kishtar ishte siguruar.[1263] Uratat u ndaluan të qëndronin me orë të gjata në dyqane apo kafene, çka vlerësohej e padenjë. Ata duhet të ishin shembuj të pastërtisë dhe sjelljes atërore e fisnike.[1264]

KOASH rendi në ndihmë të nevojtarëve. Sinodhi krijoi një zë të përvitshëm në buxhet dhe vendosi të ngrinte katër ngrehina mirëbërëse, një për çdo qark kishtar.[1265] Streha e pleqve u ngrit në Manastirin e Shën Prodhromit në Voskopojë të Korçës. Jetimorja u vendos në Manastirin e Pepelit në Gjirokastër, ndërsa një strehë për të sëmurët mendorë dhe shpirtërorë u krijua në Manastirin e Zvërnecit afër Vlorës, pjesë e qarkut kishtar të Beratit. Mitropolia e Tiranës-Durrësit do të ngrinte një strehë për priftërinj pleq dhe të varfër, si edhe për ata që kishin zell të vërtetë për vetmi murgjërore, në Manastirin e Shën Joan Vladimirit në Shpat të Elbasanit.[1266]

KOASH-i veçonte si arritje rrogat e plota të priftërinjve. Ata paguheshin nga bashkësitë vendore dhe të ardhurat e kishave, deri në vitin 1930. Buxheti i ri kishtar parashikoi për herë të parë një zë prej 14 mijë frangash ari për rrogat. Pagesa pikëllonte Greqinë. Ambasada greke në Tiranë shënonte se dëmi ishte i vetëkuptueshëm për sa i përket bindjes së priftërinjve ndaj Patriarkanës.[1267]

Buxheti parashihte pagesa për Kryepiskopin, episkopët, Ikonomin e Madh Mitrofor, llogaritarin e përgjithshëm, një njëjtëshkrues, një dhjak, dy shërbëtorë, anëtarët e Këshillit Mikst e Këshillit Ekonomik të Përhershëm, një sekretar për çdo qark kishtar dhe 20 zëvendësmitropolitë. Pjesa më e madhe e buxhetit trajtonte mbajtjen e një seminari ortodoks, bursa teologjie, përkthime, botime, festime, ndihmën e nevojtarëve dhe ndërtimin e kishave, ngrehinave mirëbërëse e koreve kombëtare. Fortlumturi Visarioni u përkujdes për zbatimin e buxhetit dhe fuqizimin ekonomik të Kishës. Ai mbikëqyrte mbarëvajtjen e arkave në Mitropoli dhe kërkonte vazhdimisht të dhëna për zbatimin e të ardhurave të parashikuara nga episkopatat.[1268]

Mbledhja e gushtit e Sinodhit të Shenjtë solli një pasqyrë të pakëndshme.[1269] Të ardhurat ishin arritur pjesërisht. Ato tejkaluan me vështirësi 70% të parashikimit në

[1261] AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-127, f. 1, KOASH drejtuar MD, 1 mars 1930.
[1262] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 190, f. 57-63, KOASH drejtuar MPB, tetor 1931.
[1263] "Deklarata V", 1.
[1264] Xhuvani, *Vepra*, 97-98.
[1265] *Zëri i Korçës* nr. 446, 5 nëntor 1929, 4.
[1266] "Sinodhi i Shenjtë dhe vepërimet e tij", *Zëri i Korçës* nr. 448, 12 nëntor 1929, 4.
[1267] Kondis, *Elinizmos IV*, 43-44: IDAYE, V. 1929-1930, D. A/22/iβ, nr. 2665, Ambasada e Tiranës drejtuar MPJG, 17 shkurt 1930.
[1268] Xhuvani, *Vepra*, 93-94.
[1269] Xhuvani, *Vepra*, 101-102.

fundvit. Sinodhi dhe Këshilli Mikst u bënë thirrje besimtarëve, nga më i pasuri te më i skamuri, të mos kursenin ndihmat për të arritur të ardhurat e parapara për vitin 1931.[1270] Njëherazi, ata vendosën pakësimin e buxhetit.[1271] Kisha arriti fuqizimin ekonomik gjatë viteve në vijim, duke hartuar buxhete gjithnjë e në rritje. Kjo mundësohej nga të ardhurat që linin besimtarët dhe dhurimet e veçanta.

Fortlumturi Visarioni dhe Sinodhi u kujdesën të fuqizonin jetën shpirtërore, duke shmangur tradita të cilësuara të këqija, sidomos në kremtimet e vdekjes. Kryepiskopi urdhëroi mbulimin e të vdekurve në rrugëtimin nga shtëpia në varreza, për të shmangur rrezikun shëndetësor. Vendimi u zbatua në mbarë vendin.[1272] Njëherazi, ai urdhëroi mosrënien e kambanave për çdo vdekje në qytete. Ato shkaktonin shqetësimin e qytetarëve sidomos në Korçë, ku ndodhnin disa vdekje në ditë, për shkak të numrit të madh të ortodoksëve.[1273] Sinodhi ndaloi të kënduarit me zë të lartë në varrime të priftërinjve dhe psaltëve.[1274] Ortodoksët e Shkodrës shoqëronin të vdekurit me ulërima, gërthitje dhe britma. Fortlumturi Visarioni e vlerësonte traditën të përkundërt me ortodoksinë, si idhujtari të pafesh. Ndaj, urdhëroi ndalimin e menjëhershëm.[1275] Bashkësitë ortodokse vendosën kufizimin e dasmave në një natë dhe me numër të vogël të ftuarish. Kryepiskopi ndaloi hedhjen e sendeve mbi të kurorëzuarit gjatë orës së kremtimit të martesës, që ulte rëndësinë e shërbesës dhe trazonte misterin e shenjtë.[1276] Fortlumturia urdhëroi mospërdorjen e ikonave të dala nga piktorë të pazotë.[1277] Ndërkaq, tejkaloi vetveten në çështjen e korit kishtar. Ai kishte kundërshtuar ashpër sjelljen e korit rus nga Hirësi Theofani. Mirëpo, Pleqësia Kishtare e Tiranës, nën drejtimin e tij, ngriti një komision për rithemelimin e korit, më 25 maj.[1278] Pleqësia la një muaj kohë, por u nevojit plot gjysmë viti. Një rus u vendos sërish në krye të korit, kur u rishfaq, më 28 nëntor 1929.[1279] Shtypi e vlerësoi si arritje, por kërkonte përmirësime.[1280] Edhe qarqet e tjera do të ngrinin kore kishtare, me të fundit Gjirokastrën në dhjetor 1930.

Shqipëria kishte nevojë të ngutshme për botimin e librave kishtarë. Gjatë vitit të parë, u botua libri i shërbesave të shenjta, i të Kremteve të Mëdha, Shërbesa e Vajit të Bekuar, Ungjilli i Madh dhe Apostulli, secila e ndarë në 365 pjesë të përditshme.[1281] Po ashtu, libri "Predikime praktike" për dobi shoqërore-shpirtërore dhe atdhetare u dha për botim.[1282] Librat u botuan në shtypshkronjat e Korçës: "Dhori Koti", "Djelli" dhe "Gutemberg".[1283]

Njëherazi, Kryepiskopi nisi botimin e të përjavshmes kishtare "Kisha Kombëtare", e cila përmbante edhe predikimet e çdo të diele. Hirësi Visarioni shihte dobi

---

[1270] "Qarkore", *Kisha Kombëtare,* 9 nëntor 1930, 2.
[1271] Xhuvani, *Vepra,* 75-76.
[1272] "Një mas'e urtë e Sinodhit të Shenjtë", *Gazeta e Re* nr. 166, 22 maj 1929, 2.
[1273] "Sinodhi i Shenjtë iu dha fund punëve të tij", 3.
[1274] Xhuvani, *Vepra,* 75-76.
[1275] Xhuvani, *Vepra,* 129-130.
[1276] Xhuvani, *Vepra,* 75-99.
[1277] "Deklarata V", 1.
[1278] Komisioni përbëhej nga dr. Athanas Shundi, Marko Hobdari, Theodhor Papamihali, Z. Pano, Zisi Morcka dhe Aleks Lubonja. "Formohet një kor kishëtar në Tiranë", *Gazeta e Re* nr. 169, 25 maj 1929, 1.
[1279] "Deklarata V", 1.
[1280] "Lajme nga Tirana", *Zëri i Korçës* nr. 454, 3 dhjetor 1929, 2.
[1281] Xhuvani, *Vepra,* 119-120.
[1282] *Gazeta e Re* nr. 141, 20 prill 1929, 3.
[1283] Xhuvani, *Vepra,* 98-99.

të shumëfishtë te e përkohshmja. Ai kërkonte nga priftërinjtë ta shpërndanin te besimtarët që dinin shkrim dhe këndim, si një ushqimin shpirtëror. Uratat do të hasnin zemërimin e Zotit, me varfërimin e arkave kishtare dhe ftohtësinë e popullit, nëse nuk do ta përhapnin.[1284]

Arsimi fetar do të gjente përkujdesjen më të madhe. Këshilli Mikst vendosi ngritjen e një arke të posaçme për mësimin e fesë në shkolla. Kryqmbajtës Josif Qirici u ngarkua të hartonte një lutësore për fëmijët.[1285] Librat shkollorë: "Historia e Dhiatës së Vjetër", "Historia e Dhiatës së Re", "Katekizmi i Krishterë Orthodhoksë" etj. u botuan në pak vjet.[1286]

Visarioni përgatiti grupin e parë të studentëve për teologji. Anglia u gjet si zgjidhje, në pamundësi për t'i nisur në universitetet e Ballkanit. Lëvizja përkonte me përpjekjet e bashkimit mes Ortodoksisë dhe Anglikanëve, që kulmonte botërisht në vitin 1933. Shkollat teologjike të Britanisë prisnin prej vitesh bursistë nga Ballkani. Visarioni arsyetonte se teologjia anglikane kishte bërë përparime të mëdha dhe u përshtatej nevojave të KOASH-it.[1287] Përkujdesja e katër studentëve të parë të nisur radhitej ndër sukseset e vitit të parë të Sinodhit.[1288] Fortlumturia bisedoi me ambasadorin e Rumanisë në gusht 1930 dhe i kërkoi pranimin e studentëve në shkollat rumune. Diplomati shprehu bindjen se kërkesa mund të pranohej.[1289] Bursistët e parë u dërguan vitin e ardhshëm, ndër të cilët shkëlqyen Dhimitër Beduli, Petro Kulono, Anastas Gjoka, Eftimi Dori.[1290] Jugosllavia do të pranonte studentë pas pak vitesh. Seminari i Manastirit mbrujti poetin Migjeni, Saqellarin e mëvonshëm Petro Doçi, Branko Kadinë, Theofan Popën etj.[1291] Seminari i Cetinjës dhe Fakulteti Teologjik i Beogradit u ndoq nga episkopi i mëvonshëm Irine (Ilia) Banushi.[1292]

Arritja më e madh e KOASH-it ishte themelimi i Seminarit Kombëtar Ortodoks. Ai qe kërkuar me ngulm prej Hirësi Jerotheut, Theofanit, Kristoforit dhe drejtuesve të lartë politikë ortodoksë. Seminari shihej si rrugëzgjidhja e vetme drejt fuqizimit të Kishës dhe ndërgjegjes kombëtare. Mirëpo, ishte pamundësuar nga mosdhënia e fondit të Jovan Bangës, bllokuar padrejtësisht nga shteti grek. Çelja e Seminarit u vendos në vitin 1929, me qëllim pranimin e studentëve të parë, vitin e ardhshëm.[1293] Drejtor i parë u emërua

---

[1284] Xhuvani, *Vepra*, 112-114.
[1285] Xhuvani, *Vepra*, 75-76.
[1286] Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë* (Tiranë: Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, 2006), 37-59.
[1287] "Një grup studentësh të theollogjisë do të shkojnë n'Angli", *Gazeta e Re* nr. 163, 17 maj 1929, 1.
[1288] AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. 92, MD drejtuar Kryeministrit, 14 tetor 1929.; "Deklaratë zyrtare mbi vepërimet e Kishës Autoeqefale", 1.
[1289] AMPJ, V. 1930, D. 327, f. 9, MPB drejtuar MPJ, gusht 1930.
[1290] Dhimitër Beduli ishte studenti më i mirë shqiptar. Ai do të kishte rol në fuqizimin e KOASH-it në të ardhmen, duke u emëruar edhe Sekretar i Përgjithshëm i Sinodhit. Beduli qe lindur në fshatin minoritar Skore të Pogonit dhe do të përbënte pjesë të ajkës së pakicës që ishte e përkushtuar ndaj shtetit shqiptar dhe shqiptarizimit të Kishës, duke kërkuar diçka të tillë akoma edhe kur kisha u ringrit në vitin 1991. Për jetën e tij shih: Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli* (Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1999). Studentë të tjerë ishin Vasil Gjini, Vangjel Popa, Petro Frashëri, Gjeorgji Papailia, Gjeorgji Prifti dhe Vasil Tereska. AQSH, F. 150 "Ministria e Oborrit Mbretëror", V. 1932, D. VI-190, f. 1, Parashtresë mbi nxënësit shqiptar në Rumani, 14 shkurt 1932.
[1291] Kristofor Beduli, *Saqellar Atë Petro Doçi* (Tiranë: Neraida, 2006), 10-11.
[1292] Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi: Martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë* (Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2000), 10.
[1293] "Deklarata V", 1.

Episkopi i Peshkopisë, Eugjeni, i cili drejtonte edhe shtypin kishtar.[1294] Mirëpo, çelja u shty për një vit, për arsye ekonomike. Shuma e nevojshme u sigurua gjatë një takimi mes Mbretit Zog dhe Fortlumturi Visarionit në Shkëmbin e Kavajës në fundqershorin 1930.[1295] Kyçjet e nxënësve nisën në fundvit, me qëllim çeljen më 1 mars 1931.[1296] Seminari nisi punën në Durrës, nën drejtimin e teologut Dhimitër Përmeti, pas largimit të Hirësi Eugjenit. Studimet ishin 4 deri në 7-vjeçare, krahas një kursi të shpejtë për një numër të vogël priftërinjsh nga datat 26 tetor deri më 15 mars 1931. Ai u zhvillua vetëm për një herë, për plotësimin e ngutshëm të vendeve të zbrazëta.[1297]

Fuqizimi i brendshëm parashihte shqiptarizimin e plotë të Kishës. Shqipja qe bërë gjuha kryesore e meshimit në të gjithë vendin. Mirëpo, nuk mungonin shenja të veçuara të përdorimit të greqishtes. Trupëzimi i Kishës pa të domosdoshëm zhdukjen e plotë të gjuhës greke nga bashkësitë ortodokse shqiptare, si të papërputhshme me traditën ortodokse dhe nevojat kombëtare. "Gazeta e Re" e lëshoi kushtrimin më 19 maj 1929, me një shkrim mjaft të gjatë të emërtuar "Kishë Shqiptare me gjuhë shqipe". Zoi Xoxa, me nofkën "Laonikus", qortonte se disa psaltë vijonin në greqisht në Tiranë, duke u arsyetuar me mungesën e librave, edhe pse prifti meshonte në shqip. Fletorja dëftonte se psaltët dinin fare mirë gjuhën amtare, pasi ishin nëpunës e mësues. Xoxa shënonte se edhe kori rus i sjellë nga Hirësi Theofani kishte mësuar brenda muajit të psalte në shqip.[1298]

Kryepiskopi Visarion u kundërpërgjigj menjëherë. Ai shpallte se nuk ishte dhënë urdhër për psaltët e Tiranës, me shpresën se ata do të bënin ndryshimin vetë. Psalti i djathtë ishte gjykatësi Theodhor Buçani, i majti drejtori i shkollës Jorgji Pano dhe i treti mësuesi Vllash Dhora, të tre të besuar të shtetit dhe të njohur për atdhetarizëm. Kryesia e Kishës u shpalli se do të pushoheshin përfundimisht e pa kthim, nëse përsëritej këndimi në greqisht.[1299] Kryesia e Kishës shpërndau menjëherë një qarkore që urdhëronte përdorimin e shqipes në çdo shërbesë fetare.[1300] Kryepiskopi shkruante se mospërdorimi i gjuhës amtare vinte nga moskujdesi dhe plogështia e psaltëve, ndonëse librat ishin botuar.[1301] Ai urdhëroi që gabimi të mos përsëritej, pasi do të merreshin masa që rridhnin nga detyra fetaro-kombëtare e Kishës.[1302]

Fortlumturi Visarioni dhe Sinodhi u kujdesën të nderonin dëshmorët ortodoksë, të rënë për fe dhe Atdhe. Këshilli Mikst lidhi pensione të posaçme për familjet e të ndjerëve Atë Grigor Popa dhe Foqion Postoli, ish-sekretar Kombëtar i Pleqësisë Kishtare në Korçë. Ndërkaq, vendosi zhvillimin e përshpirtjes për Kostandin Kristoforidhin, përkthyesin e madh të veprave ungjillore në shqip, pas sugjerimit të deputetit Thoma Papapano.[1303]

[1294] Xhuvani, *Vepra,* 88-90.
[1295] "Kryetari i Kishës Orthodhokse Imzot Vissarioni në audiencë pranë L. M. T. Mbretit", *Zëri i Korçës* nr. 513, 1 korrik 1930, 2.
[1296] *Kisha Kombëtare* nr. 20, 14 dhjetor 1930, 4.
[1297] Xhuvani, *Vepra,* 119-120.
[1298] Laonikus, "Kishë Shqiptare me gjuhë shqipe" *Gazeta e Re* nr. 165, 19 maj 1929, 3.
[1299] "Reformat përparimtare të Sinodhit të Shenjtë" *Gazeta e Re* nr. 166, 22 maj 1929, 2.
[1300] "Deklarata V", 1.
[1301] Xhuvani, *Vepra,* 88.
[1302] Po aty.
[1303] Përshpirtja u mbajt në mbarë kishat, më 21 maj. Udhëzimet qenë të detajuara për Elbasanin, nga larja e rrasave, pastrimi i oborrit e rrugës përreth, stolisja e varrit deri te ngritja e flamujve kombëtarë në Mitropoli dhe pritja e të ftuarve. Përshpirtja u krye me madhështi. Oborri i Mitropolisë së Elbasanit mirëpriti bustin e

Ambasada greke në Tiranë vlerësonte se plotësimi i Sinodhit kishte përfshirë mbarë priftërinjtë e Shqipërisë në autoqefali dhe në shqiptarizimin e plotë të KOASH. Kjo fuqizohej pas fillimit të pagesës së priftërinjve nga buxheti i njësuar.[1304] Gjirokastra ishte zona më e nxehtë prej nga priteshin kundërshti. Episkopi dhe përfaqësuesit e Kongresit të Korçës u kthyen në qytet më 29 korrik dhe menjëherë u përkujdesën për rritjen e ndërgjegjes kombëtare.[1305] Ata hasën kundërshti të pakta dhe të veçuara. Atë Thanasi nga Labova e Kryqit përbënte përjashtim. Ai nisi të shkonte fshat më fshat, duke folur kundër Kishës Autoqefale, i shtyrë nga mbështetës të konsullatës greke. Prefektura kërkoi dëbimin e menjëhershëm të Atë Thanasit.[1306] Ndryshimi i gjendjes do të ishte i vështirë. Prefekti i Gjirokastrës, Zef Kadarja, parashtronte në fillimvitin 1930 se meshat zhvilloheshin kryesisht në greqisht në fshatrat e qarkut, me përjashtim të qytetit. Aty meshohej në shqip dhe në greqisht, përveç episkopit që meshonte vetëm në shqip.[1307] Zhvillimi i meshave në gjuhën amtare nisi hap pas hapi. Dhoskati çeli rrugën funddhjetorin 1929, pasuar nga Këllëzi dhe fshatrat e tjera.[1308] Sarandioti Atë Kristo Konomi do të emërohej në pak kohë në vendlindjen e tij. Ai do të shqiptarizonte kishën dhe do të përkthente mjaft vepra në shqip.[1309]

Sinodhi i Shenjtë vendosi ndalimin e dygjuhësisë së episkopatës. Fortlumturi Visarioni qortoi Hirësi Ambrozin për dërgimin e një qarkoreje dygjuhëshe. Ambrozi u shfajësua se disa priftërinj të pakicës nuk dinin shqip.[1310] Mirëpo, Kryepiskopi urdhëroi që episkopata të lidhej me pakicën, sikurse bënin qeveritarët.[1311] Vetëm dëshmitë e greqishtfolësve mund të jepeshin në të dyja gjuhët.[1312] Visarioni shqetësohej më së shumti nga veprimet dhe udhëzimet e fshehta të konsullatës greke. Ajo i shtynte pjesëtarët e pakicës të paguanin rrogën e mësuesve të fshatrave nga arka e manastireve, duke vrarë tre zogj me një gur: rrisnin ndikimin grek, meshonin vetëm në greqisht dhe dëmtonin ekonomikisht KOASH-in.[1313]

Gjithashtu, nënkonsullata e Sarandës paguante kundërautoqefalistët e përndjekur me 500 franga ari.[1314] Sekretari i Mitropolisë, Jani Dado, dyshohej se ishte ndërlidhës i Konsullatës Greke me qarkun kishtar. Qeveria kishte të dhëna se Dado ndërhynte në dëm të Kishës Autoqefale, edhe pse publikisht e mbështeste. Ai ishte parë të fliste me përfaqësuesit e Greqisë në Gjirokastër dhe Sarandë, por edhe politikanë grekë, të cilët kalonin në qark. Ministria e Brendshme kërkoi zhvendosjen e përkohshme në një

Kristoforidhit, punuar nga Odhise Paskali. Vepra qe kryer me shpenzimet vetjake të Kryepiskopit Visarion, pavarësisht pasurisë së vogël që kishte (Xhuvani, Vepra, 116-119). Xhuvani, *Vepra*, 102-109.

[1304] Kondis, *Elinizmos IV*, 43-44: IDAYE, Ambasada e Tiranës drejtuar MPJG, 17 shkurt 1930, cit.

[1305] "Kthimi i Episkopit dhe i Delegatëve të Korçës", *Gazeta e Re* nr. 224, 30 Korrik 1929, 3.; Ai mbajti fjalim atdhetar, me rastin e përvjetorit të Mbretërisë Shqiptare, më 1 shtator 1929. Hirësia radhiti arritjet e mbretit dhe përfundoi me brohorimën "Rroftë Zogu i Parë, Mbret i Shqiptarëvet! Rroftë Atdheu!" "Dita 1 Shtator në Gjirokastrë dhe në provincat e saja", *Gazeta e Re* nr. 256, 7 shtator 1929, 3.

[1306] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Komanda e Xhandarmërisë drejtuar MPB, 17 shtator 1929.

[1307] AQSH, F 152 "MPB", V. 1930, D. 187, f. 69, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 19 prill 1930.

[1308] *Zëri i Korçës* nr. 457, 14 dhjetor 1929, 4.; *Zëri i Korçës* nr. 501, 20 maj 1929, 4.

[1309] *Predikimi* nr. 44, 31 mars 1935, 8.

[1310] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 187, f. 80, Mitropolia Gjirokastër drejtuar KOASH, 1 qershor 1930.

[1311] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 187, f. 87, KOASH drejt. Mitropolisë Gjirokastër, 5 qershor 1930.

[1312] Meta, "Përpjekjet për konsolidimin", 100.

[1313] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 187, f. 110, KOASH drejtuar MD, 22 korrik 1930.

[1314] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/2, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 10 nëntor 1929.

episkopatë tjetër.[1315] Kisha sugjeroi pushimin përfundimtar më 26 maj 1931, pasi nuk kishte vend të lirë.[1316] Dado rendi në Tiranë dhe u takua me ministrin e Brendshëm, Musa Juka. Ai u shfajësua dhe premtoi shërbim të çiltër ndaj Kishës Shqiptare.[1317] Juka urdhëroi rikthimin në punë, duke u përplasur me Pleqësinë Kishtare të Gjirokastrës dhe Episkop Ambrozin. Arsyetimi qeveritar ishte i dyfishtë. Ajo përpiqej të përthithe kundërautoqefalistët brenda Kishës dhe të shmangte ndërhyrje të reja të palës greke.[1318] Përplasja mes Dados dhe drejtuesve kishtarë ridoli në skenë më 1932, kur zyrtarët vendorë lajmëruan se emri i Mbretit nuk përmendej në mesha.[1319] Kryesia e Kishës nuk pranoi të ndërhynte, duke fajësuar se Dado nuk zbatonte urdhrat e KOASH-it.[1320] Gjithsesi, ato ishin përplasjet e vetme, në qarkun dikur "të nxehtë" të Gjirokastrës, krahas ngjarjeve të Delvinës. Episkopata iu rikthye natyrshmërisë në themele kombëtare.

Pararendësja e gjuhës shqipe në Kishë, Korça, nuk do të haste vështirësi në shqiptarizimin e plotë. Prifti i Çerkës së Leskovikut ishte i vetmi që u përndoq, edhe pse nuk do të dënohej. Ai iu nënshtrua gjyqit, pasi jepte mësim greqisht te të rinjtë e fshatit.[1321] Konsulli grek kishte rendur fshat më fshat për të bindur grekomanët e paktë se Greqia nuk i kishte braktisur. Devolli ishte qendra e fundit e lëvizjes grekomane. Një punonjës konsullor u dërgua në Hoçisht, Ziçisht, Grapsh e tre fshatra të tjera për të organizuar rrengjet e nevojshme për mosmeshimin në shqip. Rrengu u zbatua në qytetin e Bilishtit më 14 shtator 1930. Psaltët e urdhëruar nga konsullata nuk pranuan shqipen, me arsyetimin se nuk dinin. Një i ri u shpreh i gatshëm të psalte shqip, por të vjetrit kundërshtuan, sipas udhëzimit të konsullatës. Rrengu ishte bashkëmenduar me nënprefektin, Dhimitër Tushemishtin, i cili "njihej për mendimet pro" Greqisë, sipas konsullit. Nënprefekti urdhëroi psaljen greqisht, meqë nuk mundej në shqip. Konsulli njoftonte se vetëm dy priftërinj në Devoll ishin atdhetarë shqiptarë: Atë Sofroni i Hoçishtit dhe Jani i Ziçishtit. Gjithsesi, Kisha u shqiptarizua pas rrengut edhe në Devoll.[1322]

Ngjarja e dytë dhe e fundit ndodhi brenda në Korçë, me nismën e profesorit Sotir Papahristo dhe Pandeli Kotokos. Shkaktarët nuk ishin vetëm grekomanë të njohur si Arqile Fundo, Vasil Samsuri, Minella Noçka, por edhe atdhetarë, si vëllai i vogël i Gramenove, Minai, dhe punonjës të rëndësishëm shtetërorë, si prokurori Dhimitër Moskopoliti etj. Ata psaltën greqisht pas pashkëve të vitit 1931, duke tërhequr vëmendjen e kujdestarit të Kishës, Kristaq Stathi. Ai kërkoi ndalimin e meshimit në gjuhë të huaj. Prokurori Moskopoliti u përgjigj se ishte i detyruar të psalte pjesërisht greqisht, pasi disa pjesë nuk ishin të përkthyera në gjuhën amtare.[1323] Atë Josif Qirici meshonte në shqip gjatë ditëve të para. Gjithçka ndryshoi pas ditës së tertë të Pashkëve. Atë Sotiri u dërgua në Kishën e Shën Thanasit. Ai njihej si kundërshtues i autoqefalisë dhe meshoi vetëm në

[1315] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. 171, MPB drejtuar MD, 21 maj 1931.
[1316] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. 171, KOASH drejtuar MD, 26 maj 1931.
[1317] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 189, f. 52, MPB drejtuar MD, 11 shtator 1931.
[1318] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 189, f. 112, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 13 shtator 1931.; AQSH, MPB drejtuar MD, 21 maj 1931, cit.
[1319] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1932, D. 206, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 6 korrik 1932.
[1320] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. 171, KOASH drejtuar MD, 8 gusht 1932.
[1321] AQSH, F. 152 "MPB", v. 1929, D. 119/1, Batalioni IV drejtuar Komandës, 15 qershor 1929.
[1322] Kondis, *Elinizmos IV*, 82-84: IDAYE, V. 1930, D. A/22/Ìβ, nr. 11508, Konsullata Korçë drejtuar Ambasadës Tiranë, 22 shtator 1930.
[1323] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 193, f. 25, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 1 korrik 1931.

greqisht të shtunën, ndërsa kori psalti në të dyja gjuhët. Pjesëmarrësit gjetën arsyetim të ri të nesërmen. Një ekip futbolli nga Janina kishte shkuar në Korçë për të luajtur me vendasit. Atë Sotiri gjykoi se kishte të drejtë të meshonte në greqisht për nevojat shpirtërore të lojtarëve.[1324] Mesha e fundit në greqisht u mbajt më 17 prill.[1325] Shkelja e hapur e Statutit vendosi në veprim KOASH-in. Fortlumturi Visarioni i kërkoi Atë Sotirit të zëvendësohej me Atë Anastasin e Durrësit.[1326] Atë Sotiri nuk pranoi dhe qëndroi pushim për një muaj, pas një dëmtimi në sy.[1327] Anëtari i korit, mësuesi Naum Stralla, u zhvendos në Tiranë, ndërsa noteri Minella Noçka ndalohej nga ligji të shpërngulej.[1328] Drejtori i Liceut Kombëtar, Sotir Papahristo, njihej për qëndrimin e tij grekoman dhe u paralajmërua të ndryshonte qëndrim.[1329] Episkopata e Korçës u urdhërua rreptësisht vitin e ardhshëm të shpërndante një qarkore që ndalonte greqishten në meshim dhe psalje. Vetëm profetësitë e Danielit u lexuan në greqisht, teksa nuk ishin përkthyer ende.[1330]

Shërbimet e fshehta dallonin 82 grekomanë në Korçë në vitin 1932, ndarë në tri lloje. Të parët ishin 11 "grekomanë nga të 1914", të dytët ishin 8 "njerëz me ndjenja grekomane" dhe 63 të mbeturit vepronin "nën maskën e shqiptarizmës, por në realitet me ndjenja të plota greke", ku veçohej Pandeli Kotoko.[1331] Sidoqoftë, numri rrëfen sasinë e vogël të grekomanëve të mbetur në Korçë.

Mitropolia e Tiranës i kishte kopsitur çështjet kombëtare me lehtësi. As Episkopata e Beratit nuk pati vështirësi. Hirësi Agathangjeli u shqetësua vetëm nga një përplasje me disa të rinj për meshimin në Kishën e Mangalemit, por pa natyrë kombëtare.[1332] Ai kishte emëruar një prej veprimtarëve më të hershëm të lëvizjes kishtare shqiptare, Arkimandrit Isainë, si zëvendësmitropolit në Vlorë.[1333] Isaia përbënte siguri për dështimin e ndërhyrjeve të konsullit grek. Konsullata e Vlorës kishte shpërndarë 3 mijë franga ari nga fondi i Jovan Bangës ndër grekomanë. Konsulli e cilësoi kishën "bordello", kur dëgjoi të meshohej dhe psalej shqip. Ortodoksët u neveritën nga fyerja dhe kërkuan dëbimin e tij. Përpjekja e parë për meshim greqisht dështoi, pasi kori përbëhej nga atdhetarë.[1334]

Shqiptarizimi i Kishës në Himarë do të përfundonte me vonesë. Shenjat ishin dhënë që prej korrikut 1929, gjatë vizitës së Kryeministrit Kota në Dhërmi, kur zgjidhja e çështjes kishtare ishte cilësuar arritje kryesore e qeverisë.[1335] Atë Spiro Kokaveshi ishte emëruar zëvendësmitropolit, i mbështetur nga grekomanët e Himarës. Ai ishte paditur në vitin 1932 se lëshonte dëshmi në greqisht, me qëllim që të njiheshin prej zyrtarëve

[1324] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 193, f. 31, Procesverbal, 24-26 korrik 1931.
[1325] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 193, f. 1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 2 maj 1931.
[1326] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 193, f. 4, KOASH drejtuar MD, 18 maj 1931.
[1327] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 193, f. 5, Atë Sotiri drejtuar KOASH, 18 maj 1931. Raporti i dëmtimit të syrit të Atë Sotirit ishte nënshkruar pikërisht atë ditë, më 18 maj nga doktori Llambi Dardha. AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 193, f. 6, Raport mjekësor, 18 maj 1931.
[1328] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 193, f. 19, Prefektura Korçë drejtuar MPB, korrik 1931.
[1329] AQSH, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 1 korrik 1931, cit.
[1330] Kondis, *Elinizmos IV*, 148-150: IDAYE, V. 1931-1932, D. A/4, nr. 5800, Konsullata Korçë drejtuar Ambasadës Tiranë, 10 maj 1932.
[1331] Kastriot Dervishi, *Shërbimi sekret*, 146.
[1332] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1931, D. VI-403, f. 2, Mitropolia Berat drejtuar Kryeministrit, 10 dhjetor 1931.
[1333] "Nga Episkopata e Beratit", *Kisha Kombëtare* nr. 5, 17 gusht 1930, 4.
[1334] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 848, f. 3-4, Prefektura Vlorë drejtuar MPB, 16 maj 1931.
[1335] "Pritja e çkëlqyer e Kryeministrit Koço Kota në Dhërmi (Himarë)", *Gazeta e Re*, 27 Korrik 1929, 3.

grekë.[1336] Kokaveshi nuk gëzonte mbështetjen e shumicës: as të atdhetarëve shqiptarë që përbënin rreth gjysmën e popullsisë, as të të lëkundurve, që e fajësonin për keqpërdorime ekonomike. Kështu, ai u zëvendësua me dr. Mihal Canen nga Kudhësi, në korrik 1934. Cane kishte qenë përfaqësues i Himarës në Kongresin e Korçës dhe njihej si atdhetar.[1337] Pala proshqiptare ishte e përqendruar në të gjitha fshatrat me përjashtim të Himarës dhe një pjese të vogël të Dhërmiut. Paria progreke e fshatit Himarë kundërshtoi t'i dorëzonte zëvendësmitropolitit arkën e Kishës, duke shkaktuar përplasje mes dy rrymave.[1338] Zgjedhjet e pleqësisë kishtare u zhvilluan më 19 tetor dhe shumica u fitua nga proshqiptarët. Mirëpo, Fortlumturi Visarioni vendosi në shenjë pajtimi të riemëronte Atë Spiron. Paria kishtare dhe shumica e popullit kërcënuan se do të ktheheshin unit, nëse riemërohej Kokaveshi, çka solli tërheqjen e Visarionit.[1339]

Goditja përfundimtare për rrymat grekomane ishte mbyllja e shkollave private. Pakica greke kishte ngritur shkolla me të hollat e Greqisë dhe ato ishin kthyer në vatër kundërautoqefalie. Fortlumturi Visarioni rendi ta përshëndeste Mbretin Zog për ngadhënjimin e frymës kombëtare.[1340] Kundërshtitë greke sollën vetëm një ankesë të Sekretarit të Lidhjes së Kombeve, Erik Drumond. Ai shprehu dyshime për ndërhyrje qeveritare në çështjen e Kishës në shtator 1932. Drumond kërkoi mosndërhyrjen në zonat greqishtfolëse, pa përmendur shumicën dërrmuese shqipfolëse.[1341]

Kisha u shqetësua edhe nga çështja e bashkësisë vllahe të Elbasanit. Arumunët e lagjes Shën Koll kishin kërkuar të meshonin në gjuhën e tyre. Shteti kishte kundërshtuar, çka solli ndërhyrjen e Rumanisë dhe Vatikanit. Arkimandriti rumun i ritit unit Serbojani ishte dërguar në Elbasan, me shpresën se do të qëndronte përfundimisht. Sinodhi i Shenjtë i KOASH-it kërkoi ndërhyrjen qeveritare dhe Serbojani u dëbua për në Kapshticë, më 19 shtator.[1342] I ngarkuari me punë i Rumanisë kundërshtoi gojazi më 24 tetor, pa këmbëngulur në mosdëbimin e Serbojanit. Arkimandriti u dëbua përfundimisht nëpërmjet Sarandës më 1 dhjetor, pas ecejakeve nga Bilishti në Shkodër, ku as serbët e as grekët nuk pranuan ta lejonin në tokën e tyre.[1343] Dëbimi nuk zhduku rrezikun unit. Kryepiskopi Visarion bisedoi me Kryeministrin Evangjeli për zhvillimin e meshës dygjuhëshe në lagjen kuçovllahe të Elbasanit, për të shmangur ndërhyrjen e Vatikanit.[1344] Mirëpo, qeveria shqiptare nuk ishte e gatshme për këtë lëshim dhe i ngarkoi përgjegjësi Visarionit për çdo ndryshim të gjendjes.[1345] Vllehët u bindën pas vitit 1935, pasi shumica shqiptare e ortodoksëve të lagjes kundërshtuan meshimin në rumanisht.[1346]

Shqiptarizimi i shpejtë dhe i plotë ishte bërë falë bashkëpunimit mes qeverisë dhe KOASH-it. Qeveria njoftonte Kryepiskopin në çdo rast që shihte të nevojshëm dëbimin e një prifti. Ajo kishte të drejtë të ndërhynte, vetëm pasi merrte mendimin e kryesisë së

[1336] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1932, D. 206, f. 7, Konsullata e Korfuzit drejtuar MPJ, 21 nëntor 1932.
[1337] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 164, f. 80, Nënpref. Himarë drejtuar Pref. Vlorë, 6 korrik 1934.
[1338] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 164, f. 133, Nënpref. Himarë drejtuar Pref. Vlorë, 6 tetor 1934.
[1339] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 164, f. 138, Nënpref. Himarë drejtuar Pref. Vlorë, 19 tetor 1934.
[1340] AMPJ, V. 1933, D. 485, f. 12, KOASH drejtuar Mbretit Zogu I, 12 maj 1933.
[1341] Beqir Meta, "Çështja e minoriteteve në Shqipëri, në Lidhjen e Kombeve në vitet '30", *Studime Historike* 3-4 (2006), 150.
[1342] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 19 shtator 1929.
[1343] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar MPJ, 1 dhjetor 1929.
[1344] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. 172, KOASH drejtuar MD, 16 maj 1931.
[1345] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. 172, MD drejtuar KOASH, 18 maj 1931.
[1346] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 471, f. 4, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 2 maj 1935.

Kishës.[1347] Lëshimi u ngjasonte kërkesave të Patriarkanës në vitin 1927, që asokohe u quajtën të skajshme. Mirëpo, ato nuk ishin tashmë pasojë e një trysnie të huaj, por e mirëbesimit të brendshëm mes drejtuesve të shtetit dhe Kishës. Fortlumturi Visarioni kërkoi bashkëpunim më të fortë dhe të prekshëm, çka nuk u mundësua. Plani i kreut të Kishës Shqiptare ishte të fuqizonte KOASH-in, duke e rritur në një Kishë të Madhe, doemos Shqiptare, sikurse shumica dërrmuese e grigjës. Rritja e KOASH-it nënkuptonte fuqizimin e ndërgjegjes kombëtare dhe ndikimit në shoqëri. Ai paraqiti planin për shqiptarizimin e 720 kishave ortodokse më 20 mars 1933. Plani kishte për synim rrënjosjen e dashurisë ndaj gjuhës dhe vendit dhe përgatitjen e priftërinjve me parimet e duhura për t'i shërbyer bashkimit kombëtar. Uratat duhet të kishin qytetarinë e nevojshme bashkëkohore, pa ndikimet e huaja që lakmonin sundim mbi Shqipërinë. Visarioni kërkoi të holla për mbajtjen e seminarit, dërgimin për studime teologjike jashtë vendit të 12 të përzgjedhurve për episkopë të ardhshëm, botimin e librave, zhdukjen e fushatave kundërshqiptare etj. Visarioni theksonte se pasja e 420 priftërinjve dhe 420 ndihmësve të tyre në shërbim të shtetit ishte një punë e madhe, sikurse ndodhte në mbarë shtetet ballkanike.[1348] Plani nuk u pranua, për shkak të vështirësive ekonomike të shtetit.

Emëruesi i përbashkët i çështjeve të Himarës dhe vllehëve të Elbasanit ishte unitizmi. Rryma nuk kishte mbështetës të shumtë në Shqipëri në fillesat e shtetit të pavarur. Mirëpo, kërcënimi i ortodoksëve se do të kalonin në unitizëm ishte i përhershëm dhe lidhej ngushtësisht me çështjen kishtare shqiptare. Disa shqiptarë kishin kanosur se do të kalonin në varësinë e Papës, nëse nuk pranohej meshimi në shqip, në kapërcyell të qindvjeçarit.[1349] Nipi i ish-mitropolitit të Durrësit, Visarionit të Vjetër, Arkimandriti Gjermanos kishte themeluar një Kishë Unite në Elbasan, prej viteve 1890. Lëvizja kishtare shqiptare kishte bërë që unitët të ishin të papërfillshëm në numër, sidomos pas Kongresit të Beratit, kur u siguruan të drejtat kombëtare. Gjermanos kishte mbetur prifti i vetëm unit në Shqipëri. Vatikani dërgoi një prift shqiptar nga Kalabria, Atë Petro Skarpeli, më 9 maj 1928, me qëllim që ta përparonte kishën e Gjermanosit. Skarpeli i cilësonte zhgënjyes numrat e ndjekësve të mundshëm të lëvizjes në Elbasan.[1350]

Çështja u ringjall në fundvitin 1928, pak kohë para trupëzimit të KOASH-it. Shtypi ndërkombëtar njoftonte se shumë priftërinj ortodoksë shqiptarë kishin pranuar fenë katolike, prej mungesës së rendit kishtar dhe dobësimit të traditës. Ato rrëfenin se Mbreti Zog mbështeste 12 priftërinjtë unitë në Elbasan.[1351] E vërteta ishte ndryshe. Vetëm dy meshtarët e lagjes Shën Koll, Atë Naum Peçini dhe Atë Jovan Toda, shpallën se do të përqafonin unitizmin dhe shteti nuk i mbështeti aspak. Pikënisja ishte jofetare. Ata kishin kërkuar vendosjen e një rroge, teksa të ardhurat nuk u siguronin mbijetesën. Pleqësia kundërshtoi dhe priftërinjtë u hakmorën. Ata nuk kunguan djalin e sëmurë të mishshitësit të lagjes, i cili ndërroi jetë pas pak orësh. Ngjarja detyroi priftërinjtë të

[1347] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. 170, f. 1-3, KOASH drejtuar MD, 17 dhjetor 1931.
[1348] AMPJ, V. 1933, D. 484, f. 2, KOASH drejtuar MD, 20 mars 1933.
[1349] Papa i Romës rriti përpjekjet për përhapjen e unitizmit në mbarë Ballkanin gjatë kësaj periudhe, përfshi edhe në Greqi, kur disa kisha u bënë unite më 1925. "Η Ορθόδοξος Ανατολική Εκκλησία και οι Ουνιταί [Kisha Ortodokse e Lindjes dhe Unitët]", *Ο Απόστολος Ανδρέας [Apostull Andrea]* nr. 11, 1 maj 1925, 1-2.
[1350] Inez Murzaku, *Returning home to Rome: the Basilian monks of Grotaferrata in Albania [Duke u kthyer në Romë: murgjit bazilianë të Gotaferratës në Shqipëri]*, (Romë: Analekta Kryptoferris, 2009), 138-140.
[1351] AMPJ, V. 1928, D. 335, f. 1, Fletorja "Le Temps", 6 nëntor 1928.; "Mbi desertimin e priftnavet të Shën Kollit", *Gazeta e Re* nr. 2, 2 nëntor 1928, 3.

dorëhiqeshin. Ata pohuan se do të bëheshin unitë, duke marrë rrogë prej 12 dhe 10 napolonash secili.[1352]

Krijimi i Sinodhit vendosi në krye të Kishës një kundërshtar të ashpër të unitizmit, Fortlumturi Visarion Xhuvanin. Kisha Unite u trondit më 12 prill 1929, kur Arkimandrit Gjermanos ndërroi jetë, pas një sëmundjeje zemre nga e cila vuante prej shumë kohësh.[1353] Goditja më e rëndë do të vinte nga rikthimi në ortodoksi i Atë Naum Peçinit. Fortlumturi Visarioni e bindi priftin dhe e ngriti në kryemeshtar shtatorin e atij viti.[1354] Kryepiskopi shënonte se Peçini ishte kthyer në limanin e shpëtimit, si ushtar besnik dhe i bindur.[1355]

Një çështje e dytë që tërhoqi vëmendjen e Visarionit ishte çelja e Kishës Unite në Elbasan, fundgushtin 1929.[1356] Ai kundërshtoi, duke shpallur se asnjë kishë ortodokse nuk mund të ishte jashtë varësisë së KOASH-it.[1357] Kisha u çel dhe Atë Petro Skarpeli mbajti meshën në greqisht, duke ligjëruar në shqip se i vetmi shpëtim ishte Papa i Romës. Priftërinjtë unitë dukej se përpiqeshin të joshnin grekomanët, tashmë që Kisha Shqiptare ishte në themele kombëtare. Përpjekja përmbyste gjendjen e pak viteve më parë, kur unitët synonin atdhetarët shqiptarë. Visarion Xhuvani nuk qëndronte duarkryq. Ai meshoi në Kishën e Shën Mërisë në Lagjen Kala të Elbasanit, ditën që përurohej kisha unite. Kryepiskopi kërcënoi me shkishërim cilindo ortodoks që shkonte në kishën unite, të cilën e cilësoi "vepër të djallit, një kancer që tenton të minojë autoqefalinë shqiptare".[1358]

Fortlumturia kërkoi ndihmën e qeverisë për të ndaluar fushatën unite. Ai shihte si rrugëzgjidhje dëbimin e Atë Petros dhe të çdo uniti tjetër. Visarioni arsyetonte se unitët nuk kishin pasues dhe po përpiqeshin të shtonin radhët nëpërmjet të mirave materiale.[1359] Arsyetimi mbështetej nga prefekti i Elbasanit, Zyhdi Karagjozi. Ai njoftonte se Atë Petroja paguante 12 djem për korin kishtar dhe po përqendronte veprimtarinë në Shpat.[1360]

Kryepiskopi arriti të bindte qeverinë se unitizmi duhej ndaluar, duke përfituar nga vëmendja dhe gatishmëria shtetërore për të mbrojtur KOASH-in. Ai mori zotimin e Mbretit se shteti do të ndiqte çdo vepër që shkaktonte fendërrimin, si cenim i bashkëjetesës fetare.[1361] Kryepiskopi rendi ta botonte qëndrimin e ri. Ai vlerësonte se rruga e rrezikshme e përçarësve të ortodoksisë ishte kundërkombëtare dhe kundër paqes së popullit shqiptar. Fortlumturia kërkoi nga priftërinjtë dhe besimtarët të ruanin të pacenuar fenë, bashkimin kombëtar dhe harmoninë e plotë shoqërore.[1362] Mbrojtja nga

[1352] "Vetëm dy priftër orthodhoksë u lidhën me Romën", *Gazeta e Re* nr. 2, 2 nëntor 1928, 3.
[1353] "Vdekja e Papajorgjit", *Gazeta e Re* nr. 138, 17 prill 1929, 3.
[1354] "Meshë Kryepiskopale në Durrës", *Gazeta e Re* nr. 275, 28 shtator 1929, 4.
[1355] "Deklarata IV", 1.
[1356] "Pregatitjet për Inaugurimin e Kishës Orhtohdokse unite", *Gazeta e Re* nr. 246, 25 gusht 1919, 5.
[1357] "Një deklaratë e Kryepiskopit", *Gazeta e Re* nr. 248, 28 gusht 1929, 2.
[1358] Murzaku, *Murgjit bazilianë*, 141-142.
[1359] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, KOASH drejtuar MPB, 17 shtator 1929.
[1360] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, shtator 1929.
[1361] "Shteti do luftojë proselitizmën kundra Kishës Autoqefale", *Gazeta e Re* nr. 269, 21 shtator 1929, 1.
[1362] "Deklarata IV", 1.

unitizmi u shënua si fitore kyçe e vitit të parë të Sinodhit.[1363] Ambasada Greke në Tiranë njëmendësohej, edhe pse qëndrimi i saj kishte çuar në joshjen prej Vatikanit.[1364]

Shteti mori masa. Qeveria urdhëroi ndalimin e orvatjeve për zgjerimin e lëvizjes unite në treva të tjera, pas përpjekjes së Atë Petros për t'u nisur në Gjirokastër.[1365] Zyra Sekrete e Ministrisë së Brendshme urdhëroi më 18 shtator ndalimin e çdo meshë unite në Elbasan.[1366] Kisha u mbyll me kërkesë të Visarionit, një muaj pas çeljes.[1367] Kryepiskopi falënderoi nxehtësisht për vendimin.[1368]

Po ashtu, Fortlumturia ia doli të ndalonte pagëzimin e foshnjës së Gjon Palit nga Atë Petroja fundvitin 1929.[1369] Mirëpo, dy priftërinjtë unitë nuk ndërprenë përpjekjet. Ata vijonin të meshonin për qëllime vetjake, pa u rënë kambanave, derisa të rregullohej çështja.[1370] Ministria e Brendshme urdhëroi ndalimin e çfarëdolloj meshimi, qoftë edhe vetjak, sapo u lajmërua.[1371] Ndalimi solli përplasje me Atë Petron, i cili i kanosi me dhunë, nëse ndalohej predikimi.[1372] Urdhri qeveritar u zbatua me pahir. Atë Petro u nis në Tiranë ku u njoh me vendimin qeveritar. Ai u udhëzua të mos vijonte përpjekjet për afrimin me të rinjtë elbasanas. Visarioni kishte parashtruar se Skarpeli joshte djem shqiptarë për t'i nisur me studime në Romë, duke u siguruar shpenzimet, pasaportat dhe bursat.[1373] Atë Petro kundërshtoi, por nuk kishte rrugëzgjidhje, veçse të pranonte vendimin qeveritar. Ai e cilësoi veprimin kundër tij të padurueshëm dhe të jashtëligjshëm.[1374]

Shteti shqiptar nuk e njihte më si prift dhe së bashku me Atë Jovan Todën do të lejohej të meshonte vetëm nën drejtimin e KOASH-it.[1375] Toda nuk e ndoqi udhëzimin dhe i mbeti besnik Atë Petros.[1376] Prefektura e Elbasanit u urdhërua të mos zotohej në asnjë mënyrë për rihapjen e kishës unite.[1377] Urdhri u thye vetëm një herë, Krishtlindjet e vitit 1931. Priftërinjtë unitë kishin marrë leje për të meshuar në ritin latin. Mirëpo, ata meshuan në ritin bizantin, duke sjellë ndjekjen penale qeveritare.[1378]

Beteja me unitizmin ngadhënjeu përkohësisht, falë syhaptësisë së Fortlumturi Visarionit dhe mbështetjes nga shteti shqiptar.[1379] Shmangia e rrezikut unit u shpall si

---

[1363] "Deklarata V", 1.

[1364] Kondis, *Elinizmos IV*, 43-44: IDAYE, Ambasada e Tiranës drejtuar MPJG, 17 shkurt 1930, cit. Përfaqësuesi britanik në Tiranë shprehte frikën se ortodoksët po çoheshin drejt unitizmit nga qëndrimi grek. Meta, "Debatet shqiptarogreke…", 31-67.

[1365] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Elbasan, 10 shtator 1929.

[1366] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, MPB drejtuar Prefekturës Elbasan, 18 shtator 1929.

[1367] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, KOASH drejtuar MPB, 3 tetor 1929.

[1368] AQSH, F. 155 "MD", V. 1929, D. 91, f. 4, KOASH drejtuar MD, 4 tetor 1929.

[1369] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1929, D. 119/1, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 27 tetor 1929.

[1370] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 179, f. 7, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 17 prill 1930.

[1371] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 179, f. 1, MPB drejtuar Prefekturës Elbasan, 16 prill 1930.

[1372] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 179, f. 11, Komandrrethi drejt. Prefekturës Elbasan, 18 prill 1930.

[1373] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 179, f. 21, KOASH drejtuar MD, 12 korrik 1930.

[1374] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1930, D. 179, f. 26, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 22 dhjetor 1930.

[1375] AQSH, F. 155 "MD", V. 1931, D. 172, MD drejtuar MPB, 25 maj 1931.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 191, f. 18, MD drejtuar MPB, 25 maj 1931.

[1376] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 191, f. 16, KOASH drejtuar MD, 23 maj 1931.

[1377] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 191, f. 13, MPB drejtuar Prefekturës Elbasan, 4 prill 1931.

[1378] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1931, D. 206, VKM, 25 dhjetor 1931.

[1379] Vlen të theksohet se Fortlumturi Visarioni u orvat të tregohej i kujdesshëm me katolicizmin, gjatë betejës kundër unitizmit. Ai bënte thirrje për vllazërinë kombëtare mes feve të ndryshme në vend dhe rendte të krijonte marrëdhënie të mira me zyrtarët katolikë, jounitë. Kjo kulmoi me një fjalim atdhetar dhe

arritje për të mirën e ortodoksisë e të kombit nga Fortlumturi Visarioni.[1380] Raste të veçuara të rishfaqjes së unitizmit do të kishte edhe në trevjeçarin e ardhshëm. Mirëpo, ato nuk kishin pasoja. Fortlumturi Visarioni do t'i parashtronte të gjitha rastet dhe do të gjente mbështetjen e qeverisë: Uniti Nas Papanastasi u bë me fëmijë më 7 shkurt 1934. Kryepiskopi kërkoi të merreshin masa, në mënyrë që fëmija të mos pagëzohej nga Skarpeli.[1381] Prefektura e Elbasanit e thirri Nasin dhe i kërkoi të hiqte dorë nga unitizmi, edhe pse ai kishte vite në këtë fe dhe nuk pranonte të kthehej në ortodoksi.[1382] Po ashtu, Kryepiskopi padiste përpjekjen e Skarpelit dhe Todës për ngritjen e një faltoreje në varrezat katolike.[1383] Ndërtimi u parandalua në kohë nga Prefektura, me arsyetimin se toka ishte blerë për varreza katolike dhe jo kishë unite.[1384] Priftërinjtë do të përpiqeshin të ngrinin një kishëz brenda 24 orëve, por u ndaluan nga xhandarmëria që prishi themelet.[1385] Ata vepruan ngjashëm në Lushnjë dhe Divjakë. Kryepiskopi parandaloi hyrjen e unitëve në lagjet e varfra, ku fendërronin nevojtarët në këmbim të dhuratave.[1386]

Mjeti i vetëm i mbetur për Skarpelin ishin bursat që vinin nga Italia.[1387] Atë Petro ishte këshilluar të mos guxonte të përhapte unitizmin dhe ai kishte pranuar.[1388] Mirëpo, ai dredhonte nëpërmjet bursave, duke u thënë prindërve se ishte ortodoks dhe jo unit apo duke përdorur ndihma për familjet e varfra.[1389] Ai kishte dërguar gjashtë studentë nga katër familje, deri në vitin 1935.[1390] Numri qe i vogël, pavarësisht pse Skarpeli ishte i gatshëm t'i jepte bursa kujtdo.[1391] Zyrtarët vendorë parashtronin kundërshtimin e familjarëve të studentëve. Atë Petro dëshironte të dërgonte për mësime teologjike në Itali 18-vjeçarin Petraq Isaku nga Durrësi. Familjarët e ndaluan dhe lajmëruan Ministrinë e Jashtme, që nuk pranoi të lëshonte pasaportë për të përzgjedhurin për student.[1392]

---

fetar që Fortlumturia mbajti me rastin e vdekjes së Arqipeshkvit katolik të Shkodrës, Imzot Lazrit, në vitin 1936. Megjithatë, ai bëri thirrje tërthorazi për ndalimin e unitizmit, edhe në këtë rast. Fortlumturia u shpreh se Shqipëria ishte vatër e marrëdhënieve vllazërore që duhet të fuqizoheshin edhe më tej "me asnji provokim nga asnji anë, që mund të shkaktojë, edhe pa dashje, përçamje dhe ftoftësi në Shqipni në mest t"elementit Katholik dhe t'Orthodhoksisë, dhe sidomos ndër vedi në mes të kësaj, për ruejtjen e së cilës Orthodhoksi veçanërisht Modestia e Jonë, si asht e ditun, asht betue." Xhuvani, *Vepra*, 164.

[1380] Xhuvani, *Vepra*, 119-120.

[1381] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 163, f. 3, KOASH drejtuar MD, 7 shkurt 1934.

[1382] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 163, f. 6, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 19 shkurt 1934.

[1383] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 163, f. 13, KOASH drejtuar MD, 24 shkurt 1934.

[1384] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 163, f. 28, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 24 shkurt 1934.

[1385] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 163, f. 30, KOASH drejtuar MD, 10 maj 1934.

[1386] Xhuvani, *Vepra*, 141.

[1387] Qeveria shqiptare vijonte të ndalonte këdo që merrej me unitizmin. Kjo përdorej nganjëherë edhe për përplasje të brendshme. Kështu, për shembull, qeveria urdhëroi ndalimin e Uan Bamit nga Gurëza e Lushnjes, më 7 maj 1936 (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 1, MPB drejtuar Prefekturës së Beratit, 7 maj 1936). Mirëpo, u vërtetua se ai ishte kallëzuar rrejshëm, vetëm pse kishte përplasje të një natyre tjetër me priftin 22-vjeçar të fshatit, Kol Petriti (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 2, Prefektura Berat drejtuar MPB, 9 maj 1936).

[1388] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 11, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 8 prill 1936.

[1389] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 23, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 19 shkurt 1936.

[1390] Ata ishin Aeksa dhe Apostol Gega, Josif dhe Julia Papamihali, Afërdita Shahini dhe Nasi Spiro, që kishin nga një në pesë vjet që ishin dërguar (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 18, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 6 mars 1936).

[1391] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 19, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 29 prill 1936.

[1392] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 25-26, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 28 gusht 1936.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 30, Prefektura Durrës drejtuar MPB, 4 shtator 1936.

Zyrtarët grekë nuk i frikësoheshin kërcënimit unit. Ata arsyetonin në janar 1935 se shumica dërrmuese e ortodoksëve nuk do të binin pre, pasi qeveria shqiptare nuk po e mbështeste kishën unite.[1393] Qëndrimi i ashpër shqiptar vlerësohej i sinqertë nga ambasada greke në Tiranë. Qarkoret e prefektëve që cilësonin unitët "armiq të atdheut dhe organe të Vatikanit dhe Italisë" kishin bindur diplomatët fqinj.[1394] Ata parashtronin se rryma italofile përfaqësohej nga Eqrem Libohova dhe Abdurrahman Krosi, ndërsa Vasil Avrami, Abdurrahman Dibra, Xhafer Vila dhe Kryepiskopi ishin kundërshtarë të ashpër dhe qëndrimi i tyre kishte mbizotëruar.[1395]

Kisha Shqiptare ishte syçelët në raste të rralla sulmesh nga anë të tjera. Fortlumturi Visarioni u kujdes të ndalonte përpjekjet protestante, falë mbështetjes qeveritare.[1396] Ai do të haste edhe rast përgojimi të Krishtërimit, me përkthimin e librit "Jeta e Krishtit" të Ernest Renanit nga Lefter Dilos. Libri ishte cilësuar fepërdhosës. Fortlumturi Visarioni kërkoi ndalimin, me arsyen se binte ndesh me ligjin e bashkësive fetare.[1397] Rryma e fundit që do ta shqetësonte ishte komunizmi, që sapo kishte hedhur rrënjët në Shqipëri, duke nisur një fushatë kundër priftërinjve.[1398]

Pjesë e fuqizimit kishtar ishte doemos ndërkombëtarizimi. Patriarkana Ekumenike ia doli të bllokonte njohjen e Kishës Shqiptare nga kishat serbe dhe rumune. Mirëpo, kjo nuk nënkuptonte se kishat jogreke nuk e shihnin me dashamirësi Sinodhin e Shenjtë të KOASH-it. Ato kishin pranuar të mos e njihnin Kishën Shqiptare për të ruajtur baraspeshat me Patriarkanën ose me shtetin grek në rastin jugosllav. Ndaj, ato ishin të gatshme të ndihmonin Kishën Shqiptare. KOASH do të niste ndërkombëtarizimin, nëpërmjet Aleancës Botërore për Miqësi Ndërkombëtare Nëpërmjet Kishave. Ajo ishte themeluar në vitin 1914 dhe synonte përkrahjen e paqes, çarmatimit, të drejtat e pakicave etnike dhe fetare etj. Aleanca kishte në gjirin e vet të gjitha kishat ortodokse. Sekretari i Përgjithshëm, Lordi Dikson, i kërkoi Mitropolitit grek Krisanthos t'i përcillte Kishës Shqiptare ftesën për përfshirje. Krisanthos nuk kishte vepruar. Rrjedhimisht, zgjidhja ishte gjendur gjetkë.[1399]

Patriarkana Bullgare nuk njihej prej kishave greke. E kaluara mes tyre ishte një betejë e vazhdueshme. Patriarkana Ekumenike e kishte luftuar me ashpërsi përpjekjen bullgare për rilindje kombëtare në qindvjeçarin XIX dhe nuk kishte njohur krijimin e Ekzarkatit Bullgar. Beteja ishte ashpërsuar me kalimin e kohëve, sidomos pas ndarjes së Maqedonisë. Lordi Dikson iu drejtua Kryepiskopit të Sofjes, Stefan Gjeorgjievit, për të ndërmjetësuar me Kishën Shqiptare. Mitropoliti Stefan thirri ambasadorin shqiptar në Sofje në mars 1931 dhe u shpreh i habitur pse Kisha Shqiptare nuk kishte marrë pjesë në takimin e vitit të kaluar të Aleancës Botërore.[1400] Kryepiskopi i përçoi kërkesën e Lordit Dikson dhe shprehu mbështetjen e Kishës Bullgare në ndërkombëtarizim e Kishës

[1393] Kondis, *Elinizmos IV*, 222-223, IDAYE, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 13 nëntor 1934, cit.; dhe Kondis, *Elinizmos IV*, 224-225, IDAYE, D. A/4/2, nr. 20245, Ambasada drejtuar MPJG, 22 janar 1935.
[1394] Kondis, *Elinizmos IV*, 226-227, IDAYE, D. A/4/2, 20312, Ambasada Tiranë drejt. MPJG, 3 prill 1935.
[1395] Kondis, *Elinizmos IV*, 226-227, IDAYE, D. A/4/9/I, 9421, Qeveritari i Epirit drejt. MPJG, 17 maj 1935.
[1396] AQSH, F. 155 "MD", V. 1935, D. 160, Prefektura Korçë drejtuar MPB. Shih: AQSH, F. 155 "MD", V. 1930, D. VIII-124.
[1397] Xhuvani, *Vepra*, 141.
[1398] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 467, f. 5, KOASH drejtuar MD, 4 shtator 1935.
[1399] AMPJ, V. 1931, D. 219, f. 73-74, Ambasada e Sofjes drejtuar MPJ, 21 mars 1931.
[1400] Po aty.

Shqiptare. Tirana e pranoi me kënaqësi. Mbledhja e radhës do të zhvillohej në Kembrixh të Britanisë së Madhe, më 1 deri në 4 shtator 1931.[1401]

KOASH vendosi që Kisha të përfaqësohej nga Fortlumturi Visarioni dhe Stavro Stavri. Ata mbërritën më 28 gusht dhe u pritën nga Lordi Dikson. Përfaqësuesit e patriarkanave ekumenike dhe serbe kishin kundërshtuar ashpërsisht praninë e Visarionit. Megjithatë, Kryepiskopi kishte vendin e nderit në sallën e mbledhjeve të Aleancës, më 1 shtator. Përfaqësuesi i Patriarkanës Ekumenike u largua i neveritur. Episkopi serb Irinej nuk pranoi ta njihte Visarionin si prijës kishtar, si hakmarrje ndaj dëbimit të Viktorit. Kryepiskopi i Sofjes, Stefani, u gjend në krah të dërgatës shqiptare. Ai kërcënoi se do të ikte prej Kembrixhit, nëse nuk pranohej pjesëmarrja e Visarionit me të drejta të plota. Kanosja solli tërheqjen e Irinejit dhe pranimin e KOASH-it. Patriarku rumun ndoqi rrugën e atij bullgar dhe u rreshtua në krah të palës shqiptare. Fortlumturi Visarioni mbajti një fjalë mbi të drejtat që gëzonin pakicat në Shqipëri. Ai kërkonte trajtim të ndërsjellë të pakicave shqiptare në Greqi dhe Jugosllavi. Kryepiskopi Stefan kërkoi që një prej konferencave të kishave ortodokse të Ballkanit të mbahej në Tiranë.[1402]

Thyerja e veçimit ishte e rëndësishme për Kishën Shqiptare. Ajo u ftua të merrte pjesë në takimin e radhës të Aleancës Botërore, që mbahej në Bukuresht vitin pasardhës. Dërgata shqiptare përbëhej nga Kryepiskopi Visarion dhe Kristo Tarpo, të cilët mbërritën mes vështirësish.[1403] Avioni i linjës Tiranë-Rumani kalonte nëpërmjet Athinës. Greqia nuk pranonte zbritjen e Visarionit. Ndaj, Mbreti Zogu I kërkoi një avion të posaçëm që do të dërgonte krerët e Kishës në Bukuresht.

Fortlumturi Visarioni u gjend i vetëm në Rumani. Një pjesë e rëndësishme e prijësve të kishave ishin në Jeruzalem për festimin e pashkëve. Njoftimi i ndryshimit të datës kishte mbërritur në Tiranë, ditën që Visarioni ndodhej në Bukuresht. Zhvillimi në fjalë nuk ishte i keq. Prania e pak drejtuesve kishtarë në kryeqytetin rumun bëri që Fortlumturi Visarioni të ishte në qendër të vëmendjes. Ai u prit nga Mbreti Karoli II, ditën e tretë të qëndrimit në Bukuresht. Mbreti rrëfeu kërshërinë e veçantë për KOASH-in. Ai e siguroi Visarionin se ishte dashamirës dhe e mbështeste Kishën Shqiptare, duke qenë se ajo përkrahej nga Mbreti Zogu I dhe atdhetarët shqiptarë. Kryepiskopi u shoqërua nga përfaqësues të shquar për të takuar Patriarkun rumun, Mironin. Ai udhëtoi me makinën e Kryeministrit Jorga, krahas nënkryetarit të Parlamentit Topa, deputetit teolog Ispir, konsullit Dogana dhe kreut të mërgatës shqiptare Grigor Zografit. Kryeministri Jorga i tha Patriarkut se shteti rumun i njihte tërësisht cilësitë kishtare të Kryepiskopit dhe shfaqte dëshirën që edhe Kisha të kishte marrëdhëniet më të mira me KOASH-in. Arsyetimi ishte hartuar nga profesor Ispiri dhe iu dorëzua kreut të Kishës Rumune.[1404] Jorga kërkoi njohjen e autoqefalisë shqiptare. Mirëpo, Patriarku tha se nuk mund të tejkalonte Patriarkanën e Kostandinopojës dhe premtoi se do të bënte ndërhyrje të gjalla në dobi të KOASH-it.[1405]

Pritja madhështore u shoqërua me tri gosti dhe veprimtari me pjesëmarrjen e dhjetëra proshqiptarëve të Rumanisë. Megjithatë, nuk mungoi një shkrim thumbues se Fortlumturi Visarioni ishte i paligjshëm. Bashkësia Ortodokse Shqiptare në Bukuresht

[1401] AMPJ, V. 1931, D. 219, f. 44, Ambasada e Londrës drejtuar MPJ, 10 shtator 1931.
[1402] AMPJ, V. 1931, D. 219, f. 44, Ambasada e Londrës drejtuar MPJ, 10 shtator 1931.
[1403] AMPJ, V. 1932, D. 271, f. 4, MPJ drejtuar Konsullatës së Bukureshtit, 11 maj 1932.
[1404] Po aty.
[1405] AMPJ, V. 1932, D. 271, f. 6, Konsullata e Bukureshtit drejtuar MPJ, 27 maj 1932.

rendi të përgjigjej se dorëzimi ishte bërë me lejen e Patriarkut Serb nga dy episkopë, sipas rregullave kishtare dhe se kishte dëshmi zyrtare që vërtetonte ligjshmërinë e dorëzimit. Mërgata shqiptare arsyetonte të kaluarën nga shpallja e autoqefalisë, te mallkimet e Patriarkanës dhe në fund ngritjen e Sinodhit. Ajo theksonte se mallkimi i Patriarkanës kishte ardhur katër vjet pas dorëzimit të Visarionit Episkop.[1406] Sulmi kryesor do të vinte nga shtypi grek. "Estia" ankohej se Xhuvani nuk ishte aq i rëndësishëm sa të kishte pritje të atillë.[1407] Ajo nuk linte pa thumbuar Kryeministrin Jorga, i cili thuhej se kishte marrë dhuratë një pronë në Sarandë. Kryepiskopi i Greqisë kundërshtoi ashpër, çka habiti Fortlumturi Visarionin.[1408]

Shteti grek e ndiqte zhvillimin hap pas hapi. Pala shqiptare përpiqej të tregonte se kishte tejkaluar kundërshtinë e Patriarkanës Ekumenike, duke marrë bekimin e kishave të tjera. Ministria e Jashtme në Athinë shënonte se diçka e tillë nuk i shërbente Greqisë, e cila dëshironte të tregonte se ishin këshillat e saj ato që do të bënin Patriarkanën të ndryshonte qëndrim.[1409] Fortlumturi Visarioni ia doli që Patriarku Miron të ndërhynte pranë Patriarkanës Ekumenike për njohjen e KOASH-it. Kisha Rumune theksonte se nuk njihte asnjë vendim kundër kryepriftërinjve shqiptarë, as në atë kohë e as në të ardhmen.[1410]

Nismëtarja e ndërkombëtarizimit të Kishës Shqiptare kishte qenë Bullgaria. Asaj i ra radha të mirëpriste dërgatat e kishave të Aleancës Botërore në vitin 1933. Fortlumturi Visarioni pati mundësinë të zgjeronte lidhjet ndërkombëtare të Kishës Shqiptare. Kryepiskopi Stefani i Sofjes u nderua paraprakisht me Kordonin e Madh të Urdhrit të Skënderbeut nga Mbreti Zog.[1411] Ai falënderoi Mbretin dhe tha se Zogu kishte treguar trimëri dhe urtësi. Kisha Bullgare u zotua ta përkrahte KOASH-in, të cilën e quante motër të vogël. Stefani këshilloi durim dhe kërkoi tërthorazi të drejta arsimore për bullgarët e Shqipërisë.[1412]

Fortlumturi Visarioni vendosi që rrugëtimin ta kryente përmes Jugosllavisë, duke u përafruar sërish me palën serbe. Kryepiskopi udhëtoi në Strugë, ku u përshëndet me fjalime dhe u strehua te Zavçe Popoviçi. Ai vijoi në Manastir, ku u mirëprit nga shqiptarët ortodoksë të qytetit. Ai qëndroi në shtëpinë e Anastas Kristidhit, babait të mjekut të syve të shtetit shqiptar, dhe u takua me konsullin Kosta Meksi, më 10 dhe 11 shtator. Fortlumturia la disa libra dhe vaj ulliri në shenjë mirënjohjeje për Mitropolitin e Manastirit. Rilindja e përplasjeve me Greqinë kishte bërë Patriarkanën Serbe të rishihte me dashamirësi çështjen shqiptare. Meshtarët e Manastirit përmendën Visarionin si Kryepiskop dhe morën naforë nga dora e tij në fund të meshës së zhvilluar. Fortlumturia udhëtoi drejt Shkupit, Kumanovës dhe kaloi në Bullgari. Ai mbërriti në Sofje më 13 shtator. Mërgata shqiptare e priste jashtë qytetit. Ajo kryesohej nga drejtuesi i shoqërisë "Gjergj Kastrioti", Jorgji Stefani, ambasadori Skënder Konica, ndihmësi i Mitropolitit të Sofjes, Arkimandrit Kirilli etj. Xhuvani u prit si i ftuar i nderit i Sinodhit Bullgar dhe u

[1406] Xhuvani, *Vepra*, 172-175.
[1407] AMPJ, V. 1932, D. 271, f. 25, Fletorja Estia, 18 qershor 1932.
[1408] AMPJ, V. 1932, D. 271, f. 27, Fletorja Estia, qershor 1932.
[1409] Kondis, *Elinizmos IV*, 165-166: IDAYE, D. A/4/I, nr. 1267, MPJG drejtuar Ambasadës Tiranë, 8 mars 1933.
[1410] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 93, f. 1, Qarkore, 9 mars 1933.
[1411] AMPJ, V. 1932, D. 271, f. 23-24, Ambasada e Sofjes drejtuar MPJ, 7 qershor 1932.
[1412] Xhuvani, *Vepra*, 126-127.

takua me Kryeministrin Mushafan, ministrin e Jashtëm, Kryekuvendarin, kryebashkiakun dhe Mitropolitin. Shtypi bullgar e pasqyroi me shkrime lëvduese.[1413]

Konferenca e Aleancës Botërore u çel më 15 shtator. Visarioni u ul në të djathtë të Lordit Dikson, për të treguar rëndësinë që i jepej Kishës Shqiptare. Fjalimi i tij u mirëprit nga përfaqësuesit. Fortlumturia mori pjesë edhe në pritjen madhështore që i bëri mërgata, ndërsa takimet më të rëndësishme u lanë për më 22 shtator. Kryepiskopi u prit nga Mbreti Boris, i cili foli "me një shqipe të pastër". Mbreti shprehu mbështetjen për kombin shqiptar, Mbretin Zog dhe Kishën Autoqefale. Pas takimit, Kisha Bullgare njohu zyrtarisht simotrën Shqiptare dhe uroi e bekoi Sinodhin e Shenjtë të KOASH-it.[1414] Ndërkaq, Fortlumturia mbajti fjalën e nderit në Klubin Ushtarak të Sofjes, i pritur me duartrokitje dhe brohorima për rreth 14 minuta. Kryeministri dhe Patriarku i shtruan dreka zyrtare përpara fundit të udhëtimit.[1415] Patriarku kërkoi bashkëmeshimin e Fortlumturi Visarionit dhe episkopëve bullgarë.[1416] Kryepiskopi shqiptar mori mbështetjen qeveritare dhe bashkëmeshoi në shqip.[1417]

Visarioni ia kishte dalë të merrte njohje, nga të gjitha kishat autoqefale përveç simotrave greke. Përfaqësuesit e ambasadave jugosllave, bullgare dhe rumune do të merrnin pjesë në të gjitha kremtimet e mëdha kishtare në Shqipëri, prej atij çasti.[1418] Fortlumturia u përpoq të përdorte edhe miqësitë vetjake për ndërkombëtarizimin e çështjes. Kjo u mundësua në vitin 1933, kur në kabinetin qeveritar grek u emëruan dy ish-bashkëstudentë të Visarionit.[1419] Ministrat Theotaqis i Bujqësisë dhe Haxhiqiriakos i Flotës Detare u uruan nga Kryepiskopi. Ata rendën të përgjigjeshin, duke e falënderuar për bekimet. Haxhiqiriakos përgjigjej se urimet e Visarionit ishin të çmueshme.[1420] Zyra e Shtypit shfaqi telegramet si arritje. Ajo shënonte se akulli mes Kishës dhe helenizmit u thye, pasi fetë i shërbenin vëllazërimit të kombeve.[1421] Pritshmëria nuk do të ishte e themeltë. Ministrat iu përgjigjën Fortlumturisë për hatër të miqësisë së vjetër ose për mirësjellje, por kjo nuk ndryshoi asgjë në marrëdhëniet dypalëshe. Madje, shtypi grek nisi një fushatë të re kundër Kishës Shqiptare, vetëm një muaj pas shkëmbimit të urimeve.[1422] Fletoret greke përhapën lajme për zëvendësimin përfundimtar të Fortlumturi Visarionit.[1423]

Pala shqiptare e dinte se nevojitej mbështetja qeveritare greke për njohjen zyrtare nga Patriarkana Ekumenike. Ngecja e bisedimeve gjatë vitit 1930 kishte lënë çështjen në ajër. Ish-ambasadori grek në Tiranë, Leon Melas, i tha të ngarkuarit me punë në Athinë, Ali Asllanit, në korrik 1932 se qeveria greke nuk përzihej në këtë çështje, por populli dëshironte që ajo të merrte zgjidhje. Ai vlerësonte se çështja do të ishte mirë të

[1413] Xhuvani, *Vepra*, 120-122.
[1414] Po aty.
[1415] AMPJ, V. 1933, D. 487, f. 4-5, Ambasada e Sofjes drejtuar MPJ, 27 shtator 1933.; AMPJ, V. 1933, D. 487, f. 1, Ambasada e Sofjes drejtuar MPJ, 13 shtator 1933.
[1416] AMPJ, V. 1933, D. 487, f. 3, Ambasada e Sofjes drejtuar MPJ, 25 shtator 1933.
[1417] AMPJ, V. 1933, D. 487, f. 2, MPJ drejtuar Ambasadës së Sofjes, 25 shtator 1933.; Xhuvani, *Vepra*, 120-122.
[1418] "Ministrat e Huaj", *Predikimi* nr. 9, 7 maj 1934, 1.
[1419] AMPJ, V. 1933, D. 496, f. 2, Zyra e Shtypit, "Kisha shqiptare dhe marrëdhëniet grekoshqiptare", 1 mars 1933.
[1420] AMPJ, V. 1933, D. 496, f. 3, Haxhiqirjako drejtuar Fortlumturi Visarionit, 28 mars 1933.
[1421] AMPJ, "Kisha shqiptare dhe marrëdhëniet grekoshqiptare", 1 mars 1933, cit.
[1422] AMPJ, V. 1933, D. 496, f. 11, "Përgënjeshtrim" i KOASH, 5 maj 1933.
[1423] AMPJ, V. 1933, D. 496, f. 12, Fletorja Athinaika Nea, 31 maj 1933.

përfundonte edhe për nderin e Kishës Shqiptare. Asllani iu përgjigj se ajo zgjidhej lehtë, nëse Patriarkana jepte Tomosin pa kushte shtesë. Melas pranonte të drejtën e qeverisë shqiptare të zgjidhte drejtuesit fetarë. Mirëpo, shtoi se Patriarkana do të pranonte ta jepte Tomosin, nëse largohej Fortlumturi Visarioni.[1424] Ministri i Jashtëm Diamandopulos do ta fuqizonte qëndrimin, duke thënë pas një jave se Autoqefalia do të jepej, mjafton të ndërrohej Kryepiskopi.[1425]

Mirëpo, Asllani sugjeroi mosngutje. Ambasadori i Britanisë në Athinë i kishte thënë se episkopët grekë mbanin shkresa politike e shpallje kryengritjesh nën petkat e zeza fetare, duke folur për Qipron. Ai njoftoi se dy kryepriftërinj, Hirësi Krisanthosi dhe ish-mitropoliti i Durrësit Jakovi kishin zyrat në Ministrinë e Jashtme Greke. Prandaj, udhëzoi kujdes dhe përgjegjshmëri ndaj Kishës Greke.[1426] Ministri italian në Athinë i shëmbëlleu të njëjtën pasqyrë, duke u nisur nga veprimtaria në Dodekanez.[1427] Po ashtu, Asllani paralajmëronte për përgatitjen e turbullirave në Shqipëri, nën drejtimin e një shoqate vorioepirote të drejtuar nga Mitropoliti i Drinupojës, Vasili.[1428]

5.3. Rikthimi i Kristofor Kisit dhe dorëheqja e Visarionit

Visarion Xhuvani nuk ishte më drejtuesi i pakundërshtueshëm i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Hirësi Kristofor Kisi ridoli në skenë, në vitin 1933. Ai kishte kaluar katër vite i mbyllur në manastire: fillimisht në Ardenicë, më pas në Shën Joan Vladimir e sërish më vonë në Manastirin e Ardenicës. Hirësi Kristofori nuk kishte përzgjedhur të largohej nga vendi, si Jerotheu. Po ashtu, qeveria kishte kundërshtuar prerazi udhëzimet e Visarionit për ta dëbuar nga Shqipëria. Qeveria e vlerësonte Kisin besnik ndaj shtetit dhe Atdheut. Ai mund të ishte aset i vyer në një çast të dytë. Greqia e dinte këtë, ndaj e quante "vegël" në duar të qeverisë shqiptare.[1429]

Hirësi Kristofori kishte kërkuar dhe kishte marrë mbështetje ekonomike nga qeveria shqiptare. Ai i kishte shkruar ministrit të Jashtëm, Rauf Ficos, më 4 maj 1930, se qeveria nuk kishte asnjë detyrim kundrejt tij, porse besonte se nuk do ta linte pa kujdes një episkop që flijoi ndenjësen në Kostandinopojë dhe u bashkua me Kishën Autoqefale.[1430]

Kisi u shpreh i gatshëm t'i shërbente Kishës Autoqefale pas tri vitesh. Kërkesa e ripërfshirjes iu parashtrua Fortlumturi Visarionit, më 4 janar 1933, duke nënkuptuar qarkun kishtar të Korçës, të lënë qëllimisht pa episkop.[1431] Visarioni nuk ndante të njëjtën dëshirë. Ai nuk iu përgjigj kërkesës, duke i lënë Kisit të kuptonte se nuk duhet të kishte shpresë.[1432] Mirëpo, Hirësi Kristofori kishte shkuar më lart. Ai arriti të siguronte një pritje nga Mbreti, me ndërmjetësimin e Kryekuvendarit Koço Kota. Kisi kërkoi rikthimin në drejtimin e një episkopate. Visarioni rendi ta veniste pritjen mbretërore. Ai e cilësoi

[1424] AMPJ, V. 1932, D. 99, f. 1, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 9 korrik 1932.
[1425] AMPJ, V. 1932, D. 99, f. 7, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 29 korrik 1932.
[1426] AMPJ, V. 1932, D. 99, f. 141, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 20 qershor 1932.
[1427] AMPJ, V. 1932, D. 99, f. 142, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 21 qershor 1932.
[1428] AMPJ, V. 1932, D. 107, f. 1, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 2 dhjetor 1932.
[1429] Kondis, *Elinizmos IV*, 49-53: IDAYE, Shënim, cit.
[1430] AMPJ, V. 1930, D. 323, f. 22-23, Mitropolit Kristofori drejtuar MPJ, 4 maj 1930.
[1431] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 71, f. 1, Qarkore, 21 janar 1933.
[1432] Po aty.

takim mirësjelljeje treminutëshe, pas katër vjet lypjesh të kryepriftit. Kryepiskopi shënonte se ai ishte thirrur në pritje njëorëshe me Mbretin, përpara Kisit.[1433]

Fortlumturia u detyrua të sqaronte pas pak ditësh se Episkopata e Korçës nuk do të plotësohej nga Kisi.[1434] Ish-mitropoliti i Beratit ishte larguar në manastir pas një qëndrimi 33-ditor në kryeqytet. Fortlumturi Visarioni përfliste se Kisi kishte lënë pas mëri në qarqet atdhetare. Ndërkohë, nënvizonte se ai u nis në manastir me autobus të madh e jo si një zyrtar i nderuar.[1435]

Gjendja që Kryepiskopi përshkruante në qarkoret e njëpasnjëshme nuk ishte në përputhje me të vërtetën. Sinodhi i Shenjtë emëroi Kristofor Kisin Episkop të Korçës në nëntor 1933. Hirësia ishte kërcënuar nga zyrtarët grekë dhe Patriarkana Ekumenike me zhveshje nëse ripërfshihej në KOASH, porse nuk u step nga kanosja.[1436] Qeveria shqiptare po përpiqej të vendoste në zbatim mendimin e hartuar dy vite më parë, kur dështuan bisedimet me Athinën dhe Kisi pranoi të ishte pjesë e planveprimit. Heqja e Hirësive Ambrozi dhe Eugjeni do të ishte e thjeshtë. Hirësi Eugjeni u tërhoq në vendlindjen e tij, Hoshtovë, në vitin 1934.[1437] Ndërkaq, Episkop Ambrozi qëndroi në detyrë, deri kur ndërroi jetë, më 20 maj 1934. Ky ishte çasti kur Hirësi Kristofori u fuqizua më tej, pasi Sinodhi i besoi mbikëqyrjen e Episkopatës së Gjirokastrës.[1438]

Shtypi grek e quajti lëvizje të jashtëligjshme, duke kërkuar vendosjen e një kryeprifti nga Patriarkana. Mirëpo, zyra e shtypit shqiptar kundërshtoi. Ajo theksoi se emërimi i Hirësi Kristoforit u prit me ngazëllim prej popullit ortodoks të Gjirokastrës. Ai shihej si kryeprift nga më të mirët që KOASH-i kishte dhe njihej edhe nga grekët për studimet teologjike, pas të cilave ishte dorëzuar rregullisht episkop.[1439]

Përplasja më e ashpër do të ndodhte brenda radhëve të Kishës. Hirësi Kristofori nuk kishte harruar kundërshtinë e rreptë të Fortlumturi Visarionit ndaj tij. Zhvlerësimi dhe përqeshja kishin mbetur të shkruara në qarkore. Episkopi nuk do të kursente të shpallte në çdo çast se Visarioni nuk duhet të ishte në krye të KOASH-it. Përplasja e parë erdhi dy muaj pas rikthimit në kryepriftëri. Shkas u bë një padi e parëndësishme nga Përmeti se në Kishën e fshatit Badilonjë qëndronte një kornizë me një kryq dhe dy flamuj grekë. Ish-prifti Atë Stefani dhe prifti i atëhershëm Atë Thanasi u ndoqën për faj.[1440] Fortlumturi Visarioni i shfajësoi, pasi korniza kishte qenë dhuratë e blerë në Selanik nga dy vajza të fshatit. Flamuri grek qëndronte thuajse i padukshëm në një cep të kishës pa neveritur kënd. Ndaj, kërkoi rikthimin e dhuratës.[1441] Qeveria e pranoi arsyetimin dhe urdhëroi rivendosjen e kornizës. Episkopi i qarkut, Hirësi Kristofori, gjeti rastin ta kundërshtonte Fortlumturinë. Ai urdhëroi rivendosjen, meqenëse ishte kërkesë e Kryesisë së Kishës. Mirëpo, e vlerësoi si një vepër të papërshtatshme dhe kundërkombëtare.[1442]

[1433] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 71, f. 3, Qarkore, 23 janar 1933.
[1434] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 71, f. 4, Qarkore, 24 janar 1933.
[1435] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 71, f. 5, Qarkore, 25 janar 1933.
[1436] Glavina, "Kristofori i Sinadhon", 99.
[1437] Dorëheqja e Hirësi Eugjenit dhe tërheqja e tij në fshatin e lindjes nuk u njoftua botërisht, në atë kohë. Hera e parë që është përmendur dorëheqja e tij është buxheti i vitit 1935, nga arkivat që autori i këtij punimi ka shqyrtuar në Arkivën e Shtetit, AMPJ dhe në fletoret e kohës. Buxheti i vitit 1935 shënon pagesën e pensionit të episkopit ndihmës të dorëhequr. Xhuvani, *Xhuvani*, 142-144.
[1438] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 164, f. 170, MPB drejtuar Prefekturës Gjirokastër, 7 nëntor 1934.
[1439] AMPJ, V. 1934, D. 479, f. 20, Përgënjeshtrim, 5 dhjetor 1934.
[1440] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 164, f. 11, Xhandarmëria drejtuar MPB, 13 shkurt 1934.
[1441] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 164, f. 16, KOASH drejtuar MD, 6 mars 1934.
[1442] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1934, D. 164, f. 18, Mitropolia e Korçës drejtuar MD, mars 1934.

Dyluftimi i pritshëm mes dy burrave u pasua nga një përplasje e papritur me qeverinë. Ministria e Arsimit urdhëroi ndalimin e mësimit të fesë gjatë orarit shkollor. Nxënësit i ushtroheshin mësimit themeltar të fesë përkatëse, deri atë kohë. Qeveria vendosi në vitin 1934 se kjo ishte e papërputhshme me natyrën laike të shtetit shqiptar.[1443] Fortlumturi Visarioni kundërshtoi ashpërsisht. Ai theksoi se mësimi fetar përbënte domosdoshmëri për rritjen shpirtërore të besimtarëve. Kryepiskopi udhëzoi bashkëfetarët të mblidhnin shumat e nevojshme për ta vijuar mësimin, pas meshave të të dielave. E përjavshmja e botuar nga Kisha do të shpërndante mësimet fetare.[1444]

Kulmimi i përplasjes do të vinte pak muaj më vonë, në një sfond krejt tjetër të marrëdhënieve mes dy vendeve. Greqia po ndryshonte kurs kundrejt Tiranës. Ministria e Jashtme Greke zhvilloi një takim pune në gusht 1934, me pjesëmarrjen e drejtuesve të shërbimit të diplomacisë kishtare, ambasadori grek në Tiranë, Dhiamandopulos, dhe Mitropolitit të Trapezundës, Krisanthos. Dhiamandopulos shihte një rrugëzgjidhje: largimin e Visarionit dhe dhënien e Tomosit. Ai arsyetonte se kjo ishte mundësia e vetme e rifitimit të ndikimit të Patriarkanës Ekumenike në Shqipëri. Hirësi Krisanthos ndau të njëjtin mendim. Ministria e pranoi sugjerimin, së bashku me të gjitha kushtet shqiptare. Zbatimi do të shtyhej vetëm aq sa të mos ringjallte dëshirat e italianëve për autoqefali në Dodekanez.[1445] Kryekuvendari Koço Kota u takua me Pandeli Kotokon fundvitin 1934. Ai shprehu gatishmërinë për ndryshimin e Visarionit, nëse jepej Tomosi.[1446]

Zhvillimet nuk ishin njoftuar botërisht përgjatë fundvitit 1934 dhe fillimvitit 1935. Ajo çka ndihej ishte se Fortlumturi Visarioni ishte në prag të largimit nga drejtimi i Kishës. Mënyra e njoftimit të Kryepiskopit mbi këtë zhvillim është e panjohur. Mirëpo, ai nisi një fushatë në dy drejtime prej fillimvitit 1935. Fortlumturia kundërshtoi zyrtarët shtetërorë dhe u përpoq të çelte marrëdhënie të reja me kishat e huaja, në kërkim të njohjeve zyrtare. Mësimi i feve në shkolla u bë fushëbeteja kryesore. Kryepiskopi sulmoi frymëzuesin e ligjit të ri të arsimit, ministrin Mirash Ivanaj, në janar 1935. Visarioni e quajti të pafe dhe e paditi se po shkatërronte besimin. Ai sulmoi edhe deputetët ortodoksë që nuk kujdeseshin aq sa duhej për nderimin e priftërinjve dhe fesë.[1447]

Kundërshtitë e ashpra të Fortlumturisë do të përshkallëzoheshin, deri në prill 1935. Ai i nisi një përkujtesë Mbretit, ku radhiste përndjekjet ndaj besimtarëve. Përkujtesa ishte pasojë e kundërmësymjes së Ivanajt. Ministri kishte paditur Kryepiskopin se merrej me çështje politike. Fortlumturi Visarioni ankohej se disa nga zyrtarët shtetërorë nuk bënin aq sa duhej për njohjen e Kishës nga simotrat e saj dhe mbështesnin unitizmin në Shpat të Elbasanit. Po ashtu, ai theksonte se mësuesit fyenin prindërit në kundërshtim me traditën dhe denjësinë kombëtare, në disa shkolla, kryesisht në Elbasan. Kryepiskopi kishte edhe ankesa ekonomike për përvetësimin e pronave kishtare dhe mosmbledhjen e taksave të ortodoksëve nga zyrtarët qeveritarë. Visarioni vlerësonte se gjendja e Kishës ishte serioze dhe e ngutshme, çka e bënte t'i drejtohej Mbretit për të peshuar siç duhej punën, për të mënjanuar rrezikun ndaj Atdheut.[1448]

[1443] Shih ASQSH, F. 155 "MD", V. 1934, D. VIII-273.
[1444] Xhuvani, *Vepra,* 129-130.
[1445] Kondis, *Elinizmos IV,* 222-223, IDAYE, D. A/22/Iβ, nr. 12159, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 13 nëntor 1934.
[1446] Po aty ; dhe Kondis, *Elinizmos IV,* 224-225, IDAYE, D. A/4/2, nr. 20245, Ambasada Tiranë drejtuar MPJG, 22 janar 1935.
[1447] AQSH, F. 155 "MD", V. 1935, D. VIII-315, f. 4, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 4 janar 1935.
[1448] Xhuvani, *Vepra,* 140-141.

Shtypi grek do t'i bënte jehonë përkujtesës, duke theksuar përndjekjen e ortodoksëve, të përshkruar nga Kryepiskopi. Visarioni u tërbua nga përdorimi i fjalëve të tij për mbështetjen e qëndrimeve greke. Ai përligji përkujtesën me lirinë e të folurit haptazi që mbizotëronte në Shqipëri. Fortlumturia kundërshtonte se kishte përndjekje ndaj pakicës greke. Ai shprehej se nuk ishte Kryepiskop i greqishtfolësve që dihej se sa ishin, por i gjithë Shqipërisë dhe rrjedhimisht drejtonte mbarë grigjën shqiptare. Ndaj, shprehej kryelartë që asnjë grek i Shqipërisë nuk ankohej për përndjekje gjatë drejtimit të Kishës prej tij. Fortlumturia theksonte se ortodoksia në Shqipëri kishte mbështetje të plotë të Mbretit dhe shtetit. Ai përfundonte se kundërshtitë brenda vendit i rregullonin mes veti, pasi atdhetaria e ndërgjegjja kombëtare ishin zhvilluar mjaftueshëm për t'u bërë ballë dredhive të huaja.[1449] Sidoqoftë, përkujtesa i ashpërsoi marrëdhëniet e Kryepiskopit me qeverinë. Ministria e Brendshme urdhëroi post-telegrafet të mos përçonin asnjë telegram të Kryepiskopit drejt Mbretit, nëse kishte përmbajtje të dëmshme.[1450]

Zhvillimet e brendshme dhe marrëveshja e pritshme mes qeverisë shqiptare dhe Patriarkanës Ekumenike nënkuptonin largimin e Visarionit nga drejtimi i Kishës. Ndaj, Fortlumturia u përpoq për herë të fundit të merrte njohje zyrtare ndërkombëtare. KOASH ishte pranuar zyrtarisht si Autoqefale nga Kisha Bullgare, porse Patriarkana e Sofjes nuk njihej nga kishat greke. Kryepiskopi kishte marrë mbështetje shpirtërore edhe nga kishat rumune e serbe, porse jo një njohje zyrtare. Ai kishte pritshmëri të veçantë nga Beogradi. Fortlumturi Visarioni ishte përpjekur t'i paraqiste bisedat me drejtuesit kishtarë të Kishës Serbe si njohje të KOASH-it. Ai kishte rendur të fliste për njohje akoma edhe kur thjesht merrte ftesa për kremtime.[1451] Mirëpo, kjo nuk kishte vlerë. Çështja kishtare shqiptare nuk shihej njëtrajtshmërisht në Beograd. Shtypi ishte i ndarë: "Politika" botonte shkrime kundër KOASH-it, duke mbrojtur vetëm Visarionin, ndërsa "Stampa" pasqyronte kërkesën e Kryepiskopit për njohje zyrtare më 9 dhjetor 1934.[1452] Visarioni zhvilloi një përshpirtje për ish-kryetarin e Bashkisë së Durrësit gjatë kohës së Mitropolitit Jakov, Vuko Gjurashkoviç, në përpjekje për t'u ripajtuar me Beogradin.[1453]

Ai pati rastin për të marrë njohje zyrtare në takimin e radhës të Konferencës Ballkanike të Kishave Ortodokse. Mbledhja u zhvillua në Herxeg Novi të Jugosllavisë në vitin 1935. Visarioni ishte i dërguari i vetëm i KOASH-it.[1454] Ai parashtronte se përfaqësuesit e Kishës Greke e kishin mirëpritur praninë e Kishës Shqiptare dhe e kishin nderuar Visarionin si prijës kishtar. Fortlumturia theksonte se ishte përmendur Kryepiskop dhe Mitropolit i Shqipërisë në meshimin e kryer në Manastirin e Savinës, ku edhe ishte dorëzuar dhjetë vjet më parë. Xhuvani shënonte se përfaqësuesit grekë kishin dhënë miratimin që Konferenca t'i dërgojë Kishës Shqiptare një përshëndetje, duke nënkuptuar njohje të KOASH-it. Urimi nënshkruhej nga patriarkët e Rumanisë, Jugosllavisë dhe Kryepiskopi i Athinës, Krisostomi. Ata miratuan drejtimin e mbledhjes së parë dhe të fundit të konferencës, nga Visarioni në shqip. Flamuri shqiptar ishte valëvitur pranë atij grek në ballkonin e ndërtesës së Konferencës, ku u dëgjua edhe himni

[1449] "Spjegime mbi përgënjeshtrimet Kryepiskopale", *Predikimi* nr. 44, 31 mars 1935, 1.
[1450] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 473, f. 1, MPB drejtuar Drejtorisë së PT Lezhë, 27 prill 1935.
[1451] Xhuvani, *Vepra*, 97.
[1452] AMPJ, V. 1934, D. 287, f. 21-22, Fletorja Politika, 14 maj 1934; AMPJ, V. 1934, D. 287, f. 15, Fletorja Stampa, 9 dhjetor 1934.
[1453] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 460, f. 6, Batalioni IV drejtuar Komandës së Kufirit, 15 maj 1935.
[1454] Përfaqësuesi tjetër Thoma Orolloga e kishte të pamundur të shkonte. Kryepiskopi foli mbi veprën e Kishës në Shtet dhe në Komb, një fjalim i bashkëpregatitur nga Visarioni, Orollogai dhe dr. Irakli Noçka.

mbretëror e ai kombëtar. Fortlumturia u prit me nderime të mëdha nga qeveritari i Herxeg Novit, si edhe nga Mitropoliti i Cetinjës, Hirësi Gabrieli.[1455]

Takimi i Jugosllavisë do të pasohej nga mbledhja e përvitshme e Aleancës Botërore në Montro të Zvicrës, në gusht. Visarioni përhapte sërish lajme të mira. Ai shënonte se ishte takuar me Hirësi Gjermanosin e Patriarkanës Ekumenike dhe të dërguarin e Kishës së Greqisë, teologun Alivizatos. Kryepiskopi theksonte se përfaqësuesit grekë dhe kreu i Kishës Polake mbështetën Kishën Shqiptare. Visarioni vlerësoi se takimet përbënin ndriçimin e kishave simotra për çështjen kishtare shqiptare dhe krijimin e një përshtypjeje të mirë në Evropë dhe Amerikë. Parashtresat e Fortlumturi Visarionit ishin një përpjekje e fundit për të mbetur në krye të KOASH-it, më shumë sesa një pasqyrim i veprimtarive. Ai do ta vërtetonte sforcimin muajt në vijim. Kryepiskopi lëvdoi Patriarkun e ri Serb, Varnava, me rastin e panairit të përvitshëm të Shën Joan Vladimirit në Elbasan. Patriarku Varnava u përgjigj me falënderimet dhe bekimet për Kishën dhe popullin Shqiptar.[1456] Fortlumturia kërkoi njohjen zyrtare nga pala serbe më 22 prill, teksa rreziku i unitizmit ishte shtuar.[1457]

Përpjekja përafruese do të sillte një vendim të papritur, që Krishtlindja e vitit 1935 të zhvillohej në tri gjuhë. Mesha u mbajt në shqip dhe greqisht më 25 dhjetor dhe në sllavisht më 7 janar, çka përkonte me Krishtlindjet në kalendarin e vjetër, të përdorur nga kishat sllave.[1458] Greqia u përpoq të përfitonte. Konsullata në Korçë kërkoi meshimin në greqisht për punonjësit, në një prej kishave të qytetit.[1459] Kërkesa u mohua nga qeveria, si e papajtueshme me Statusin e Kishës.[1460] Prefektura gjykonte se qëllimi i konsullatës ishte krijimi i një kishe që do të meshonte në greqisht edhe për banorët, çka vlerësohej rrezik kombëtar.[1461] Konsulli u shpreh i zhgënjyer. Ai e cilësoi vendimin të padrejtë, për aq sa mund të meshohej greqisht në Tiranë.[1462]

Përpjekjet e Visarionit nuk u ndalën. Ai dërgoi dy telegrame, që pak kohë më parë do të ishin të papërfytyrueshme. Fortlumturia uroi Mbretin e Grekëve, Gjergji II, për rikthimin në detyrë. Ndërkaq, rendi të lajmëronte Patriarkun Ekumenik Foti se kishte meshuar në greqisht me rastin e Krishtlindjeve. Visarioni përfundonte me një lutje drejtuar Tërëshenjtërisë për bekim shpirtëror. Kryepiskopi përdori edhe ndikimin në shtyp. Londinezja "Britania e Madhe dhe Lindja" lëvdonte meshimin në tri gjuhë, duke e vlerësuar si shenjë miqësie dhe mirënjohjeje e kombit shqiptar ndaj sivëllaut grek.[1463] Mirëpo, arritja e madhe erdhi më 2 nëntor 1935, kur fletorja kishtare athinase "Zëri i Kishës", botoi një shkrim pro Visarionit. Fortlumturia lëvdohej se mbante seminarin

[1455] Xhuvani, *Vepra*, 53.
[1456] Xhuvani, *Vepra*, 148-161.
[1457] AMPJ, V. 1936, D. 305, f., 18, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJ, 22 prill 1936.; Vlen të theksohet se Patriarku Serb Varnava kërkoi nga Patriarkana Ekumenike njohjen e Kishës Shqiptare, duke përdorur si arsyetim përhapjen e unitizmit. Mirëpo, kërkesa do të bëhej disa muaj më vonë, më nëntor 1936, kur Visarioni nuk ishte më në krye të KOASH. (AMPJ, V. 1936, D. 305, f., 32, Ambasada e Beogradit drejtuar MPJ, 16 nëntor 1936)
[1458] "Krishtlindja në gjuhën helenike dhe sllavishte", *Predikimi* nr. 62, 16 janar 1936, 8.
[1459] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1936, D. VI-578, f. 2, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 9 janar 1936.
[1460] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1936, D. VI-578, f. 3, Kryeministri drejtuar Prefekturës Korçë, 18 janar 1936.
[1461] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 190, f. 3, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 1 janar 1936.
[1462] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 190, f. 6, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 28 janar 1936.
[1463] Xhuvani, *Vepra*, 160-162.

priftëror me shpenzime vetjake dhe përshkruhej si drejtues madhështor shpirtëror e luftues i armiqve të ortodoksisë.[1464]

"Predikimi" vlerësonte përshëndetjet e marra. Ajo shënonte se Fortlumturia kishte të drejtë të mburrej për këto vepra të larta, duke nënvizuar se Visarioni mbështetej nga Kryepiskopi i Athinës.[1465] Shkrimi përfundonte se KOASH u njoh në vetëm shtatë vjet, ndërsa Kisha e Greqisë priti plot 20 vjet.[1466]

Lëvizjet kishin qenë tregues pasigurie. Xhuvani shihte se çështja kishtare po shkonte drejt zgjidhjes, çka nënkuptonte largimin e tij nga kryesimi i KOASH-it. Mesha e trefishtë në Tiranë u bë pika që derdhi kupën. Zyrtarët e Korçës vërenin se edhe atdhetarët, edhe grekomanët e paktë ishin rreshtuar rreth Hirësi Kristoforit. Prefekti i Korçës, Ismet Kryeziu, parashtronte në qershor 1935 se ndalimi i shkollave private kishte zhvendosur grekomanët në kërkesa kishtare. Ata dëshironin shkatërrimin e rendit të Kishës për të rizgjuar të drejtat që kishte dikur. Atdhetarët shqiptarë u ishin bashkangjitur me ndihmën e Hirësi Kristoforit. Bindja e Kryeziut ishte krijuar pas zgjedhjeve të shoqërisë "Rinia Korçare", ku ortodoksët kishin mbështetur vetëm bashkëfetarët e tyre. Arsyeja kryesore e lëvizjes ishte natyra e Kryepiskopit, për të cilin ajka ortodokse shqiptare ndiente mëri. Kryeziu mendonte se Kisi po përfitonte, duke vepruar kundër dobisë kombëtare. Ai parashtronte se Kristofori kishte ndikuar me sjelljet dhe predikimet për të rrënjosur pakënaqësi dhe për të arritur qëllime dashakeqe ndaj Kishës Kombëtare.[1467]

Pasqyra që ofronte Kryeziu nuk ishte tërësisht e saktë. Pjesa dërrmuese e ortodoksëve ishin rreshtuar rreth Kisit, por kjo nuk vinte përkundër dobisë kombëtare. Hirësi Kristofori ishte në dijeni të planeve qeveritare për marrjen e Tomosit, çka nënkuptonte largimin e Visarionit. Ngjarjet do të përshpejtoheshin, nëse ai zgjidhej Kryepiskop. Kisi nuk drejtohej nga grekomanët në këtë përpjekje, siç gjykonte Kryeziu. Kahkundërt, beteja drejtohej nga atdhetarët Dhimitër Mano, Vangjel Turtulli dhe Llambi Bimbli, anëtarë të Pleqësisë Kishtare Korçare. Kryeziu do t'i dallonte drejtuesit vetëm në fillimvitin 1936. Maskat u hodhën pas meshës së trefishtë. Ajka atdhetare shqiptare shprehu pakënaqësi të madhe ndaj shërbesës në greqisht dhe urimit të Mbretit Grek nga Visarioni.[1468]

Hirësi Kristofori i tha Kryeziut se populli kishte të drejtë të kërkonte largimin e Visarionit, pasi zotimet qeveritare nuk ishin plotësuar. Prefekti vërente se qëllimi i Kisit dhe parisë ortodokse atdhetare zinte vend gjithnjë e më shumë. Ndaj, udhëzoi qeverinë të largonte Kisin nga Korça së paku për dy javë, nëse dëshironte ndalimin e kundërshtive ndaj Visarionit. Ai këshillonte që ndryshimi i Kryepiskopit të bëhej me vullnet qeveritar dhe jo me lëvizje nga Korça, çka mund të shoqërohej nga kërkesa të tjera.[1469]

[1464] "Kryepiskopi i Shqipnisë Vissarion", *Predikimi* nr. 64, 15 shkurt 1936, f. 1.

[1465] "Kishat e tjera Orthodhokse dhe Kisha e jonë Autoqefale", *Predikimi* nr. 62, 16 janar 1936, f. 1.

[1466] *Predikimi* nr. 64, 23 shkurt 1936, 3. Të gjitha kishat kishin kaluar në periudha përçarjeje, me përjashtim të Kishës Serbe. Kisha e Greqisë u cilësua përçarëse për 17 vjet nga 1833 deri më 1850. Kisha Rumune ishte e panjohur për 21 vjet nga 1864 deri në 1885. Ndërsa, Kisha Bullgare do të qëndronte pa Tomos nga Patriarkana, akoma edhe pas njohjes së autoqefalisë së KOASH. Ajo u cilësua përçarëse për plot 72 vjet nga 1872 deri më 1948. Panev, "Koncepti i autoqefalisë", 32.

[1467] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 467, f. 1-4, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 12 qershor 1935.

[1468] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 1, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 4 janar 1936.

[1469] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 5, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 23 mars 1936.

Hirësi Kristofori vijoi pareshtur sulmin kundër Fortlumturi Visarionit dhe përhapi kërkesën për thirrjen e një kongresi të ri kishtar.[1470] Ai u nis në Gjirokastër dhe Përmet, ku prej kohësh bisedohej për mbledhjen e një kongresi.[1471] Kërkesa zyrtare u hartua në Përmet dhe shprehte hidhërimin për gjendjen e Kishës.[1472] Ortodoksët e atyshëm kërkonin thirrjen e një kongresi që do të trajtonte çështjen e njohjes, kryesinë e Kishës dhe shkollat fetare.[1473] Letra mbërriti shumë shpejt në Korçë, ku u nënshkrua nga një sërë qytetarësh të njohur dhe u shndërrua në kërkesë të të gjithë ortodoksëve të Qarkut Kishtar të Korçës.[1474] Nismëtari Vangjel Turtulli ndihmohej nga Grigor Çani, Lalmbi Bimbli dhe Dhimitër Mano, nën shtysën e pashpallur të Hirësi Kristofor Kisit.[1475]

Ata njoftuan mitropolitë e tjera, duke kërkuar zgjedhjen e përfaqësuesve nga çdo qark kishtar. Pleqësia e Korçës u mblodh më 4 maj 1936.[1476] Hirësi Kristofori nuk rendi ta pranonte nismën. Ai u kërkoi juristëve ta studionin nga pikëpamja ligjore. Mbledhja u zhvillua me shprehje atdhetarizmi për vendin dhe për Kishën Autoqefale.[1477]

Qeveria shqiptare u doli para pasojave. Ajo frikësohej se çështje të tjera mund të ngriheshin në një kongres, si përpjesëtimi i nëpunësve, zgjedhje të deputetëve në bazë të fesë apo heqja e të drejtës së Mbretit për të shkarkuar episkopët. Një pjesë e atdhetarëve, si Vasil Marko, Nikollaq Zoi, Petraq Katrua, Ilo Argjendari etj. ndanin frikën qeveritare. Nismëtarët dhe shumica dërrmuese e nënshkruesve vinin nga radhët e atdhetarëve. Mirëpo, Prefektura e Korçës shihte me dyshim faktin se ndër ta ishte edhe Vasil Kondi e Ilo Çipi, të njohur si grekomanë. Sipas prefektit, kjo fshihte përfshirjen e konsullatës greke.[1478] Qeveria udhëzoi Prefekturën e Korçës ta luftonte veprën pa bujë dhe pa i dhënë shkak ndonjë kundërveprimi.[1479] Po ashtu, udhëzoi të gjitha prefekturat të kërkonin tërthorazi rrëzimin e kërkesës.[1480] Qeveria lajmëroi prefektët se kishte pasur qëllim heqjen e Visarionit, nëse ai nuk pranonte të jepte dorëheqjen.[1481]

[1470] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 7, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 15 prill 1936.

[1471] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 8, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 18 prill 1936.

[1472] Një meshë unite u mbajt për herë të parë në Korçë, në mars 1936, me pjesëmarrjen e 20 ortodoksëve, nën drejtimin e Atë Petros (AQSH, F. 152 "MPB", V. 1938, D. 1124, f. 22, Prefektura Korçë drejtuar MPB, mars 1936). Mirëpo, kjo ishte një trysni ndaj Visarionit dhe asnjë prej pjesëmarrësve nuk kishte ndërmend të kalonte në unitizëm, sipas zyrtarëve vendorë. Rreziku unit u përdor për shkarkimin e Visarionit.

[1473] AQSH, F. "Mitropolia Korçë", V. 1936, D. 567, f. 1, Kërkesë e Orthodhoksëve të Përmetit, pa datë.

[1474] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 17, Komanda e Xhandarmërisë drejtuar MPB, 5 maj 1936; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 46, Letra e Orthodhoksëve të Korçës, pa datë.

[1475] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 13, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 29 prill 1936; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 15, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 30 prill 1936.

[1476] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 19, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 5 maj 1936. Ajo përbëhej në shumicë dërrmuese nga atdhetarë. Anëtarë ishin Thoma Turtulli, Petraq Kondi, Kristaq Kosturi, Ilo Kota, Kristaq Marko, Gaqi Bardho, Nuçi Mborja, Sotiraq Lako, Llambi Bimbli dhe Dhimitër Mano. Përjashtimisht morën pjesë në mbledhje edhe Ilo Çipi, Kristo Moskopoliti, Arqile Fundo, Rafail Prodani, Vasil Kondi, Vangjell Turtulli dhe Ilo Nona. (AQSH, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 30 prill 1936, cit.).

[1477] AQSH, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 5 maj 1936, cit.

[1478] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 38, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 9 maj 1936.

[1479] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 30, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 7 maj 1936.

[1480] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 23, MPB drejtuar Prefekturave Elbasan, Vlorë, Durrës dhe Berat, 7 maj 1936.

[1481] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 22, MPB drejtuar Prefekturës Gjirokastër, 6 maj 1936.

Letra nuk shihej me sy të mirë nga pleqësitë e tjera kishtare. Ajo përflitej në Gjirokastër së paku prej 25 prillit.[1482] Pleqësia vendosi mospranimin e Kongresit, teksa shihte kryeneçësi të korçarëve dhe rrezik përçarjeje.[1483] Njëherazi, kërkoi largimin e Visarionit.[1484] Prifti i sprovuar Atë Pano ishte kundër largimit të Kryepiskopit. Ai i shpalli qeverisë se dorëheqja e Visarionit ishte varrim i gjuhës kombëtare.[1485] Mbështetja ishte ndër të paktat që Visarioni do të merrte. Ai kishte kundërshtarë të njohur akoma dhe në Durrës e Elbasan, qendrat e Mitropolisë që drejtonte, si Grigor Nosi e Thanas Floqi.[1486] Hirësi Agathangjeli paralajmëronte se kërkesa do të rrëzohej në Berat dhe Vlorë.[1487] Mirëpo, pleqësitë e atyshme ngritën një komision për të shkuar në Tiranë.[1488] Agathangjeli u takua me ministrin e Brendshëm, më 7 maj. Ministri i bëri të ditur se Xhuvani do të dorëhiqej brenda pak ditësh dhe nuk kishte asnjë arsye për të mbledhur një kongres të ri. Hirësia u rikthye në Berat të nesërmen dhe lajmëroi Pleqësinë, duke shtyrë vendimmarrjen.[1489] Pleqësia e Beratit vendosi më 13 maj të kërkonte që qendra e Kongresit të ishte Berati, nëse ai zhvillohej.[1490] Hirësi Agathangjeli rendi të kërkonte mendimin e qeverisë. Një tepri populli dhe priftërinjsh kishin nënshkruar kërkesë për largimin e menjëhershëm të Visarionit.[1491] Agathangjeli u kishte thënë se ishte çështje ditësh. Mirëpo, vonesa qeveritare e kishte vendosur në vështirësi.[1492] Gjithsesi, prefektura e siguroi se Kryepiskopi do të largohej shpejt.[1493]

Qeveria shqiptare kishte arritur ta bindte Fortlumturi Visarionin të dorëhiqej. Largimi nga një kërkesë e brendshme bënte të qartë se Greqia nuk kishte ndryshuar gjendjen kishtare në Shqipëri. Vetë shqiptarët ishin ata që i hapën rrugë zhvillimit. Përligjja lehtësonte marrëveshjen për njohjen e autoqefalisë, teksa Visarioni nuk do të ishte më Kryepiskop. Ai thirri anëtarët e Sinodhit më 27 maj për të dhënë dorëheqjen.[1494] Qeveria kishte dijeni për mbledhjen, ku morën pjesë edhe anëtarët e Këshillit Mikst.[1495]

Kryepiskopi sqaroi se e shihte të nevojshme largimin nga drejtimi i Kishës, si pasojë e lodhjes dhe nevojës që kishte për t'u qetësuar. Ai tha dëshironte të dorëhiqej përpara një kongresi mbarortodoks, sikurse ishte zgjedhur, por kjo nuk iu mundësua. Kryepiskopi nuk la pa thumbuar lëvizjen e korçarëve, Kristoforit dhe Agathangjelit. Visarioni e quajti besëprerje dhe thyerje të rendit si para rregullave fetare edhe para Mbretit. Ai theksoi se kërkesat e Pleqësisë Kishtare të Korçës duhet të ishin bërë rregullisht, qoftë edhe për zëvendësimin e tij. Fortlumturia njoftoi se dorëheqja nuk qe e

[1482] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 11, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 25 prill 1936.
[1483] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 40, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 8 maj 1936.
[1484] AQSH, F. 150 "Ministria e Oborrit Mbretëror", V. 1936, D. VI-287, f. 13, Prefektura Gjirokastër drejtuar Kryeinspektorit të Oborrit Mbretëror, 2 maj 1936.
[1485] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1936, D. VI-576, f. 1, Atë Pano Gjirokastra drejtuar Kryeministrit, 18 maj 1936.
[1486] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 42, Prefektura Elbasan drejtuar MPB, 8 maj 1936.
[1487] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 31, MPB drejtuar Prefekturave Berat dhe Vlorë, 7 maj 1936.
[1488] Për telegramet e shkëmbyera shih: AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 32-35.
[1489] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 41, Prefektura Berat drejtuar MPB, 8 maj 1936.
[1490] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 50, Prefektura Berat drejtuar MPB, 13 maj 1936.
[1491] Shih AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 52-53 dhe 55-58.
[1492] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 51, Mitropolia Berat drejtuar MPB, 13 maj 1936.
[1493] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 54, MPB drejtuar Prefekturës Berat, 14 maj 1936.
[1494] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 72, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 21 maj 1936.
[1495] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 74, MPB drejtuar Prefekturës Korçë, 21 maj 1936.; AMPJ, V. 1936, D. 305, f. 19, "Mbledhja e Sinodhit të Kishës Autoqefale të Shqipërisë", 27 maj 1936.

shtrënguar as nga shteti, as nga populli e as ishte rrjedhojë e frikës mos vritej nga të huajt. Kryepiskopi u shpreh se mendimin për dorëheqje e kishte prej vitit 1932, por kishte frikë mos keqkuptohej, prandaj nuk e pati paraqitur.[1496]

Ai arsyetoi dorëheqjen me tri shkresa. Visarioni shpalosi shkaqet që e çuan në këtë vendim në shkresën e parë. Arsyet ishin lehtësimi i shtetit për arritjen e dobisë kombëtare në çështjet politikofetare; lehtësimi i njohjes së KOASH-it nga kishat greke dhe shpresa se kryetari i ri do të mbështetej më shumë nga qeveria.[1497]

Kryepiskopi shpaloste gjendjen e kishës në shkresën e dytë. Ai e vlerësonte të pamundur të vazhdonte detyrën, teksa mungonin mjetet për mësimin e besimit, mbajtjen e episkopëve, predikuesve, zëvendësve, priftërinjve dhe studentëve. Visarioni theksonte se nuk kishte mjetet për të mbajtur rendin kishtar, teksa nuk zbatoheshin vendimet. Ai sulmoi drejtuesit e lartë shtetëror, pasi i kishte munguar përkrahja e 3-4 njerëzve që përbënin mbarë drejtimin politik ortodoks në Shqipëri. Këtu nënkuptonte Koço Kotën, Pandeli Evangjelin, Vasil Avramin dhe ndonjë tjetër. Visarioni ankohej për mungesë fondesh për mbajtjen e kishës, përkthimin e librave, marrëdhëniet me kishat në mërgatë, ruajtjen e kishave të lashta, dhe përballjen me dredhitë e fushatat kundërkishtare. Kryepiskopi theksoi se ishte teologu i vetëm me doktoraturë në Shqipëri dhe nismëtari i lëvizjes kishtare nga Kongresi i Beratit te Kongresi i Korçës. Visarioni çmonte se Sinodhi i Shenjtë kishte shmangur pagesën e priftërinjve nga të huajt dhe kishte vendosur përfundimisht shqipen në të gjitha kishat, duke meshuar me lutje për Mbretin, ushtrinë dhe Kombin. Visarioni shpallte se Kisha njihej botërisht, pavarësisht pse tre katër herë në vit njoftohej se po shkarkohej nga Mbreti.[1498]

Fortlumturi Visarioni shfaqi në shkresën e tretë përmbledhjen e punës nga sigurimi i dogmës te ringritja kishtare. Ai theksoi se dorëheqja ishte pasojë e lodhjes prej punës ditë e natë në shërbim të Kishës dhe Atdheut, porse ngushëllohej nga sigurimi i autoqefalisë dhe atdhetarizmit. Fortlumturia kujtoi se arriti të merrte njohje të Kishës nga të gjitha kishat jogreke: rumune, serbe, bullgare, polake dhe mundësoi arsimimin e 4 djemve për teologji dhe të 22 të tjerëve në seminarin kombëtar. Ai kishte mundësuar botimin në shqip të shumë librave të shenjtë dhe mësimit fetar. Ndërkohë, asnjë pakicë kombëtare nuk ishte ankuar për përndjekje. Visarioni vinte në dukje mirëqeverisjen e pasurive dhe ruajtjen e denjësisë së Kishës. Ai falënderoi priftërinjtë e laikët për bashkëpunimin dhe Mbretin e zyrtarët shtetërorë për përkujdesjen. Fortlumturia shfaqi mirënjohjen për Patriarkun serb Dhimitrin, Episkopin Viktor dhe Mbretin jugosllav Aleksandrin I për ndihmën e dhënë në krijimin e Sinodhit. Në fund, Kryepiskopi i besoi drejtimin e kishës Episkopit të Korçës, Kristofor Kisit, duke e siguruar se nuk do të jepte veçse ndihmë dhe përkrahje. Fortlumturia u zotua se do të qëndronte larg çdo pune politikofetare.[1499]

Hirësi Kristofori mori fjalën dhe shfaqi hidhërimin për dorëheqjen. Ai e siguroi Visarionin se Sinodhi do ta quante gjithnjë të pranishëm, vëlla dhe bashkëpunëtor në çdo çështje për mbarëvajtjen e Kishës Autoqefale, edhe pas largimit nga detyra.[1500] Fortlumturia i dorëzoi zyrtarisht të nesërmen Ministrisë së Drejtësisë njoftimin e

[1496] AMPJ, V. 1936, D. 305, f. 20, Akti i dorëheqjes, pa datë.
[1497] Po aty.
[1498] Po aty.
[1499] Po aty.
[1500] Xhuvani, *Vepra*, 165-167.

dorëheqjes.[1501] Ajo u dekretua nga Mbreti Zog më 2 qershor, duke i dhënë fund drejtimit shtatëvjeçar të Kishës nga Visarion Xhuvani.[1502] Shtypi grek i dha lajmit hapësirë të veçantë, duke shënuar se tashmë u hap rruga për dhënien e Tomosit.[1503]

Shteti shqiptar u kujdes të ndalonte çfarëdo ndryshimi të rendit kishtar në Shqipëri, që mund të sillte dështim të ri në bisedimet me Greqinë.[1504]

Rendi ishte i brishtë, sidomos pas vdekjes së Episkopit të Gjirokastrës, Ambrozit. Përflitej se Kisha do të plotësonte vendin e zbrazët me Atë Pano Gjirokastrën, i mbetur i ve prej vitesh. Prefekti Zef Kadarja e kundërshtoi, si një përzgjedhje që do të sillte përçarje me greqishtfolësit. Për më tepër, mospasja e një diplome teologjike do të përdorej si armë nga kundërshtarët e autoqefalisë.[1505] Kadarja këshilloi emërimin përfundimtar të zëvendësisht Mitropolitit Hirësi Kristoforit.[1506] Ministria e Brendshme vendosi në lëvizje Ministrinë e Drejtësisë, duke parandaluar emërimin e Atë Panos.[1507] Mundësia tjetër e përfolur ishe Hirësi Eugjeni, pas dorëheqjes së Visarionit. Prefekti i ri i Gjirokastrës, Nikollaq Zoi, e vlerësoi të papranueshëm emërimin e episkopit të tërhequr.[1508] Qeveria ndërhyri sërish.[1509] Përpjekja e fundit për emërimin e episkopëve të rinj u krye në Tiranë. Mirëpo, Sinodhi i Shenjtë nuk arriti në vendimmarrje.[1510]

Episkopata e Gjirokastrës vijonte të ishte mes dy zjarreve. Qeveria shqiptare kishte ndërhyrë për mosemërimin e Atë Nikollës si zëvendësmitropolit të Delvinës, në kujtim të ndodhive të vitit 1929. Po ashtu, u zëvendësua edhe prifti i Palasës, i cili kishte paguar kryeplakun atdhetar të fshatit, Perikli Milon, për ta çuar në krah të grekomanizmës.[1511] Ndodhi të ngjashme haseshin edhe në qytetin e Gjirokastrës. Prefekti Nikollaq Zoi kundërshtoi emërimin e mundshëm të anëtarit të pakicës, Atë Zisi, si zëvendësmitropolit. Ai e cilësoi Atë Zisin, më 26 gusht, pijanec të dyshimtë në sjelljet kombëtare.[1512] Mirëpo, prifti mbërriti të nesërmen me emërimin e nënshkruar nga Hirësi Kristofori.[1513] Qeveria kërkoi shfuqizimin e vendimit, duke e përligjur me një kërkesë të Pleqësisë Kishtare.[1514] Hirësi Kristofori nuk pranoi, duke detyruar qeverinë të urdhëronte hartimin e një kërkese të dytë.[1515] Përfundimisht, Atë Zisi u tërhoq në fshehtësi, më 1 tetor 1936.[1516]

Ruajtja e gjendjes së krijuar mund të cenohej nga Kongresi Kishtar, të kërkuar nga Hirësi Kristofori për largimin e Visarionit. Kisi u përpoq të bindte pasuesit se

---

[1501] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1936, D. VI-576, f. 3, Visarion drejtuar MD, 28 maj 1936.
[1502] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1936, D. VI-576, f. 6, Dekreti i dorëheqjes, 2 qershor 1936.
[1503] AMPJ, V. 1936, d. 304, f. 4, Fletorja Nei Kairi, 4 prill 1936.
[1504] Kisha vijoi të fuqizohej në vitet 1937-1937. Kristofori riorganizoi seminarin, duke shtuar bursistët. Ndërkaq, çeli "Bibliotekën Predikimi" dhe botoi libërtha si "Engolpioni Orthodhoks", "Jeta dhe çudirat e dëshmorit të madh Shën-Mitrit", "Disa Këshilla Krishtërore", etj. Beduli, *Kishë dhe kulturë,* 37-59.
[1505] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 474, f. 4, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 1 nëntor 1935.
[1506] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 474, f. 8, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 5 nëntor 1935.
[1507] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 474, f. 5, MPB drejtuar MD, 2 nëntor 1935.; AQSH, F. 152 "MPB", V. 1935, D. 474, f. 6, MD drejtuar MPB, 7 nëntor 1935.
[1508] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 101, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 9 qershor 1936.
[1509] AQSH, F. 155 "MD", V. 1936, D. VIII-341, MPB drejtuar MPD, 10 qershor 1936.
[1510] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 106, Prefektura Korçë drejtuar MPB, pa datë.
[1511] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 315, f. 21, MPB drejtuar Nënprefekturës së Bregut të Detit.
[1512] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 315, f. 32, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 26 gusht 1936.
[1513] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 315, f. 34, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 27 gusht 1936.
[1514] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 37, MPB drejtuar Prefekturës Gjirokastër, 28 gusht 1936.
[1515] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 40, MPB drejtuar Prefekturës Gjirokastër, 29 shtator 1936.
[1516] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 315, f. 41, Prefektura Gjirokastër drejtuar MPB, 1 tetor 1936.

kongresi ishte i panevojshëm dhe kundër dobisë kombëtare, pas dorëheqjes së ish-kryepiskopit.[1517] Hirësia kërkonte që mbledhja të shtyhej në një kohë të dytë, pas plotësimit të Sinodhit të Shenjtë.[1518] Ruajtja e gjendjes kishtare i kishte çelur rrugë njohjes së Autoqefalisë...

5.4.Njohja e Autoqefalisë

Zhvillimet e brendshme nuk ishin të pandikuara nga ndodhitë e jashtme. Dorëheqja e Visarionit ishte përligjur me "kryengritjen" e drejtuar nga Hirësitë Kristofori dhe Agathangjeli. Mirëpo, ajo shëmbëllente një periudhë të re marrëdhëniesh shqiptaro-greke, të nisur prej vitit 1933. Fuqitë kundërvenizeliste kishin fituar pushtetin, duke drejtuar qeveri të njëpasnjëshme me në krye Panagis Caldharis, Kondilis dhe Ioanis Metaksas. Çështja kishtare nuk ishte e vetmja mes dy vendeve. Kokëçarja kryesore kishte të bënte me pakicat përkatëse. Grekët në Shqipëri përqendroheshin në Pogon, Dropull dhe Vurg. Ndërkaq, një popullsi domethënëse shqiptare jetonte në Greqi. Shqiptarët kishin një prani të hershme në Greqinë Qendrore, me popullsitë arbërore. Po ashtu, ata përbënin shumicën në trevën e Çamërisë, nga Preveza në kufirin shqiptaro-grek. Zyrtarët vendorë grekë njoftonin për 86 fshatra greqishtfolëse, 49 shqipfolëse ortodokse, 35 shqiptare myslimane dhe 20 të përziera në mbarë Çamërinë.[1519] Pala shqiptare vlerësonte se vetëm 30 fshatra ishin greke, ndërsa të tjerat shqiptare, myslimane ose ortodokse. Të drejtat e tyre u shuan pas rënies së Pangalosit nga pushteti. Zyrtarët vendorë grekë shënonin se shqiptarët e Çamërisë kërkonin vetëm afrimin shpirtëror me Shqipërinë dhe ruajtjen e gjuhës dhe ndërgjegjes kombëtare. Mirëpo, edhe kjo kërkesë vlerësohej e zmadhuar.[1520]

Shqipëria u përpoq disa herë të trajtonte çështjen e të drejtave shkollore të shqiptarëve të Çamërisë, pas shpalljes Mbretëri. Mirëpo, Greqia shmangej vazhdimisht. Tirana vlerësonte në vitet `30 se përafrimi shqiptaro-grek ishte i mundur me tri kushte. Së pari, kërkonte të drejta të ndërsjella për shqiptarët e Greqisë me ato të grekëve të Shqipërisë. Së dyti, kërkohej dëmshpërblimi i drejtë i pronave të shqiptarëve, që Greqia kishte shpronësuar pak vite më parë. Së treti, ishte çështja e autoqefalisë së Kishës Shqiptare. Mirëpo, ajo ishte tashmë pjesë e pandashme e një dosjeje më të gjerë diplomatike, të cilat duheshin trajtuar në tërësi. Kundërvenizelistët nisën të shihnin një rrugëzgjidhje të vetme: përafrimin e tretë shqiptaro-grek, që do të kulmonte mes vitit 1934 deri në vitin 1937. Trazirat e brendshme politike ishin tejkaluar në Shqipëri pas vitit 1932. Pandeli Evangjeli fuqizoi qeverinë më jetëgjatë të deriatëhershme shqiptare. Ndërkaq, viti 1934 do të shënonte trazirën e fundit qeveritare në Greqi. Rrethanat çuan në fuqizimin e kundërvenizelistëve, çka solli diktaturën e Ioanis Metaksas prej gushtit 1936.[1521]

[1517] AQSH, F. 152 "MPB", V. 1936, D. 317, f. 110, Prefektura Korçë drejtuar MPB, 29 tetor 1936.
[1518] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 130, f. 1, Qarkore, 24 dhjetor 1936.
[1519] Kondis, *Elinizmos IV*, 147: IDAYE, V. 1935, D. A/4/9, nr. 55, Nënprefekti i Thiamidhos drejtuar Zyrës Politike të Kryeministrit, 16 prill 1932.
[1520] Kondis, *Elinizmos IV*, 147: IDAYE, V. 1935, D. A/4/9/I, nr. 9365, Komanda e Xhandarmërisë drejtuar MPJG, 10 tetor 1933.
[1521] Alkis Rigos, *Η Β΄ Ελληνική Δημοκρατία 1924-1935. [Republika e Dytë Greke 1924-1935]*, (Athinë: Themelio, 1988), 223-251.

Vendet nisën të përafroheshin prej vitit 1933. Marrëveshja tregtare përbënte pararojën e fuqizimit të marrëdhënieve dypalëshe. Greqia miratoi një plan dëmshpërblimi për pronarët shqiptarë të tokave, pak muaj më vonë. Vetëm çështjet e pakicave dhe të Kishës mbetën të hapura fundvitin 1934. Shqipëria i kishte kryer "detyrat e shtëpisë" në çështjen e pakicave. Përpjekja e fundit për të kufizuar keqpërdorimin nga jashtë ishte në vitin 1934, kur vendosi mbylljen e shkollave private, përfshi edhe ato të pakicës. Mirëpo, Gjykata Ndërkombëtare e Hagës e hodhi poshtë ligjin një vit më vonë, si të papajtueshëm me Shpalljen për Mbrojtjen e Pakicave të dorëzuara në Lidhjen e Kombeve në vitin 1921. Kështu, lëshime mbi pakicat priteshin vetëm nga Greqia. Athina pranoi më 1935 të lejonte mësimin e shqipes në shkollat e myslimanëve të Çamërisë, por jo dhe në fshatrat ortodokse shqiptare.[1522]

Në këto rrethana, zgjidhja e çështjes kishtare ishte veprimi i fundit që do të mbyllte përafrimin e tretë shqiptaro-grek. Ajo shihej si çështje denjësie: nënkuptonte gjithëpranimin e autoqefalisë për shqiptarët dhe një humbje pa përulje për grekët. Visarion Xhuvani nuk linte pikëpyetje, duke theksuar se lehtësimi i zgjidhjes se çështjes kishtare ishte arsye kryesore e dorëheqjes.

Një ndër tre ndikuesit kyçë politikë të lëvizjes kishtare shqiptare ishte Koço Kota. Ai rridhte nga një familje e njohur korçare: pasardhës i Vangjel Kotës, që për vite me radhë shërbeu si anëtar i Pleqësisë Kishtare të qytetit e u shqua me veprimtarinë atdhetare. Po ashtu, edhe vëllezërit e Koços, Sotir dhe Kristo Kota, shërbyen si anëtarë të pleqësive kishtare në Korçë. Kryengritësi i vitit 1929 iu drejtua zgjidhjes diplomatike, në prag të përafrimit të tretë shqiptaro-grek. Kota shkoi në Athinë në vitin 1935, si Kryetar i Kuvendit. Ai u takua me Kryeministrin Ioanis Metaksas, ministrin e Jashtëm Mavrudhis dhe Hirësi Krisanthosin. Kota kërkoi njohjen pa kushte të autoqefalisë dhe thirri murgun Evlogji Kurilla, të cilit i la të kuptonte se do ta mbështeste për Kryepiskop.[1523]

Nisja e bisedimeve zyrtare do të vinte pas nëntorit 1936, kur Koço Kota u emërua sërish Kryeministër i Shqipërisë. Kota renditi zgjidhjen e çështjes kishtare si synim kyç të qeverisë. Ai takoi ambasadorin grek në Tiranë, Skeferis, dhe përsëriti këmbënguljen shqiptare për dorëzimin e Tomosit, pa asnjë kusht shtesë. Kryeministri i kërkoi legatës shqiptare në Athinë më 28 dhjetor 1936 të bisedonte me kryediplomatin grek Mavrudhis për nisjen e një dërgate kishtare.[1524]

Mavrudhis nuk e mohoi se Patriarkana Ekumenike këshillohej me qeverinë greke për disa çështje, mirëpo tëhuajti përshtypjen se çdo gjë kalonte nëpërmjet Ministrisë së Jashtme të Greqisë. Mavrudhis u përgjigj se nuk kishte asnjë kundërshtim dhe dëshironte që çështja të zgjidhej për të vëllazëruar dy popujt fqinj. Diplomatët shqiptarë takuan edhe Hirësi Krisanthosin. Ai u tregua i gatshëm, duke kërkuar që dërgata të nisej për të mbyllur çështjen pas Ditës së Ujit të Bekuar.[1525] Qeveria shqiptare lajmëroi Hirësi Kristoforin dhe vendosi që dërgata të qëndronte në Athinë e të nënshkruante marrëveshjen me Krisanthosin. Zëvendësisht Kryepiskop Kristofori lajmëroi shtypin më

[1522] Puto, *Shqipëria politike*, 350-450.
[1523] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 1, MPJ drejtuar Ambasadës së Athinës, 28 dhjetor 1936.; AMPJ, F. 141 "Mitropolia Korçë", V. 1937, D. 581, f. 2, Evlogji drejtuar Kotës, 14 shtator 1937.
[1524] AMPJ, MPJ drejtuar Ambasadës së Athinës, 28 dhjetor 1936, cit.
[1525] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 2, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 2 janar 1937.

19 shkurt 1937 se do të shkonte në Stamboll së bashku me ish-ministrin e Drejtësisë, Josif Kedhin, për të zgjedhur dy anëtarët e tjerë të Sinodhit.[1526]

Dërgata dyanëtarëshe mbërriti në Athinë më 6 mars dhe nisi bisedimet me Hirësi Krisanthosin.[1527] Kryeprifti grek i pranoi të gjitha kushtet shqiptare. Marrëveshja përfundimtare u arrit më 18 mars 1937, e ndarë në shtatë pika. Ajo caktonte fillimisht se Kisha Ortodokse e Shqipërisë përbëhej nga katër qarqe kishtare: 1. Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, 2. Korçës, 3. Gjirokastrës, 4. Beratit, Vlorës dhe Kaninës. Pika e dytë përcaktonte se kryeprifti që do të qëndronte në Tiranë do të quhej Mitropolit i Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit dhe Kryepiskop i Gjithë Shqipërisë, ndërsa tre kryepriftërinjtë e tjerë do të quheshin episkopë të qytetit ku ishte qendra e qarkut kishtar. Kjo pikë dukej e parëndësishme, por në të vërtetë rrëfente pranimin nga Patriarkana Ekumenike të trupëzimit kishtar të vitit 1929, kur qarqet ishin ulur në episkopata dhe vetëm ajo e Tiranës kishte mbetur Mitropoli. Pika e tretë emëronte Kristofor Kisin Mitropolit të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit dhe Kryepiskop i Gjithë Shqipërisë, Evlogji Kurillën Episkop të Korçës dhe Pandeli Kotokon Episkop të Gjirokastrës. Hirësi Agathangjel Çamçja duhet të dorëzonte dhe t'i pranohej falja nga Patriarkana Ekumenike, duke hequr rrjedhimisht dënimin kishtar e më pas do të njihej si Episkop i Beratit.[1528]

Pika e katërt ishte e vetmja për të cilën biseduan palët. Krisanthos kishte kundërshtuar pjesëmarrjen e Atë Vasil Markos si anëtar i Sinodhit të Shenjtë.[1529] Mirëpo, Kryeministri Kota nuk u tërhoq. Ai këmbënguli që marrëveshja të shënonte se Sinodhi duhet të ngrihej sipas rregullave kishtare e të mos shtjellohej përbërja. Kota përligjte se kjo nevojitej për të mos dhënë përshtypjen se largimi i Atë Vasilit ishte detyruar nga jashtë. Ndaj, ujdia përcaktoi se Kisha në Shqipëri do të drejtohej sipas kanoneve të shenjta të Kishës Ortodokse të Shenjtë Lindore. Shteti merrte përsipër të lejonte liri dhe vetëdrejtim të plotë në zhvillimin e fesë dhe jetës kishtare, përfshi shkollat priftërore dhe ngrehinat arsimore fetare, sipas pikës së pestë. Patriarkana Ekumenike dorëhiqej nga dëmshpërblimet mbi manastiret në Shqipëri dhe ia kalonte pasurinë e tyre KOASH-it me anë të pikës së gjashtë. Ndërkaq, pika e fundit vendosi dorëzimin e Tomosit.[1530]

Pala greke nuk arriti të përfshinte asnjë kusht. Greqia u kënaq vetëm me zgjedhjen e Pandeli Kotokos në Sinodh, duke e lënë shumicën në duart e atdhetarëve shqiptarë. Ministri i Jashtëm, Mavrudhis, vlerësoi se marrëveshja përbënte fundin e çështjeve të pazgjidhura dhe arritjen e përafrimit të tretë shqiptaro-grek.[1531] Patriarkana Ekumenike dilte nga një rrugë pa krye me denjësinë e tronditur nga zgjatja e çështjes ndër vite. Ajo u detyrua të pranonte heqjen e të gjitha përcaktimeve, akoma edhe ato që pala shqiptare kishte pranuar në vitin 1926, 1928, 1929 dhe 1930. Shqipëria nuk ishte më e gatshme të lëshonte pe me rrethanat e reja të vitit 1937.

Kryesimi i KOASH-it solli përplasje të brendshme. Koço Kota i qe zotuar murgut athonit Evlogji Kurillës përpara dorëheqjes së Visarionit. Mirëpo, koha rrodhi në dobi të Hirësi Kristoforit. Ai nisi të thirrej "Fortlumturi", sapo u emërua zëvendësisht Kryetar i Sinodhit. "Predikimi" shënonte në korrik 1936 se Kristofori ishte i pari episkop shqiptar

[1526] AQSH, F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës", D. 153, f. 1, Qarkore, 19 shkurt 1937.
[1527] "Komisjoni për rregullimin e çeshtjes kishtare", *Predikimi* nr. 3/viti IV, mars 1937, 8.
[1528] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 4, MPJ drejtuar Ambasadës së Athinës, 6 mars 1937.
[1529] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 6, Kryepiskopi Kristofor drejtuar MPJ, 8 mars 1937.
[1530] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 7, MPJ drejtuar Ambasadës së Athinës, 9 mars 1937.
[1531] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 12, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 5 prill 1937.

që erdhi me vetëdashje në Shqipëri, njohu dhe u bashkua me Kishën Autoqefale.[1532] Kisi përligjej se u zyrtarizua Kryepiskop në mbledhjen e Sinodhit të Shenjtë, më 16 nëntor 1936.[1533] Mirëpo, ky arsyetim i bërë rreth një vit më vonë, nuk duket i vërtetuar në asnjë shkresë tjetër. Përvijimi i ngjarjeve lë të kuptohet se Hirësi Kristofori u zgjodh Kryetar i Kishës në vend të Evlogji Kurillës si shpërblim për qëndrimin e tij në Shqipëri dhe ripërfshirjen në KOASH prej vitit 1933. Kryeministri Kota u detyrua të bindte Kurillën të pranonte të vinte si Episkopi i Korçës. Ai u bëri thirrje ndjenjave atdhetare të Evlogjit, duke e vendosur të betohej mbi kombësinë e tij që të mos kundërshtonte. Kryeministri e la të hapur që kreu i Kishës të zgjidhej pas dhënies së Tomosit. Betimi përpara kombësisë e bëri Evlogji Kurillën të pranonte. Ai i shkruante Kryeministrit pak kohë më vonë se kishte hequr dorë nga kryesia për të mos u bërë shkak për dështim të ri të çështjes kishtare, që përbënte ngadhënjimin më të madh të jetës politike të Kotës.[1534]

Çështja e fundit përpara dhënies së Tomosit ishte falja e kryepriftërinjve shqiptarë. Hirësi Agathangjeli dorëzoi zyrtarisht lutjen, më 10 mars, pa u nënshkruar ende marrëveshja në Athinë. Ai theksonte se veprimet e vitit 1929 synonin shmangien e rrëmujës kishtare dhe mbajtjen e popullin në traditat e Kishës Ortodokse.[1535] Patriarkana e fali, por nuk e njohu si Episkop të Beratit. Agathangjeli u emërua përkohësisht Episkop Titullar i Vlorës, deri në ngritjen e Sinodhit.[1536]

Falja e Atë Vasil Markos ishte e domosdoshme përpara se të jepej Tomosi. Hirësi Kristofori lajmëroi qeverinë më 18 mars se Atë Vasili nuk e kishte dorëzuar ende lutjen. Hirësi Krisanthos i kishte thënë Kisit se pjesëmarrja e Markos në shërbesa fetare duke qenë i rrëzuar do të sillte shfuqizimin e marrëveshjes së nënshkruar.[1537] Qeveria shqiptare veproi menjëherë dhe kërkesa e Atë Vasilit u dërgua me postë ajrore për të mbërritur sa më shpejt në Stamboll, më 20 mars.[1538] Edhe Atë Vasili u përligj se pikësynimi i tij ishte shmangia e rrëmujës kishtare.[1539]

Gjithçka ishte gati për Tomosin. Dërgata shqiptare përbëhej nga katër anëtarë: përfaqësuesi i qeverisë, Josif Kedhi, dhe të zgjedhurit për Sinodh, Hirësi Kristofori, Evlogji Kurilla e Pandeli Kotoko. Ajo mbërriti në Stamboll më 28 mars, e pritur nga Kryekonsulli i Shqipërisë, mërgata dhe përfaqësues të Patriarkanës.[1540] Dërgata dhe dy mitropolitë të Kishës së Madhe zhvilluan të nesërmen bisedimet zyrtare. Konsulli shqiptar njoftonte se ato ishin në frymë mirësjelljeje dhe përfunduan sipas parashikimit. Ujdia ishte e arritur që në Athinë dhe bisedat e Stambollit ishin sa për emër. Palët nënshkruan marrëveshjen përfundimtare, të hartuar në kryeqytetin grek. Hirësi Kristofori dhe Kryekonsulli shqiptar u pritën nga Patriarku Venaimin, po atë ditë. Tërëshenjtëria shprehu kënaqësinë për zgjidhjen e duhur të çështjes, siç i kishte hije shtetit të pavarur, të drejtuar nga një sovran me cilësi të rralla. Ai u lut për shtetin, Mbretin dhe kombin fisnik

[1532] "Emzot Kristofori", *Predikimi* nr. 69, 1 korrik 1936, 1.
[1533] AQSH, F. 155 "MD", V. 1937, D. VIII-367, f. 2, Kryepiskopi Kristofor drejtuar Sinodhit, 26 maj 1937.
[1534] AMPJ, Mitropolit Evlogji drejtuar Kryeministrit Kota, 14 shtator 1937, cit.
[1535] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 81.
[1536] Glavina, *Kisha Ortodokse*, 56.
[1537] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 8, Kryepiskopi Kristofor drejtuar MPJ, 18 mars 1937.
[1538] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 9, MPJ drejtuar Ambasadës së Athinës, 20 mars 1937.
[1539] Tasudhis, *Kujtime biografike*, 82.
[1540] Glavina, *Kisha Ortodokse*, 59.

shqiptar. Kryekonsulli shqiptar theksoi se emri i Veniaminit do të mbetej i paharruar në historinë fetare shqiptare.[1541]

Sinodhi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike vendosi të nesërmen ndryshimin e qarqeve kishtare shqiptare.[1542] Vendimi i parë ishte "Akti i Mitropolisë së Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit". Ai arsyetonte se Mitropolia që kishte nën varësi kryeqytetin shqiptar do të riemërtohej. Kështu "Mitropolia e Durrësit" u shndërrua në "Mitropoli të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit" dhe drejtuesi i saj do të thirrej "Mitropolit i Hirshëm". Vendimi i dytë ishte "Akti i riemërtimit të Mitropolisë së Korçës në Episkopatën e Korçës". Shndërrimi u përligj me krijimin e një Kishe Autoqefale në Shqipëri. Edhe vendimi i tretë u mor me të njëjtin arsyetim: "Akti i riemërtimit të Mitropolisë së Velegradit në Episkopatën e Beratit, Vlorës dhe Kaninës". Vendimi i katërt dhe i fundit ishte krijimi i Episkopatës së Gjirokastrës. Ky qark u krijua nga e para, pasi hapësira e ish-mitropolisë së Drinupojës brenda Shqipërisë kishte varësi të paqartë, që kur Patriarkana kishte krijuar një Mitropoli të Drinupojës në hapësirën e Mitropolisë së vjetër të mbetur në Greqi.[1543]

Qarqet kishtare u vendosën nën drejtim të drejtpërdrejtë të Patriarkut, derisa të themelohej Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë. Tomosi do të vononte pak ditë për të dorëzuar episkopë Kurillën dhe Kotokon. Ata u bënë dhjakë më 2 prill. Patriarkana i zgjodhi kryepriftërinj të nesërmen, Kurillën si Episkop i Korçës dhe Kotokon si Episkop i Gjirokastrës, me emrin priftëror Pandelejmon. Dy dhjakët u ngritën në shkallën e priftit e Arkimandritit më datë 4 dhe morën denjësinë episkopale më 11 prill 1937.[1544]

Evlogji Kurilla u bë episkop i pari. Ai mbajti dy fjalime në gjuhën shqipe pas shërbesës, duke u lutur në veçanti për lumturinë e kombit shqiptar dhe përparimin e Lartmadhërisë së Tij Mbretit të Shqiptarëve. Kryekonsulli Asaf Xhaxhuli shënonte se Hirësi Evlogji shquhej me kulturën e lartë dhe fliste një shqipe të rrjedhshme e rrëfente plot atdhedashuri, pavarësisht pse nuk jetonte në Shqipëri.[1545]

Hirësi Evlogji nuk përbënte habi. Ai kishte theksuar kurdoherë synimet kombëtare shqiptare që përpara pavarësisë e deri në ditën kur u dorëzua episkop. Mirëpo, e papritura erdhi kur Hirësi Pandelejmoni mbajti një fjalim po aq të zjarrtë. Ai njihej për gojëtari me prirje kombëtare, mirëpo greke e jo shqiptare. Ai ishte shquar në këtë fushë që në kohën e pushtimit grek të Korçës. Ndaj, fjalimi me ngjyrime shqiptaromadhe i kapi në befasi të pranishmit. Kotoko bekoi nxehtësisht Mbretin dhe thirri mërgatën shqiptare në Stamboll të kujdesej për detyrat kombëtare. Udhëzimet e Pandelejmonit shkuan në skaj. Ai tha se kishte atdhetarë shqiptarë mes të pranishmëve, që gratë i kishin të kombësive të tjera e që nuk e flisnin shqipen. Ai e quajti të papranueshme, ndaj i kështilloi të mos i përsërisnin gabimet dhe t'u mësonin grave e fëmijëve gjuhën e dashur amtare shqipe.[1546]

[1541] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 19-25, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 16 prill 1937.

[1542] Sinodhi përbëhej nga Patriarku dhe 11 mitropolitë. Ndër anëtarët ishte edhe ish-mitropoliti i Korçës, gjatë periudhës së pushtimit grek deri në vitin 1914, tashmë Mitropolit i Sardës, Gjermanos Anastasiadhis. Të tjerët ishin Maksimi i Halikdhonës, Joakimi i Derkonit, Polikarpi i Prusës, Thomai i Pringiponisonit, Gjenadhi i Iliupolit dhe Thiron, Lenodios i Theodhorupoleos, Konstandini i Irinupoleos, Meleti i Hristupoleos, Dhorotheu i Laodhiqias dhe Gjermanos i Eniut. Glavina, *Kisha Ortodokse*, 59

[1543] Të gjitha aktet e plota botohen në Glavina, *Kisha Ortodokse*, 60-62.

[1544] AMPJ, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 16 prill 1937, cit.

[1545] Po aty.

[1546] Po aty.

Dorëzimet i hapën rrugën vendimit të madh. Sinodhi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike u mblodh më 12 prill 1937, për të miratuar njëzëri fundin e betejës kishtare shqiptare: "Tomosin Patriarkal dhe Sinodhik mbi Bekimin e Autoqefalisë së Kishës Orthodhokse në Shqipëri". Tomosi shënonte dhembshurinë, përkujdesjen dhe gatishmërinë e Patriarkanës për plotësimin e nevojave të shpresëtarëve në Shqipëri. Sinodhi pranoi kërkesën e ortodoksëve shqiptarë, nisur nga siguria e dhënë nga shteti për liri të plotë të Kishës në Shqipëri. Tomosi vendoste se të gjitha qarqet dhe bashkësitë ortodokse që përfshiheshin në shtetin e Perëndishpëtuar Shqiptar, do të krijonin "Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë", të pavarur dhe autoqefale. Kisha do të drejtohej nga Sinodhi i Shenjtë, i përbërë nga Kryepirftërinjtë ortodoksë të vendit, me kryetar Kryepiskopin e Tiranës dhe Gjithë Shqipërisë. Kryepiskopi njoftonte të gjitha kishat ortodokse motra për zgjedhjen dhe hipjen në fron, me anë të letrave fronëzuese. Ai duhet të përmendte të gjithë drejtuesit e kishave të tjera në diptik dhe do të kujdesej për ruajtjen e padevijueshmërisë së besimit. KOASH-i merrte Miron e Shenjtë prej Patriarkanës Ekumenike dhe do t'i drejtohej asaj për çdo paqartësi të një natyre të përgjithshme kishtare.[1547]

Shpallja e Tomosit u krye me praninë e të ftuarve. Kryekonsulli i Shqipërisë u ul në krah të Patriarkut. Ndërsa, 11 mitropolitët e Sinodhit të Shenjtë patën në krah kryepriftërinjtë shqiptarë, ortodoksët e mërgatës së Stambollit etj.[1548] Tomosi u lexua nga Kryesekretari i Sinodhit, Arkimandriti Qirili, dhe u nënshkrua nga Patriarku dhe 11 mitropolitët. Patriarku u lut që Zoti të mbështeste Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të fuqizonte besimtarët e saj.[1549] Po ashtu, u lut për Mbretin e Shqiptarëve, Zogun I, dhe mbarë kombin.[1550] Në fund, Tërëshenjtëria e Tij Veniamini i dorëzoi Tomosin Kryepiskopit Kristofor. Kisi e falënderoi dhe i shprehu mirënjohjen e tij dhe mbarë popullit ortodoks shqiptar, duke e siguruar për dashuri, nder dhe besnikëri. Ai puthi dorën e djathtë të Patriarkut. Veniamini ia ktheu me puthje vëllazërore, sikurse shkëmbeu edhe me dy kryepriftërinjtë e tjerë, Hirësi Evlogjin dhe Hirësi Pandelejmonin.[1551] Hirësi Kristofori dhe Konsullata Shqiptare shtruan një drekë falënderimi të veçantë, në nder të drejtuesve të Patriarkanës.[1552]

Sinodhi i Shenjtë dërgoi një letër patriarkale për të gjithë ortodoksët shqiptarë të mbishkruar "Letër lajmërimi për popullin ortodoks të Shqipërisë". Ajo njoftonte lajmin e mirë dhe bënte thirrje për bindje dhe nënshtrim ndaj Sinodhit të Shenjtë të KOASH-it. Një letër sqaruese iu dërgua edhe ministrit të Drejtësisë, Thoma Orollogait.[1553] Patriarku Veniamin shkëmbeu falënderime me Mbretin Zogu dhe Kryeministrin Kota. Ai e përgëzoi nxehtësisht Mbretin dhe i parashtroi falënderimet e Kishës Mëmë për sigurinë

[1547] Tomosi Patriarkal dhe Sinodhik nuk e quan Kryepiskopin e Shqipërisë "Fortlumturia e Tij" (Makariotatos në greqisht), siç quheshin të gjithë prijësit e tjerë të kishave, por "Hirësia e Tij" (Sevasmiotatos në greqisht), një thirrje që përdorej për episkopët. Po ashtu, kryeqyteti shqiptar Tirana shënohet "Τυραννων", në shqiptim të njëjtë me fjalën tiran, dhe jo "Τιραννων", siç ishte shkruar në aktin sinodhik të përpara 12 ditëve, mbi krijimin e Mitropolisë së Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Sidoqoftë, ne nuk jemi në gjendje të themi nëse kemi të bëjmë me diçka të qëllimshme apo lajthime të çastit.
[1548] AMPJ, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 16 prill 1937, cit. dhe Glavina, *Kisha Ortodokse*, 67.
[1549] Glavina, *Kisha Ortodokse*, 67.
[1550] AMPJ, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 16 prill 1937, cit.
[1551] Glavina, *Kisha Ortodokse*, 67.
[1552] AMPJ, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 16 prill 1937, cit.
[1553] Letrat e plota botohen në Glavina, *Kisha Ortodokse*, 68-70.

që kishte dhënë në zhvillimin e jetës kishtare. Zogu u përgjigj i prekur thellësisht nga ndjenjat e përzemërta, e falënderoi dhe e uroi për mbarëvajtjen e Patriarkanës Ekumenike.[1554] Patriarku përgëzoi edhe drejtuesin politik të lëvizjes kishtare shqiptare, Koço Kotën, duke u lutur për mbarë kombin fisnik shqiptar. Kota iu përgjigj me ngazëllim se shqiptarët e prisnin pa durim këtë çast. Kryeministri shprehu bindjen se kjo ngjarje do të shënonte një kohë të re miqësie e përparimi në marrëdhëniet shpirtërore mes KOASH-it dhe Kishës Mëmë.[1555]

Zgjidhja e çështjes ndiqej me vëmendje nga ish-kryepiskopi Visarion. Ai ishte dorëhequr për t'i çelur rrugën marrëveshjes, mirëpo kundërshtoi ashpër kur mësoi kushtet e saj. Visarioni i dërgoi qeverisë shqiptare një përkujtesë shumëfaqëshe, ku tëhuante dy çështje: dorëzimin në Stamboll të episkopëve dhe faljen e drejtuesve të deriatëhershëm të Sinodhit të Shenjtë të KOASH-it. Visarioni frikësohej se do të rikthehej ndikimi i huaj dhe se marrëveshja do të dukej si tërheqje e palës shqiptare. Një pasqyrë e tillë mund të përdorej nga dashakeqësit për të thënë se ortodoksët po shtypeshin prej vitit 1929 dhe se rendi kishtar ishte shtrënguar nga lart. Ajo do të hapte rrugën për dredhi të mëvonshme me qëllim, teksa Visarioni fajësonte dredhitë e Kristoforit për dorëheqjen e tij.[1556]

Ish-kryepiskopi parashihte krijimin e padrejtë të bindjes ndërkombëtare se fuqia fanariote në Shqipëri ishte e pathyer. Dorëzimi i dy episkopëve jashtë vendit ishte i panevojshëm, teksa ishin katër kryepriftërinj që mund t'i dorëzonin në Shqipëri: Kristofori, Agathangjeli, Eugjeni dhe Visarioni, ndërkohë që një tjetër ishte jashtë vendit, Theofan Noli. Kjo mund të sillte përçarje fetare, ku disa do të mendonin se myslimanët vijonin të kishin dashuri ndaj Kalifatit turk dhe ortodoksët ndaj Patriarkut grek. Po ashtu, ai shënonte se shteti shqiptar turpërohej duke njohur mallkimet e Patriarkanës ndaj episkopëve atdhetarë, ndërkohë që pranonte për episkopë njerëz që kishin 17 vjet që rrinin pa punë, pa asnjë mjet jetese e që kalonin jetën më së shumti në Greqi. Visarioni shënonte se nuk ishte e drejtë që Kisha ose Shteti Shqiptar të kërkonte të bisedonte për dënime fetare nga jashtë, mbi çështje që i quante të drejta deri dje.[1557]

Ish-kryepiskopi këmbëngulte se nuk duhej bërë asnjë lëshim ndaj pakicave. Ai arsyetonte se të gjitha kishat e Ballkanit, përfshi ajo e Greqisë, kishin pakica, por asnjë e drejtë shtesë nuk u ishte dhënë. Visarioni kërkonte të pritej, teksa kishave të tjera u ishte nevojitur nga 16 në 65 vjet për arritjen e njohjes së autoqefalisë. Visarioni kujtonte se prania e episkopëve që nuk njihnin gjendjen e nuk vepronin për kombin nuk ishte në dobi të vendit, duke përmendur episkopët e së kaluarës që kishin bërë politikën e "Vorio-Epirit". Ai shprehej se ishin dy episkopë shqiptarë: ai dhe Noli, apo edhe tre të tjerë të

[1554] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 45, Korrespondenca e Patriarkut Ekumenik dhe Mbretin Zog, 12 prill 1937.
[1555] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 38, Korrespondenca e Patriarkut Ekumenik dhe Kryeministrit Kota, 12 dhe 14 prill 1937.
[1556] AQSH, F. 536 "KOASH", D. 1435, f. 1-18, Referat i Ish Kryepiskopit Visarion, 18 janar 1937.
[1557] Po aty. Edhe Hirësi Joakimi kishte kundërshti ndaj të zgjedhurve për episkop. Madje, kjo do ta sillte në përplasje me ish-deputetin e Gjirokastrës, Mihal Kaso, pak kohë më vonë, më 20 gusht 1938. Dy burrat u gjendën rastësisht në Legatën Shqiptare në Athinë, ku kishin shkuar për kafe si shpeshherë. Hirësi Joakimi ishte orvatur të hidhte baltë mbi dy episkopët e rinj. Mirëpo Kaso e qortoi përse nuk kishte pranuar të vinte në Atdhe për t'i shërbyer Kishës Autoqefale. Ministri shqiptar u përpoq t'i zbuste që të mos zemëroheshin për ndodhi të së shkuarës, mirëpo Hirësi Joakimi u ngrit, sapo piu kafen, duke i thënë Kasos: "E tregove veten tënde që je gjirokastrit dhe kam faj unë që bisedoj me ty", dhe iku nga takimi. Ai telefonoi ministrin shqiptar pas pak, duke i kërkuar ndjesë dhe duke i thënë se nëse nuk do të ishte në legatën e atdheut të tij dhe nëse Kaso nuk do të ishte i moshuar "do t'i kisha dhënë një dackë që ta mbante mend për gjith jetën..." (AMPJ, V. 1938, D. 217, f. 2, Ambasada e Athinës drejtuar MPJ, 20 gusht 1938).

gatshëm prej Kavaje, Gjirokastre dhe Shkodre që kishin përfunduar studimet teologjike për të zënë këto vende. Visarioni theksonte se katër emrat e rinj ishin nga e njëjta trevë, duke folur për krijimin e një klike që dëshironte të udhëhiqte kishën. Ish-kryepiskopi frikësohej se ortodoksët në Shqipëri mund të vendoseshin nën luftën e ndikimit të dy fuqive të huaja: Greqisë dhe Italisë. Visarioni përfundonte përkujtesën, duke kërkuar të mos vijohej me planin e parashikuar.[1558]

Qeveria këmbënguli në çështjen e pakicave dhe në kërkesën që lutjet e faljes së ish-kryepriftërinjve të mos kishin gjuhë të ashpër. Mirëpo, dy pikat kryesore të kundërshtisë: dorëzimi i episkopëve në Stamboll dhe moskërkesa e faljes nuk u morën parasysh. Qeveria shqiptare i kërkoi zyrtarisht Visarionit të dorëzonte kërkesën e faljes, pas përfundimit të çështjes së autoqefalisë.[1559]

Hirësi Visarioni i dërgoi Mitropolitit të Trapezundës, Krisanthos, një letër më 17 prill 1937, me anë të së cilës i kërkonte të ndërhynte pranë Patriarkanës për heqjen e dënimit. Letra shoqërohej nga kërkesa zyrtare drejtuar Patriarkut.[1560] Ish-kryepiskopi i shkruante Krisanthosit se ishte lajmëruar jozyrtarisht për dënimin e tij, vetëm ato ditë. Ai siguronte se nuk do të merrte asnjë detyrë zyrtare kishtare në të ardhmen dhe kërkonte ndërmjetësimin për të marrë sërish bekimin dhe dashurinë patriarkale. Visarioni e lajmëronte Patriarkun Ekumenik se krijimi i Sinodhit të Shenjtë në vitin 1929 ishte një detyrë e shenjtë. Ai shprehej se kishte punuar në shërbim të besimit të shenjtë ortodoks dhe dobisë së Atdheut të tij, si edhe për dobinë e të gjithë ortodoksëve në Shqipëri. Visarioni kërkonte heqjen e dënimeve dhe marrjen e bekimit për denjësinë episkopale.[1561]

Patriarkana shqyrtoi letrën dhe vendosi heqjen e dënimit. Po ashtu, u njoh "dorëzimi i tij kundërkanonik në kryeprift" nisur nga nevoja kishtare. Lajmi iu dërgua Kryepiskopit Kristofor, më 18 maj. Patriarku Veniamin ia la në dorë KOASH-it të caktonte emërtimin e Kryepriftit Visarion, me përjashtim "ish-kryepiskop i Shqipërisë". Njëherazi, bënte të ditur zotimin e Visarionit se nuk do të kërkonte detyrë zyrtare në të ardhmen. Megjithatë, nuk theksonte se kjo qe ndaluar nga Patriarkana, porse thjesht i bënte të ditur pjesën e letrës së Hirësisë.[1562]

Visarioni do të lihej në hije nga Sinodhi i ri. Ai u përpoq të rishfaqej, duke marrë pjesë në takimin e radhës së "Aleancës Botërore të Miqësisë Ndërkombëtare nëpërmjet Kishave" në Oksford, në korrik 1937. Mirëpo, Hirësi Kristofori rendi ta ndalonte. Visarioni kishte përfaqësuar Shqipërinë në mbledhjen e vitit të mëparshëm si ish-kryepiskop, në marrëveshje me qeverinë shqiptare.[1563] Aleanca e pranoi njëzëri asokohe dhe e ftoi për në mbledhjen e Oksfordit.[1564] Prandaj, ai nuk e kishte parë të udhës të kërkonte leje. Hirësi Kristofori i dërgoi një letër Mitropolitit të Thiatironit, Gjermanosit, më 13 korrik, me anë të së cilës lajmëronte se Hirësi Evlogji do të ishte përfaqësues i Shqipërisë. Kryepiskopi e njihte Visarionin si ish-kryetar i Sinodhit të KOASH-it, por

[1558] Po aty. Kurilla, Kotoko dhe Agathangjeli ishin të tre nga Korça, ndërsa Kisi kishte punuar disa vjet në Korçë, si mësues i shkollës greke e më vonë si episkop.
[1559] AMPJ, V. 1937, D. 307, f. 15, MD drejtuar MPJ, 20 prill 1937.
[1560] Glavinas, *Kisha Ortodokse,* 97. Krisanthos e mori letrën më 28 prill nga ambasadori Rauf Fico (AMPJ, MD drejtuar MPJ, 20 prill 1937, cit.).
[1561] Letrat e plota botohen në Glavinas, *Kisha Ortodokse,* 97-101.
[1562] Po aty.
[1563] AMPJ, V. 1936, D. 306, f. 1, Ish Kryepiskopi Visarion drejtuar MPJ, 11 gusht 1936.
[1564] AMPJ, V. 1936, D. 306, f. 4, Raport i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (korrespondent ish-kryepiskopi Visarion), 26 gusht 1936.

shënonte se ai nuk mund të quhej ish-kryepiskop, për shkak të kërkesës së Patriarkanës.[1565]

Hirësi Visarioni mori pjesë në takimin e parë si i ftuar i veçantë pa përfaqësuar Kishën Shqiptare. Ndërkaq, ai nuk u pranua të ishte pjesë e mbledhjes së dytë që mbahej në gusht.[1566] Mbreti Zogu I e urdhëroi të tejkalonte përplasjen me Patriarkun dhe për këtë qëllim, Visarioni u nis nga Oksfordi për në Stamboll.[1567] Ai mori pjesë në varrimin e ish-patriarkut serb në Beograd, ku u prit me nderime. Po ashtu, ndaloi në Sofje ku u takua me Sinodhin e Shenjtë dhe u prit nga Mbreti.[1568]

Hirësi Visarioni mbërriti në Stamboll dhe u prit nga Patriarku Veniamin, më 5 gusht 1937.[1569] Ai i tha Tërëshenjtërisë se vendosi ta falënderonte nga afër, në vend që t'i përgjigjej me shkrim letrës së 18 majit. Xhuvani shprehu mirënjohjen e përzemërt për "mbështetjen ndaj meje të paktit kryepriftit Visarion Shqiptarit", duke u shprehur se shihte te Patriarku jo vetëm kryebariun, por edhe qendrën qindravjeçare të greqizmit, ndaj të cilit mbarë njerëzia kishin mirënjohje për qytetarinë dhe atdhetarizmin.[1570] Visarioni u shoqërua për disa orë në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Patriarkanës nga anëtarë të Sinodhit të Shenjtë, pas pritjes nga Patriarku.[1571] Ai nuk harroi t'i dërgonte një letër falënderimi Mitropolitit të Trapezundës, Hirësi Krisanthosit, për ndërhyrjen që kishte bërë. Xhuvani shkruante se fryma qytetëruese bujare e helenizmit i kishin dhënë mundësinë t'i shërbente dobisë së Kishës Ortodokse dhe të shtetit të Atdheut të tij të shtrenjtë, Shqipërisë. Letra përfundonte me besimin e bashkëpunimit vëllazëror mes kombit grek dhe kombit shqiptar, "të cilit Zoti deshi që përultësia jonë të jetë bir i vogël".[1572] Përfaqësuesi i Patriarkut i ktheu vizitën ditën e nesërme. Visarioni u mbajt për drekë nga kryepriftërinjtë e Patriarkanës Ekumenike dy herë dhe iu urua udha e mbarë nga fjetorja ku u nis për në Shqipëri, më 9 gusht 1937.[1573]

Përfundimi i ngërçit të fundit mbi Hirësi Visarionin shenjonte se gjithçka kishte marrë fund: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ishte njohur nga Patriarkana Ekumenike, e përbërë nga kryepriftërinj shqiptarë dhe duke mbajtur Statutin dhe Rregulloren e vitit 1929. KOASH nuk kishte bërë asnjë lëshim mbi shqiptarinë e saj...

[1565] Letra e plotë botohet në Glavinas, *Kisha Ortodokse*, 107-108.
[1566] "Kongreset e Oxford-it dhe të Edinburgut", *Predikimi* nr. 3-4/Viti V, mars-prill 1938, 8-10.
[1567] AQSH, F. 149 "Kryeministria", V. 1937, D. VI-638, f. 1, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 10 gusht 1937.
[1568] Shih edhe AMPJ, V. 1937, D. 313.
[1569] Tasudhis, *Kujtime Biografike*, 85-86; Glavina, *Kisha Ortodokse*, 101-102; Xhuvani, *Vepra*, 186-189.
[1570] Po aty.
[1571] AMPJ, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 10 gusht 1937, cit.
[1572] Tasudhis, *Kujtime Biografike*, 86-87; Glavina, *Kisha Ortodokse*, 102-103.
[1573] AMPJ, Konsullata e Stambollit drejtuar MPJ, 10 gusht 1937, cit.

PËRFUNDIME

Çështja kishtare shqiptare ndoqi ulje-ngritjet e marrëdhënieve shqiptaro-greke. Ajo pësoi shndërrime të mëdha, në varësi të baraspeshave mes dy vendeve. Çështja kishtare lindi së bashku me përpjekjen për krijimin e kombit shqiptar. Përfshirja e ortodoksëve shqiptarë nën Patriarkanën Ekumenike bëri që Kisha të përdorej nga shteti grek për të rritur ndikimin në Shqipëri. Përplasja mes dy rrymave ishte fillimisht e pabarabartë: atdhetarë shqiptarë përballeshin me struktura shtetërore greke, zyrtarë të Patriarkanës Ekumenike, akoma edhe me shtetin otoman. Fundi i Luftës së Parë Botërore do t'i vendoste palët në kushte të njëtrajtshme, me përpjekjen për krijimin dhe fuqizimin e strukturave qeverisëse shqiptare.

Periudha mes viteve 1918 dhe 1921 vendosi përballë orvatjen për shtetformim të shqiptarëve me Greqinë bashkëfituese të Luftës së Parë Botërore dhe një fuqi ushtarake të rëndësishme në Mesdheun Lindor. Rrjedhimisht, çështja kishtare shqiptare qëndroi në vendnumëro, në pritje të vendimeve të Konferencës së Paqes së Parisit, që do të përcaktonte të ardhmen politike ndërmjet dy vendeve. Përqendrimi i Greqisë në zgjerimin tokësor drejt Turqisë bëri që të mos ndërhynte ushtarakisht në Shqipëri. Lëvizja kishtare shqiptare u zhvillua në Shtetet e Bashkuara dhe në zonën e Shqipërisë së Mesme, nga dy arkimandritë atdhetarë, Theofan Noli dhe Visar Xhuvani, përkatësisht. Megjithatë, në *terra irredenta* të Gjirokastrës dhe Korçës, Kisha u vendos në dobinë politike të Greqisë. Ajo u shqiptarizua, vetëm pas përcaktimit përfundimtar të kufijve në vitin 1921.

Shkatërrimi grek i vitit 1922 do të ndryshonte baraspeshat. Humbja ushtarake e luftës me Turqinë dhe shkëmbimi pasues i popullsisë e uli fuqinë e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përcaktimi i datës së shpalljes së autoqefalisë erdhi pikërisht si pasojë e humbjes greke në Azinë e Vogël dhe njohja fillestare nga i dërguari i Patriarkut, Jerotheu, ishte rrjedhojë e dobësisë së Greqisë dhe rrjedhimisht të Patriarkanës. Kahkundërt, kur Greqia ia doli të nënshkruante Marrëveshjen e Lozanës dhe u vendos mbijetesa e Patriarkanës Ekumenike, kjo e fundit nuk pranoi të njihte autoqefalinë e Kishës Shqiptare.

Sidoqoftë, çështja kishtare shqiptare mori zgjidhje të njëanshme, në kohën e dobësisë së shtetit grek dhe diplomacia greke shprehej e gatshme të ndërhynte për njohjen e autoqefalisë, pas venitjes së ndikimit të saj. Autoqefalia do të ishte njohur shumë shpejt, nëse Shqipëria nuk do të kaplohej nga trazirat e brendshme politike që sollën në pushtet dhe në krye të gjashtë muajve hodhën nga pushteti Mitropolitin e Durrësit, Theofan Noli. Rikthimi i Ahmet Zogut, me anë të një marrëveshjeje, që për herë të parë po e botojmë, riktheu baraspeshat në anën e Greqisë. Mirëpo, në më pak se gjashtë muaj, trazirat në Greqi do të kthenin gjendjen në dobi të palës shqiptare, me ardhjen në pushtet të gjeneralit proshqiptar Theodhoros Pangalos.

Tollovia e viteve 1924-1926 do të merrte fund me një zhvillim tjetër ndërkombëtar: Paktet e Tiranës mes Shqipërisë dhe Italisë u bënë pararoja e fuqizimit të pushtetit të Zogut, çka i dha mundësinë ta shndërronte Shqipërinë në Mbretëri dhe të shpallej Mbret. Njëherazi, ato i mundësuan Ahmet Zogut të ishte i pavarur nga politika greke dhe jugosllave dhe të orvatej drejt një zgjidhjeje me dobi vetëm kombëtare. Kështu, baraspesha e re në dobi të Shqipërisë solli zgjidhjen e njëanshme me krijimin e Sinodhit të Shenjtë në vitin 1929.

Shteti shqiptar nuk nuk lëshoi pe dhe në vitet `30 ia doli të arrinte marrëveshje në dobi të saj dhe pa asnjë lëshim shtesë si për çështjen kishtare, edhe për çështjen çame, çështjen e pronave të shqiptarëve në Greqi, të marrëdhënieve tregtare dhe çështjen e nënshtetësisë. Siguria që i jepte mbrojtja italiane në çështjet me fqinjët bëri që çështja kishtare shqiptare të vendosej si pjesë e disa çështjeve me palën greke, ku më kryesorja ishte çështja e pakicës shqiptare në Çamëri. Kjo siguri bëri që Kisha Shqiptare të çrrënjoste çfarëdo ndikimi joshqiptar (grek, serb, vlleh, por akoma edhe unit, pavarësisht nga ndikimi italian) dhe rrjedhimisht u pasua me fuqizim të brendshëm dhe njohje e mirëdashje nga ngrehina të huaja kishtare. Të njëjtën lakore ndoqën edhe çështjet e tjera. Greqia u mjaftua vetëm me emërimin episkop të Pandeli Kotokos dhe arritjen e përafrimit të tretë shqiptaro-grek. Ndërsa Patriarkana veçse sa doli me denjësi nga qorrsokaku ku kishte hyrë, pala shqiptare ngadhënjeu pa lëshime të panevojshme.

Rrethanat ndërkombëtare u përdorën nga të dyja palët për të marrë epërsi ndaj njëra-tjetrës. Shqipëria ia doli të shmangte trysninë greke pas vitit 1927, më së shumti për shkak të sigurisë që kishte pas Pakteve të Tiranës me Italinë. Mirëpo, edhe vende të tjera patën ndikime të tërthorta apo të drejtpërdrejta në çështjen kishtare shqiptare. Kisha Serbe dhe shteti jugosllav ndihmuan shqiptarët të krijonin Sinodhin e Shenjtë në vitin 1929, pasi kishin ndihmuar edhe në dorëzimin episkop të Visar Xhuvanit më 1926. Kjo ndihmesë vinte e mirëllogaritur në kornizën e marrëdhënieve ndërshtetërore në Ballkan. Greqia dhe Jugosllavia kishin përplasje të hershme, sidomos për çështjen e pakicave sllave në Maqedoninë Greke dhe për daljen jugosllave në detin Egje. Ndërhyrja fillestare jugosllave në dobi të çështjes kishtare shqiptare vinte si një levë trysnie ndaj Greqisë. Kahkundërt, Kisha Serbe nuk e njohu Kishën Shqiptare në vitin 1930, pasi Greqia pranoi të nënshkruante marrëveshjen për Skelën e Selanikut dhe pakicën sllave. Shqipëria u kundërpërgjigj me levën e saj të trysnisë, duke dëbuar priftërinjtë sllavë nga Shkodra e Dibra dhe duke shqiptarizuar tërësisht Kishën, në një qasje realpolitike.

Çështja e autoqefalisë së Kishës së Dodekanezit u ndërthur po ashtu në çështjen kishtare shqiptare, si një orvatje e Patriarkanës Ekumenike dhe shtetit grek për të zvarritur të dyja çështjet deri në gjetjen e rrethanave të përshtatshme që do t'i çonin përfundimet në dobi të Greqisë. Po ashtu, Kisha Shqiptare dhe shteti shqiptar lidhën nyje të ngushta me Kishën Bullgare dhe Kishën Rumune, kundërshtare të kahershme të kishave greke. Ndërsa, shteti grek u orvat të trysnonte Shqipërinë me anë të lidhjeve të saj ndërkombëtare.

Këto zhvillime na sjellin edhe në një përfundim tjetër: Politika greke e vlerësonte më shumë sundimin ndaj Kishës Shqiptare, sesa politika shqiptare. Ajo lëshoi pe në çështje të rëndësishme, si qëllimet jugosllave në Maqedoninë Greke apo shprehte gatishmëri të pranonte autoqefalinë e Dodekanezit, vetëm dhe vetëm për të mos lejuar "humbjen" e Kishës Shqiptare. Vështirësitë që haste shteti në vitet e para e detyruan të vinte në përplasje të drejtpërdrejtë me besimtarët vendas: qeveria shqiptare gjykonte si të domosdoshme sigurimin e tërësisë tokësore dhe pavarësisë së plotë në vitet 1920 dhe në fillim të viteve `30. Prandaj, ajo u detyrua të shtypte kërkesat e vazhdueshme për meshim në shqip që vinin nga besimtarët shqiptarë, deri kur u detyrua të zmbrapsej pas një puçi të organizuar nga oficerë ortodoksë të ushtrisë.

Sidoqoftë, sigurimi i kufijve e bëri të mos hezitonte të dëbonte kryepriftin e fundit grek nga Shqipëria dhe prej atij çasti e vlerësoi çështjen kishtare si të brendshme, ashtu sikurse në të vërtetë ishte si në pikëpamjen politike, ashtu edhe në atë fetare ortodokse.

Mirëpo, qeveritarët shqiptarë e vendosën çështjen në biseda dypalëshe, së paku në dy raste, duke i dhënë palës greke të drejtën të shprehte qëndrim në një çështje ku nuk kishte punë. Për më tepër, pala shqiptare rrëfente në takime me diplomatë grekë se çështjet fetare ishin të parëndësishme në qindvjeçarin XX, ndonëse pala greke shprehte haptazi qëllimin e ndikimit të Shqipëri me anë të Kishës Shqiptare, edhe në ato kohë.

Greqia u orvat të përdorte Kishën Ortodokse si mjet trysnie në marrëdhëniet dypalëshe. Përpjekja fillestare greke për përvetësimin e Korçës dhe të Gjirokastrës u bë duke përdorur kryepriftërinjtë grekë. Greqia dërgoi në Korçë Mitropolit Jakovin e Durrësit për të përgatitur pushtimin grek dhe për të minuar përpjekjet shqiptare, duke përdorur maskën fetare. Roli që Mitropolit Jakovi luajti në ideimin, hartimin dhe miratimin e "Protokollit të Kapshticës" dhe në nxitjen nën rrogoz të Përkujtesës së Korçës në vitin 1921 përbëjnë kulmin e ndërhyrjes politike të shtetit grek në atë shqiptar me anë të një kreu kishtar gjatë atyre viteve. Njëherazi, ajo paguante rregullisht zëvendësmitropolitin e Gjirokastrës, Thanas Duka, për të njëjtin qëllim.

Në të gjitha orvatjet greke për mbizotërimin e Kishës Shqiptare ka disa të përbashkëta: ajo përpiqej të vendoste njerëz të besuar në Sinodhin e Shenjtë, duke këmbëngulur vazhdimisht për emra si Pandeli Kotoko, Vasil Joanidhi, Jakovi apo Vasili i Drinupojës. Greqia nuk mundej të kërkonte që kryepriftërinjtë të ishin grekë, pasi atdhetarët ortodoksë shqiptarë që ishin në pushtet, nuk do ta pranonin kurrë pas vitit 1922, prandaj përpiqej të përfshinte shqiptarë grekomanë.

Së dyti, Greqia përdori çdo mjet për të kanosur palën shqiptare në çështjen kishtare. Ndodhia e Kishës së Shën Gjergjit në vitin 1921 u pasua nga moslejimi i shtetasve shqiptarë të kalonin kufirin shqiptaro-grek, mbylljen e kufijve dhe kanosjen me luftë. Greqia u orvat të përdorte diplomacinë në Lidhjen e Kombeve për të sulmuar Shqipërinë, si edhe shtypin grek dhe ato pjesë të shtypit ndërkombëtar ku mundej. Beteja në shtyp ishte e ashpër, sidomos në vitet 1927-1931, por mund të thuhet se edhe pala shqiptare përdori shtypin në dobinë e vet kombëtare. Së fundmi, Greqia kërcënoi haptazi shtete si Jugosllavia që nëse Kisha Serbe do të njihte Kishën Shqiptare, Greqia nuk do të nënshkruante marrëveshjen e rëndësishme për Portin e Selanikut dhe për pakicën sllave në Greqi.

Së treti, Greqia synonte që të çelte sa më shumë shkolla greke nën maskën e Kishës. Fillimisht kjo u bë haptazi në kohën e Jakovit. Pas vitit 1922, ajo kërkonte që Kisha të kishte të drejtën të çelte shkolla ku të mësohej edhe greqishtja. Ky përcaktim u bë pjesë si në Marrëveshjen e fshehtë të Beogradit, në protokollin e vitit 1927 dhe në disa takime të diplomatëve grekë me zyrtarët shqiptarë. Çështja e gjuhës greke dallohej edhe në meshimet dhe predikimet kishtare. Meshat bëheshin vetëm në greqisht, përpara shpalljes së autoqefalisë. Ndërkaq, Jakovi predikonte po ashtu në greqisht, edhe pse ishte njohës shumë i mirë i shqipes. Ai shtirej se nuk mundej të predikonte në shqip, për të mbajtur natyrën greke të Kishës.

Së katërti, Greqia u orvat të krijonte përçarje mes ortodoksëve dhe bashkësive të tjera fetare në vend, me anë të shkollave, me anë të diplomacisë dhe ankesave në Lidhjen e Kombeve, me anë të fushatave kundërshqiptare etj. Dy përpjekjet greke për të ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 1921 dhe 1923 tregojnë se synimi ishte fitorja politike e myslimanëve, me qëllim që të përçahej edhe më shumë popullsia në linja fetare dhe që ortodoksët të hidheshin në krahët e Greqisë.

Të gjitha këto arsye na bëjnë të themi me siguri se shteti grek qëndronte pas pengesës së Patriarkanës Ekumenike për të pranuar autoqefalinë, teksa ajo u bindej verbërisht urdhrave politikë të Athinës. Kjo dallohet edhe në disa veprime të tjera: dërgimi i Jakovit si ekzark në Korçë u krye me urdhër të Kryeministrit grek. Patriarkana nuk pranoi të njihte autoqefalinë në vitin 1923, siç kishte paralajmëruar pak muaj më parë, pas kërkesës së qeverisë greke. Ajo pranoi të njihte autoqefali me kushte proshqiptare në vitin 1926, kur diçka të tillë e kërkoi Pangalos dhe bëri krejt të kundërtën një vit më vonë, kur Venizelos u kthye në pushtet në Greqi. Së fundmi, ajo mallkoi vendimin e njëanshëm të vitit 1929, duke e shpallur Kishën përçarëse dhe kryepriftërinjtë shqiptarë fepërdhosës dhe i fali tërësisht e pranoi autoqefalinë, thuajse pa kushte, në vitin 1937, kur e kërkoi Metaksas.

Ky qëndrim i bindur i Patriarkanës Ekumenike ndaj kërkesave politike të shtetit grek fshihej për ortodoksët shqiptarë. Mitropoliti Jakov na dëshmon se ai e qeveriste Kishën me anë të një pleqësie jopërfaqësuese, duke pasur pak grekomanë rreth vetes (ndërkohë që parashtresat greke, franceze dhe shqiptare tregojnë se grekomanët në Korçë ishin më pak se 30 veta). Ai e qeveriste Mitropolinë, duke përçarë popullsinë e duke lëshuar kushtrimin e rrezikut që kishte ortodoksia nga fetë e tjera dhe nga një shtet mysliman, deri kur u dëbua.

Pra, mund të themi se Greqia dhe kryepriftërinjtë grekë u orvatën të minonin shtetin shqiptar, nëpërmjet vendosjes së kryepriftërinjve që do t'u bindeshin urdhrave të saj dhe do të punonin për krijimin e një kishe gjysmë shqiptare, gjysmë greke, ku do të meshohej në të dyja gjuhët dhe ku do të veprohej në dobinë politike të Greqisë.

Gjithsesi, duhet theksuar se çështja kishtare shqiptare nuk kishte dy palë. Njohja nga ana e Patriarkanës, që mundësohej nëpërmjet Athinës, ishte e nevojshme për të mbyllur çështjet dypalëshe. Mirëpo, kur vjen fjala në zhvillimet e brendshme, shqiptarët ishin të njëzëshëm pro autoqefalisë. Rrymat e popullsisë dhe ajkës politike ortodokse ishin të shumëtrajtshme, nga ndryshimi rrënjësor i Fan Nolit te konservatorizmi i disa shqiptarëve ortodoksë si Vasil Dilo dhe Koço Tasi. Mirëpo, të gjitha rrymat ishin pro autoqefalisë, kundër kryepriftërinjve të huaj, pro përdorimit të shqipes në kishat e mbarë vendit dhe shihnin te Kisha një ngrehinë që do të rriste atdhedashurinë dhe ndërgjegjen kombëtare shqiptare. Grekomanët ishin shumë të pakët, kryesisht nga pakica greke. Kjo pakicë përbënte më pak se 10% të ortodoksëve në Shqipëri, teksa më shumë se 9 në 10 ortodoksë ishin shqiptarë, çka e bënte Kishën Shqiptare më homogjenen kombëtarisht, kundrejt pakicave në kishat e tjera (shqiptarët çamë ortodoksë e arbërorë, vllehët, sllavët dhe turqishtfolësit ortodoksë në Greqi, bullgarishtfolësit e Maqedonisë në Serbi, rumunët e Bullgarisë dhe bullgarët e Rumanisë etj.)

Vlen të theksohet se pas vitit 1927, shumica dërrmuese e pakicës greke u bashkua me Kishën Autoqefale. Madje, Kongresi i Dytë Kishtar i vitit 1929 kishte përfaqësues të rregullt, të zgjedhur nga shumica dërrmuese e pakicës. Po ashtu, mërgata shqiptare ishte e pandarë ndaj çështjes kishtare, pavarësisht nga mëria që kishte ndaj Ahmet Zogut, teksa në masë ishte fanoliste. Vetëm një atdhetar shqiptar doli kundër zgjidhjes së vitit 1929: Koço Tasi. Ai kishte vërtetuar në të kaluarën dhe do të vërtetonte edhe në të ardhmen gjatë Luftës së Dytë Botërore se ishte për një Kishë Shqiptare Autoqefale Kombëtare e pa ndërhyrje greke. Mirëpo, kundërshtoi ashpër orvatjen e Kotës, Xhuvanit dhe Mbretit Zog. Megjithatë, të qenit i vetmi zë kundër dëshmon më së miri njëmendësinë shqiptare pro zgjidhjes së gjetur.

Po ashtu, punimi dëshmon se shteti shqiptar ka pasur rolin kryesor në zgjidhjen e çështjes kishtare, me udhërrëfimin politik të politikanëve ortodoksë, pra drejtuesit politikë ortodoksë shqiptarë ishin pararojë e lëvizjes kishtare shqiptare. Autoqefalia është shpallur sipas planveprimit politik të Sotir Pecit, Visar Xhuvanit dhe Pandeli Evangjelit, ndërsa bisedimet, krijimi i Sinodhit dhe njohja përfundimtare u krye me pararojë Koço Kotën, Vasil Avramin dhe Pandeli Evangjelin. Pa dyshim se Ahmet Zogu kishte rol të rëndësishëm në të gjitha këto veprime, si drejtues i Ministrisë së Brendshme në shpalljen e autoqefalisë, Kryetar i Republikës dhe Mbret në hapat e tjerë. Mirëpo, duket qartë se ai vendosi, duke u nisur nga këshillat, planet dhe pikësynimet e katërshes Peci, Kota, Avrami dhe Evangjeli e më pak Xhuvani dhe Noli. Madje, vlen të theksohet fakti se diplomatët grekë shpreheshin më të kënaqur nëse bisedues kishin politikanë myslimanë si Hysni Vrioni sesa si Avrami dhe Kota.

Drejtuesit kishtarë shqiptarë kanë vepruar në shërbim të dobisë kombëtare shqiptare. Të gjithë kryepriftërinjtë shqiptarë të kësaj periudhe: Jerotheu, Kristofori, Theofani, Visarioni, Agathangjeli, Eugjeni, Ambrozi dhe shumica dërrmuese e priftërinjve, nisur nga Atë Vasil Marko, Atë Josif Qirici, Atë Pano Gjirokastra etj., kishin për synim fuqizimin e një Kishe Autoqefale të pavarur nga ndërhyrjet greke dhe me qëllim rritjen e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Ata u vendosën në shërbim të synimit të përbashkët kombëtar. Bashkëpunimi i Zogut dhe Jerotheut në fillimvitin 1925 ishte jetësor për shmangien e trysnisë greke për zbatimin e Marrëveshjes së Beogradit; roli i Kristofor Kisit pas vitit 1933 ishte kryesor në ndihmesën e njohjes së autoqefalisë; roli i Visarion Xhuvanit ishte parësor në mosrënien pre të trysnive të njëpasnjëshme greke etj.

Historiografia shqiptare ka pasur paragjykime negative ndaj Jerotheut, Kisit, Joakimit dhe Kurillës, por ato nuk dalin të vërteta. Vlen të theksohet se dyshimet e hedhura mbi Xhuvanin si "njeri i Beogradit" në Tiranë nuk janë të përputhshme me ndodhitë e kohës. Ajo që del nga burimet arkivore është se kryepriftërinjtë shqiptarë kanë vepruar në dobinë shqiptare, disa herë kanë përdorur ndikimet e huaja në dobi të Shqipërisë, por nuk janë përdorur vetë në dobi të vendeve të tjera. Mjafton të kujtojmë dy njëmendësi: "Progreku" Jerotheu dorëzoi Nolin Mitropolit dhe njohu Kishën Autoqefale; "Proserbi" Visarion dëboi Episkopin Viktor dhe shqiptarizoi Kishën e Shkodrës.

Pasja e një qëllimi të përbashkët nuk nënkupton bashkëveprim të plotë mes këtyre kryepriftërinjve. Kisha Shqiptare u dallua për përplasje të forta të brendshme, të cilat në vetvete dëshmojnë se ajo vepronte si një Kishë e mirëfilltë Ortodokse, ku vendimet nuk ishin të qendërzuara, po ku përplasja e brendshme sillte ndryshime të vazhdueshme në çështje qeverisjeje. Dy rrymat fillestare ishin ndërmjet Visar Xhuvanit dhe Fan Nolit. Xhuvani ia doli të mbivendosej deri në Kongresin e Beratit, teksa mbi Nolin rëndonte fakti se ishte vetëshpallur episkop. Mirëpo, Kongresi i Beratit bëri që mbështetësit e Nolit të fitonin shumicën.

Prandaj, Xhuvani u mënjanua dhe dy episkopët Jerotheu dhe Kisi dorëzuan rregullisht Nolin për Mitropolit të Durrësit. Të gjithë mitropolitët në vijim do të ndiqnin rrugë të ndryshme e do të kishin përplasje me njëri-tjetrin. Jerotheu fillimisht ishte mbështetës i flaktë i Nolit, por kur ai ra nga pushteti dhe pa se Zogu mund të rrëzonte mbarë ngrehinën e ngritur kishtare, ai iu drejtua për ndihmë shtetit grek, duke u shfaqur më i ngurtë në çështjen kishtare. Mitropolit Jerotheu është paragjykuar rëndomtë nga historiografia shqiptare si "progrek" dhe nga ajo greke si "antigrek". Ky punim nxjerr në pah se veprimet e Jerotheut kanë qenë kombëtare dhe se dyshimet e hedhura nga

historiografia shqiptare vijnë prej mospasjes së burimeve të mjaftueshme për të dalluar qëllimet e tij. Akoma edhe shkresat kundërshqiptare pas largimit të tij provohet se kanë qenë të sajuara. Jerotheu "e pësoi" qëndrimin e tij atdhetar shqiptar, duke u syrgjynosur nga shteti grek dhe Patriarkana Ekumenike për çerek qindvjeçari, si episkopi i vetëm në Malin e Shenjtë murgjëror të Athosit.

Krejt e kundërta, Kristofor Kisi, që zgjodhi të qëndronte në Shqipëri, u shpërblye për qëndrimin atdhetar shqiptar, duke u bërë pas disa vitesh Kryepiskop. Kisi ishte fanolist i orëve të para dhe pati përplasje të ashpra me Jerotheun dhe Xhuvanin gjatë gjithë rrugëtimit në KOASH. Mirëpo, ai do të vinte në përplasje edhe me fanolistin tjetër Agathangjel Çamçe, i cili po ashtu do të kishte armiqësi të hapur me Visarion Xhuvanin. Këto përplasje të brendshme nuk ndikuan në tërësinë e çështjes kishtare, kryesisht falë ndërhyrjeve paqtuese të drejtuesve politikë ortodoksë shqiptarë e kryesisht të Koço Kotës dhe Vasil Avramit, si edhe prej rolit përbashkues që luante Atë Vasil Marko.

Kisha u fuqizua kur mori trajtën e një kishe kombëtare shqiptare. Zhvillimet ndërmjet viteve 1926-1937 dëshmojnë se KOASH u fuqizua ekonomikisht, duke arritur për herë të parë të paguante 400 priftërinjtë nga një buxhet i qendërzuar, të mirëmbante qindra faltore, të botonte përkthime, libra dhe të përkohshme, të përgatiste studentë për priftërinj dhe episkopë të ardhshëm, të çelte seminar kombëtar dhe mbi të gjitha të rriste numrin e ortodoksëve nga njëri numërim i popullsisë në tjetrin, duke arritur në 23%. Kjo periudhë përkon me ndalimin e dygjuhësisë së Mitropolisë së Gjirokastrës dhe shqiptarizimin e plotë të KOASH-it, me ndalimin e fushatave të huaja greke, sllave, unite, protestante dhe komuniste në Kishë, me predikimin e atdhedashurisë, me ndalimin e traditave të vjetra dhe ndërhyrje të tjera të thella në Kishë. Kahkundërt, kryepriftëria dyvjeçare e Mitropolit Jakovit në Korçë rrëfen për ulje të numrit të besimtarëve, mosveprim në çështje të traditave të papëlqyera etj.

Duhet theksuar se veprimet e shqiptarëve ishin në përputhje me të drejtën kishtare. Shpallja e autoqefalisë u krye me anë të një Kongresi Priftëror-Laik, në një kohë kur në vende të tjera kishte mjaftuar vetëm një shpallje mbretërore (Greqi) apo vendime qeveritare (Rumani). Krijimi i Këshillit të Lartë Kishtar ishte një arsyetim *sui generis*, në të drejtën kishtare, që shërben për t'u shqyrtuar veçmas e thellësisht. Krijimi i njëanshëm i Sinodhit ishte pasojë e pashmangshme e zvarritjeve të palës greke, nëpërmjet Patriarkanës Ekumenike dhe u bë me ndihmën shpirtërore të një kishe tjetër, asaj Serbe. Së fundmi, njohja e autoqefalisë pa kushte dëshmon rregullsinë e veprimeve kishtare shqiptare.

Kryepriftërinjtë grekë arritën deri në fepërdhosje, duke vepruar si etnofiletistë, në rastin e Jakovit, që mohonte meshimin në gjuhën amtare të popullsisë, apo duke mohuar "Symphoni"-në, që përbën të drejtën e patjetërsueshme të shtetit për të bashkëvepruar me Kishën e shtetit të vet. Mirëpo, kryepriftërinjtë shqiptarë, shumica dërrmuese e priftërinjve dhe drejtuesit shtetërorë ortodoksë shqiptarë ishin të qartë mbi domosdoshmërinë e zbatimit të atij parimi, si mënyra e vetme për të ruajtur edhe shtetin dhe kishën. Prandaj, krerët kishtarë shqiptarë vepruan në dobi kombëtare dhe krerët shtetërorë vepruan në mbrojtje të Kishës, në përputhje me detyrimin kishtar të "Symphon"-isë.

Pra, mund të themi se "Symphonia" bëri që drejtuesit kishtarë shqiptarë të ishin pararojë e nevojës për autoqefali pa kushte dhe për zhvillimin e një Kishe që nderonte kombëtarinë shqiptare. Pala shqiptare ia doli të nuhaste çastet e duhura për të përfituar

nga ulje-ngritjet e marrëdhënieve dypalëshe, të lidhura ngushtësisht me zhvillimet më të gjera në Ballkan dhe në botë. Lëvizja ngadhënjeu prej aftësisë dhe atdhetarisë së disa prej drejtuesve ortodoksë të shtetit, si: Kota, Evangjeli, Avrami, Peci dhe të Kishës, si: Jerotheu, Kristofori, Xhuvani, Noli etj. Autoqefalia e Kishës Shqiptare u arrit pa asnjë lëshim nga Shqipëria, falë këmbënguljes së Kryeministrit Koço Kota dhe Kryepiskopit Kristofor Kisi, të cilët iu përmbajtën parimit ortodoks të "Symphoni"-së.

BIBLIOGRAFIA

Burime arkivore

- Arkiva Qendrore e Shtetit Shqipëri (AQSH)
  - F. 2 "Asdreni"
  - F. 14 "Fan Noli"
  - F. 55 "Sotir Peci"
  - F. 99 "Kolonia shqiptare në Rumani"
  - F. 136 "ZV/Mitropolia Durrës"
  - F. 141 "Mitropolia Korçë"
  - F. 142 "Komuniteti Ortodoks Shkodër"
  - F. 149 "Kryeministria"
  - F. 150 "Ministria e Oborrit Mbretëror"
  - F. 152 "Ministria e Punëve të Brendshme"
  - F. 155 "Ministria e Drejtësisë"
  - F. 156 "Gjykata e Diktimit"
  - F. 163 "Legata Italiane"
  - F. 317 "Prefektura Korçë"
  - F. 536 "KOASH"
- Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ)
- Arkiva e Përgjithshme e Shtetit Greqi (GAK)
  - F. "Zyra Politike e Kryeministrit"
- Arkiva Historike dhe Logoteknike Greke (ELIA)
  - F. "Eleftherios Venizelos"
  - F. "Hrisanthos, Kryepiskopi i Athinës"

Burime nga shtypi i kohës

- Albania, kolana v. 1918.
- Apostull Andrea, kolana v. 1925.
- Dajti, kolana v. 1926.
- Gazeta e Korçës, kolana v. 1924-1929.
- Gazeta e Re, kolana v. 1928-1929.
- Gjergj Kastrioti, kolana v. 1924.
- Kisha Kombëtare, kolana v. 1930.
- Koha, kolana v. 1919-1926.
- Liria, kolana v. 1925.
- Lidhja ortodokse, kolana v. 1908.
- Posta e Korçës, kolana v. 1921.
- Predikimi, kolana v. 1934-1938.
- Skënderbeu, kolana v. 1925.
- Skrip, kolana v. 1916.
- Tirana, kolana v. 1924-1925.
- Zëri i Gjirokastrës, kolana v. 1923.
- Zëri i Korçës, kolana v. 1925-1929.

Burime arkivore të botuara

1. Çami, Muin., përg. *Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirimin Kombëtar 1918-1920 (përmbledhje dokumentesh) Vëllimi I*. Tiranë: Shtypshkronja "Mihal Duri", 1975.
2. Çami, Muin., përg. *Lufta e Popullit Shqiptar për Çlirimin Kombëtar 1918-1920 (përmbledhje dokumentesh) Vëllimi II*. Tiranë: Shtypshkronja "Mihal Duri", 1978.
3. Glavinas, Apostolos. *Εγγραφα περί της πραξικοπηματικής συγκροτήσεως της συνόδου της Ορθοδόξου Εκκλησίας της Αλβανίας (1929) [Dokumente mbi organizimin grushtshtetas të Sinodhit të Kishës Ortodokse të Shqipërisë (1929)]*. Janinë: Fondacioni i Hapësirës së Jonit dhe Adriatikut, 1981.
4. Kondis, Vasilios., dhe Manda, Eleftheria., përg. *The Greek Minority in Albania: A Documentary record (1921-1993) [Pakica Greke në Shqipëri: Një përmbledhje dokumentash (1921-1993)]*. Selanik: Instituti i Studimeve Ballkanike 1994.
5. Kondis, Vasilios., përg. *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 1, 1879-1918 [Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet grekoshqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 1, 1879-1918]*. Athinë: Estia, 1995.
6. Kondis, Vasilios. *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 2, 1918-1921 [Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet grekoshqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 2, 1918-1921]*. Athinë: Estia, 1995.
7. Kondis, Vasilios. *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 3, 1922-1929 [Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet grekoshqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 3, 1922-1929]*. Athinë: Estia, 1995.
8. Kondis, Vasilios. *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και ελληνοαλβανικές σχεσείς, έγγραφα άπο το ιστορικό αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, τομος 4, 1930-1940 [Helenizmi i Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet grekoshqiptare: dokumente nga arkiva historike e Ministrisë së Jashtme, Vëllimi 43, 1930-1940]*. Athinë: Estia, 1995.

Burime të dyta

1. Akademia e Shkencave, red. *70 Vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*. Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
2. Akademia e Shkencave, red. *Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi 3.* Periudha e Pavarësisë: 28 nëntor 1912-7 prill 1939. Tiranë: Toena, 2007.
3. Beduli, Dhimitër. *Gjuha Shqipe në Kishë*. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1997.
4. Beduli, Dhimitër. *Kishë dhe kulturë*. Tiranë: Instituti i Dialogut dhe i Komunikimit, 2006.
5. Beduli, Dhimitër. *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*. Tiranë: Neraida, 2007.
6. Beduli, Kristofor. *Atë Marko Papajani dhe shënimet e tij*. Tiranë: Neraida, 2004.
7. Beduli, Kristofor. *Dhimitër Beduli*. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 1999.
8. Beduli, Kristofor. *Episkop Irine Banushi*: *Martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*. Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2000.
9. Beduli, Kristofor. *Ortodoksët e Gollobordës*. Tiranë: Neraida, 2008.

10. Beduli, Kristofor. *Saqellar Atë Petro Doçi*. Tiranë: Neraida, 2006.
11. Bërxholli, Arqile. *Bashkësia shoqërore ortodokse në Shqipëri*. Tiranë: 2013.
12. Calahuris, Kostas. *Το Αυτοκέφαλο της Εκκλησίας της Δωδεκανήσου : από τα αρχεία του Υπουργείου των Εξωτερικών της Ελλάδος [Autoqefalia e Kishës së Dodekanezit: nga arkivat e Ministirsë së Jashtme të Greqisë]*. Athina: 1992.
13. Cironis, Theodhoris. *Εκκλησια Πολιτευομενη Ο Πολιτικός Λόγος και Ρόλος της Εκκλησίας της Ελλάδος (1913-1941) [Kisha në politizim: Fjala dhe Roli Politik i Kishës së Greqisë (1913-1941)]*. Athinë: Epikendro, 2011.
14. Çami, Muin. *Shqipëria në rrjedhat e historisë 1912-1924*. Tiranë: Onufri, 2007.
15. Cici, Foti. *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë: Nga bujtja e Nolit tek zhvarrosjet e Përmetit*. Tiranë: Globus R., 2006.
16. Daskarolis, Ioanis. *Στρατιωτικά κινήματα στην Ελλάδα του Μεσοπολέμου 1922-1935 [Lëvizje ushtarake në Greqinë e mesluftës 1922-1935]*. Athinë: Gnomon, 2012.
17. Della Rocca, Roberto Morozzo. *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*. Tiranë: Elena Gjika, 1994.
18. Dervishi, Kastriot. *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*. Tiranë: "55", 2006.
19. Dervishi, Kastriot. *Shërbimi sekret i shtetit shqiptar 1922-1944*. Tiranë: 55, 2007.
20. Duka, Valentina. *Histori e Shqipërisë 1912-2000*. Tiranë: SHBLU, 2007.
21. Enosis Smyrneon. *Ο Μητροπολίτης Μυτηλήνης Ιάκωβος, ο άπο Δυρραχίου [Mitropoliti i Mitilinit Jakovi, prej Durrësi]*. Athinë: Enosis Smyrneon, 1965.
22. Estrefi, Diana. *Ligjvënësit shqiptarë 1920-2005*. Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë, 2005.
23. Glavinas, Apostolos. *Ορθόδοξη Αυτοκέφαλη Εκκλησία της Αλβανίας [Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë]*. Selanik: Fondacioni i Hapësirave të Adriatikut dhe Jonit, 1992.
24. Glavinas, Apostolos. *Το αυτοκέφαλον της εν Αλβανία Ορθοδόξου Εκκλησίας επί τη βάσει ανεκδότων εγγράφων, [Autoqefalia e Kishës Ortodokse në Shqipëri mbi bazën e dokumenteve të pabotuara]*, Janinë: Fonadacioni i Jonit, 1978.
25. Grandits, Hannes., Clayer, Nathalie., dhe Pichler, Robert. *Conflicting Loyalties in the Balkans: The Great Powers, the Otoman Empire and Nation-Building*. London: I.B. Tauris, 2011.
26. Goldstein, Joshua S. *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*. Tiranë: Dituria, 2003.
27. Gurakuqi, Romeo. *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë 1913-1914* (Tiranë: UET Press, 2012).
28. Heywood, P. et. al., eds. *Developments in European Politics [Zhvillime në politikat evropiane]*. Londër: Palgrave, 2006.
29. Huntington, Samuel P. *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*. Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos-A, 2009.
30. Ikonomu, Fotios G. *Η Ιστορια των τοπικων εκκλησιων της Ηπειρου Τομος Β' [Historia e kishave lokale të Epirit, Vëllimi 2]*. Athinë: 1969.
31. Ikonomu, Fotios G. *Η Ορθόδοξος Εκκλησία της Αλβανίας και η συμβολή της εις την διατήρησιν του ελληνισμού της Βορείου Ηπείρου [Kisha Ortodokse në Shqipëri dhe kontributi i saj në ruajtjen e helenizmit të Epirit të Veriut]*. Athinë: Nees Theseis, 1988.
32. Jelavich, Charles., dhe Jelavich, Barbara. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit: 1804-1920*. Tiranë: Dituria, 2004.
33. Jorgaqi, Nasho. *Jeta e Fan S. Nolit V. 1*. Tiranë: Ombra GVG, 2006.

34. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë. *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipris.* Korçë: Gazeta e Korçës, 1929.
35. Kissinger, Henry. *Diplomacia.* Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999.
36. KOASH. *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë.* Korçë: Dhori Koti, 1923.
37. Kola, Sifi. *Ο Αργυροκάστρου Παντελεήμων: Ο Αγωνιστής Ιεράρχης της Β. Ηπείρου [I Gjirokastrës Pandelejmoni: Kryeprifti luftues i Epirit V.]*. Athinë: Nei Palmi, 1970.
38. Kostandinidhis, Emanuil. *Η ανακηρυξις του αυτοκεφαλου της εν Ελλαδι Εκκλησιας 1850. και η θεσις των μητροπολεων των Νεων Χωρων 1928 [Shpallja e autoqefalisë së Kishës në Greqi 1850. dhe vendi i mitropolive të vendeve të reja]*. Athinë: 1974.
39. Krisafi, Ksenofon. *Për tokën dhe detin e Shqipërisë.* Tiranë: UET Press, 2014.
40. Leustean, Lucian edit. *Eastern Christianity and the Cold War, 1945-91 [Krishtërimi Lindor dhe Lufta e Ftohtë, 1945-91]*. Londër: Routledge, 2010.
41. Llukani, Andrea. *Kanonet dhe statutet e kishës ortodokse.* Tiranë: Trifon Xhagjika, 2011.
42. Llukani, Andrea. *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë: nga vitet apostolike deri në vitet tona.* Tiranë: Botimet "Trifon Xhagjika", 2005.
43. Makmillan, Margaret. *Paris 1919: gjashtë muajt që ndryshuan Botën.* Tiranë: Plejad, 2006.
44. Malltezi, Luan., dhe Delvina, Sherif. *Mid'hat Frashëri Ministër fuqiplotë: Athinë 1923-1926.* Tiranë: Lumo Skëndo, 2002
45. Matanov, Hristo., et. al. *Historia e Bullgarisë.* Tiranë: Teuta, 2006.
46. Mehmetaj, Faton. *Veprimtaria kriminale e "Dorës së Zezë" serbe në trojet shqiptare.* Prishtinë: Anatema, 2004.
47. Meta, Beqir. *Tensioni grekoshqiptar 1939-1949.* Tiranë: Geer, 2002.
48. Murzaku, Inez. *Returning home to Rome: the Basilian monks of Grotaferrata in Albania [Duke u kthyer në Romë: murgjit bazilianë të Gotaferratës në Shqipëri]*. Gotaferrata, Romë: Analekta Kryptoferris, 2009.
49. Nathanaili, Petrit. *Marrëdhëniet ndërkombëtare nga origjina deri më sot.* Tiranë: Filara, 2009.
50. Nesimi, Qani. *Ortodoksizmi te shqiptarët.* Tetovë: 2005.
51. Noli, Fan S. (Mitropolit). *Pesëdhjetëvjetori i Kishës Ortodokse Shqiptare 1908-1958.* Boston: KOSH, 1958.
52. Novosela, Vasil J. Tako. *Përgjigje e Shqiptarëvet Krishten të Misirit për Botimet e Koço Tasit.* Misir: 1929.
53. Paraskevopulos, Tasos P. *Δεκαπέντε ημέραι εις την Αλβανία [Pesëmbëdhjetë ditë në Shqipëri]*. Athinë: Pyrsou, 1931., 28.
54. Periç, Dimso. *Srpska pravoslavna crkva i njena dijaspora [Kisha Ortodokse Serbe dhe Mërgata e Saj]*. Beograd: 1996.
55. Përmeti, Turhan Pashë. *Shqipëria përballë Konferencës së Paqes Paris 1919.* Tiranë: Eugen, 2007.
56. Pangalos, Theodoros. *Τα απομνημονεύματά μου 1897-1947 [Kujtimet e mia 1897-1947]*. (Athinë: 1959).

57. Petito, Fabio., dhe Hatzopoulos, Pavlos. *Religion in international relations: the return from exile [Feja në marrëdhëniet ndërkombëtare: Rikthimi nga ekzili]*. Londër: Palgrave Macmillan, 2003.
58. Polinder, Simon. *International relations, religion, and the transcendent [Marrëdhëniet ndërkombëtare, feja, dhe e përtejmja]*. Leuven: Peeters, 2008.
59. Pop, Ioan-Aurel., dhe Bolovan, Ioan. *History of Romania [Historia e Rumanisë]*. Bukuresht: Instituti i Kulturës Rumuna, Qendra për Studime mbi Transilvaninë, 2006.
60. Poradeci, Lasgush. *Vepra 2*. Tirana: "Onufri", 1999.
61. Puto, Arben. *Shqipëria politike: 1912-1939*. Tiranë: Toena, 2009.
62. Qiriazi, Dhori. *Krishtërimi në Shqipëri*. Tiranë: Argeta-LMG, 2000.
63. Rich, Norman. *Diplomacia e fuqive të mëdha 1814-1914*. Tiranë: Instituti i Dialogut & Komunikimit; Botimet Toena, 2006.
64. Rigos, Alkis. Η Β΄ Ελληνική Δημοκρατία 1924-1935. [Republika e Dytë Greke 1924-1935]. Athinë: Themelio, 1988.
65. Sekretariati i Sinodhit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, *L'Eglise Autocephale Orthodoxe d'Albanie [Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë]*. Gjenevë: Imprimerie Albert Kundig, 1929.
66. Spahiu, Avni. *Noli: Jeta në Amerikë*. Tiranë: Toena, 2007.
67. Spahiu, Nexhmedin. *National Awakening Process among Orthodox Albnaians.* Hamburg: 2006.
68. Stamatoviç, Aleksandar. *Kratka istorija Mitropolije Crnogorsko-primorske 1219-1999 [Historia e Mitropolisë së Malit të Zi 1219-1999]*. Podgorica: Svetigora, 2000.
69. Stratigaqis, Ioanis Em. *Ο Μητροπολίτης Μυτιλήνης Ίακωβος: ο άνθρωπος και η δράση του [Mitropoliti i Mitilinit Jakovi: njeriu dhe vepra e tij]*. Athinë: 1956.
70. Swire, Joseph. Shqipëria: *Ngritja e një mbretërie.* Tiranë: Dituria, 2005.
71. Tasi, Koço. *Shqiptarvet të Krishtern bashkëpunëtorë të Muhamedanëvet.* Athinë: 1929.
72. Tasudhis, Gjeorgjios. *Βιογραφικαί αναμνήσεις του Αρχιεπισκόπου Αθηνών Χρύσανθου του από Τραπεζούντος: 1881-1949 [Kujtimet biografike të Kryepiskopit të Athinës Krisanthosit nga Trapezunda: 1881-1949]*. Athinë: Kostandinidhi & Mihala, 1970.
73. *Τραπεζούντος Χρύσανθος: Επίσημα έγγραφα περι της Εκκλησιαστικής και Εθνικής δράσεως του [Krisanthosi i Trapenzundës: Dokumente zyrtare mbi veprimtarinë e tij kishtare dhe kombëtare]*. Aleksandri: 1925.
74. The Pan Albanian Federation of America Vatra, *Statement of the Christian Orthodox Albanians Natives of the Districts of Koritza and Kolonia in Reply To the Declaration of the Pan-Epirotic Union in America, of May, 1919,* Boston: Vatra, 1919.
75. Tritos, Mihail. *Η εκκλησία στο ανατολικό Ιλλυρικό και την Αλβανίαë [Kisha në Ilirikun Lindor dhe në Shqipëri]*. Athinë: Qiriaqidhi Afi, 1999.
76. Vaso, Thanas. *Οι βουλευτές της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας στο Αλβανικό Κοινοβούλιο 1920-2011 [Deputetë të Pakicës Etnike Greke në Kuvendin Shqiptar 1920-2011]*. Tiranë: Neraida, 2012.
77. Veremis, Thanos. *Zgjerimi ballkanik i Greqisë.* Athinë: Fondacioni Helenik për Politikë të Jashmte dhe Evropiane, 1995.
78. Verli, Mareglen përg. *Shqipëria e viteve 1912-1964 në kujtimet e Spiro Kosovës Vëllimi 1.* Tiranë: Klean 2008.
79. Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime politike në Shqipëri.* Tiranë: Vllamasi, 2012.

80. Ware, Timothy. The *Orthodox Church [Kisha Ortodokse]*. New York: Penguin Books, 1980.
81. Xhuvani, Nos. *Na flet Visarion Xhuvani.* Tiranë: 2008.
82. Xhuvani, Nos. *Visarion Xhuvani: Apostull i Atdhetarizmit dhe i Ortodoksisë.* Shqiptare Tiranë, 2003.
83. Xhuvani, Visarion (Episkop*). Çështje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë Pjesa I.* Tiranë: Tirana, 1926.
84. Xhuvani, Visarion (Episkop). *Çështje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë Pjesa II.* Tiranë: Tirana, 1926.
85. Xhuvani, Visarion (Episkop). *Kujtim vepre dhe intrige.* Tiranë: Tirana, 1926.
86. Xhuvani, Visarion (Kryepiskop), *Vepra, Për Kishën Orthodhokse Shqiptare; Në Kuvendin e Shqipërisë; Për jetën dhe veprën,* përg. Nos Xhuvani dhe Pavli Haxhillazi Tiranë: "55", 2007.
87. Xorxatos, Varnavas (Mitropolit). *Η Αυτοκέφαλος Ορθόδοξος Εκκλησία της Αλβανίας και οι βασικοί θεσμοί διοικήσεως Αυτής [Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe institucionet bazike administrative të saj]*. Athinë: 1975.
88. Xoxa, Zoi. *Kujtimet e një shkruesi.* Tiranë: "55", 2007.
89. Xoxi, Koli. *Shkolla ortodokse në Shqipëri dhe rilindësit tanë.* Tiranë, 2002.

Punime doktorale të pabotuara

1. Bido, Ardit. "Autoqefalia e Kishës Ortodokse si aktor dhe faktor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare". Mikrotezë, Universiteti i Tiranës, 2011.
2. Janaku, Maria. "Ο Μητροπολίτης Αργυροκάστρου Παντελεήμων και το Βορειοηπειρωτικό Ζήτημα [Mitropoliti i Gjirokastrës Pandelejmon dhe Çështja Vorioepirotase]". Mikrotezë, Universiteti Aristotel i Selanikut, 2009.
3. Katopodhis, Apostolos. "Ο Μητροπολίτης Δρυινουπόλεως Βασίλειος Παπαχρήστου στο Βοριοηπειρώτικο Αγώνα, [Mitropoliti i Drinupojës Vasil Papakristu në Betejën Vorioepirotase]". Disertacion, Universiteti Aristotel i Selanikut, 2001.
4. Kondili, Pirro. "Η Ορθόδοξη Εκκλησία της Αλβανίας κατά τη διάρκεια της κομμουνιστικής δικτατορίας [Kisha Ortodokse e Shqipërisë gjatë diktaturës komuniste". Master, Universiteti Athinës, 2002.
5. Kulas, Antonios. "Ελληνογιουγκοσλαβικές σχέσεις άπο το 1923 εώς το 1928 [Marrëdhëniet greko-jugosllave nga 1923 deri më 1928]". Disertacion, Universiteti i Selanikut, 2007.
6. Marmarinos, Justinios. "Η συμβολή του Μητροπολίτη Τραπεζούντος Χρύσανθου στην ανακήρυξη του αυτοκεφάλου της εν Αλβανία Ορθοδόξου Εκκλησίας". Mikrotezë, Universiteti Kombëtar dhe Kapodistriak i Athinës, 2003.
7. Simaku, Gjergji (Atë Dhaniil). "Theofan Mavromati (Fan Noli): Pasoja të tendencave nacionaliste në ndryshimin e përkatësisë dhe besimit kombëtar". Disertacion, Universiteti i Selanikut, 2011.

Kumtesa/botime shkencore

1. Anastasi, Aurela. "Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe evoluimi i tij". *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.* Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
2. Avakumoviç, Mirko. "Pravoslavna Crkva u Albaniji [Kisha Ortodokse në

Shqipëri].” *Arhiv za pravno i drustvene nauke [Arkivë për Shkenca Ligjore dhe Shoqërore]* 4 (1936).

3. Bido, Ardit. “The Church Issue of Shkodra between Albania and Yugoslavia in its Initial Phase (1912-1923).” *International Journal of Humanities and Social Science* [“Çështja kishtare e Shkodrës mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë në periudhën e saj fillestare (1912-1923)” *Revista Ndërkombëtare e Humaniteteve dhe Shkencave Shoqërore*] 4:12 (2014).
4. Bido, Ardit. “The role of Metropolitan Iakovos in Albanian-Greek relations (1919-1921)” *International Journal of Scientific and Research Publications (IJSRP)* [“Roli i Mitropolit Jakovit në Marrëdhëniet Shqiptaro-Greke (1919-1921)” *Revista Ndërkombëtare e Botimeve Kërkimore dhe Shkencore (IJSRP)*] 4:9 (2014).
5. Bihiku, Koço. “Themelimi i Kishës Ortodokse Kombëtare dhe roli i Nolit”. *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*. Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
6. Çami, Muin. “Kleri i Lartë Ortodoks në Shqipëri dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1912-1921”. *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.* Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
7. Çami, Muin. “Ushtarakët francezë në Korçë, mbështetës të aspiratave kombëtare të popullsisë (1916-1920).” *Studime Historike* 3-4 (2002).
8. Duka, Valentina. “Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut: Një vështrim të legjislacionit të kohës (1928-1939)”. *Studime Albanologjike* 11:1 (2011).
9. Duka, Valentina. “Veprimtaria e Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës (1912-1920)”. *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.* Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
10. Dushku, Ledia. “Debatet shqiptaro-greke dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922).” *Studime Historike* 3-4 (2006).
11. Fox, Jonathan. “Religion as an Overlooked Element of International Relations [Feja si një element i anashkaluar i marrëdhënieve ndërkombëtare]”, *International Studies Review [Rishikimi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare]* (2003).
12. Fox, Jonathan. “The Multiple Impacts of Religion on International Relations: Perceptions and Reality [Impaktet e shumëfishta të fesë në Marrëdhëniet Ndërkombëtare: Perceptimi dhe realiteti].” *International Studies Review [Rishikimi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare]* (2001).
13. Glavinas, Apostolos. “Ο Μητροπολίτης Δυρραχίου Ιάκοβως και οι δραστηριότητες του για το εκκλησιαστικό ζήτημα της Αλβανίας.” *Ηπειρότηκο Ημερολόγιο* 2 (1986).
14. Glavinas, Apostolos. “Ο Συναδών Χριστόφορος και οι δραστηριότητες του για το εκκλησιαστικό ζήτημα της Αλβανίας [Kristofori i Sinadhon dhe veprimtaria e tij në zgjidhjen e çështjes kishtare të Shqipërisë]”, *Ηπειρότηκο Ημερολόγιο [Ditari Epirotas]* 2 (1984).
15. Glavinas, Apostolos. “Ιωακείμ Μαρτίστης η Μαρτινιανός [Joakim Martishti ose Martiniani]”, *Ηπειρωτικό Ημερολόγιο [Ditari Epirotas]* 3 (1981).
16. Jani, Alqi. “Papa Pano Gjirokastra – Figurë e shquar e Kishës Shqiptare”. *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.* Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
17. Kalezić, Dimitrije M. “Srpske škole u Albaniji [Shkollat serbe në Shqipëri]”, *Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Popullsia me origjinë sllave në Shqipëri”,* Cetinjë, Mali i Zi, 21-23 qershor 1990.

18. Lynch, Cecelia. "A neo-Weberian approach to religion in international politics [Një përqasje neo-Veberiane për fenë në politikën ndërkombëtare]." *International Theory [Teoria ndërkombëtare]* 1 (2009).
19. Meta, Beqir. "Autoqefalia e Kishës Ortodokse Shqiptare në procesin e formimit të institucioneve kombëtare në vitet 1920-1924". *Studime Albanologjike* 11:1 (2011).
20. Meta, Beqir. "Çështja e minoriteteve në Shqipëri, në Lidhjen e Kombeve në vitet '30." *Studime Historike* 3-4 (2006).
21. Meta, Beqir. "Debati shqiptarogrek për problemet e minoriteteve dhe të Kishës Autoqefale Shqiptare në organizmat ndërkombëtare në vitet 1929-1934." *Studime Historike* 3-4 (2011).
22. Meta, Beqir. "Përpjekjet për konsolidimin e institucioneve kombëtare (1925-1935)." *Studime Historike* 3-4 (2008).
23. Meta, Beqir. "Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj pakicës etno-kulturore vllehe dhe asaj malazeze në vitet 1920-1924." *Studime Historike* 3-4 (2009).
24. Meta, Beqir. "Përpjekjet për konsolidimin e Kishës Autoqefale Shqiptare sipas optikës së diplomatëve britanikë në vitet 1925-1928." *Studime historike* 1-2 (2012).
25. Naska, Kaliopi. "Kongresi themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat". *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.* Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
26. Noli, Fan. "Declaration concerning the Protection of Minorities in Albania [Shpallje mbi Mbrojtjen e Pakicave në Shqipëri]", *League of Nations Treaty Series* 51 (1922)
27. Panev, Atë Zhivko. "Some remarks on the Notion of Autocephaly [Disa shënime mbi konceptin e autoqefalisë]." *Sourozh* 63 (1996).
28. Pelushi, Joan (Mitropolit). "Kisha Ortodokse dhe Konfliktet Etnike." *Tempulli* 9 (2004).
29. Philpot, Daniel. "The religious roots of modern international relations [Rrënjët fetare të marrëdhënieve moderne ndërkombëtare]." *World Politics* 1 (2000).
30. Psomas, Lambros. "Το πρόβλημα της άρνησης των Σέρβων για υποστήριξη των πρώτων προσπαθειών των Ορθοδόξων Αλβανών για αυτοκέφαλη Εκκλησία [Problemi i refuzimit të serbëve për mbështetjen e përpjekjeve të para të ortodoksëve shqiptarë për kishë autoqefale]." *Teologjia* 77: 2 (2006).
31. Rama, Fatmira. "Sinodi i Parë Shqiptar dhe Kongresi i Dytë Panortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare". *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.* Tiranë: Instituti i Historisë, 1993.
32. Rama, Fatmira. "Shteti dhe njohja e Kishës Autoqefale Shqiptare (1922-1929)". *Studime Albanologjike* 11:1 (2011).
33. Roudometof, Victor. "From Rum Millet to Greek Nation: Enlightenment, Secularization, and National Identity in Otoman Balkan Society, 1453-1821", *Journal of Modern Greek Studies* 16:1 (1998).
34. Tushi, Dion. "Joakim Martiniani". *Kërkim* nr. 6. (Tiranë: KOASH, 2010).

Botime në të përkohshme

1. "Personalitet i dyfishtë, Ikonom Papapano atdhetar shqiptar dhe prift shqiptar", Autoqefalia Ortodokse Shqiptare, nr. 10, shtator 1994, 3.
2. "Meditim rreth dy fotografive", Autoqefalia Ortodokse Shqiptare nr. 5, 1994, f. 3.
3. Bidoshi, Petrit. "Një ngjarje e paharrueshme e vitit 1916 në Durrës", Autoqefalia Ortodokse Shqiptare nr. 7, qershor 1994, 5.

4. Dilo, Vasil. “Psikoza e “Vorio Epirit”dhe marrëveshjet mbi protokollin e Korfuzit”. *Ndryshe*, 26 prill 2007.
5. Papahristo, Sotir. “Ngritja e flamurit në Korçë pas luftës me "batalionin e shenjtë": [përkthyesi Sotir Papahristo boton autobiografinë e tij]”. *Standard*, 28 prill 2009.
6. Vasili, Ilia S. “Si e gjeta Episkop Jerotheos”. *Ngjallja*, gusht 1996.
7. “Personalitet madhor i Kishës sonë Orthodhokse: Imzot Kristofor Kisi”. *Ngjallja*, korrik 1996.
8. Jani, Alqi. “Të njohim dhe nderojmë klerikët e Kishës Ortodokse të Shqipërisë: Episkopi Eugjen Hoshteva”. *Republika*, 27 maj 2009.

ABSTRAKT

Tema: Autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë në marrëdhëniet shqiptaro-greke 1918-1937
Fusha: Marrëdhënie Ndërkombëtare

Ky punim doktoral trajton ndikimin e marrëdhënieve shqiptaro-greke në çështjen e Kishës Ortodokse të Shqipërisë nga viti 1918 deri në njohjen përfundimtare të autoqefalisë. Punimi shtjellon përpjekjet shqiptare për krijimin e një Kishe Kombëtare, të pavarur nga ndikimet e huaja politike dhe me gjuhë të vetme shqipen. Po ashtu, trajton orvatjen e shtetit grek për ta vendosur Kishën Shqiptare nën drejtimin e besnikëve të saj dhe për të minuar shtetin e sapokrijuar. Ai pasqyron shpalljen e autoqefalisë dhe arsyet përse Patriarkana fillimisht e bekoi, por më vonë nuk e njohu Kishën Shqiptare. Aty detajohen edhe përpjekjet për zgjidhje të njëanshme. Trazirat e brendshme politike si në Shqipëri, ashtu edhe në Greqi e kaluan gjendjen sa në dobi të njërës palë, sa në dobi të palës tjetër. Teza shqyrton arsyet e ndryshimit të baraspeshave në mesin e viteve `30 dhe rolin që luajti Jugosllavia dhe Italia. Punimi trajton gjerësisht krijimin e njëanshëm të Sinodhit të Shenjtë dhe kundërveprimin grek. Njëherazi, analizon zhvillimet e brendshme dhe fuqizimin e KOASH-it, si ndikues në zgjidhjen përfundimtare. Në fund, trajtohen arsyet pse Greqia u detyrua të pranonte autoqefalinë shqiptare pa asnjë kusht të rëndësishëm.

Fjalët kyçe: Shqipëria, Greqia, Feja, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Fuqia e Butë

ABSTRACT

Topic: The Autocephaly of the Orthodox Church of Albania in Albanian-Greek Relations 1918-1937
Field: International Relations

This doctoral thesis analyzes the impact of Albanian-Greek relations in the issue of Orthodox Church of Albanian from 1918 to the final acceptance of Autocephaly. The thesis develops the Albanian effort for the creation of a National Church, independent from foreign political influences and with Albanian as its sole official language. It also explains the Greek state`s bid to put the Albanian Church under the leadership of clergyman loyal to Greece in order to undermine the newly established Albanian state. It discusses the declaration of Autocephaly and the reason why the Ecumenical Patriarchate initially blessed, but latter did not recognize the Albanian Church. It also details the efforts for a unilateral solution. Internal turmoil in Albania and Greece gave the whip hand once to Tirana, once to Athens. The thesis marks the reasons of balance change in the middle of `30 and the role that Yugoslavia and Italy played. It analyses the unilateral creation of the Saint Synod and the Greek reaction. It also analyses the internal developments and the consolidation of the Albanian Church, as a catalyst to the final solution. Finally, it notes the reasons why Greece was forced to accept the Albanian autocephaly without any notable condition.

Keywords: Albania, Greece, Religion, International Relations, Softpower